

MODULE TRAJNIMI

PËR TRAJNIMIN BAZË TË PUNONJËSVE
TË POLICISË TË SISTEMIT TË BURGJEVE



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Module Trajnimi

**Për Trajnimin Bazë të Punonjësve të
Policisë të Sistemit të Burgjeve**

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, 2022”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t’i drejtohen Directorate General Human Rights and Rule of Law.

@ Këshilli i Evropës, Prill 2022. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Europian sipas kushteve të miratuara.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Kopertina: Source One. Shtypur: Source One

Tabela e lëndës

Pjesa e parë

Moduli 1: Hyrje në sistemin e drejtësisë penale (3 orë)	8
Moduli 2: Të burgosurit dhe mjedisi i burgut (2 orë)	23
Moduli 3: Parandalimi i keqtrajtimit dhe roli i Mekanizmit Kombëtar dhe Ndërkombëtar për parandalimin e torturës (2 orë)	32
Moduli 4: Kodi i Sjelljes (4 orë)	46
Moduli 5: Komunikimi (4 orë)	65
Moduli 6: Diversiteti kulturor (3,5 orë)	82
Moduli 7: Programi i Rehabilitimit Social (3,5 orë)	97
Moduli 8: Teknikat për zgjidhjen e një krize pa përdorimin e forcës (3.5 orë)	112
Moduli 9: Menaxhimi i sjelljes së të burgosurve (3 orë)	127

Pjesa e dytë

Moduli 1: Siguria statike, procedurale dhe dinamike (4 orë)	146
Moduli 2: Vlerësimi i situatës – Vetëdija ndaj mjedisit që ju rrethon (2 orë)	168
Moduli 3: Mbikëqyrja e të burgosurve (2,5 orë)	179
Moduli 4: Transportimi dhe shoqërimi i të burgosurve (5 orë)	190
Moduli 5: Teknikat e kontrollit dhe sendet e ndaluara (5.5 orë)	206
Moduli 6: Përgatitja për situatat e emergjencës (4 orë)	233
Moduli 7: Çelësat dhe Kontrolli i Mjeteve të Punës (1,5 -2 orë)	247
Moduli 8: Shkrimi i raporteve (3 orë)	255
Moduli 9: Përdorimi i forcës (5 orë, duke përfshirë edhe detyrat)	267
Moduli 10: Përdorimi i mjeteve kufizuese (4 orë)	299

Module Trajnimi
Pjesa e Parë

Moduli 1: Hyrje në sistemin e drejtësisë penale (3 orë)

Objektivat

Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të përkufizojnë sistemin e drejtësisë penale;
- të kuptojnë filozofinë pas dënimit ligjor, në bazë të shtetit të së drejtës dhe të bëjnë dallimin midis **qëllimeve hakmarrëse dhe utilitariste** të sistemit të drejtësisë penale;
- të rendisin agjencitë përbërëse të sistemit të drejtësisë penale;
- të shpjegojnë misionin dhe vizionin e sistemit të drejtësisë penale;
- të shpjegojnë strategjinë e sistemit të burgjeve për ekzekutimin e dënimeve me burgim;
- të kuptojnë konceptin e **performancës morale të burgjeve**;
- të rendisin standardet bazë të të drejtave të njeriut gjatë një procesi penal, siç sanksionohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- të kuptojnë pasojat dhe shkeljet që përbëjnë një akt penal kundër veprimtarisë shtetërore.

1. Sistemi i drejtësisë penale (60 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në juridiksionet moderne, në bazë të shtetit të së drejtës, qëllimi i përgjithshëm i sistemit të drejtësisë penale është përmirësimi dhe ruajtja e drejtësisë në shoqëri. Në kontekstin e ndëshkimit ligjor nga sistemet e drejtësisë penale të shoqërive moderne demokratike, ndiqen dhe kombinohen **dy qëllime apo orientime kryesore**:

Qëllimi 1: Ndëshkimi ligjor si instrument **për rivendosjen e drejtësisë dhe paanësisë** në shoqëri.

Ky objektiv arrihet përmes **dy nënobjektivave të ndëshkimit dhe kompensimit të viktimës si palë e dëmtuar**.

Ky qëllim përfshin fillimisht idenë e shpagimit, e cila është ndoshta teoria më e famshme e ndëshkimit. Fraza të njohura të tilla si “dhëmbë për dhëmbë”, shprehin idenë bazë të hakmarrjes: autorët duhet të marrin atë që meritojnë, që është vuajtja e dënimit në proporcion me dëmin që u kanë shkaktuar viktimave të tyre. Ndëshkim hakmarrës nënkupton eliminimin e një avantazhi të padrejtë që lind nga krimi: ndëshkimi shihet si mënyrë për rivendosjen e paanësisë dhe drejtësisë në shoqëri. Qëllimet e rivendosjes së drejtësisë dhe paanësisë përfshijnë edhe kompensimin e viktimës si palë e dëmtuar dhe riparimin e dëmit që i është bërë viktimës (drejtësia restauruese). **Retributivizmi (ndëshkimi)**, i cili përqendrohet në vlerën e brendshme të kompensimit ndëshkues dhe/ose në eliminimin e avantazhit të padrejtë është **një perspektivë në thelb e prapambetur**. Sipas ndëshkimit, justifikimi i dënimit ligjor nuk shtrihet në efektet e tij të ardhshme, pavarësisht nëse ato janë reformimi i autorit apo parandalimi i individëve të tjerë nga kryerja e krimeve. Dënimi është çështje merite,

përgjegjësie morale dhe drejtësie. Kjo lidhet me pikëpamjen e integruar në teoritë retributiviste ku individët janë faktorë moralë me kapacitet për sjellje të përgjegjshme morale.

Qëllimi 2: Dënimi ligjor si mjete për parandalimin/uljen e krimit (Konsekuencializmi).

Dënimi ligjor i shërben të mirës së menjëhershme **të parandalimit/uljes së krimit** dhe nxitjes së sigurisë në komunitet. Konsekuencializmi argumenton se dënimi ligjor mund të çojë në parandalimin e krimit në mënyra të ndryshme.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet: Cilat janë mënyrat përmes të cilave dënimi ligjor mund të arrijë parandalimin dhe reduktimin e krimit?

Trajneri e fton grupin në diskutim të lirë, duke dalë me sa më shumë ide që të jetë e mundur.

Pas mbledhjes së përgjigjeve dhe shkrimit të tyre në tabelë, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

- Dënimi ligjor i pengon individët të kryejnë vepra penale përmes ekzekutimit të tij ose si kërcënim potencial. Kërcënimi me dënim bëhet për t'u dhënë individëve një nxitje që të mos e shkelin ligjin. Ky quhet si **parandalim i përgjithshëm**.
- Shkelësi që është dënuar mund të frenohet në kryerjen e veprave të tjera penale për shkak të përvojës së pakëndshme të dënimit. Ky quhet si **parandalim i veçantë**.
- Dënimi ligjor dhe, veçanërisht, burgu e dënimi kapital, bëhen për ta **bërë shkelësin** të paaftë për të kryer krime të mëtejshme. Shumica e sanksioneve krijojnë gjendje pamundësie të pjesshme dhe të përkohshme për autorët dhe jo të plota e të përhershme. Burgimi i pengon të burgosurit të kryejnë shkelje të caktuara, por ekziston ende mundësia që i burgosuri të mund të kryejë krime kundër shokëve të tij ose kundër oficerëve të burgut. Për sa kohë që dikush nuk është i burgosur përjetësisht, atëherë ky paaftësim është vetëm i përkohshëm.
- Të qenit objekt dënimi mund ta reformojë ose ta rehabilitojë autorin. Reforma nënkupton modifikimin që qëllimi i dënimit mund t'i bëjë gjendjes së njerëzve në mënyrë që ata me vullnetin e tyre t'i shmangen krimit e të mos kryejnë krime në të ardhmen. Të paktën nga ana teorike, dënimi nxit respektin ndaj ligjit penal, si dhe arsyetimin e autorit se krimi i kryer ishte i gabuar.

Sistemi i drejtësisë penale zbaton dhe realizon detyrimet e parashikuara nga ligji penal për t'i shërbyer:

- interesave të komunitetit
- viktimës
- dhe autorit të veprës

Një grup i agjencive dhe funksioneve të ndërlidhura për:

- zbatimin e ligjit
- ndjekjen penale
- mbrojtjen

- gjyqësorin dhe
- zbatimin e vendimeve penale

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit të përmendin agjencitë që përbëjnë Sistemin e Drejtësisë Penale.

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

Agjencitë e sistemit të drejtësisë penale janë:

- Sistemi gjyqësor
- Policia
- Prokuroria
- Sistemi i burgjeve
- Shërbimi i Provës

Shënim për trajnerin

Ndani klasën në pesë grupe dhe kërkojini secilit grup të diskutojë misionin dhe detyrat e pesë agjencive.

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh:

Kontributi i trajnerit

- **Sistemi Gjyqësor.** Në bazë të nenit 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Pjesë e sistemit gjyqësor janë edhe Gjykatat për vepra penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe ajo e apelit, për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, organizohet dhe funksionon për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe selinë e ka në Tiranë. Këto gjykata janë krijuar për herë të parë me ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor (2017), i hartuar në kuadër të reformës për drejtësi. Gjykata, përmes ligjeve të vëna nga dega legjislative dhe pas dëgjimit të provave, përcakton fajësinë apo pafajësinë e individit dhe vendos për dënimin e tij.
- **Policia** është një organ i specializuar për parandalimin dhe luftën kundër krimit. Detyrat, misioni, struktura dhe funksionimi i saj janë parashikuar në Ligjin e Policisë së shtetit. (2014) Policia nuk jep dënim, por vetëm bën arrestimin e të dyshuarit për krimin. Policia nuk duhet të harrojë se personi është i pafajshëm deri në momentin që gjykata vendos për fajësinë e tij.
- **Prokuroria** në bazë të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit. Ndonëse prokurorët nuk janë pjesë e sistemit gjyqësor, ato janë organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar.
- **Sistemi i Burgjeve dhe Paraburgimit** (Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale) është pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale, që ka për mision, pritjen, sistemimin, trajtimin dhe sigurimin e personave të dënuar me masë sigurie arrest me burgim, ose të dënuar me burgim. Burgu shërben për mbajtjen e personit larg shtetasve të tjerë me qëllim mbrojtjen e publikut. Po ashtu, burgu

duhet të bëjë çfarëdolloj gjëje që mundet për ta ndihmuar të burgosurin të fitojë aftësi dhe të ndjekë të gjitha trajtimet e mundshme, në mënyrë që kur ai të lirohet, të jetë i përgatitur ta jetojë jetën pa krime, nëse e zgjedh diçka të tillë. Pra, një individ dërgohet në burg si dënim e jo për t'u ndëshkuar aty. Kjo do të thotë se, stafiti të burgut nuk i lejohet të abuzojë me të burgosurin, qoftë nga ana mendore ashtu edhe nga ajo fizike, për ta bërë atë të vuajë. Thjesht fakti i mohimit të lirisë së lëvizjes dhe i kufizimit të mundësisë së takimit të familjarëve dhe miqve konsiderohet dënim për të burgosurin.

- **Shërbimi i Provës** është agjencia më e re e zbatimit të vendimeve penale, e ngritur me ligj nga viti 2008, që ka për mision mbikqyrjen, kontrollin dhe mbështetjen e personave të dënuar me dënime alternative (me kusht, me qëndrim në shtëpi, me punë në interes publik, etj)

2. Sistemi i burgjeve dhe kontributi i tij në qëllimin, misionin dhe vizionin e Sistemit të Drejtësisë Penale (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

- Sistemi i drejtësisë penale krijon kushtet e duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.
- Zhvillon një strategji të përshtatshme për sistemin e burgjeve dhe kushtet sociale në Shqipëri.
- Harton programe të specializuara për të rritur punësimin e të burgosurve për çdo burg duke patur parasysh kushtet e çdo institucioni.
- Forcon sistemin e burgjeve dhe rritjen profesionale të stafit, duke i motivuar për të kryer një shërbim sa më të mirë, gjë e cila do të rriste sigurinë në shoqëri dhe do të kishte efekte pozitive në mbarëvajtjen e punës së institucionit.

Përmes zbatimit të sanksioneve të privimit të lirisë, Shërbimi i Burgut jep kontributin e tij në mbështetje të qëllimeve të lartpërmendura kryesore të Sistemit të Drejtësisë Penale:

1. Rivendosja e drejtësisë dhe paanësisë
2. Parandalimi/ulja e krimit dhe rritja e sigurisë së komunitetit

Shërbimi i Burgut jep kontributin e tij në mbështetje të qëllimeve të sistemit të drejtësisë penale përmes miratimit të strategjisë së mëposhtme për ekzekutimin e dënimeve me burgim (MATERIALI 1):

- Shërbimi i Burgut garanton, pikësëpari, **sigurinë dhe rendin** e mjedisit të burgut (mbajtja brenda). Ruajtja e rendit, paqes dhe sigurisë në burg përbën **themelin** e domosdoshëm për ekzekutimin e pacenuar të dënimeve me burgim nga Shërbimi i Burgut - **(Niveli 1)**.
- Mjedisi i burgut me rend, paqe dhe siguri përbën bazën për ekzekutimin e burgimit **në mënyrë humane**, që karakterizohet nga trajtimi i respektueshëm dhe i ndershëm i të burgosurve pa vuajtje të panevojshme dhe pa dëmtim të integritetit të tyre personal - **(Niveli 2)**.

- Një mjedis burgu, i cili ka rend, siguri dhe humanizëm, ofron kushte të mira për zhvillimin e **marrëdhënieve pozitive e konstruktive** mes personelit të burgut dhe të të burgosurve. Në këtë kontekst, të burgosurit ndihen **të sigurt** dhe **të mbështetur** në marrjen e përgjegjësisë dhe në sjelljen e përgjegjshme - **(Niveli 3)**.
- Niveli i mëparshëm 3 përbën bazën e shëndoshë për hapin e mëtejshëm të promovimit **të një procesi individual reformimi, rehabilitimi dhe korrektimi** përmes shërbimeve në fushën e kujdesit shëndetësor, aktiviteteve dhe kontakteve me persona apo institucioneve të tjera të rëndësishme në botën e jashtme - **(Niveli 4)**.




Figura 1.

3. Veprimtaria morale e burgjeve (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Dënimi ligjor, në bazë të sundimit të ligjit, i përmbahet parimit se kufizimi i lirisë **është** dënim dhe se askush nuk do ta kryejë dënimin e tij/saj me vuajtje të panevojshme dhe nën rrethana më të ashpra seç nevojitet për sigurinë e komunitetit. Parimet e ndëshkimit ligjor nënkuptojnë detyrimin etik dhe normativ për krijimin e *kushteve minimale të kufizimit*, që t'u mundësojnë të burgosurve të jetojnë sa më shumë të jetë e mundur si qytetarë të rregullt. Parim i normalitetit nënkupton se ne duhet të krijojmë një mjedis burgu me *cilësi jetese*.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet grupin, sipas pikëpamjes së tyre, se çfarë është e rëndësishme për cilësinë e jetës në burg (ose se si duhet të ishte burgu). Është e rëndësishme të theksohen dy dimensionet: 1) marrëdhëniet njerëzore dhe 2) regjimi i burgjeve i

përcaktuar si sistemi i rregulluar i veprimtarive dhe shërbimeve në burg.

Fillimisht, le të punojnë pjesëtarët e grupit në mënyrë individuale, pastaj të bëhet diskutimi në grup.

Ushtrim: Cilësia e jetës në burgje

Cilat janë aspektet e rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës në burgje?

- Lidhur me marrëdhëniet njerëzore
- Lidhur me regjimin e burgjeve

Kontributi i trajnerit

Pas prezantimit të pikëpamjeve të grupit, trajneri përmbledh dhe jep opinionin/kontributin e mëposhtëm.

Studimi empirik (Liebling, 2005) tregon se kur pyesim *si* të burgosurit, *ashtu edhe* personelin e burgjeve se çfarë, sipas pikëpamjes së tyre, ka më shumë rëndësi për cilësinë e jetës në burg (apo si duhet të jenë burgjet), ne marrim një tablo shumë informuese që pasqyron kërkesat me bazë empirike për performancën *morale të burgjeve*.

Marrëdhëniet njerëzore

Sa i përket **dimensionit të marrëdhënieve** të cilësisë së jetës së jetuar në burg, si të burgosurit, ashtu edhe stafi (në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri) theksojnë rëndësinë e:

Respektit: qëndrimi me respekt dhe vlerësim; kushtimi i vëmendjes së duhur dhe mosushtimi i dhunës. Për dinjitetin dhe vlerën e njeriut;

Humanizmit: një mjedis i karakterizuar nga mirësjellja për njeriun, mirësia dhe dashamirësia, përmes të cilave shkaktohet sa më pak degradim të jetë e mundur;

Marrëdhënieve mes personelit - të burgosurve: sjellja (konstruktive) dhe shkalla e ndërveprimit mes personelit dhe të burgosurve gjatë zbatimit të rregullave dhe gjatë moszbatimit të rregullave;

Besimit: mbështetja te ndershmëria, besueshmëria dhe arsyetimi i shëndoshë i mirë i një personi; niveli i përgjegjësisë ose besimit të shfaqur dhe të përjetuar nga individët;

Mbështetjes: për të ndihmuar, për të mbajtur peshën ose presionin; për të dhënë ndihmë apo kurajo; mbështetje dhe forcë. Për të lehtësuar barrën.

Regjimi i burgut

Sa i përket **dimensionit të regjimit** të cilësisë së jetës së jetuar në burg, si të burgosurit, ashtu edhe stafi (në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri) theksojnë rëndësinë e:

Paanësisë: pa nuanca pandershmërie apo diskriminimi. Për t'u trajtuar drejtë, në mënyrë të qëndrueshme, të paanshme, në përputhje me rregullat apo standardet, me mundësi për korrektim dhe me mirësjellje.

Rendit: shkalla e qëndrueshmërisë, parashikueshmërisë dhe pranueshmërisë së mjedisit të burgut;

Sigurisë: ndjenja e sigurisë apo mbrojtja nga e keqja, kërcënimi apo rreziku dhe besimi fizik e psikologjik në mjedis.

Mirëqenies: gjendja e të qenit i kënaqur dhe shëndeti psikologjik; sigurimi i një atmosfere apo mjedisi ku mund të arrihet mirëqenia dhe përshtatja e të burgosurve.

Zhvillimit personal: hapësira dhe mundësitë që u ofrohen të burgosurve për të kaluar kohë cilësore dhe konstruktive; mundësitë ofrohen për zhvillimin vetjak dhe të burgosurit mund ta zhvillojnë potencialin e tyre, të fitojnë sensin e drejtimit dhe të përgatiten për lirim.

Kontaktet me familjen: shkallën, në të cilën të burgosurit nxiten të ruajnë lidhjet dhe të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre me familjen;

Mirësjelljes: niveli i pastërtisë që mund të mbajnë të burgosurit për veten e tyre dhe për vendin ku jetojnë, koha që shpenzojnë jashtë qelive të tyre dhe mundësia për privatësi.

Kontributi i trajnerit

Më poshtë, jepet një pamje e përgjithshme e performancës së mirë dhe jo të mirë morale në burgje (Liebling, 2005)

MATERIALI 2

	Performanca e dobët	Performanca e mirë
Cilësitë	Mungesa e respektit Jo njerëzore Marrëdhënie jo të mira Mungesë drejtësie të paanshme (drejtësi formale, paanshmëri e drejtë e stafit dhe qartësi) Lëshime dhe çorganizim Menaxhim i dobët	Respekt Njerëzore Marrëdhënie të mira staf-të burgosur Drejtësi (drejtësi formale, paanshmëri e drejtë e stafit dhe qartësi) Siguri dhe sisteme menaxhimi Drejtimit i fortë
Simptomat	Situatë jo e mirë e punës në burg Stafi i demoralizuar Identitet i paqartë Asnjë “kujdes” për rezultate Kërcënime ndaj sigurisë Çrregullsi Shqetësime	Puna e burgut i përmbush qëllimet e performancës Moral i lartë dhe kënaqësi në punë Identitet i qartë Rezultate me standarde profesionale Siguri Rregull Mirëqenie
Shkaqet themelore	Ndryshim i menaxhimit Konfuzion i funksioneve Mungesë besimi në menaxhim Mungesë ose mosbalancim vlerash Disbalancë pushtetesh Kushte fizike të papërshtatshme ose të rrënuara	Stabilitet i menaxhimit të aftë Qartësi e funksioneve dhe drejtimit Besim në menaxhimin e linjës dhe atë të lartë Balancë vlerash Balancë pushtetesh Kushte të arsyeshme infrastrukture fizike

4. Standardet e të drejtave themelore të njeriut gjatë një procesi penal që sanksionohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. (60 minuta)

Shënim për trajnerin

*Ndani klasën në grupe të vogla dhe kërkojini të diskutojnë mbi thelbin e materialit vijues për të drejtat e njeriut (**MATERIALI 3**) lidhur me mënyrën se si i shohin ato në kontekstin e zbatimit të sanksioneve nga shteti dhe rolet e tyre si oficerë në burgje.*

Kontributi i trajnerit

Të drejtat e njeriut kanë disa karakteristika:

- Të drejtat e njeriut janë universale
- Të drejtat e njeriut janë konkrete
- Të drejtat e njeriut janë të pandashme
- Të drejtat e njeriut janë të pa tjetërsueshme
- Të drejtat e njeriut janë sanksionuar në Kushtetutën e Republikës

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Barazia para ligjit

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Liritë dhe të drejtat themelore

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.
2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Shënim për trajnerin

Pas diskutimit, trajneri përmbledh sa më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Çdo qytetar ka të drejtë morale për jetën, integritetin fizik dhe psikologjik, lirinë e shprehjes dhe të fesë, për t'u angazhuar në punë, të mbajë kontakte me qytetarët e tjerë dhe për pjesëmarrjen politike. E drejta morale për integritet psikologjik nënkupton, për shembull, respektin për veprimtarinë morale dhe kapacitetet e motivacionet e përfshira në këtë veprimtari.

Këto të drejta duhet të respektohen edhe në rastin e zbatimit të një dekreti gjyqësor për heqje lirie. Ata nuk mund të mohohen dhe as nuk mund të humbin sepse një individ ka shkelur ligjin. Individit i dënuar ka të njëjtat të drejta si të gjithë qytetarët e tjerë.

Gjatë burgimit, kufizimi apo mohimi i këtyre të drejtave themelore dhe morale duhet të bazohet mbi argumentimin e legjitimuar nga shteti. Ju nevojitet një arsye për t'ia mohuar këto të drejta një autori të dënuar dhe për t'ia dhënë ato atij.

Shënim për trajnerin

Tani është moment i shkëlqyer për t'u kujtuar pjesëmarrësve se kombi dhe burgjet e tij funksionojnë sipas një sistemi ligjesh. Theksoni se arsyeja e mësimit të këtyre të drejtave dhe ligjeve e politikave të tjera është sepse përgjegjësia e tyre është jo vetëm zbatimi i diktatit të ligjit, por edhe respektimi i tij kur u kërkohet apo inkurajohen të veprojnë në kundërshtim me ligjin. Kur të ndodhë kjo, ata kanë të drejtë ta refuzojnë urdhrin në bazë të asaj që nuk është e ligjshme. Kjo gjë do të ndodhë rrallë, por duhet të zbatohet veçanërisht lidhur me trajtimin e të burgosurve dhe punonjësve të tjerë. Sigurohuni që pjesëmarrësit të kuptojnë se i gjithë personeli është përgjegjës për të siguruar se të gjithë personat e burgosur janë dënuar në përputhje me udhëzimet dhe në bazë të mbrojtjes së ligjeve të Shqipërisë.


*Ndani klasën në grupe të vogla dhe kërkojuni të gjithëve të lexojnë dhe të diskutojnë mbi thelbin e **MATERIALEVE 3 dhe 4** dhe bëni testin e vlerësimit (**MATERIALI 5**).*

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

Figura 1.



MATERIALI 2

	Performanca e dobët	Performanca e mirë
Cilësitë	Mungesa e respektit Jo njerëzore Marrëdhënie jo të mira Mungesë drejtësie të paanshme (drejtësi formale, paanshmëri e drejtë e stafit dhe qartësi) Lëshime dhe çorganizim Menaxhim i dobët	Respekt Njerëzore Marrëdhënie të mira staf-të burgosur Drejtësi (drejtësi formale, paanshmëri e drejtë e stafit dhe qartësi) Siguri dhe sisteme menaxhimi Drejtimit i fortë
Simptomat	Situatë jo e mirë e punës në burg Stafi i demoralizuar Identitet i paqartë Asnjë “kujdes” për rezultate Kërcënime ndaj sigurisë Çrregullsi Shqetësime	Puna e burgut i përmbush qëllimet e performancës Moral i lartë dhe kënaqësi në punë Identitet i qartë Rezultate me standarde profesionale Siguri Rregull Mirëqenie
Shkaqet themelore	Ndryshim i menaxhimit Konfuzion i funksioneve Mungesë besimi në menaxhim Mungesë ose mosbalancim vlerash Disbalancë pushtetesh Kushte fizike të papërshtatshme ose të rrënuara	Stabilitet i menaxhimit të aftë Qartësi e funksioneve dhe drejtimit Besim në menaxhimin e linjës dhe atë të lartë Balancë vlerash Balancë pushtetesh Kushte të arsyeshme infrastrukturore fizike

MATERIALI 3

Të drejtat e njeriut në një proces penal

Neni 27

- Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
- Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
 - kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
 - për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij;

2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

Neni 29

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij;

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet;
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 35

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij;
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj;
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj;
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Neni 36

Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.

Roli i personelit të burgut

- Të trajtojë të burgosurit në mënyrë të sjellshme, njerëzore dhe të drejtë;
- Të garantojë që nuk rrezikohen nga asgjë;
- Të garantojë që të burgosurit nuk do të arratisen;
- Të garantojë që nëpër burgje ushtrohet kontroll;
- T'u japë mundësi të burgosurve ta përdorin pozitivisht kohën e tyre në burg në mënyrë që pasi të lirohen të rigjejnë një vend në shoqëri.

MATERIALI 4

Raste të implikimeve dhe shkeljeve që përbëjnë vepër penale kundër veprimtarisë shtetërore.

Neni 248. Shpërdorimi i detyrës

(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 58)

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror ose me shërbim publik, kur i kanë sjellë pasoja të rënda interesave të ligjshme të shtetasve ose shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 249

Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij

Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 250

Kryerja e veprimeve arbitrare

Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 251

Mosmarrja e masave ose moskërkimi pranë personit kompetent, që të ndërpritet gjendja e paligjshmërisë si rezultat i një veprimi arbitrar, që ka prekur lirinë e shtetasit, nga ana e personit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në shërbim publik, që vjen në dijeni të asaj gjendjeje për shkak të funksionit apo shërbimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 252

Mbajtja në burg, pa vendim të organit kompetent ose tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj, prej personit të ngarkuar me detyrën e administratorit të burgut, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 259

Kryerja e veprimeve nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror apo në shërbim publik, për të kërkuar ose urdhëruar dhënien e shpërblimeve që nuk i takojnë ose më shumë nga sa i takojnë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 260

Marrja e shpërblimeve, dhuratave ose përfitimeve të tjera prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik e në ushtrim të tyre, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me funksionin apo shërbimin ose për të përdorur ndikimin pranë autoriteteve të ndryshme për t'i siguruar çdo personi favorizime, dallime, vende pune e përfitime të tjera, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

MATERIALI 5

Testi i vlerësimit

1. IEVP, janë pjesë në sistemin e drejtësisë penale.
 - a. E vërtetë
 - b. E pa vërtetë
2. Shërbimi i provës është pjesë e sistemit të drejtësisë penale.
 - a. E vërtetë
 - b. E pa vërtetë
3. Forcat e armatosura janë pjesë e sistemit të drejtësisë penale.
 - a. E vërtetë
 - b. E pa vërtetë
4. Sistemi i drejtësisë penale zbaton dhe realizon detyrimet e parashikuara nga ligji penal për t'i shërbyer: interesave të komunitetit, viktimës dhe _____
 - a. autorit të veprës
 - b. shtetit
 - c. shoqërisë
 - d. institucioneve
5. Rrethoni një fjalë kyçe të vizionit të sistemit të burgjeve:
 - a. Ri-integrim
 - b. Përmirësim
 - c. Angazhim
 - d. Dinamizëm
6. Të drejtat e njeriut janë universale.
 - a. E vërtetë
 - b. E pavërtetë
7. Të drejtat e njeriut janë të pandashme.
 - a. E vërtetë
 - b. E pavërtetë
8. Listo 5 standarte bazë të të drejtave të njeriut në një proces penal
9. Listo tre vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore

Moduli 2: Të burgosurit dhe mjedisi i burgut (2 orë)

Objektivat: Në fund të modulit, pjesëmarrësit do të:

- jenë në gjendje të përshkruajnë faktorët që e bëjnë mjedisin e burgut të ndryshëm nga komuniteti normal;
- njihen me proceset dhe mekanizmat që të burgosurit dhe stafi përdorin për t'u përshtatur me mjedisin e burgut;
- kuptojnë rëndësinë e “normalizimit” me jetën në burg;
- kuptojnë gamën e gjerë të detyrave dhe sfidave të një oficeri burgu që vepron në përputhje me standardet e larta profesionale dhe personale.

Hyrje (15 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në demokracitë moderne, atje ku sundon ligji, drejtësia penale dhe burgimi ekzekutohen bazuar në parime dhe standarde të caktuara për trajtimin e të burgosurve, kushtet e burgut dhe mjedisin e burgut.

Për shembull, parimet bazë të Rregullave Evropiane të Burgjeve rekomandojnë që¹:

1. *Personat, të cilëve iu është mohuar liria, trajtohen me respekt ndaj të drejtave të tyre njerëzore.*
2. *Personat, të cilëve iu është mohuar liria, gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë marrë atyre në mënyrë të ligjshme nga dënimet që i dënojnë ata ose i lënë në paraburgim.*
3. *Kufizimet për personat të cilëve iu është mohuar liria ushtrohen në masën minimale të nevojshme dhe në përpjesëtim me objektivat legjitime për të cilat ato janë vendosur.*
4. *Kushtet në burg që cenojnë të drejtat e njeriut të burgosurve nuk justifikohen nga mungesa e burimeve.*
5. *Jeta në burg duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në komunitet.*
6. *E gjithë koha e ndalimit menaxhohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë ri-integrimin e në një shoqëri të lirë të personave të cilëve iu është privuar liria.*
7. *Bashkëpunimi me shërbime të jashtme shoqërore dhe përfshirja e shoqërisë civile në jetën e burgut inkurajohet sa më shumë që të jetë e mundur.*
8. *Personeli i burgut kryen një shërbim të rëndësishëm publik dhe rekrutimi, trajnimi dhe kushtet e punës të personelit të burgut duhet të mundësojnë aplikimin e standardeve të larta në kujdesin ndaj të burgosurve.*

Parimet e mësipërme të Rregullave Evropiane të Burgjeve, janë të inkuorpuara në standardet që lidhen me rolin, qëllimin dhe statusin profesional të punonjësve të burgut.

Në nenet 72-75 të Rregullave Evropiane të Burgjeve² përshkruhen karakteristikat e mëposhtme të rolit dhe nivelit profesional të personelit të burgut:

- 72.2 *Personeli manifeston një sens të qartë të qëllimit të sistemit të burgjeve. Strukturat drejtuese japin orientim sesi mund të arrihet sa më mirë ky qëllim.*
- 72.3 *Detyrat e personelit shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe duhet të marrin parasysh nevojën e lehtësimit të ri-integrimit të burgosurve në shoqëri pas përfundimit të dënimit nëpërmjet programeve të kujdesit dhe ndihmës pozitive.*
- 72.4 *Stafi punon sipas standardeve të larta profesionale dhe personale.*
73. *Autoritetet e burgut i japin përparësi vëzhgimit të zbatimit të rregullave që lidhen me stafin.*
74. *Një vëmendje e rëndësishme i kushtohet menaxhimit të marrëdhënieve ndërmjet personelit të burgut që punon direk me të burgosurit dhe të burgosurve që ata kanë nën kujdes.*
75. *Gjatë të gjithë kohës personeli sillet mirë dhe realizon detyrat në mënyrë që të ndikojë te të burgosurit me shembullin e tij të mirë dhe të fitojë respektin e të burgosurve.*

2. Faktorët që e bëjnë mjedisin e burgut të ndryshëm nga komuniteti normal (20 minuta)

Ndëshkimi ligjor nëpërmjet drejtësisë penale dhe në veçanti parimi që kufizimi i lirisë **realizohet nëpërmjet** dënimit, ekzekutohet duke krijuar kushte normale në burg. Këshilli i Evropës rekomandon që kushtet e jetesës në burg duhet të *“përafrohen sa më afër me aspektet pozitive të jetës në komunitet”* ku të burgosurit të kenë të njëjtat të drejta si qytetarët e lirë. Ideja e normalizimit me jetën e burgut ka për qëllim të sigurojë:

- të drejtat e njeriut të burgosurve;
- të promovojë ri-integrimin e tyre, dhe
- të zvogëlojë dëmin e shkaktuar nga burgimi.

Normalizimi me jetën e burgut është një sfidë e vërtetë sepse burgu nuk ofron shumë nga gjërat normale që njerëzit kishin gjatë lirisë dhe jetës në komunitet.

Shënime për trajnerët

Trajneri i bën grupit pyetjen e mëposhtme dhe shënon përgjigjet në dërrasën e zezë ose në tabelë

Ushtrim

Pyetje: Cilët faktorë e bëjnë mjedisin e burgut të ndryshëm nga komuniteti normal?

Kontributi i trajnerit

Burgu mund të kthehet në mjedisin e përbashkët të burgosurve dhe të personelit, për disa ditë, javë, muaj ose vite. Për nga natyra, forma e jashtme dhe mënyra e organizimit, burgu përbën diçka të veçantë. Aty jetojnë së bashku duke u mbështetur në rregulla dhe kodin e sjelljes, stafi i shërbimit që është i ngarkuar për sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve dhe të burgosurit, të cilët janë vendosur aty si një ndëshkim.

Burgu është mjedisi i përgjithshëm, ku “të gjitha aspektet e jetës së të burgosurve zhvillohen në të njëjtin vend dhe nën një autoritet të vetëm”. Në burg eliminohen shumë nga gjërat normale të cilat i ndajnë njerëzit në jetën e lirë. Jashtë mjedisit të burgut njerëzit janë të lirë të hanë, të flenë, të luajnë, të punojnë vetëm ose me njerëz të tjerë të cilët i zgjedhin vetë. Ndërsa në burg të gjitha zgjedhjet që zakonisht njerëzit i bëjnë vetë, nuk ekzistojnë. Të njëjtët njerëz, si personeli dhe të burgosurit, janë bashkë për një kohë të gjatë. Institucionet e burgjeve dhe të paraburgimeve punojnë sipas orareve dhe me veprimtari të detyruara të cilat kanë si synim të realizojnë qëllimet zyrtare dhe nuk ka shumë vend për dëshira apo objektiva personale.

Shënime për trajnerët

Trajneri i bën grupit pyetjen e mëposhtme dhe shënon përgjigjet në dërrasën e zezë ose në tabelë

Ushtrim

Pyetje: Cilat janë tiparet e mjedisit të burgut që mund të kenë një ndikim negativ, dëmtues tek të burgosurit?

Pasi merr përgjigjet, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Vetëm *thjesht humbja e lirisë* sjell dëm ose *humbje të konsiderueshme në cilësinë e jetës*. Mundësia për zhvillim pozitiv përmes ndërveprimit shoqëror me persona të tjerë të rëndësishëm, nevoja për privatësi, disponueshmëria e të mirave dhe shërbimeve materiale, mundësia për të fituar një pagë normale dhe kënaqësi përmes një pune, nevoja për autonomi (mundësi për të zgjedhur), zhvillim personal dhe rekreacion kufizohet seriozisht me privimin e personit nga liria.

Humbja e lirisë dhe izolimi brenda një hapësire të vogël, sigurisht, sjellin mërzë dhe vetmi, si dhe mendimin tek i burgosuri se është hedhur poshtë nga komuniteti i lirë. Të qenët të mbyllur me të tjerët të cilët mund t'i konsiderojë të rrezikshëm ose të paqëndrueshëm, shkakton ankth.

Përveç dallimit real, ndërmjet mjedisit të burgut dhe mjedisit të zakonshëm të komunitetit, ka edhe dallime të perceptuara ose perceptime, që krijohen nga mediat, nga bisedat e zakonshme rreth burgut dhe të dënuarve, keqinterpretimi i të dhënave dhe informacionit etj. Të gjitha këto bëjnë që shpesh për burgun të mos kemi një përfytyrim të drejtë. *P.sh., një ditë, prindi i një të riu që ndodhej i paraburgosur, takoi një punonjës të burgut dhe, pasi e pyeti si ishte djali, i kërkoi punonjësit në formë lutjeje dhe me mirësjellje: “Ju lutem mos e rrihni”. Punonjësi e pyeti qytetarin se përse e kishte atë frikë. Qytetari iu shpreh se kishte dëgjuar që dikur i rrihnin dhe i torturonin dhe kështu e kishte mendimin për burgun. Punonjësi e qetësoi duke i thënë: “Të burgosurit këtu nuk janë për t’u ndëshkuar, por si një ndëshkim dhe janë të sigurt”.*

2. Procese dhe mekanizma për përshtatjen e të burgosurve dhe stafit me mjedisin e burgut (90 minuta)

Kontributi i trajnerit

Nënkultura dhe burgosja e të burgosurve

Studimet shkencore³ sugjerojnë se të burgosurit përshtaten me privimin e vështirë të lirisë, autonomisë, sigurisë, mallrave dhe shërbimeve personale, etj. duke zhvilluar një nënkulturë të veçantë të burgosurve që i ndihmon ata të përballojnë efektet e burgimit. Kjo është një nënkulturë e veçantë me normat, gjuhën dhe rolet e veta. “**Burgëzimi**” i referohet procesit me anë të cilit të burgosurit përshtaten me jetën e burgut duke adoptuar normat, vlerat dhe besimet e nënkulturës së të burgosurve. Teoria e burgëzimit pohon se sa më gjatë të qëndrojnë të burgosurit në burg, aq më shumë ata mësohen, përshtaten dhe socializohen me këtë nënkulturë të burgosurish, e cila ka natyrë subversive dhe kundërshtuese. Në këtë mënyrë, të burgosurit “burgëzohen” dhe kanë prirje të kundërshtojnë autoritetet dhe janë të motivuar gjithnjë e më pak për tu rehabilituar dhe të kenë një jetë normale jashtë burgut.

Kultura profesionale e punonjësve të burgut

Shumë punonjës duhet ta mësojnë pjesën e vërtetë të punës së tyre vetë ose prej të dënuarve. Situata me të cilën ata përballen në realitet nuk mësohet në klasa. Ndodh që punonjësit e rinj të shihen si të “huaj” nga më të vjetrit. Punonjësit e burgut kanë të njëjtën humbje sigurie që u përshkrua më lartë për të dënuarit. Punonjësit e burgut, në një masë të madhe, e kanë humbur njëlloj sikurse edhe të dënuarit mundësinë për të zgjedhur. Kjo pasi ata duhet të ndjekin politikat dhe rregullat institucionale në një sistem që, tradicionalisht, është shumë i strukturuar dhe funksionon sipas urdhrave që jepen nga lart-poshtë.

Studimet shkencore⁴ sugjerojnë më tej se punonjësit e burgut përshtaten me mjedisin e burgut duke krijuar një **kulturë joformale profesionale**. Kjo kulturë profesionale është një komponent i rëndësishëm i punës dhe përfshin rregullat dhe normat joformale që mbështesin mënyrën se si punonjësit e burgjeve ndihen dhe mendojnë për ndërveprimin me të burgosurit, me njëri -tjetrin, eprorët dhe drejtuesit e tyre. Normat e punës përcaktojnë gjithashtu se si punonjësit reagojnë (pozitivisht, negativisht ose me indiferencë) ndaj punës që bëjnë dhe si kombinojnë rolet (potencialisht) konfliktuale të kryerjes së detyrave të sigurisë dhe kontrollit nga njëra anë dhe detyrat me fokus trajtimin, rehabilitimin, kujdesin dhe nevojat e të burgosurve nga ana tjetër. Duke kërkuar nga punonjësit që të marrin role të reja të specializuara siç është lehtësimi i ri-integritetit të të burgosurve ose ndërveprime më të kujdesshme, në të njëjtën kohë krijohen pritshmëri që punonjësit të sfidojnë normat e vendosura prej kohësh të punës.

Shënime për trajnerët

Trajneri i kërkon grupit të japë shembuj se cilat mund të jenë këto norma profesionale të vendosura prej kohësh (të vështira për t'u ndryshuar) të punonjësve të burgut që duhet të sfidohen kur stafi duhet të marrë role të reja që shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe i referohen lehtësimit të ri-integritetit të burgosurve në shoqëri dhe ofrimit të kujdesit.

Ushtrim

A mund të jepni shembuj të normave profesionale të vendosura prej kohësh (të vështira për t'u ndryshuar) të punonjësve të burgut që duhet të sfidohen kur stafi duhet të marrë role të reja që shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe i referohen lehtësimit të ri-integrimit të burgosurve në shoqëri dhe ofrimit të kujdesit?

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Normat e njohura të vendosura prej kohësh të punonjësve të burgut që duhet të sfidohen kur i kërkojmë personelit të burgut të marrë role të reja të orientuara drejt trajtimit dhe kujdesit shpesh përfshijnë:

- mentalitetin tradicional “ne dhe ata” në burgje;
- punonjësve të cilëve iu është mësuar se të burgosurit janë armiku;
- pikëpamje negative ndaj të burgosurve dhe mohimin e potencialit të tyre për ndryshim;
- punonjësit mësohen se puna e tyre është të sigurojnë që të burgosurit të qëndrojnë nën kontroll dhe të mbahen brenda institucionit penitenciar.
- një qëndrim në mbështetje të ndëshkimit të burgosurve që është i rrënjësor në pikëpamjen se të burgosurit ndërsa janë në burg duhet të ndëshkohen për krimet e tyre;
- besimi se marrëdhëniet kuptimplote, respektuese dhe mbështetëse nuk mund të zhvillohen brenda realitetit të burgjeve, ku punonjësit kryejnë kontrole të imtësishme trupore, hapin postën e të burgosurve, monitorojnë marrëdhëniet e tyre me të tjerët dhe dënojnë të burgosurit për shkelje kundër rendit institucional.

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon anëtarëve të grupit të imagjinojnë veten në rolin e tyre të ardhshëm si punonjës burgu dhe të shkruajnë individualisht se çfarë duhet të bëjnë për të integruar dhe kombinuar me sukses ruajtjen e sigurisë, qetësisë, kontrollit dhe rendit me punën rehabilituese dhe ndërveprimet e kujdesshme me të burgosurit.

Pastaj kërkojuni anëtarëve të grupit të ndajnë idetë e tyre dhe të shkruajnë të gjitha sugjerimet

Ushtrim

Pyetje: *çfarë duhet të bëni ju si punonjës për të integruar dhe kombinuar me sukses ruajtjen e sigurisë fizike, ndjenjën e sigurisë, kontrollit dhe rendit me punën rehabilituese dhe ndërveprimet e kujdesshme me të burgosurit?*

Pas marrjes së përgjigjeve dhe diskutimit trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Studimet shkencore⁵ evidentojnë se:

- siguria, qetësia, kontrolli dhe rendi, si dhe puna rehabilituese, realizohen më me sukses nga punonjësit e burgut përmes **marrëdhënieve pozitive staf-të burgosur**;
- marrëdhëniet pozitive midis stafit dhe të burgosurve ndodhin përmes praktikave ndërvepruese shoqërore në jetën e përditshme të burgut;

- në përvojën staf/i burgosur, **respekti, mirësjellja, besimi dhe mbështetja** janë vlera thelbësore humaniste që kanë rëndësi në burg dhe janë elementë vendimtar të marrëdhënieve pozitive staf-i burgosur (i cili gjithashtu lehtëson **sigurinë dinamike!**) dhe **ndërveprimet e kujdesshme**⁶.

Punonjësit e burgut *që janë në gjendje të integrojnë me sukses ofrimin e kujdesit me ruajtjen e sigurisë, qetësisë dhe rendit:*

- u ndjenë në përgjithësi të sigurt;
- vendosën autoritetin e tyre personal dhe kompetencat e tyre legjitime për të ruajtur rendin;
- vlerësuan se të burgosurit që ndiheshin të sigurt ndiheshin edhe se u kushtohej vëmendje dhe kujdes
- vlerësuan se përgjigja ndaj nevojave të burgosurve ishte thelbësore për ruajtjen e qetësisë;
- marrin më shumë kënaqësi nga puna, ndonëse nuk janë të përjashtuar nga stresi dhe mërzitja.

Shënime për trajnerët

Trajneri e ndan grupin në dy nëngrupe.

Anëtarët e nëngrupit 1 ndajnë mendimet, diskutojnë se cilat janë ato sjellje që korrespondojnë me një qëndrim përkujdesje të punonjësit të burgut.

Nëngrupi 2 diskuton se cilat janë ato sjellje që korrespondojnë me një qëndrim të pakujdesshëm të punonjësit të burgut.

Ushtrim

Anëtarët e nëngrupit 1 ndajnë mendimet, diskutojnë se cilat janë ato sjellje që korrespondojnë me një qëndrim përkujdesje të punonjësit të burgut.

Nëngrupi 2 diskuton se cilat janë ato sjellje që korrespondojnë me një qëndrim të pakujdesshëm të punonjësit të burgut.

Pas këtij ushtrimi trajneri përmbledh si më poshtë:

- Ndërveprimet e përkujdesit bazohen në marrëdhënie të karakterizuara nga respekti, drejtësia dhe socializimi;
- Të burgosurit i përshkruan punonjësit që përkujdesen si njerëz që komunikojnë me ta pa nënçmim. Kjo përfshinte përshëndetje të përditshme, si “mirëmëngjesi”, biseda të rastësishme për familjen, sportin ose zonën lokale dhe integrimin fizik me të burgosurit (lojëra në pishinë, biseda të ndryshme);
- Punonjësit që përkujdesen demonstrojnë *empati institucionale*, ose vlerësim të kufizimeve strukturore me të cilat përballen të burgosurit (për shembull, mbipopullimi, problemet e mensës dhe sistemet jofunksionale të kontakteve me familjen dhe miqtë);
- Ky lloj ndërveprimi i tregonte të burgosurve se punonjësit i konsideronin ata me vlerë dhe me status të barabartë moral; shpesh kundër përvojave të përhapura të mosrespektimit dhe degradimit të statusit, siç e përshkruan një femër e burgosur⁷:

Të flet sikur je njësoj me të. U flet të gjithëve me respekt. Duket që i trajton të gjithë

⁷ Tait, op.cit. f.6

siç do që ta trajtojnë atë vetë të tjerët. I trajton të gjithë mirë. Nuk të flet me atë tonin “përçmues” që duket sikur të thotë “ti je kriminel, këtu komandoj unë, do bësh atë që them unë”, nuk e ka atë ton në zë, atë sjellje në përgjithësi. Është i sjellshëm. Vërtet i sjellshëm.”⁸

- Ndërveprimet e përkujdesjes, me kalimin e kohës, ndërtojnë besimin, duke i bërë të burgosurit të aftë për t’u afruar punonjësve në rast nevojë ose të pranojnë qasjet e punonjësve, si dhe lehtësojnë komunikimin e tyre për problemet emocionale dhe praktike;
- Përkujdesja krijoi siguri ose besimin bazë tek ambienti i burgut, duke hedhur themelet për përmirësimin e humorit dhe të mirëqenies;
- Të burgosurit që ndiheshin se po u kushtohej vëmendje dhe kujdes shprehën dëshirën për të bashkëpunuar me stafin për ta shpërblyer në njëfarë mënyre kujdesin e treguar;
- Ndërveprimet e përkujdesjes mund të zbusin ndjenjat e pafuqisë, izolimit dhe ndjesinë e të qenit i pavlefshëm që ka risk të krijojë mjedisi i burgut.

Qëndrim **“i pakujdesshëm”** do të thotë:

- trajtimi me indiferencë;
- trajtimi me një status më të ulët dhe me më pak vlerë morale;
- trajtimi në mënyrë të padrejtë.

Ndërveprimet e pakujdesshme intensifikojnë:

- ndjenjën e pafuqisë, izolimit dhe ndryshimet e shpeshta dhe të shpejta të humorit;
- gjendjen armiqësore dhe depressive;
- dhunën ndaj stafit dhe humbjen e shpresës;
- nevojën për të mos lënë asgjë të paplotësuar.

Pakujdesia nuk është mungesë kujdesi, por e kundërta e kujdesit

Është e rëndësishme që punonjësit, me sjelljen e tyre, të bëhen shembull për të dënuarit. Qëndrimi i punonjësit luan rol kyç në aftësinë e tij për të pasur sukses në ndikimin e sjelljes së të burgosurve.

Një punonjës “i përkujdesshëm” burgu është në gjendje të integrojë dhe të kombinojë me sukses ruajtjen e sigurisë, qetësisë, kontrollit dhe rendit me punën rehabilituese dhe ndërveprimet e kujdesshme me të burgosurit. Ai është një punonjës i gjithanshëm, i cili duhet:

- Të jetë shumë i disiplinuar;
- Të jetë i sigurt nga ana emocionale;
- Të kuptojë personalitetin e të burgosurve në mënyrë individuale, si dhe në grup dhe të pranojë faktin se ata janë qenie njerëzore;
- Të kuptojë se çfarë është disiplina dhe çfarë duhet të arrihet nëpërmjet saj;
- Të shmangë identifikimin emocional me të burgosurit, probleme personale, ligjore ose disiplinore;
- Të ketë gjykim të mirë dhe të jetë i ekuilibruar;

- Të jetë vigjilent ndaj atyre teknikave që kanë me shumë rezultat për të përfshirë individin;
- Të jetë i qëndrueshëm;
- Të jetë i drejtë;
- Të jetë objektiv;
- Të zbatojë rregullat dhe normat edhe pse mund të duken të padrejta dhe të ndjekë kanalet e duhura për të kërkuar ndryshime.

Është e rëndësishme të kuptojmë qëndrimet e përbashkëta të burgosurve.

- Dëshirën konstante për liri, si gjëja më e rëndësishme se gjithçka;
- Tensionin e brendshëm konstant dhe nevojat në lidhje me familjen, miqtë, njerëzit e dashur;
- Qëndrimet ndaj të tjerëve në burg (dyshim, armiqësi, rezistencë ndaj programeve, frikë nga dëmtimi fizik, frikë ndaj ngacmimeve homoseksuale, frikë nga hakmarrja nëse informojnë ose ndihmojnë punonjësit etj.);
- Tensionin emocional në lidhje me izolimin dhe monotoninë;
- Nevojën që kanë disa individë që të jenë të fuqishëm;
- Agresivitetin e disa individëve;
- Bashkëpunimin në këmbim të ndereve, sendeve etj.

Teknikat për trajtimin e të burgosurve

- Çdo i burgosur duhet të trajtohet si një individ. Metodat e trajtimit zakonisht kanë ndikime të ndryshme në individë të ndryshëm;
- Individët i shohin dhe i dëgjojnë gjërat ndryshe, zakonisht duke pranuar ato që duan të shohin e të dëgjojnë dhe duke refuzuar pothuajse në mënyrë të pandërgjegjshme ato që nuk duan të shohin ose të dëgjojnë. Duhet të siguroheni që mesazhi juaj kuptohet qartë;
- Favorizimi duhet shmangur, pavarësisht sesa vështirë mund të jetë;
- Individë të cilët fitojnë me ndershmëri privilegje dhe përparojnë, duhet t'i marrin ato, të tjerët jo;
- Qetësia dhe ekuilibri kanë me shumë rezultat sesa shfryrjet;
- Vënia në lojë zakonisht shkakton armiqësi dhe zemëratë. Mos e përdorni këtë metodë për të trajtuar të burgosurit;
- Sugjerimi është forca kryesore lëvizëse për veprime njerëzore;
- Individët janë më të predispozuar për të punuar nëse e kuptojnë arsyen pse duhet realizuar një detyrë e tillë;
- Së bashku me autoritetin përdorni edhe dinjitetin, duke treguar dëshirë për të ndihmuar dhe për ta mbështetur të burgosurin;
- Shmangni ofendimet dhe vulgaritetin. Këto e zvogëlojnë respektin për punonjësin;
- Afërsia e tepruar sjell përbuzje. Mos përdorni nofka të papërshtatshme në kontakte me të burgosurit;
- Tregoni më shumë kujdes dhe durim ndaj të burgosurve të rinj;
- Mos shprehni keqardhje ose mos inkurajoni ankesat e të burgosurve ndaj punonjësve të tjerë, rregullave dhe normave apo çështjeve të tjera, pavarësisht se si mendoni ju në lidhje me çështjen në fjalë. Raportoni ankesat e arsyeshme tek

autoritetet për zgjidhje;

- Mos jepni këshilla në rast se kjo nuk është pjesë e detyrave tuaja. Nëse ka diskutime në lidhje me fusha specifike, adresojini ato te specialistët;
- Mos hyni në detyrime ndaj të burgosurve (ndere, dhurata, ryshfete) etj;
- Jini gjithnjë vigjilentë dhe gati për të ndërhyrë. Të burgosurit që kanë fituar përvojë në jetën e burgut, kanë gjithnjë shumë marifete në dispozicion. Asnjëherë mos pushoni së vëzhguari. Kini kujdes nga taktikat që përdorin të burgosurit për t'ju tërhequr vëmendjen;
- Mos i lejoni të burgosurit të demonstrojnë vetëm se po bëjnë sikur po respektojnë një urdhër. Ngulni këmbë që urdhri të zbatohet deri në fund.

Duke vëzhguar sjelljen e të burgosurve:

- Kushtojini vëmendje nevojave të burgosurve
- Jini të vëmendshëm për ndryshime të dyshimta në sjelljen e një të burgosuri.
- Jini të vëmendshëm për shenja shqetësimi ose ankthi.
- Tregohuni të kujdesshëm ndaj të burgosurve që papritur fillojnë të tërhiqen nga grupi
- Tregohuni të kujdesshëm në rastin e ndryshimeve në strukturat e miqësive.
- Jini të vëmendshëm ndaj ndryshimeve në pamjen e jashtme.

Detyrë shtëpie

Përgjigju pyetjeve në vazhdim:

1. Të burgosurit duhet të dinë të gjitha rregulloret, ligjet, rregullat dhe kodet e sjelljes në burg, që nga dita e parë që hyjnë në mjedisin e burgut. Shpjegoni pse kjo është shumë e rëndësishme.
2. A është e rëndësishme që punonjësit të njohin (nën) kulturën e të burgosurve?
3. A ka të drejtë një punonjës burgu të ofrojë ndihmë ose të bëjë favore nëse ato nuk lidhen me çështjet dhe nevojat në fjalë?
4. Pse është e rëndësishme që një punonjës që ka punuar në burg për një periudhë të shkurtër kohore, të mos ndikohet nga e ashtuquajtura nënkulturë e të burgosurve?
5. Studimi i rastit të mëposhtëm:

Një punonjës i emëruar në shërbimin e sigurisë në regjimin e brendshëm të një burgu dha dorëheqjen 4 ditë pas emërimit. Si mendoni, cilat ishin rrethanat apo arsyet e dorëheqjes së punonjësit, edhe pse ai kishte pritur dy vjet rresht për ta filluar këtë detyrë?

Diskutoni me kolegët në lidhje me përvojat e ndryshme që lidhen me ndikimin që mjedisi i burgut dhe të burgosurit kanë mbi stafin, veçanërisht tek të sapoemëruarit.

Mbyllja

Moduli 3: Parandalimi i keqtrajtimit dhe roli i Mekanizmit Kombëtar dhe Ndërkombëtar për parandalimin e torturës (2 orë)

Objektivi: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të kuptojnë parimin e ndalimit universal të torturës dhe të trajtimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, si një parim të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare;
- do të kuptojnë natyrën dhe elementët e torturës;
- do të kuptojnë trajtimet e tjera të egra, çnjerëzore, ose poshtëruese, në mënyrë të veçantë keqtrajtimin e të burgosurve dhe do të diskutojnë raste nga raportet e monitorimit;
- do të jenë në gjendje të përshkruajnë elementët bazë të strategjisë gjithëpërfshirëse për parandalimin e torturës dhe do të njihen me Protokollin e Stambollit;
- do të njihen me qëllimet dhe aktivitetet e mekanizmave parandalues.

I. Hyrje (15 minuta)

Kontributi i trajnerit

Personat e dënuar ose të paraburgosur vazhdojnë të mbajnë të gjitha të drejtat e tyre si qenie njerëzore, përveç të drejtave që kanë humbur si pasojë specifike e privimit të lirisë. Autoritetet e burgjeve dhe stafi i burgjeve duhet të kuptojnë qartë implikimet e këtij parimi. Disa çështje janë shumë të qarta. Për shembull, ndalohet **totalisht** tortura dhe shkaktimi në mënyrë të qëllimshme i trajtimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues. Duhet të kuptohet se ky ndalim nuk vlen thjesht dhe vetëm për abuzimet e drejtpërdrejta fizike ose mendore. Ai vlen gjithashtu për **tërësinë e kushteve** ku mbahen të burgosurit.

E drejta e mbrojtjes ndaj torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimeve mbrohet si një parim i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare dhe është pjesë e shumë konventave ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar dhe pranuar në nivel botëror nga pothuajse të gjitha shtetet, si shtete anëtare në këto konventa. Parimi i përgjithshëm i cili përcakton se tortura dhe të gjitha format e tjera të keqtrajtimeve ndalohen në mënyrë absolute në të gjitha rrethanat, është tashmë pjesë e së drejtës së brendshme të shteteve anëtare. Ndalimi i torturës ose trajtimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues është **një e drejtë absolute** që nuk mund të hiqet as edhe në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme. Pavarësisht garancive kombëtare dhe ndërkombëtare, raportet dhe vëzhgimet e të drejtave të njeriut kanë vazhduar të dokumentojnë akte të torturës dhe forma të tjera të keqtrajtimeve ndaj personave të dënuar me heqje lirie nga zyrtarë publikë në mbarë botën.

Parandalimi universal i torturës parashikohet në një numër të madh konventash ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjithashtu, pranohet si “normë urdhëruese” e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.

Parandalimi i torturës përcaktohet në nenin 5 të Deklaratës Universale për të

Drejtat e Njeriut (1948), por përfshihet edhe në një numër të madh dokumentesh ndërkombëtare. Një numër i konsiderueshëm shtetesh kanë ratifikuar instrumente që përmbajnë nene të veçanta që ndalojnë torturën dhe forma të tjera të keqtrajtimeve. Të tilla janë: Pakti Ndërkombëtar “Për të Drejtat Civile dhe Politike” (1966), Konventa Evropiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut” (1950), Konventa Amerikane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut” (1978) e shumë të tjera.

Siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës së OKB-së “Kundër Torturës dhe Trajtimeve, ose Dënimeve të tjera të Egra, Çnjerëzore dhe Poshtëruese” (UNCAT), termi “torturë” nënkupton: *çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.*

2. Natyra dhe elementet kryesore të torturës dhe trajtimeve të tjera të egra, çnjerëzore ose poshtëruese (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Sipas Këshillit Ndërkombëtar të Rehabilitimit për Viktimat e Torturave (IRCT), disa prej metodave më të zakonshme të torturave fizike përfshijnë rrahjen, shokun elektrik, shtrirjen me forcë, zhytjen, mbytjen, djegiet, përdhunimin dhe ngacmimin seksual. Format psikologjike të torturës dhe keqtrajtimin, të cilat shpesh kanë pasojat më afatgjata për viktimat përfshijnë: izolimin, kërcënimin, poshtërimin, ekzekutimet e simuluar, amputimet e simuluar, si dhe të qenit dëshmitar i torturave ndaj të tjerëve.

Nga përkufizimi i mësipërm i UNCAT i torturës, mund të nxirren katër elemente ose kushte që duhet të përmbushen për ta cilësuar një veprim si akt torture.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet: “Cilët janë katër elementet e torturës në përkufizimin e UNCAT”?

Nxiteni grupin që ta lexojë edhe njëherë përkufizimin e UNCAT dhe të japë përgjigje, duke i shkruar ato në tabelë. Pas përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

Katër elementet e torturës⁹

- 1. Dhembjet ose vuajtjet:** Një veprim karakterizohet si torturë nëse ka shkaktuar një dhembje ose vuajtje të madhe fizike ose mendore. Ashpërsia e aktit të torturës nuk përbën një përcaktim objektiv, por varet nga faktet dhe rrethanat e rastit. Në përgjithësi, dhembjet dhe vuajtjet janë kategori subjektive dhe pashmangshmërisht relative. Se sa vuan një person varet nga disa faktorë, si gjinia, mosha, besimi i tyre fetar apo kulturor dhe gjendja shëndetësore. Për shembull, prerja e flokëve mund të jetë më poshtëruese për një person në një kontekst të caktuar kulturor.

9 Udhëzues për Raportimin e Torturës, f. 20

Duhet theksuar se shumica e traktateve të të drejtave të njeriut kombinojnë qasjet objektive (disa akte konsiderohen kaq të rënda, sa që çojnë **gjithmonë** në torturë) dhe subjektive në përcaktimin e shkallës së tyre.

2. **Qëllimi:** Vuajtjet shkaktohen për një qëllim specifik, si për shembull për të marrë informacione, si ndëshkim, intimidim, shtrëngim ose diskriminim.
3. **Synimi:** Dhembjet dhe vuajtjet duhet të jenë shkaktuar me synimin që akti të çojë në torturë. Nëse nuk mund të vërtetohet asnjë synim apo në rast neglizhence, sjellja mund të përbëjë një lloj tjetër keqtrajtimi nëse shkakton dhembje dhe vuajtje (si për shembull kushtet e këqija në burgje).
4. **Përfshirja e shtetit:** Autoritetet shtetërore e kanë shkaktuar këtë dhembje vetë ose kanë udhëzuar të tjerë për ta bërë këtë ose kanë qenë në dijeni ose duhet të kishin qenë në dijeni lidhur me të, por nuk kanë bërë asnjë përpjekje për ta parandaluar. Në rastin e individëve jozyrtarë, shteti mund të mbajë përgjegjësi nëse nuk ka arritur që të përmbushë detyrimet e kujdesit të duhur për parandalimin e torturës ose për mbrojtjen e individit.

3. Natyra e trajtimeve të tjera të egra, çnjerëzore ose poshtëruese (keqtrajtimi) (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Tortura **dallohet nga format e tjera të keqtrajtimit** bazuar në një analizë specifike të kontekstit dhe fakteve të qëllimit, për të cilin është shkaktuar vuajtja dhe ashpërsia e trajtimit. Nëse vuajtja nuk e përmbush përkufizimin e torturës, viktimë mund të jetë ende në gjendje të vërtetojë shkaktimin e trajtimit apo ndëshkimit **të egër, çnjerëzor ose poshtërues**, gjë që nuk kërkon vërtetimin e synimit specifik të atij që ka kryer veprimin, por që duhet të arrijë minimumin e nivelit të ashpërsisë.

Dokumentet ndërkombëtare zbulojnë forma të ndryshme të trajtimit të egër, çnjerëzor apo poshtërues të burgosurve. Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që ndalon trajtimin çnjerëzor ose poshtërues, përfshin edhe shkeljet në kontekstin e burgimit në secilën fazë të tij - nga momenti kur një person vendoset në paraburgim, për shkak të arrestimit ose kapjes nga një polic apo oficer ushtarak, deri në kohën kur një person lirohet nga burg.

Shënim për trajnerin

Le të reflektojmë pak për format e ndryshme të trajtimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues të burgosurve. Cila mund të jetë përmbajtja e këtyre formave ose manifestimeve të trajtimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues të burgosurve?

Zhvillohen disa diskutime dhe më pas trajneri përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Kushtet e paraburgimit/burgut mund të çojnë në disa raste në trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Kjo është gjithashtu një fushë, ku ka një evolucion të vazhdueshëm të standardeve bazë që konsiderohen të pranueshme në të gjitha shoqëritë. Me kushte të paraburgimit/burgut, kemi parasysh si mjedisin e përgjithshëm ku mbahen të paraburgosurit, ashtu edhe regjimin dhe kushtet specifike të burgut ku mbahen

të dënuarit. Në vlerësimin, nëse mjedisi i përgjithshëm i të burgosurit apo kushtet e vendosura ndaj tij apo ndaj saj janë apo jo në përputhje me Konventën, duhet të merren parasysh rrethanat e të burgosurit - mosha, gjinia, gjendja e tij ose e saj shëndetësore, rreziku që përbën vetë i burgosuri - si dhe faktin nëse personi është në paraburgim apo duke vuajtur dënimin me burg. Një person në paraburgim, përgjegjësia penale e të cilit nuk është vërtetuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, gëzon prezumimin e pafajësisë, që vlen jo vetëm sa i përket procedurës penale, por edhe statusit ligjor që rregullon të drejtat e personave të paraburgosur në institucionet e paraburgimit.

Shënim për trajnerin

Ja një listë e shembujve të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues e të burgosurve sipas Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut¹⁰.

Trajneri e ndan klasën në grupe të vogla dhe i kërkon secilit grup që të diskutojë thelbin e materialeve në vijim sa i përket trajtimit njerëzor dhe me dinjitet në këta shembuj.

Trajneri diskuton përfundimet e grupeve.

MATERIALI 1

Kushtet (higjienike) e qelive:

“Të kaluarit praktikisht të një pjese të konsiderueshme të çdo 24 orëshi i lidhur pas shtratit në qeli, pa asnjë ajrim dhe pa asnjë dritare, gjë që bën që në qeli të bëhet ndonjëherë aq nxehtë sa nuk mund të durohet.”

“Në një sipërfaqe prej 17 metra², mbaheshin 24 të burgosur - duke qenë i rrethuar nga persona që pinin shumë duhan, ai ishte i detyruar të kthehej në një duhanpirës pasiv, ishte e pamundur të flinte si duhet, pasi televizori dhe drita e qelisë nuk fikeshin kurrë, qelia ishte e tejmbushur me milingona dhe buburreca dhe ai kishte marrë një sërë sëmundjesh lëkure dhe infeksionesh mykotike, duke humbur si pasojë thonjtë e këmbës dhe disa prej thonjve të gishtave të dorës”.

Keqtrajtimi nga shokët e qelisë: *“Ankuesi pretendonte se kishte qenë viktimë e keqtrajtimit nga shokët e tjerë të qelisë gjatë dy periudhave të burgimit, veçanërisht për shkak të homoseksualitetit të tij dhe pretendonte se autoritetet nuk kishin marrë masat e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e tij”.*

“Një (tjetër) rast në lidhje me vdekjen e një të burgosuri, djali i ankuesit, pas akteve të torturës që i kishin shkaktuar shokët e qelisë, me përfshirjen e mundshme të një polici të burgut, gjatë burgimit të tij në një institucion penal”.

Keqtrajtim nga policët e burgut: *“I keqtrajtuar nga gardianët e burgut – u parashtrua se këta të fundit i kishin rrahur të burgosurit me shkopinj gome gjatë një kontrolli në qelinë e tyre - dhe se hetimi i kryer lidhur me ankesat e tyre kishte qenë joefikas”.*

Hapësira personale në një qeli me shumë persona dhe mbipopullimi i burgut:

U konstatua se hapësira e jetesës së ankuesve nuk kishte qenë në përputhje me

¹⁰ **Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut** Tabelë - Kushtet e paraburgimit dhe trajtimit të burgosurve, maj 2020.

standardet që konsiderohen të pranueshme në jurisprudencën e gjykatës. Gjykata theksoi se standardi i rekomanduar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) sa i përket hapësirës së jetesës në qeli ishte 4 metër² për person. Mungesa e hapësirës në të cilën ishin vendosur ankuesit ishte përkeqësuar edhe nga kushtet e tjera, si mungesa e ujit të ngrohtë për periudha të gjata kohe, si dhe ndriçimi dhe ajrimi jo i mjaftueshëm në këtë burg. Të gjitha këto mangësi, ndonëse jo çnjerëzore dhe degraduese në vetvete, kishin çuar në vuajtje shtesë. Ndonëse nuk kishte asnjë tregues për asnjë synim për poshtërimin apo zhvleftësimin e ankuesve, Gjykata u shpreh se kushtet e burgimit i kishin vënë ata - sa i përket kohëzgjatjes së burgimit të tyre - përballë vështirësive të një intensiteti që e tejkalonte nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që burgimi ka për nga natyra.

Transferimet e përsëritura

Siguria e të burgosurve gjatë transferimeve

Izolimi i veçuar

Ankuesi ishte mbajtur në paraburgim për tetë vjet në izolim shumë të rreptë para dënimit dhe ishte dënuar me vdekje për një sërë veprash të lidhura me terrorizmin. Ankuesi ishte shpallur de facto i pafajshëm dhe ishte liruar më pas në vitin 2001. Gjatë kohës që priste dënimin me vdekje, ai nuk kishte pasur asnjë kontakt me të burgosurit e tjerë, asnjë lajm nga jashtë - duke qenë se nuk i lejohej që të dërgonte apo të merrte postën - dhe nuk kishte pasur asnjë të drejtë për të kontaktuar me avokatin e tij apo për të pritur vizita sistematike nga familjarët. Qelia e tij ishte pa ngrohje, i privohej ushqimi si ndëshkim dhe i lejohej të bënte dush shumë rrallë. Këto kushte dhe mungesa e kujdesit mjekësor kishin bërë që shëndeti i tij të përkeqësohej.

Gjykata u shpreh se këto kushte në tërësinë e tyre kishin çuar në torturë.

Kontrolli fizik i të burgosurve

Gjatë paraburgimit, ankuesi kishte kërkuar leje që të votonte në zgjedhjet parlamentare të vitit 1993. Atij i ishte thënë nga një grup policësh të burgut se që të lejohej të votonte, ai duhet të zhvishej dhe t'i nënshtrohej një kontrolli fizik. Ai kishte hequr rrobat, përveç të brendshmeve dhe në atë moment policët e burgut ishin tallur me të, kishin shkëmbyer komente poshtëruese për trupin e tij dhe kishin abuzuar me të verbalisht. Ai u urdhërua që të zhvishej lakuriq, gjë që ai nuk pranoi ta bënte dhe më pas e kishin çuar në qeli, pa e lejuar që të votonte. Gjykata u shpreh se kjo sjellje kishte çuar në trajtim poshtërues, në shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) të Konventës.

Nuk kishte pasur asnjë arsye bindëse për të justifikuar urdhrin për zhveshjen e tij lakuriq para policëve të burgut dhe asnjë arsye që justifikohet për qëllime sigurie, duke qenë se ankuesi kishte demonstruar sjellje paqësore gjatë kohës së tij në paraburgim, nuk ishte akuzuar për ndonjë krim të dhunshëm, nuk kishte rekorde të mëparshme kriminale dhe se nuk ishte vërtetuar se kishte pasur arsye për të pasur frikë se ai mund të sillej në mënyrë të dhunshme. Ndonëse kontrollet fizike mund të jenë të nevojshme në raste të caktuara për të garantuar sigurinë e burgut apo për të parandaluar prishjen e rendit në burg, ato duhet të kryheshin në mënyrën e duhur. Sjellja që ka për qëllim të provokojë ndjenjën e poshtërimit dhe inferioritetit, si në këtë rast, kishte treguar mungesë respekti për dinjitetin njerëzor të të burgosurit.

Survejimi me video i qelisë.

4. Elementët bazë të një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin e torturës¹¹ (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin e torturës kërkon një qasje të integruar, të përbërë nga tre elementë të lidhur me njëri-tjetrin:

- një kuadër ligjor që ndalon torturën
- zbatimin efikas të këtij kuadri ligjor
- mekanizma për monitorimin e kuadrit ligjor dhe zbatimin e tij

Lufta kundër torturës është fokusuar për një kohë të gjatë në dy elementët e parë të kësaj strategjie, veçanërisht në zbatimin e ligjit dhe në shqyrtimin gjyqësor të rasteve. Një *kuadër ligjor efikas* është pjesë e domosdoshme e çfarëdolloj programi kundër torturës. Megjithatë, vetëm ekzistenca e ligjeve dhe rregulloreve nuk mjafton për parandalimin e torturës; Nevojitet të kuptohen si duhet dhe të zbatohen me rigozitet.

Vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar dhënies fund të pandëshkueshmërisë (përfshijmë nga ndëshkimi për një vepër penale) përmes përdorimit të së drejtës penale kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo linjë veprimi është një strategji e rëndësishme e parandalimit të tërthortë që mund të kombinohet me qasje të tjera për adresimin efikas të shkaqeve themelore të torturës.

Kjo është edhe arsyeja se pse një strategji e integruar për parandalimin e torturës kërkon një element të tretë që fokusohet tek parandalimi i drejtpërdrejtë dhe tek përdorimi i mekanizmave të kontrollit jokonfrontues dhe jogjyqësor. Për shembull, këto mekanizma mund të përfshijnë, monitorimin sistematik dhe pa njoftim paraprak të vendeve të burgimit nga organe të pavarura, si dhe fushata të edukimit të publikut për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbështetjen e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit.

Kjo strategji e integruar parandaluese mund të përshkruhet në formën e një shtëpie, ku kuadri ligjor përbën themelet, zbatimi i këtij kuadri krijon muret, kurse mekanizmat e kontrollit përfaqësojnë çatinë mbrojtëse. (shih figurën 1)




Figura 1

11 Parandalimi i Torturës Udhëzues Operacional për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut

Shënim për trajnerin

Trajneri e ndan klasën në grupe të vogla dhe u kërkon të lexojnë thelbin e

MATERIALIT 2 (Shih Shtojcën) me informacione rreth:

- **Protokolli Opsional i Konventës “Kundër Torturës” (OPCAT)**
- **Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës**
- **Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruar dhe kuadrin rajonal për Evropën**
- **Kuadri ligjor shqiptar për parandalimin e torturës dhe të keqtrajtimit në sistemin e burgjeve**
- **Mekanizmi Kombëtar Parandalues**
- **Protokolli i Stambollit**

Pas leximit të materialit, nëngrupet duhet t’u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme.

Nëngrupet raportojnë përgjigjet e tyre, të cilat më pas diskutohen dhe kontrollohen nga trajneri.

Pyetje

1. Përshkruani veprimet ose mungesën e veprimeve që mund të çojnë në torturë dhe keqtrajtim, sa i përket keqtrajtimit të të burgosurve.
2. Çfarë është Protokolli i Stambollit?
3. Çfarë dini për Konventën “Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera të Egra, Çnjerëzore dhe Degraduese” (OPCAT)?
4. Çfarë është Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës?
5. Çfarë është kuadri rajonal për Evropën?
6. Çfarë dini për Mekanizmin Kombëtar të Parandalimit të Torturës?

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

Kushtet (higjienike) e qelive:

“Të kaluarit praktikisht e një pjese të konsiderueshme të çdo 24 orëshi i lidhur pas shtratit në qeli, pa asnjë ajrim dhe pa asnjë dritare, gjë që bën që në qeli të bëhet ndonjëherë aq nxehtë sa nuk mund të durohet.”

“Në një sipërfaqe prej 17 metra katrorë, mbaheshin 24 të burgosur - duke qenë i rrethuar nga persona që pinin shumë duhan, ai ishte i detyruar të kthehej në një duhanpirës pasiv, ishte e pamundur të flinte si duhet, pasi televizori dhe drita e qelisë nuk fikeshin kurrë, qelia ishte e tejmbushur me milingona dhe buburreca dhe ai kishte marrë një sërë sëmundjesh lëkure dhe infeksionesh mykotike, duke humbur si pasojë thonjtë e këmbës dhe disa prej thonjve të gishtave të dorës”.

Keqtrajtimi nga shokët e qelisë: *“Ankuesi pretendonte se kishte qenë viktimë e keqtrajtimit nga shokët e tjerë të qelisë gjatë dy periudhave të burgimit, veçanërisht për shkak të homoseksualitetit të tij dhe pretendonte se autoritetet nuk kishin marrë masat e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e tij”.*

“Një (tjetër) rast në lidhje me vdekjen e një të burgosuri, djali i ankuesit, pas akteve të torturës që i kishin shkaktuar shokët e qelisë, me përfshirjen e mundshme të një polici të burgut, gjatë burgimit të tij në një institucion penal”.

Keqtrajtim nga policët e burgut: *“I keqtrajtuar nga gardianët e burgut – u parashtua se këta të fundit i kishin rrahur të burgosurit me shkopinj gome gjatë një kontrolli në qelinë e tyre - dhe se hetimi i kryer lidhur me ankesat e tyre kishte qenë joefikas”.*

Hapësira personale në një qeli me shumë persona dhe mbipopullimi i burgut:

U konstatua se hapësira e jetesës së ankuesve nuk kishte qenë në përputhje me standardet që konsiderohen të pranueshme në jurisprudencën e gjykatës. Gjykata theksoi se standardi i rekomanduar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) sa i përket hapësirës së jetesës në qeli ishte 4 metër katrorë për person. Mungesa e hapësirës në të cilën ishin vendosur ankuesit ishte përkeqësuar edhe nga kushtet e tjera, si mungesa e ujit të ngrohtë për periudha të gjata kohe, si dhe ndriçimi dhe ajrimi jo i mjaftueshëm në këtë burg. Të gjitha këto mangësi, ndonëse jo çnjerëzore dhe degraduese në vetvete, kishin çuar në vuajtje shtesë. Ndonëse nuk kishte asnjë tregues për asnjë synim për poshtërimin apo zhvleftësimin e ankuesve, Gjykata u shpreh se kushtet e burgimit i kishin vënë ata - sa i përket kohëzgjatjes së burgimit të tyre - përballë vështirësive të një intensiteti që e tejkalonte nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që burgimi ka për nga natyra.

Transferimet e përsëritura

Siguria e të burgosurve gjatë transferimeve

Izolimi i veçuar

Ankuesi ishte mbajtur në paraburgim për tetë vjet në izolim shumë të rreptë para dënimit dhe ishte dënuar me vdekje për një sërë veprash të lidhura me terrorizmin. Ankuesi ishte shpallur de facto i pafajshëm dhe ishte liruar më pas në vitin 2001. Gjatë kohës që priste dënimin me vdekje, ai nuk kishte pasur asnjë kontakt me të burgosurit e tjerë, asnjë lajm nga jashtë - duke qenë se nuk i lejohej që të dërgonte apo të merrte postën - dhe nuk kishte pasur asnjë të drejtë për të kontaktuar me avokatin e tij apo për të pritur vizita sistematike nga familjarët. Qelia e tij ishte pa ngrohje, i privohej ushqimi si ndëshkim dhe i lejohej të bënte dush shumë rrallë. Këto kushte dhe mungesa e kujdesit mjekësor kishin bërë që shëndeti i tij të përkeqësohej.

Gjykata u shpreh se këto kushte në tërësinë e tyre kishin çuar në torturë.

Kontrolli fizik i të burgosurve

Gjatë paraburgimit, ankuesi kishte kërkuar leje që të votonte në zgjedhjet parlamentare të vitit 1993. Atij i ishte thënë nga një grup policësh të burgut se që të lejohej të votonte, ai duhet të zhvishej dhe t'i nënshtrohej një kontrolli fizik. Ai kishte hequr rrobat, përveç të brendshmeve dhe në atë moment policët e burgut ishin tallur me të, kishin shkëmbyer komente poshtëruese për trupin e tij dhe kishin abuzuar me të verbalisht. Ai u urdhërua që të zhvishej lakuriq, që gjë ai nuk pranoi ta bënte dhe më pas e kishin çuar në qeli, pa e lejuar që të votonte. Gjykata u shpreh se kjo sjellje kishte çuar në trajtim poshtërues, në shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) të Konventës.

Nuk kishte pasur asnjë arsye bindëse për të justifikuar urdhrin për zhveshjen e tij

lakuriq para policëve të burgut dhe asnjë arsye që justifikohet me qëllime sigurie, duke qenë se ankuesi kishte demonstruar sjellje paqësore gjatë kohës së tij në paraburgim, fakti që ai nuk ishte akuzuar për ndonjë krim të dhunshëm, që nuk kishte rekorde të mëparshme kriminale dhe se nuk ishte vërtetuar se kishte pasur arsye për të pasur frikë se ai mund të sillej në mënyrë të dhunshme. Ndonëse kontrollet fizike mund të jenë të nevojshme në raste të caktuara për të garantuar sigurinë e burgut apo për të parandaluar prishjen e rendit në burg, ato duhet të kryheshin në mënyrën e duhur. Sjellja që ka për qëllim të provokojë ndjenjën e poshtërimit dhe inferioritetit, si në këtë rast, kishte treguar mungesë respekti për dinjitetin njerëzor të të burgosurit.

Survejimi me video i qelisë.

MATERIALI 2

I. Prezantimi i Protokollit Opsional të Konventës “Kundër Torturës” (OPCAT)

Protokolli opsional i Konventës “Kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues” (në vazhdim OPCAT) është një vazhdë e rëndësishme e Konventës së OKB-së “Kundër Torturës” e vitit 1984. Qëllimi i këtij protokoll është vendosja e një sistemi vizitash të rregullta, të ndërmarra nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare në vendet ku njerëzve u është hequr liria, me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Protokolli opsional përfaqëson një arritje të re që bazohet në premisën se, sa më të hapura dhe transparente të jenë procedurat në vendet e vuajtjes së dënimit, aq më pak mundësi abuzimi vihen re. Protokollin opsional është forma më efektive për parandalimin e praktikave abuzive dhe përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit.

Nënkomiteti i Parandalimit të Torturës

Një institucioni i krijuar në bazë të nenit 2 të Protokollit Opsional (OPCAT), Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës krijohet me kompetenca të gjera, duke përfshirë ndikimin e drejtpërdrejtë në krijimin e mekanizmave kombëtarë të parandalimit (NPM), të cilët formojnë shtyllën e dytë të një mekanizmi universal.

Gjatë veprimtarisë së tij, Nënkomiteti bashkëpunon me shtetet palë individualisht. Bazohet në parimet thelbësore të bashkëpunimit dhe të besueshmërisë, të paanësisë, mosdallimit, universalitetit dhe objektivitetit. Bazuar në përcaktimet e OPCAT-it, tre karakteristikat kryesore të nënkomitetit janë si më poshtë:

1. përfaqëson një organ vizitash
2. përfaqëson një organ ndihmës dhe këshillues për shtetet palë dhe mekanizmat kombëtarë parandalues
3. një organ që integrohet me mekanizmat ekzistues

Siç përcaktohet në nenin 11(c) të OPCAT-it, nëpërmjet veprimtarisë së tij, Nënkomiteti bashkëpunon për parandalimin e torturës në përgjithësi, me organet dhe mekanizmat përkatës të Kombeve të Bashkuara, si dhe me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, regjionale dhe kombëtare, që punojnë për forcimin e mbrojtjes së personave nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

II. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës dhe kuadri rajonal për Evropën¹²

Detyrimet në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare të cilat përcaktojnë që autoritetet shqiptare të marrin masat për ndalimin e torturës dhe të keqtrajtimit të tjera, rrjedhin jo vetëm nga anëtarësimi i saj në Kombet e Bashkuara, por edhe nga anëtarësimi i Shqipërisë në **Këshillin e Evropës (KiE)** me qendër në Strasburg, Francë.

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në mbarim të Luftës së Dytë Botërore për ruajtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës në Evropë. Është themeluar në vitin 1949 dhe ka një anëtarësi prej 47 shtetesh.

Këshilli i Evropës ka zhvilluar një kuadër për Evropën, ku përfshihet **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)**, e cila çoi në ngritjen e **Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ)**, **Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës**, e cila çoi në ngritjen e **Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT)**. Ndalimi absolut i shprehur i torturës dhe i formave të tjera të keqtrajtimit sipas nenit 3 të KEDNJ-së është zhvilluar ndjeshëm në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Bashkë me **detyrimet** e shteteve anëtare për të mos cenuar të drejtat e njeriut që parashikohen në KEDNJ, në jurisprudencën e GjEDNJ-së janë zhvilluar edhe **detyrimet** e shteteve për të ndërmarrë hapa ose masa pozitive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga agjencitë shtetërore dhe nga individët privatë. Këto detyra dhe hapa pozitivë që duhet të ndërmerren nga shtetet janë:

- krijimi i një kuadri ligjor që mbron në mënyrë efikase të drejtat e parashikuara në KEDNJ
- parandalimi i shkeljeve të drejtave të KEDNJ-së
- ofrimi i informacioneve dhe këshillave në lidhje me shkeljen e të drejtave të parashikuara në KEDNJ
- hetimi në mënyrë efikase i shkeljeve të drejtave të KEDNJ-së, dhe
- sigurimi i burimeve për individët që të marrin pjesë në procedime kur ka pasur shkelje të drejtave të KEDNJ-së.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT) organizon vizita në ambiente burgimi për të vlerësuar se si trajtohen personat, të cilët janë privuar nga liria. Këto vende përfshijnë burgjet, qendrat e burgimit për të miturit, rajonet e policisë, qendrat për mbajtjen e emigrantëve të burgosur, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj.

Delegacionet e KPT-së kanë akses të pakufizuar në ambientet e paraburgimit, si dhe të drejtën për të hyrë brenda këtyre vendeve pa asnjë kufizim. Ata intervistojnë personat e privuar nga liria në mënyrë private dhe komunikojnë lirisht me këdo që mund të ofrojë informacion.

Pas çdo vizite, KPT-ja i dërgon një raport të detajuar shtetit përkatës. Në këtë raport

¹² Manual trajnimi për ndalimin e torturës dhe të trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues, 2018. Këshilli i Evropës, <http://horizontal-facility-eu.coe.int>.

përfshihen konstatimet e KPT-së, si dhe rekomandimet, komentet dhe kërkesat për informacion që ky Komitet mund të ketë. KPT-ja kërkon gjithashtu edhe përgjigje të detajuara për çështjet e ngritura në raport. Këto raporte dhe përgjigje përbëjnë pjesë të një dialogu të vazhdueshëm me shtetin përkatës.

Titulli i plotë i KPT-së është “Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese”. Kjo vë në dukje dy elementë të rëndësishëm: së pari, është evropian dhe, së dyti, mbulon jo vetëm “torturën”, por edhe një gamë të gjerë situatash që mund të çojnë në “trajtim ose dënim çnjerëzor ose poshtëruës”.

III. Kuadri ligjor shqiptar për parandalimin e torturës dhe të keqtrajtimeve në sistemin e burgjeve

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Kundër torturës” afro dhjetë vjet më parë, duke marrë përsipër detyrimet për parandalimin e torturës dhe të gjitha formave të tjera të keqtrajtimit, pavarësisht nga rrethanat që mund të krijohen.

Si një prej 139 shteteve palë të CAT-it dhe 39 shteteve palë të OPCAT-it, Shqipëria ka detyrimin të hartojë dhe të paraqesë në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë raporte periodike në lidhje me masat që shteti shqiptar ka marrë për të luftuar fenomenin torturë.

Ligji nr. 7227 i vitit 1993, “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën “Kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër çnjerëzor ose poshtëruës”, ligjin nr. 7510 të vitit 1991, “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike” dhe ratifikimi i Konventës Evropiane “Për të drejtat e njeriut” janë masat formale se Shqipëria angazhohet për garantimin e lirive, luftën kundër torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe një respektim më të mirë nga stafi policor i të drejtave të individit nga zyrtarët zbatues të ligjit.

Në kuadrin ligjor shqiptar, neni 25 i Kushtetutës së Shqipërisë ndalon përdorimin e torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit nga policia dhe në nenin 28 pika 5 të Kushtetutës parashikohet trajtimi njerëzor dhe respektimi i dinjitetit për të gjithë personat e dënuar me heqje lirie.

Gjithashtu, Kodi Penal ndalon përdorimin e forcës dhe dënime të rënda për personat që e shkelin atë. Veç kësaj, neni 314 i Kodit Penal ndalon përdorimin e forcës gjatë periudhës së hetimit. Shkelja e këtij neni dënohet nga 3-10 vjet burg.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon sanksione për të gjitha format e keqtrajtimit që përbëjnë elemente të torturës, të kryera gjatë ushtrimit të profesionit, në të dyja nenet e ndryshuara 86 dhe 87 për torturën dhe për torturën me pasoja të rënda.

Dhuna ndaj grave, veçanërisht ajo në familje, ka rritur në mënyrë të ndjeshme numrin e grave të cilat kanë tentuar të kryejnë vetëvrasje ose krime të tmerrshme brenda një realiteti i cili ofron një informacion të pamjaftueshëm për përmasat dhe popullaritetin e kësaj dukurie. Në përfundimet e vëzhgimeve të Komitetit kundër Torturës ndihet shqetësimi në raport me popullaritetin e dhunës ndaj grave dhe vajzave përfshirë dhunën seksuale edhe në familje dhe ngurrimin nga ana e autoriteteve që, nëpërmjet ndryshimeve legjislative dhe masave të tjera, të luftojnë në mënyrën maksimale të mundshme këtë dukuri.

Neni 44 i Kushtetutës garanton kompensimin e personave që kanë vuajtur dëme si rezultat i veprimeve të paligjshme apo mosveprimeve nga zyrtarë të shtetit apo autoritetet. Sidoqoftë, ka nen në legjislacionin shqiptar që e njeh përgjegjësinë e shtetit për kompensimin e viktimave të torturës dhe keqtrajtimit nga policia dhe zyrtarë publikë. E vetmja mënyrë kompensimi për viktimat e torturës është hapja e një çështjeje civile për kompensim. Për t'u nisur kjo procedurë, kërkohet besim në sistemin gjyqësor, mundësi financiare për të marrë një avokat, apo asistencë ligjore nga organizata, si dhe durim.

Ndryshimet ligjore të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” lidhur me vendosjen e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës, si edhe aksesit që ligji u lejon institucioneve të jashtme monitoruese si Avokati i Popullit, OJF të tjera jofitimprurëse që mbrojnë të drejtën e personave të privuar nga liria, janë garanci ligjore të vëzhgimit të trajtimit që u ofrohet personave nën kujdesin e institucioneve të burgjeve dhe të paraburgimeve dhe denoncimit të torturës, nëse ajo ndodh, dhe rivendosjen e të drejtave të këtyre personave.

IV. Mekanizmi kombëtar i parandalimit

Shqipëria është shteti i dytë që ka ratifikuar OPCAT-in, më datë 1 tetor 2003 dhe teorikisht, duhej të krijonte mekanizmin e vet parandalues kombëtar deri më 22 qershor 2007. Por, me ndryshimet që solli ligji nr. 9888, datë 10.3.2008, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”¹³, nenet 76/1 dhe 76/2, Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (në vijim Mekanizmi Kombëtar) që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, fiton të drejtën e mbikqyrjes së zbatimit të këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të dënuarve.

Pavarësisht formës së mekanizmit kombëtar të parandalimit që një shtet vendos të krijojë, elementi më i rëndësishëm është që ky organ të plotësojë kriteret e përcaktuara në tekstin e protokollit opsional lidhur me pavarësinë e mekanizmit (neni 18(1), protokollit opsional), (neni 35, protokollit opsional), (Deklarata e Parisit: Përbërja dhe garancitë e pavarësisë, parimi 2), (Deklarata e Parisit: Përbërja dhe garancitë e pavarësisë, parimi 3) përbërja (neni 18(2), protokollit opsional), pushtetet dhe mandati (neni 4(1), protokollit opsional), (neni 29, protokollit opsional) dhe autoriteti (neni 4 dhe 20(c), protokollit opsional).

Por cilat janë këto elemente dhe çfarë përfaqësojnë?

Në ligjin e ri “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (Nr.81/2020), Neni 81 i tij, “Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij” thotë:

Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:

13 Në vitin 2020, ky ligj u shfuqizua dhe u miratua ligji i ri “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Nr. 81 datë 25.06.2020. Kompetencat e Avokatit të Popullit në këtë ligj janë parashikuar në nenin 81, 82, 83.

a. vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve të dënuar me heqje liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

b. paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve të dënuar me heqje lirie dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 82 i këtij ligji, "Garancitë në veprimtaritë e Mekanizmit Kombëtar"

Mekanizmit Kombëtar, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, i garantohet:

a. marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve të dënuar me heqje lirie, në vendet e heqjes së lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b. marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;

c. hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;

ç. kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët e dënuar me heqje lirie, personalisht ose me një përkthyes, kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;

d. zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitojë dhe e individëve që kërkon të intervistojë.

Neni 83 i këtij ligji, "Format e mbikqyrjes"

Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet:

a. pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit me shkrim ose drejtpërdrejt;

b. marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;

c. kërkit të informacioneve nga administrata e institucionit;

ç. verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.

Për realizimin e procesit të mbikqyrjes, Mekanizmi Kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrit të vërejtjeve".

V. Protokollit i Stambollit

Gjatë dy dekadave të fundit, janë nxjerrë shumë mësimë për torturat dhe pasojat e tyre, por nuk ka pasur asnjë udhëzim ndërkombëtar për dokumentacionin para se të hartohet Protokollit i Stambollit. Protokollit i Stambollit është një Manual për hetimin dhe dokumentimin efikas të torturës dhe të trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore,

çnjërëzore ose poshtëruese. Ai ka për qëllim të shërbejë si një paketë udhëzuesish ndërkombëtar për vlerësimin e personave që pretendojnë se kanë qenë objekt i torturës dhe keqtrajtimit, për hetimin e çështjeve të torturës së pretenduar, si dhe për raportimin e konstatimeve tek gjyqësori ose në çdo organ tjetër hetimor. Protokolli i Stambollit përfshin parimet për hetimin dhe dokumentimin efikas të torturës dhe të trajtimeve ose dënimeve të tjera çnjërëzore, mizore ose degraduese. Këto parime përcaktojnë standardet minimale që duhet të zbatohen shtetet për të garantuar dokumentimin efikas të torturës.

Moduli 4: Kodi i Sjelljes (4 orë)

Objektivi: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të njohin Kodin e Sjelljes që orienton sjelljen e punonjësve të burgjeve;
 - do të jenë në gjendje të shpjegojnë se pse është e rëndësishme që punonjësit e burgjeve të sillen në mënyrë etike, t'u përmbahen standardeve më të larta të sjelljes profesionale dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut;
 - do të jenë në gjendje të shpjegojnë në mënyrë të detajuar se cilat standarde etike duhet të zbatojë personeli i burgjeve;
 - do të eksplorojnë etikën e tyre personale përmes kryerjes së një testi vetëvlerësimi;
 - do të jenë në gjendje të reflektojnë dhe të zbatojnë standardet etike që mund të hasin në realitet, sipas shembullit të një dileme.
-

1. Prezantimi i Kodit të Sjelljes (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në këtë modul do të analizojmë Kodin e Sjelljes për stafin e shërbimit të burgjeve dhe përgjegjësinë që kanë punonjësit për ruajtjen e standardeve më të larta të sjelljes profesionale duke plotësuar kërkesat ligjore, mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut. Gjithashtu, do të shqyrtojmë etikën personale duke e praktikuar me një shembull të një dileme marrë nga jeta e përditshme.

Shënim për trajnerin

Trajneri e pyet grupin: Çfarë është Kodi i Sjelljes?

Trajneri shënon mendimet e shprehura nga grupi në tabelë, duke i inkurajuar pjesëmarrësit sipas rastit. Ky ushtrim zgjat 5 minuta. Pasi trajneri mbledh mendimet e pjesëmarrësve, ai/ajo e përmbledh si vijon:

Në përgjithësi, Kodi i Etikës duhet të përcaktojë se çfarë duhet të konsiderojë një institucion burgimi si sjellje të drejtë apo të gabuar ose sjellje të mirë dhe të keqe. Është një tërësi e rregullave të sjelljes apo përmbledhje standardesh të cilat udhëzojnë punonjësit e shërbimit të burgjeve për sjelljet e tyre. Kodi është i bazuar në konceptin e shërbimit publik, si dhe në respektimin e dinjitetit njerëzor. Punonjësit duhet të jenë të paanshëm në veprimet e tyre dhe kurrë nuk lejohet ta përdorin autoritetin e tyre për përfitime personale. Në Kodin e Sjelljes flitet për një përmbledhje të standardeve të vendosura për sjelljet e punonjësve të sistemit të paraburgimit dhe burgjeve, të cilat sigurojnë që ata të plotësojnë kërkesat ligjore dhe të mbrojnë e të promovojnë të drejtat e njeriut.

Kodi i Sjelljes i referohet gjithashtu identitetit profesional brenda fushës përkatëse dhe shërben si një udhëzues apo orientues për vlerësimet në nivel personal dhe institucional. “Identiteti profesional” i çdo punonjësi të burgjeve bazohet tek njohja dhe zbatimi etik i një grupi njohurish të specializuara dhe të zhvilluara, si dhe një bashkësie të aftësive në pune ose kompetencash të ndryshme.

2. Kodi i Sjelljes - Shpjegimi (20 minuta)

Shënim për trajnerin

Trajneri e pyet grupin: A mund të më thoni se pse punonjësit e burgjeve duhet t'i përmbahen një Kodi Sjellje që përfshin sjelljen etike që ata duhet të demonstrojnë?

Trajneri shënon mendimet e shprehura nga grupi në një tabelë, duke i inkurajuar pjesëmarrësit sipas rastit. Ky ushtrim duhet të marrë afërsisht 10 minuta.

Pasi trajneri mbledh mendimet e pjesëmarrësve, e përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Sistemi i burgjeve është pjesë e sistemit të drejtësisë penale që ka për qëllim zbatimin e drejtësisë dhe promovimin e sigurisë në komunitet. Komuniteti pret që sistemi i drejtësisë penale “të praktikojë atë çka predikon” dhe që organizatat e drejtësisë penale dhe sjellja e drejtësisë penale apo e zyrtarëve të burgjeve të mos cenojë besimin e publikut dhe të burgosurve në një sistem të ndershëm dhe efikas.

Pra, punonjësit e shërbimit të burgjeve kanë përgjegjësi të sillen në mënyrë etike dhe të mbajnë standardet më të larta të sjelljes profesionale. Çdo sjellje joetike e treguar nga punonjësi ka ndikim shumë negativ të të burgosurit, të cilët mbajnë sy e vesh tek ai, por njëkohësisht bie në sy të qytetarëve të cilët mund të jenë si vizitorë aty. Kjo sjell humbjen e besimit tek institucionet, te ligji dhe drejtësia, prandaj është një përgjegjësi e madhe për çdo punonjës. Rregullat e sjelljes janë të përcaktuara qartë. Duhet vetëm vullnet dhe dëshirë për t'i zbatuar. Ato janë përcaktuar në aktet vendore, siç janë: “Rregullat e sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve”, të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 3052/1, datë 25.5.2005 dhe kodet ndërkombëtare të sjelljes së punonjësve të zbatuesve të ligjit.

Kodet ndërkombëtare për sjelljen e punonjësve të zbatimit të ligjit janë parashikuar në Kodin e Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në Rregullat Evropiane të Burgjeve, miratuar nga Këshilli i Evropës.

Si kodet kombëtare, ashtu edhe ato ndërkombëtare theksojnë faktin se marrëdhëniet njerëzore dhe dinjitoze mes punonjësve të burgjeve dhe të burgosurve, si dhe *konteksti etik* janë thelbi i jetës në burg. Cilësia morale e jetës në burg mishërohet në *qëndrimet dhe sjelljet* e punonjësve të burgjeve. Kodi i Sjelljes mbështet qëllimin e garantimit të një cilësie morale në jetën e burgut.

Kodi i sjelljes ka për qëllim të rritetësojë çështjet e të drejtave ligjore dhe të drejtave të njeriut të përcaktuara me ligj. Kodi i shndërron këto çështje në sjellje të mirëfillta të punonjësve të shërbimit të burgjeve. Ai parashton vlerat dhe normat e sjelljes së dëshiruar dhe të pranueshme të punonjësve në sistemin e paraburgimit dhe burgjet. Etika dhe vlerat duhet të drejtojnë organizimin e burgut në të gjitha nivelet hierarkike. Standardet morale dhe etike duhet të jenë përparësia më e lartë për personelin në burgje. Nëse nuk veprohet kështu, do të shfaqet një hendek i dukshëm midis misionit dhe vizionit të organizatës dhe veprimeve të përditshme. Burgjet që nuk arrijnë të artikulojnë dhe demonstrojnë standarde të përshtatshme etike do të rezultojnë në një staf të demoralizuar i cili nuk do të përpiqet të zbatojë misionin dhe vizionin e organizatës.

Le të shohim nga afër standardet etike dhe sjelljen etike.

3. Standardet ndërkombëtare për sjelljen etike të punonjësve të burgjeve: Kodi Evropian i Etikës (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Sjellja etike e punonjësve të burgjeve bazohet në objektivat kryesore të punonjësve të burgjeve në një shoqëri demokratike që drejtohet nga shteti i së drejtës. Sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve¹⁴ të Këshillit të Evropës, objektivat kryesore të punonjësve të burgjeve në një shoqëri demokratike që drejtohet nga shteti i së drejtës janë:

- 1) zbatimi i të gjitha detyrimeve të tyre në përputhje me ligjin vendas dhe standardet ndërkombëtare;
- 2) mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore të individit, siç parashikohen në veçanti në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- 3) marrja e masave që të gjithë të burgosurit të jenë të sigurt dhe të mbahen në kushte që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht me Rregullat Evropiane të Burgjeve;
- 4) respektimi dhe mbrojtja e të drejtës së publikut për të qenë i mbrojtur nga aktiviteti kriminal;
- 5) puna për ri-integrimin social të të burgosurve pas lirimit të tyre nga burgu, duke u dhënë atyre mundësinë për ta shfrytëzuar pozitivisht kohën e qëndrimit në burg.

Më specifikisht, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁵ parashikojnë:

- 72.1 Burgjet menaxhohen brenda një **kuadri etik** që njeh të drejtën për të trajtuar të gjithë të burgosurit në mënyrë njerëzore dhe duke respektuar dinjitetin e çdo personi.
- 72.2 Stafi manifeston një sens të qartë të qëllimit të sistemit të burgjeve. Strukturat drejtuese japin orientimet se si mund të arrihet ky qëllim.
- 72.3 Detyrat e stafit shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe duhet të marrin parasysh nevojën e lehtësimit të ri-integrimit të burgosurve në shoqëri pas përfundimit të dënimit përmes programeve të kujdesit dhe ndihmës pozitive.
- 72.4 Stafi punon sipas standardeve të larta profesionale dhe personale.
- 73 Autoritetet e burgut i japin përparësi vëzhgimit të zbatimit të rregullave që lidhen me stafin.
- 74 Një vëmendje e rëndësishme i kushtohet menaxhimit të marrëdhënieve ndërmjet personelit të burgut që punon direkt me të burgosurit dhe të burgosurve që ata kanë nën kujdes.
- 75 Gjatë gjithë kohës stafi sillet mirë dhe realizon detyrat në mënyrë që të ndikojë tek të burgosurit me shembullin e tij të mirë dhe të fitojë respektin e tyre.

14 Rekomandimi Rec(2006)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane të Burgjeve (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 dhe i rishikuar dhe i ndryshuar nga Komiteti i Ministrave më 1 korrik 2020 në takimin e 1380^{-të} të Zëvendësministrave).

15 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

- 76 Stafi përzgjidhet me kujdes, trajnohet si duhet, si në fillim, ashtu edhe në mënyrë të vazhdueshme, paguhet në nivelin e punonjësve profesionistë dhe ka një status të respektuar nga shoqëria civile.
- 77 Gjatë përzgjedhjes së stafit të ri, autoritetet e burgjeve i kushtojnë rëndësi të madhe nevojës për integritet, trajtim human, kapacitet profesional dhe qëndrueshmëri personale për punën komplekse që ata duhet të kryejnë.
- 81.1 Përpara fillimit të punës, stafi merr pjesë në një kurs trajnimi rreth detyrave të tij të përgjithshme dhe specifike dhe i kërkohet të japë teste teorike dhe praktike.
- 81.4 Trajnimi i të gjithë stafit përfshin udhëzime për instrumentet dhe standardet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, veçanërisht Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues, si dhe zbatimin e Rregullave Evropiane të Burgjeve.

Këshilli i Evropës ka përmbledhur në Rekomandimin CM/Rec (2012)5 të Komitetit të Ministrave, Kodin Evropian të Etikës për Stafin e Burgjeve (Shih MATERIALIN 2). Kodi Evropian i Etikës përfshin këto aspekte të sjelljes etike:

- A. Përgjegjshmërinë
- B. Integritetin
- C. Respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor
- D. Kujdesin dhe ndihmën
- E. Drejtësinë, paanshmërinë dhe mosdiskriminimin
- F. Bashkëpunimin
- G. Konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave
- H. Të përgjithshme

Shënim për trajnerin

Trajneri e ndan grupin në katër nëngrupe të vogla.

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të punojnë në grupe të vogla për t'iu përgjigjur pyetjes se çfarë do të thotë për punonjësit e burgjeve që ta kryejnë punën me:

- Përgjegjshmëri dhe Integritet (**Grupi 1**)
- Respekt dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe Kujdes e ndihmë (**Grupi 2**)
- Ndershmëri, paanshmëri dhe mosdiskriminim (**Grupi 3**)
- Bashkëpunim dhe Konfidencialitet e mbrojtje të dhënash (**Grupi 4**)

Shënim për trajnerin

Trajneri mban shënim mendimet e grupit në një tabelë dhe i përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Përgjegjshmëri: do të thotë që pranon përgjegjësinë personale për veprimet apo mosveprimet dhe pasojat e tyre, si dhe kryen çdo herë paraprakisht verifikime për ligjshmërinë e veprimeve që do të ndërmarrësh.

Integriteti: i referohet vendosjes së standardeve të larta për dinjitetin personal, përpjekje për ruajtjen e marrëdhënieve personale pozitive me të burgosurit, shmangie e konfliktit të interesit midis pozicionit dhe interesave private, financiare apo interesave të tjera, kundërshtimi, luftimi dhe kundërvënja ndaj të gjitha formave të korrupsionit, zbatimi i të gjitha udhëzimeve ligjore, si dhe moszbatimi i udhëzimeve që bien në kundërshtim me ligjin.

Respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor: nënkupton respektimin e të drejtës së çdo personi për jetën dhe të drejtën për privatësi, mbrojtjen e integritetit fizik, psikologjik dhe seksual të gjithë të burgosurve, përpjekjet për të mos shkaktuar, nxituri apo toleruar torturën apo trajtime apo dënime të tjera çnjerëzore, trajtimi i cilitdo me respekt dhe mirësjellje, etj.

Kujdesi dhe ndihma: nënkuptojnë lehtësimin e ri-integrimit social të burgosurve përmes programeve të aktiviteteve konstruktive, ndërveprimeve individuale dhe ndihmëse. Kjo do të thotë gjithashtu që të jesh i ndjeshëm ndaj nevojave të veçanta të individëve, si p.sh. të burgosurve të mitur, të burgosurve gra, pakicave, shtetasve të huaj, të moshuarve dhe të burgosurve me aftësi të kufizuara, si dhe nevojave të çdo të burgosuri që mund të jetë vulnerabël për arsye të tjera dhe ndërmarrja e të gjitha përpjekjeve të mundshme për plotësimin e nevojave të tyre.

Ndershmëria, paanshmëria dhe mosdiskriminimi: nënkuptojnë respektimin e pluralizmit dhe diversitetit dhe mosdiskriminimin e asnjë të burgosuri për shkak të seksit, moshës, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, opinioneve politike apo opinioneve të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, përkatësisë në një minoritet kombëtar, statusit të pronave, statusit në lindje apo çdo statusi tjetër dhe as për arsye të veprës penale për të cilin është akuzuar apo që e ka kryer një i burgosur. Kjo nënkupton gjithashtu kryerjen e detyrave me ndershmëri, objektivitet dhe qëndrueshmëri, si dhe respektimin e prezumimit të pafajësisë së të burgosurve që nuk janë dënuar me vendim gjykatë, etj.

Bashkëpunimi: nënkupton marrjen e masave që të burgosurit të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të pasur akses sistematik dhe të mjaftueshëm tek avokati dhe familjarët gjatë gjithë kohës së qëndrimit në burg, si dhe lehtësimin e bashkëpunimit me organet qeveritare apo joqeveritare dhe me grupet e komunitetit që punojnë për mirëqenien e të burgosurve.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave: nënkupton që informacionet me natyrë konfidenciale që zotëron stafi i burgjeve duhet të mbahen konfidenciale, me përjashtim të rasteve kur kryerja e detyrës apo nevojat e drejtësisë kërkojnë rreptësisht të kundërtën.

Të përgjithshme: kjo do të thotë se stafi i burgjeve duhet të respektojë këtë kod. Ata duhet gjithashtu që, me aftësitë e tyre më të mira, të parandalojnë dhe të kundërshtojnë në mënyrë rigorozë çdo shkelje të këtij kodi. Punonjësit e burgjeve që kanë arsye të besojnë se ka ndodhur apo pritet të ndodhë një shkelje e këtij kodi duhet ta raportojnë këtë çështje te autoritetet e prokurorisë dhe, sipas rastit, tek strukturat e tjera përkatëse.

4. Rregullat Kombëtare të Sjelljes për Stafin e Burgjeve (45 minuta)

Udhëzimet për sjelljen etike të punonjësve të policisë së burgjeve shqiptare janë të përcaktuara në Rregulloren e Etikës së Policisë së Burgjeve hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve¹⁶ (DPB). (Shih MATERIALIN 1)

Rregullat e sjelljes përmbajnë një përmbledhje të standardeve etike të sjelljeve për punonjësit e burgjeve. Ekzistojnë disa parime të përgjithshme të cilat përbëjnë themelin e sjelljeve të cilat duhet t'i ketë punonjësi i shërbimit të burgjeve. Këto parime janë si më poshtë:

A. Mbrojtja e dinjitetit të personave të dënuar me heqje lirie:

Neni 2 i Kodit të sjelljes: *“Në realizimin e detyrave që u ngarkon ligji, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve do të respektojnë dhe do të mbrojnë dinjitetin njerëzor, si dhe do të përkrahin respektimin e të drejtave të çdo personi të dënuar me heqje të lirisë”*. Në shoqërinë demokratike, ligji mbështetet dhe mbron vlerat themelore të shoqërisë, ndër të cilat më e rëndësishmja është respekti për dinjitetin e lindur të qenieve njerëzore. Një nga sprovat më të mëdha në respektimin e natyrës njerëzore qëndron në mënyrën si i trajton shoqëria ata që kanë shkelur apo që akuzohen se kanë shkelur ligjet penale. Këta janë persona të cilët mund të kenë treguar mungesë respekti për dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Personeli i burgjeve luan rol të veçantë në emër të pjesës tjetër të shoqërisë, në respektimin e dinjitetit të tyre, pavarësisht nga krimi që ata mund të kenë kryer.

B. Sundimi i ligjit

Punonjësi i shërbimit të burgjeve kryen detyrën si përfaqësues zyrtar i qeverisë. Në këtë mënyrë, nga ai/a jo kërkohet dhe i është besuar të punojë në bazë të ligjit. Ata kanë autorizimet dhe detyrat e ngarkuara me ligj. Neni 8 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve, në punën e tyre, duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe këto rregulla. Ata duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për t'iu kundërvënë dhe për të parandaluar shkeljen e tyre....”*

C. Paanshmëria (mosdiskriminimi)

Punonjësit e burgjeve duhet të respektojnë dhe të mbrojnë dinjitetin njerëzor e, gjithashtu, edhe të drejtat e njeriut. Ata duhet t'i kryejnë detyrat në mënyrë të paanshme, pa bërë favorizime, pa qëllime të këqija, pa marrë parasysh statusin, gjininë, bindjet fetare, bindjet politike dhe ambiciet. Të burgosurit duhet të trajtohen me mirësjellje, konsideratë dhe dinjitet të njëjtë.

Neni 4 i Rregullave të sjelljes: *“Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të lejojnë ose të kryejnë asnjë akt diskriminimi për shkak të racës, besimit fetar, origjinës, gjinisë, moshës, kulturës, kufizimeve fizike dhe prirjeve seksuale”*.

16 Miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr. 10288, datë 18.11.2015

D. Ndalimi i dhunës

Punonjësit e shërbimit të burgjeve do të duhet ta përdorin forcën vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë shkallë të cilën e kërkon kryerja e detyrave të tyre. Ata kurrë nuk duhet të guxojnë të përdorin forcën e panevojshme apo dhunën, por vetëm forcën e domosdoshme për kryerjen e detyrave të tyre, forcë kjo e cila duhet të jetë e arsyeshme në të gjitha rrethanat. Përdorimi i forcës duhet të bëhet me maturinë më të madhe dhe vetëm nëse mënyrat e tjera nuk janë efektive. Shkalla e forcës duhet të jetë proporcionale me atë të kërcënimit. Në qoftë se përdorimi i forcës në disa raste është i pashmangshëm, çdo punonjës do të përmbahet që të mos shkaktojë dhembje ose vuajtje të panevojshme dhe kurrë nuk do ta trajtojë një person në mënyrë mizore, poshtëruese ose çnjerëzore. Siç është theksuar, forca përdoret si mjet i fundit dhe vetëm për të vënë në kontroll personin e paraburgosur/të dënuar.

Neni 3 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të lejojnë, të nxitin apo të shkaktojnë akte të torturës, të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues ndaj personave të dënuar me heqje të lirisë”.*

E. Besueshmëria

Çfarëdo që punonjësi sheh, dëgjon ose mëson në lidhje me diçka që është e natyrës së besueshmërisë, duhet ta mbajë të fshehtë, përveç rasteve kur kryerja e detyrave ose ligji kërkon ndryshe. Qytetarët kanë të drejtën e sigurisë dhe jetës private dhe informacionet e mbledhura, që kanë të bëjnë me ta, nuk duhet të nxirren në shesh.

Neni 5 i Rregullave të sjelljes: *“ Për detyrat me natyrë të rezervuar, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve duhet të ruajnë sekretin, me përjashtim të rastit kur urdhërohen apo kur udhëzohen me shkrim nga autoriteti përkatës dhe kompetent, i parashikuar në ligj”.*

F. Bindja ndaj urdhrave

Punonjësit do t'u binden të gjithë urdhrave ligjorë, sikurse është përcaktuar në paketën ligjore të sistemit të burgjeve. Edhe pse punonjësi duhet t'i zbatojë urdhrat (p.sh., hierarkinë në polici), ai duhet ta ketë të qartë që zbatimi i urdhrave të dhënë nga eprorët nuk duhet përdorur për të justifikuar shkelje serioze të drejtave të njeriut. Edhe për “situatat e jashtëzakonshme”, si p.sh në gjendje lufte, këta urdhra nuk mund të përdoren si justifikim për torturë ose keqtrajtim. *Nuk ka justifikim për torturën.*

Neni 13 i Rregullave të sjelljes: *“Kur një punonjësi të sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve i kërkohet të zbatojë një urdhër apo një detyrë që është në kundërshtim të hapur me ligjin dhe normat për të drejtat e njeriut, ai nuk është i detyruar ta zbatojë atë dhe duhet të vërë në dijeni eprorin më të lartë”.*

G. Integriteti

Qytetarët kërkojnë që integriteti i punonjësit të shërbimit të burgjeve të jetë jashtë çdo kritike. Prandaj ata duhet t'u shmangen sjelljeve të cilat do të mund të komprometojnë integritetin e tyre (rrezikojnë figurën e tyre morale) dhe që mund të çojnë deri në humbjen e besimit të qytetarëve ndaj shërbimit të burgjeve. Prandaj një punonjës i sistemit të burgjeve nuk duhet të përfshihet në korrupsion ose mitmarrje, ose të mbyllë sytë kur një koleg i tij i kryen këto akte.

Punonjësit do t'i refuzojnë dhuratat, dhuratat në shenjë falënderimi, shërbimet e ndryshme, mallrat me çmim të lirë enkas për ta ose premtimet të cilat do të mund të interpretoheshin si përpjekje për ta shtyrë punonjësin që t'i shmangët kryerjes së ndershme të detyrës zyrtare të ngarkuar me ligj.

Integriteti përcakton, gjithashtu, sjelljen e punonjësve si në detyrë, ashtu edhe jashtë saj. Punonjësit duhet të sillen në mënyrë të tillë që të mos turpërojnë (diskreditojnë) shërbimin e burgjeve ose veten. Karakteri dhe sjelljet e punonjësit jashtë detyrë duhet të shërbejnë gjithmonë si shembull për të ruajtur një pozicion të respektuar në komunitetin ku ai/ajo punon. Respekti i qytetarëve nuk blihet, ai vetëm mund të fitohet dhe të kultivohet.

Neni 7 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësi i sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të kryejë akte korruptive, si dhe duhet t'u kundërvihet dhe të luftojë akte të ngjashme”.*

5. Sjellja joetike (30 minuta)

Shënim për trajnerin

Për një përmbledhje të ***sjelljes së dëshirueshme/etike përkundrejt sjelljes së padëshirueshme, joetike*** shih **MATERIALIN 3**. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve:

1. Të krahasojnë këto dy dokumente në lidhje me etikën e stafit të burgjeve dhe të moderojnë një diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet mes Kodit Evropian të Sjelljes dhe Rregullave Kombëtare Shqiptare të Sjelljes për stafin e burgjeve.

Shënim për trajnerin

Trajneri e ndan grupin në grupe të vogla dhe secili nëngrup zgjedh një formë të një sjelljeje joetike dhe diskuton natyrën e saj, duke dhënë shembuj të këtyre formave të sjelljes joetike

Format e sjelljes joetike janë:

- Ngacmimet seksuale
- Diskriminimi
- Agresioni
- Korrupsioni
- Shpërdorimi i materialeve institucionale
- Dypunësimi në konflikt me punën në burg

MATERIALI 3

Përmbledhje e sjelljeve etike dhe sjelljeve të padëshirueshme/joetike

Sjelljet Etike Parimet e përgjithshme të Rregullave të Sjelljes Kodi Evropian i Sjelljes	Sjellje e padëshirueshme	Sjellje joetike
<i>Respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor të individëve të privuar nga liria</i> (përkushtimi)	<i>Mungesë sinjoriteti</i>	<i>Ngacmimi seksual</i>
<i>Zbatimi i ligjit</i> (ndershmëria/përgjegjshmëria)	<i>Pandershmëria</i>	<i>Diskriminimi</i>
<i>Ndershmëria, paanshmëria dhe mosdiskriminimi</i> (përfshirja dhe ndershmëria)	<i>Tinëzar</i>	<i>Agresioni</i>
<i>Parandalimi i dhunës</i> (përgjegjshmëria)	<i>“Tip Roboti” Bën të fortin/garipin</i>	<i>Marrëdhënie dashurore midis të dënuarve dhe stafit</i>
<i>Konfidencialiteti</i>	<i>Mendjelehtë</i>	<i>Korrupsioni</i>
<i>Zbatimi i urdhrave</i>	<i>I paqartë/ I dyshimtë</i>	<i>Alkooli dhe droga</i>
<i>Integriteti</i>	<i>Sjellje e ftohtë Vëmendje negative</i>	<i>Keqpërdorimi i materialeve të institucionit</i>
<i>Përgjegjshmëria</i> (ndërgjegjshmëria & i motivuar)	<i>I izoluar</i>	<i>Punësim i dytë që bie në konflikt me punën në sistemin e burgjeve</i>
<i>Kujdesi dhe ndihma</i>	<i>Fshihet pas rregullave I pandryshueshëm</i>	<i>Sjellje jo profesionale</i>
<i>Bashkëpunimi</i>	<i>I pandërgjegjshëm I pamotivuar</i>	
<i>Të përgjithshme</i>	<i>Skllav i rregullave; i rreptë; i ngurtë</i>	

1. Marrja e vendimeve etike (10 minuta)

Trajneri jep një udhëzim të shkurtër për etikën para se pjesëmarrësit të fillojnë testin.

Kontributi i trajnerit

Etika ka të bëjë me zgjedhjet mes së drejtës dhe së gabuarës... të bësh gjënë e duhur. Busulla për këtë është **ndërgjegjja**. Shmangni problemet etike:

- Përmes një arsytimi të mirë
- Duke vepruar në mirëbesim
- Duke e bërë punën me ndershmëri dhe drejtësi
- Duke respektuar të drejtat e personave të tjerë
- Duke zbatuar rregullat dhe rregulloret

Rregullat **bazë** për marrjen e vendimeve etike

- Konsiderimi me seriozitet i zgjedhjeve
- Vlerësimi i vendimeve të rëndësishme
- Vendimet e mira janë etike dhe efikase
- Gjykimi dhe disiplina
- Palët e interesuara

Hapat për marrjen e vendimeve më të mira

- Ndalo dhe mendo
- Qartësimi i qëllimeve
- Përcaktimi i fakteve
- Identifikimi i mundësive
- Konsiderimi i pasojave
- Zgjedhja
- Monitorimi dhe modifikimi

Etika dhe Veprimi:

Etika ka të bëjë me vënien në veprim të parimeve. Përputhshmëria midis asaj që themi se vlerësojmë dhe asaj se çfarë tregojnë veprimet tona se vlerësojmë është çështje integriteti.

Ajo ka të bëjë me **vetëpërmbajtjen**:

- Të mos bësh atë që ke pushtet të bësh.

Një akt apo veprim nuk është i duhuri vetëm sepse lejohet apo ngaqë mund të shpëtosh pa asnjë pasojë.

- Të mos bësh atë që ke të drejtë ta bësh. Ka një ndryshim të madh midis asaj që ke të drejtë të bësh dhe asaj çfarë është e drejtë për t'u bërë.

1. Test i Vetëvlerësimit të Etikës Personale (10 minuta)

Shënim për trajnerin

Trajneri shpërndan Testin e Vetëvlerësimit të Etikës Personale (MATERIALI 4) dhe u kërkon pjesëmarrësve që të plotësojnë pyetësorin që vlerëson etikën personale ose mundësinë për të zgjedhur mes së drejtës dhe së gabuarës.

1. Dilemat (45 minuta)

Shënim për trajnerin

*Trajneri paraqet prezantimin me **gjashtë** dilemat (MATERIALI 5) dhe diskuton me grupin se cilat janë vendimet e duhura në secilën situatë dhe **pse** ai është vendimi i duhur.*

Ose organizon grupe të vogla që diskutojnë për këto dilema dhe raportojnë pikëpamjet e tyre lidhur me zgjidhjet e duhura.

*Për vendimet e duhura në secilin rast: **Shih MATERIALIN 6.***

Një nga kolegët e mi fillon të mbledhë pjesëmarrës për një lloj skeme piramidale. Jo vetëm që fut në skemën e tij kolegë, por edhe të dënuar. Mesa duket, disa nga kolegët e tjerë kanë bërë shumë para në këtë mënyrë. Çfarë bëj?

1. I kërkoj t'i japë fund menjëherë këtyre aktiviteteve dhe paralajmëroj kolegët e mi.
2. Nuk bëj gjë por, sapo të dëgjoj ankesa do ta ngre çështjen tek kreu i departamentit tim.
3. I kërkoj këtij kolegu të vijë në zyrën time dhe i theksoj se aktivitetet e tij të mos përfshijnë edhe të burgosurit.
4. Ia bëj të ditur problemin përgjegjësit të sektorit. Ai është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme.

Mbyllja

Shtojca

MATERIALI 1

Parimet e përgjithshme të Rregullave të Sjelljes

A. Mbrojtja e dinjitetit të personave të dënuar me heqje lirie:

Neni 2 i Kodit të sjelljes: *“Në realizimin e detyrave që u ngarkon ligji, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve do të respektojnë dhe do të mbrojnë dinjitetin njerëzor, si dhe do të përkrahin respektimin e të drejtave të çdo personi të dënuar me heqje të lirisë”. Në shoqërinë demokratike, ligji mbështetet dhe mbron vlerat themelore të shoqërisë, ndër të cilat më e rëndësishmja është respekti për dinjitetin e lindur të qenieve njerëzore. Një nga sprovat më të mëdha në respektimin e natyrës njerëzore qëndron në mënyrën si i trajton shoqëria ata që kanë shkelur apo që akuzohen se kanë shkelur ligjet penale. Këta janë persona të cilët mund të kenë treguar mungesë respekti për dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Personeli i burgjeve luan rol të veçantë në emër të pjesës tjetër të shoqërisë, në respektimin e dinjitetit të tyre, pavarësisht nga krimi që ata mund të kenë kryer.*

B. Sundimi i ligjit

Punonjësi i shërbimit të burgjeve kryen detyrën si përfaqësues zyrtar i qeverisë. Në këtë mënyrë, nga ai/ajo kërkohet dhe i është besuar të punojë në bazë të ligjit. Ata kanë autorizimet dhe detyrat e ngarkuara me ligj. Neni 8 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve, në punën e tyre, duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe këto rregulla. Ata duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për t’iu kundërvënë dhe për të parandaluar shkeljen e tyre....”*

C. Paanshmëria (mosdiskriminimi)

Punonjësit e burgjeve duhet të respektojnë dhe të mbrojnë dinjitetin njerëzor e gjithashtu, edhe të drejtat e njeriut. Ata duhet t'i kryejnë detyrat në mënyrë të paanshme, pa bërë favorizime, pa qëllime të këqija, pa marrë parasysh statusin, gjininë, bindjet fetare, bindjet politike dhe ambiciet. Të burgosurit duhet të trajtohen me mirësjellje, konsideratë dhe dinjitet të njëjtë.

Neni 4 i Rregullave të sjelljes: *“Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të lejojnë ose të kryejnë asnjë akt diskriminimi për shkak të racës, besimit fetar, origjinës, gjinisë, moshës, kulturës, kufizimeve fizike dhe prirjeve seksuale”.*

D. Ndalimi i dhunës

Punonjësit e shërbimit të burgjeve do të guxojnë ta përdorin forcën vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë shkallë të cilën e kërkon kryerja e detyrave të tyre. Ata kurrë nuk duhet të guxojnë të përdorin forcën e panevojshme apo dhunën, por vetëm forcën e domosdoshme për kryerjen e detyrave të tyre, forcë kjo e cila duhet të jetë e arsyeshme në të gjitha rrethanat. Përdorimi i forcës duhet të bëhet me maturinë më të madhe dhe vetëm nëse mënyrat e tjera janë pa rezultat. Shkalla e forcës duhet të jetë proporcionale me atë të kërcënimit. Në qoftë se përdorimi i forcës në disa raste është i pashmangshëm, çdo punonjës do të përmbahet që të mos shkaktojë dhembje ose vuajtje të panevojshme dhe kurrë nuk do ta trajtojë një person në mënyrë mizore, poshtëruese ose jonjerëzore. Siç është theksuar, forca përdoret si mjet i fundit dhe vetëm për të vënë në kontroll personin e paraburgosur/të dënuar.

Neni 3 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të lejojnë, të nxitin apo të shkaktojnë akte të torturës, të trajtimit jonjerëzor apo poshtërues ndaj personave të dënuar me heqje të lirisë”.*

E. Besueshmëria

Çfarëdo që punonjësi sheh, dëgjon ose mëson në lidhje me diçka që është e natyrës së besueshmërisë, duhet ta mbajë të fshehtë, përveç rasteve kur kryerja e detyrave ose ligji kërkon ndryshe. Qytetarët kanë të drejtën e sigurisë dhe jetës private dhe informatat e mbledhura, që kanë të bëjnë me ta, nuk duhet të nxirren në shesh.

Neni 5 i Rregullave të sjelljes: *“Për detyrat me natyrë të rezervuar, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve duhet të ruajnë sekretin, me përjashtim të rastit kur urdhërohen apo kur udhëzohen me shkrim nga autoriteti përkatës dhe kompetent, i parashikuar në ligj”.*

F. Bindja ndaj urdhrave

Punonjësit do t'u binden të gjithë urdhrave ligjorë, sikurse është përcaktuar në paketën ligjore të sistemit të burgjeve. Edhe pse punonjësi duhet t'i zbatojë urdhrat (p.sh., hierarkinë në polici), ai duhet ta ketë të qartë që zbatimi i urdhrave të dhënë nga eprorët nuk duhet përdorur për të justifikuar shkelje serioze të drejtave të njeriut. Edhe për “situatat e jashtëzakonshme”, si p.sh në gjendje lufte, këta urdhra nuk mund të përdoren si justifikim për torturë ose keqtrajtim. *Nuk ka justifikim për torturën.*

Neni 13 i Rregullave të sjelljes: *“Kur një punonjësi të sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve i kërkohet të zbatojë një urdhër apo një detyrë që është në kundërshtim të hapur me ligjin dhe normat për të drejtat e njeriut, ai nuk është i detyruar ta zbatojë atë dhe duhet të vërë në dijeni eprorin më të lartë”.*

G. Integriteti

Qytetarët kërkojnë që integriteti i punonjësit të shërbimit të burgjeve të jetë jashtë çdo kritike. Prandaj ata duhet t'u shmangen sjelljeve të cilat do të mund të komprometojnë integritetin e tyre (rrezikojnë figurën e tyre morale) dhe që mund të çojnë deri në humbjen e besimit të qytetarëve ndaj shërbimit të burgjeve. Prandaj një punonjës i sistemit të burgjeve nuk duhet të përfshihet në korrupsion ose mitmarrje, ose të mbyllë sytë kur një koleg i tij i kryen këto akte.

Punonjësit do t'i refuzojnë dhuratat, dhuratat në shenjë falënderimi, shërbimet e ndryshme, mallrat me çmim të lirë enkas për ta ose premtimet të cilat do të mund të interpretoheshin si përpjekje për ta shtyrë punonjësin që t'i shmangët kryerjes së ndershme të detyrës zyrtare të ngarkuar me ligj.

Integriteti përcakton, gjithashtu, sjelljen e punonjësve si në detyrë, ashtu edhe jashtë saj. Punonjësit duhet të sillen në mënyrë të tillë që të mos turpërojnë (diskreditojnë) shërbimin e burgjeve ose veten. Karakteri dhe sjelljet e punonjësit jashtë detyre duhet të shërbejnë gjithmonë si shembull për të ruajtur një pozicion të respektuar në komunitetin ku ai/ajo punon. Respekti i qytetarëve nuk blihet, ai vetëm mund të fitohet dhe të kultivohet.

Neni 7 i Rregullave të sjelljes: *“Punonjësi i sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të kryejë akte korruptive si dhe duhet t'u kundërvihet dhe të luftojë akte të ngjashme”.*

MATERIALI 2

Rekomandimi CM/Rec (2012)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Kodin Evropian të Etikës për Stafin e Burgjeve:

Përgjegjshmëri: do të thotë që pranon përgjegjësinë personale për veprimet apo mosveprimet dhe pasojat e tyre, si dhe kryen çdo here paraprakisht verifikime për ligjshmërinë e veprimeve që do të ndërmarrësh.

Integriteti: i referohet vendosjes së standardeve të larta për dinjitetin personal, përpjekje për ruajtjen e marrëdhënieve personale pozitive me të burgosurit, shmangie e konfliktit të interesit midis pozicionit dhe interesave private, financiare apo interesave të tjera, kundërshtimi, luftimi dhe kundërvënja ndaj të gjitha formave të korrupsionit, zbatimi i të gjitha udhëzimeve ligjore, si dhe moszbatimi i udhëzimeve që bien në kundërshtim me ligjin.

Respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor: nënkupton respektimin e të drejtës së çdo personi për jetën dhe të drejtën për privatësi, mbrojtjen e integritetit fizik, psikologjik dhe seksual të gjithë të burgosurve, përpjekjet për të mos shkaktuar, nxitur apo toleruar torturën apo trajtime apo dënime të tjera çnjerëzore, trajtimi i cilitdo me respekt dhe mirësjellje, etj.

Kujdesi dhe ndihma: nënkuptojnë lehtësimin e ri-integrimit social të burgosurve përmes programeve të aktiviteteve konstruktive, ndërveprimeve individuale dhe ndihmëse. Kjo do të thotë gjithashtu që të jesh i ndjeshëm ndaj nevojave të veçanta të individëve, si p.sh. të burgosurve të mitur, të burgosurave gra, pakicave, shtetasve të huaj, të moshuarve dhe të burgosurve me aftësi të kufizuara, si dhe nevojave të çdo të burgosuri që mund të jetë vulnerabël për arsye të tjera dhe ndërmarrja e të gjitha përpjekjeve të mundshme për plotësimin e nevojave të tyre.

Ndershmëria, paanshmëria dhe mosdiskriminimi: nënkuptojnë respektimin e pluralizmit dhe diversitetit dhe mosdiskriminimin e asnjë të burgosuri për shkak të seksit, moshës, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, opinioneve politike apo opinioneve të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, përkatësisë në një minoritet kombëtar, statusit të pronave, statusit në lindje apo çdo statusi tjetër dhe as për arsye të veprës penale për të cilin është akuzuar apo që e ka kryer një i burgosur. Kjo nënkupton gjithashtu kryerjen e detyrave me ndershmëri, objektivitet dhe qëndrueshmëri, si dhe respektimin e prezumimit të pafajësisë së të burgosurve që nuk janë dënuar me vendim gjykatë, etj.

Bashkëpunimi: nënkupton marrjen e masave që të burgosurit të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të pasur akses sistematik dhe të mjaftueshëm tek avokati dhe familjarët gjatë gjithë kohës së qëndrimit në burg, si dhe lehtësimin e bashkëpunimit me organet qeveritare apo joqeveritare dhe me grupet e komunitetit që punojnë për mirëqenien e të burgosurve.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave: nënkupton që informacionet me natyrë konfidenciale që zotëron stafi i burgjeve duhet të mbahen konfidenciale, me përjashtim të rasteve kur kryerja e detyrës apo nevojat e drejtësisë kërkojnë reptësisht të kundërtën.

Të përgjithshme: kjo do të thotë se stafi i burgjeve duhet të respektojë këtë kod. Ata duhet gjithashtu që, me aftësitë e tyre më të mira, të parandalojnë dhe të kundërshtojnë në mënyrë rigoroze çdo shkelje të këtij kodi. Punonjësit e burgjeve që kanë arsye të besojnë se ka ndodhur apo pritet të ndodhë një shkelje e këtij kodi duhet ta raportojnë këtë çështje te autoritetet eprore dhe, sipas rastit, tek strukturat e tjera përkatëse.

MATERIALI 3

Përmbledhje e sjelljeve etike dhe sjelljeve të padëshirueshme/joetike

Sjelljet Etike Parimet e përgjithshme të Rregullave të Sjelljes Kodi Evropian i Sjelljes	Sjellje e padëshirueshme	Sjellje joetike
Respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor të individëve të privuar nga liria (përkushtimi)	Mungesë sinqeriteti	Ngacmimi seksual
Zbatimi i ligjit (ndershmëria/ përgjegjshmëria)	Pandershmëria	Diskriminimi
Ndershmëria, paanshmëria dhe mosdiskriminimi (përfshirja dhe ndershmëria)	Tinëzar	Agresioni
Parandalimi i dhunës (përgjegjshmëria)	“Tip Roboti” Bën të fortin/garipin	Marrëdhënie dashurore midis të dënuarve dhe stafit
Konfidencialiteti	Mendjelehtë	Korrupsioni
Zbatimi i urdhrave	I paqartë/ I dyshimtë	Alkooli dhe droga
Integriteti	Sjellje e ftohtë Vëmendje negative	Keqpërdorimi i materialeve të institucionit
Përgjegjshmëria (ndërgjegjshmëria & i motivuar)	I izoluar	Punësim i dytë që bie në konflikt me punën në sistemin e burgjeve
Kujdesi dhe ndihma	Fshihet pas rregullave I pandryshueshëm	Sjellje jo profesionale
Bashkëpunimi	I pandërgjegjshëm I pamotivuar	
Të përgjithshme	Skllav i rregullave; i rreptë; i ngurtë	

MATERIALI 4

Testi i Vetëvlerësimit të Etikës Personale

Përgjigjet duhet të jepen në bazë të pyetësorit vijues:

1 = Nuk pajtohem asnjëherë

2 = Deri diku nuk pajtohem

3 = Barabartë, pajtohem dhe nuk pajtohem (neutral)

4 = Pajtohem deri diku

5 = Pajtohem plotësisht

PYETJET	1	2	3	4	5
Nuk është gabim për punonjësën nëse merr dhurata të vogla nga familjarët e të dënuarve?					
A duhet të përdorë punonjësi i burgut ndonjëherë masa të ndaluara për të bërë zbatimin e ligjit apo për të mbajtur rregullin në burg?					
Unë nuk do të ndërmerrja masa nëse do të dija për sjellje të këqija të ndonjë kolegu nëse ai do të ishte shoku im.					
Familjarët e të dënuarve të cilët kanë dyqane u bëjnë ulje çmimesh apo u japin gjëra falas punonjësve të burgjeve, për shërbimin që ata bëjnë ndaj fëmijëve të tyre të dënuar.					
Punonjësi i burgut nuk mund të jetë vazhdimisht efikas nëse, kohë pas kohe, nuk i thuhet rregullat apo ndonjëherë nuk u shmanget atyre.					
Unë ndoshta do të kisha përdorur masat e ndaluara ndaj të dënuarve problematikë dhe agresorë për të siguruar rendin.					
Përderisa nuk është çështje jashtëzakonisht serioze, punonjësit duhet ta mbrojnë njëri-tjetrin kur ekzistojnë akuzat për sjellje të keqe.					
Ndonjëherë është e nevojshme që me fjalë të jeni mosrespektues apo keqtrajtes ndaj ndonjë personi për arsye se kjo është e vetmja mënyrë që ata të kuptojnë apo të binden.					
"Mirësjellja profesionale", arsyetimi i punonjësit të burgut për shkelje të vogla të rregullores është në rregull.					
Unë njoh një numër të madh punonjësish të burgjeve që kanë thyer apo i janë shmangur ligjit për ta zbatuar atë.					
Shumica e eprorëve pajtohen me faktin se rregullat duhet të thuhet apo t'u shmanget për të përfunduar punët, por nuk dëshirojnë ta pranojnë këtë.					
Zmadhimi i shkakut të mundshëm për ta bërë një kontroll intim, është i drejtë.					
Ndonjëherë është e domosdoshme për punonjësën që të gënjehet në komisionin disiplinor apo në raport në mënyrë që të sigurojë dënimin e personit.					
Përderisa duket se rregullat po zbatohen, çdo gjë që bëhet për të garantuar sigurinë, është e drejtë.					
Unë do të kisha gënjer për të ruajtur vendin tim të punës.					
Jeta ime personale më përket vetëm mua dhe eprorët e mi nuk mund të thonë asgjë lidhur me atë se çka bëj unë kur jam jashtë orarit të punës.					
Kujdesi për punët personale derisa jeni në punë zakonisht është i drejtë.					
Në përgjithësi, nuk është gabim për punonjësën e burgjeve të pranojë sende apo ushqim falas apo me çmim të ulët nga biznesmenët, të cilët kanë fëmijët e tyre në burg.					
Disa të dënuar duhet të marrin përgjigjen e merituar nga grupi i sigurisë nëse lëndojnë fizikisht kolegët tanë.					
Unë do të kisha gënjer për të ruajtur vendin e punës së ndonjë kolegu tjetër, nëse ai ose ajo ka qenë shoku/shoqja ime.					

MATERIALI 5

DILEMAT

DILEMA 1

Një koleg nuk është shumë i rreptë sa i përket zbatimit të rregullave për mbylljen e të burgosurve në qeli në kohën e duhur. Ai thotë: “Epo, të shkojë si të shkojë” ...

Çfarë bëni ju?

DILEMA 2

Një koleg që punon me ju në burg ju thotë se fundjavën e ardhshme do të punojë si polic privat sigurie në një festival të madh vallëzimi.

Çfarë bëni ju?

Nuk doni që t’i tregoni shefit.

DILEMA 3

Një punonjës i burgut rrihet nga një i burgosur. Kur kolegët e tij e transferojnë këtë të burgosur në qelinë e izolimit, ata e shtyjnë fort për nga muri, e pengojnë dhe e qëllojnë me shqelma kur ai bie në dysheme.

Ju, si koleg, e shihni këtë skenë.

Çfarë bëni ju?

DILEMA 4

Keni pirë shumë, por gjithsesi vendosni të shkoni në shtëpi me makinën tuaj. Shkaktoni një aksident. Policia ka bërë një raportim zyrtar dhe gjykata ju ka vënë gjobë.

Çfarë duhet të bëni si polic burgu?

DILEMA 5

Një koleg i ri nuk pëlqehet shumë nga grupi me të cilën ju punoni.

Në dhomën e kontrollit, shikoni një koleg, dikush që e ke mik, që pyet kolegët e tjerë, përveç kolegut të ri, nëse duan kafe....

Si reagoni?

DILEMA 6

Një prej kolegëve tuaj fillon t'u flasë të tjerëve për një lloj loje të ngjashme me skemat piramidale. Ai përfshin në këtë skemë jo vetëm kolegët, por edhe disa të dënuar. Me sa duket, disa kolegë të tjerë kanë bërë shumë para në këtë mënyrë.

Çfarë duhet të bëni?

MATERIALI 6

Vendimet dhe zgjidhjet e dilemave

Dilema 1

- Diskutojeni këtë çështje me një koleg dhe me ekipin tuaj.
- Merrni masat që procedurat të jenë të qarta dhe të njohura.
- Profesionalizmi është edhe çështje e logjikës bazë.
- Promovoni një kulturë, ku këto probleme janë të hapura për diskutim.
- Kini parasysh se edhe vetë siguria juaj varet nga profesionalizmi i kolegëve tuaj.

Dilema 2

- Pyesni një koleg nëse e di nëse ky lloj dypunësimi duhet raportuar gjithmonë tek eprori përgjegjës për grupin/sektorin tuaj.
- Sillni në vëmendje pasojat e mosraportimit të një pune të dytë.
- Paraqiteni këtë çështje tek këshilltari juridik i burgut.

Dilema 3

- Kujtojeni menjëherë kolegët se me këtë sjellje po shkelin rregullat për trajtimin e kësaj situate.
- Përpiquni ta vlerësoni këtë incident.
- Paraqiteni këtë çështje tek këshilltari juridik i burgut.
- Flisni për vëzhgimet tuaja në këtë rast me eprorin përgjegjës për sektorin/drejtorinë tuaj.

Dilema 4

- Përpiquni të kuptoni se në cilat raste jeni të detyruar të raportoni tek eprori.
- Ju duhet të besoni se shefi i sektorit tuaj do ta trajtojë çështjen në mënyrë konfidenciale.

Dilema 5

- Krijoni një shembull të mirë dhe ofrojeni kolegut të ri një filxhan kafe.
- Kini parasysh se ndaj kujt duhet të jeni besnik: ndaj kolegëve tuaj/miqve tuaj më të mirë apo ndaj kolegut tuaj të ri?
- Kushtojini vëmendje kolegut tuaj të ri.
- Diskutojeni këtë situatë me kolegun tuaj/mikun më të mirë që e anashkaloi këtë koleg të ri.
- Ngrijeni këtë çështje me shefin e sektorit.

Dilema 5

- Kërkojini që ta ndërpresë menjëherë këtë aktivitet.
- Paralajmërojeni kolegët.
- Ngrijeni çështjen me shefin e sektorit. Ai ka përgjegjësinë e marrjes së masave të nevojshme.

Moduli 5: Komunikimi (4 orë)

Objektivat: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të jenë në gjendje të përkufizojnë komunikimin;
- do të kuptojnë rolin thelbësor të komunikimit midis punonjësve që kanë kontakt direkt me të burgosurit dhe kolegëve;
- do të jenë në gjendje të analizojnë proceset e komunikimit dhe komponentët e karakteristikat e tyre bazë;
- do të familjarizohen me aftësitë e komunikimit të mirë e jo të mirë;
- do të praktikojnë aftësitë e komunikimit efektiv, duke përfshirë aftësitë e të dëgjuarit aktiv;
- do të mësojnë etikën e komunikimit profesional me kolegët, eprorët, publikun dhe autoritetet;
- do të mësojnë elementet bazë të strukturës së komunikimit dhe rregullat e tij në burgje.

1. Hyrje (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në këtë modul do të trajtojmë komunikimin në burgje. Së pari, fillojmë me një reflektim mbi karakterin dhe elementet e komunikimit.

Më pas, do të mësoni për aftësitë e komunikimit, rolet e stafit të burgut në komunikim, barrierat e komunikimit që ndeshin më shpesh punonjësit e zbatimit të ligjit, si dhe teknikat për kapërcimin e tyre. Në fund, do ta mbyllim me temën e strukturës së komunikimit në burg.

Shënim për trajnerin

*Trajneri e fillon seminarin duke iu bërë pjesëmarrësve disa **pyetje** që lidhen me komunikimin*

Ushtrim

Pyetje

- A ju pëlqen të komunikoni me njerëz të tjerë?
- A është e rëndësishme mënyra se si njerëzit na thonë diçka dhe mënyra si duken ata para nesh? Apo rëndësi ka vetëm përmbajtja dhe ajo çfarë ata thonë?
- A reflektoni mbi mënyrën se si ndikojnë fjalët e tua tek të tjerët? Toni, pamja, qëndrimi juaj?

Shënim për trajnerin

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të zgjedhin ngjitëset me ngjyra dhe me fjalët e tyre të shkruajnë se çfarë do të thotë komunikimi për ata.

Ngjitëset vendosen në tabelë ku vizatohen dy degë, në varësi të përkufizimit që i jepet komunikimit, pra nëse përmendet vetëm komunikimi verbal (i foluri) apo edhe ai joverbal.

Kontributi i trajnerit

Njerëzit mund të mendojnë se komunikimi ka të bëjë vetëm me të folurën. Ndonëse e folura është një prej komponentëve të komunikimit, me sa duket nuk është më e rëndësishmja. Komponentët e tjerë të komunikimit janë: dëgjimi, gjuha e trupit, leximi, shkrimi, dërgimi i mesazheve, dërgimi i emaileve, Facebook etj.

Shënim për trajnerin

Ju lutemi, kërkojini pjesëmarrësve të bëjnë një përkufizim të komunikimit. Pjesëmarrësit mund ta bëjnë këtë në grupe ose në mënyrë të pavarur.

Përkufizimi i komunikimit shkruhet në tabelë.

PËRKUFIZIMI i KOMUNIKIMIT është procesi i shkëmbimit të mesazheve (verbale dhe joverbale) mes dy ose më shumë personash, në mënyrë të tillë që personi tjetër e kupton atë që po thoni, dhe ka qëllimin e objektivin e tij.

Shënim për trajnerin

Ushtrim dhe pyetje: pse komunikimi profesional është kaq i rëndësishëm për një punonjës burgu?

Ky ushtrim bëhet në grupe dyshe:

*Secila dyshe merr pak kohë dhe mendon e reflekton mbi: **arsyet pse komunikimi profesional është kaq i rëndësishëm për një punonjës burgu?***

Secili grup bën një prezantim të shkurtër të rezultateve.

Pas prezantimeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Punonjësit e burgjeve duhet të kenë *aftësi komunikimi në nivel profesional*, pasi thelbi i profesionit të tyre si zbatues ligji është puna dhe komunikimi me njerëzit. Ju keni pajisje të tilla si armë zjarri dhe elektrike dore që ju ndihmojnë dhe keni mundësi të ushtroni forcë në situata të caktuara, por këto nuk janë fokusi i punës tuaj: **fokusi i punës janë njerëzit**. Puna juaj varet drejtpërdrejtë tek aftësia që keni për të komunikuar në mënyrë efektive me të burgosurit dhe me kolegët tuaj. Më qëllim që t'ia dilni mbanë, duhet të zhvilloni aftësitë e komunikimit profesional.

Komunikimi rrit në mënyrë profesionale sigurinë e punës tuaj si punonjës burgu pasi ul gjasat e konfrontimeve fizike apo të mungesës së sigurisë. Ai rrit shanset për ndërveprime pozitive dhe bashkëpunuese, si dhe nivelin e kënaqësisë në punë. Si komunikues i mirë, ju jeni më efektivë në fitimin e bashkëpunimit, besimit, mbështetjes nga të burgosurit dhe nënkulturën e tyre në burg. Më specifikisht, punonjësit e burgjeve që janë komunikues të mirë, kanë më shumë aftësi t'i transformojnë përballjet e përditshme me të burgosurit në marrëdhënie më shumë mbështetëse, më pak armiqësore e më të sigurta, të cilat i motivojnë të burgosurit t'i zbatojnë vullnetarisht rregullat dhe të transformojnë jetët e tyre.

Pra, sa më i qartë të jetë mesazhi i punonjësit, aq më pak ka keqinterpretime të qëllimeve të tij nga të tjerët. **Interesante është se mënyra se si thuhet diçka mund të bëhet më e rëndësishme se sa vetë fjalët.** Shumica e agjencive konstatojnë se pjesa më e madhe e ankesave të qytetarëve dhe e të burgosurve kanë të bëjnë me punonjësit që perceptoheshin si të vrazhdë ose autoritarë. Ka shumë pak të

ngjarë që të adresohen ankesa për një komunikues të aftë dhe nga ana tjetër ai/ajo është në gjendje të përfaqësojë pozitivisht institucionin e tij ose të saj. Për më tepër, komunikuesit e aftë shkruajnë raporte më të qarta dhe më të sakta duke evituar ribërjen e punës.


2. Komunikimi dhe elementët bazë të tij (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Punonjësit e zbatimit të ligjit dhe ato të burgjeve kalojnë një pjesë të konsiderueshme të punës së tyre duke komunikuar në një mënyrë apo në një tjetër. Ndonjëherë komunikimi është verbal dhe herë të tjera është jo verbal. Komunikimi mund të jetë me gojë, i shkruar ose jo verbal.

Pavarësisht formës që merr, komunikimi është proces që përfshin **katër elemente bazë**:

Trajneri tregon faqen e prezantimit



Një mënyrë tjetër për ta parë procesin është nga njëra anë dërguesi që e kodon mesazhin (me fjalë të thëna ose të shkruara ose me gjeste e me gjuhën e trupit) dhe nga ana tjetër marrësi që e çkodon atë. Qëllimi është që mesazhi i koduar apo i dërguar *të përputhet* saktësisht me mesazhin që çkodohet apo merret. Për arritjen e këtij qëllimi nevojiten aftësi të mira komunikimi në procesin bazë të komunikimit, i cili përfshin katër hapa:

- Mesazhi duhet të përcillet
- Mesazhi duhet të merret
- Duhet të ketë një përgjigje
- Mesazhi duhet të kuptohet

Shpesh mesazhi që dërguesi dëshiron të përcjellë NUK është mesazhi që kuptohet nga marrësi.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit të diskutojë rreth faktit se PSE mesazhi që dërguesi dëshiron të përcjellë, shpesh nuk është ai mesazh që kuptohet?

Trajneri përmbledh me:

Kontributi i trajnerit

Sa herë që një person fillon të flasë (dërguesi), mesazhi ndikohet nga besimet,

qëndrimet dhe njohuritë e folësit. Të njëjtët faktorë ndikojnë mënyrën në të cilën marrësi interpreton mesazhin. Përveç kësaj, mesazhet mund të deformohen nga toni i zërit të folësit, zgjedhja e fjalëve, gjendja fizike, ndjenjat personale ndaj marrësit dhe ambienti ose koha e ditës. Këta janë faktorë deformues për dërguesin. Në skajin tjetër të transmetimit është një grup faktorësh deformues që ndikojnë në mënyrën e marrjes së mesazhit. Këto përfshijnë nivelin e interesit, ndjenjat personale ndaj dërguesit, gjendjen fizike dhe kërkesat në kohë.

Shënim për trajnerin

*Ushtrim dyshe-dyshe me teknikën e ushtrimit me role: ushtrimi bëhet nga secili grup dhe një **dërgues/folës** tregon një histori të shkurtër (tema e mundshme: si kaluat në fundjavë, pushime, sportet, kafshët shtëpiake etj....). për një **marrës/dëgjues**, i cili tregon aftësi jo të mira komunikimi (dëgjimi).*

Roli i marrësit:

- Nuk krijon **Asnjë** kontakt me sy me dërguesin;
- E drejton trupin e tij/saj pak larg dërguesit;
- I papërqendruar dhe i painteresuar;
- Mungon **tundja** pohuese e kokës si formë pozitive e **komunikimit joverbal**;
- Kur dërguesi ndalon, marrësi hesht, harron të bëjë pyetje dhe nuk shpreh asgjë.

Pas përfundimit të këtij ushtrimi, bëni një diskutim të përgjithshëm mbi atë që vërejtën pjesëmarrësit. Përdorni pyetjet e mëposhtme për të udhëzuar diskutimin:

- Çfarë mësuat rreth këtij stili jo të mirë komunikimi?

Kontributi i trajnerit

Më poshtë, paraqiten karakteristikat e aftësive jo të mira të komunikimit.

Aftësi jo të mira të komunikimit përfshijnë:

- Tonin e acaruar dhe kundërshtues,
- Ndërprerjen e folësit,
- Mungesën e kontaktit me sy/rrotullimin e syve,
- Stilin dhe tonin sarkastik,
- Gjuhë jo të mirë të trupit (qëndrimin e pakujdesshëm, shtrëngimi i duarve)
- Mungesa e qartësisë në shprehjen e qëndrimit/opinionit.

Duke praktikuar aftësitë e të folurit e të dëgjuarit të mirë, njerëzit do të jenë në gjendje të komunikojnë më saktë dhe më mirë me njëri-tjetrin.

Komunikimi mund të përmirësohet me përvetësimin e strategjive për reduktimin ose eliminimin e deformimit. Strategjitë përfshijnë aftësi të tilla si komunikimi në mënyrë të qartë, përdorimi i gjuhës së thjeshtë në të folur, përdorimi i elementeve verbale dhe joverbale të komunikimit dhe aftësitë e të dëgjuarit aktiv duke përdorur si pyetjet e hapura, ashtu edhe ato të mbyllura për të ndihmuar në qartësimin e kuptimit, mbështetja në kanale të shumta komunikimi për verifikimin e mesazhit dhe të kuptimit të tij, ofrimi i informacionit të kufizuar për zvogëlimin e konfuzionit dhe perifraximi i asaj çka është thënë për të garantuar kuptimin.

3. Aftësitë e komunikimit efektiv (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Procesi bazë i komunikimit dhe aftësitë bazë të komunikimit përbëjnë themelin e aftësive të komunikimit specifik për detyrat e punonjësve të sistemit të drejtësisë penale.

A. Rëndësia e komunikimit të qartë

Për të **komunikuar në mënyrë të qartë**, duhet të ndaleni një moment dhe të mendoni se çfarë doni të thoni dhe pse. Shpesh njerëzit flasin ose shkruajnë pa pushim sepse mendojnë se duke thënë më shumë, me siguri do t'i mbulojnë të gjitha pikat. Megjithatë, shpesh, kjo i ngatërron njerëzit me të cilët ata flasin. Për planifikimin e komunikimit tuaj, merrni parasysh katër faktorë:

- **PSE dhe SI (qëllimi dhe mënyra)?** Kuptoni objektivin tuaj: Pse po komunikoni? Si do ta dërgoni mesazhin tuaj? Për shembull: personalisht, në telefon, në takime, me emaille, përballë etj.
- **INFORMACIONI (kompleksiteti)?** Planifikoni atë çka dëshironi të thoni. Çfarë informacioni duhet të komunikohet? Për shembull: oraret e takimit, informacioni buxhetor, incidentet, informacion konfidencial etj.
- **KUSH? (konteksti i komunikimit)** Kuptoni audiencën tuaj. Me kë po komunikoni? Çfarë duhet të dinë ata?
- **RREZIKU I MOSKOMUNIKIMIT?** Cilat janë pasojat e moskomunikimit? Për shembull: rrezik i ulët, humbje e mundshme parash apo rrezik “jetë a vdekje”.

Shënim për trajnerin

Lexoni skenarin e mëposhtëm dhe diskutoni se si duhet ta komunikoni mesazhin duke përdorur katër faktorët e mësipërm.

Pjesëmarrësit, të ndarë në grupe, lexojnë skenarin e materialit dhe vendosin mbi mënyrën se si do të jepet mesazhi duke përdorur katër faktorët e rëndësishëm të komunikimit të mesazhit.

Ushtrim: Skenari (MATERIALI 1)

Skenari

Zelda është oficere burgu. Ajo është në dhomën e kontrollit të sektorit të burgut. Ngre telefonin. Në telefon është kolegu i saj i recepsionit, i cili e lidh Zeldën me avokatin e të burgosurit Leo. Në këtë moment, Leo punon në departamentin e punës së burgut. Avokati i thotë Zeldës se gjendja e babait të sëmurë të Leos është përkeqësuar papritur dhe doktorët thonë se nuk i ka mbetur edhe shumë kohë për të jetuar. Avokati i Leos thotë se duhet të paraqesë menjëherë një kërkesë pranë drejtorit të burgut për leje specifike që Leo të mund të vizitojë babain e tij që po vdes.

Diskutoni:

1. Qëllimi dhe mënyra: Si duhet ta komunikojë Zelda këtë informacion?
2. Kompleksiteti i informacionit: Çfarë informacioni duhet të jepet?
3. Konteksti i komunikimi: Kujt duhet t'i komunikojë ajo këtë informacion?
4. Rreziku u moskomunikimit: Çfarë mund të ndodhë nëse ajo nuk arrin ta komunikojë informacionin siç duhet?

B. Elementet verbale, joverbale, përputhshmëria dhe mjedisi

Kontributi i trajnerit

Komunikimi kryhet përmes kombinimit të **dërguesit** të mesazhit, pra personit që flet apo shkruan **mesazhin** me përmbajtjen e asaj çka thuhet, **një mjedis** me një ton të caktuar dhe **marrësit** të mesazhit, i cili është personi që dëgjon.

Mënyra e kombinimit të dërguesit, mesazhit, mjedisit dhe marrësit përcakton suksesin (ose mungesën e suksesit) të çfarëdolloj situatë komunikimi verbal.

Mesazhi i dhënë verbalisht një personi tjetër përmban dy komponentë bazë: **verbal dhe joverbal**. Përmbajtja verbale është ajo çfarë thoni; kuptimi faktik i fjalëve. Përmbajtja joverbale përfshin elementet e tjera që e përcjellin informacionin te marrësi.

Shënim për trajnerin

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të japin shembuj të këtyre elementeve joverbale.

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh:

Elementet joverbale përfshijnë:

- Zërin, duke përfshirë tonin e zërit, ritmin, lartësinë e zërit dhe modulimin.
- (intonacioni mund të shprehë frikë, autoritet apo empati);
- Shprehja e fytyrës, kontakti me sy, qëndrimi;
- Qëndrimi i trupit dhe lëvizja e tij;
- Gjestet, pra lëvizja e duarve dhe krahëve, duke përfshirë të treguarin e tjetrit me gisht;
- Distanca fizike nga subjekti/marrësi.

Shënim për trajnerin

Kuiz: trajneri pyet se sa për qind e komunikimit ka të bëjë me fjalët që flisni? Sa për qind ka të bëjë me komunikimin joverbal? Sa për qind është larmia e vokalit?

Përgjigjet: Fjalët 7%, komunikimi joverbal 55% dhe larmia vokale 38%.

Cilado qoftë situata, eksperiencia kryesore e audiencës do të bazohet më shumë tek MËNYRA e paraqitjes së informacionit, sesa informacioni që thuhet.

Kontributi i trajnerit

Elementet joverbale përcjellin qëndrimin dhe emocionin e dërguesit dhe të mesazhit te marrësi. Këto elemente gjenden në çdo situatë komunikimi, pavarësisht nëse dërguesi dhe marrësi janë ose jo të vetëdijshëm për to.

Komunikimi është efektiv kur mesazhi që *merret* është i njëjtë me mesazhin që

dërgohet. Me fjalë të tjera, çfarëdo që dërguesi dëshironte të thoshte, përcillet te marrësi pa u shtrembëruar. Kjo njihet si *përputhshmëri*. Në mënyrë që komunikimi të jetë efektiv dhe pozitiv, përmbajtja joverbale duhet të jetë në harmoni me përmbajtjen verbale. *Ajo çka thoni* duhet të përputhet me *mënyrën* si e thoni atë.

Mjedisi i referohet tonit dhe “mjedisit” të situatës së komunikimit. Në një situatë komunikimi, si dërguesi, ashtu edhe marrësi kanë role dhe përgjegjësi për krijimin e atmosferës së situatës. Si **dërgues** i mesazhit, ju jeni kryesisht përgjegjës për krijimin e atmosferës. Kini parasysh se *përmbajtja* që artikulonit përbën vetëm një pjesë të vogël të asaj që komunikoni. Mënyra si e paraqisni veten dhe mënyra si veproni në një situatë të caktuar përcjell tek marrësi pjesën më të madhe të mesazhit dhe të elementeve të tjera. Sjellja juaj është shumë e rëndësishme.

C. Dëgjimi aktiv

Një nga aftësitë më të rëndësishme të komunikimit që do të përdorni është **i dëgjuari aktiv**. Dëgjimi nënkupton dëgjimin nga pikëpamja fizike dhe të kuptuarin e asaj çfarë po thuhet nga personi që flet. Termi “*dëgjim aktiv*” i referohet një mënyre specifike të dëgjuarit me vëmendje dhe me efikasitet të personit tjetër që flet. Si punonjës burgu ose të zbatimit të ligjit, do t’ju duhet t’i përdorni aftësitë tuaja të të dëgjuarit në shumë situata të ndryshme, duke variuar me marrjen e informacionit bazë nga një person i qetë dhe bashkëpunues, deri tek komunikimi me një individ jashtëzakonisht të acaruar apo të shqetësuar. Dëgjimi aktiv do t’ju ndihmojë në të gjitha kontekstet.

Dëgjimi aktiv, i cili përfshin si sjelljen verbale ashtu edhe atë joverbale, mund të ndahet në katër aftësi bazë:

Aftësitë e të dëgjuarit aktiv

1. Përgatitja e terrenit

- Zgjidhni një mjedis të përshtatshëm fizik
- Hiqni ose minimizoni shpërqendrimet e brendshme dhe të jashtme
- Jini të hapur dhe të afrueshëm; shmangni gjykimet e parakohshme
- Dëgjoni me empati

2. Sigurimi i të kuptuarit të ndërsjellët

- Reflektoni ndjenja
- Perifrazoni folësin
- Bëni pyetje të hapura për sqarim
- Konfirmoni hapat e mëtejshëm

3. Kuptimi i gjuhës së trupit

- Vëreni pozicionin dhe posturën (COVID-19, 1.5 metër distancë)
- Krijoni kontakt me sy dhe qëndroni përballë folësit
- Mbani parasysh shprehjen dhe gjestet

4. Ndërprerja e gjykimit

- Përqendrohuni, fokusohuni tek ajo çfarë thotë folësi
- Jini mendjehapur
- Dëgjoni personin që flet

4. Ushtrim me role (45 minuta)

Shënim për trajnerin

Fillojeni këtë aktivitet me **Skenarin 1** (MATERIALI 2) dhe **Skenarin 2** (MATERIALI 3).

Skenari 1 përfshin komunikimin joefektiv/efektiv gjatë trajtimit të një kërkesë apo pyetjeje. (I burgosuri dëshiron të bëjë një ankesë për sjelljen e stafit)

Skenari 2 përfshin komunikimin joefektiv/efektiv kur bëni një kërkesë ose lëshoni një urdhër (punonjësi i burgut i kërkon të burgosurit të zbatojë rregullat)

Përdorni ushtrimet e shkurtra me role për të theksuar informacionin e prezantimit. Ushtrimi i parë me role duhet të demonstrojë Skenarin 1 dhe Skenarin 2 me aftësitë e komunikimit joefektiv. Ushtrimi i dytë me role duhet të demonstrojë Skenarin 1 me aftësitë e komunikimit të mirë.

Shënim për trajnerin: Zgjidhni dy pjesëmarrës që t'ju ndihmojnë të ilustroni ushtrimet me role.

1. Përdorni të njëjtën situatë për të dy ushtrimet me role.
2. Secili ushtrim nuk duhet të zgjasë më shumë se 5 minuta.
3. Në **ushtrimin e parë me role**, demonstrohen aftësitë e komunikimit (dëgjimit) jo të mirë.

Si shembull, mund të përmendim:

- Tonin e acaruar dhe kundërshtues,
- Ndërprerjen e folësit,
- Mungesën e kontaktit me sy/rrotullimin e syve,
- Stilin dhe tonin sarkastik,
- Gjuhën jo të mirë të trupit (qëndrimin e pakujdesshëm, shtrëngimin e duarve), dhe
- Mungesa e qartësisë në shprehjen e qëndrimit/opinionit.

Në **ushtrimin e dytë me role**, të dy palët duhet të demonstrojnë aftësitë e komunikimit (të dëgjuarin dhe të folurin) të mirë. Si shembull përmendim:

- Krijimi i kontaktit me sy,
- Toni i mirë i zërit,
- Gjuha pozitive e trupit (qëndrimi drejt, tundja e kokës në formë pohimi),
- Perifrazimi i folësit,
- Mosndërprerja,
- Kërkimi i sqarimit,
- Shprehja e një qëndrimi.

Shënim për trajnerin ¹⁷

Në **skenarin 1** të trajtimit të kërkesës,¹⁸ një prej pjesëmarrësve luan rolin e oficerit mbikqyrës apo të shefit të Sektorit A në burg. Pjesëmarrësi tjetër luan rolin e të burgosurit me emrin George. Ai i afrohet shefit të sektorit dhe i thotë atij se një tjetër anëtar i stafit të burgut ka bërë komente raciste lidhur me të. Ai ndihet i mërzitur dhe i kërcënuar nga abuzimi. Ai do dëshironte të bënte një ankesë.

¹⁷ <https://www.how2become.com/blog/prison-officer-2015-role-play-questions/>.

¹⁸

Në **pjesën e parë** të ushtrimit me aftësi komunikimi **jo të mirë**, “George” po flet me “shefin e sektorit”. “Shefi i sektorit” e dëgjon George, flet me të, POR papritur merr telefonin, u përgjigjet telefonatave, nuk është i përqendruar, shikon ekranin e kompjuterit, e minimizon incidentin në mënyrë paksa sarkastike, nuk kërkon sqarim. Ndërkohë, dikush tjetër hyn në dhomën e kontrollit kur po zhvillohej bisedimi dhe pyet diçka. Po ashtu, “shefi i sektorit nuk është i qartë në qëndrimin/opinionin e shprehur”.

Ajo çka është e rëndësishme këtu, është fakti se personi që luan rolin e “George” nuk e di se çfarë do të ndodhë gjatë bisedimit.

Pas përfundimit të ushtrimit me role me aftësitë e komunikimit joefektiv, “George” duhet të pyetet se si u ndje ai gjatë bisedimit.

Në **pjesën e dytë** të ushtrimit me aftësitë e komunikimit **efektiv**, dy pjesëmarrës luajnë rolin e “shefit të sektorit” dhe të burgosurit “George”, por këtë herë shefi i sektorit e dëgjon “George” me vëmendje, pa i rënë telefoni, pa sjellje dhe ton sarkastik apo komente të papërshtatshme dhe pa mungesë qartësie në shprehjen e qëndrimit të tij. Pas përfundimit të kësaj pjese, “George” pyetet se si u ndje. Më poshtë, jepen disa këshilla për luajtjen e rolit të shefit të sektorit me aftësitë e komunikimit efektiv.

MATERIALI 2: Këshilla për Skenarin 1, aftësitë e komunikimit të mirë

Gjëja e parë që duhet të thoni si shef sektori është:

“Përshëndetje, faleminderit që ke ardhur të më takosh. Me sa kuptoj, ke pasur një eksperiencë jo të mirë? Do të më pëlqente të zbuloja se çfarë ka ndodhur. Ju lutem, a mund të më thoni saktësisht se çfarë ju ka ndodhur?”

Mos harroni se si shef sektori, po testoheni jo vetëm për aftësitë tuaja verbale, por edhe për aftësitë e komunikimit fizik. Duhet ta shfaqni veten si qetësues dhe sigurues për anëtarin e stafit, që është në gjendje të vështirë. Për ta demonstruar këtë qetësi dhe siguri, tundni kokën, krijoni kontakt me sy dhe bëni gjeste me dorë. Pasi anëtari i stafit të ketë shpjeguar situatën, mund të bëni pyetje të tilla si:

- *Do ketë qenë e tmerrshme për ty, a më lejon të bëj disa pyetje rreth situatës? Nëse në çfarëdolloj momenti nuk ndihesh rehat, të lutem më ndalo dhe do të bëjmë një pushim.”*
- *“Çfarë të tha personi?”*
- *“Kur dhe ku ndodhi kjo?”*
- *“Si u ndjeve nga ajo gjë?”*
- *“A të kanë thënë më parë gjëra të tjera të ngjashme si kjo?”*
- *“A njeh ndonjë person tjetër që trajtohet në të njëjtën mënyrë?”*

Pyetjet do t’ju japin tablonë e përgjithshme të fakteve fillestare të situatës dhe ju ndihmojnë të bëni një gjykim. Më pas, duhet të demonstroni aftësinë tuaj të transmetimit të këtij gjykimi te anëtari i stafit.

“Ju falënderoj për informacionin që më keni dhënë sot. Mund t’ju garantoj se kjo lloj sjelljeje nuk do të tolerohet dhe do të kryhet një hetim i plotë i rastit. Ndërkohë, me qëllim mbrojtjen tuaj nga probleme të tjera në të ardhmen, do t’ju largoj nga anëtari i stafit ky sektor dhe do të caktoj një tjetër anëtar mbikqyrës që t’ju kontrollojë rregullisht. Ju lutem, mos hezitoni të vini e të më takoni sërish në rast se ka çështje të tjera apo thjesht nëse dëshiron të flasësh me dikë.”

Në **Skenarin 2**, njëri prej pjesëmarrësve luan rolin e “oficerit të burgut” dhe tjetri luan rolin e të burgosurit “Lukas”, i cili ka thyer rregullat duke ngacmuar (bullizuar) të burgosurit e rinj dhe duke sharë të burgosurit e tjerë. Është përgjegjësi e “oficerit të burgut” të flasë me të për sjelljen e papërshtatshme, si dhe për ta ndryshuar atë. Lukas është një i burgosur relativisht i ri dhe po ndesh vështirësi me ambientimin me jetën e burgut. Kini gjithmonë parasysh, se oficeri i burgut duhet të ofrojë mbështetjen e duhur për të burgosurit dhe jo t’u bërtasë atyre apo t’i dënojë ata për krimet e tyre.

Në pjesën e **parë** të ushtrimit me aftësi komunikimi **jo të mirë**, roli i “oficerit të burgut” luhet me aftësi jo të mira komunikimi, të tilla si toni i acaruar dhe kundërshtues i zërit, ndërprerja e folësit, ku në këtë rast i burgosuri është Lukas, mungesa e kontaktit me sy/rrotullimi i syve, sjellja dhe toni sarkastik, gjuha e dobët e trupit (qëndrimin e pakujdesshëm, shtrëngimi i duarve).

Pas përfundimit të pjesës **së dytë me aftësi të mira** komunikimi, “Lukas” pyetet se si u ndje. Më poshtë jepen disa këshilla për pjesën e dytë të ushtrimit të lojërave me role të Skenarit 2 me aftësi të mira komunikimi.

MATERIALI 3: Këshilla për skenarin 2, aftësitë e komunikimit të mirë

Ky skenar do të testojë kompetencën e oficerit të burgut në aftësitë komunikuese, kujdestare dhe ndikuese pasi duhet të qartësojë të gjitha detajet e situatës dhe arsyet se pse i burgosuri po sillet në një mënyrë të veçantë, me qëllim që të bëjë një gjykim, prandaj gjëja e parë që duhet të pyesni është:

“Përhëndetje, dua të flas me ty rreth një çështje që është sjellë në vëmendjen time. Është vënë re se ke ngacmuar (bullizuar) disa prej të burgosurve të rinj, si edhe ke sharë të burgosurit e tjerë. Çfarë ju ka shtyrë të veproni në këtë mënyrë?”

Në këtë moment, i burgosuri nis të qajë. Duket qartësisht se është i mërzhitur me diçka. Në këtë rast, është e rëndësishme të tregoni “kujdes”.

“Hej, çfarë të shqetëson? Me thuaj se ç’ke në mendje dhe si ndihesh? E kuptoj plotësisht se është vështirë për ty, por duhet të flasësh dhe t’i nxjerrësh gjërat, të mos i mbash përbrenda.”

I burgosuri tregon se së fundmi ka marrë një letër nga e dashura e tij jashtë ku i thotë se lidhja e tyre ka përfunduar. Ai është i zemëruar për këtë dhe ndaj e ka shfryrë inatin tek të burgosurit e tjerë. Ju duhet të shfaqni një qëndrim të vendosur, por empatik ndaj çështjes së tij.

“Oh sa keq, ky është një lajm i tmerrshëm dhe më vjen vërtetë keq që po e dëgjoj. Mund ta kuptoj zemërimin që duhet të ndjeni momentalisht. Megjithatë, siç edhe vetë e vlerëson, veprimet tuaja kundrejt të burgosurve të tjerë nuk janë të pranueshme. Pikërisht në momente si ky, keni nevojë për mbështetjen e njerëzve të tjerë dhe këtë mbështetje mund të fitoni vetëm duke i trajtuar njerëzit me respekt. E kupton?”

Nëse i burgosuri nuk bie dakord me ju, atëherë duhet të demonstroi vendosmërinë tuaj, duke i shpjeguar më tej situatën. Pasi ta keni afruar me mënyrën tuaj të të menduarit, atëherë mund ta ndihmoni.

“Është e qartë që po kaloni një kohë të vështirë. Unë jam këtu të flas me ty kurdoherë të kesh nevojë. Në vend që t’u bërtasësh të burgosurve të tjerë, hajde dhe ulu këtu me mua e të flasim për ndjenjat e tua. Hë, si thua?”

5. Parimet e komunikimit profesional

Kontributi i trajnerit

Komunikimi profesional nënkupton disa parime kyçe. Si profesionistë, do të komunikoni me më shumë efikasitet, nëse mbani parasysh këto parime:

- Ta trajtoni gjithkënd me dinjitet dhe respekt;
- Të shfaqni empati;
- Të jeni të aftë të punoni në grup;
- Kini parasysh se qëllimi juaj është që të burgosurit të bashkëpunojnë me dëshirë.

Si nëpunës publik në një shoqëri demokratike, ti punësohesh nga populli. Kjo do të thotë se e ke për detyrë t'i trajtosh si duhet qytetarët që ke marrë përsipër t'u shërbesh. Këtu futen edhe të burgosurit. Si profesionist, duhet ta trajtoni gjithkënd në të njëjtën mënyrë që do donit edhe vetë t'ju trajtonin. Kjo është pjesë e detyrës suaj

6. Struktura e komunikimit në institucionet penitenciare dhe rregullat (45 minuta)

Shënim për trajnerin

Në varësi se sa kohë kemi kjo pjesë ose konsiderohet si detyrë shtëpie ose si një detyrë për t'u kryer në fund të këtij moduli.

Kur zgjidhet opsioni tjetër, trajneri vazhdon si vijon:

*Ndajeni grupin në grupe të vogla dhe kërkojuni në fillim që të lexojnë pjesën 6 dhe pastaj përgjigjuni pyetjeve të **pjesës 7**, gjatë së cilës trajneri bën një përmbledhje të diskutimeve dhe kontrollon përgjigjet.*

Në këtë seksion do të flasim për komunikimin në aspektin organizativ dhe menaxhues në sistemin e burgjeve .

Tradicionalisht, pavarësisht nga personeli që punon brenda tyre, sistemet e vuajtjes së dënimit janë konsideruar si organizata statike dhe hierarkike. Konsiderohen si statike, pasi objektivat e tyre janë të qartë dhe të pandryshueshëm. Sipas këtij këndvështrimi, burgjet ekzistojnë për të ekzekutuar vendimin e gjykatës, që i heq personit të dënuar me heqje lirie, lirinë e tij/saj. Ky vendim mund të jetë vendim për paraburgimin (në pritje të gjykimit) ose një vendim dënimi me burg për një periudhë të caktuar. Burgjet janë organizata hierarkike me drejtim nga lart – poshtë që do të thotë se janë organizata me disiplinë në të cilat urdhrat shkojnë nga lart në nivelet e ulëta dhe se përgjegjësia e stafit në nivelet më të ulëta është thjesht që t'u bindet këtyre urdhrave. Në të njëjtën mënyrë, të burgosurit pritet t'u binden udhëzimeve të personelit, pa i diskutuar ato. Është argumentuar se kjo strukturë organizative është e nevojshme për shkak të kërkesave operacionale të jetës në burg. Kërkesa e parë, e qartë dhe e pandryshueshme është se të burgosurit nuk duhet të lejohen të arratisen. E dyta është se nuk duhet të ketë trazira brenda burgjeve. E vetmja mënyrë për të siguruar se këto dy kërkesa përmbushen është që të gjithë, personeli dhe të burgosurit, të dinë cili është vendi i tyre në hierarki dhe t'u binden udhëzimeve operacionale, pa asnjë kundërshtim.

Vendosja e një strukture kaq të ashpër dhe të ngurtë ka pasur dy pasoja kryesore:

E para ka qenë se shumë nga personeli me uniformë, të cilët janë shumë të rëndësishëm për të përcaktuar kulturën e një organizate ku ka punë intensive, siç është sistemi i vuajtjes së dënimit, janë ndier të nënvlerësuar dhe shpejt kanë hasur problemet e zbehjes dhe pakësimit të motivimit.

E dyta ka qenë se burokracia e sistemeve të vuajtjes së dënimit zakonisht është zhvilluar në mënyrë të centralizuar dhe ky është tipar i brendshëm i organizatave të këtij lloji.

Por shoqëritë kanë ndryshuar. Nën ndikimin e këndvështrimeve të reja shkencore mbi detyrat e shërbimeve të burgut, shoqëruar këto edhe nga presioni i medias, politikat për mënyrën si duhet të vihen në zbatim dënimet kanë ndryshuar në mënyrë radikale. Në të njëjtën mënyrë, edhe personeli emancipoi vetveten. Personeli kërkoi më shumë përfshirje në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të burgjeve dhe një nga instrumentet ishte krijimi i sindikatave të oficerëve të burgjeve. Në të njëjtën kohë, “bota e jashtme” (OJF-të) u bë aktive në brendësi të botës së burgjeve. Të gjitha këto rrethana bënë që misioni aktual në shërbimin modern të burgjeve të përmbajë tri fjalët e mëposhtme kyçe: siguria, humanizmi, risocializimi/riintegrimi.

E vetmja detyrë e burgjeve nuk ishte më të parandalonte arratisjen e të burgosurve, por, gjithashtu, brenda së njëjtës energji, të zhvilloheshin në burg aktivitete që përqendrohen në përgatitjen e përshtatshme të burgosurve për lirin dhe kthimin në shoqëri. Për të arritur qëllimet e përmendura, një nga instrumentet e rëndësishme brenda organizatës së burgut është struktura e komunikimit të përshtatshëm.

Është arti i drejtuesve të burgut të gjejnë ekuilibrin e vërtetë ndërmjet organizatës historike statike dhe organizatës moderne dinamike, ku besimi i ndërsjellë ndërmjet drejtuesve të burgut dhe të gjitha niveleve më të ulëta të personelit është kusht bazë.

Komunikimi në burgje

Rregullat Evropiane të Burgjeve, Neni 83c (rishikuar në vitin 2020)¹⁹ thotë se:

Autoritetet e burgjeve duhet të fusin sisteme organizimi dhe menaxhimi që: lehtësojnë komunikimin e mirë mes burgjeve dhe midis kategorive të ndryshme të stafit në burgje dhe koordinimin e duhur të gjithë sektorëve, si brenda, ashtu edhe jashtë burgut.

Neni 86

Drejtuesit duhet të marrin masa për t’u konsultuar me personelin, si një strukturë, për çështje të përgjithshme dhe sidomos për ato që kanë të bëjnë me kushtet e tyre të punësimit.

Neni 87. 1.

Duhet të krijohen kushtet që inkurajojnë komunikimin më të mirë të mundshëm midis drejtuesve, personelit tjetër, agjencive të jashtme dhe të burgosurve.

Tipar i rëndësishëm i një burgu të mirëmenaxhuar është se ka një sistem të mirë për komunikimin ndërmjet të gjithë punonjësve dhe të gjithë të burgosurve. Më sipër u

¹⁹ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

përmend fakti se në shumë sisteme hierarkike burgjesh me drejtim nga lartë-poshtë, i vetmi komunikim që konsiderohej I nevojshëm ishte përcjellja e urdhrave dhe udhëzimeve nga maja e organizatës në fundin e saj. Nuk ka reagime me drejtimin nga poshtë-lart dhe shumë pak informacion kalon nga një sektor i organizatës te tjetri. Kjo situatë shihet ende në disa sisteme të vuajtjes së dënimit të Evropës Lindore. Por kjo nuk është karakteristika specifike e një burgu të menaxhuar mirë.

Komunikimit në sistemet penitenciare i nevojitet një ekuilibër ndërmjet niveleve të ndryshme të përgjegjësive së ministrave, administratave kombëtare të sistemeve të vuajtjes së dënimit dhe burgjeve locale, si dhe besim i ndërsjellë midis të gjithë personave të përfshirë në nivele të ndryshme.

I njëjti parim zbatohet edhe brenda burgjeve individuale. Drejtori i burgut (ekipi i plotë i drejtimit) është përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm të burgut. Mënyra si e kryejnë ata detyrën e tyre ka ndikimin kryesor në atmosferën e burgut. Ata janë përgjegjës për gjithë klimën e punës dhe të jetës në burg.

Dhe kjo mund të bëhet në një atmosferë në të cilën ekziston besimi midis të gjithë personave të përfshirë. Kjo do të ndodhë vetëm nëse ka një sistem të mirë komunikimi (strukturë komunikimi).

Me komunikim kuptojmë komunikimin vertikal dhe horizontal, të brendshëm dhe të jashtëm. Le t'i shpjegojmë më tej parimet e komunikimit.

Së pari: duhet të ketë komunikim në dy kahe nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart, pra komunikim vertikal. Kjo do të thotë se duhet të ketë një proces i cili t'u lejojë drejtuesve të kenë dialog të vërtetë me të gjitha nivelet dhe llojet e personelit, sidomos me personelin me uniformë. Kjo përfshin aftësinë e drejtuesve që, kur është e nevojshme, të japin udhëzime në një mënyrë e cila të kuptohet nga i gjithë personeli. Por duhet të shkojë edhe më tej, pasi do të mundësojë që drejtuesit të kërkojnë këshillat dhe mendimin e personelit jo vetëm për çështje hollësirash, por edhe për çështje më të përgjithshme që kanë të bëjnë me politikën. Përveç kësaj, bën të mundur që drejtuesit të kërkojnë këshillat dhe mendimet e personelit për çështje që kanë të bëjnë me kushtet e punës, pagat, arsimimin dhe mundësitë për të bërë karrierë.

Së dyti: duhet të ketë, gjithashtu, një sistem të mirë të komunikimit horizontal përmes sektorëve dhe departamenteve të ndryshme në burg. Në një strukturë komunikimi nga lart-poshtë shefat e sektorëve dhe të departamenteve, nga njëra anë, i raportojnë drejtpërdrejt drejtuesit të burgut dhe, nga ana tjetër, u komunikojnë mesazhe dhe udhëzime nga lart vetëm vartësve të tyre. Në këtë model, sektorët dhe departamentet e ndryshme nuk kanë mjete formale komunikimi me njëri – tjetrin. Kjo shkakton shumë keqkuptime dhe shumë herë konflikte.

Është e dukshme se e gjithë veprimtaria në njësitë dhe departamentet e burgut është e ndërruar dhe sikur edhe vetëm për këtë arsye komunikimi formal horizontal është kusht themelor.

Prandaj është e nevojshme të ketë një forum formal që lejon personelin me uniformë në sektorin e sigurisë, në njësitë e banimit (regjimet e brendshme), personelin e departamenteve të ndryshme, të arsimimit, personelin mjekësor dhe së fundmi atë të departamentit të financës dhe logjistikës, të cilët nuk janë më pak të rëndësishëm, të shpjegojnë përparësitë e tyre të ndryshme (përgjegjësitë) ndaj njëri – tjetrit dhe

të mësojnë si mund të plotësojë puna e tyre punën e të tjerëve dhe të mos jetë në kundërshtim me punën e grupeve të tjera.

Së treti, duhet të ketë edhe një platformë të mirë formale komunikimi ndërmjet të dënuarve dhe personelit. Nuk ka përse të dënuarve të mos u jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre për aspekte të ndryshme të jetës në burg të cilat i prekin ata. Këshillohet që, periodikisht, të dënuarit të kenë një instrument audit, bazuar në pyetësorë që u adresohen të dyja palëve, nga njëra anë i drejtohet stafit të institucionit dhe të dënuarve në lidhje me të gjitha aspektet e jetës së të dënuarve. Kjo do të matë klimën dhe mjedisin e institucionit, kështu që niveli i lartë i drejtimit të institucionit do të ketë reagime konkrete nga personat e dënuar me heqje lirie dhe nga stafi për çështje konkrete dhe, çka është më e rëndësishme, do të shërbejë për përmirësimin e atmosferës dhe cilësisë së jetës në institucion.

Përmendet disa herë se burgu nuk ka për detyrë vetëm të shmangë arratisjen e të burgosurve. Zbatimi i vendimeve të gjykatës duhet të bëhet edhe në një mënyrë humane dhe përgatitja për lirin është detyra e tretë më e rëndësishme. Kusht thelbësor për të arritur të dy objektivat është një strukturë e përshtatshme komunikimi. Është përgjegjësi e drejtuesve të burgut të integrojnë të gjithë të burgosurit në të dyja strukturat e komunikimit. Mbi të gjitha, kjo është e një rëndësie shumë të madhe për mirëqenien e të burgosurve. Personeli duhet të ketë mundësinë të informojë drejtuesit dhe specialistët për problemet individuale të të burgosurve, por edhe për klimën e jetesës në përgjithësi. Në të njëjtën kohë, personeli duhet të njoftohet nga specialistët si të veprojnë në lidhje me të burgosur individualë (problematikë) dhe mund të këshillojnë personelin (dhe drejtuesit) si të përmirësojnë klimën e jetesës.

Së katërti, personeli luan rol kyç në përgatitjen e të burgosurve për momentin e lirimit të tyre, në stimulimin e të burgosurve dhe në udhëheqjen e tyre. Gjithashtu, personeli duhet të japë kontributin e tij për planin e ndalimit, si dhe për raportin përfundimtar të lirimit (para kohe).

Komunikimi i personave të dënuar

Diskutoam komunikimin nga këndvështrimi i institucionit të burgut, por ka më shumë se kaq. Duhet të diskutojmë, gjithashtu, komunikimin nga këndvështrimi i të burgosurve dhe jo vetëm në “botën e brendshme” të burgut, por ndoshta edhe më shumë, atë me “botën e jashtme” të burgut.

Së pari, ajo që është më e rëndësishmja, është komunikimi me të afërmit: vizitat, korrespondenca dhe telefonatat.

Së dyti, komunikimi (konfidencial) me përfaqësuesit ligjorë dhe punonjësit socialë (nga shërbimi i lirimit me kusht ose përfaqësues të OJF-ve). Kjo ka të bëjë me vizitat, korrespondencën e shkruar dhe telefonatat.

Së treti, i burgosuri mund të ketë korrespondencë në mënyrë konfidenciale me përfaqësuesit e bordeve mbikqyrëse, deputetë, prokurorë, gjykatat, Avokatin e Popullit.

Së fundmi, stafi duhet t’u sigurojë të burgosurve akses në media, radiot dhe televizionet dhe është e dukshme se këtu duhet të ketë kufizime për shkak të sigurisë dhe mbrojtjes së jetës private.

Në rast se nuk ka arsye të motivuara, duhet të jetë e qartë se të gjitha mundësitë e përmendura për komunikim me botën e jashtme duhet të jenë të njëjta, si për ata që janë të padënuar, edhe për të burgosurit e dënuar. Arsyet mund të kenë lidhje me sigurinë (p.sh., arratisje) ose me krimin (p.sh., humbja e provave ose kërcënim i viktimave).

Përfundime

Komunikimi është i rëndësishëm për të garantuar mbarëvajtjen e institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale. Një komunikim korrekt dhe i qartë i stafit të burgut me të dënuarit do të kursejë shumë energji në krijimin e një klime bashkëpunimi të ndërsjellë dhe për motivimin e të dënuarve për zbatimin e rregullave të jetës së brendshme.

7. Diskutime dhe dilema

1. Diskutoni raste konkrete të rolit të komunikimit në zgjidhjen e incidenteve, trajtimin e kërkesave, si dhe në adresimin e kërkesave?
2. Si do ta komentoni komunikimin vertikal?
3. Si do ta komentoni komunikimin horizontal? Ilustrojeni me raste.
4. Përgatitni një ese të shkurtër për zbatimin e parimeve të komunikimit.

Dilema

I dënuari Demiraj duhet të shkojë për kontroll mjekësor jashtë institucionit, në spitalin publik dhe personeli mjekësor ka kërkuar që ky i dënuar të transportohet me kujdes, pa pranga pasi ka thyer dorën. Punonjësit e togës së shoqërimit, të cilët janë përgjegjës për transportin, kanë mendimin se ky i dënuar është i rrezikshëm, paraqet rrezikshmëri për arratisje.

- Çfarë mendoni për këtë situatë?
- Kush është përgjegjës për marrjen e vendimit?
- Si procedohet për të kaluar informacionin? Pra si mund të realizohet komunikimi mes punonjësve të sektorëve të ndryshëm?

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

Skenari

Zelda është oficer burgu. Ajo është në sallën e kontrollit të burgut. Ngre telefonin. Është një koleg nga recepsioni, që e lidh me avokatin e të burgosurit Leo. Në këtë moment, Leo punon në departamentin e punës së burgut. Avokati i thotë Zeldës se babai i tij i sëmurë është përkeqësuar edhe më shumë. Avokati i Leos thotë se ai duhet t'u paraqesë menjëherë një kërkesë drejtuesit të burgut për leje të posaçme që të vizitojë babanë e tij që po vdes.

MATERIALI 2

Këshilla për Skenarin 1, aftësitë e mira të komunikimit

E para gjë që duhet të pyesni si menaxher i grupit, është:

“Përsëritet, faleminderit që ke ardhur të më shohësh. Mesa kuptoj, ke pasur një përvojë të keqe? Do të doja të kuptoja pak çfarë ka ndodhur. A mund të më thuash se çfarë ndodhi saktësisht?”

Mos harro se ti si menaxher i grupit po testohesh jo vetëm për aftësitë e tua verbale, por edhe për aftësitë e tua të komunikimit fizik. Duhet të prezantoheni si një njeri i qetë, prania e të cilit u jep punonjësve të tjerë një lloj sigurie. Përdorni tundjen e kokës, kontaktin me sy dhe gjestet e duarve si një mënyrë demonstrimi, pasi punonjësi të shpjegon situatën, mund t’i bësh pyetje si:

- *“Kjo duhet të ketë qenë e tmerrshme për ty. E ke problem nëse të bëj ca pyetje? Nëse në ndonjë moment nuk ndihesh rehat, të lutem me ndalo dhe bëjmë një pushim.”*
- *“Çfarë të tha ky person?”*
- *“Kur dhe ku ndodhi kjo?”*
- *“Si u ndjeve?”*
- *“A ta kanë thënë ndonjëherë më parë këtë?”*
- *“Di gjë? Trajtohet njeri tjetër kështu?”*

Kjo do t’ju japë një përmbledhje të fakteve fillestare të situatës dhe do t’ju ndihmojë të arrini në një gjykim. Pastaj, ju duhet të demonstroi aftësinë për t’ia përcjellë këtë gjykim punonjësit përkatës.

“Ju falënderoj për informacionin që më dhatë sot. Mund t’ju siguroj se kjo sjellje nuk ka për t’u toleruar dhe se për këtë do të bëhet një hetim i plotë. Ndërkohë, për t’ju mbrojtur nga çdo problem tjetër, unë do t’ju largoj nga ky punonjës dhe do t’ju caktoj një tjetër mbikëqyrës për t’ju kontrolluar sistematikisht. të lutem, mos hezito, por hajde të më takosh përsëri nëse ka ndonjë problem tjetër apo qoftë edhe nëse do të flasësh me dikë.”

MATERIALI 3

Këshilla për skenarin 2, aftësitë e mira të komunikimit Ky skenar teston aftësitë e oficerëve të burgut për të komunikuar me kujdes dhe në mënyrë influencuese, pasi ju duhet të sqaroni të gjitha detajet e situatës dhe pse i burgosuri po sillet ashtu, në mënyrë që të gjykoni se çfarë po ndodh, kështu që e para gjë që pyesni është:

“Shiko, dua që të flasim pak për një çështje që më është sjellë në vëmendje. Është parë se ti je tallur me disa nga të burgosurit e rinj dhe ke sharë ca nga ata të vjetrit. Çfarë të ka bërë të sillesh kështu?”

Në këtë pikë, i burgosuri shpërthen duke qarë. Duket qartë se është mërziur për diçka. Në këtë rast, është e rëndësishme të shfaqni një sjellje ‘përkujdesëse’.

“Hej, si është puna? Çfarë bluan në mendje, si je? E kuptoj shumë mirë që e ke të vështirë, por është mirë të flasësh, ta thuash.”

I burgosuri ju thotë se ka marrë së fundmi një letër nga e dashura që i thotë se mes tyre ka marrë fund. Ai është zemëruar, kështu që ka filluar t’ua nxjerrë inatin të tjerëve. Tani, ju do të duhet të tregoheni të vendosur, por edhe empatikë për këtë çështje.

“Oh sa keq, lajm i tmerrshëm. Më vjen keq që e dëgjoj! E kuptoj zemërimin që mund të ndjesh. Megjithatë, siç mund ta kuptosh edhe vetë, është e papranueshme që të sillesh ashtu me të burgosurit e tjerë. Në ditë si kjo ke nevojë të të mbështesin, por ata mund ta bëjnë këtë vetëm nëse ti i trajton me respekt. E kupton?”

Nëse i burgosuri nuk bie dakord me ju, atëherë duhet të tregoheni rezistentë, duke ia shpjeguar situatën edhe më tej. Në momentin që e bëni ta mendojë si ju, mund ta ndihmoni.

Kuptohet që po kalon një periudhë të vështirë. Unë këtu jam, flasim sa herë të duash. Në vend që t’u bërtasësh të burgosurve të tjerë, hajde dhe ulu me mua. Hë, si thua?

Moduli 6:Diversiteti kulturor (3,5 orë)

“Nuk janë dallimet ato që na ndajnë. Është paaftësia jonë për t’i njohur, për t’i pranuar dhe për t’i festuar ato dallime”. Audre Lorde²⁰

Objektivat: deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të jenë në gjendje të japin përkufizimin e koncepteve të kulturës dhe diversitetit;
- do të kuptojnë dhe do të respektojnë kulturën e personave të tjerë;
- do të njohin mekanizmat e mospranimit të personave që ne i perceptojmë si të ndryshëm dhe lidhja me paragjykimin, intolerancën, stereotipin, diskriminimin dhe racizmin;
- do të jenë në gjendje të përdorin metoda efikase për të kapërcyer pengesat kulturore.

1. Hyrje (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Punonjësit e burgjeve janë profesionistë që kanë nevojë për të gjitha mjetet dhe njohuritë e mundshme kur punojnë me njerëz të tjerë, me të burgosurit dhe me publikun në përgjithësi. Njohja e dallimeve kulturore i ndihmon punonjësit që të kuptojnë më mirë si dhe pse persona të tjerë mund të reagojnë ndryshe ndaj të njëjtave rrethana.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet pse është e rëndësishme për stafin e burgjeve që t’i njohin dallimet kulturore dhe të kuptojnë se pse njerëz të ndryshëm mund të reagojnë ndryshe ndaj të njëjtave rrethana. Trajneri merr shënim përgjigjet dhe përmbledh si vijon.

Kontributi i trajnerit

Të kuptuarit e arsyeve dhe mënyrave se si persona të ndryshëm mund të reagojnë ndryshe ndaj të njëjtave rrethana ndihmon për t’i trajtuar të tjerët më pozitivisht dhe në mënyrë më njerëzore, si dhe krijon një mjedis të sigurt dhe konstruktiv jetese në burgje. Funkzionimi i sigurt, konstruktiv dhe i rregullt i burgut varet nëse njerëzit janë në gjendje që të shkojnë mirë me njëri-tjetrin me sa më pak konflikte. Prandaj, është e rëndësishme që stafi t’i njohë ndryshimet (kulturore) të cilat mund të shkaktojnë konflikte midis të burgosurve dhe mund të bëjë stafin t’i trajtojë të burgosurit që në dukje janë të ndryshëm prej tyre në mënyrë të padrejtë apo diskriminuese.

Rritja e njohurive për larminë kulturore i shtyn punonjësit e shërbimit të burgjeve t’i shohin njerëzit si individë dhe t’i çmojnë për atë që janë, duke marrë parasysh të drejtat dhe dinjitetin individual të tyre. Si qenie njerëzore, punonjësit e burgjeve duhet të vlerësojnë specifikat dhe karakteristikat e veçanta të çdo personi, t’i respektojnë dhe të pranojnë kulturat individuale të njëri-tjetrit, të të dënuarve dhe në komunitet.

Këto udhëzime kanë për qëllim të shtjellojnë ndikimet që ka diversiteti kulturor në burgje dhe mënyrën se si duhet t’i kryejë detyrat stafi i burgjeve.

20 Shapiro I., 2002. Trajnim për barazinë raciale dhe gjithëpërfshirjen sociale: f.23

2. Kultura (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Përkufizimet për kulturën janë të ndryshme dhe të shumta. Thuhet se aq sa autorë kanë shkruar për kulturën, po aq përkufizime ka për të. Gjithsesi, në vijim po shtjellojmë një përkufizim gjithëpërfshirës për kulturën.

Kultura (latinisht *cultura*) është tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëzimit në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor; shkalla e këtyre arritjeve dhe e këtij zhvillimi në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror që përfshin krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore. Kultura është shkalla e zhvillimit që ka arritur një popull, një grup shoqëror a një njeri në një fushë të caktuar të veprimtarisë. Kultura është tërësia e njohurive dhe e shprehive të sjelljes e të edukatës që ka përvetësuar dhe përvetëson njeriu në shkollë ose në jetë.

Përmbledhje: Kultura është një tërësi e integruar besimesh, moralesh, artesh, komunikimesh, veprimesh, zakonesh, traditash dhe institucionesh që i përmbahet një grup specifik njerëzish. Kultura, si një tërësi traditash dhe rregullash, formëson ndjenjat, mendimet dhe sjelljet e një grupi personash. Kultura është mënyra se si një grup i caktuar njerëzish është mësuar t'i zgjidhë problemet dhe dilemat. Ajo është mënyra se si bëhen gjërat në një vend të caktuar. Që të kuptosh kulturat do të thotë të kuptosh se pse njerëzit që i përkasin një kulture të caktuar i bëjnë gjërat në një mënyrë të caktuar.

Kultura mund të përkufizohet si: programimi kolektiv i mendjes që i dallon anëtarët e një grupi njerëzor prej njëri-tjetrit. "Kategoria" mund t'u referohet kombeve, rajoneve brenda ose përtej kombeve, etnive, feve, profesioneve, organizatave ose gjinive. Një përkufizim më i thjeshtë është "rregullat e pashkruara shoqërore". (Geert Hofstede, 1993)

3. Karakteristikat që i dallojnë njerëzit nga njëri-tjetri dhe diversiteti kulturor (60 minuta)

Kontributi i trajnerit

Të gjithë kanë identitete të shumëfishta. Identitetet mund të jenë personale dhe shoqërore. Identiteti personal përfshin emrin, personalitetin, karakteristikat unike, prejardhjen, historinë dhe tipare të tjera që e dallojnë njërin nga tjetri. Identiteti shoqëror përfshin lidhjen farefisnore të dikujt me njerëzit e tjerë; vlerat personale; normat dhe sjelljet shoqërore të lidhura me to.

Vlerat janë qëndrime dhe sjellje themelore, zakone dhe institucione që krijohen, me dëshirë ose jo, nga grupe etnike ose kombe. Vlerat ndikojnë në mënyrën se si e perceptojmë realitetin. Ato mësohen përmes:

- familjes
- shoqërisë
- besimit fetar
- shokëve
- mjeteve të komunikimit masiv
- mësuesve

Vlerat kulturore përfaqësojnë një grup të të gjitha vlerave që u përkasin njerëzve, grupeve etnike dhe kombeve.

Shënim për trajnerin

Trajneri e pyet grupin “Çfarë është diversiteti?”

Trajneri merr shënime përgjigjet dhe përmbledh si vijon:

Termi “diversitet” do të thotë që të gjitha dallimet e rëndësishme mes njerëzve, duke përfshirë edhe mënyrën e perceptimit të këtyre dallimeve, duhet të merren në konsideratë në situata dhe rrethana të caktuara. Shpesh, dallimet më të rëndësishme janë ato që janë më pak të dukshme, si mënyra jonë e të menduarit, besimet dhe vlerat tona.

Koncepti i diversitetit i referohet mozaikut të njerëzve, të cilët kanë një larmi prejardhjesh, perspektivash, vlerash, stileshe dhe besimesh, që i konsiderojnë si pasuri në grupet me të cilët ndërveprojnë. Në përgjithësi, diversitet kulturor do të thotë që të kuptosh dhe të marrësh parasysh zakonet e ndryshme të individëve, në lidhje me origjinën e tyre etnike apo prejardhjen e tyre si emigrantë, të kuptosh besimin fetar, gjininë, moshën, aftësinë fizike (paaftësinë), orientimin seksual dhe aftësinë për t'i dhënë vlefshmëri dhe integritet një sjelljeje të tillë.

Formimi kulturor

Formimi kulturor është një prej dimensioneve më komplekse të shumë dimensioneve të diversitetit që ndikojnë te motivimet dhe pritshmëritë e një personi, bashkë me moshën, gjininë, aftësitë fizike dhe mendore, arsimin dhe kështu me radhë. Prania e personave nga kultura të ndryshme që punojnë dhe jetojnë në një vend të caktuar e bën edhe më kompleks këtë vend. Në thelb njerëzit janë më shumë të ngjashëm se sa të ndryshëm. Dallimet mes nesh vijnë nga mënyra se si jemi rritur, mënyra se si na kanë mësuar ta shohim botën dhe t'i bëjmë gjërat. Dallimet më të rëndësishme janë shpesh ato që duken më pak, ato që shprehen përmes vlerave dhe qëndrimeve tona. Njohja dhe pranimi i vlerës së dallimeve individuale është e rëndësishme në shumë situata, duke përfshirë edhe vendin e punës. Përqafimi i diversitetit në vendin e punës nënkupton krijimin e një mjedisi të sigurt, ku të gjithë vlerësohen dhe mbështeten për atë çka janë dhe në të njëjtën kohë u njihet kontributi që japin përmes dallimeve mes tyre.

Shënim për trajnerin

Ushtrim: (opsional/me dëshirë)

Njohja e trashëgimisë kulturore dhe ekspozimi ndaj multikulturalizmit

Trajneri i kërkon çdo pjesëmarrësi që t'i përgjigjet pesë pyetjeve, pastaj moderon diskutimin, duke mbajtur shënime në tabelë.

Ushtrim

1. Cilit grup etnik, klasë social-ekonomike, besimi fetar, grupmoshe, komuniteti apo grupi tjetër socio-kulturor i përkisni?
2. Çfarë përvojash ke pasur me persona nga grupe etnike, klasa social-ekonomike, besime fetare, grupmosha, komunitete apo grupe të tjerash social-kulturore që janë të ndryshme nga grupi të cilit ti i përket?
3. Çfarë thoshin prindërit dhe njerëzit e tjerë të rëndësishëm për ty gjatë rritjes tënde për personat e ndryshëm nga familja jote?
4. Çfarë faktorësh social-kulturore të prejardhjes mund të kontribuojnë në refuzimin tënd nga personat që u përkasin kulturave të tjera? Çfarë cilësish personale keni ju që ju ndihmojnë të ndërtoni marrëdhënie ndërpersonale me persona nga grupe të tjera kulturore/çfarë cilësish personale mund t'ju prishin punë?

4. Grupet e pakicës dhe grupet vulnerabël (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

(Kuptimi i mirëfilltë i minoritetit) Numër më i vogël, krahasuar me “shumicën”.

Në shumë vende të botës kemi grupe të ndryshme që quhen grupe minoritare dhe grupe vulnerabël. Shpesh, grupet e pakicës ose grupet vulnerabël kanë më pak akses në pushtet dhe në mundësi të ndryshme krahasuar me grupet që përfaqësojnë shumicën e privilegjuar. Këto grupe vulnerabël mund të vuajnë nga diskriminimi dhe mungesa e tolerancës nga ana e shumicës, e cila çon në mospranimin dhe në përjashtimin e personave që perceptohen si të ndryshëm ose si inferiorë, si për shembull anëtarët e grupeve të pakicave sociale ose etnike ose personat e ndryshëm nga pikëpamjet politike apo orientimi seksual.

Demokracitë janë të dobëta ndaj “tiranisë së shumicës”: situata ku vendos shumica është kaq shtypëse saqë i shpërfill plotësisht nevojat dhe dëshirat e anëtarëve të pakicave. Kuadri i të drejtave të njeriut jo vetëm i mbron qytetarët nga shtypja e individit apo e grupeve të vogla të individëve, por është edhe një mjet mbrojtjeje për pakicat nga shumica. Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet edhe grupeve të burgosurve që nuk janë pjesë e shumicës në institucion, për shkak të një apo më shumë arsyeve. Këto mund të përfshijnë: racën, grupet etnike, origjinën shoqërore, kulturore, fetare, orientimin seksual, gjuhën dhe kombësinë. Rregullat dhe rregulloret e burgut duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve të ndryshme. Një metodë e rëndësishme për uljen e diskriminimit mund të jetë duke marrë në punë në shërbimin e burgjeve persona që përfaqësojnë të gjitha grupimet e popullatës.

Shënim i trajnerit

Trajneri i kërkon grupit të shpjegojë se si e kupton diversitetin e burimeve njerëzore të shërbimit të burgjeve në Shqipëri.

Trajneri i kërkon grupit që të ndajnë mendimet e tyre për diversitetin e burimeve njerëzore të shërbimit të burgjeve në Shqipëri – a është diversiteti i rëndësishëm/i mirë/ i dobishëm dhe pse?

Trajneri i merr përgjigjet shënim në tabelë

Ose

Trajneri shpërndan letra dhe u kërkon pjesëmarrësve që t’i shkruajnë përgjigjet dhe t’i ngjisin ato në mur/ në tabelë

5. Mospranimi i personave që i perceptojmë si të ndryshëm dhe lidhja me paragjykimin, intolerancën, stereotipin, diskriminimin dhe racizmin. (60 minuta)

Shënim për trajnerin

Trajneri lexon këtë citim:

“Nuk janë dallimet ato që na ndajnë. Është paaftësia jonë për t'i njohur, për t'i pranuar dhe për t'i festuar ato dallime”. Audre Lorde²¹

Më pas, trajneri u prezanton pjesëmarrësve temën e mëposhtme:

Kontributi i trajnerit

Në këtë pjesë flitet për mosnjohjen e vlerave të dallimeve individuale dhe kulturore, si dhe për reagimet sa i përket paragjytimeve, intolerancës, stereotipeve, diskriminimit dhe racizmit.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit që të ndahet në pesë nëngrupe, duke u drejtuar pyetje: si i perceptojnë konceptet e paragjykit (grupi 1), intolerancës (grupi 2), stereotipeve (grupi 3), diskriminimit (grupi 4) dhe racizmit (grupi 5) dhe që t'i shkruajnë përgjigjet në një letër. Trajneri i mbledh përgjigjet dhe i ngjit ato në tabelë/në mur si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Paragjykimi

Paragjykimi është mendim i gabuar dhe i pambështetur, i ngulitur nga njohja jo e plotë e dukurive të shoqërisë dhe e shkaqeve të tyre, nga i cili niset dikush në gjykimet dhe në veprimet e tij në kundërshtim me njohjen dhe arsyen, pikëpamje dhe qëndrim që formohet si shprehje në ndikimin e shoqërisë e të mjedisit dhe jo nga njohja ose përvoja e jetës.

Paragjykimi është mendim i padrejtë, që është formuar që më parë për ndonjë person ose për diçka tjetër, pa e njohur mirë atë, dhe që pengon për ta vlerësuar me paanshmëri; dhënia para kohe e një mendimi për dikë apo për diçka; nxjerrja, formimi shpejt e shpejt i mendimit për tjetrin, bazuar në të dhënat e pakta që ka ai që paragjykon. Njëanshmëri, paragjykime, tendenca, këto mund të jenë ose pozitive ose negative, por zakonisht kanë të bëjnë me ndjenjat/ opinionet/ gjykimet/ besimet negative.

Shumë nga paragjykimet që ekzistojnë në shoqëri, shfaqen edhe në jetën e burgut, madje këtu shfaqen edhe më të mprehta. Burgjet pasqyrojnë në shkallë të madhe vlerat e shoqërisë së cilës i përkasin, kështu që aty reflektohen të gjitha paragjykimet ndaj grupeve të ndryshme etnike, si dhe grupeve në nevojë.

Shënim për trajnerin

Ushtrim me një RAST STUDIMI (opsional/me dëshirë): MATERIALI 3

Rekomandohet që trajnerët t'i ndryshojnë emrat, vendet e origjinës dhe/ose detajet

21 Shapiro I., 2002. Trajnim për barazië raciale dhe gjithëpërfshirjen sociale: f.23.

e tjera të historisë në këtë material në mënyrë që të përfaqësojnë realitetin në kontekstin e tyre.

Besmiri identifikohet me grupin me të cilin ai ka ndarë përvoja të përbashkëta dhe që ai beson se ka të njëjtat vlera themelore si ai. Nuk ka asnjë problem që Besmiri identifikohet me këto grupe. Problemi lind kur Besmiri fillon të flasë me gjuhën “ne dhe ata”, me një mentalitet “ne dhe ata”, duke prezumuar gjëra të ndryshme për personat që u përkasin grupeve të tjera. Besmiri duhet të jetë i vetëdijshëm për prezumimet/paragjykimet dhe stereotipet e tij dhe të kujdeset që të mos lejojë më që ato të ndikojnë te veprimet/perceptimet e tij kundrejt personave të tjerë.

Anila është më e hapur ndaj personave që nuk i përkasin grupeve të njëjta si ajo. E megjithatë, modelet sociale ndikojnë në mënyrën se si ajo i gjykon ata, duke mos qenë në këtë mënyrë e sigurt. Edhe Anila duhet të bëhet e vetëdijshme për këto stereotipe të saj dhe të kujdeset që kjo të mos ndikojë në marrëdhëniet e saj me personat e tjerë.

Olga u ofendua dhe duke pasur parasysh se për shkak të prezumimeve dhe stereotipeve sociale, kjo ndoshta nuk është hera e parë që ajo dyshohet që ka bërë diçka që nuk e ka bërë, ndoshta ndihet e lënduar dhe e tradhtuar. Këto ndjenja ndikojnë negativisht tek ajo dhe mirëqenia e saj dhe mund të çenojnë edhe marrëdhënien e saj me Anilën.

Udhëzime

1. Trajneri i kërkon grupit që të ndahet në grupe me 3-4 vetë.
2. Trajneri shpërndan MATERIALIN 3 për grupet.
3. Trajneri u kërkon pjesëmarrësve ta lexojnë materialin dhe të diskutojnë sa më poshtë:

- Sjelljen e Besmirit
- Reagimin e Anilës
- Ndjenjat e Olgës
- Çfarë mendojnë ata për marrëdhënies mes Anilës dhe Olgës pas incidentit?
- A mund të ndikojë ky incident në marrëdhëniet mes tyre?
- A mund të mësojë Besmiri diçka pas këtij incidenti?

Ftojini grupet që të diskutojnë nëse kanë hasur incidente të ngjashme në jetë, çfarë ka ndodhur, si vepruan/reaguan dhe si u ndjenë.

4. Trajneri u kërkon grupeve të prezantojnë konkluzionet e tyre
5. Trajneri i diskuton konkluzionet, duke i pasuruar edhe me këndvështrimet e tij:
 - Shpjegoni se, te të gjithë njerëzit, eksperiencat e mëparshme dhe paragjykimet që kanë pasur krijojnë një lloj skeme, ku bazohen veprimet/reagimet, opinionet dhe sjelljet e njerëzve.
 - Theksoni se si mund të ndikojnë paragjykimet dhe stereotipet tuaja në gjykimin tuaj.
 - Vini në dukje se prezumimet mund të ndikojnë negativisht dhe mund të pengojnë marrëdhëniet dhe jetën tuaj, si dhe jetën e personave të tjerë.

Mostoleranca është mungesa e respektimit të praktikave apo besimeve të ndryshme nga tonat. Ajo përfshin edhe mospranimin e personave që ne i perceptojmë si të ndryshëm nga vetja, si për shembull anëtarët e një grupi social apo etnik të ndryshëm

nga i yni ose personat e ndryshëm për nga pikëpamjet politike ose orientimi seksual. Mostoleranca mund të manifestohet në një sërë veprimesh, që nga shmangia deri te gjuha e urrejtjes dhe dëmtimet fizike e madje deri te vrasja.

Steriotipet janë besime ose opinione të përgjithësuara për një grup të caktuar njerëzish, si për shembull “sipërmarrësit janë ambiciozë”, “nënpunësit publikë janë njerëz pa humor” ose “gratë janë flokëgjata dhe mendjeshkurtra”. Funksioni kryesor i steriotipeve është thjeshtimi i realitetit. Steriotipet zakonisht bazohen ose në një lloj përvojë personale ose te përshtypjet që ne kemi përvetësuar gjatë fëmijërisë, duke u shoqëruar nga të rriturit në shtëpi, në shkollë ose edhe në masmedia, përshtypje që më pas përgjithësohen dhe përfshijnë të gjithë personat që mund të lidhen me to.

Stereotipat janë ide të ngulitura, të pandryshueshme (shabllone, klishe), për një grup njerëzish apo për një gjë të caktuar, ide të cilat në realitet nuk janë të vërteta, p.sh.: *femrat nuk mund të punojnë si punonjëse të burgjeve; të gjithë meshkujt janë të vrazhdë.*

(Shih gjithashtu Shtojcën për MATERIALIN 4 me ushtrimin opsional për steriotipet.

Diskriminimi

Diskriminimi dhe intoleranca bazohen ose justifikohen shpesh me paragjykimin dhe steriotipizimin e personave dhe grupeve sociale, në mënyrë të vetëdijshme ose jo; ato përbëjnë shprehje të paragjykimeve në praktikë. Diskriminimi (strukturor) është rrjedhojë e formave të vazhdueshme të paragjykimeve.

Diskriminimi ndodh kur njerëzit trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se sa personat e tjerë në situata të krahaseshme, vetëm për shkak se ata i përkasin ose perceptohet se i përkasin një grupi të caktuar ose një kategorie të caktuar njerëzish. Njerëzit mund të diskriminohen për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, etnisë, origjinës, besimeve politike, racës, besimit fetar, seksit ose gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, kulturës dhe për shumë arsye të tjera. Diskriminimi, i cili është shpesh rrjedhojë e paragjykimeve të njerëzve, i bën njerëzit të pafuqishëm, i pengon nga angazhimi aktiv, nuk i lë që të zhvillohen.²²

Diskriminimi është sjellje e bazuar në paragjykim. Në Kushtetutën e Shqipërisë diskriminimi është i ndaluar me ligj (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18). Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë, siç parashikohet me ligj.

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizikë dhe juridikë, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizike dhe juridike.

Rreziqet e diskriminimit bëhen më të mëdha në kushtet e burgut. Është përgjegjësia e administratës së burgut për të siguruar parandalimin e krijimit të nëngrupeve që diskriminojnë pakicat në popullatën e burgut dhe në personelin e saj gjithashtu. Një rast i dukshëm është mënyra si akomodohen privilegjet për disa punonjës. Vërehen

22 Diskriminimi ka pasoja të drejtpërdrejta ndaj personave dhe grupeve që diskriminohen, por ka pasoja të thella dhe të drejtpërdrejta edhe ndaj shoqërisë si një e tërë. Një shoqëri ku lejohet apo tolerohet diskriminimi është një shoqëri ku njerëzit privohen nga ushtrimi i lirisht i potencialit të tyre të plotë për veten dhe për shoqërinë.

raste ku të dënuar romë ose pa mbështetje punësohen në punë të rëndomta, si pastrimet, ndërsa të tjerë në punë më të mira. Pakësimi i rasteve të shfaqjes së këtij fenomeni negativ në burgje kërkon më shumë vëmendje dhe angazhim nga ana e drejtuesve të lartë në institucionet penitenciare, por jo vetëm. Roli i punonjësve të rolit bazë është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt, duke qenë se ata kanë kontakte të drejtpërdrejta gjatë gjithë kohës me të dënuarit.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet: *A jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuar?*

Koncepti i racës dhe racizmit

Kontributi i trajnerit

Trajneri e përmbledh tekstin e mëposhtëm nga një fletëpalosje e Këshillit të Evropës për diskriminimin dhe intolerancën.²³

“Disa paragjykime mund të transformohen në ideologji dhe të ushqejnë urrejtjen. Një ideologji e tillë është racizmi. Racizmi përfshin sjelljet diskriminuese ose abuzive ndaj njerëzve, për shkak të “inferioritetit” të tyre të imagjinuar. Kanë ekzistuar besime të përhapura se brenda species njerëzore ekzistojnë disa raca njerëzore, të cilat dallohen nga ndryshime fizike. Megjithatë, studimet shkencore tregojnë se “popullatat e njeriut janë grupe qartësisht të dallueshme biologjike” dhe se raca është një entitet ose një konstrukt social imagjinar”.

Prandaj, termi “racë” nuk përdoret më nga antropologët dhe shkencëtarët e tjerë socialë, pasi ky koncept konsiderohet një konstrukt social dhe politik i bazuar **në shumë pak fakte shkencore, në mos në asnjë fakt shkencor**. Të gjitha grupet njerëzore i përkasin *species hominids* dhe kanë 99.9% material gjenetik të përbashkët. Njerëzit janë si të ndryshëm ashtu edhe të njëjtë, pasi që të gjithë i përkasin të njëjtës specie ose familje të *hominids*. **Të gjitha qeniet njerëzore i përkasin të njëjtës specie dhe, për këtë arsye, nuk ka asnjë kuptim të flitet për “racë”.**

Në këtë fletëpalosje, më tej thuhet se:

“Ndikimi i ideologjive raciste ka qenë shkatërrues për njerëzimin; ai është përdorur si justifikim për skllavërinë, kolonializmin, aparteidin, sterilizimet dhe asgjësimet të detyruara të njerëzve. Ato kanë qenë baza e ideologjive naziste dhe programeve për zhdukjen e hebrenjve dhe grupeve të tjera njerëzish që janë diskriminuar dhe stigmatizuar si “popuj inferiorë”. Për fat të keq, racizmi vazhdon të ekzistojë në shoqëritë dhe politikën evropiane bashkëkohore. Ndonëse, raca nuk pranohet më si kategori biologjike dhe ndonëse janë të paktë ata që besojnë tashmë te “racat superiore” që kanë një të drejtë që nga lindja për të ushtruar pushtetin mbi ato që konsiderohen “inferiore”, impakti i racizmit vazhdon të ngelet dhe të marrë forma të ndryshme, si racizëm kulturor ose etnocentrizëm, besimi se disa kultura, zakonisht e atyre që u besojnë këtyre ideologjive, janë superiore ndaj kulturave, traditave, zakoneve dhe historive të tjera që nuk përputhen me të tyret. Praktikata e përhapura të deportimit dhe trajtimit të pabarabartë të emigrantëve, si dhe diskriminimi strukturor ndaj pakicave të caktuara etnike, si atyre rome, nga shumë qeveri, ushqen ksenofobinë

23 <https://www.coe.int/en/web/compass/discrimination-and-intolerance> Council of Europe

dhe ndjenjat e përgjumura të racizmit. Krimet me bazë urrejtjen që mbështeten nga ideologjia raciste vazhdojnë të raportohen sistematikisht në lajmet e shumë shteteve evropiane”.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet: A mund të identifikoni ndonjë rast dhune raciste në vendin tuaj?

Shih edhe MATERIALIN 2 për racizmin.

6. Njohja dhe respektimi i diversitetit kulturor (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Njohja dhe respektimi i kulturës realizohet kur një person shpreh gatishmërinë dhe ka aftësi të çmojë kulturat e tjera, si dhe zotëron njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme që të komunikojë në mënyrë efikase me njerëzit që kanë prejardhje të ndryshme kulturore. Për t'i njohur dhe respektuar kulturat e të tjerëve ne duhet t'i njohim veçoritë e kulturave të tyre. Këto veçori ndahen në pesë kategori:

- vlerat dhe supozimet
- besimet fetare
- rolet dhe modelet e sjelljeve të ndryshme në familje
- mënyrat e të menduarit
- llojet e komunikimit

A. Krijimi i besimit dhe i marrëdhënieve të mira

Ne duhet të krijojmë besim dhe marrëdhënie të mira para se të fillojmë komunikimin me persona të kulturave të ndryshme. Elementet që shërbejnë për të krijuar besimin dhe marrëdhëniet e mira janë shtatë:

- gjuha
- përdorimi i emrave të duhur
- sinqeriteti
- shmangia e lojërave dhe lojërave psikike
- lejimi dhe pranimi i sjelljeve që mundësojnë shprehje të lirë
- njohja e çështjeve racore/etnike duke mos i mbajtur anën askujt
- mosparaqitja juaj si “kryesor”.

B. Metodat e komunikimit të drejtpërdrejtë

Personi i cili njeh kulturën duhet të përqendrohet dhe të dallojë ndryshimet në metodat e komunikimit në mënyrë që të parandalojë që këto metoda të paraqiten si pengesa gjatë komunikimit. Elementët kryesorë të komunikimit të drejtpërdrejtë janë:

- gjuha e folur
- toni/intonacioni i zërit
- kontakti i drejtpërdrejtë me sy/mimika (shprehjet përmes fytyrës)
- gjuha e trupit/gjestet
- prekja

7. Mënyrat efiçente të kapërcimit të pengesave kulturore: aftësitë kulturore (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Tejkalimi i pengesave kulturore është një aftësi e cila fitohet dhe që kërkon respektimin dhe kuptimin e besimeve dhe vlerave kulturore të të tjerëve. Këto aftësi janë:

A. Të dëgjuarit me vëmendje

Aftësia për të dëgjuar me vëmendje duhet të zhvillohet, sepse ka shumë faktorë që e pengojnë këtë gjë. Ata janë:

- përqendrimi në atë që do të themi dhe jo në atë që po thotë bashkëbiseduesi
- kur dëgjojmë vetëm atë që dëshirojmë të dëgjojmë
- mendime të formuara më parë lidhur me atë se çfarë do të thotë ai që na flet
- besimet dhe vlerat që e ndryshojnë domethënien e fjalëve në mes të atij që flet dhe atij që dëgjon

B. Kundërshtimi i reagimeve paragjyquese

Ne duhet të dëgjojmë informacione në mënyrë të paanshme. Kur ne themi një gjykim lidhur me vlerat, folësi vihet në mbrojtje.

C. Këndvështrimi i perceptimeve (mënyrave të të kuptuarit)

Mënyrat si i shikojmë ne gjërat varet nga bindjet dhe vlerat tona. Ne duhet t'i lëmë anash vlerat dhe bindjet tona të cilat zakonisht ia veshim asaj që dëgjojmë dhe shohim. Për ta bërë këtë, ne duhet të bëjmë përpjekje që të shmangim paragjykimet kulturore.

D. Kërkimi i komenteve

Kërkoni nga personi me të cilin jeni duke folur, në e kupton atë çfarë po i thoni. Sqaroni domethëniet të cilat, në të kundërtën, do të mund të keqinterpretoheshin për shkak të dallimeve kulturore.

E. Kultivimi i vetëdijes

Vëzhgimi i mënyrës si i shikojnë të tjerët gjërat, kërkon vetëdije. Në fazat fillestare të çfarëdo kontakti ndërkulturor ju duhet të keni posaçërisht kujdes për sjelljet tuaja, për mënyrën e komunikimit dhe të menduarit.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit që të ngrejë disa prej pyetjeve që mund t'i bëjnë vetes kur jetojnë në një situatë të ndryshme nga ana kulturore. Shkruajini përgjigjet në tabelë dhe më pas vazhdoni me tekstin në vijim.

Pyetjet që do t'i bënit vetes nëse jeni në një situatë të ndryshme nga ana kulturore përfshijnë ato që quhen aftësi kulturore.

Në nivel individual, aftësitë kulturore përfshijnë këta komponentë:

- ***Ndërgjegjësimin për vlerat kulturore dhe për mënyrën se si ato ndikojnë te sjellja dhe marrëdhëniet tona.***
- ***Ndërgjegjësimin dhe pranimin e ndryshimeve: të qenit i hapur ndaj kulturës së personave të tjerë.***
- ***Njohjen e dinamikave së ndryshimeve: koncepti i të qenit i/e hapur dhe të përqafuarit e konceptit se “ndryshe nuk do të thotë keq”. Që të përpiqesh që të kuptosh ndryshimet duhet të kesh vullnet.***
- ***Përvetësimi i njohurive kulturore: ndjesia e vërtetë të një kulture përmes të lexuarit, duke folur me individët që i përkasin asaj kulture dhe përjetimi i jetës brenda asaj kulture.***
- ***Aftësia për t’iu përshtatur çështjeve të diversitetit. Gjetja e mënyrave për t’iu përshtatur çështjeve të ndryshme të diversitetit me situatat me të cilat përballemi çdo ditë.***

8. Përfitimet nga njohja e kulturave të tjera (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Sigurisht, njerëzit kanë shumë përfitime nga njohja e kulturave të ndryshme. Megjithatë, aftësimi i punonjësve të shërbimit të burgjeve në lidhje me shumëllojshmërinë kulturore sjell përfitime të veçanta, si p.sh.:

- pakëson konfliktet e dhunshme midis të dënuarve dhe punonjësve të shërbimit;
- pakëson konfliktet dhe mosmarrëveshjet midis të dënuarve me njëri-tjetrin;
- rrit frymën e bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme sociale;
- siguron mbrojtje më të mirë për grupet e pambrojtura, pakicat, romët etj.;
- mundëson ri-integrimin e të gjitha grupeve që ndodhen të dënuar;
- rrit sigurinë dhe besimin midis grupeve të ndryshme.

Përmbledhje

Për të njohur dhe kuptuar kulturat që dallojnë nga kultura jonë, duhet të jemi të hapur dhe të kemi vullnet për të mësuar. Kjo nuk është detyrë e lehtë, por secili prej nesh, si punonjës i një shërbimi publik të një shteti që ka pakica kombëtare dhe grupe në nevojë, duhet ta vlerësojmë këtë aspekt me mendje të hapur. Çfarë mësojmë dhe përfitojmë nga kulturat do të na përmirësojë pozitën tonë si punonjës të shërbimit të burgjeve dhe si individë.

Detyrë shtëpie

Ju lutemi, plotësoni pyetësin për njohuritë rreth diversitetit kulturor (MATERIALI 1) dhe kuizin me këto pyetje:

1. Përkufizoni secilin prej gjashtë termave në lidhje me karakteristikat e grupeve sociale, siç është dhënë në mësim.
2. Përkufizoni secilin prej tre elementeve që formojnë individët, sipas mësim.
3. Numëroni tre llojet e racizmit, siç është mësuar në klasë.

4. Numëroni shtatë metodat e ndërtimit të besimit dhe marrëdhënieve të mira, sipas mësimit.
5. Numëroni dhe shpjegoni gjashtë metodat e tejkalimit të pengesave kulturore, siç është përshkruar në mësime.

“Si do të ndiheshit në qoftë se njëri nga shokët e klasës do të përbuzte njërin nga traditat e tua familjare?”; “Si do të ndiheshit nëse dikush do të qeshte me diçka që ju bën të veçantë?”; “Si do të ndiheshit nëse dikush i injoron të tjerët apo i trajton keq, për shkak se kanë diçka të veçantë?”.

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

Pyetësor përshkrues për njohjen e diversitetit kulturor.

Udhëzime: Lexoni çdo pyetje në faqet vijuese dhe rrethoni numrin që zgjidhet. Konsideroni çdo pyetje në bazë të veprimeve, besimit dhe përvojës suaj. Pasi të jeni përgjigjur për 18 pyetjet e pyetësorit, numrat e rrethuar mbledhni dhe në një fletë të pastër shënoni shumat e secilës faqe. Pastaj, shënoni shumën e përgjithshme e cila është shuma e të gjitha faqeve.

Sa shpesh unë:

Gati kurrë = 1, rrallë = 2, zakonisht = 3, gati çdoherë = 4.

- | | |
|---|---------|
| 1. Sfidoj të tjerët për pikëpamjet racore, etnike apo përçmime racore? | 1 2 3 4 |
| 2. Reagoj kur dikush e poshtëron personin tjetër apo sillet në mënyrë jokorrekte? | 1 2 3 4 |
| 3. Mendoj për ndikimin e mendimeve dhe veprimeve të mia para se të flas apo të veproj? | 1 2 3 4 |
| 4. Refuzoj të marr pjesë në shakatë të cilat janë përçmuese për ndonjë person, kulturë, grup apo nëngrup gjinor? | 1 2 3 4 |
| 5. Tregohem i kujdesshëm për ekzistencën e thashethemeve të cilat përforcojnë paragjykimin apo anësinë? | 1 2 3 4 |
| 6. Verifikoj a janë të vërteta faktet apo janë thjesht thashetheme apo supozime për ndonjë person? | 1 2 3 4 |
| 7. Njoh dhe sfidoj paragjykimet të cilat ndikojnë në mënyrën e të menduarit tim? | 1 2 3 4 |
| 8. I shmangem përdorimit të gjuhës e cila forcon stereotipat negativë? | 1 2 3 4 |
| 9. Pranoj dhe përcjell porositë se anëtarët e grupeve jokryesore (etnike etj.) janë të shkathët dhe përgjegjës njësoj si të tjerët? | 1 2 3 4 |
| 10. I pranoj njerëzit e grupeve dhe të kulturave të ndryshme si individë? | 1 2 3 4 |

- | | |
|--|---------|
| 11. Pranoj dhe përkrah faktin se nuk është e nevojshme të veprosh në mënyrë të veçantë për të qenë i suksesshëm apo i dobishëm për organizatën time? | 1 2 3 4 |
| 12. Marr përgjegjësinë të ndihmoj anëtarët e rinj në organizatën time, duke përfshirë femrat dhe personat me kulturë e moshë ndryshme, që ata ta ndiejnë veten të mirëseardhur dhe të pranuar? | 1 2 3 4 |
| 13. Mësoj dhe respektoj arritjet kulturore si dhe festat dhe ngjarjet e rëndësishme të tyre? | 1 2 3 4 |
| 14. Kërkoj dhe planifikoj aktivitete shoqërore ku të gjithë do të kenë mundësi për pjesëmarrje? | 1 2 3 4 |
| 15. Dëgjoj idetë e anëtarëve të grupeve jo kryesore dhe çmoj punën e tyre, si individuale, ashtu edhe atë në grup? | 1 2 3 4 |
| 16. Inkuadroj anëtarët e grupeve jokryesore në proceset e vendimmarrjeve të cilat kanë ndikim në ta? | 1 2 3 4 |
| 17. Ndjek dhe zbatoj politikat organizative që kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, duke përfshirë kundërvënien ndaj atyre të cilët i cenojnë këto politika? | 1 2 3 4 |
| 18. Bëj përpjekje të shumta për të mësuar nga kultura të tjera? | 1 2 3 4 |

MATERIALI 2

Informacione shtesë për racizmin

Racizmi është dukuri e cila lejon që sjellja e njerëzve të përcaktohet nga stereotipat, pikëpamjet dhe qëndrimet se njëra racë është superiore ndaj tjetrës. Racizmi ndahet në tri kategori:

A. Racizmi individual

Besimi se pakicat kombëtare janë në pozitë inferiore për shkak të përkatësisë racore si dhe sjelljet e tyre të cilat duket se shkaktojnë krijimin e këtyre pikëpamjeve dhe pozitave.

B. Racizmi institucional

Të gjitha aktivitetet brenda organizatave të cilat krijojnë pabarazi racore dhe që rezultojnë në nënshtrimin dhe shtypjen e pakicave, qoftë me qëllim apo janë rezultat i aktiviteteve të përditshme. Racizmi institucional është vazhdim i racizmit individual.

C. Racizmi kulturor

Racizmi kulturor është mbivlerësimi i kulturës së njërit grup etnik ndaj kulturës së grupit apo grupeve të tjera etnike. Pikëpamja se njëri grup ka gjithmonë të drejtë, e grupet e tjera jo, mbizotëron në këtë lloj racizmi.

Në bazë të kësaj, vetëm vlerat, pikëpamjet, qëndrimet, traditat dhe morali që i takojnë grupit sundues, konsiderohen sjellje të pranueshme dhe “normale”.

Për të kuptuar më qartë llojet e ndryshme të racizmit, shembujt vijues do të paraqiten për të identifikuar se për cilin lloj të racizmit bëhet fjalë.

1. Spitali ka një parim sipas të cilit të gjitha infermieret duhet të jenë me lëkurë të bardhë. (Përgjigjja: racizëm institucional. Kjo është rregullore e brendshme e një organizate me të cilën shkaktohet pabarazi).
2. Klara beson se njerëzit nga Kina janë inferiorë dhe megjithëse në vendin e saj të punës punojnë një numër i vogël kinezësh, ajo nuk pranon të flasë me ta. (Përgjigjja: racizëm individual. Ajo beson se një racë e caktuar është inferiore, prandaj ajo refuzon të flasë me ta).
3. Vendi është i banuar nga një popull, 90 për qind e të cilit janë të të njëjtit besim (fe). Njerëzve të feve të tjera u pengohet hyrja në atë vend, ndërsa atyre që jetojnë në atë vend u jepen punë që paguhet pak. (Përgjigjja: racizëm kulturor, sepse një grup e ngre veten mbi gjithë grupet e tjera).

MATERIALI 3

Rasti i studimit të Bledit (opsional/me dëshirë)

Bledi është një profesionist IT dhe punon për një kompani komunikimi. Ai është i martuar me Sonilën, e cila punon në të njëjtën kompani. Fundjavave, Bledi luan futboll. Bledi identifikohet dhe shoqërohet me profesionistë të tjerë IT, me kolegët e tij të kompanisë për të cilën punon dhe me persona të tjerë që luajnë futboll, të cilët janë që të gjithë zakonisht nga vendi nga vjen edhe vetë Bledi. Ai beson se njerëzit që vijnë nga po ai vend kanë cilësitë më të mira. Bledit i pëlqejnë edhe francezët, italianët, britanikët dhe gjermanët. Bledi ka studiuar në Angli dhe ka disa kolegë britanikë dhe italianë. Ai ka edhe shokë nga futbolli që janë francezë dhe gjermanë. Sonila ka një shoqe, Olgën, e cila është nga një vend i Ballkanit Perëndimor. Olga punon si shitëse dhe është nënë e divorcuar. Sonila e fton ndonjëherë në shtëpi Olgën për kafe, sidomos fundjavave, kur Bledi zakonisht luan futboll. Bledi nuk e pëlqen Olgën. Bledi beson se njerëzit nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe sidomos gratë nga Ballkani Perëndimor kanë tendencën të gënjejnë dhe shfrytëzojnë të tjerët. Bledi beson gjithashtu se gratë në përgjithësi janë të dobëta dhe se nënat e divorcuara janë që të gjitha të varfëra dhe imorale.

Të dielën e kaluar, Bledi u kthye nga futbolli, hëngri darkë në shtëpi me Sonilën dhe po përgatitej të dilte me kolegët për birra. Po kërkonte orën prej floriri, por nuk po e gjente dot. Pyeti Sonilën, por ajo tha se as ajo nuk e kishte parë. Bledi e pyeti Sonilën nëse shoqja e saj, Olga, kishte qenë atë ditë për kafe siç ishte plani dhe Sonila tha se po, kishte qenë. Bledi i tha Sonilës se ishte i sigurt që orën e kishte vjedhur Olga. Sonila tha se kjo ishte e pamundur, por Bledi insistonte. Bledi insistonte gjithashtu që Sonila ta merrte në telefon Olgën dhe t'i kërkonte që t'i kthente orën. Sonila nuk pranonte, por Bledi këmbëngulte dhe u zemërua. Sonila më në fund e mori në telefon Olgën dhe i tha se Bledit i kishte humbur ora dhe e pyeti nëse ajo e kishte parë kur ishte në shtëpinë e tyre. Olga tha se nuk e kishte farë idenë dhe dëgjoi Bledin që bërtiste dhe që thoshte që ishte i sigurt që orën e kishte vjedhur ajo. Olga i tha Sonilës se ndihej e ofenduar dhe mbylli telefonin. Bledi tashmë ishte i bindur se orën ia kishte vjedhur Olga dhe i tha Sonilës të mos e ftonte kurrë më atë në shtëpi. Bledi doli me shokët. Sonila qëndroi në shtëpi, pa ditur ç'të bënte. Ajo kishte besim te shoqja e saj,

por Bledi ndoshta kishte të drejtë. Ajo e dinte që Olga kishte vështirësi financiare dhe nuk ishte e sigurt se çfarë duhet të besonte dhe çfarë jo. Sonila vazhdoi të kërkonte orën e Bledit, por nuk e gjeti dot. Të nesërmen, Bledin e mori në telefon e ëma, e cila i tha se ia kishte gjetur orën. Të premten e kaluar, ai e kishte pasur në dorë dhe e kishte hequr kur kishte ndihmuar prindërit të prisnin një pemë në kopësht.

MATERIALI 4

Ushtrim: Identifikimi i stereotipeve (opsionale/ me dëshirë)

Materialet:

Flipchart

Markera

UDHËZIME

- *Trajneri i kërkon grupit që të rendisë karakteristikat mbi bazën e të cilave krijohen stereotipet dhe t'i shkruajnë përgjigjet në flipchart. Nëse është e nevojshme, trajneri bën edhe pyetje të tjera.* Përgjigjet janë si: raca, kombësia, origjina etnike, gjuha/ theksi, rajoni, identiteti gjinor, orientimi seksual, aftësia e kufizuar, pamja fizike (ngjyra e lëkurës, pesha, ngjyra e flokëve, tatuazhet, pirsing, veshja), profesioni, vendi ku jetojnë, origjina e familjes, statusi civil (beqar, i martuar, i divorcuar, prind me fëmijë por i pamartuar, çift pa fëmijë, çifte të pamartuar), kategoria social-ekonomike.
- *Për shembull, trajneri pyet për stereotipe negative në lidhje me këto kategori.* Trajneri jep edhe vetë disa shembuj, si: “gratë janë të dobëta”, “njerëzit e shëndoshë janë të sëmurë”, “njerëzit me shumë tatuazhe/pirsing janë kriminelë”, “aziatikët janë njerëz të nënshtruar”, “arabët janë agresivë”, “rumunët dhe bullgarët janë pijanecë”, “gratë përpiqen të mashtrojnë burrat”, “burrat homoseksualë janë imoralë”, “njerëzit me aftësi të kufizuara janë lypës”, “persona me histori të shëndetit mendor janë të prirur të bëjnë krime”, “personat me HIV janë të rrezikshëm”, “gratë e mbuluara janë të shtypura”, “gratë e pamartuara me fëmijë janë imorale”, “çiftet e martuar pa fëmijë janë egoistë”, “të varfrit kanë më shumë gjasa të vjedhin”.

Moduli 7: Programi i Rehabilitimit Social (3,5 orë)

Objektivat: Në fund të modulit, pjesëmarrësit:

- do të vënë veten e tyre nëpërmjet një ushtrimi në vend të personave me liri të kufizuar;
 - do të jenë në gjendje të bëjnë përkufizimin e rehabilitimit social;
 - do të jenë në gjendje të shpjegojnë arsyet e promovimit të rehabilitimit social për të burgosurit;
 - do të kuptojnë qëllimin e kujdesit social;
 - do të jenë në gjendje të përshkruajnë fushat e ndërhyrjes nga punonjësit socialë;
 - do të kuptojnë rëndësinë që ka bashkëpunimi midis sektorëve të ndryshëm për zbatimin e programeve ditore në institucion;
 - do të kuptojnë konceptin e Specialistit Kujdestar të Burgut;
 - do të familjarizohen me aktivitetet e programit ditor të regjimit të burgut, duke përfshirë aspektet rehabilituese.
-

1. Hyrje

Në këtë modul do të trajtojmë temën e rehabilitimit social të burgosurve dhe rolin e stafit të edukimit (punonjësit socialë, psikologët etj.) dhe sektorët e tjerë të institucionit, duke përfshirë stafin me uniformë, për promovimin e rehabilitimit social të burgosurve.

2. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe empatia (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Stafi i burgut punon me individë, liria e të cilëve është e ndaluar me ligj. Kjo është një situatë ku liritë dhe të drejtat kufizohen në mënyrë të ligjshme. Stafi i burgut është në vijën e parë të mbrojtjes së përditshme të drejtave të njeriut, duke i respektuar ato dhe duke promovuar rehabilitimin social të burgosurve. Për këtë, punonjësit e burgut duhet të tregojnë empati dhe duhet të jenë në gjendje ta vënë veten e tyre në vendin e personit të cilit i është privuar liria.

Shënim për trajnerin

Trajneri thotë: fillojmë me “Ushtrimin e humbjes”, ku ju e vendosni veten në vendin e personit të cilit i është privuar liria.

- *Kërkojini pjesëmarrësve të heqin çdo gjë nga tavolinat e tyre dhe të mos kenë asgjë mbi to, përveç një flete dhe një lapsi apo stilolapsi.*
- *Kërkojini pjesëmarrësve të shkruajnë numrat nga 1 deri në 5 në fletën e tyre.*
- *Shpjegojuni se do të lexoni pesë deklaratë dhe duhet t’u përgjigjen secilës deklaratë në fletën e tyre. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë person tjetër në sallë nuk do t’i shohë fletët e tyre - fletët nuk do të mblidhen. Fletët nuk do të përdoren as më vonë – ato janë prona e tyre personale.*

- Bëjeni këtë ushtrim ngadalë dhe kushtojini rëndësinë e duhur.
- Pjesëmarrësit duhet të ndjejnë ndikimin e plotë të këtij diskutimi.
- Lexoni një nga një deklaratat dhe thuajuni pjesëmarrësve të shkruajnë përgjigjet e tyre në fletë.
- Theksoni sërish faktin se fleta nuk do të ndahet me të tjerët.

1. Shkruani emrin e pronës personale apo të një objekti që keni në pronësinë tuaj që e doni më shumë. Mund të jenë paratë tuaja, shtëpia, makina, motorri, qeni, telefoni, laptopi, bizhuteritë, veshjet etj. Cila është ajo gjë që keni, e cila ka shumë rëndësi për ju? Shkruani përgjigjen në pikën 1.
2. Shkruani emrin e aktivitetit që ju pëlqen ta bëni më shumë në kohën tuaj të lirë. Mund të jenë daljet me miqtë apo çfarëdolloj aktiviteti tjetër. Çfarë ju pëlqen të bëni më shumë se gjithçka tjetër? Shkruajeni aktivitetin në pikën 2.
3. Shkruani aktivitetin e punës që ju pëlqen më shumë ose një aspekt të saj për të cilin jeni më shumë krenar. Shkruani aktivitetin ose aspektin në pikën 3.
4. Shkruani një gjë shumë konfidenciale rreth vetes tuaj që askush tjetër në botë nuk e di ose e di vetëm një person. Shkruani sekretin tuaj personal në pikën 4 (kujtojini grupit se askush nuk do ta shohë fletën e tyre përveçse vetë atyre).
5. Në pikën 5, shkruani emrin e një personi, shoqëria, dashuria dhe mbështetja e të cilit ka më shumë rëndësi se çdo gjë tjetër në botë.

Pasi të gjithë të kenë mbaruar, shpjegoni se tani do t'i riktheheni sërish listës. Gjatë kohës që i rikthehen deklaratave, pjesëmarrësit duhet të imagjinojnë sikur po përjetojnë atë çfarë po thonë.

1. Imagjinoni sikur ndodh diçka e tmerrshme dhe ju humbni të gjithë pasurinë materiale që doni më së shumti. Kurrë më nuk do ta shihni atë që keni shkruar në pikën 1. Me laps ose stilolaps, vini kryq në **pikën 1**.
2. Imagjinoni sikur për shkak të një fatkeqësie, të mos kishit më mundësi ta bënit sërish aktivitetin tuaj të preferuar të kohës së lirë. Me laps ose stilolaps, vini kryq në **pikën 2**.
3. Imagjinoni sikur, për shkak të së njëjtës fatkeqësie, të mos kishit më mundësi ta vazhdonit sërish punën tuaj dhe as të mos shijonit më kurrë përvojat e këndshme që ajo ka. Me laps ose stilolaps, vini kryq në **pikën 3**.
4. Imagjinoni sikur për shkak të të gjitha situatave të mësipërme, sekretin më konfidencial që kishit rreth vetes tuaj të merret vesh. Dhe çdokush tashmë e di atë që ti ke shkruar në pikën 4. Sekreti yt u bë informacion publik.

Me laps ose stilolaps, vini kryq në **pikën 4**.

5. Së fundmi, për shkak të të gjitha këtyre ndryshimeve (humbja e pronësive, e aktiviteteve të preferuara, e privatësisë, edhe personi që ju donit më shumë në botë ju lë përgjithmonë. Pra, personin që donit dhe i cili ishte burimi më i rëndësishëm i mbështetjes tënde, nuk do ta shohësh kurrë më. Me laps ose stilolaps, vini kryq në **pikën 5**.

Lini pjesëmarrësit për disa çaste në heshtje me qëllim që të ndjejnë vërtetë atë që

sapo thatë. Zakonisht, në këtë pikë, njerëzit janë disi të mërzhitur dhe të pikëlluar. Jepuni pak kohë të mendojnë rreth kesaj gjëje.

Tani, kërkojuni pjesëmarrësve të përshkruajnë me një fjalë ose me një frazë emocionet që po ndjenin. Shkruajini fjalët në tabelë.

Vazhdoni diskutimin e lirë derisa të shpalosen të gjitha idetë e mundshme. Lista mund të përfshijë fjalë të tilla si: trishtim, pikëllim, ndjenjë vetëvrasjeje, i pashpresë, i vetmuar, i mjerë, depresiv, i zemëruar, fajëson të tjerët, nuk ka arsye për të vazhduar jetën.

Kërkojuni pjesëmarrësve t'i hedhin një sy listës që kanë krijuar. Kërkojini të imagjinojnë se si mund të lidhen këto ndjenja me burgimin. Diskutoni lidhjet mes ushtrimit dhe privimit të lirisë. Kujtojini grupit se e kanë vënë veten e tyre në vend të një personi të burgosur dhe kanë mundur të përjetojnë emocione shumë të forta, me të cilat një person i tillë mund të jetë duke jetuar çdo ditë.

3. Rehabilitimi social i të burgosurve si qëllim i rëndësishëm i dënimit human dhe ligjor (60 minuta)

Shënim për trajnerin

Si fillim, trajneri bën një reflektim mbi atë se çfarë do të thotë termi i rehabilitimit social dhe flet për llojet e veprimeve dhe dispozitave që nevojiten për zbatimin efektiv të qëllimit të rehabilitimit në burgje.

Trajneri pyet grupin: “Cili është kuptimi i termit “rehabilitim social i të burgosurve”? Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë vijon:

Kontributi i trajnerit

Qëllimi dhe koncepti i rehabilitimit i referohet një fushe njohurish (me një grup vlerash, teorish, parimesh) dhe një qasje me *instrumente* për t'i ndihmuar të burgosurit të zhvillojnë një *kapital njerëzor* (aftësi, kapacitete, njohuri) dhe një *kapital social* (burimet në drejtim të rrjeteve shoqërore, si dhe marrëdhënieve pozitive brenda familjeve e komuniteteve më të gjera) që u nevojiten për të (ri)fituar vlerësimin në komunitetet e tyre. Termi *ri-integrim* i referohet atij procesi, i cili u mundëson (ish) të burgosurve, të përshtaten me jetën e përditshme të komunitetit falë të jetuarit të një jete pa krime dhe më të përmbushur, me kontribute pozitive për veten, të tjerët dhe për shoqërinë.

Shënim për trajnerin - Kërkojini grupit të shkruajnë, në mënyrë individuale, tre arsye për promovimin e reformimit personal dhe të rehabilitimit social të burgosurve (+/- 5 minuta). Më pas, kërkojini anëtarëve të grupit të ndajnë idetë e tyre dhe shkruajini të gjitha sugjerimit në tabelë.

Opsionale: vazhdoni me një diskutim në grup, 10 minuta

USHTRIM: Rehabilitimi social i të burgosurve

Detyrë: Mendoni rreth arsyeve të promovimit të reformimit personal dhe të rehabilitimit social të të burgosurve.

Shkruani tre arsye:

- 1.....
- 2.....
- 3.....

Kontributi i trajnerit

Argumentet mbrojtëse dhe mbështetëse të promovimit të reformimit personal dhe rehabilitimit social të të burgosurve mund t'u referohen:

1) argumenteve normative etike: këto argumente u referohen ndjenjave të solidaritetit, motiveve humaniste, etikës ligjore, teorisë penale ndëshkimore (retributiviste), sundimit të ligjit, të drejtave njerëzore dhe parimeve të vendosura me ligj. Këto argumente janë me natyrë *etike-normative* pasi i referohen plotësisht vlerave morale/etike dhe parimeve themelore normative të lirisë individuale, dinjitetit dhe barazisë — themelet më ideologjike të shtetit demokratik në bazë të sundimit të ligjit. Vlerat dhe parimet e dënimit ligjor në bazë të sundimit të ligjit pohojnë se promovimi i reformimit personal dhe i rehabilitimit social të burgosurve është *në thelb i mirë* ose i vlefshëm në vetvete.

2) argumenteve utilitariste (ose instrumentale): kujdesi ndaj rehabilitimit social të burgosurve përmes veprimtarive të planifikimit të dënimit që ndihmojnë në mirëqenien dhe zhvillimin personal të burgosurve nuk kërkohet vetëm për arsye morale apo normative. Ekziston një numër në rritje studimesh që tregojnë *dobishmërinë* e adresimit të mirëqenies dhe rehabilitimit social të burgosurve përmes planifikimit të dënimit, pasi i shërben *qëllimit të uljes së krimit* duke zvogëluar rrezikun e sjelljes së keqe gjatë dënimit dhe të ripërsëritjes së veprës pas lirimit.

Këto studime mbështesin *argumentet utilitariste (ose instrumentale)* që e shohin rehabilitimin e të burgosurve si mjet për arritjen e qëllimit të krijimit të *instrumenteve* sa i përket uljes së krimit dhe rritjes së sigurisë së shoqërisë.

Një **argument themelor etik-normativ** është se ***Për shkak se dënojmë, Ne duhet të rehabilitojmë.***

Arsyetimi i këtij argumenti është si më poshtë:

- Autorët dënohen për vepra penale pasi gjyqtari vendos se ata kanë zgjedhur me vetëdije të kryejnë krime, ndërsa si agentë të arsyeshëm moralë me *aftësi të përgjegjshme morale*, ata kanë mundësi të mirëfillta që t'i arrijnë qëllimet e tyre në mënyra të tjera të ndryshme nga kryerja e veprave penale apo krimi.
- Në dënimin ligjor retributivist, supozimi se autori ka personalitet moral dhe dinjitet si qenie njerëzore plotësisht e zhvilluar, e lirë dhe e aftë për sjellje morale e të përgjegjshme, e bën autorin subjekt të përshtatshëm për gjykim nga gjyqtari dhe për marrjen e dënimit ligjor.

- Kur, në rastin e një çrregullimi mendor, ekzistojnë prova për **mungesë** të lirisë dhe të aftësisë për sjellje të përgjegjshme morale, atëherë dënimi i autorëve nuk lejohet me dënimin ligjor retributivist në bazë të sundimit të ligjit.

Shënim për trajnerin

Trajneri përdor Teknikën me pyetje dhe përgjigje, në të cilën pjesëmarrësit u përgjigjen me gojë pyetjeve të bëra nga trajneri.

Pyetje: *Trajneri pyet grupin: Kur një autor i dënuar dërgohet në burg nga gjyqtari, a do të thotë kjo se gjatë ekzekutimit të masës, ai humb dinjitetin e tij human dhe statusin si qenie plotësisht e zhvilluar dhe e lirë njerëzore me aftësi për sjellje të përgjegjshme morale?*

Përgjigjja: JO

Kontributi i trajnerit

Dënimi konsistent ligjor retributivist, në bazë të sundimit të ligjit, nënkupton se edhe gjatë fazës së ekzekutimit të masës, të burgosurit **duhet** ta ruajnë statusin dhe aftësinë e tyre të sjelljes si qenie plotësisht të zhvilluara dhe të përgjegjshme njerëzore.

Kontributi i trajnerit

Nëse përgjigjja është JO, atëherë do të thotë se ne kemi detyrimin ta ndihmojmë të burgosurin që të *ruajë dinjitetin e tij njerëzor* dhe personalitetin/sjelljen morale, si dhe të mos e cenojë kapacitetin e tij për t'u zhvilluar përmes kontributeve pozitive për veten, të tjerët dhe shoqërinë, si qenie njerëzore të pavarura e moralisht të përgjegjshme.

Pyetje: *Si mund ta ndihmojmë të burgosurin gjatë dënimit për zhvillimin e tij si qenie njerëzore e pavarur dhe e përgjegjshme?*

Kontributi i trajnerit

Përgjigjja: Vetë humbja e lirisë, pa asnjë faktor tjetër, përmban dëme të konsiderueshme të qëllimshme e të paqëllimshme ose *humbje në cilësinë e jetës* dhe të mundësisë për zhvillim pozitiv. Mundësitë për zhvillim pozitiv të burgosurit përmes ndërveprimit social me persona të tjerë të rëndësishëm, të pasurit e të mirave/shërbimeve materiale dhe të privatësisë, mundësitë për të fituar një pagë normale dhe kënaqësi përmes një pune, përmbushja e nevojës për autonomi, zhvillimi personal dhe rekreacioni, kufizohen jashtë mase shumë nga heqja e lirisë së një personi të burgosur. Duke pasur parasysh humbjet në cilësisë e jetës dhe kriteret e dënimit ligjor retributivist të moscënimit të aftësisë së të burgosurit për t'u zhvilluar dhe për t'u sjellë si qenie njerëzore plotësisht e zhvilluar dhe moralisht e përgjegjshme, ne kemi edhe **detyrimin moral**:

- Të luftojmë efektet negative të burgimit përmes kushteve njerëzore, të respektueshme, më pak të dëmshme dhe minimizimin e izolimit, u mundëson të burgosurve të jetojnë sa më shumë që të jetë e mundur, si persona të rregullt, moralisht të *përgjegjshëm* në fushat e jetës, ku përfshihet dhe ndërveprimi me persona apo elementë të tjerë të rëndësishëm si (familja) puna, të ardhurat, privatësia, mirëqenia, zhvillimi personal, koha e lirë etj. **Parimi i normalitetit**, nënkupton që, përveç burgimit të tij, personi i dënuar ruan të gjitha të drejtat e tjera themelore apo të drejtat civile në fushat e lartpërmendura, të cilat nuk hiqen shprehimisht apo me nënkuptime të nevojshme.

- Të adresojmë rehabilitimin social të burgosurve duke promovuar reformimin e tyre personal dhe rritjen e aftësive e të mundësive të tyre për të jetuar një jetë pa krime pas lirimit, me qëllim arritjen e kontributeve pozitive për veten, të tjerët dhe shoqërinë. Nëse shkelësit e ligjit dalin nga burgu në një gjendje ku kapacitetet e tyre për t'u ri-integruar në shoqëri, për të zbatuar ligjin dhe për të qenë qytetarë *të përgjegjshëm* dëmtohen rëndë, atëherë ndëshkimi vazhdon edhe pas lirimit tyre. Situata me “*ndëshkim ekstra, të pamëritueshëm pas dënimit*” bie në kundërshtim edhe me parimin retributivist **të proporcionalitetit** (dënimi duhet të jetë në proporcion me seriozitetin e krimit të kryer) dhe me qëllimet e dënimit ligjor e njerëzor sipas shtetit të së drejtës.
- Prandaj, sipas shtetit të së drejtës, parimi është se e vetmja e drejtë që kufizohet nga një gjyqtar i gjykatës në procesin gjyqësor për dënimin, është heqja e lirisë. Dënimi **është** kufizimi i lirisë. Kjo nënkupton se të gjitha të drejtat e tjera për jetën, integritetin fizik dhe psikologjik (moral), për lirinë e shprehjes dhe besimin, për t'u angazhuar në punë, për të kontaktuar me persona të tjerë dhe të drejtat politike duhet të respektohen.
- Kjo njihet gjithashtu si: ***“Njerëzit dërgohen në burgje si formë ndëshkimi, dhe jo për të qenë objekt ndëshkimesh të tjera brenda tyre.”***
- Përveç kësaj, motoja tjetër është: ***Meqë ndëshkojmë, duhet të rehabilitojmë të dënuarit!!*** Ndëshkimi dhe rehabilitimi nuk janë dy qëllime të kundërta, ato janë dy anë të së njëjtës monedhë....

Shënim për trajnerin

Pyesni grupin: Cilat janë veprimet dhe dispozitat që i nevojiten burgut dhe sistemit të burgjeve në përgjithësi për të zbatuar në mënyrë efektive objektivin e rehabilitimit të të burgosurve?

Trajneri diskuton me grupin dhe shkruan përgjigjet në tabelë.

Pas renditjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh sa më poshtë vijon:

Kontributi i trajnerit

Veprimet dhe dispozitat e lidhura me rehabilitimin e të burgosurve përfshijnë:

- adaptimi i një kuadri ligjor të shëndoshë dhe të bazuar tek të drejtat e njeriut;
- mjedis mbështetës burgu (cilësia e marrëdhënieve staf – i burgosur dhe regjimi);
- sistemi i planifikimit të dënimeve hartuar nga punonjësit socialë (përgjegjësit e çështjeve);
- menaxhimi i çështjeve, këshillim individual dhe social për çështjet;
- arsimimi, udhëzimi profesional dhe programet e trajnimit;
- lehtësimi i kontakteve me botën e jashtme (familja, komuniteti);
- puna në mjedisin e brendshëm të burgut, ndërmjetësim për punësim
- lirim gradual;
- dispozitat për kujdesin shëndetësor fizik dhe mendor;
- partneritetet bashkëpunuese me komunitetet dhe agjencitë e jashtme etj.

4. Roli i kujdesit social në burgje dhe paraburgime (15 minuta)

Kontributi i trajnerit

Qëllimi i kujdesit social në institucion është:

1. Trajtimi human i të dënuarve bëhet në përshtatje me kapacitetin, arsimimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë.
2. Për realizimin e rehabilitimit social të dënuarve, IEVP-ja duhet të verë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e kontakteve me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e ri-integrimit shoqëror pas lirit.

Disa nga fushat e ndërhyrjes së punonjësve të kujdesit social janë:

- Vëzhgimi i personave të dënuar me qëllim evidentimin e nevojave të saj/tij.
- Hartimin e një programi individual të trajtimit të dënuarve, i cili përfshin aktivitete të ndryshme në përputhje me nevojat e tij/saj. Programi individual diskutohet paraprakisht me të dënuarin.
- Vlerësimi i sjelljes së të dënuarve nën kujdesin e tyre.
- Hartimi i programeve ditore në bashkëpunim me personelin tjetër të institucionit.
- Realizimi i disa veprimtarive të programit ditor si arsimimi, këshillime në grup. Shërbimi bibliotekar, veprimtari që ndërtojnë aftësitë sociale tek personat që kanë nën kujdes, trajtimi individual psikologjik etj.
- Përgatitja e të dënuarve për lirim dhe bashkëpunimi me botën e jashtme dhe aktorë të ndryshëm për ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri pas lirit.

5. Bashkëpunimi i stafit multi-sektorial për zbatimin e programeve ditore në institucion (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Rregullorja Evropiane e Burgjeve ²⁴ përcakton se:

72.3 Detyrat e stafit shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe duhet të marrin parasysh nevojën e lehtësimit të ri-integrimit të burgosurve në shoqëri pas përfundimit të dënimit përmes programeve të kujdesit dhe ndihmës pozitive.

Sistemi i burgjeve ka për mision: sigurinë, trajtimin human dhe ri-integrimin e personave në kujdesin e tij.

Shumica e personelit të burgjeve përbëhet nga sektori me uniformë/ punonjësit e sigurisë. Arsyeja kryesore për këtë është sepse detyra kryesore e një burgu është: siguria, t'i pengosh të dënuarit të arratisen, të mbrosh shoqërinë. Si pasojë e kësaj, merren të gjitha llojet e masave paraprake të veçanta, në mënyrë materiale dhe personale. Të gjithë dimë se burgjet kanë mure të larta; kamera sigurie; pajisjet e detektimit; hekurat, gardhet etj.

24 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

Stafi me uniformë është i trajnuar për të shmangur arratisjet, jo vetëm nga ana psikologjike, por edhe nga ana materiale në përdorimin e armëve, prangave, shkopinjve të gomës etj. Përveç kësaj, ekzistojnë rregulla të qarta dhe rigoroze dhe ndonjëherë regjime të sigurisë së lartë, të cilët kufizojnë lirinë dhe lëvizshmërinë e individit deri në 100%.

Por koha e qëndrimit në burg është e kufizuar. 98% prej tyre do të lirohen nga burgu në një moment të caktuar. Të dënuarit kanë gjithashtu nevojat e tyre fizike dhe sociale. Ata kanë edhe probleme që lidhen me familjet e tyre, me ndjenjën e fajit, ata mund të kenë humbur gjithçka, mund të kenë probleme mjekësore etj.

Duke u nisur nga sa më sipër sektori i edukimit ka si qëllim dhënien e ndihmës lidhur me këto probleme, dhënien e përgjigjeve të duhura pyetjeve të ngritura nga të dënuarit që lidhen drejtpërdrejtë me jetën e tyre.

Është evident fakti që ekziston një lloj “kontradikte” e brendshme në detyrat e punës së sektorit të sigurisë dhe sektorit të edukimit. Fokusi i sektorit të sigurisë është siguria, mbrojtja e shoqërisë; dhe fokusi i sektorit të edukimit është personi i privuar nga liria dhe problemet e tij. Në praktikën ditore kjo situatë kontradiktore shkakton shumë probleme, të cilat në të vërtetë nuk janë të qëllimshme nga asnjëra palë.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit

- *të japin shembuj problemesh apo konfliktesh të mundshme mes sektorit të social apo edukimit dhe sektorit të sigurisë.*
- *të diskutojnë rolin e sigurisë dinamike dhe të përgjegjësisë së përbashkët të dy sektorëve për krijimin e një klime humane, të sigurt dhe konstruktive burgimi.*

Ushtrim

Shembujt e problemeve/konfliktëve të mundshme mes sektorit social apo edukimit dhe sektorit të sigurisë.

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

Siguria dinamike

Që në momentet e para, është përgjegjësi e autoriteteve të krijojnë një situatë ku konfliktet/kontradiktat të kufizohen në maksimumin e mundshëm. Së pari, kjo mund të realizohet– dhe është kryer tashmë në shumë vende të botës- nëpërmjet forcës së ligjit, rregulloreve dhe procedurave të brendshme të institucionit. Të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të dënuarve duhet të jenë të qarta dhe të njohura nga të gjithë punonjësit në burgje. Drejtuesit e burgjeve janë përgjegjës për zbatimin e efektshëm të tyre.

Garancia e dytë për një praktikë të mirë është trajnimi: në trajnimin bazë për personelin me uniformë të drejtat dhe detyrimet e të dënuarve dhe të stafit duhet të

përbëjnë pjesën më thelbësore të trajnimit. Personeli me uniformë duhet të trajnohet për të pranuar specialistët/ personelin civil në institucion dhe duhet të mësojë se si të bashkëveprojë me ta; punonjësit me uniformë duhet të mësojnë se cili është pozicioni i tyre i punës; duhet të mësojnë rëndësinë e ndihmës së përshtatshme psikologjike, mjekësore dhe sociale, si edhe se ç'nënkupton kjo edhe për vetë sigurinë e tyre gjithashtu. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, ata mësojnë se ç'nënkupton kjo për shoqërinë: lirim i përshtatshëm i të dënuarve dhe ulja e përsëritjes së krimit e bën shoqërinë më të sigurt.

Në të njëjtin mënyrë, edukatorët kanë nevojë për trajnim: ata duhet të mësojnë se çfarë nënkupton siguria, pse është ajo e nevojshme dhe se siguria është detyra kryesore e stafit me uniformë. Kjo gjithashtu e bën shoqërinë më të sigurt.

Në këtë kontekst, pranimi dhe respekti reciprok mes sektorëve, janë fjalët kyçe për një bashkëpunim efektiv dhe realizim të misionit të burgjeve.

6. Specialisti Kujdestar i Burgut (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Me qëllim që të njiheni me rolin më aktiv të stafit me uniformë në rehabilitimin social të burgosurve, do të marrin pak kohë të shtjellojmë nocionin e **“specialistit kujdestar të burgut”**.

Sa i përket nocionit të “kujdesit” në burg, një pjesë pohojnë fuqimisht se kujdesi duhet të jetë fokusi i punës së specialistit të burgut për të mirën e të burgosurve dhe të punonjësve (Tait, 2008)²⁵. Të tjerë nuk besojnë se në burg mund të zhvillohen marrëdhënie të mirëqena, të respektueshme dhe mbështetëse, pasi burgu është një institucion në thelb detyrues dhe i orientuar drejt kontrollit. Pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme rreth kujdesit, në disa vende, ai konsiderohet si vlera qendrore e shërbimit të burgjeve përkrah objektivave të tjera të burgimit si kontrolli dhe siguria.

Kujdesi mund të lidhet me përgjegjësi të tjera të punonjësit: ai i ndihmon të burgosurit të përballojnë burgimin, mbështet ruajtjen e rendit dhe mund të jetë ndihmesë për procesin e ndryshimit të sjelljes dhe të shkëputjes. Një përkufizim i pranuar për kujdesin është: *“kujdesi i përgjigjet (ndihet, nëse nuk shprehet) nevojës së një personi dhe promovon ndryshimin pozitiv dhe mirëqenien e personit që merr kujdesin”*. (Tait, 2008)

Sidoqoftë, të vepruarit me qëllime të mira nga ana e “kujdestarit” nuk përbën “kujdes”, nëse personi i cili e merr kujdesin nuk e përjeton ndjesinë e të qenit “nën kujdes” nga personi që kujdeset për të. Brenda kontekstit të kujdesit, është e rëndësishme të ngrihet pyetja se si përjetohet kujdesi dhe çfarë do të thotë kujdes për njerëzit, veçanërisht, për të burgosurit, kur ata ndërveprojnë me personelin e burgut.

25 Tait, S. (2008) Kujdesi dhe oficeri i burgut: përtej “gardianëve” dhe “arinjve të kujdesit”. Gazeta e Shërbimit të Burgut. Botimi 180.

Shënim për trajnerin

Kërkojini anëtarëve të grupit të lexojnë dhe të analizojnë rastin vijues të një të burgosuri.

USHTRIM: Rasti i të burgosurit Peter

Detyrë: Lexoni rastin më poshtë dhe nënvizoni aspektet e rëndësishme

Peter është në burg dhe ka historik rastesh me sjellje jo të mirë në një sektor. Ai është i ulur në shtrat në qelinë e tij. Dera e qelisë së tij është e hapur pasi është koha rekreative, gjatë të cilit të burgosurit mund të lëvizin lirisht në sektor. Koha rekreative thuhet po mbaron dhe për pjesën tjetër të mbetur të pasdites, mbrëmjes dhe natës, të burgosurit do të mbyllën në qelinë e tyre. Peter është shumë i mërzhitur për shkak të një bisede telefonike me bashkëshorten e tij dhjetë minuta më parë. Ajo i tha se ndihet e frikësuar pasi është kërcënuar bashkë me fëmijët e saj nga një prej miqve të tij të vjetër kriminelë. Ndërkohë, vjehrrit e tij kanë nisur të ushtrojnë presion mbi vajzën e tyre që të divorcohet. Ajo thotë se ka vuajtur shumë gjatë gjithë kësaj situatë dhe se divorci mund të ishte zgjidhje më e mirë. Ajo është në panik dhe pas fyerjesh e qortimesh të ndërsjellta, ata mbyllën bisedën.

Peter nuk di si të veprojë tani. Ai është i dëshpëruar dhe i acaruar.

Vetëm ditën e nesërme pasdite, atij do t'i jepet mundësia t'i kërkojë një këshillë dikujt dhe të marrë në telefon bashkëshorten e tij. Për më tepër, nuk ka mjaftueshëm para për të blerë një kartë të re telefoni. Kjo e bën atë të ndihet edhe më i pashpresë, më i acaruar dhe i shqetësuar.

Një punonjës burgu, i cili është gati duke ikur, shfaqet në derën e tij.

Punonjësi i burgut është me nxitin pasi ai, bashkë me kolegët e tij, tashmë janë shumë orë pas orarit të planifikuar. Ai e dallon se Peter është i mërzhitur dhe dyshon se ka një problem.

Çfarë aspektesh të rëndësishme keni identifikuar?

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....
- 5.....

Kontributi i trajnerit

Trajneri i kërkon grupit të diskutojnë dhe të ndajnë me të tjerët analizën e tyre të rastit (5 deri në 10 minuta)

Shënim për trajnerin: Vazhdimi i ushtrimit të mësipërm. Trajneri e fton grupin të shkruajnë se si do të reagonit rreth situatës së përshkruar më sipër. Fillimisht, në mënyrë individuale, pastaj në diskutim në grup.

USHTRIM: Profesionisti kujdestar

Pyetje: Si do të reagonit ndaj Peter si punonjës burgu?

- 1.....
- 2.....
- 3.....

Kontributi i trajnerit

Studimet tregojnë se ndërveprimet e kujdesit mes stafit të burgut dhe të burgosurve i kanë themelet në marrëdhënie të karakterizuara nga respekti, drejtësia dhe socializimi (Tait, 2008). Këtu përfshihen sjelljet e përditshme, si “mirëmëngjes”, një bashkëbisedim i zakonit rreth familjes, sportit ose zonës lokale dhe integrimi fizik me të burgosurit (lojëra në pishinë, bisedime në sektor). Ndërveprimet e kujdesit demonstrojnë ndjeshmëri institucionale ose mirëkuptim rreth kufizimeve infrastrukturore me të cilat ndeshen të burgosurit, si mbipopullimi, problemet e mensës, dështimi i sistemeve për të kontaktuar me miqtë, familjet apo me persona të tjerë të rëndësishëm (punonjësit). Këto ndërveprime u treguan të burgosurve se punonjësit i shohin ata me vlerë dhe status të barabartë moral.

Me kalimin e kohës, kjo lloj marrëdhënie krijoi *besim*, duke u mundësuar të burgosurve t’u afrohen punonjësve apo të pranojnë afrimin nga ana e tyre dhe lehtësoi shprehjen e problemeve emocionale dhe praktike. Afrimi shprehës dhe domethënës i punonjësit manifestohet me diskrecion e interes, duke ofruar edhe ndihmë praktike e praninë e tij afektive. Përjetimi i ndjenjës se po dallohesh dhe nuk mbetesh në hije, sensi i sigurisë, veprimet dhe vetëvendosja janë karakteristika jashtëzakonisht vendimtare, të cilat mbeten të paprekuara gjatë ndërveprimeve përkujdesëse.

Ndërveprimet e kujdesit lehtësojnë ndjesitë e pafuqisë, izolimit dhe pavlefshmërisë, që krijohen nga mjedisi i burgut. Ato nxisin sjelljet bashkëpunuese të burgosurve dhe ringjalljen e shpresës për të ardhmen. Për të burgosurit, “mungesa e kujdesit” nënkupton se po trajtohen me indiferencë, po trajtohen me status e vlerë të ulët morale dhe në mënyrë të padrejtë. “Mungesa e kujdesit” priret ta intensifikojë nevojën (zemërimin, mungesën e shpresës, humorin e keq, izolimin etj.) më shumë sesa ta lërë atë të papërbushur.

Punonjësit e burgjeve kanë qasje të ndryshme ndaj kujdesit:

Kujdestarët e vërtetë, Kujdestarët e kufizuar dhe Punonjësit tradicionalë mund ta përfshijnë ofrimin e kujdesit dhe ruajtjen e sigurisë dhe rendit (Tait, 2008). Ata pranojnë se përgjigjja ndaj nevojave të burgosurve është komponent i rëndësishëm për ruajtjen e paqes dhe për promovimin e një sjelljeje më bashkëpunuese dhe konstruktive të burgosurve. Punonjësit *konfliktues* e kanë të vështirë ta përfshijnë kujdesin në sjelljen e tyre dhe në sigurinë e kontrollit, si dhe priren ta konceptualizojnë përkujdesjen si “mësimi i të burgosurve” se si të bëhen njerëz më të mirë. Për ata, ofrimi i kujdesit kushtëzohet nga respekti dhe sjellja e të burgosurve “që meritojnë kujdes”.

7. Familjarizimi me programet e rehabilitimit dhe përshtatja e tyre (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Koha e qëndrimit në burg është sa e gjatë, aq edhe e shkurtër. Në një moment të caktuar shumica e të dënuarve do të lirohen nga burgu dhe shumë shpejt do të përballen me probleme sociale nga më të ndryshmet, si: probleme familjare, ekonomike pasi mund të ketë humbur gjithçka; probleme me ndjenjën e fajit etj.

Duke iu referuar sa më sipër, sektori i edukimit duhet të kuptojë rëndësinë e zhvillimit dhe të zbatimit të programeve të rehabilitimit social, rritjen e aftësive sociale të të dënuarit dhe përgatitjen e tyre për jetën e lirë.

Personeli i edukimit duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se duhet të përfshihet në problemet e të dënuarve, por në një distancë të caktuar; ata nuk duhet të ndiejnë keqardhje për të dënuarin, por duhet ta kuptojnë atë. I dënuari gjithmonë është përgjegjës për krimin e kryer dhe sjelljen e tij, si dhe për mënyrën si do t'i përdorë mundësitë dhe lehtësirat që i ofron institucioni.

7.1 Programe ditore të mirëdetajuara (Shih Shtojcën me MATERIALIN 2)

Me programe ditore nënkuptojmë të gjithë veprimtarinë e të dënuarve gjatë ditës, nga mëngjesi/zgjimi dhe deri në mbylljen e aktivitetit.

Është shumë e rëndësishme më parë njohja e këtij programi nga personeli i institucionit dhe më pas nga të gjithë të dënuarit. Më poshtë do të njihemi me një model të thjeshtë të programit ditor/javor që mund të zbatohet në një institucion shqiptar të burgimit. Suksesi i realizimit të tij në mënyrë efektive varet nga bashkëpunimi mes sektorëve të institucionit.

Punonjësit më uniformë mund të marrin pjesë në realizimin e disa veprimtarive të tilla si: sporte të ndryshme, aktivitete të ndryshme argëtuese, palestër, punë në punishte etj.. Puna në burgje është pjesë e programit ditor/javor në institucion dhe ndihmon në rehabilitimin e të dënuarve dhe rikthimin e tyre në shoqëri. Puna në paraburgim është një mundësi për të paraburgosurit, ndërsa në burgje duhet të jetë pjesë e programit ditor të institucioneve.

Puna organizohet me turne paradite dhe pasdite nga 4 orë secili dhe gjatë këtij aktiviteti, përveç specialistëve të profesioneve të ndryshme, një rol të rëndësishëm në drejtimin dhe mbikqyrjen e të dënuarve luajnë edhe punonjësit me uniformë në institucion.

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

USHTRIM: Rasti i të burgosurit Peter

Detyrë: Lexoni rastin më poshtë dhe nënvizoni aspektet e rëndësishme

Peter është në burg dhe ka historik rastesh me sjellje jo të mirë në një sektor. Ai është i ulur në shtrat në qelinë e tij. Dera e qelisë së tij është e hapur pasi është koha rekreative, gjatë të cilit të burgosurit mund të lëvizin lirisht në sektor. Koha rekreative thuhet se po mbaron dhe për pjesën tjetër të mbetur të pasdites, mbrëmjes dhe natës, të burgosurit do të mbyllën në qelinë e tyre. Peter është shumë i mërzhitur për shkak të një bisede telefonike me bashkëshorten e tij dhjetë minuta më parë. Ajo i tha se ndihet e frikësuar pasi është kërcënuar bashkë me fëmijët e saj nga një prej miqve të tij të vjetër kriminelë. Ndërkohë, vjehrrit e tij kanë nisur të ushtrojnë presion mbi vajzën e tyre që të divorcohet. Ajo thotë se ka vuajtur shumë gjatë gjithë kësaj situatë dhe se divorci mund të ishte zgjidhje më e mirë. Ajo është në panik dhe pas fyerjesh e qortimesh të ndërsjellta, ata mbyllën bisedën.

Peter nuk di si të veprojë tani. Ai është i dëshpëruar dhe i acaruar.

Vetëm ditën e nesërme pasdite, atij do t'i jepet mundësia t'i kërkojë një këshillë dikujt dhe të marrë në telefon bashkëshorten e tij. Për më tepër, nuk ka mjaftueshëm para për të blerë një kartë të re telefoni. Kjo e bën atë të ndihet edhe më i pashpresë, më i acaruar dhe i shqetësuar.

Një punonjës burgu, i cili është gati duke ikur, shfaqet në derën e tij.

Punonjësi i burgut është me nxitin pasi ai, bashkë me kolegët e tij, tashmë janë shumë orë pas orarit të planifikuar të punës. Ai e dallon se Peter është i mërzhitur dhe dyshon se ka një problem.

Çfarë aspektesh të rëndësishme keni identifikuar?

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....
- 5.....

MATERIALI 2

Model programi ditor

Poshtëshënuar gjeni një shembull të një programi ditor, në të cilin është e përfshirë edhe puna.

Programi ditor i sektorit A (të rriturit)

E hënë

08.30 – 10.30 Palestër (15 vetë) Futboll (15 vetë)

09.00 – 10.00 Në godinën F (kurse saldator, hidraulik, kopshtar)

10.00 – 11.00 Kurse kompjuteri

10.00 – 11.55 Palestër

11.30 – 12.30 Biblioteka (kati 2)

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 16.00 Ajrim

17.00 – 19.00 Aktivitete të përbashkëta

16.00 – Regjim

19.30 – 22.00 Aktivitete në dhomë

E martë

08.30 – 10.00 Aktivitete sportive (futboll dhe palestër)

10.10 – 11.45 Palestër

11.00 – 12.30 Dushe (bibliotekë)

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 15.00 Palestër

14.00 – 15.00 Dreka

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

E mërkurë

08.30 – 10.00 Palestër (15 vetë) Futboll (15 vetë)

10.10 – 11.45 Palestër (15 vetë)

10.00 – 11.00 Orë fetare

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 15.00 Palestër (11 vetë)

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

E enjte

08.30 – 10.00 Palestër (15 vetë) Futboll (15 vetë)

09.00 – 10.00 Në godinën F (kurse saldator, hidraulik, kopshtar)

10.00 – 11.00 Kurse kompjuteri

10.10 – 11.45 Palestër (15 vetë)

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 15.00 Palestër (11 vetë)

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

E premte

08.30 – 10.00 Palestër (15 vetë)

09.10 – 11.45 Palestër (15 vetë)

10.00 – 13.00 Dushe

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

E shtunë

08.00 – 12.00 Ajrim

09.00 – 10.30 Ndeshje futboll

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

E diel

08.00 – 12.00 Ajrim

12.30 – 13.00 Dreka

14.00 – 16.00 Ajrim

16.00 – Regjim

Programi ditor i sektorit D (të miturit, 18-21 vjeçarët, të rriturit)

E hënë

08.30 – 12.00 Ajrim (në bokse të veçanta sipas grupmohave)
09.00 – 10.00 Kurse kompjuteri (të miturit)
10.00 – 11.00 Kurse (saldator, hidraulik, kopshtar) të rriturit
11.00 – 12.00 Kurse (saldator, hidraulik, kopshtar) të miturit. Të rriturit kurs kompjuteri.
12.10 – 13.20 Futboll (12 vetë) të rriturit
12.10 – 13.20 Palestër të miturit
13.00 – 13.30 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

E martë

08.00 - 12.00 Ajrim në bokse të veçanta sipas grupmohave
10.00 – 11.45 Në sektorin D lojëra tavoline të rritur
12.15 – 13.15 Palestër (15 vetë; 18-21 vjeçarët)
12.15 – 13.15 Futboll (14 vetë minorenët)
13.00 – 13.30 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

E mërkurë

08.30 – 12.00 Ajrim
10.15 – 11.15 Lojëra tavoline të rritur në sektorin D
10.00 – 11.45 Punë artistike minorenët
10.00 – 11.00 Orë fetare
12.15 – 13.30 Futboll (18-21 vjeçarët)
12.15 – 13.30 Palestër dhe bibliotekë (të rriturit në sektorin D)
13.30 – 14.00 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

E enjte

08.30 – 12.00 Ajrim
09.00 – 10.00 Kurse kompjuteri
10.00 – 11.00 Kurse (saldator, hidraulik, kopshtar) të rriturit
11.00 – 12.00 Kurse (saldator, hidraulik, kopshtar) të miturit. Të rriturit kurs kompjuteri.
12.15 – 13.30 Futboll, të rriturit. Sallë force të miturit. Bibliotekë 18-21 vjeçarët.
13.30 – 14.00 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

E premte

08.30 – 12.00 Ajrim
10.10 – 11.45 Lojëra tavoline të rriturit në sektorin D
10.10 – 11.30 Të miturit, punime artistike
11.30 – 12.30 Bibliotekë të miturit
12.15 – 13.25 Palestër të rriturit
12.15 – 13.25 Futboll (të miturit; bibliotekë)
13.30 – 14.00 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 Regjim

E shtunë

08.00 - 12.00 Ajrim në bokse sipas grupmohave
09.00 – 10.30 Ndeshje futbollit
12.30 – 13.00 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

E diel

08.00 – 12.00 Ajrim në bokse sipas grupmohave
12.30 – 13.00 Dreka
14.00 – 16.00 Ajrim
16.00 – Regjim

Moduli 8: Teknikat për zgjidhjen e një krize pa përdorimin e forcës (3.5 orë)

Objektivat: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të jenë në gjendje të përshkruajnë se si manifestohet konflikti dhe dhuna në burgje;
- do të jenë në gjendje të përshkruajnë se nga vijnë konfliktet dhe dhuna në burgje;
- do të jenë në gjendje të shpjegojnë tre metodat kryesore të reduktimit dhe parandalimit të dhunës në burg;
- do të dinë si të menaxhojnë të burgosurit e vështirë dhe agresivë nëpërmjet teknikave efektive të komunikimit;
- do të kenë praktikuar teknikat jo të dhunshme të komunikimit.

1. Hyrje

Në këtë Modul do të reflektojmë pak mbi natyrën dhe shkaqet e konflikteve dhe dhunës në burgje dhe për metodat apo strategjitë efektive të reduktimit ose parandalimit të konfliktit dhe dhunës. Për më tepër, do të diskutojmë edhe teknikat e trajtimit efikas të trajtimit të burgosurve të vështirë.

2. Konfliktet dhe dhuna në burgje (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Dhuna në burgje manifestohet si:

- Dhuna e të burgosurve (ose dhuna mes vetë të burgosurve, sulmet mes tyre)
- Dhuna mes të burgosurve dhe stafit (sulmet ndaj anëtarëve të stafit)

Luftimet mes të burgosurve - përleshjet dhe sulmet - janë kulmi i konflikteve që lindin mes të burgosurve.

Shënim për trajnerin

*Trajneri i kërkon grupit të diskutojë dyshe-dyshe nga vjen **dhuna midis të burgosurve**.*

USHTRIM Dhuna mes të burgosurve

Nga vjen dhuna mes të burgosurve?

Shkruani disa aspekte:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Pas këtij ushtrimi, trajneri përmbledh sa më poshtë:

Temat e mëposhtme ndihmojnë të shpjegohet se nga vjen dhuna midis të burgosurve:

Struktura dhe faktorët mjedisorë: mundësitë e kufizuara në të mira dhe shërbime në burgje krijojnë konkurrencë dhe konflikte mes të burgosurve. Për shembull, nëse në njërin seksion të burgut priset telefoni, mund të lindin mosmarrëveshje. Reagimet ndaj konfliktit ndikohen edhe nga mjedisi. Rreziku i shfrytëzimit nga dikush që do të përfitojë prej teje është shqetësim i përhapur gjerësisht. Ekziston një cikël rreziku: frika e të burgosurve për sigurinë e tyre dhe mënyra se si e trajtojnë ata frikën e tyre rrit gjatat e lindjes së konflikteve, luftimeve dhe sulmeve.

Rreziku i viktimizimit, për shembull me anë të vjedhjes së pronës, abuzimeve verbale/raciste, mashtrimit, krijon kushtet në të cilat të burgosurit mund të tundohen të përdorin dhunën për të mbrojtur interesat e tyre. Viktimizimi tenton të përshkallëzohet në dhunë. Nëse policët nuk mbrojnë njerëzit nga grabitjet, shfrytëzimi, frikësimi dhe vjedhjet, shumë njerëz dalin në përfundimin se duhet të mbrohen me forcë.

Marrëdhëniet: Situatat më të zakonshme që rezultojnë në dhunë janë përplasjet për pushtet, konfliktet ku njëri ndihet i kërcënuar nga tjetri. Secili përpiqet të dëmtojë tjetrin nëpërmjet abuzimit me fjalë dhe frikësimit për ta detyruar tjetrin të tërhiqet.

Që të dyja palët janë të ndjeshme ndaj rrezikut të dominimit dhe baza e konfliktit bëhet garë për pushtet ndaj kundërshtarit.

Qëllimi: Disa nga motivet kryesore të përdorimit të forcës fizike janë: për të demonstruar ashpërsi, për ta ndëshkuar tjetrin ose për të zgjidhur një konflikt. Të burgosurit që përdorin forcën për të demonstruar pushtetin e tyre kanë frikë se mos të tjerët e konsiderojnë të dobët dhe të pambrojtur. Qëllimi i tyre është të krijojnë një reputacion që mund t'i mbrojë nga dëmtimet si grabitja apo vjedhja. Ata synojnë që ta bëjnë dhunën e tyre publike.

Shënim për trajnerin

*Trajneri i kërkon grupit të diskutojnë dyshe-dyshe se nga vijnë **sulmet ndaj anëtarëve të personelit**.*

USHTRIM Sulmet ndaj anëtarëve të personelit

Sulmet ndaj anëtarëve të stafit, nga vijnë?

Shkruani disa aspekte:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Pas këtij ushtrimi, trajneri përmbledh sa më poshtë:

Stafi i burgut ka një shkallë të konsiderueshme diskrecioni në kryerjen e punës së tyre. Në mungesë të udhëzimeve të detajuara dhe të qarta, personeli i burgut përballet çdo ditë me dilema të shumta. Këto dilema kanë të bëjnë me interpretimin e rregullave dhe rregulloreve: nëse një i burgosur duhet të vihet nën akuzë disiplinore; cila është sjellja e duhur; sa sende personale është e arsyeshme të mbajë i burgosuri

në qeli; kush duhet të dalë i pari nga qelia apo kush mund të bëjë dush dhe kur.

Ushtrimi i **papërshtatshëm** i diskrecionit nga stafi mund të çojë në pasoja të rënda. Një sjellje e tillë mund të përfshijë: akuza disiplinore të panevojshme; kontrolle të papërshtatshme; trajtim jo të njëjtë të burgosurve; ngacmimin e të burgosurve të caktuar nga stafi në mënyrë tendencioze; të burgosurve të ndryshëm mund t'u jepet akses i ndryshëm dhe jo i njëjtë në të mira apo shërbime të ndryshme; poshtërimin e të burgosurve ose shkaktimin e ndjenjave të pafuqisë tek ata; abuzimet, ngacmimet dhe talljet; ose manipulimi i të burgosurve nga personeli. Të burgosurit mund të përgjigjen me dhunë ndaj këtyre sjelljeve të papërshtatshme, të padrejta dhe joprofesionale të personelit të burgut.²⁶

Hulumtimet mbi motivimin e të burgosurve pas sulmeve të personelit tregojnë se sulmet ndaj personelit mund të jenë:

- akte të rastësishme dhune;
- reagime ndaj urdhrave të drejtpërdrejta të një oficeri burgu (urdhrat për të hyrë ose për t'u larguar nga një zonë, dhe kështu me radhë).
- protesta kur të burgosurit mendojnë se po trajtohen në mënyrë të padrejtë nga punonjësi i stafit të burgut dhe hakmerren ndaj tij apo asaj.
- rrjedhoja të kontrollit të personit apo qelisë, ndërhyrjet midis të burgosurve, lëvizjet e të burgosurve dhe konfiskimi i artikujve të ndaluar nga të burgosurit.
- rrjedhojë e paqëndrueshmërisë emocionale/mendore ose e ndikimit të drogës dhe/ose alkoolit.

3. Metodat për të reduktuar dhe parandaluar dhunën në burgje (60 minuta)

Shënim për trajnerin

Të burgosurit përgjithësisht duan ndërveprime pozitive sociale me anëtarët e personelit dhe me njëri-tjetrin: askush nuk do kaos apo një mjedis të pakontrollueshëm në burg.

Kështu që duhet të përqendrohemi tek strategjitë ose metodat e parandalimit të dhunës në burgje.

Ushtrim - Metodat për uljen e dhunës në burgje

Punë individuale

Ushtrim

Bëjini këtë pyetje grupit: "Cilat janë strategjitë apo metodat e mira për të reduktuar konfliktin dhe dhunën në burg?"

²⁶ Menaxherët janë në gjendje të ndihmojnë personelin e burgjeve në rolet e tyre duke zgjidhur **dilemat** që rezultojnë nga ushtrimi i diskrecionit me të cilin duhet të përballen. Ata janë në gjendje ta mbështesin stafin me rregulla të detajuara, rregullore dhe rutina që ndihmojnë për të sqaruar atë që pritet në rrethana të posaçme. Përveç kësaj, menaxherët mund të kërkojnë të ndikojnë në mënyrën se si e përdor personeli diskrecionin e vet, duke krijuar një "kuadër interpretues" për trajtimin e çështjeve të përditshme që dalin në përballjet e personelit me të burgosurit dhe duke vendosur standarde dhe pritshmëri të qarta. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në burgjet ku mbahen të burgosurit me rrezikshmëri të lartë.

Përgjigjet: Trajneri i menaxhon përgjigjet sipas dëshirave të grupit dhe përmbledh si vijon.

A. Metodatat tradicionale të reduktimit të dhunës

Kontributi i trajnerit

Strategjitë tradicionale të reduktimit dhe *parandalimit* të dhunës në burgje bazohen tek siguria, disiplina dhe kontrolli.

Metodat tradicionale të reduktimit të dhunës mbështeten tek:

- Trajtimi i dhunës si shkelje rregullash
- Ndëshkimi i atyre që përfshihen në përleshje dhe sulme
- Vënia në shënjestër e atyre që identifikohen si agresivë dhe parandalimi i tyre
- Ndarja e autorëve të veprave nga viktimat

Të gjitha këto masa janë masa që shkaktojnë reagime dhe marrjen e veprimeve; ndaj duhet të jemi skeptik ndaj pretendimeve se këto masa përbëjnë themelin për parandalimin efektiv.

Pa dyshim që disiplinimi është instrument i rëndësishëm për ruajtjen e rendit në burgje, për zbatimin e rregullave dhe për garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë. Sjellja e të burgosurve, e cila bie në kundërshtim me rregullat dhe i cenon ato, nuk duhet të tolerohet dhe kur rregullat shkelen duhet të merren masa disiplinore dhe sanksionuese.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet grupin: A mjafton të mbështetemi te dënimi për të parandaluar dhunën dhe për ta bërë burgun një vend më të sigurt? A do të bëhet mjedisi i burgut më pak i dhunshëm nga ndëshkimi më i shpeshtë dhe më i ashpër i të burgosurve që thyejnë rregullat? Çfarë mendoni? Pas diskutimit, trajneri përmbledh sa më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Ka disa arsye se pse **mbështetja e tepërt** te ndëshkimi nuk ka gjasa të parandalojë dhunën dhe të pakësojë e parandalojë sjelljen e dhunshme të burgosurve:

- Sistemi ndëshkues i vë të burgosurit dhe personelin në kushte kundërshtuese ndaj njëri-tjetrit. Ndëshkimi është shprehja e pushtetit dhe metodat detyruese priren të frymëzojnë qëndresën e të dëmtojnë profesionalizmin e oficerit të burgut bazuar në aftësitë e tij: njohja e individëve në qeli, si dhe modelimi i sjelljes sociale dhe parandalimi i konflikteve.
- Faktikisht, rritja e sigurisë mund të *redukojë* apo ndryshojë ndërveprimet ndërpersonale mes personelit dhe të burgosurve, mund të pengojnë përpjekjet e rehabilitimit dhe të dëmtojnë njohjen nga ana e oficerit të burgut të situatës që po ndodh në nënkulturën e burgut, e cila njihet si natyrë kundërshtuese.
- Më e rëndësishmja, ka të ngjarë se kjo politikë mund të nxisë në fshehtësi sjellje devijuese dhe të dhunshme, pasi të burgosurit mësojnë mënyra më të mira për të kapërcyer rregullat. Nga perspektiva tradicionale, zgjidhja ndaj dhunës është bërja e burgjeve më të rrepta dhe në mjedise më ashpra, me besimin se kjo do të sigurojë edhe më shumë kontroll mbi të burgosurit kundërshtues.

- Por, provat tregojnë se e ndodh e kundërta (Bierie, 2012; Chen & Shapiro, 2007; Drago, Galbiati & Vertova, 2011; Listwan et al., 2013). Studimi mbi dhunën në burgje tregon se sa më detyrues është mjedisi i burgut, aq më e madhe është mundësia për dhunë.
- Mundësia për dhunë është më e madhe kur menaxhimi i burgut dhe trajtimi i të burgosurve perceptohen nga të burgosurit si të padrejtë, pasi kjo forcon solidaritetin e të burgosurve në kundërshtim të autoriteteve.
- Për shembull, rregullat e ashpra të burgjeve nuk është se rezultojnë domosdoshmërisht në më pak dhunë nga të burgosurit drejt stafit, por janë ndërveprimet pozitive midis të burgosurve dhe personelit ato që e arrijnë këtë (Lahm 2009). Kur ndërveprimet bëhen nga një oficer, i cili vendos autoritetin e tij personal dhe pushtetin e ligjshëm për ruajtjen e rendit dhe pranon se të burgosurit që ndihen të sigurt, ndiejnë edhe kujdesin ndaj tyre, dhe se përgjigja ndaj *nevojave* të të burgosurve është pjesë përbërëse e ruajtjes së paqes, atëherë mundësia për dhunë në burgje ulet.

B. Metodatat e zgjidhjes së konfliktit në mjediset e burgjeve

Një tjetër strategji më efektive për uljen e dhunës në burgje është fokusimi te njohja dhe te menaxhimi i konflikteve, tek të kuptuarit e zanafillës së konflikteve dhe të mënyrës së përshkallëzimit të tyre, tek ndryshimi i kontribuesve strukturorë dhe tek njohja e mënyrës së ndërhyrjes dhe e parandalimit të zënkave dhe sulmeve.

Më poshtë jepen disa veçori dhe parime thelbësore për zgjidhjen e konflikteve në mjediset e burgjeve:

- Analizimi i konflikteve dhe identifikimi i shkaqeve.
- Analizimi i burgut si një mjedis që *gjeneron konflikte*.
- Burgjet e sigurta përmbushin nevojat bazë të personelit të burgjeve dhe të të burgosurve, që përfshijnë masën e privatësisë, strukturimin e ditës, mbështetjen dhe reagimin (feedback-un) emocional, veprimtarinë dhe lirinë për të bërë zgjedhje reale.
- Kur njerëzit ndiejnë se nevojat e tyre bazë njerëzore janë përmbushur, atëherë mundësia për ndodhjen e konflikteve shkatërruese ulet.
- Personeli përdor **sigurinë dinamike** në rolin paqeruajtës.
- Jepen mundësitë për zgjidhjen e diferencave.
- Menaxhimi i konflikteve është përgjegjësi e përbashkët.
- Perspektivat e të burgosurve janë të mirëpritura.

C. Komunikimi jo i dhunshëm i stafit me uniformë

Në literaturë përmendet një pikë e rëndësishme, e cila thotë se stili i komunikimit me mosrespektim verbal mund të jetë shkak kryesor i konfliktit në burgje. Mosrespektimi shkakton dhunë mes të burgosurve dhe personelit. Nëse anëtarët e personelit, veçanërisht stafi policor, i cili është në kontakt të vazhdueshëm me të burgosurit, venosin “nofka” apo ngacmojnë të burgosurit, atëherë vënë veten dhe oficerët e tjerë në rrezik. Studimi tregon lidhjen e drejtpërdrejtë mes ndërveprimeve shoqërore negative dhe dhunës institucionale. Për këtë, komunikimi efektiv, profesional dhe **jo i dhunshëm** është i rëndësishëm.

Për të arritur një komunikim jo të dhunshëm në burg duhet të kemi dy pikënisje:

1. Së pari, ruajtja e vlerave themelore të burgut është një pjesë e funksionimit të tij, si p.sh. drejtësia, toleranca, respekti, humanizmi dhe mosushtrimi i dhunës. Këto vlera duhet të jenë në themel dhe në thelbin etik të punës në burgje dhe nuk duhen perceptuar si diçka që shkatërron efektshmërinë e organizimit dhe devijon nga qëllimi real i një burgu.
2. Së dyti, ne besojmë se si personeli me uniformë i burgut, ashtu edhe të burgosurit/të dënuarit duhet ta vlerësojnë më shumë një kulturë burgu, ku i mëshohet ruajtjes së rendit përmes marrëdhënieve dhe NVC-së se sa përdorimit të forcës apo pushtetit (**Siguria dinamike**)²⁷

Stafi merr kënaqësi nga ndërtimi i marrëdhënieve të duhura dhe është krenar për administrimin e krijimit të një fryme të kënaqshme dhe **bashkëpunuese**. Kjo marrëdhënie duhet të bazohet tek trajtimi me respekt.

Për më tepër, sjellja që ndërton marrëdhënie **bashkëpunuese** krijon besim tek i burgosuri. Kur këta të fundit u pyetën se çfarë vlerësojnë tek stafi me uniformë, përgjigja ishte: *“Duhet të përpiqesh të ndërtosh marrëdhënie ndërpersonale me të tjerët për të kontrolluar mjedisin pa nxitur dhunë gjatë gjithë ditës”*.

Duke dhënë një shembull trajnimi mbi marrëdhëniet, personeli me uniformë demonstroi kështu për të burgosurit/të dënuarit, metoda ndërveprimit me figura me autoritet dhe me persona të tjerë që mund t'i mbështesin ato. Nga ana tjetër, në këtë mënyrë të dënuarit mund të mësojnë aftësitë e komunikimit që do t'i shërbejnë atyre si brenda ashtu edhe jashtë burgut.

Procesi i komunikimit jo të dhunshëm mbështetet nga shumë njerëz në botë si një mënyrë për të jetuar një jetë më harmonike.

Parimet kryesore të komunikimit jo të dhunshëm

- Vëmendja jonë drejtohet tek ajo çka ndodh rreth nesh në kohë reale. Qëllimi ynë duhet të jetë më shumë **të lidhemi** me të tjerët, të interesohemi për ta dhe jo t'i kritikojmë, t'j gjojmë, t'i qortojmë, etj.

Kjo do të ishte e mundur nëse ndjekim këta katër hapa:

- Vëzhgim: Çfarë shoh, dëgjoj, mbaj mend.
- Ndjenjat: Çfarë ndjenjash më shkakton ky observim?
- Nevojat: Çfarë nevojash të përmbushura dhe të papërmbushura janë në themel të ndjenjave të mia?
- Kërkesë: çfarë veprimesh specifike mund të kërkoj vazhdimisht nga vetja dhe nga të tjerët për të përmbushur nevojat e mia?

Interesimi aktiv dhe i vërtetë te komunikimi jo i dhunshëm bazohet tek aftësitë e

²⁷ Siguria dinamike - Një nga fushat kyçe ku burgjet duhet të përqendrohen është siguria dinamike. Marrëdhëniet duhen parë si guri i themelit i çdo sistemi të efektshëm burgu. Interesimi aktiv dhe i sinqertë për të burgosurin si individ dhe për mirëqenien e tij siguron bazën e një marrëdhënieje respekti, ku ka një ekuilibër të pushtetit, kontrollit dhe drejtësisë njëherësh. Kjo marrëdhënie dhe ndërveprim aktiv siguron edhe platformën themelore për demonstrimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe për sundimin e ligjit. Anëtarët e stafit duhet të trajnohen për aftësitë e komunikimit, si dhe në zgjidhjen e konflikteve dhe komunikimin jo të dhunshëm.

gjuhës dhe komunikimit që forcojnë aftësinë tonë për të mbetur human, edhe në kushte sfiduese. Ai nuk përmban asgjë të re; çdo gjë që përfshihet në komunikimin jo të dhunshëm njihet prej shekujsh. Qëllimi është të na kujtojë atë që tashmë ne e dimë - **pra, se si, ne, njerëzit, jemi të destinuar të lidhemi me njëri - tjetrin** - si dhe të na ndihmojnë të jetojmë sipas një mënyre që e manifeston shumë qartë këtë njohuri.

Komunikimi jo i dhunshëm na udhëzon në reformimin e mënyrës së shprehjes së vetvetes dhe se si i dëgjojmë të tjerët. Në vend të reagimeve të zakonshme, automatike, fjalët tona bëhen reagime të vetëdijshme bazuar në ndërgjegjësimin e asaj që ne perceptojmë, ndjejmë dhe dëshirojmë. Jemi të sigurt të sillemi me ndershmëri dhe qartësi, ndërsa njëkohësisht u kushtojmë të tjerëve vëmendje të respektueshme dhe empatike. Në këmbim, ne mund të dëgjojmë nevojat tona më të thella dhe të të tjerëve. Komunikimi jo i dhunshëm na trajnon të vëzhgojmë me kujdes dhe të jemi në gjendje të specifikojmë sjelljet dhe kushtet që na prekin. Ne mësojmë të identifikojmë dhe të artikulojmë qartë atë që duam konkretisht në çdo situatë të dhënë. Kjo formë është e thjeshtë, por jashtëzakonisht transformuese.

Kur komunikimi jo i dhunshëm i zë vendin mekanizmave tanë të vjetër të mbrojtjes, tërheqjes ose sulmeve, ne fillojmë ta perceptojmë veten dhe të tjerët, si dhe qëllimet dhe marrëdhëniet tona, në një perspektivë të re. Rezistenca, mbrojtja dhe reagimet e dhunshme minimizohen. Nëse përqendrohemi te qartësimi i asaj çfarë vërehet, ndihet dhe nevojitet, në vend që të ekzaminojmë dhe gjykojmë, ne zbulojmë thellësinë e dhembshurisë sonë. Duke u përqendruar te dëgjimi i thellë – i vetvetes tonë, si dhe i të tjerëve - komunikimi jo i dhunshëm nxit respektin dhe përkujdesjen.

- Nuk ka justifikim për përdorimin e dhunës, qoftë të dhunës fizike, seksuale ose për t'i shkaktuar dëm psikologjik një personi tjetër. Problemi është në fakt se ne nuk e dimë me siguri se si të mbrohemi.
- Nëse trajtoheni padrejtësisht, ju mund ta ndreqni situatën efektivisht duke vepruar në mënyrë të fortë, duke përdorur kërcënime të shkaktuara nga zemërimi dhe agresioni, ose mund të merrni pak kohë fillimisht për t'u qetësuar dhe për të marrë një vendim të drejtë.

Në punë, zakonisht hasim tre lloje njerëzish të zemëruar:

1. Lloji i parë bën sherr për çdo kontradiktë. Ai ka gjithmonë “të drejtë”.
2. I dyti shpërthen dhe sulmon këdo që e zemëron.

Gjërat që duhen pasur parasysh me këta dy lloje njerëzish:

- Jepuni kohë të qetësohen.
- Ndërhyni duke e parë në sy dhe duke i thënë p.sh...: “Eja, ulu! Dua që të kuptosh edhe se si e shikon tjetri këtë, ti ke të drejtë, etj”
- Shprehini opinionet tuaja shkurt, me siguri dhe qartë.
- Mundohu të jesh miqësor, empatik dhe i hapur për kompromis.
- Empati do të thotë të jesh i ndjeshëm ndaj asaj që përjeton tjetri.
- Empatia me të tjerët ndodh vetëm kur i hedhim poshtë të gjitha nocionet paragjyquese ndaj të tjerëve.
- Vërbani veshin asaj çfarë u duhet dhe jo asaj se ç'mendojnë njerëzit.
- Kur kërkojmë informacion, së pari shprehim nevojat dhe ndjenjat tona.

- Folësit që shprehin mesazhe tejet emocionale do ta vlerësonin nëse reflektojmë mbi to.

Tipi i tretë të godet me komente dhe gjeste pas shpine dhe të buzëqesh.

- Mos e lër t'ia hedhë paq duke të goditur pas shpine.
- Përballuni me të dhe kërkojini që t'jua shprehë hapur mendimet, por mos ia pranoni gjithçka siç e thotë një herë për një herë.
- Mos e lejoni këtë të ndodhë në të ardhmen duke pasur takime të rregullta të grupit për të zgjidhur problemin, duke përfshirë edhe atë person.

4. Ushtrim me komunikimin jo të dhunshëm (30 minuta)

Shënim për trajnerin

Ushtrim me pyetje dhe përgjigje për rastin e një të burgosuri të zemëruar dhe një oficeri burgu që reagon me komunikim jo të dhunshëm.

Trajneri i kërkon grupit të sugjerojë përgjigje jo të dhunshme të komunikimit të oficerit të burgut ndaj një të burgosuri të zemëruar. Trajneri lexon me zë të lartë atë çfarë thotë i burgosuri dhe më pas u kërkon pjesëmarrësve të sugjerojnë përgjigje duke përdorur teknikën e komunikimit jo të dhunshëm.

Kontributi i trajnerit

Rasti i një të burgosuri shumë të irrituar.

Një i burgosur i irrituar fillon t'i bërtasë oficerit të burgut, i cili i ka sekuestruar një send nga qelia e tij (objekt i ndaluar për t'u mbajtur në qeli: një skulpturë e vogël e bërë vetë e ndërtuar nga pjesët e ruajtura dhe të shkruara të sapunit, si dhuratë ditëlindje për djalin e tij.)

- **I burgosuri bërtet:** "Ju jeni shtypës jonjerëzorë, që vetëm përpiqeni të na e bëni jetën skëterrë...."

Pyetje: *çfarë do t'i thoshit këtij të burgosuri duke përdorur komunikimin jo të dhunshëm?*

Përgjigje e mundshme e oficerit të burgut: *"Je i nevrikosur. A je i nevrikosur sepse do të doje që organizimi i burgut dhe regjimi i tij të ishin më pak të rreptë dhe më shumë mbështes për të burgosurit? (nuk e dini nëse hamendësimi juaj është i saktë, por ajo që është vendimtare është përpjekja juaj e sinqertë për t'i lidhur me ndjenjën dhe nevojën e tij.)"*

- **I burgosuri:** Dreq, ke të drejtë, jam i nevrikosur! Ne duhet të kemi më shumë nga gjërat tona në qeli që ta bëjmë jetën këtu pak më normale dhe më pak të dhimbshme!

Pyetje: *çfarë do t'i thoshit këtij të burgosuri duke përdorur komunikimin jo të dhunshëm?*

Përgjigje e mundshme e oficerit të burgut: *"Pra je i acaruar dhe do të vlerësoje më shumë mbështetjen dhe lehtësira për përmirësimin e kushteve të jetesës".*

- **I burgosuri:** "A e di çfarë do të thotë të jetosh këtu për tetë vite, siç kam jetuar

unë? A e ke idenë më të vogël se si ka qenë kjo për mua dhe për të burgosurit e tjerë?

Pyetje: *çfarë do t'i thoshit këtij të burgosuri duke përdorur komunikimin jo të dhunshëm?*

Përgjigja e mundshme e oficerit të burgut: *Mesa duket po ndiheni shumë të dëshpëruar dhe po mendoni nëse unë apo dikush tjetër mund të kuptojë vërtetë se çdo të thotë të jetosh në këto kushte.*

- **I burgosuri:** Do që ta kuptosh? Më thuaj, a ke fëmijë? A e kupton se sa i dhimbshëm është fakti për fëmijët e mi që unë jam këtu? Me këtë dhuratë për djalin tim, dua t'i tregoj atij dashurinë time, pavarësisht se unë jam një baba që nuk ka arritur të jetë prind i mirë për fëmijët e tij për shkak të faktit se jam në burg.

Pyetje: *çfarë do t'i thoshit këtij të burgosuri duke përdorur komunikimin jo të dhunshëm?*

Përgjigje e mundshme për oficerin e burgut: *E shoh se sa e dhimbshme është për ju të jeni në burg; ti do që unë të kuptoj se ajo çka doni ju është ajo çka duan të gjithë prindërit për fëmijët e tyre, pra, të jeni një prind i mirë, i dashur për ta ndërkohë që jeni në burg.*

- **I burgosuri:** Pikërisht, respektimi i të drejtave njerëzore të të burgosurve, kështu e quani jo, apo jo? Pse nuk na lejonin të jetojmë më shumë si qytetarë normalë këtu në burg?

Pyetje: *çfarë do t'i thoshit këtij të burgosuri duke përdorur komunikimin jo të dhunshëm?*

- **Përgjigje e mundshme e oficerit të burgut:** *Ju do të pëlqenit që regjimi i burgut apo burgu të jenë më shumë në dijeni të vuajtjeve dhe privimit këtu dhe që të shikojë më thellësisht mbi pasojat e regjimit?*

Ky dialog bën të mundur që i burgosuri të shprehë dhimbjen e tij dhe oficeri i burgut të dëgjojë ndjenjën dhe nevojën pas çdo fjale. Oficeri i burgut nuk pohoi as nuk kundërshtoi. Ai nuk i mori fjalët e të burgosurit si sulme, por si sinjale nga një njeri i gatshëm për të qenë i hapur për të treguar dobësitë e tij të thella.

Nëse jeni të interesuar ta vazhdoni këtë marrëdhënie pas keqkuptimeve ose incidenteve që kanë ndodhur, duhet më shumë kohë dhe kujdes.

1. Dëgjoni të burgosurin;
2. Përpquni të kuptoni pikëpamjen e tij.
3. Mos u përpqini të shpjegoni apo të mbronin veten tuaj para se ai të përfundojë së foluri.
4. Pranoni gabimet e mundshme.
5. Pranoni zemërimin dhe lëreni atë të ikë.
6. Jini të përgatitur për kompromis.
7. Madje edhe faleni personin tjetër.

5. Menaxhimi i të dënuarve problematikë (45 minuta)

Sidoqoftë, disa njerëz duken të detyruar e të projektuar emocionalisht për të qenë (përgjithmonë) të zemëruar. Ju mund të mos jeni në gjendje ta ndryshoni një person të tillë. Në raste të këtilla, më mirë është izolimi apo mbrojtja e tyre në një mjedis të posaçëm burgu, në përpjekje për të minimizuar ndikimet e mundshme shkatërruese.

Një model pozitiv është ai i ofrimit të akomodimit të burgosurve problematikë në njësi më të vogla me deri në dhjetë vetë, bazuar në faktin se një regjim i përqendruar mund të menaxhohet më mirë duke i mbajtur ata në grup dhe jo në izolim individual. Një personel i trajnuar profesionalisht me uniformë mund të zhvillojë një regjim pozitiv dhe aktiv për të burgosurit / të dënuarit më të rrezikshëm. Qëllimi është që ata të kenë mundësi të lëvizin relativisht lirisht brenda qelive të tyre dhe të bëjnë për aq sa është e mundur një jetë sa më normale në burg.

Reduktimi i frustrimit dhe agresionit të tjetrit

Së pari, nuk është punë të shërosh urrejtjen e dikujt. Sidoqoftë, ju doni të kontribuoni në paqen dhe harmoninë në mjedisin e punës. Dijeni se njerëzit që ndjehen keq ose të përjashtuar janë më të prirur të jenë të dhunshëm. Është strategji efektive t'ua përmbushësh nevojat pa ushqyer agresionin.

Nëse kjo nuk është e mundur, shmangni çdo ndërveprim apo komunikim që inkurajon emocione intensive apo kërcënim dhune. Mos lejoni gjëra që inkurajojnë diskutimet e paarsyeshme dhe aty ku është e mundur: gjithmonë përdorni **strategjitë e shpërndarjes**.

Strategjitë e shpërndarjes (pjesa MATERIALIT 1)

Para se të ndodhë diçka tjetër, stafi duhet të përpiqet ta shuajë/qetësojë situatën. Një i burgosur që është jashtë kontrollit duhet të jetë nën ndikimin e ndonjë efekti negativ. Stafi duhet të synojë të mos bëjë asgjë që përshkallëzon gjendjen e tyre mendore, ndërsa është i përgatitur të mbrojë veten, nëse kjo është e nevojshme.

Stafi duhet të përpiqet:

- të duket i sigurt;
- të shfaqë qetësi;
- të krijojë pak hapësirë;
- të flasë ngadalë, butë dhe qartë;
- të ulë zërin;
- të shmangë kureshtjen;
- të shmangë grindjet dhe konfrontimet;
- të tregojë që po dëgjon;
- të qetësojë të burgosurin para se të mundohet të zgjidhë problemin.

Stafi duhet të mbajë qëndrim trupor jokërcënues:

- të mbajë qëndrim të qetë, të hapur (të jetë i ulur ose në këmbë);
- të reduktojë kontaktin e drejtpërdrejtë me sy (pasi mund të merret si konfrontim);
- t'i mundësojë të burgosurit hapësirën e nevojshme personale;

- t'i mbajë të dyja duart të dukshme;
- të shmangë lëvizjet e papritura që mund të trembin ose të perceptohen si sulm;
- të shmangë audiencat - pasi audienca mund të përshkallëzojë situatën.

MOS KËRCËNONI KURRË: Pasi të keni bërë një kërcënim apo të keni dhënë ultimatum, i keni ndërprerë të gjitha negociatat dhe e keni vënë veten në situatë të mundshme humbjeje.

Teknikat e çpërshkallëzimit

Shpjegoni qëllimin apo synimin tuaj

- Jepni udhëzime të qarta, të shkurtra, të sigurt, negocioni opsione dhe shmangni kërcënimet.
- Shkoni drejt një “vendi më të sigurt”, pra mos ngecni në një qoshe.

Nxitni arsyetimin (për sjelljen e tyre)

- Nxitni arsyetimin duke bërë pyetje të hapura dhe pyesni në lidhje me arsyen e agresionit.
- Pyetjet mbi “faktet” dhe jo mbi ndjenjat mund të ndihmojnë përshkallëzimin (p.sh çfarë ju ka bërë të ndiheni i zemëruar?)
- Tregoni shqetësimin tuaj nëpërmjet përgjigjeve jo-verbale dhe verbale.
- Dëgjoni me kujdes dhe tregoni ndjeshmëri, pranoni çdo ankesë, shqetësim apo acarim. Mos i nënçmoni shqetësimet e tyre.

Sigurohuni që komunikimi juaj jo verbal të mos jetë kërcënues

- Shqyrtoni teknikat e çpërshkallëzimit që janë të përshtatshme për situatën.
- Kushtojini vëmendje indicieve jo-verbale (pra kontaktit me sy). Krijojini hapësirë trupit më shumë se normalisht.
- Jini të vetëdijshëm për sjelljen tuaj joverbale, si qëndrimi i trupit dhe kontakti me sy.
- Shfaquni të qetë, të vetëkontrolluar dhe konfident, pa qenë mospërfillës apo autoritarë.
- Kontrolloni situatën.

Shënim për trajnerin

Diskutim dhe kuiz

1. Tregoni rastet e konflikteve që keni pasur.
2. Përshkruani përvojat tuaja dhe mënyrën se si i keni zgjidhur gjërat.
3. Cilat janë veçoritë kryesore të strategjive të shpërndarjes?
4. Çfarë duhet marrë parasysh për vlerësimin e rrezikut kur shfaqet tek të burgosurit agresivë? (Shih MATERIALI 1)

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

STRATEGJITË EFEKTIVE TË KOMUNIKIMIT: ÇPËRSHKALLËZIMI DHE AFTËSITË NDËRPERSONALE/TË KOMUNIKIMIT

Ky seksion përfshin:

- Menaxhimi i agresionit;
- Komunikimi;
- Komunikimi joverbal;
- Strategjitë e shpërndarjes;
- Teknikat e çpërshkallëzimit.

Menaxhimi i agresionit

Përkufizimi i dhunës në burgje:

“Çfarëdoj incidenti, si pasojë e të cilit, abuzohet, kërcënohet ose sulmohet një person. Këtu përfshihet cenimi direkt ose i nënkuptuar i sigurisë, mirëqenies ose shëndetit të tyre. Dëmi i shkaktuar mund të jetë fizik, emocional ose psikologjik.”

Menaxhimi efektiv i të burgosurve agresivë është një nga aspektet më sfiduese të punës në institucion. Është një fushë ku kërkohet ndërveprim i mirë dhe aftësi komunikimi.

Shumica e situatave, ku mund të ketë dhunë, mund të trajtohen me komunikim.

Agresioni mund të përcaktohet si çfarëdoj sjellje që perceptohet nga viktimat si e dëmshme me qëllim dhe dëmtuese si psikologjikisht ashtu edhe fizikisht.

Politika jonë është që stafi të parandalojë përshtallëzimin e agresionit në dhunë reale fizike.

Shenjat e agresionit:

- Qëndrimi autoritar në këmbë
- Skuqja e fytyrës
- Ngritja e zërit
- Frymëmarrja e shpejtë
- Kontakti i zgjatur me sy
- Gjestet e ekzagjeruara

Të burgosurit mund të bëhen agresivë për arsye të ndryshme, duke përfshirë:

- Acarimin
- Padrejtësinë
- Poshtërimin
- Papjekurinë
- Zemërimin
- Sjelljen e mësuar (merr rezultate)

- Reputacionin
- Mjetet për të arritur qëllimin
- Karremin

Shenjat e mëposhtme mund të tregojnë agresion:

- Çfarëdolloj ndryshimi i konsiderueshëm i sjelljes që ndryshon nga sjellja normale e të burgosurit
- Fytyra e zbehtë ose e skuqur
- Ngritja e zërit
- Përqendrimi/ngushtimi i shikimit
- Tensionimi i muskujve
- Rritja e zemërimit dhe e shqetësimit në sjellje (p.sh. endja me hapa)

Personeli që përballët me të burgosurit agresivë duhet të vlerësojë rrezikun e dhunës duke marrë parasysh sa më poshtë:

- A po përballët i burgosuri me një nivel të lartë stresi? (p.sh. humbja e dikujt kohën e fundit, pritja e datës së gjykimit)
- A duket se i burgosuri është i dehur apo i droguar?
- A ka i burgosuri histori dhune?
- A ka i burgosuri histori sëmundje psikiatrike?
- A ka pasur abuzime verbale nga ana e të burgosurit kundrejt stafit në të kaluarën?
- A ka pasur kërcënime me dhunë nga ana e të burgosurit në të kaluarën?

Komunikimi

Komunikimi është një proces me dy drejtime që lidhet me ndërveprimin me fjalë (të dëgjuarin si shqisë, të folurin dhe dëgjimin me vetëdije), ndërveprimin joverbal (interpretimin dhe aftësitë vëzhguese, shikimin dhe perceptimin).

Për të minimizuar problemet e komunikimit, stafi duhet të përdorë gjuhën e duhur ndaj të burgosurit (dhe nëse është e mundur në gjuhën e tij/saj dhe përmes përkthyesve), të marrë kohë për të komunikuar, të verifikojnë që është kuptuar, të nxisë dhe të japë mendimin e tij dhe të sigurohet që zhvillimi i bisedës të bëhet në kohën dhe vendin e duhur (kur është e mundur).

Disa nga pengesat e përbashkëta të komunikimit efektiv janë:

- Zhurma
- Gjuha
- Perceptimi dhe paragjykim
- Ndërhyrje në hapësirën personale

Ne nuk mund t'i shmangim apo kapërcejmë domosdoshmërisht të gjitha këto pengesa, por duhet të gjejmë mënyra për t'i minimizuar ato.

Zhurma:

Zhurma është hutim i madh kur po komunikohet. Është e vështirë që diskutimi të zhvillohet kur në sfond ka zhurmë.

Gjuha:

Oficerët duhet të shprehen në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë e të qartë që të jetë e mundur dhe të shmangin gjuhën emocionale (për shembull - shmangia e fjalëve të “pushtetit”).

Perceptimi dhe paragjykimi:

Çdokush ka një formim dhe historik unik me ndikime dhe përvoja që përbëjnë mënyrën tonë të të parit të botës. Është e rëndësishme të njohim paragjykimet tona dhe të punojmë rreth paragjykimeve të të tjerëve. Ne duhet të mbajmë një qëndrim profesional duke mos lejuar që perceptimet tona të pengojnë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të tjerëve, veçanërisht në promovimin e mundësive të barabarta ose në lënien e paragjykimeve tona që të ndikojnë mënyrën tonë të komunikimit.

Ndërhyrje në hapësirën personale:

Mos qëndroni shumë afër personit.

Komunikimi joverbal

Stafi duhet të jetë në dijeni të mesazheve joverbale që tregojnë mënyrën se si ndihet dhe si mund të përgjigjet i burgosuri dhe duhet të përdorë teknikat e komunikimit joverbal që mësohen në trajnim për të ndihmuar në shuarjen e situatave potencialisht të dhunshme.

Strategjitë e shpërndarjes

Para se të ndodhë diçka tjetër, stafi duhet të përpiket ta shuajë/qetësojë situatën. Një i burgosur që është jashtë kontrollit duhet të jetë nën ndikimin e ndonjë efekti negativ. Stafi duhet të synojë të mos bëjë asgjë që përshkallëzon gjendjen e tyre mendore, ndërsa është i përgatitur të mbrojë veten, nëse kjo është e nevojshme.

Stafi duhet të përpiket:

- të duket i sigurt
- të shfaqë qetësi
- të krijojë pak hapësirë
- të flasë ngadalë, butë dhe qartë
- të ulë zërin
- të shmangë kureshtjen
- të shmangë grindjet dhe konfrontimet
- të tregojë që po dëgjon
- ta qetësojë të burgosurin para se të mundohet të zgjidhë problemin

Stafi duhet të mbajë qëndrim trupor jokërcënues:

- të mbajë qëndrim të qetë, të hapur (të jetë i ulur ose në këmbë)
- të reduktojë kontaktin e drejtpërdrejtë me sy (pasi mund të merret si konfrontim)
- t'i krijojë të burgosurit hapësirën e nevojshme personale
- t'i mbajë të dyja duart të dukshme
- të shmangë lëvizjet e papritura që mund të trembin ose të perceptohen si sulm
- të shmangë audiencat - pasi audienca mund të përshkallëzojë situatën

MOS KËRCËNONI KURRË: Pasi të keni bërë një kërcënim apo të keni dhënë ultimatum, i keni ndërprerë të gjitha negociatat dhe e keni vënë veten në situatë të mundshme humbjeje.

Teknikat e çpërshkallëzimit

Shpjegoni qëllimin apo synimin tuaj

- Jepni udhëzime të qarta, të shkurtra, të sigurt, negociatori opsione dhe shmangni kërcënimet.
- Shkoni drejt një “vendi më të sigurt”, pra mos ngecni në një qoshe.

Nxitni arsyetimin (për sjelljen e tyre)

- Nxitni arsyetimin duke bërë pyetje të hapura dhe pyesni në lidhje me arsyen e agresionit.
- Pyetjet mbi “faktet” dhe jo mbi ndjenjat mund të ndihmojnë përshkallëzimin (p.sh çfarë ju ka bërë të ndiheni i zemëruar?)
- Tregoni shqetësimin tuaj nëpërmjet përgjigjeve jo-verbale dhe verbale.
- Dëgjoni me kujdes dhe tregoni ndjeshmëri, pranoni çdo ankesë, shqetësim apo acarim. Mos i nënçmoni shqetësimet e tyre.

Sigurohuni që komunikimi juaj jo verbal të mos jetë kërcënues

- Shqyrtoni teknikat e çpërshkallëzimit që janë të përshtatshme për situatën.
- Kushtojini vëmendje indicieve jo-verbale (pra kontaktit me sy). Krijojini hapësirë trupit më të madhe normalisht.
- Jini të vetëdijshëm për sjelljen tuaj joverbale, si qëndrimi i trupit dhe kontakti me sy.
- Shfaquni të qetë, të vetëkontrolluar dhe konfident, pa qenë mospërfillës apo autoritarë.
- Kontrolloni situatën.

Moduli 9: Menaxhimi i sjelljes së të burgosurve (3 orë)

Objektivat: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të jenë njohur me Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe me instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare për menaxhimin e burgjeve dhe të burgosurve;
- do të kenë kuptuar rolin vendimtar të cilësisë së marrëdhënies mes stafit dhe të burgosurve për menaxhimin e sjelljes së të burgosurve;
- do të jenë në gjendje të përshkruajnë karakteristikat e marrëdhënieve të mira mes stafit dhe të burgosurve, drejtësisë procedurale dhe sigurisë dinamike;
- do të marrin njohuri për klasifikimin e të dënuarve sipas sigurisë, për qëllime të mbrojtjes dhe mbështetjes së tyre;
- do të jenë në gjendje të shqyrtojnë kërkesat e të burgosurve në mënyrë efikase;
- do të jenë në gjendje t'u bëjnë të burgosurve kërkesa në mënyrë efikase;
- do të jenë në gjendje të vlerësojnë situatat, duke vëzhguar sjelljet e të dënuarve dhe reagimet efikase ndaj të burgosurve;
- do të kuptojnë Teknikën e Modelit Prosocial (PSM).

1. Hyrje (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Trajneri fillon me një shpjegim të shkurtër të Rregullave të rishikuara Evropiane të Burgjeve²⁸ dhe të instrumenteve të tjera ligjore ndërkombëtare:

72.1 Burgjet menaxhohen brenda një kuadri etik që njeh të drejtën për të trajtuar të gjithë të burgosurit në mënyrë njerëzore dhe duke respektuar dinjitetin e çdo personi.

72.3 Detyrat e stafit shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe duhet të marrin parasysh nevojën e lehtësimit të ri-integritit të burgosurve në shoqëri pas përfundimit të dënimit përmes programeve të kujdesit dhe ndihmës pozitive.

74. Një vëmendje e rëndësishme i kushtohet menaxhimit të marrëdhënieve ndërmjet personelit të burgut që punon direkt me të burgosurit dhe të burgosurve që ata kanë nën kujdes.

STANDARDET E KPT-së: MARRËDHËNIET MES STAFIT DHE TË BURGOSURVE, paragrafi 26: Baza e një sistemi human burgjesh duhet të jetë rekrutimi i duhur dhe trajnimi i stafit, të cilët do të jenë të aftë të demonstrojnë qëndrimet e duhura në marrëdhëniet e tyre me të burgosurit dhe ta konsiderojnë punën si një mision dhe jo si një punë të thjeshtë. Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me të burgosurit duhet të shihet si një karakteristikë kryesore e këtij misioni.

Menaxhimi dhe kontrolli i sjelljes së të burgosurve do të thotë në radhë të parë kompetencën e marrjes së përgjegjësisë dhe të qenit i përgjegjshëm për situatën.

28 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

Ky është thelbi i menaxhimit dhe kontrollit të sjelljes së të burgosurve në institucion. Pa aftësinë për të kontrolluar sjelljen, të gjitha përpjekjet e tjera janë të humbura. Një punonjës burgu duhet të bëjë gjithçka që është e mundur për të garantuar sjelljen e duhur të burgosurve: së pari në interes të institucionit dhe të tij dhe më pas në interes të burgosurve. E njëjta gjë vlen edhe për të burgosurit. Të mësuarit për të kontrolluar sjelljen është në interesin e tyre. Kontrolli i sjelljes së të burgosurve çon në një institucion të sigurt. Vetëkontrolli i të burgosurve i çon të burgosurit drejt suksesit. Pa kontroll, në burg nuk mund të ndodhë asgjë produktive.

Kontrolli i sjelljes së të burgosurve është një aktivitet i aplikuar dhe jo një ushtrim filozofik. Në këtë modul, përqendrohemi në tre aftësi specifike:

1. Trajtimi i kërkesave të të burgosurve
2. Dhënia e urdhrave për të burgosurit
3. Përforsimi i sjelljeve përmes Modelimit Prosocial

Menaxhimi i mirë, “i drejtë” dhe efikas i sjelljes së të burgosurve nga stafi që punon direkt me të burgosurit përbën një aspekt të rëndësishëm të roleve dhe praktikave të policisë së burgjeve dhe veçanërisht **të marrëdhënieve konstruktive dhe bashkëpunuese midis stafit dhe të burgosurve. Ose me fjalë të tjera: menaxhimi i sjelljes së të burgosurve është pjesë e tablosë së madhe që përfshin cilësinë e marrëdhënieve mes stafit dhe të burgosurve.**

Shënim për trajnerin

Diskutim në grup

Trajneri e ndan grupin në grupe më të vogla dhe i kërkon secilit grup që të diskutojë për karakteristikat e marrëdhënieve të mira konstruktive dhe bashkëpunuese mes stafit që punon direkt me të burgosurit dhe të burgosurve. Çdo grup ndan idetë e veta me grupin e madh. Më pas, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Studimet tregojnë se faktorët që ndikojnë drejtpërdrejtë në përvojën e të burgosurve dhe në cilësinë e perceptuar të kushteve të jetesës në burgje (ose në ambientet e paraburgimit) përfshijnë natyrën e kontakteve midis stafit dhe të burgosurve, autonominë, sigurinë, kontaktet me botën e jashtme, aktivitetet e rëndësishme gjatë ditës dhe mirëqenien fizike. Një nga gjetjet e vazhdueshme të studimeve është se kontaktet e mira midis stafit dhe të burgosurve përbëjnë një faktor thelbësor që ndikon në përvojën pozitive të burgosurve dhe perceptimet pozitive të kushteve të jetesës. Ka prova bindëse që tregojnë se kontaktet e mira mes stafit dhe të burgosurve mund të ushtrojnë një ndikim pozitiv, si në përvojën e të burgosurve gjatë paraburgimit, sigurinë e institucioneve, ashtu edhe tek sjellja pas qëndrimit në një institucion të mbyllur korrektues.²⁹

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit që të diskutojë për karakteristikat e marrëdhënieve të mira midis stafit dhe të burgosurve. Nxiteni grupin që të japë përgjigje dhe shkruajini përgjigjet në tabelë. Pas përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

29 Boone et al. (2016) Het leefklimaat in justitiële inrichtingen. Boom

Kontributi i trajnerit

Nga këndvështrimi i të burgosurve, *respekti dhe mbështetja* janë karakteristikat kryesore të një marrëdhënie të mirë me stafin. Për të burgosurit, respekt do të thotë që nevojat e tyre të dëgjohen dhe të plotësohen. Të burgosurit parapëlqejnë një qëndrim *mbështetës* të stafit në vend të një qëndrimi që ka të bëjë vetëm me zbatimin e rregullave. Qëndrimi mbështetës rrit nivelin e zbatimit të rregullave dhe regjimit të burgut nga ana e të burgosurit, si dhe e motivon atë më shumë për t'u bërë pjesë e trajtimit. Ky është një konstatim që është në përputhje me teorinë e *drejtësisë procedurale*, e cila shprehet se ushtrimi i autoritetit dhe i drejtësisë sipas perceptimit të njerëzve (punonjësve, qytetarëve, të burgosurve) varet nga *kriteret e marrëdhënieve*, duke përfshirë edhe:

- 1) sa lejohen të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes (sa u dëgjohe zëri);
- 2) sa i kuptojnë vendimet;
- 3) sa trajtohen në një mënyrë të respektueshme, me besim, në mënyrë joposhtëruese dhe jostigmatizuese; dhe
- 4) sa neutrale apo të paanshme janë vendimet e marra.

Marrëdhëniet e mira mes stafit dhe të burgosurve karakterizohen edhe nga ndërveprimi me të burgosurit, përdorimi i një komunikimi njerëzor, efikas dhe të hapur. Këto karakteristika lehtësojnë ushtrimin e autoritetit nëpërmjet përdorimit minimal të forcës dhe promovojnë përdorimin e **sigurisë dinamike** dhe formave më pak autoritare të *pushtetit*.

Shënim për trajnerin

Trajneri e pyet grupin “çfarë dini për sigurinë dinamike”?

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

“Siguria dinamike” është një koncept dhe një metodë pune, përmes së cilës stafi i kushton vëmendje prioritare krijimit dhe ruajtjes së një komunikimi dhe ndërveprimi të përditshëm me të burgosurit, bazuar në një etikë të lartë profesionale dhe marrjes së masave për të pasur aktivitete të rëndësishme për ta zënë kohën e të burgosurve, kombinuar me sigurinë fizike. Kjo lloj sigurie ka për qëllim që të kuptojë më mirë të burgosurit dhe të vlerësojë rreziqet që ata mund të përbëjnë, si dhe marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe rendit, duke kontribuar në rehabilitimin dhe përgatitjen për lirin nga burgu. Burgjet e menaxhuara në bazë të **parimeve të Sigurisë Dinamike** nënkuptojnë që kanë një grup vigjilent stafi që ndërvepron me të burgosurit dhe **që i njeh të burgosurit**, staf që zhvillon marrëdhënie pozitive me të burgosurit; staf që **është i vetëdijshëm për atë që ndodh** në burg, **trajtim i drejtë dhe një sens “mirëqenieje” mes të burgosurve**; si dhe staf që merr masa që të burgosurit ta kenë kohën **të zënë** përmes aktiviteteve konstruktive dhe të rëndësishme që kontribuojnë në ri-integrimin e tyre në shoqëri. Ruajtja e kontrollit në burgje duhet të bazohet në përdorimin e sigurisë dinamike, zhvillimin e marrëdhënieve pozitive nga stafi me të burgosurit bazuar tek vendosmëria dhe drejtësia, kombinuar me njohjen e situatës së tyre personale dhe të çdo rreziku që mund të paraqesin të burgosur të caktuar.³⁰

Për ta përmbledhur: studimet tregojnë se në rastet kur marrëdhëniet mes stafit dhe të burgosurve kanë **ekuilibrin e duhur të**:

- 1) kontrollit, sigurisë;
- 2) trajtimin dinjitoz, human dhe mbështetës të të burgosurve;
- 3) profesionalizëm dhe përdorimin e duhur të autoritetit;

pothuajse të gjitha aspektet e përvojës së të burgosurve dhe kushtet në burgje, duke përfshirë edhe menaxhimin e mirë apo “të drejtë” të sjelljes së të burgosurve kanë mundësi të përmirësohen.

Për të pasur një ndikim pozitiv tek të burgosurit dhe për të menaxhuar sjelljen e të burgosurve, është e nevojshme që policët e burgjeve:

- Të angazhohen, kohë pas kohe, realisht me të burgosurit, sjelljeve të ndryshme që ata shfaqin, shtysave dhe nevojave të shumëfishta të të burgosurve;
- Të trajtojnë çdo të burgosur rast pas rasti; nuk ka recetë për të gjithë;
- Të integrojnë ofrimin e kujdesit (ose të ndihmës dhe mbështetjes) dhe të ruajnë sigurinë dhe rendin;
- Të shmangin të dyja, edhe mbipërdorimin e autoritetit dhe kontrollit shumë të rreptë, por edhe nënëpërdorimin sa duhet të autoritetit dhe të sigurojnë një ambient të tillë në burg që të mos jetë më i rreptë seç duhet apo më pak i kontrolluar seç duhet;
- Të ndihen të sigurt dhe të përdorin autoritetin e tyre personal dhe autoritetin që u jep ligji për të ruajtur rendin, duke kuptuar se të burgosurit që kanë një lloj vetëkontrolli, që ndihen të sigurt, që ndihen nën kujdes do të kenë një performancë më të mirë morale në ato burgje ku humanizmi, mirëqenia shkojnë paralel me sigurinë dhe rendin në burg.

2. Klasifikimi i të burgosurve (20 minuta)

Shënim për trajnerin

Ushtrim - diskutim

Trajneri pyet:

1. Cilat aspekte janë të rëndësishme për klasifikimin e të burgosurve?
2. Pse përdoret në burgje klasifikimi i të burgosurve?

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh:

Kontributi i trajnerit

Zhvillimi i një procesi për klasifikimin efikas të çdo të burgosuri bazohet në informacionet e disponueshme në lidhje me të burgosurit, duke përfshirë aspekte si:

- historiku i veprave penale
- vepra penale për të cilën është dënuar
- kohëzgjatja e dënimit
- mosha
- gjinia

- vulnerabiliteti
- gjendja shëndetësore
- historiku i arratisjeve / incidenteve
- sjellja aktuale dhe historiku i masave disiplinore të mëparshme në burg
- etnia / besimi fetar
- anëtarësimi në ndonjë organizatë
- historiku ushtarak apo të dhëna për pjesëmarrje më parë në luftime të ndryshme
- mbështetja nga familja / komuniteti

Ky informacion mund ta orientojë nivelin drejtues të burgjeve në marrjen e vendimeve për mënyrat **më të përshtatshme të menaxhimit të burgosurve**, duke përfshirë vendosjen e tyre në burgje dhe shkallën e mbikqyrjes së nevojshme për ta. Të burgosurit duhet të klasifikohen në momentin e hyrjes në burg dhe të rivlerësohen pas çdo ngjarje të rëndësishme që mund të ndikojë në menaxhimin e të burgosurit (si për shembull, pas marrjes së vendimit të dënimit nga gjykata në rastin e të paraburgosurve). Procesi efikas i klasifikimit fokusohet tek nevojat individuale të burgosurve, ndryshe nga qasja tradicionale e të trajtuarit të gjithë të burgosurve në të njëjtën mënyrë. Përpjekjet për menaxhimin e të gjithë të burgosurve duke u nisur nga prezumimi se ata përfaqësojnë që të gjithë të njëjtin nivel rreziku nuk është e saktë dhe përbën një përdorim joeficient të burimeve.

Aftësia e drejtuesve të burgjeve për t'i menaxhuar të burgosurit si individë dhe jo grupe individësh, apo si një grup homogjen nga ana tjetër, përmes një klasifikimi efikas dhe përmes një procesi ndarjeje, ndihmon ndjeshëm për vendosjen e rendit në burgje dhe lehtëson rehabilitimin e të burgosurve. Megjithatë, aftësia për t'i ndarë fizikisht kategoritë e ndryshme të burgosurve (për shembull të burgosurit e dhunshëm nga ata jo të dhunshëm) varet nga infrastruktura e burgut dhe niveli i mbipopullimit. Në shumë burgje, në shumë sektorë, ndarja fizike efikase nuk është e mundur.

3. Trajtimi i kërkesave të burgosurve në mënyrë efikase (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Stafi i burgut, në çdo kohë, gjendet përpara kërkesave të ndryshme të dënuarve. Disa mund të jenë të drejta dhe të tjerat jo. Në këto raste, nëse një kërkesë e caktuar, edhe pse mund të mos jetë e drejtë, injorohet dhe nuk i jepet një përgjigje e shpjeguar, ajo mund të sjellë pasoja në institucion. Nëse e keni të vështirë ta besoni, vendoseni veten në një situatë ku i kërkonit shefit të trajtojë kërkesat tuaja dhe ai ju injoron. Si do të ndiheshit? Çfarë mesazhi do të komunikonte nëse do të ndodhte shpesh? Cilat mund të jenë pasojat në sjelljen tuaj?

Para se t'i përgjigjeni çdo kërkesë të të burgosurit, duhet të përdorni aftësitë tuaja kryesore për të kontrolluar të burgosurin. A po ju thotë të vërtetën apo po përpiket t'ua hedhë? Gjithashtu, duhet të kontrolloni situatën në lidhje me rregullat ose rregulloret që mund të zbatohen. Përdorimi i aftësive tuaja të pozicionimit, vëzhgimit, dëgjimit dhe kthimit të përgjigjes janë shumë të rëndësishme. Ndërsa praktikoni, do të bëhet edhe më e qartë për ju.

Të menaxhosh kërkesat e dikujt është aftësia për të reaguar ndaj sjelljes së një të dënuari në mënyrë të drejtë dhe efektive. Aftësimi në këtë drejtim ndihmon për të rritur besimin dhe zvogëlon tensionin në institucion.

Trajtimi i kërkesave të burgosurve: ushtrim me role

- Kërkojuni dy kursantëve të luajnë, njëri rolin e të burgosurit dhe tjetri rolin e policit.
- Trajneri duhet të përshkruajë një skenë në të cilën një i burgosur kërkon diçka që është e vështirë për t'u lejuar - shembuj mund të jetë një vizitë shtesë ose të lejohet të punojë një punë më të lehtë ose disa sende të mos iu lejohen të burgosurve të tjerë.
- I kërkonti grupit të analizojnë mënyrën se si policët e trajtuan situatën dhe të shpjegojnë pse kontrolli ose menaxhimi i sjelljes së të burgosurit është i rëndësishëm për menaxhimin dhe çfarë përfiton i burgosuri kur mëson të menaxhojë ose kontrollojë sjelljen e tij?

Më pas vini në dukje:

Kontributi i trajnerit

Në rastin më sipër, punonjësi ushtroi kontroll përmes aftësive dhe jo forcës. Ai nuk e uli apo ofendoi të burgosurin dhe nuk përdori as sarkazëm. Megjithatë, ju do të vini re se në këto aftësi përfshihej vendosmëria dhe arsyet për veprimet e tij. Nuk pati asnjë dobësi. I burgosuri tashmë e di se çfarë pritet prej tij dhe pse. Punonjësi madje ishte në gjendje të vazhdonte të reagoonte ndaj të burgosurit, kur i burgosuri u irritua. Përdorimi i aftësive të ndihmon të bësh punën dhe rrit probabilitetin që i burgosuri të ndihet se është trajtuar në mënyrë të drejtë edhe pse i kanë ndërprerë një lloj rutine.

Trajtimi i kërkesave është aftësia për të menaxhuar kërkesat e të burgosurve në një mënyrë të drejtë dhe efektive. Trajtimi profesional i kërkesave ndihmon në krijimin e besimit dhe uljen e tensionit në institucion. Gjithashtu, është një teknikë e mirë e menaxhimit të sjelljes së të burgosurve. Dy hapat për trajtimin e kërkesave janë:

1. Pranimi i kërkesës
2. Dhënia e një përgjigjeje dhe arsyet për këtë përgjigje

AD1 Rregullat, rregulloret dhe të drejtat e të dënuarve

Çdo burg është i bazuar mbi disa rregulla ligjore dhe institucionale të caktuara për të siguruar të drejtat bazë të dënuarve. Çdo institucion penal ka një rregullore të shkruar me anë të së cilës përcakton si duhet të ruhen këto të drejta. Kujdesi për të ruajtur këto të drejta bën që punonjësit e burgut të ndërtojnë marrëdhënie pune me pothuajse të gjithë të dënuarit. Në përgjithësi ka rreth 10-20 për qind të dënuar që gjithmonë reagojnë negativisht, pavarësisht veprimit të ndërmarrë ndaj tyre apo caktimit të një detyre për të kryer. Duke ndjekur rregulloren, personeli e di si duhet të silllet me një sjellje të të dënuarit dhe në këtë mënyrë shmangen të gjitha ato sjellje të punonjësit të burgut që mund të përcaktohen si negative nga të dënuarit. Kur të dyja palët i ndjekin në mënyrë korrekte të drejtat dhe detyrimet e tyre mundësohet drejtimi i institucionit në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Shënim për trajnerin

Trajneri lexon situatën e mëposhtme për gjithë grupin dhe më pas u kërkon atyre që ta përshkruajnë dhe të diskutojnë se si do të vepronin. Shkruani përgjigjet e tyre në tabelë.

Diskutime

Situata 1

Një i dënuar kërkon: “Z. polic jam sëmurë. Kam dhembje stomaku dhe po djersij më shumë se zakonisht. A mund të më çoni në infermieri?”

Çfarë aftësish duhet të tregojë një polic në këtë rast?

Cilat rregulla duhet të ndjekë?

Situata 2

Një tjetër i dënuar ka këtë kërkesë:

“Z. polic, kam harruar radion në bibliotekë dhe kam frikë se mund të ma vjedhin. A mund të shkoj ta marr?”

Çfarë aftësish duhet të tregojë një polic në këtë rast?

Cilat rregulla duhet të ndjekë?

AD. 2 Përgjigjja me një arsye e vendimit të marrë

Aftësia e re këtu përfshin shfaqjen e veprimit që do të ndërmarrësh - vendimin tënd - dhe dhënien e arsyes të burgosurit. Dhënia e një arsyeje për vendimin e marrë nuk është shenjë dobësie nga ana e stafit, përkundrazi, është mënyra më e mirë për të zvogëluar ankesat e ardhshme. Nëse një të dënuar do t'i refuzohet një kërkesë, ai do të kërkojë përsëri për shkak të refuzimit të kërkesës së parë. Ndërsa, në rastin kur i jepet një përgjigje, atëherë i dënuar e di se kjo përgjigje ishte e bazuar në një arsye të qartë.

Në thelb, një punonjës ka tre rrugë të mundshme veprimi në lidhje me kërkesën e një të burgosuri.

Në secilin rast ai duhet të japë arsye për veprimin e tij.

“Po, unë do të bëj _____ sepse _____.”

“Jo, unë nuk do të bëj _____ sepse _____.”

“Do të shikoj _____ sepse _____.”

Në çdo rast personeli duhet t'i bazojë përgjigjet mbi ligjet dhe rregullat përkatëse. Nëse një i dënuar kërkon diçka që është tej këtyre rregullave, përgjigjet në këtë rast duhet të shoqërohen, nëse është e mundur, edhe me shpjegime të tjera që përcaktojnë arsyen e një përgjigjeje të tillë.

P.sh., kërkesës “A mund të bëj një bisedë telefonike?” mund t'i jepet kjo përgjigje: “Jo nuk është e mundur, ju keni të drejtën e tetë telefonatave në muaj dhe bisedat ekstra jepen vetëm në ato raste kur këshillohet nga specialistët e edukimit”.

Njohja e ligjit dhe rregulloreve të institucionit e bën punën më të lehtë.

Kujdesi për nevojat themelore është një “domosdoshmëri” në çdo marrëdhënie. Do

të ishte shumë e vështirë për një të burgosur të besonte se dëshironit të komunikoniit dhe ta ndihmoniit nëse nuk i plotësonit nevojat e tij themelore - domethënë nëse nuk i jepnit atë që i takonte.

Shënim për trajnerin

Ndërkohë që shkruani përgjigjet në tabelë, kërkojini pjesëmarrësve që të identifikojnë disa prej kërkesave legjitime që mund të bëjë një i burgosur. Pastaj kërkojini që të listojnë kërkesat jolegjitime që mund të bëjë një i burgosur. Kërkojuni që të shpjegojnë se pse disa kërkesa janë legjitime dhe disa jo. Tek lista e kërkesave legjitime, pyetini se cilat prej tyre janë të drejta themelore.

Diskutim

- Cilat janë kërkesat legjitime që mund të bëjë një i burgosur?
- Cilat janë kërkesat jolegjitime që mund të bëjë një i burgosur?
- Shpjegoni se pse disa kërkesa janë legjitime dhe të tjerat jo.
- Tek lista e kërkesave legjitime, pyetini se cilat prej tyre janë të drejta themelore.

4. Dhënia e urdhrave (30 Minuta)

Dhënia e urdhrave është aftësia për të menaxhuar të burgosurit duke u bërë atyre kërkesa specifike. Bërja e kërkesave me zgjuarsiri përmirëson mundësitë që të burgosurit të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë më lehtë kërkesën tuaj.

Dy hapat e përfshirë në bërjen e kërkesave janë:

1. Verifikimi

2. Marrja e masave të duhura

Edhe në këtë rast, duhet të kryeni verifikime për t'u siguruar që të mos bëni një lëvizje të gabuar, një lëvizje që mund të rrisë tensionin sesa të qetësojë situatën. Pasi ta keni bërë këtë, mund të vendosni nëse veprimi më i mirë do të përfshijë një urdhër të thjeshtë, me porosi apo edhe veprim fizik të drejtpërdrejtë.

1. **Verifikimi.** Duke qenë se procedurat do të jenë të njëjta me ato të përfshira në trajtimin e kërkesave të burgosurve, nuk ka nevojë t'i rikthehemi gjatë. Megjithatë, qëllimi juaj duhet të jetë të kuptoni të gjithë situatën që përfshin të burgosurin të cilin planifikoni ta bëni të kryejë diçka. A është ai me miqtë e tij? Nëse po, cila është marrëdhënia e tij me ta? A do të ndihet i ofenduar nëse i jepni një urdhër dhe mund të reagojë në mënyrë antagoniste? Duke përdorur aftësitë tuaja bazike intuitive dhe aftësitë e reagimit, për të kuptuar nëse ka ndonjë tension në ajër, më tej mund të siguroheni që çdo veprim që kryeni për të kërkesën tuaj do të jetë efektive.

2. **Marrja e masave të duhura.** Kur ndërmerren veprime për të bërë që një i burgosur të kryejë diçka, duhet të mbani mend të jeni specific. Duhet të tregoni se çfarë doni të bëhet dhe kur. Të komunikosh me të burgosurin në këtë mënyrë ju bën të përgjegjshëm. E keni adresuar urdhrin tuaj për të burgosurin pa prezencën e dikujt tjetër. Shumë punonjës kanë kuptuar se një urdhër i adresuar në mënyrë të sjellshme është më efektiv për ta detyruar një të burgosur të bëjë atë që i është kërkuar. Një urdhër i butë dhe i sjellshëm mund të ketë formën e "A mund ju lutem _____." ose mund të jetë "Do ta vlerësoja nëse mund të _____."

Duke qenë se të burgosurit shpesh sfidojnë sjelljen autoritare nëse i urdhëroni të bëjnë diçka, mund të keni më pak probleme nëse përdorni një lloj gjuhe të butë. Shembuj mund të jenë “Unë do të doja që ju të bëni _____.” ose “A do të ndalonit _____.” Ju mund ta zbusni situatën edhe më shumë duke përdorur fjalë edhe më të sjellshme. Për shembull, “Unë do të doja dhe ju lutem të ndaloni _____.”

Metoda që përdorni për të dhënë një urdhër do të varet nga situata dhe i burgosuri. Sigurisht, nëse një i burgosur abuzon me metodën e butë, ju jeni gjithmonë të lirë të lëvizni në një pozitë më të fortë, duke përfshirë një urdhër të drejtpërdrejtë. Siç u përmend më lart, çështja është që të kryeni detyrën - që ta bëni të burgosurin të bëjë atë që dëshironi. Shumica e policëve me përvojë bien dakord se është përgjithësisht më e lehtë nëse shmangen konfrontimet e drejtpërdrejta.

Shënim për trajnerin

Ndërkohë që shkruani përgjigjet në tabelë, kërkojuni pjesëmarrësve që të reflektojnë mbi mënyrat efikase dhe joefikase për t'i bërë të burgosurit që të respektojnë rregullat duke dhënë urdhra legjitime. Kërkojuni të shpjegojnë pse disa prej tyre janë efikase dhe disa të tjera jo. Trajneri përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Punonjësit e burgjeve zbatojnë rregullat që vlejnë për të gjithë popullatën e burgjeve në vendin e punës dhe në situata reale. Ata përdorin diskrecionin e tyre për mënyrën se si i zbatojnë rregullat ndaj individëve të caktuar, duke garantuar në të njëjtën kohë se i zbatojnë rregullat njësoj dhe me ndershmëri, duke qëndruar brenda kufirit të parimeve të gjera. Punonjësit e burgjeve e mbajnë autoritetin e tyre dhe i ruajnë kufijtë (pasi disa të burgosur kërkojnë t'i manipulojnë për të arritur qëllimet e tyre), gjë që nuk është e lehtë.

Në ndërveprimet e tyre me të burgosurit, punonjësit e burgjeve e përdorin autoritetin me zgjuarsiri dhe në mënyrë profesionale.

Ata janë të ndershëm dhe transparentë për mënyrën se si presin që individët të respektojnë rregullat. Ata e fitojnë respektimin e rregullave përmes respektimit të të burgosurve dhe jo duke i kërcënuar apo ndëshkuar ata.

Punonjësit efikas të burgjeve duhet të demonstrojnë këto aftësi.

- **Janë të sjellshëm dhe të respektueshëm.** Edhe kur gjërat janë të tensionuara, ata vazhdojnë të flasin me qetësi dhe me kortezi. Kanë **aftësi të mira të dëgjuari**. Mbajnë rendin duke ia kërkuar të burgosurve dhe jo duke i urdhëruar ata që të bëjnë gjëra të caktuara. Kujdesen që të mos i fyejnë apo poshtërojnë. Vazhdojnë të vlerësojnë humanizmin e njerëzve.
- **Kanë njohuri profesionale për rregullat dhe të drejtat e të burgosurve.**
- **U shkojnë deri në fund gjërave që kanë premtuar.**
- **Arrijnë t'i ndajnë gjërat** dhe të reagojnë me ndershmëri dhe pa vonesa të tepruara.
- E përdorin shqyrtimin e kërkesave, të pyetjeve të ndryshme nga të dënuarit për çështje të ndryshme duke u konsultuar me specialistë të ndryshëm si një **mundësi bashkëpunimi dhe komunikimi** mes sektorëve të ndryshëm të institucionit.

- **Janë të vetëdijshëm nga ana morale.** Që të jesh punonjës burgu është një detyrë e vështirë moralisht. Punonjësit kanë pushtet mbi njerëzit. Njerëz që janë ndonjëherë të dobët, ndonjëherë të rrezikshëm dhe ndonjëherë të dyja bashkë. Sjellja e ndërgjegjshme moralisht ka të bëjë me të vepruarit duke pasur parasysh pasojat e çdo veprimi që bën. Sjellja e ndërgjegjshme morale ka të bëjë edhe me çështjet morale. Kjo i ndihmon ata që të jenë efikas në ofrimin e mbështetjes, strukturimin dhe në motivimin e të burgosurve
- **Duhet të kenë aftësi komunikuese dhe rehabilituese.** Inkurajojnë sjelljet pro-sociale të të burgosurve dhe i ndihmojnë ata që të zhvillojnë kapacitetet për të ndryshuar, për t'u shkëputur nga krimi dhe për t'u ri-integruar në shoqëri. E dinë se si të bëjnë një kërkesë apo si të nxisin dhe ta mbështesin një person në marrjen e hapave për një të ardhme më të mirë. I trajnojnë njerëzit për aftësitë për zgjidhje problemesh dhe për të menduar për pasojat. I ndihmojnë për të gjetur identitete të reja të ndryshme nga identiteti kriminal. I bëjnë njerëzit të mendojnë dhe të flasin pozitivisht për të ardhmen.

5. Vlerësimi i situatës, vëzhgimi i sjelljes së të dënuarve dhe reagimi efikas ndaj të dënuarve (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Stafi i burgjeve përballet në çdo kohë me nevojën për shqyrtimin e kërkesave të burgosurve dhe marrjen e ankesave nga të burgosurit. Në rast se kërkesat specifike, ndonëse të papërshtatshme, injorohen dhe nuk u jepet një përgjigje e shpjeguar, ato mund të çojnë në pasoja për institucionin. Stafi duhet ta vendosë veten në vendin e të dënuarve dhe të mendojë për situatën, se si do të ndiheshin ata nëse drejtuesit do t'i injoronin kërkesat e tyre dhe veçanërisht nëse këto kërkesa ishin të arsyeshme. Vëzhgimi, dëgjimi dhe marrja e informacioneve për situatat është shumë e rëndësishme. Më pas, polici i regjimit të brendshëm ia përcjell kërkesën specialistit (p.sh. mjekut, psikologut, punonjësit social, edukatorit, avokatit, etj.).

- Kur i kërkojnë të burgosurit diçka dhe duan që i burgosuri të veprojë në përputhje me rregullat, punonjësit e burgjeve që theksojnë më shumë se duhet shqetësimet në lidhje me sigurinë, duke nënvleftësuar dinjitetin dhe të drejtat e të burgosurve dhe duke u mbështetur më shumë tek ndëshkimet dhe masat në emër të sigurisë, masa joproporcionale e madje të tepruara, respektohen më pak.
- Punonjësit që negociojnë dhe komunikojnë respektohen më shumë. Punonjësit e burgjeve operojnë më mirë kur e përdorin pushtetin zyrtar që u është dhënë, duke u mbështetur më shumë tek autoriteti i tyre.
- Punonjësit që kanë një autoritet jo shumë të madh, mund të mos ndihen rehat me këtë autoritet. Ata mund t'ia kalojnë të gjitha vendimet eprorëve të tyre. Ata mund të duken të dobët dhe më të lehtë për t'u intimiduar.

6. Modeli pro-social (30 minuta)

Një mënyrë për nxitjen e sjelljeve dhe aftësive pozitive është përmes ndërveprimeve që vijnë nga marrëdhëniet konstruktive ose mbikqyrëse mes punonjësve të burgjeve dhe të burgosurve. Ajo që është e rëndësishme për formësimin e sjelljeve pozitive të burgosurve është përdorimi i parimeve të teorisë sociale të të mësuarit dhe i teknikave të modeleve pro-sociale.

Çfarë është modeli pro-social? Termi model pro-social në kuptimin e tij të ngushtë nënkupton mënyrën se si punonjësit e burgjeve apo të shërbimit të provës apo personat që punojnë me klientë që janë në atë pozicion pa vullnetin e tyre, modelojnë vlerat dhe sjelljet pro-sociale në ndërveprimet e tyre me klientët ose me të burgosurit. Megjithatë, ky term shpesh interpretohet në një kuptim më të gjerë dhe përfshin një grup aftësish që përfshijnë vlerat pro-sociale të modeleve të paraqitura nga eprorët, duke përfshirë shprehitë dhe veprimet pro-sociale të klientëve dhe duke trajtuar si negative apo duke u konfrontuar me veprimet apo shprehitë pro-kriminale të atyre klientëve. Termi praktik pro-sociale apo model pro-social përdoret gjithashtu shpesh nga profesionistët për të përshkruar një qasje edhe më të gjerë të mbikqyrjes së të dënuarve, e cila përfshin zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim dhe qartësimin e roleve (shih Trotter 1999, 2004).

Sipas teorisë së të mësuarit social, personat mësojnë dhe përfitojnë sjellje të reja përmes përforsimeve pozitive apo negative, vëzhgimeve dhe ushtrimit të aftësive.

Kontributi i trajnerit

- Përforsimet pozitive dhe negative përfshijnë shpërblimet dhe sanksionet (shprehjen e pakënaqësisë) që formësojnë sjelljen e njeriut.
- Kur përpiqemi të ndryshojmë sjelljen: përforsimet pozitive duhet të aplikohen më shpesh sesa përforsimet negative.
- Të dënuarit kanë histori të gjata përforsimesh negative: ata janë pak a shumë të pandjeshëm ndaj dhimbjes që shkaktojnë sanksionet.
- Të dënuarit kanë më shumë gjasa të përsërisin sjellje dhe qëndrime që vlerësohen, konfirmohen apo shihen pozitivisht.
- Një raport prej 4 përforsimesh pozitive për çdo përforsim negativ.
- Kjo formulë forcon motivimin e të dënuarve për të vazhduar demonstrimin e sjelljeve pro-sociale.

Kontributi i trajnerit

Përforsimet pozitive nuk janë domosdoshmërisht të kushtueshme apo të vështira për t'u administruar.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit të reflektojë mbi mënyrat e shpërblimit dhe afirmimit të sjelljeve pro-sociale.

Kontributi i trajnerit

Trajneri përmbledh përgjigjet e grupit dhe jep disa shembuj të strategjive të shpërblimeve dhe afirmimeve:

- Fjalë lavdëruese
- Caktimin e detyrave që tregojnë besim tek aftësitë e individit dhe niveli i tij i përgjegjshmërisë
- Simbol vlerësimi (certifikatë, shënim me shkrim)
- Lavdërimi në publik
- Caktim i detyrave më të dëshirueshme

Kontributi i trajnerit

Dështimi për të shprehur pakënaqësinë/mosmiratimin kur shfaqen sjellje/qëndrime antisociale mund të përcjellë aprovim të nënkuptuar të këtyre sjelljeve.

Reagimet efikase ndaj sjelljeve të dënuarve që nuk janë në përputhje me rregullat përfshijnë:

- Njohja e sjelljeve të dëshiruara dhe të padëshiruara nga të dënuarit
- Pasojat e qarta të sjelljeve negative
- Reagimi në kohë ndaj lidhjes mes sjelljes dhe reagimit ndaj saj
- Reagimet nuk duhet të jenë më të ashpra apo më ndëshkuese sesa është e nevojshme
- Reagime të drejta dhe të barabarta

Kontributi i trajnerit

Modelet prosociale: Modeli i roleve, ushtrimi i aftësive, raportet dhe komunikimi

- Modeli i roleve: të burgosurit mësojnë përmes vëzhgimit të sjelljeve të punonjësve të cilët shfaqin sjelljet e duhura
- Vetëm njohuritë nuk mjaftojnë për të ndryshuar sjelljet: të mësuarit e mënyrave të reja të sjelljes ndodh përmes *ushtrimit të aftësive*
- Praktikimi i mënyrave të reja të reagimit ndaj situatave çon edhe në mënyra të reja të të menduarit për këto situata
- Ushtrimi i aftësive: vëzhgimi i të tjerëve, praktikimi i sjelljeve të reja, marrja e vlerësimeve apo komenteve dhe përmirësimi i vazhdueshëm
- Aftësi për të ndërtuar raporte sa i përket besimit mes stafit dhe të dënuarve
- Besimi fitohet përmes interesave të vërteta, komunikimit/veprimeve të sqarta dhe efikase, përmes aleancave të rëndësishme të të punuarit dhe përmes zgjidhjeve orientuese dhe të strukturuar, si dhe reagimeve që nuk konsistojnë tek identifikimi i autorit të fajit

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit të reflektojë për mënyrat se si mund të funksionojë stafi si një rol model efikas.

Trajneri i përmbledh përgjigjet si vijon:

Stafi si model

- Vendosja e modeleve
- Komunikimi aktiv
- Respektimi i individit
- Respektimi i ligjit dhe rregulloreve
- Përpikmëria
- Besueshmëria
- Konsistenca
- Drejtësia
- Ndarja e gjërave si duhet
- Vendosmëria
- Modelet pozitive të stafit për atë që duan të bëjnë të tjerët
- Inkurajimi aktiv i sjelljeve të duhura
- Të ndihmuarit e të burgosurve nga stafi në mënyrë aktive për të mësuar sjelljet e reja dhe për të kuptuar se si ndikojnë mendimet dhe ndjenjat e tyre në mënyrat që ata sillen

Modeli social pozitiv me SHEMAJ

Shënim për trajnerin

Trajneri kalon në pyetjen tjetër, duke pyetur pjesëmarrësit “si ju duket?” P.sh. a është kjo gjuha e përshtatshme e trupit? Gjestet e përshtatshme - Çfarë janë gjestet e papërshtatshme? Etj.

Modeli social pozitiv me SHEMAJ

- Përsëritet çdo të burgosur individualisht
- Drejtojnë të burgosurve me emër duke treguar mirësjellje
- Mbani kontakte të përshtatshme me sy gjatë bisedës
- Përdorni një gjuhë të përshtatshme trupore
- Përdorni gjeste të përshtatshme
- Përdorni një ton të ekuilibruar të zërit
- Kushtojini vëmendje të gjithëve
- Trajtojnë të gjithë në mënyrë të barabartë, duke marrë parasysh nevojat e secilit
- I jepni udhëzime të qarta për punët që duhet të bëjnë
- Kujtojnë njerëzve që të bëjnë punën, të vendosur por me mirësjellje
- Respektoni rregullat

Dhënia e detyrave

Lexoni MATERIALIN 1 për Modelin Prosocial dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme për PSM:

- Thoni 5 përgjigje që demonstrojnë modelin prosocial.
- Cilat janë mënyrat efikase për përf forcimin/shpërblimin e sjelljeve pozitive?
- Cilat janë mënyrat efikase për mosmiratimin e sjelljeve negative?

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

MODELI PROSOCIAL (MPS)

Shërbimi i burgjeve i Zelandës së Re ka hartuar këto udhëzime në ndihmë të stafit:

Modeli është burimi më i fuqishëm i ndikimit. Ai përbën një faktor kontekstual dhe jo një mënyrë të drejtpërdrejtë reagimi. I burgosuri mund të ndikohet më shumë nga fjalët dhe nga sjelljet tuaja, nëse sheh se “ti vepron si duhet”.

A. MPS demonstrohet, kur shfaq këto 5 reagime:

- respekton rregullat dhe autoritetin legjitim
- autokontrolli
- mospranimi i dhunës
- ndershmëria dhe besueshmëria
- respektimi i të tjerëve

Në pjesën në vijim të këtij Materiali, do të shpjegojmë këto 5 reagime.

Respektimi i rregullave

Më poshtë jepen disa shembuj të demonstrimit të respektimit të rregullave dhe të autoritetit legjitim:

- Respektoni gjithmonë procedurat e duhura (të burgjeve), duke përfshirë edhe raportimin e incidenteve dhe të shkeljeve sipas rastit.
- Jini gjithmonë të drejtë dhe të paanshëm, duke u kujdesur që të mos ndikoheni nga paragjykimet tuaja personale në sjelljen apo vendimmarrjen tuaj.
- Kryeni detyrat tuaja teknike, ndonëse të rëndomta, në mënyrë të kujdesshme dhe të vetëdijshme.
- Jini të përpiktë, të veshur mirë dhe me kujdes.
- Shmangni çdo përplasje me pretendimet e të burgosurve për pafajësi apo pretendime se dikush “u ka ngritur kurth”, se janë ndjekur nga policia, etj.

Autokontrolli

Si vijon janë disa shembuj të autokontrollit:

- Menaxhoni me efikasitet emocionet tuaja - mundohuni të shmangni përdorimin e gjuhës jo të përshtatshme, shpërthimet e nervave, etj.
- Vazhdoni të silleni mirë edhe përballë armiqësisë apo provokimeve.
- Trajtojini konfliktet në mënyrë të vendosur, por me durim.

Mospranimi i dhunës

Ja disa shembuj të mospranimit të dhunës:

- Përdorni vazhdimisht aftësitë verbale për qetësimin e situatave ku ka kërcënim për dhunë.
- Mos iu përgjigjini sjelljeve intimiduese/kërcënuese të të burgosurve.
- Shmangni komentet, shakatë apo vërejtjet, etj. që nënkuptojnë se i jepni

rëndësi dhunës.

- Nëse nevojitet forcë fizike (si p.sh. C&R), bëjeni këtë në mënyrë humane dhe duke përdorur nivelin më të ulët të forcës që nevojitet.

Ndershmëria dhe besueshmëria

Ja disa shembuj të ndershmërisë dhe besueshmërisë:

- Thoni gjithmonë të vërtetën
- Mbajini gjithmonë premtimet
- Pranojeni kur jeni gabim. Mos u përpiqni të sajoni informacione për të mbuluar gabimet

Respektimi i të tjerëve

Ja disa shembuj të respektimit të të tjerëve:

- Shfaqni një qëndrim të respektueshëm ndaj kolegëve, të burgosurve dhe vizitorëve
- Shmangni çdo koment apo barcaletë raciste apo seksiste
- Tregoni që jeni të gatshëm të ndihmoni dhe të kujdeseni për individin

Përforcimi i sjelljeve prosociale është një përbërës i rëndësishëm i MPS dhe përdoret për të garantuar se u qëndrojmë vazhdimisht atyre sjelljeve që dëshirojmë të promovojmë duke i shpërblyer kur i shohim të ndodhin.

B. Përforcimi efikas

- I fortë, empatik dhe i menjëhershëm
- Arsye të qarta
- I dallueshëm nga mbështetja 'kontekstuale', shqetësimet dhe interesat
- Empatik

Çfarë shpërblimesh mund të ofrojmë?

- Lavdërim
- Kohë
- Komente pozitive në dosje dhe në raporte
- Avokaci (mbrojtje)
- Rritje/zvogëlim të kontakteve
- Pak më shumë tolerim

Lavdërimi është përforcimi më i fuqishëm që ka aktualisht në dorë stafi

- Ajo që është më e rëndësishmja është se ky lloj përforcimi duhet të lidhet qartë me një sjellje specifike dhe të shprehet mjaftueshëm qartë dhe kjo lidhje të shprehet aq qartë, sa i dënuari të mund ta bëjë lidhjen.
- Komentet përforcuese nuk duhet të jenë asnjëherë të përgjithshme.
- Komentet përforcuese duhet të jenë komente vërtet të ndjera dhe jo sa për të thënë.
- Komentet e bëra formalisht shumë shpejt e humbasin ndikimin që kanë tek i dënuari.
- Komentet përforcuese duhet të lidhen gjithmonë me sjelljen e të dënuarit.

Përforcimi nuk duhet të jetë asnjëherë i përgjithshëm: kjo do të thotë se nëse i bëni komente apo vlerësime të dënuarit për një sjellje specifike, duhet t'i thoni më shumë sesa "E bërë mirë këtë gjë" - ky lloj pohimi apo komenti do të klasifikohet si mbështetje kontekstuale dhe tepër e përgjithshme për dikë që ka nevojë të mësojë nga kjo, prandaj duhet të jenë gjithmonë specifike lidhur me sjelljen për të cilën i bëni të dënuarit komente. Përforcimi duhet të jetë gjithmonë diçka që ndihet vërtet, përndryshe nuk ka asnjë lloj ndikimi tek njerëzit dhe ata nuk do t'ju besojnë, ndërkohë që ju dilni të pasinqertë dhe sikur i merrni në patronazh.

Përforcimet automatike janë si pagat, i merr rregullisht dhe pas njëfarë kohe ato e humbasin ndikimin si një lloj shpërblimi apo inkurajimi - shpërblimet dhe inkurajimet funksionojnë shumë më mirë kur personi nuk i pret.

Koha. Përdorimi i kohës është koncept interesant dhe mund të përdoret për komente përforcuese, ashtu edhe për të pranuar sjellje të caktuara - është pikërisht mënyra se si e përdorni kohën ajo që është e rëndësishme!!! Ose mund të përdorni më shumë kohë sesa është planifikuar për t'i ndihmuar dhe për t'i inkurajuar ose për t'i kontrolluar më shumë dhe për të menaxhuar sjelljet e vështira. Koha është një veçori e rëndësishme e kësaj qasjeje, por është e rëndësishme që njerëzve t'u shpjegohet qartë se pse po u jepet më shumë kohë.

Avokacia apo mbrojtja është mënyra e të ofruarit më shumë mbështetje për një person, duke e ndihmuar dhe duke folur në emër të tij apo të saj, si p.sh. me punëdhënësin apo në një institucion arsimor, në mënyrë që ai apo ajo të mund të integrohet më lehtë.

Rritja ose zvogëlimi i kontakteve mund t'ju ndihmojë nëse i shpjegoni qartë personit se pse po e bëni këtë, si p.sh. mund t'i thoni se po i mundësoni më shumë kontakte sepse besoni se kjo do ta ndihmojë atë që të arrijë qëllimet e veta ose t'i thoni se po ia zvogëloni kontaktet, sepse ai apo ajo nuk po ecën edhe aq mirë dhe se në fakt nuk duket i motivuar. Pra, është arsyeja pse po e bëni diçka; gjykimi dhe njohuria juaj profesionale për mënyrën se si funksionon individi është i rëndësishëm në këtë aspekt.

Të bësh diçka më tepër thjesht do të thotë të bësh diçka shtesë për një person si një lloj vlerësimi për progresin që ai ka bërë duke u përpjekur dhe përtej asaj që mund të bëjë një person në rrethana të zakonshme.

Shprehja e mosmiratimit për sjellje të papranueshme është elementi i katërt i qasjes prosociale Trotter. Mosmiratimi nuk duhet të përpiket që të fajësojë, të ndëshkojë apo të gjykojë - këto qasje janë të destinuara të dështojnë dhe për këtë do themi diçka më vonë. Kur flasim për shprehjen e mosmiratimit, duhet të kujdesemi për sa vijon:

Mosmiratimi efikas

- I fortë, empatik dhe i menjëhershëm
- Shtjellimi i arsyeve
- Kontrasti me nivelet e mëparshme të ngrohtësisë, interesit dhe shqetësimit
- Reagimet e menjëhershme ndaj ndryshimeve

Rregulli: “Sjellja dhe jo personi” dhe vendosja e “Targeteve reale për ndryshim”

Ne kemi një tendencë që të theksojmë gjërat që njerëzit bëjnë gabim dhe të fokusohemi tek dobësitë dhe gabimet e tyre. Ky studim thotë se duhet të përqendrohemi tek gjërat që njerëzit i bëjnë mirë dhe që të theksojmë më shumë gjërat pozitive sesa ato negative - përqendrimi tek pikat e forta dhe jo tek pikat e dobëta të njerëzve, 4 gjëra pozitive për një gjë negative.

Çfarë qasjesh mund të përdoren?

- Reagimet me vonesë
- Të shpjegosh se pse nuk je dakord
- Komentë negative në dosje/raporte
- Kontakte të shtuara/të zvogëluara

Reagimet e vonuara. Shumë persona mësojnë gjatë jetës se mund të marrin më lehtë vëmendje duke u sjellë keq, ose duke shpërqendruar, ose duke u larguar nga ajo çfarë thuhet – ky studim e pranon këtë dhe thotë se ndonjëherë veprimi i duhur është që sjellje të tilla shpërqëndruese të shpërfillen dhe jo t’u kushtohet vëmendje tendencave të shpërqëndruesit - në këtë mënyrë, sjelljet e padëshiruara zvogëlohen - stafi duhet të jetë më pak reagues ndaj këtyre situatave për t’i menaxhuar - kjo kërkon aftësi dhe një lloj gjykimi profesional, por mund të funksionojë mirë në çdo moment.

Module Trajnimi

Pjesa e Dytë

Moduli 1: Siguria statike, procedurale dhe dinamike

(4 orë)

Objektivat: Në fund të modulit pjesëmarrësit do të:

- kenë njohuri për standardet ndërkombëtare për sigurinë në burgje, përfshirë sigurinë statike, procedurale dhe dinamike;
- përshkruajnë mënyrat e garantimit të sigurisë fizike;
- përshkruajnë tiparet kryesore të sigurisë dinamike;
- kuptojnë se si kushtet e punës kontribuojnë në rendin dhe sigurinë e mirë në burg;
- kuptojnë se si kushtet fizike kontribuojnë në një mjedis jetësor pozitiv dhe të sigurt në burgje.

Hyrje (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në këtë modul, trajtojmë aspektet e sigurisë në burg. Së pari, do të diskutojmë shkurtimisht Rregullat Evropiane të Burgjeve në lidhje me sigurinë në institucion. Më pas, do të ndalemi në aspektet fizike ose statike, procedurale dhe dinamike të sigurisë, kushtet e përshtatshme të punës dhe ndikimin e kushteve fizike në një mjedis jetese të sigurt dhe pozitiv në burgje.

Çdo institucion penal dhe autoritet burgu ka për detyrë parësore garantimin e sigurisë së të dënuarve, personelit dhe vizitorëve. Ata duhet të jenë të sigurt nga çdolloj dhune apo kërcënim ndaj jetës dhe shëndetit. Edhe komuniteti ka të drejtë të presë që anëtarët e vet të mbrohen nga krimi. Masat e sigurisë përdoren për të ruajtur rregullin dhe kontrollin brenda institucioneve penale. Të gjitha masat e sigurisë duhet të monitorohen dhe duhet t'i nënshtrohen kontrollit.

Garantimi i një burgu të sigurt përfshin: marrjen e masave të duhura të sigurisë fizike; marrjen e masave efektive të sigurisë procedurale dhe kontributi në këtë mënyrë për sigurinë dinamike.

Shënime për trajnerët

Rregullat përkatëse Evropiane të Burgjeve janë nenet 51-55. (Materiali 1)

Trajneri shpërndan Materialin 1 dhe sqaron rregullat 51.1 -51.5. Leximi i Rregullave 52-55 është detyrë shtëpie.

Neni 51.1. Masat e sigurimit që aplikohen për çdo person të burgosur, janë masa minimale të mundshme për të pasur një ndalim të sigurt.

Neni 51.2. Sigurimi që ndalohet nëpërmjet pengesave fizike dhe mjeteve të tjera teknike plotësohet nga sigurimi dinamik i ofruar nga personeli që është në gatishmëri, i cili njeht të dënuarit që janë nën kontrollin e tij.

Neni 51.3 Menjëherë pas pranimit, të burgosurit duhet të vlerësohen për të përcaktuar rrezikun që paraqesin për komunitetin në rast se:

a. arratisen,

b. përpiqen të arratisen vetë ose me ndihmën e të tjerëve.

Neni 51.4 Më pas, çdo i burgosur mbahet në kushte sigurie që u përkojnë niveleve të rrezikut që ato paraqesin.

Neni 51.5. Niveli i nevojshëm i sigurimit rishikohet në intervale të rregullta gjatë gjithë kohës së burgimit të një personi.

Shënime për trajnerët

Trajneri fillon me një reflektim mbi atë që nënkuptojnë termat rend dhe siguri.

Trajneri pyet grupin: “Cili është kuptimi i rendit dhe sigurisë? I burgosur?”

Pasi ka marrë përgjigje nga grupi, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Rend: shkalla në të cilën mjedisi i burgut është i strukturuar, i qëndrueshëm, i parashikueshëm dhe i pranueshëm.

Sigurimi (safety): një ndjenjë mbrojtjeje nga dëmet, kërcënimet ose rreziqet, dhe besimi fizik dhe psikologjik tek mjedisi.

Siguria (security): i referohet mbrojtjes së individëve, organizatave dhe pronave nga kërcënimet e jashtme që kanë të ngjarë të shkaktojnë dëm.

Është e qartë se *siguria (security)* në përgjithësi përqendrohet te marrja e masave që faktorët e jashtëm të mos shkaktojnë telashe ose situata të padëshiruara për organizatën, individët dhe asetet brenda ambienteve. Prandaj, *siguria (security)* është procesi i garantimit i të qenurit i sigurt (*safety*).

Nga ana tjetër, *sigurimi (safety)* është ndjenja e mbrojtjes nga faktorët që shkaktojnë dëm. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se një individ që kontrollon faktorët që shkaktojnë rrezik duhet të ketë ndjenjën e të qenit i sigurt. Ndjenja e të qenit i sigurt është një aspekt emocional, ndërsa *siguria* ka të bëjë me aspektet fizike.

Rendi, *siguria* dhe *sigurimi* janë pjesë e një tabloje më të madhe që lidhen me kontributin e Shërbimit të Burgjeve në qëllimet e Sistemit të Drejtësisë Penale (shih Materialin 1 dhe figurën). Përmes ekzekutimit të sanksionit të privimit të lirisë, Shërbimi i Burgjeve kontribuon në dy qëllimet e lartpërmendura kryesore të Sistemit të Drejtësisë Penale 1) rivendosjen e drejtësisë dhe 2) parandalimin/zvogëlimin e krimit dhe rritjen e sigurisë së komunitetit.


Duke qenë pjesë e sistemit të drejtësisë penale, Shërbimi i Burgjeve kontribuon për arritjen e qëllimeve të sistemit duke u angazhuar për realizimin e strategjisë **për ekzekutimin e dënimeve me burgim (Materiali 2):**

- Shërbimi i Burgjeve siguron në radhë të parë një mjedis burgu që karakterizohet nga **rendi, siguria** (mbajtja e të burgosurve brenda). Ruajtja e rendit, qetësisë, sigurisë (dhe të sigurimit) në burg përfaqëson **themelin** e domosdoshëm për ekzekutimin pa probleme të dënimeve nga ana e Shërbimit të Burgjeve - **(Niveli 1)**.
- Ky mjedis burgu i karakterizuar nga rendi, paqja, *siguria* fizike dhe ndjesia e sigurisë hedh bazën për një **ekzekutim human** të dënimit me burg që karakterizohet nga një trajtim me dinjitet dhe të drejtë i të burgosurve, pa vuajtje të panevojshme dhe pa dëmtime të integritetit të tyre personal - **(Niveli 2)**.
- Një mjedis burgu që karakterizohet nga rendi, *siguria* fizike, *sigurimi* dhe humaniteti

ofron kushte të mira për zhvillimin e **marrëdhënieve pozitive dhe konstruktive** midis personelit të burgut dhe të burgosurve. Në këtë klimë, të burgosurit ndihen të **besuar** dhe të **mbështetur** në marrjen e përgjegjësisë dhe sjelljen me përgjegjësi - **(Niveli 3)**.

- Niveli i mëparshëm 3 ofron një bazë të shëndoshë për hapin tjetër të promovimit të një **procesi të reformës, rehabilitimit dhe rikuperimit personal** përmes shërbimeve në fushën e kujdesit (shëndetit), aktiviteteve dhe kontakteve me njerëz ose institucione të tjera të rëndësishme në botën e jashtme - **(Niveli 4)**.

Materiali 2



1. Siguria fizike (ose statike) (40 minuta)

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të imagjinojnë veten duke qëndruar jashtë një burgu, para ndërtesës së burgut dhe të shkruajnë (ose vizatojnë) atë që shohin.

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Ajo që shihni në pjesën e jashtme të ndërtesës së burgut janë elementë të **sigurisë fizike** të cilat përfshijnë arkitekturën e ndërtimit dhe të mureve të ndërtesës së burgut, hekurat e dritareve të qelive, rrethimet e jashtme dhe kullat e vrojtimit. Për më tepër, shikon edhe masa të sigurisë elektronike të tilla si kamera, sisteme alarmi, tela të veçantë me gjemba dhe një portë kryesore.

Muret ose rrethimet e lidhura me zinxhirë të dyfishtë me ose pa kulla vëzhgimi,

porta kryesore, “dyert dopio” (hyrje të sigurt, të kontrolluara për stafin, vizitorët dhe automjetet) dhe instalimi i telave me gjemba i referohen të ashtuquajturit **perimetër** të ndërtesës së burgut.

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të imagjinojnë veten duke hyrë në ndërtesën e burgut përmes portës kryesore dhe duke bërë një turne nëpër të gjithë ndërtesën. Trajneri i kërkon grupit që të krijojë ide mbi përbërësit fizikë të brendshëm të ndërtesës së burgut që duhet të sigurohen siç duhet.

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kushtet e sigurisë së infrastrukturës së burgut përfshijnë elemente të tilla si:

- Siguria e perimetrit;
- Patrullimi i perimetrit;
- Kulla e vrojtimit;
- Sigurimi i portës kryesore;
- Shoqërimi dhe siguria e të burgosurve;
- Akomodimi i të burgosurve;
- Ambientet e ushtrimeve/ajrosjes së të burgosurve;
- Ambientet e vizitave;
- Ambiente administrative të ndryshme si kuzhina, logjistika/magazina, shëndetësia, edukimi/formimi profesional, punësimi në burg, etj..;
- Kontrolli kryesor;
- Pajisjet e armatimit.

Për çdo element të mësipërm të infrastrukturës duhet të identifikohen qartë detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë specifike, si dhe të përshtaten sipas kushteve të veçanta të çdo burgu.

Është e rëndësishme që struktura e ndërtesës ose infrastruktura e burgut dhe elementet e sigurisë të jenë në ekuilibër me dinjitetin human të personave.

Siguria fizike garantohej edhe nga personeli, e në këtë kuptim, i gjithë personeli ka për detyrë të bëjë punë kontrolluese, verifikuese dhe parandaluese dhe të veprojë kur vihet në rrezik siguria. Disa anëtarë të personelit punësohen për të përmbushur detyra që lidhen me sigurinë.

Në praktikën e përditshme, pas pranimit në institucion, të dënuarit të mbahen në një seksion të veçantë aty ku mund të vëzhgohet sjellja e tyre. Përgjatë dy javëve mund të zbulohet nëse gëzojnë shëndet të plotë dhe çfarë lloj mbështetjeje u nevojitet. Gjithashtu, mund të vëzhgohet nëse dhe në ç’ mënyra mund të paraqesin rrezik për veten, personelin dhe të dënuarit e tjerë, mund të vlerësohet se çfarë rreziku ekziston që ai të arratiset dhe mund të vëzhgohet sjellja e tyre e përgjithshme. Kjo është një kërkesë e parashikuar në aktet ligjore e nënligjore. Por ndodh që të mos zbatohet për arsye mbipopullimi. Duke u vendosur i dënuari në mjediset e banimit të dënuarve të tjerë, mund të shkaktohen probleme në lidhje me sigurinë e tij. Gjithashtu, personeli nuk ka mundësi të vëzhgojë nga afër dhe të bëjë vlerësimin e tij.

Pas kësaj periudhe vëzhgimi, i dënuari duhet të vendoset në një seksion që është i/e përshtatshëm për cilësitë e tij/e saj. Për këtë arsye, është e nevojshme të krijohen seksione të ndryshme me regjime të ndryshme në paraburgime dhe burgje.

Në burgje dhe paraburgime zbatohen disa procedura vlerësimi dhe mbikëqyrjeje të dënuarve për të cilat plotësohen disa formularë standardë, si dosjet psiko-sociale, vlerësimi i sjelljes, edhe disa formularë vlerësimi nga shërbimi i sigurisë. Përpara se personi të vendoset në regjimin përkatës, ai duhet të ndërmarrë procedurën e vlerësimit të riskut, e cila mundëson një ndarje objektive në regjimet e duhura.

Për klasifikimin e sigurisë janë krijuar institucione të sigurisë së lartë, të zakonshme dhe të ulët, si dhe institute të veçanta, të cilat kanë të bëjnë me grupe specifike dhe të cënueshme.

Një proces efektiv i klasifikimit përqendrohet te nevojat individuale të burgosurve, duke iu larguar qasjes tradicionale të trajtimit të njëjtë të gjithë të burgosurve. Përpjekja për të menaxhuar të gjithë të burgosurit njësoj me supozimin se të gjithë paraqesin të njëjtin nivel risku është e padrejtë dhe përdorim joefikas i burimeve.

Gjatë tre dekadave të fundit, janë kryer kërkime të konsiderueshme mbi faktorët që parashikojnë sjelljen e të burgosurve (sjellje të papërshtatshme) dhe recidivizmin. Pavarësisht vështirësive që lidhen me parashikimin, sistemet objektive të klasifikimit të burgjeve që *përdorin kriteret e besueshme dhe të vlefshme të vlerësimit* kanë provuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të suksesshme klasifikimin e të burgosurve sipas nivelit të riskut që ata paraqesin për përfshirjen në *sjellje të papërshtatshme* në burg.

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të shkruajnë individualisht se cilët janë faktorët që parashikojnë sjelljen e keqe të burgosurve.

Ushtrim

Faktorët parashikues të sjelljes së keqe të burgosurve.

Pyetje: cilët janë faktorët që parashikojnë sjelljen e keqe të burgosurve?

1.....

2.....

3.....

Kontributi i trajnerit

Në përgjithësi, faktorët e konsideruar si parashikues të sjelljes së të burgosurve janë si më poshtë³¹:

- Mosha aktuale: Të burgosurit e moshuar janë më pak të përfshirë në të gjitha format e sjelljes së keqe;
- Gjinia: Femrat janë më pak të përfshira në incidente të dhunshme;

31 Austin, J. (2003) Gjetje në Klasifikimin e Burgjeve dhe Vlerësimin e Rrezikut. Instituti Kombëtar i Korrektimit. Universiteti George Washington

- Historia e dhunës: Të burgosurit me histori dhune të kohëve të fundit kanë më shumë gjasa ta vazhdojnë atë sjellje;
- Historia e sëmundjeve mendore: Të burgosurit me histori të tilla kanë më shumë gjasa të përfshihen në të gjitha format e sjelljes së keqe;
- Anëtarësimi në banda: Anëtarët e bandave kanë më shumë gjasa të përfshihen në të gjitha format e sjelljes së keqe;
- Pjesëmarrja në programet e ofruara: Të burgosurit që nuk janë të përfshirë në programe, ose nuk i kanë përfunduar programet, kanë më shumë gjasa të përfshihen në të gjitha format e sjelljes së keqe;
- Veprimet e fundit disiplinore: Të burgosurit që kanë qenë kohët e fundit (12 muajt e fundit) të përfshirë në sjellje të keqe kanë më shumë gjasa të vazhdojnë të përfshihen në sjellje të tjera shkatërruese në të ardhmen.

Gjatë viteve të fundit, me ndërtimin e burgjeve të reja dhe rikonstruktimin e institucioneve të vjetra, tendenca është që, në të njëjtin institucion, të përqendrohen regjime të ndryshme, si: regjimet e paraburgimit dhe regjimet me siguri të lartë, të zakonshme dhe të ulët. Përveç këtyre zhvillimeve pozitive të pasjes së një varieteti regjimesh në institucione shumë-funksionale, ekziston nevoja e ndarjes së regjimeve për të siguruar zbatimin e planit të dënimit të dënuarve duke nisur që nga situata e paraburgimit në institucione të mbyllura, më tej në gjysmë të hapur dhe në përfundim të dënimit në regjime apo institucione të hapura, si edhe programe trajtimi sipas specifikave të grupeve të ndryshme në burgje. Kjo do të ndihmojë në parapërgatitjen e të dënuarit/së dënuarës për t'u integruar në shoqëri, gjë e cila do të përmbushte edhe njëherë nga detyrat më kryesore të sistemit të burgjeve kundrejt personave nën kujdesin e tij.

SHIH DETYRËN E SHTËPISË PËR REGJIMET E NDRYSHME NË FUND TË KËTIJ MODULI

Siguria fizike ka të bëjë edhe me kontrollin fizik dhe kontrollet në përgjithësi. Neni 54.1-54.10 i Rregullave Evropiane të Burgjeve shpreh nevojën për procedura të hollësishme që lidhen me çfarë, kë dhe ku të kontrollohet. Kjo pjesë adresohet në një modul më vete.

Në çdo burg duhet të ketë persona të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë mjekësore, shuarjen e zjarrit dhe kontrollin e revoltave. Pajisjet duhet të gjenden pranë dhe të jenë në gjendje të mirë. Personeli duhet të jetë i ndërgjegjshëm për incidentet që ndodhin mes të dënuarve. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e vetëvrasjes dhe të jenë të qartë mbi ekzistencën e abuzimit (seksual) mes të dënuarve. Në rastet e duhura, personeli merr masat e nevojshme për të mbrojtur të dënuarit e cënueshëm.

Mënyra e përballimit të incidenteve të rënda duhet të shprehet në protokolle/procedura të qarta të cilat janë në përputhje me ligjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

2. Siguria procedurale (30 minuta)

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet: çfarë është një procedurë dhe cilat janë tiparet e një procedure të mirë?

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh

Kontributi i trajnerit³²

Një procedurë mund të përkufizohet si një proces i standardizuar apo qasje që siguron rregullin, qëndrueshmërinë dhe drejtësinë, i cili ndihmon drejtuesit dhe stafin e burgjeve për kryerjen e detyrave funksionale. Procedurat përfshijnë pikat bazë që shërbejnë si një lloj kontrolli shtesë për tu siguruar që puna po kryhet si duhet. Gjithashtu, procedurat mund të japin informacion të detajuar në lidhje me problemet e veçanta që janë të njohura dhe ndodhin. Në bazë të politikave, procedurat përcaktojnë se si të kryhet një detyrë në mënyrë optimale dhe sigurojnë zbatim të standardizuar në çdo burg dhe në të gjitha burgjet.

Procedurat:

- Përshkruajnë mënyrën e zbatimit të politikave
- Identifikojnë një sërë hapash që duhen ndërmarrë për të arritur një qëllim përfundimtar
- Përcaktojnë mekanizmat për zbatimin e politikës
- Sigurojnë një referencë të shpejtë në kohë krize
- Janë baza e trajnimit të stafit
- Ndihmojnë për të eliminuar problemet që shfaqen gjithmonë në një pikë

Procedurat cilësore kanë këto karakteristika. Shkruhen dhe paraqiten në një stil dhe formë të qartë dhe të kuptueshme; nxirren në kohë për zbatimin e duhur të tyre; konceptohen sa më shkurt që të jetë e mundur, duke mos përfshiruar materialet relevante; janë të zbatueshme dhe të aplikueshme, të riprodhueshme dhe mund të përditësohen dhe/ose të hiqen.

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet: cilat janë aspektet e sigurisë procedurale në burg?

Kontributi i trajnerit

Masat e sigurisë procedurale në burgje janë thelbësore për përmirësimin e sigurisë dhe për parandalimin e arratisjeve pasi mundësojnë që rreziqet të vlerësohen dhe të trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

Rëndësia e procedurave të sigurisë: Këto procedura mundësojnë identifikimin e rreziqeve të cilat më pas mund të trajtohen në mënyrë të duhur. Si rezultat, të gjithë të burgosurit janë nën kontroll edhe në rastet kur mund të cenohet apo shkelet siguria fizike. Procedurat e sigurisë ndiqen gjatë gjithë kohës. Ato kanë si qëllim:

- Identifikimin dhe izolimin e rreziqeve të mundshme të sigurisë;
- Trajtimin dhe izolimin e rreziqeve fizike;
- Të gjitha procedurat kanë nevojë për plotësimin e dokumenteve dhe shënimeve përkatëse.

32 Manualin e Trajnerit të KiE-s për Sigurinë Dinamike, 2018. <https://rm.coe.int/final-training-manual-on-dynamic-security-june-2018-koregiran-4-/16808ccae2>. Udhëzues mbi menaxhimin e të burgosurve me rrezik të lartë. 2016. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/HB_on_High_Risk_Prisoners_Ebook_appr.pdf

Procedurat e sigurisë në burgje mbulojnë shumë aspekte të punës që lidhen me sigurinë. Së paku, praktika e mirë sugjeron që duhet të ketë procedura që mbulojnë:

- strategjinë e kontrolleve dhe kryerjen e kontrolleve;
- monitorimin dhe raportimin për të burgosurit;
- raportimin për sendet që paraqesin rrezik, siç janë mjetet e ndryshme;
- monitorimin e kontaktit me botën e jashtme;
- vlerësimin dhe klasifikimin e të burgosurve;
- komunikimin dhe mbikëqyrjen; dhe
- mbledhjen e informacionit dhe sistemet inteligjente të sigurisë.

Më poshtë paraqiten shembuj konkretë për të evidentuar detyra të caktuara ditore dhe procedura të zakonshme për burgjet: vënia e prangave; kontrollet e automjeteve, mbikëqyrja e lëvizjeve; kontrolli i qelive; komunikimi me radio; kontrolli i çelësave/bravave; kontrolle të planifikuara: plani i kontrollit është një komponent kyç i planit vjetor të punës të çdo institucioni. Kontrolli duhet të konsiderohet si një element bazë i kërkesave të çdo institucioni për një mjedis të sigurt dhe të qetë.

Të gjitha procedurat kanë nevojë për plotësimin e regjistrave dhe dokumenteve shoqëruese. Menjëherë pas identifikimit dhe izolimit të një risku të mundshëm të sigurisë dhe rreziqeve fizike, duhet të plotësohen raportet përkatëse.

3. Siguria dinamike (një orë)

Kontributi i trajnerit

Masat e sigurisë fizike dhe procedurale janë karakteristika thelbësore të çdo burgu, por në vetvete ato nuk janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e të burgosurve.

Siguria varet edhe nga ndërgjegjësimi i stafit për ndërveprimin dhe njohjen e të burgosurve në institucion; zhvillimin e marrëdhënieve pozitive staf-të burgosur; vigjilenca e stafit për atë që ndodh në burg; trajtimi i drejtë dhe ndjenja e “mirëqenies” midis të burgosurve; angazhimi i stafit për të siguruar që të burgosurit aktivizohen në aktivitete konstruktive dhe të dobishme që kontribuojnë në ri-integrimin e tyre në shoqëri në të ardhmen.

Ky koncept shpesh përshkruhet si siguri dinamike dhe po aplikohet gjithnjë e më shumë në nivel global.³³

Prandaj, siguria nuk ka të bëjë vetëm me ngritjen e barrierave fizike, por edhe me të ashtuquajturën siguri dinamike që nënkupton ndërveprimin mes personelit dhe të dënuarve. Personeli i trajnuar mund të vlerësojë rreziqet dhe duke qenë i vetëdijshëm për atë që ndodh në burg, mund të garantojë që të dënuarit të mbeten aktivë në një mënyrë pozitive. Një tjetër fjalë për sigurinë dinamike është *siguria psikologjike* dhe kjo do të thotë që siguria arrihet më mirë duke *ndërtuar marrëdhënie pozitive mes personelit dhe të dënuarve*.

Të dënuarit mund të menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe pozitive vetëm nëse ata bashkëpunojnë. Siguria e jashtme (evitimi i arratisjeve) dhe siguria e brendshme (evitimi i trazirave) arrihen më mirë duke ndërtuar marrëdhënie të mira mes personelit

33 Udhëzues për Sigurinë Dinamike dhe Inteligjencën e Burgjeve, UNODC, 2015, f. 29.

dhe të dënuarve. Të dënuarit duhet të trajtohen me mirësjellje dhe me respekt për të drejtat e tyre të njeriut, duke u bërë të qartë zgjedhjet që kanë dhe pasojat e tyre. Po kështu duhet t'u ofrohet ndihmë për vetëzhvillim.

Në këtë pikë merr rëndësi të madhe krijimi i një programi të mirë ditor që i krijon të dënuarve mundësi pozitive me interes për të ardhmen. Personeli mund të kontribuojë në këtë zhvillim pozitiv duke dhënë ndihmesën e vet në aspekte të ndryshme të programit ditor. Gjithashtu, personeli duhet të ketë kontakte të ngushta, por profesionale me të dënuarit. Ky lloj kontakti i ofron personelit informacion rreth të dënuarve dhe u jep mundësi të marrin masat e nevojshme. Personeli duhet t'i informojë kolegët mbi gjëra që ata duhet të dinë për të qenë të aftë të ofrojnë mbështetje optimale ose për të ndërhyrë gjatë incidenteve ose para se ato të ndodhin. Përdorimi i të dënuarve si informatorë nuk është i këshillueshëm jo vetëm për arsye etike, por edhe për shkak të besueshmërisë së informacionit dhe situatës së rrezikshme ku mund të futet informatori. Përveç kësaj, të dënuarit presin një lloj shpërblimi në këmbim të shërbimit të tyre dhe sistemi i burgimit zor se mund të japë shpërblime.

Shënime për trajnerët

Trajneri kërkon nga pjesëmarrësit që të diskutojnë për tiparet e marrëdhënieve profesionale dhe konstruktive të stafit të burgut me të burgosurit. Ky ushtrim do të bëhet në grupe dyshe.

Ushtrim

Pyetje: Cilat janë tiparet e marrëdhënieve profesionale dhe konstruktive të stafit të burgut me të burgosurit?

- 1.....
- 2.....
- 3.....

Kontributi i trajnerit

Stafi i burgut duhet të zhvillojë dhe të mbajë marrëdhënie profesionale me të burgosurit. Indikatorët e suksesit të sistemit të burgjeve evidentohen nga përpjekjet e stafit të burgut për të punuar në mënyrë konstruktive me të burgosurit dhe duke shfaqur intelektin dhe maturinë profesionale. Siguria dinamike ndodh kur punonjësit e burgjeve ndërveprojnë dhe komunikojnë me të burgosurit gjatë punës së tyre duke:

- kontrolluar vazhdimisht dhe gjatë kryerjes së detyrës si punonjës burgu;
- folur me të burgosurit, duke fituar besimin e tyre dhe duke ndërtuar një raport me ta;
- kontrolluar mirëqenien fizike të burgosurve gjatë kontrolleve të rregullta;
- ruajtur një qasje të qëndrueshme ndaj sjelljes së papërshtatshme;
- inkurajuar një sjellje pozitive dhe duke adresuar sjelljet negative;
- u angazhuar në procesin e menaxhimit të rasteve;
- i ndjekur kërkesat në kohën e duhur; dhe
- ruajtur qetësinë gjatë incidenteve.

Siguria dinamike është shumë më efektive sesa masat statike të sigurisë fizike dhe procedurale. Aty ku ka kontakte të rregullta me të burgosurit, një punonjës vigjilent do të reagojë ndaj situatave të cilat janë të ndryshme nga normat dhe që mund të paraqesin një kërcënim për sigurinë. Stafi i cili është i angazhuar me të burgosurit në këto mënyra do të jetë në gjendje të parandalojë arratisjet dhe incidentet që ndodhin³⁴.

4. Si kontribuojnë kushtet e punës në rendin dhe sigurinë e mirë në burg (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Kushtet e punës prekin personelin dhe të burgosurit.

Në Rregullat Evropiane të Burgjeve, *rregulli 26.13* thotë se masat parandaluese shëndetësore dhe të sigurisë për të dënuarit duhet t'i mbrojnë ata si duhet dhe nuk duhet të jenë më rrepta nga çka zbatohet për punonjësit jashtë. *Rregulli 26.15* thotë se orari maksimal i punës ditore apo javore për të dënuarit duhet të përcaktohet në përputhje me rregullat vendore apo traditat që rregullojnë punësimin e punëtorëve ditor.

Në përgjithësi mund të thuhet se të dënuarve duhet t'u ofrohen kushte të sigurta pune dhe se për punën që bëjnë, ata duhet të marrin një pagesë të përshtatshme. Kushte të sigurta do të thotë punishte të ndriçuara mirë, të ajrosura mirë, me hapësirë të mjaftueshme pune për çdo individ, një orar normal pune, pushim të rregullt gjatë orarit, kërkesa të arsyeshme për rezultatet e punës së tyre, pajisje të sigurisë në punë, udhëzime të qarta për sigurinë, udhëzime të qarta për punën dhe një pagesë e përshtatshme. Udhëzimet për makineritë duhet të jenë të qarta dhe personeli duhet të kujdeset për mbikëqyrjen në punë. Grupet nuk duhet të jenë tepër të mëdha, pasi ato duhen mbajtur nën kontroll dhe mbikëqyrje.

Për kushtet e punës së stafit, është drejtori i burgut që ka si përgjegjësi të garantojë kushte të mira pune për personelin. Kjo do të thotë godina të përshtatshme në gjendje të pranueshme, atmosferë e mirë dhe kushte sigurie në punë. Zyrat dhe vendet e tjera të punës duhet të kenë pajisjet e nevojshme. Kur të jetë e nevojshme, çdo seksion duhet të ketë në dispozicion pajisje moderne, si për shembull: një kompjuter apo laptop.

Gjithashtu, për rastet urgjente, duhen marrë masa në favor të personelit dhe të dënuarve. Pagesa e mirë është e rëndësishme për një sërë arsyesh. Një personel i paguar mirë funksionon më mirë, gjë që ul numrin e arratisjeve, tensionin dhe rezistencën dhe, në fund fare, bën që të dënuarit të veprojnë sipas rregullave. Personeli duhet të ketë të ardhura të mjaftueshme për të ruajtur një standard të arsyeshëm jetese. Personeli duhet të fitojë mjaftueshëm në mënyrë që të mos ketë arsye për të gjetur një punë të dytë. Një tjetër aspekt i pagesës së mirë është që parandalon ndjeshmërinë e personelit ndaj mitë-marrjes. Korrupsioni brenda një institucioni çon në mungesë të ligjit, padrejtësi, frikë, pasiguri, pështjellim, revoltë dhe vë në rrezik jetën. Në fund fare, asnjë palë nuk fiton.

34 Udhëzues mbi Sigurinë Dinamike dhe Inteligjencën e Burgjeve, UNODC, 2015, f.31.

5. Si kontribuojnë kushtet fizike në një mjedis jetësor pozitiv dhe të sigurt në burgje? (një orë)

Kontributi i trajnerit

Kushtet e jetesës në një burg janë ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë ndjenjën e vetëvlerësimit dhe të dinjitetit të një i dënuar. Vendi ku ai ose ajo fle, veshjet që lejohet të mbajë, mënyra dhe ku ha, nëse ka një shtrat me çarçaf e batanije apo fle në dysheme, i mbuluar me rrecka, nëse i lejohet të lahet dhe sa herë lejohet të lahet, nëse mund të shkojë sa herë të ketë nevojë në banjë apo nëse i duhet të pyesë punonjës të rolit bazë sa herë, të gjitha këto kanë një ndikim marramendës në mirëqenien mendore dhe fizike të burgosurit.

Neni 1 i Rregullave Evropiane të Burgjeve, thotë: “Të drejtat e njeriut të gjithë personave të dënuar me heqje lirie duhet të respektohen”.

Neni 4: “Ato kushte në burg që shkelin të drejtat e njeriut nuk mund të justifikohen me mungesë burimesh”.

Neni 5: “Jeta në burg duhet t’i përngjajë sa të jetë e mundur aspekteve pozitive të jetës në komunitet”.

Shënime për trajnerët

Rregullat përkatëse evropiane të burgjeve janë rregullat 17-22 (**Materiali 1**)

Leximi i Rregullave 17-22 dhe përgjigja ndaj pyetjes në lidhje me njërin nga rregullat është për detyrë shtëpie.

Një dhomë nuk mund të krahasohet me mjedisin e jetesës së një personi të lirë. Por ajo që mund të pritet është që i dënuari ta mbajë hapësirën e vet të pastër. Kur një anëtar personeli hyn në një qeli apo fjetore, ai/ajo duhet të njoftojë duke trokitur me çelës në derë se është duke hyrë. Kjo tregon një lloj respekti për të dënuarin dhe hapësirën e tij. Sigurisht, një i dënuar nuk mund të refuzojë hyrjen e personelit në qelinë e tij, por duke iu përmbajtur rregullave të respektit, lehtësohet krijimi i një klime më të shtendosur në burg.

Rregullat Evropiane të Burgjeve parashikojnë:

Rregulla 18.1: Strehimi që u sigurohet të burgosurve, dhe në veçanti kushtet e fjetjes, duhet të respektojë dinjitetin e tyre njerëzor dhe sa të jetë e mundur jetën e tyre private plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe të higjienës, duke i kushtuar kujdesin e duhur kushteve klimatike dhe veçanërisht kushteve të ajrimit, një hapësirë të arsyeshme, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.

Rregulli 18.2: Në të gjitha vendet ku jetojnë, punojnë ose mblidhen të burgosurit:

- a. dritaret do të jenë në madhësi të mjaftueshme për t’iu dhënë mundësi të burgosurve, ndër të tjera, për të lexuar ose punuar me dritë natyrale në kushte normale. Ato do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen e ajrit të freskët, përveç rastit kur ka një sistem të përshtatshëm të ajrimit të kondicionuar;*
- b. drita artificiale do të plotësojë standardet e njohura teknike; dhe*
- c. duhet të ketë një sistem alarmi që u mundëson të burgosurve të kontaktojnë pa vonesë personelin.*

Rregulli 18.3: Kërkesat minimale specifike në lidhje me çështjet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 do të përcaktohen në legjislacionin kombëtar.

Rregulli 18.4: Ligji kombëtar do të sigurojë mekanizma për të bërë të mundur që këto kërkesa minimale të mos shkelen nga mbipopullimi i burgjeve.

Rregulli 18.5: Të burgosurit do të strehohen normalisht gjatë natës në qeli individuale, përveç rasteve kur shihet e nevojshme se strehimi i përbashkët me të burgosurit e tjerë ka avantazhe.

Rregulli 18.6: Në strehimin e përbashkët do të vendosen ata të burgosur që i përshtaten shoqërimin me njëri-tjetrin në këto kushte.

Rregulli 18.7: Për aq sa është e mundur, të burgosurve do t'u jepet mundësia e zgjedhjes përpara se t'u kërkohet të ndajnë qelinë për të fjetur.

Rregulli 18.8: Në shpërndarjen e të burgosurve në institucione apo regjime të ndryshme do të merret parasysh siç duhet për të mbajtur në burg:

- a. të paraburgosurit veçmas nga të dënuarit;*
- b. të burgosurit meshkuj veçmas nga femrat; dhe*
- c. të burgosurit e rinj në moshë veçmas nga të burgosurit më të vjetër.*

Rregulli 18.9: Përjashtime mund të bëhen nga kërkesat për burgim të veçantë në kuptim të paragrafit 18.8 duke i lejuar të burgosurit të marrin pjesë bashkërisht në aktivitetet e organizuara, por këto grupe duhet të ndahen gjithmonë gjatë natës, përveç nëse ata pranojnë të qëndrojnë së bashku dhe autoritetet e burgut gjykojnë se do të ishte në interesin më të mirë të gjithë të burgosurve në fjalë.

Rregulli 18.10: Strehimi i të gjithë të burgosurve duhet të jetë në masa sa më pak kufizuese të sigurisë dhe në përputhje me rrezikun e arratisjes ose dëmtimit të tyre ose të tjerëve.

Rregullat **19.1-19.7** të RREB përmendin nevojën e ruajtjes së shëndetit dhe të higjienës, kujdesin që duhet treguar për kushtet klimatike e veçanërisht përmasave të dhomës, hapësirës kubike të ajrit, ndriçimit ngrohjes dhe ventilimit. Kjo do të thotë se është e nevojshme që në dimër të tregohet kujdes për ngrohjen dhe në verë për qarkullimin e ajrit. Kjo merr më tepër rëndësi kur të dënuarve u duhet të shpenzojnë shumë orë brenda qelisë. Në burgjet e shumë vendeve të ndryshme, fatkeqësisht, mbipopullimi është bërë dukuri shumë përhapur. Mbiipopullimi shkakton shpesh tensione, pasi prania e shumë njerëzve në një hapësirë tepër të vogël mund të bëhet shkak për acarim. Shumë të dënuar nuk kanë shumë të vetësiguri. Për pasojë, kjo mund të shkaktojë agresion. Nëse është e mundur, mbipopullimi duhet luftuar, për shembull përmes një programi që i ofron gjysmës së popullatës aktivitete të ndryshme nga gjysma tjetër. Disa aktivitete madje nuk kushtojnë. Ajrimi dhe sportet janë aktivitete me kosto të ulët që pëlqehen mjaft nga të dënuarit. Një tjetër aktivitet me kosto të ulët dhe tepër i pëlqyer janë vizitat shtesë për të dënuarit. Kur i dënuari nuk mbahet në një burg larg shtëpisë së vet, atëherë vizitat shtesë nuk bëhen barrë e rëndë për familjen e tij.

Të burgosurit janë të detyruar t'i mbajnë pastër banjat dhe dushet. Inspektimin e pastërtisë e bën personeli. Mjediset e fjetjes ndryshojnë. Ndonjëherë çdo i dënuar rri në qeli më vete. Të burgosurit në Shqipëri zakonisht flenë në dhoma të përbashkëta. Disa të dënuarve kjo gjë u pëlqen e disave jo. Epërsia e fjetjes me dikë tjetër në dhomë

është që nuk mbetesh vetëm. Disa thonë se kjo i ndalon të dënuarit t'i bëjnë keq vetes apo të kryejnë vetëvrasje. Sigurisht, mangësia është ndryshimi i pushtetit që ndihet ditë dhe natë. Kjo do të thotë se disa të dënuar mund të detyrohen nga të tjerët të bëjnë gjëra që nuk duan. Ka të ngjarë të ketë abuzime, madje edhe abuzim seksual. Është përgjegjësia e personelit të bëjë kujdes ndaj të dënuarve të cenusëshëm, siç janë djemtë dhe vajzat, autorët e veprave penale seksuale dhe atyre me çrregullime mendore. Është e domosdoshme që gjatë natës të kryhen inspektime të rregullta. Në rast abuzimi, këta të dënuar duhet të ndahen nga të tjerët dhe agresori duhet ndëshkuar. Të dënuarit me të kaluar të dhunshme duhet të mbahen veças grupit.

E njëjta rregull përmend nevojën e ajrimit dhe të ndriçimit të mjaftueshëm. Çdo i dënuar i vendosur në një dhomë me persona të tjerë ka të drejtë për një hapësirë personale prej të paktën 4 m².

Në këtë drejtim, standardet e KPT-së specifikojnë:

- 6m² hapësirë të jetesës për një qeli me një të burgosur të vetëm dhe pajisje sanitare;
- 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me shumë të burgosur dhe anekse plotësisht të ndara sanitare;
- të paktën 2 metra mes mureve të qelisë;
- të paktën 2.5 metra mes dyshemesë dhe tavanit të qelisë.

Çdo dhomë apo qeli ku qëndrojnë të dënuar duhet të ketë ndriçim natyral. E njëjta gjë vlen për personelin: është e ndaluar që ata të punojnë në vende që ndriçohen vetëm nga drita elektrike. Çdo qeli duhet të ketë të paktën një dritare të një madhësie që lejon gjatë ditës të futet dritë e mjaftueshme për të lexuar. Gjatë natës, të gjithë duhet të kenë mundësi të përdorin dritën elektrike.

Higjiena është tepër e rëndësishme për qeniet njerëzore. Jo vetëm që bën mirë për shëndetin, por higjiena rrit respektin për veten. Prandaj është me rëndësi që të dënuarve t'u ofrohen pajisjet dhe mjediset e nevojshme në mënyrë që të mbajnë pastër veten dhe vendin ku banojnë. Kjo nënkupton se ata duhet të lejohen të përdorin banjat dhe dushet. Të dënuarit mund të lahen një herë në javë. Kur është e mundur, të dënuarit duhet të lejohen të lahen përditë. Për të dënuarat, duhet të ketë mjedise shtesë higjiëno-sanitare. Burgu siguron artikujt kryesorë të higjiënës, si: uji, sapuni, pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, artikuj rroje. Për femrat, burgu siguron edhe peceta sanitare.

Çdo i burgosur ka të drejtën të mbajë veshje të përshtatshme. Nisur nga parimi i burgjeve moderne dhe humane, të burgosurve duhet t'u lejohet të veshin rrobat e veta. Në këtë rast, në burg duhet të ketë pajisje për larjen e veshjeve dhe riparimin e tyre. Këto veshje duhet të jenë të përshtatshme. Nëse të dënuarit nuk lejohen të veshin rrobat e tyre ose kur ata nuk kanë rroba mjaftueshëm, autoritetet e burgut duhet t'u sigurojnë atyre veshje të përshtatshme. Kjo gjë vlen edhe për sendet personale, si për shembull furçë dhe pastë dhëmbësh, sapun dhe artikuj rroje.

Ushqimi ka rëndësi të madhe për çdo qenie njerëzore. Në burg ushqimi merr edhe më shumë rëndësi dhe shpeshherë bëhet shkas për ankesa, pa qenë nevoja të themi se ushqimi në burg është gjithmonë i keq. Rregulli 22 parashikon cilësinë e ushqimit. Është e rëndësishme që në përgatitjen e ushqimit të mbahen parasysh rregullat fetare, dietat dhe sëmundjet e të dënuarve. Të burgosurve të mitur duhet t'u jepet më shumë ushqim kur kërkojnë.

Si përfundim: siguria fizike dhe dinamike, si dhe kushtet e sigurisë, mënyra e trajtimit, higjiena, akomodimi, puna dhe programet e rehabilitimit social i shërbejnë krijimit të një klime të sigurt për të dënuarin dhe personelin, nga ana tjetër ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të burgosurit në drejtim progresiv.

Shënime për trajnerët

*Duke përdorur gjetjet e spikatura të studimeve penologjike, vazhdojmë me një kuiz që përmban deklarata që secili pjesëmarrës i shënon individualisht si të **vërteta** ose false.*

Deklaratat i referohen ndikimit në ndjenjat e sigurisë së të burgosurve nga faktorë të tillë si kontaktet me të burgosurit e tjerë, ndërveprimet me stafin, hapësirat personale, besimi midis personelit dhe të burgosurve dhe lloji i masave të sigurisë që janë marrë.

6. Kuiz³⁵

Trajneri lexon deklaratat dhe pyet: a është kjo e vërtetë apo false?

Pyetja 1: Sa më shumë persona janë në qeli, aq më të sigurt ndihen të burgosurit. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë.

Sa më shumë persona të kenë në qeli, aq më pak të sigurt ndihen të burgosurit dhe kjo frikë është më e fortë gjatë natës sesa gjatë ditës.

Pyetja 2: Sa më të mira t'i kenë kontaktet të burgosurit me të burgosurit e tjerë, aq më të sigurt ndihen. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E vërtetë.

Pyetja 3: Një qëndrim armiqësor i stafit të burgut nuk ndikon në ndjenjat e sigurisë së të burgosurve. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë.

Sa më pozitive të jetë përvoja e të burgosurve në marrëdhënien e tyre me stafin, aq më të sigurt ndihen. Një qëndrim mbështetës i stafit mund të rrisë ndjenjat e sigurisë. Sa më shumë të përjetojnë të burgosurit mungesën e besimit në ndërveprimet e tyre me stafin e burgut, aq më pak të sigurt ndihen. Sa më shumë të organizohet klima e burgjeve rreth një theksimi të njëanshëm mbi rrezikshmërinë e të burgosurve, aq më shumë ka gjasa të ketë një kulturë mosbesimi dhe ndjenjë pasigurie tek të burgosurit.

Pyetja 4: Perceptimi i të burgosurve për sigurinë lidhet me disponueshmërinë dhe pajisjen e hapësirës së tyre të jetesës. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E vërtetë.

Edhe këtu ekziston një marrëdhënie negative midis numrit të shokëve të qelisë dhe shkallës në të cilën të burgosurit ndihen të sigurt. Ndonjëherë kjo ka si pasojë që të burgosurit të ndihen më të sigurt jashtë qelisë së tyre. Në përgjithësi, të burgosurit e lidhin sigurinë me hapësirën personale. Hapësira e mjaftueshme personale në qeli, më pak shokë qelie dhe kalimi i më shumë orëve jashtë qelisë lidhen me përjetimin e një niveli më të lartë sigurie nga i burgosuri.

35 Boone, M, Althoff, M & Koenraadt F. (2016) Het leefklimaat in justitiële inrichtingen. Boom Juridisch: Den Haag. fq.170

Pyetja 5: Më shumë masa (fizike) të sigurisë do të garantojnë gjithmonë ndjesi më të madhe sigurie. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë.

Studimet mbi ndikimin e sigurisë në mjedisin e jetesës tregojnë një paradoks: Më shumë masa sigurie nuk çojnë në përjetimin e një shkalle më të lartë sigurie! Masat e sigurisë mund të kenë një ndikim negativ në mjedisin e jetesës (për shembull përmes një autonomie më të vogël për të burgosurit). As më shumë masa të sigurisë fizike në një institucion nuk garantojnë siguri më të madhe.

Pyetja 6: Akomodimi në qeli vetëm apo me të burgosur të tjerë nuk ka ndonjë ndikim në përvojën e të burgosurve. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë.

Studimet kërkimore kanë arritur në përfundimin se është relativisht i drejtpërdrejtë: në përgjithësi detyrimi për të jetuar me persona të tjerë në një qeli ka një ndikim negativ në përvojën e dënimit me burg, edhe pse nga literatura duket se për disa kategori të burgosurish është e ndryshme në rrethana të caktuara.

Detyrë shtëpie (Shih Materialin 1 dhe Materialin 3)

Përgjigju pyetjeve në vazhdim:

1. Cili është dallimi midis sigurisë fizike dhe sigurisë dinamike?
2. Si ndikojnë kushtet higjienike dhe një trajtim normal në përgjithësi në sigurinë e të burgosurit?
3. Pse është i nevojshëm bashkëpunimi midis shërbimeve të ndryshme të stafit në burg?
4. Çfarë thonë Rregullat Evropiane për zgjedhjen e të burgosurve në lidhje me kërkesën për të qëndruar në qeli/fjetore të vetëm apo me të tjerë?
5. Cilat janë grupet specifike të burgosurve në Shqipëri?
6. Pse është e rëndësishme të vendosen regjime të ndryshme brenda institucioneve?
7. Cilat janë detyrimet e stafit të burgut ndaj të burgosurve të huaj ?

Mbyllja

MATERIALI 1

Standardet ndërkombëtare

Rregullat e Rishikuara Evropiane të Burgjeve 2020³⁶ 17-22

Ndarja dhe akomodimi

17.1 Të burgosurit duhet të mbahen/dërgohen, për aq sa është e mundur, në burgjet afër vendbanimit të tyre ose vendeve të rehabilitimit social.

17.2 Akomodimi, gjithashtu, duhet të marrë parasysh kërkesat për vazhdimin e hetimeve penale, sigurinë fizike dhe ndjenjën e të qenit i sigurt dhe nevojën për të garantuar regjime të përshtatshme për të gjithë të burgosurit.

17.3 Për aq sa është e mundur, të burgosurit duhet të konsultohen për akomodimin e tyre fillestar dhe për çdo transferim të mëvonshëm nga një burg në tjetrin.

Rregulla 18.1: Strehimi që u sigurohet të burgosurve, dhe në veçanti kushtet e fjetjes, duhet të respektojë dinjitetin e tyre njerëzor dhe sa të jetë e mundur jetën e tyre private plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe të higjienës, duke i kushtuar kujdesin e duhur kushteve klimatike dhe veçanërisht kushteve të ajrit, një hapësirë të arsyeshme, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.

Rregulli 18.2: Në të gjitha vendet ku jetojnë, punojnë ose mblidhen të burgosurit:

- a. dritaret do të jenë në madhësi të mjaftueshme për t'iu dhënë mundësi të burgosurve, ndër të tjera, për të lexuar ose punuar me dritë natyrale në kushte normale. Ato do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen e ajrit të freskët, përveç rastit kur ka një sistem të përshtatshëm të ajrit të kondicionuar;
- b. drita artificiale do të plotësojë standardet e njohura teknike; dhe
- c. duhet të ketë një sistem alarmi që u mundëson të burgosurve të kontaktojnë pa vonesë personelin.

Rregulli 18.3: Kërkesat minimale specifike në lidhje me çështjet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 do të përcaktohen në legjislacionin kombëtar.

Rregulli 18.4: Ligji kombëtar do të sigurojë mekanizma për të bërë të mundur që këto kërkesa minimale të mos shkelen nga mbipopullimi i burgjeve.

Rregulli 18.5: Të burgosurit do të strehohen normalisht gjatë natës në qeli individuale, përveç rasteve kur shihet e nevojshme se strehimi i përbashkët me të burgosurit e tjerë

ka avantazhe.

Rregulli 18.6: Në strehimin e përbashkët do të vendosen ata të burgosur që i përshtaten shoqërimit me njëri-tjetrin në këto kushte.

Rregulli 18.7: Për aq sa është e mundur, të burgosurve do t'u jepet mundësia e zgjedhjes përpara se t'u kërkohet të ndajnë qelinë për të fjetur.

Rregulli 18.8: Në shpërndarjen e të burgosurve në institucione apo regjime të ndryshme do të merret parasysh siç duhet për të mbajtur në burg:

- a. të paraburgosurit veçmas nga të dënuarit;

36 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

- b. të burgosurit meshkuj veçmas nga femrat; dhe
- c. të burgosurit e rinj në moshë veçmas nga të burgosurit më të vjetër.

Rregulli 18.9: Përjashtime mund të bëhen nga kërkesat për burgim të veçantë në kuptim të paragrafit 18.8 duke i lejuar të burgosurit të marrin pjesë bashkërisht në aktivitetet e organizuara, por këto grupe duhet të ndahen gjithmonë gjatë natës, përveç nëse ata pranojnë të qëndrojnë së bashku dhe autoritetet e burgut gjykojnë se do të ishte në interesin më të mirë të gjithë të burgosurve në fjalë.

Rregulli 18.10: Strehimi i të gjithë të burgosurve duhet të jetë në masa sa më pak kufizuese të sigurisë dhe në përputhje me rrezikun e arratisjes ose dëmtimit të tyre ose të tjerëve.

Higjiena

19.1 Çdo ambient dhe hapësirë në burg duhet të mirëmbahet dhe të jetë i pastër gjatë gjithë kohës.

19.2 Kur të burgosurit futen në burg, qelitë ose vendet e tjera ku caktohen të qëndrojnë duhet të jenë të pastra.

Veshjet dhe mbulesat

20.1 Të burgosurit të cilët nuk kanë veshje të përshtatshme, duhet të pajisen me veshje të përshtatshme për klimën.

20.2 Kjo veshje nuk duhet të jetë poshtëruese apo degraduese.

20.3 Të gjitha veshjet duhet të jenë në gjendje të mirë, të mirëmbahen dhe të zëvendësohen kur është e nevojshme.

20.4 Të burgosurve që marrin leje për të dalë jashtë burgut nuk duhet t'u kërkohej të veshin rroba që i identifikojnë si të burgosur.

21. Secilit të burgosur do t'i sigurohet një krevat i veçantë dhe mbulesa të veçanta e të përshtatshme, të cilat do të mbahen në gjendje të mirë dhe të ndërrohen aq shpesh sa

është e nevojshme për të siguruar pastërtinë e tyre.

Të ushqyerit

22.1 Të burgosurit duhet të pajisen me një dietë ushqyese që merr parasysh moshën, shëndetin, gjendjen fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës së tyre.

22.2 Kërkesat e një diete ushqyese, duke përfshirë përmbajtjen e saj minimale me energji dhe proteina, duhet të përfshihen në ligjin kombëtar.

22.3 Ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në mënyrë higjienike.

22.4 Duhet të ketë tre vakte në ditë me intervale të arsyeshme mes tyre.

22.5 Uji i pijshëm i pastër duhet të jetë i disponueshëm për të burgosurit gjatë gjithë kohës.

22.6 Mjeku ose një infermiere e kualifikuar duhet të propozojë ndryshimin e dietës për një të burgosur të veçantë kur është e nevojshme për arsye mjekësore.

Rregullat 51-55

Sigurimi (safety)

52.1 Sa më shpejt të jetë e mundur pas futjes në burg, të burgosurit duhet të vlerësohen për të përcaktuar nëse paraqesin rrezik për sigurinë e të burgosurve

të tjerë, për personelin e burgut apo për persona të tjerë që punojnë ose vizitojnë burgun, ose nëse ka të ngjarë të dëmtojnë veten.

52.2 Duhet të ekzistojnë procedura për të garantuar sigurinë e të burgosurve, të stafit të burgut dhe të gjithë vizitorëve, për të zvogëluar në minimum rrezikun e dhunës dhe të ngjarjeve të tjera që mund të kërcënojnë sigurinë.

52.3 Duhet të bëhet çdo përpjekje e mundshme që të gjithë të burgosurit të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet e përditshme në mënyrë të sigurt.

52.4 Duhet të sigurohet që të burgosurit të kontaktojnë stafin gjatë gjithë kohës, duke përfshirë edhe gjatë natës.

52.5 Ligjet kombëtare të shëndetit dhe sigurisë duhet të respektohen në burgje.

Masa të veçanta të sigurisë së lartë fizike ose sigurimit

53.1 Masat e veçanta të sigurisë së lartë fizike ose të sigurimit shkojnë përtej atyre të përmendura në Rregullat 51 dhe 52 dhe janë masa të vendosura për të burgosurit që përbëjnë një kërcënim të veçantë ndaj sigurisë fizike apo sigurimit.

53.2 Këto masa duhet të zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm për atë kohë sa siguria fizike apo sigurimi nuk mund të mbahen me mjete më pak kufizuese.

53.3 Masa të tilla mund të përfshijnë veçimin e një të burgosuri nga të burgosurit e tjerë. Një ndarje e tillë duhet t'i nënshtrohet kërkesave të këtij rregulli dhe, përveç kësaj, të Rregullit 53A.

53.4 Natyra e çdo mase të tillë, kohëzgjatja dhe bazat mbi të cilat mund të zbatohen, si dhe procedurat që duhen ndjekur në vendosjen dhe zbatimin e tyre, duhet të përcaktohen nga ligji kombëtar.

53.5 Aplikimi i një mase të tillë duhet të miratohet nga autoriteti kompetent për një periudhë të caktuar kohe dhe një kopje e vendimit me shkrim duhet t'i sigurohet të burgosurit së bashku me informacionin se si të kundërshtohet ajo masë.

53.6 Çdo vendim për të shtyrë kohëzgjatjen e miratuar të një mase të tillë duhet t'i nënshtrohet një miratimi të ri nga autoriteti kompetent dhe një kopje e vendimit me shkrim duhet t'i sigurohet të burgosurit së bashku me informacionin se si të kundërshtohet ajo masë.

53.7 Këto masa duhet të zbatohen për individët dhe jo për grupet e të burgosurve.

53.8 Masa të tilla duhet të bazohen vetëm në riskun aktual që paraqet një i burgosur, duhet të jenë proporcionale me atë rrezik dhe nuk duhet të përfshijnë më shumë kufizime sesa janë të nevojshme për të parandaluar atë rrezik.

53.9 Çdo i burgosur që i nënshtrohet masave të tilla duhet të ketë të drejtë ankese sipas kushteve të përcaktuara në Rregullin 70.

Veçimi

53A Dispozitat e mëposhtme zbatohen për veçimin e një të burgosuri nga të burgosurit e tjerë si një masë e veçantë e sigurisë së lartë:

- a. të burgosurve të veçuar duhet t'u ofrohen të paktën dy orë kontakt domethënës njerëzor në ditë;
- b. vendimi për veçimin duhet të marrë parasysh gjendjen shëndetësore të burgosurit në fjalë dhe çdo aftësi e kufizuar që ata mund të kenë, të cilat mund t'i bëjnë ata më të prekshëm ndaj efekteve negative të ndarjes;

- c. veçimi duhet të përdoret për periudhën më të shkurtër të nevojshme për të arritur objektivat e tij dhe duhet të rishikohet rregullisht në përputhje me këto objektiva;
- d. të burgosurit e veçuar nuk duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të mëtejshme përtej atyre të nevojshme për të përmbushur qëllimin e deklaruar të një veçimi të tillë
- e. qelitë e përdorura për veçimin duhet të përmbushin standardet minimale të zbatueshme në këto rregulla për akomodimet e tjera për të burgosurit;
- f. sa më gjatë të veçohet një i burgosur nga të burgosurit e tjerë, aq më shumë hapa duhet të ndërmerren për të zbutur efektet negative të veçimit, duke maksimizuar kontaktin e tyre me të tjerët dhe duke u siguruar atyre lehtësira dhe aktivitete;
- g. të burgosurit që janë të veçuar, duhet të pajisen, si minimum, me materiale leximi dhe mundësi për t'u ushtruar fizikisht për një orë në ditë, siç përcaktohet për të burgosurit në Rregullat 27.1 dhe 27.2;
- h. të burgosurit që janë të veçuar duhet të vizitohen çdo ditë, duke përfshirë edhe drejtorin e burgut ose një anëtar të personelit i autorizuar të veprojë në emër të drejtorit të burgut;
- i. kur veçimi ndikon negativisht në shëndetin fizik ose mendor të një të burgosuri, duhet të ndërmerren veprime për ta pezulluar atë ose për ta zëvendësuar me një masë më pak kufizuese;
- j. çdo i burgosur i veçuar duhet të ketë të drejtën për t'u ankuar sipas kushteve të përcaktuara në Rregullin 70.

Kërkimi dhe kontrollat

54.1 Duhet të ketë procedura të hollësishme të cilat personeli duhet t'i ndjekë kur kontrollon:

- a. të gjitha vendet ku jetojnë, punojnë dhe mblidhen të burgosurit;
- b. të burgosurit;
- c. vizitorët dhe sendet e tyre; dhe stafin;

54.2 Situatat në të cilat këto kontrolle janë të nevojshme dhe natyra e tyre përcaktohen me ligj kombëtar.

54.3 Personeli duhet të trajnohet për t'i kryer këto kontrolle në mënyrë të tillë që të zbulojë dhe të parandalojë çdo përpjekje për t'u arratisur ose futje të sendeve të ndaluara, duke respektuar në të njëjtën kohë dinjitetin e atyre që kontrollohen dhe sendet e tyre personale.

54.4 Personat që kontrollohen nuk duhet të poshtërohen nga procesi i kontrollit.

54.5 Personat duhet të kontrollohen vetëm nga personeli i së njëjtës gjini.

54.6 Nuk duhet të ketë kontroll fizik të brendshëm të trupave të burgosurve nga personeli i burgut.

54.7 Një ekzaminim intim që lidhet me një kontroll mund të bëhet vetëm nga një mjek.


54.8 Të burgosurit duhet të jenë të pranishëm kur kontrollohen sendet e tyre personale, përveçse nëse teknikat e hetimit ose kërcënimi i mundshëm ndaj stafit e ndalojnë këtë.

54.9 Detyrimi për të mbrojtur sigurinë duhet të jetë i balancuar me privatësinë e vizitorëve. 17 Rec (2006) 2-rev

54.10 Procedurat për kontrollin e vizitorëve profesionistë, si përfaqësuesit ligjorë, punonjësit socialë dhe praktikuesit mjekësorë, etj., duhet të jenë subjekt i konsultimit

me organet e tyre profesionale për të siguruar një ekuilibër midis sigurisë fizike dhe sigurimit, dhe të drejtës së aksesit konfidencial profesional.

MATERIALI 2



MATERIALI 3

Regjime të ndryshme (20 minuta)

Sigurimi dhe siguria janë rregullat bazë për ekzistencën e një burgu. Menjëherë pas tyre vijnë ato rregulla bazë të parashtruara në Rregullat Evropiane të Burgjeve.

Rregullat Evropiane të Burgjeve parashikojnë si më poshtë:

Neni 5: Jeta në burg duhet t'i përafrohet sa më shumë që të jetë e mundur aspekteve të jetës në komunitet

Neni 6: Çdo burg duhet të menaxhohet në mënyrë të atillë që të lehtësojë ri-integrimin në shoqërinë e lirë të personave të cilët janë dënuar me heqje lirie.

Rregulla 25.1: Regjimi duhet të ofrojë një program të balancuar aktivitetesth.

Rregulla 25.2: Regjimi duhet t'i japë mundësi të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre pasi është e nevojshme për një nivel adekuat të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror.

Rregulli 25.3: Ky regjim do të sigurojë gjithashtu nevojat e mirëqenies së të burgosurve.

Rregulli 25.4: Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të burgosurve që kanë përjetuar abuzim fizik, mendor ose seksual.

Institucionet mund të kenë regjime të ndryshme për të burgosurit në pritje të gjyqit, personat e dënuar, të rriturit, të miturit, gratë, personat me çrregullime mendore, personat e sëmurë apo ata me varësi ndaj substancave.

Regjimet ndryshojnë përderisa edhe qëllimi ndryshon nga institucioni në institucion. Në qendrat e riedukimit, të burgosurit prezumohen të pafajshëm deri në çastin kur dënohen. Është e qartë se në këto institucione juristët, policët dhe prokurorët kanë mundësi të jenë në kontakt me klientët e tyre.

Niveli i sigurisë varet nga disa faktorë, si për shembull: kohëzgjatja e dënimit, pjesa e mbetur e dënimit, e kaluara penale dhe sjellja. Kryerja e analizave të rregullta të rrezikut do të ishte diçka me mend. Rezultatet mund të përdoren për të vendosur llojin e regjimit për të cilin kanë nevojë të burgosurit dhe këto të dhëna mund të ndihmojnë për të vendosur rreth mundësisë për dhënien e lejeve dhe për të marrë vendime rreth lirit të parakohshëm.

Rregullat Evropiane të burgjeve parashikojnë:

Rregulli 51.3: Menjëherë pas pranimit, të burgosurit duhet të vlerësohen për të përcaktuar:

a. rrezikun që paraqesin për komunitetin në rast se arratisen;

b. riskun që ata kanë për tu arratisur qoftë në mënyrë individuale ose me ndihmë nga jashtë.

Rregulli 51.4: Më pas, çdo i burgosur mbahet në kushte sigurie që u përkojnë niveleve të rrezikut që ato paraqesin.

Rregulli 51.5: Niveli i nevojshëm i sigurimit rishikohet në intervale të rregullta gjatë gjithë kohës së burgimit të një personi.

Lloji i krimit ose kohëzgjatja e dënimit nuk duhet të ndikojë vendimmarrjen lidhur me nivelin e riskut të një të burgosuri.

Ja si ndryshojnë emërtimet nga vendi në vend:

Burgu i sigurisë së lartë është konceptuar për ata të burgosur që kanë të kaluar negative për sa u përket arratisjeve, pengmarrjes, kërcënimeve, kryerjes së krimeve në burg, sjelljes agresive. Regjimi bazohet kryesisht te siguria. E, megjithatë, aspektet humane luajnë rol të rëndësishëm. Marrëdhënia mes personelit dhe të burgosurve duhet të jetë sa më e shtensionuar.

Ky lloj burgu duhet përdorur vetëm për raste të veçanta dhe dy herë në vit duhet rishqyrtuar nevoja për t'i mbajtur të burgosurit në të. Nëse është e mundur, i burgosuri duhet të dërgohet në një regjim më liberal.

Burgjet e mbyllura apo qendrat e riedukimit. Të gjitha qendrat e riedukimit kanë një regjim më të rreptë. Kjo vlen edhe për burgjet e mbyllura. Siguria luan rol të rëndësishëm, por, në të njëjtën kohë, i kushtohet mjaft rëndësi përgatitjes së një programi të dobishëm që përmban elemente, si: puna, studimi, argëtimi, sportet, kontaktet me botën e jashtme.

Burgjet gjysmë të hapura mund të përdoren kur nuk ka shumë nevojë për siguri. I burgosuri mund të dërgohet në një burg të tillë nëse i ka mbetur shumë pak kohë

nga përfundimi i vuajtjes së dënimit ose kur sjellja është e tillë që tregon se nuk ka nevojë për një regjim të rreptë. Burgjet gjysmë të hapura i ofrojnë të burgosurit pak e nga pak mundësinë për t'u mësuar me lirinë dhe janë një mundësi e mirë që ai/ajo të përgatitet për lirinë. Kjo mund të shihet te programet më të lira që kanë këto burgje, godinat e shumta që kanë për vizitat, orarin më të gjatë jashtë qelive apo dhomave. Gjithashtu, të burgosurit kanë mundësi të marrin leje rregullisht.

Burgjet e hapura janë hapi i fundit drejt botës jashtë. Në një burg të hapur duhet të ketë shumë kontakte me botën jashtme. Kjo mund të realizohet duke u ofruar të burgosurve më shumë mjedise për pritjen e vizitorëve, marrjen e telefonatave apo mundësinë e lejeve. Nëse është e mundur të burgosurit duhet t'i jepet mundësia të punojë apo të ndjekë studimet jashtë burgut.

Duke pasur në mendje karakteristikat e përmendura më lart për regjimet e ndryshme të burgjeve të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura, të cilat në parim ndryshojnë në bazë të nivelit të lirisë dhe përgjegjësisë që u ofrojnë personave të dënuar me heqje lirie, si edhe duke e krahasuar situatën më Shqipërinë, burgjet shqiptare operojnë ende me regjime të mbyllura.

Gjatë viteve të fundit, me ndërtimin e burgjeve të reja dhe rikonstruktimin e institucioneve të vjetra, tendenca është përqendrimi i llojeve të ndryshme të regjimeve të tilla, si: paraburgimi, siguria e lartë, e mesme dhe e ulët në një institucion të vetëm. Përveç këtyre zhvillimeve pozitive për të pasur një varietet regjimesh në institucione shumë funksionale, ekziston nevoja e regjimeve të ndryshme për të siguruar zbatimin e planit individual të dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, nisur që nga çasti i paraburgimit për te regjimet apo institucionet e mbyllura, gjysmë të hapura dhe, në fund, te regjimet apo institucionet e hapura. Kjo do të ndihmojë personin e dënuar me heqje lirie ta përgatitë veten për ri- integrim në shoqëri, duke përmbyllur kështu edhe një nga detyrat kryesore të sistemit të burgjeve kundrejt personave nën kujdesin e tij.

Në Shqipëri, të gjitha burgjet janë të mbyllura. Niveli i sigurisë varion.

Për shumicën e të burgosurve niveli normal i sigurisë është i mjaftueshëm. Niveli i sigurisë së ulët zbatohet për ata të cilëve u kanë mbetur jo më tepër se dy vjet dënim nga data e liritë ose për ata të cilët janë dënuar për kundërvajtje. Regjimi i sigurisë së lartë ekziston për ata të cilët nuk janë të përshtatshëm për nivelin e sigurisë normale ose të cilët u përkasin bandave profesionale.

Është e qartë se, kur keni përpara disa mundësi për të zgjedhur, atëherë një pjesë e mirë e vendimit varet nga të burgosurit. Individit duhet të përfshihet në vendimet që merren për të dhe në mënyrën si do të ecë burgimi. Këshillohet që, së bashku me të burgosurin, të diskutohet një plan individual i dënimit dhe para liritë të tij ose të saj dhe të flitet për alternativat e mundshme atëherë kur ekziston kjo mundësi. Në këtë plan duhet t'i kushtohet vëmendje arsimit, punës, marrëdhënieve familjare si dhe rolit që sistemi i burgimit dhe i burgosuri duhet të luajnë për të përmirësuar gjasat e një ri-integrimit pozitiv.

Moduli 2: Vlerësimi i situatës – Vetëdija ndaj mjedisit që ju rrethon (2 orë)

Objektivat: Në fund të modullit, pjesëmarrësit do të:

- përvetësojnë aftësitë bazë të vlerësimit të situatës;
- aftësohen për parandalimin e situatave të ndryshme në burgje;
- marrin njohuri për “çfarë”, “ku”, “kur” dhe “pse-në” e situatave specifike dhe sjelljeve që duhen parandaluar;
- njohin katër aftësitë kryesore që lidhen me vlerësimin e situatës.

Hyrje (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Rregullat Evropiane të Burgjeve³⁷

Neni 51.2 “Sigurimi që realizohet nëpërmjet pengesave fizike dhe mjeteve të tjera teknike, plotësohet nga sigurimi dinamik i ofruar nga personeli që është në gatishmëri, i cili njuh të burgosurit që janë nën kontrollin e tyre”.

Neni 52.2 “Sapo të jetë e mundur pas pranimi, të burgosurit vlerësohen për të përcaktuar nëse ata përbëjnë një rrezik sigurie për të burgosur të tjerë, për personelin e burgut ose për persona të tjerë që punojnë ose vizitojnë burgun, ose nëse ka gjasa që ata të dëmtojnë veten”.

Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe ligji nr. 80/2020 “Për policinë e burgjeve”, kanë parashikuar procedurat për sigurinë dhe sigurimin në burgje, me të cilat duhet të njiheni në mënyrë të vazhdueshme.

Kjo temë ka të bëjë me një nga mënyrat kryesore për garantimin e sigurisë, që është vlerësimi i situatës, ose mund ta quajmë ndryshe, aftësitë intuitive për kapjen e situatave dhe parandalimin. Në praktikën e përditshme punonjësit e burgjeve duhet të jenë të vëmendshëm për të kuptuar se çfarë po ndodh, me qëllim që të parandalojnë. Është një postulat i njohur: *më mirë të parandalosh, sesa të riparosh dëmet*.

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të japin shembuj të përvojave të tyre të mëparshme që pasqyrojnë konceptin e vlerësimit të situatës.

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

“Vlerësimi” ka të bëjë me ato aftësi që ju ndihmojnë të dini se çfarë po ndodh në çdo situatë. Vlerësimi ju ndihmon të shmangni gabime të kushtueshme dhe të maksimizoni mundësitë që vendimet dhe veprimet tuaja të jenë efektive dhe të sakta. Vlerësimi funksionon, pasi ju përgatit të merrni dhe ta përdorni informacionin për të menaxhuar dhe shpesh për të parandaluar problemet.

³⁷ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581.

1. Parandalimi i situatës në burgje dhe njohja e “çfarë”, “ku”, “kur” dhe “pse-në” e situatave specifike dhe sjelljeve që duhen parandaluar (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në thelb elementi kritik i vlerësimit të situatës në punën e punonjësit të burgut kërkon disa njohuri bazë në lidhje me zbatimin e **teorisë së parandalimit të situatave** në mjedisin e burgut.

Në përgjithësi, parimet e parandalimit të situatave të krimit kanë të bëjnë kryesisht me minimizimin e mundësive për krim. Parimet e parandalimit të situatës sigurojnë gjithashtu një kuadër dhe një metodologji për një shfrytëzim më sistematik të mjedisit të burgut për të kontrolluar sjelljen problematike të burgosurve. Përpjekjet parandaluese përqendrohen në marrëdhëniet midis *aspekteve të veçanta* të mjedisit dhe *llojeve të veçanta* të sjelljes jo të mirë të burgosurve. Përveç kësaj, ndërhyrjet për të minimizuar mundësitë për kryerjen e një krimi kërkojnë që ta kuptosh atë që i burgosuri shpreson të përfitojë nga sjellja e tij e papërshtatshme, pasi ndryshimi i perceptimit të kostove dhe përfitimeve nga kjo sjellje është çelësi i zgjidhjes së parandalimit të krimit. Me pak fjalë, kontrolli i situatës në burg kërkon një mendësi të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve që fillon me një analizë të detajuar të - «çfarë», «ku», «kur» dhe «pse» - të sjelljes që duhet parandaluar. Pasi të kemi një kuptim më të mirë të pyetjeve “çfarë”, “ku”, “kur” dhe “pse” - të sjelljes që duhet parandaluar, ne bëhemi vëzhgues më të mirë dhe jemi më të aftë të përcaktojmë nëse ka apo jo probleme në një situatë të caktuar.

Kontributi i trajnerit

Si hap i parë në parandalimin e situatës në burg, duhet të përcaktohet “**çfarë**” sjelljesh duhen parandaluar. Kjo do të thotë që koncepti i prishjes së rendit në burg duhet të zbërthehet sa më shumë që të jetë e mundur në lloje të veçanta sjelljesh jo të mira.

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet pjesëmarrësit: Cilat janë llojet e ndryshme të sjelljeve të këqija të burgosurve?

Ushtrim

Pyetje: Çfarë kuptojmë me sjellje të keqe të burgosurve?

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Llojet e veçanta të sjelljeve të këqija përfshijnë:

- dhunën mes të burgosurve;
- dhunën midis të burgosurve dhe stafit;
- sulmet seksuale;
- vjedhjet;
- vandalizmin;
- përdorimin e drogës dhe trafikimin e drogës;
- vetëlëndimin;
- arratisjet; dhe
- çrregullimin kolektiv.

Shënime për trajnerët

Vazhdojmë me një kuiz, me disa pohime “të vërteta ose false”.

Pohimet i referohen “ku”, “kur” dhe “pse-në” e sjelljeve që duhet të parandalohen.

Kuiz³⁸

Trajneri lexon deklaratat dhe pyet: a është kjo e vërtetë apo false?

Pyetja 1: Është konstatuar se vendet ku ndodhin më shpesh sulmet e të burgosurve ndaj gardianëve janë palestrat dhe ambientet rekreative. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë.

Në rastin e sulmeve të burgosurve ndaj gardianëve, vendi ku kjo ndodh më shpesh është vendi (qelia) ku jeton autori. Një implikim i këtij zbulimi është se të burgosurit mund të bëhen veçanërisht armiqësorë kur pushtohet territori i tyre personal dhe se personeli duhet të jetë i ndjeshëm ndaj kësaj ndjesie kur kryen kontrolle në qelitë e të burgosurve.

Pyetja 2: Sulmet mes vetë të burgosurve konstatohet se ndodhin më shpesh në qeli, korridore dhe dushe. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja : E vërtetë.

Sulmet mes vetë të burgosurve ndodhin në këto vende dhe në vende të tjera që karakterizohen nga *mundësitë jo të mira për mbikëqyrje nga stafi*.

Pyetja 3: Sulmet ndaj gardianëve (stafit të burgut) **nuk** rezultojnë të ndodhin përgjithësisht në periudha të caktuara kohore. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja : E pavërtetë

Po kështu, analizat e përkohshme të sjelljes së keqe nxjerrin në pah disa pika stresi në rutinën institucionale kur anëtarët e stafit duhet të jenë veçanërisht vigjilentë. Sulmet ndaj gardianëve ndodhin zakonisht gjatë periudhave kur ka lëvizje të burgosurve ose numër të reduktuar stafi. Për shembull, kulmet e sulmeve ndaj personelit të burgut ndodhin gjatë transferimit të burgosurve, lirimit nga qelitë dhe gjatë ndryshimit të turneve.

38 Bazuar në Wortley, R. (2003). Parandalimi i krimit dhe kontrolli i burgjeve. Tek botimi i MJ Smith dhe DB Cornish (Eds.), Teoria për praktikën në parandalimin e krimit. Studime për parandalimin e krimit , Vëllimi 16. Monsey, NY: Buletini i Drejtësisë Penale.

Pyetja 4: Vetëvrasjet në burgje nuk përqendrohen në pika të veçanta në kohë dhe në hapësirë. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë

Duke ekzaminuar vendet ku janë kryer vetëvrasjet në burgje, studimet kanë treguar se disa qeli njiheshin si vende ku kishin ndodhur vetëvrasje në mënyrë të herëpashershme, gjë që tregon se ato qeli kishin probleme të veçanta me mënyrën se si ishin projektuar - kishin pika ku të burgosurit mund të vareshin, mezi dukeshin nga jashtë-brenda, ishin të zymta e kështu me radhë - gjëra që duhej të adresoheshin. Është konstatuar se vetëvrasjet në burgje ndodhin më shpesh gjatë natës dhe fundjavës. Nata dhe fundjavat janë periudha me staf të reduktuar, kur ka më pak mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të burgosurve dhe ku sjellja vetë dëmtuese ka më shumë gjasa të mos zbulohet. Për arsye të ngjashme, edhe përdorimi i drogës ka tendencë të përshkallëzohet gjatë fundjavave.

Pyetja 5: Arratisjet nga një institucion për të mitur rriten gjatë muajve të verës për shkak të rritjes së dëshirës së të burgosurve për të shijuar gjërat e mira dhe të këndshme të një jete në liri gjatë verës. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigja: E pavërtetë

Hulumtimet kanë treguar se arratisjet nga një institucion (për të mitur) rriten gjatë muajve të dimrit. Ato dalin në përfundimin se kjo ndodh ngaqë ka më shumë mundësi për të shpëtuar për shkak të errësirës më të madhe që rrit shanset që arratisja të mos vihet re.

Pyetja 6: Shumica dërmuese e të burgosurve që ndodhen në situata me masa minimale sigurie nuk arratisen kur u jepet mundësia. A është kjo e vërtetë apo false?

Përgjigje: E vërtetë

Në përgjithësi, arratisjet ndodhin për një arsye. Shpjegimet e dhëna nga të arratisurit për sjelljen e tyre kanë qenë se kishin marrë lajme të këqija nga shtëpia, ngjarje me të cilat ata mendonin se duhet të merreshin vetë. Të arratisurit besonin se arratisja e tyre do të ishte parandaluar nëse në burg do të kishte shërbime të përshtatshme mirëqenieje. Të burgosurit e tjerë kanë përmendur frikën ose ngacmimin nga të burgosurit e tjerë si arsyen e arratisjes së tyre.

2. Katër aftësi bazë (60 minuta)

Vlerësimi i çfarëdo situatë lidhet me katër aftësi bazë:

1. Pozicioni
2. Qëndrimi i trupit
3. Vëzhgimi
- 4. Dëgjimi**

Në përgjithësi, një punonjës i aftë i vlerëson gjërat sistematikisht gjatë turnit të punës, për mbikëqyrjen e të burgosurve apo gjatë kryerjes së detyrave të tjera. Ja disa nga mënyrat me të cilat ai mund të vlerësojë situatën përpara se të marrë turnin:

1. Kontrollon me mbikëqyrësin (kolegun që dorëzon shërbimin) dhe rishikon regjistrat për të parë se çfarë ka ndodhur gjatë turnit të kaluar.

2. Lexon regjistrin e shërbimit të punonjësit që po zëvendëson dhe kërkon një raportim rreth kushteve në zonën e përgjegjësisë së tij.
3. Përcakton nëse ka çështje që kanë nevojë për vëmendje parësore (si kontrolli i një mjedisi, një konflikt i lindur që nuk është trajtuar, një ankesë etj.) dhe bën një shënim për t'u kujdesur për këto.
4. Ecën në zonën e përgjegjësisë për të parë se çfarë po ndodh, ku është gjithsecili, çfarë po bëjnë dhe për të testuar atmosferën e përgjithshme brenda zonës së përgjegjësisë.

2.1 Pozicionimi

Pozicionimi nënkupton të vendoseni në vendin më të mirë për të parë dhe për të dëgjuar individët apo grupet. Kjo ju ndihmon të merrni informacionin që ju nevojitet për të menaxhuar të burgosurit dhe për të parandaluar përshkallëzimin e incidenteve të vogla në të mëdha.

Tre kërkesat e pozicionimit janë:

1. Distancimi
2. Fushëpamja katrore
3. Të shohësh drejtpërdrejt

Pozicionimi fizik në lidhje me grupin apo individin është shumë i rëndësishëm për menaxhimin efektiv të burgosurve.

Si punonjës efektiv duhet të pozicionoheni aty ku mund të shihni dhe të dëgjoni problemet. Duke qenë të mirë pozicionuar, keni mundësi të kuptoni se çfarë po ndodh e, për rrjedhojë, të rritni aftësinë për të parandaluar zmadhimin e problemeve. Sikundër e dini, është e pamundur të jeni ngado e kurdo. Gjithashtu, është tepër e vështirë që të burgosurit të kapen duke kryer disa veprime për shkak të “mbylljes në dhoma”. E, megjithatë, sa më mirë t'i përdorni aftësitë e pozicionimit për të parë e për të dëgjuar, aq më pak gjasa ka që të burgosurit të përfshihen në gjëra që janë kundër rregullave.

Tani le t'i hedhim një shikim tri aftësive specifike apo procedurave.

Distancimi. Parimi i parë i distancimit është të ruani sigurinë tuaj. E, ndërsa siguria është parësore, ajo nuk mjafton. Mund të jeni të sigurt në mjedisin tuaj, ndërkohë që gjërat që ndodhin në burg kalojnë pa u vënë re. Distanca duhet të ruajë sigurinë, por duhet të jeni të aftë të shihni se çfarë po ndodh dhe çfarë po thuhet, kurdoherë që të jetë e mundur. Pozicionimi do të thotë distancimi aq larg sa për të qenë i sigurt dhe aq afër sa për të dëgjuar dhe për të parë.

Fushëpamja katrore. Të pozicionuarit në mënyrë të atillë për të pasur një fushëpamje kuadrate ju siguron pamjen më efektive. Shpatulla juaj e majtë duhet të jetë në një drejtim me vijën e majtë të kufirit të zonës që po mbani nën mbikëqyrje dhe shpatulla e djathtë duhet të jetë në një drejtim me vijën e kufirit të djathtë të zonës që po mbikëqyrni. Kur të lëvizni kokën majtas apo djathtas aq sa mjekra të jetë fiks mbi shpatull, duhet të jeni i aftë të shihni të gjithë zonën për të cilën jeni përgjegjës. *Pozicionim do të thotë të keni një fushëpamje katrore të burgosurve.*

Ndonjëherë edhe vetë zona për të cilën jeni përgjegjës ua bën të pamundur të keni një fushëpamje katrore nga një pozicion i caktuar. Në këtë rast, duhet të rotulloheni

në mënyrë që përmes lëvizjeve të njëpasnjëshme të mund të shikoni drejtpërdrejt të gjitha zonat apo personat për të cilët jeni përgjegjës. Gjatë rotacionit, sikundër me të gjitha sjelljet, mbetet e rëndësishme të ndryshoni rendin e të bërit të gjërave, në mënyrë që sjellja juaj të mos parashikohet lehtë.

Shënime për trajnerët

Bëjini grupit dy pyetjet e mëposhtme dhe shënojeni përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë ose në tabelë:

Ushtrim

Pyetje dhe përgjigje

1. Jepni dy shembuj situatash, ku mendoni se do të ishte ide e mirë që ta shihnit një të burgosur drejt e në sy.
2. Jepni dy shembuj situatash, ku mendoni se nuk do të ishte ide e mirë ta shihnit një të burgosur drejt e në sy.

Të parët drejtpërdrejt. Kur të pozicionoheni duhet të shikoni drejtpërdrejt zonën apo personat që po menaxhoni. Nëse nuk jeni duke parë drejtpërdrejt, nuk do të jeni në kontroll të situatës edhe sikur të jeni në pozicionin e drejtë dhe keni një fushëpamje katrore. Të shikosh drejtpërdrejt një grup, shpeshherë do të thotë t'i shohësh drejtpërdrejt në sy. Kur jeni duke pyetur të burgosurit, për shembull, duhet të jeni i aftë të dalloni shenja të rëndësishme duke vëzhguar nga afër sytë e tyre dhe gjestet. Përveç informacionit që mund të mblidhni, shikimi i drejtpërdrejtë i thotë të burgosurve se nuk po i kërcënoni dhe se kjo është çështje pune. Shumë të burgosur besojnë se një njeri i cili nuk të sheh në sy, të ka frikë. Pozicionim do të thotë të shohësh drejtpërdrejt te zona apo personat që po menaxhon.

Kontakti me sy mund të jetë mënyra më e mirë për të komunikuar. Të burgosurit bëhen të vetëdijsëm për përpjekjet tona të kontaktojmë me ta kur na shohin duke i parë drejtpërdrejt në fytyrë. Sigurisht, të shohësh drejtpërdrejt të burgosurit të jep shumë informacion të vlefshëm rreth tyre. Nëse të burgosurit e ndryshojnë drejtimin e shikimit teksa janë duke folur me ju, atëherë kjo sinjalizon që, më e pakta, ju ose ajo që po thuhet nuk i bën të ndihen rehat. Ky lloj informacioni është i rëndësishëm për menaxhimin e të burgosurve. Gjithsesi, duhet të jeni të vetëdijsëm, gjithashtu, se disa kultura e konsiderojnë të pasjellshme të parët në sy. Prandaj, mos harroni të merrni parasysh sfondin kulturor dhe vetë të burgosurit në mënyrë që të mos keqinterpretoni shikimin e tyre apo se çfarë nënkupton shmangia e shikimit në sy.

2.2 Qëndrimi i trupit

Pozicioni i trupit tuaj – si e mbani veten - i flet shumë një të burgosuri. Ky lloj qëndrimi mund ta bëjë të burgosurin të mendojë se keni besim te vetja ose se jeni me të vërtetë të shqetësuar për atë që mund të ndodhë. Sigurisht, synimi juaj është të tregoni besim të vërtetë.

Tre hapat e qëndrimit të trupit janë:

1. Të qëndruarit drejt
2. Eliminimi i sjelljeve shpërqendruese
3. Përkulja lehtas përpara

Kur qëndroni drejt dhe hiqni dorë nga sjelljet shpërqendruese, kjo gjë u thotë të burgosurve se jeni në kontroll të plotë fizik – kontroll jo vetëm mbi trupin tuaj, por edhe të gjithë situatës. Dhe kjo është thelbësore! Edhe përkulja pak përpara mund të tregojë besim duke përforcuar idenë se e gjithë vëmendja dhe energjia e mundshme është e përqendruar te të burgosurit.

Të qëndruarit drejt. Të gjithë e dimë sa e rëndësishme është të qëndrosh drejt. Ndoshta e keni dëgjuar kur keni qenë fëmijë shprehjen “Ji krenar, nxirre gjoksin para”. Të qëndruarit drejt kërkon muskuj dhe praktikë. Shikojeni veten në pasqyrë dhe kontrolloni veten. A i keni shpatullat drejt? A e keni nxjerrë gjoksin përpara? Si ndiheni? *Qëndrimi i mirë i trupit, do të thotë të rrini drejt për të treguar besim.*

Shmangia e sjelljeve shpërqendruese. Një burrë apo një grua që nuk rri dot pa lëvizur konsiderohet nervoz. Kafshimi i thonjve, rrahja e dyshemesë me këmbë dhe sjellje të tjera shpërqendruese nuk përcjellin besim dhe kontroll. Por as edhe qëndrimi i ngurtë, plot tension, nuk komunikojnë besim dhe kontroll. Pasi të keni eliminuar sjelljet shpërqendruese nuk duhet të ndieni tension në trup. *Qëndrimi i mirë i trupit do të thotë eliminim i të gjitha sjelljeve shpërqendruese.*

Të përkulurit para. Qëllimi juaj këtu është të komunikoni interesim dhe shqetësim duke e zhvendosur peshën tuaj përpara në mënyrë që të burgosurit të shohin “prirjen” tuaj për të komunikuar dhe për t’i mbikëqyrur me respekt. Këtë mund ta bëni duke vendosur një këmbë pak përpara tjetrës dhe duke e hedhur peshën te këmba para. Kjo komunikojnë se “po afroheni” pa lëvizur shumë më pranë apo pa kontakt fizik. Duke qenë se ky pozicion ju tregon më vigjilentë, gjithashtu ju jep më shumë kontroll mbi situatën. *Qëndrimi i mirë i trupit do të thotë të përkuleni pak përpara për të treguar se vëmendja juaj është vërtet e fokusuar.*

2.3 Të vëzhguarit

Të vëzhguarit është aftësia për të vërejtur dhe për të kuptuar paraqitjen e të burgosurit, sjelljen dhe mjedisin. Një vëzhgim i kujdesshëm i veprimeve të burgosurit do t’ju flasë më tepër nga çfarë keni nevojë të dini rreth tyre, rreth ndjenjave dhe problemeve të tyre.

Tre hapat e të vëzhguarit janë:

1. Të shikosh me kujdes.
2. Të nxjerrësh përfundime rreth ndjenjave, marrëdhënieve dhe niveleve të energjisë.
3. Të përcaktosh problematiken/ose jo problematiken.

Të vëzhgosh sjelljen, paraqitjen dhe mjedisin. Mënyra si sillet është një shenjë joverbale që dërgohet nga diçka që i burgosuri e bën teksa është i ndërgjegjshëm dhe aktiv. Teksa vëzhgoni një të burgosur, duhet t’u përgjigjeni me mend pyetjeve të tilla, si: “Çfarë po bën tani?” (sjellja). “Çfarë pamje ka?” “Ku është ai? Dhe me kë?” “Çfarë është me rëndësi në pamjen e tij të jashtme?” (paraqitja). “Çfarë është e rëndësishme rreth vendit ku është dhe me kë është?” (mjedisi). Pasi t’i jeni përgjigjur këtyre pyetjeve, jeni gati të arrini në disa përfundime rreth të burgosurit. *Të vëzhgosh, do të thotë të shikosh sjelljen e të burgosurit, paraqitjen dhe mjedisin.*

Nxjerrja e përfundimeve. Përfundimet janë konstatimet paraprake që nxirrni si

rezultat i vëzhgimit të burgosurve. Ju analizoni të gjitha shenjat vizuale që lidhen me paraqitjen dhe sjelljen e të burgosurit si dhe mjedisin. Këto janë me të vërtetë “sinjale” që ju tregojnë diçka rreth ndjenjave intime të burgosurit, marrëdhënieve intime, niveleve intime të energjisë si dhe vlerat intime. Sa më shumë të vëzhgoni aq më shumë përfundime mund të nxirrni e aq më të sakta do të jenë ato. *Të vëzhgosh do të thotë të nxjerrësh përfundime rreth ndjenjave, marrëdhënieve, niveleve energjike dhe vlerave intime të burgosurit.*

Nxjerrja e përfundimeve rreth ndjenjave. Punonjësi me uniformë mund t'i përdorë aftësitë e veta vrojtuese për të nxjerrë përfundime mbi mënyrën si ndihet një i burgosur apo një regjim i tërë. Për shembull, mund të përdorni fjalën përshkruese “i lumtur” për një të burgosur i cili po bën ushtrime dhe qesh. Mund të përdorni fjalën “i tensionuar” për një të burgosur i cili është duke ecur poshtë e lart dhe shtrëngon duart me shpejtësi.

Nxjerrja e përfundimeve rreth marrëdhënieve. A është pozitiv, negative apo asnjë kundrejt të tjerëve? Përveç dallimit të shenjave joverbale që tregojnë ndjenjat e të burgosurit, punonjësi me uniformë mund ta rritë efektivitetin e vet në menaxhimin korrigjues duke kërkuar për shenja që tregojnë natyrën e marrëdhënies mes tij dhe të burgosurve dhe mes vetë të burgosurve. Në përgjithësi, marrëdhëniet dhe ndjenjat mund t'i kategorizoni si pozitive, negative apo neutrale. Të dish marrëdhënien mes punonjësit me uniformë dhe të burgosurit dhe mes vetë të burgosurve, përbën një tregues të mirë për veprimet e ardhshme. Për shembull, marrëdhëniet e pushtetit mes të burgosurve janë kritike. Një përplasje mes dy miqsh nuk do të thotë asgjë, por përplasja mes anëtarëve të grupeve të ndryshme do të thotë probleme.

Shënime për trajnerët

Bëjini klasës pyetjet e mëposhtme dhe shënojin përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë ose në tabelë:

Ushtrim

Pyetje dhe përgjigje

1. Përshkruani sjelljet dhe/ose veprimet apo pamjet që tregojnë se dy të burgosur kanë një marrëdhënie negative. Pyetini se çfarë mund të ndodhë si rezultat i këtyre sjelljeve dhe/ose veprimeve.
2. Përshkruani sjelljet dhe/ose veprimet apo pamjet që tregojnë se dy të burgosur kanë një marrëdhënie pozitive.

Përfundime rreth nivelit të energjisë. Nivelet e energjisë na tregojnë shumë rreth shkallës dhe llojit të problemit që mund dhe/ose do të shkaktojë një i burgosur.

Përfundimet rreth vlerave të burgosurve. Me rëndësi është të kuptohen edhe vlerat e një të burgosuri të caktuar. Këtu futet në lojë vëzhgimi i mjedisit nga vjen i burgosuri. Çdo i burgosur ka tri mjedise bazë: vendin ku jeton (njësinë), vendin ku punon (punishten) dhe vendin ku mëson (shkollën). Në secilin nga këto vende, vetë “mjedisi” përfshin jo vetëm materialet fizike, por edhe njerëzit – njerëzit me të cilët i burgosuri parapëlqen të rrijë. Mund të mësoni shumë për një të burgosur duke vërejtur me kujdes mjedisin e tij. Rregulli i përgjithshëm është: Kur dikush i kushton diçkaje energji, atëherë ajo diçka është me vlerë për të; sa më shumë energji, aq më e lartë vlera.

Arsyet duhet të jenë të vëzhgueshme, konkrete. Arsyet që çojnë në përfundimet tuaja,

duhet të jenë shenja vizuale që lidhen me sjelljet, paraqitjet dhe mjedisin. Përfundimet kanë më shumë gjasa të jenë të sakta nëse bazohen në vëzhgime të hollësishme dhe konkrete sesa në vrojtime të vagëta dhe të përgjithshme. Përfundimet bazohen te vëzhgimet e mëparshme të sjelljeve dhe paraqitjeve. Sa më konkrete të jenë përshkrimet e paraqitjes kur ia thoni vetes apo të tjerëve me të cilët ndoshta dëshironi t'i ndani ato, aq më shumë gjasa ka që përfundimet tuaja të jenë korrekte.

Shënime për trajnerët

Lexojini grupit incidentin e mëposhtëm.

Pyetje për ushtrimin

“10 nëntor, ora 16:30, jashtë në oborr. Menjëherë pas orarit të vizitave, një grup prej pesë të burgosurish trupmëdhenj iu afruan një të burgosuri të ri në moshë dhe të sapoardhur në burg. Iu afruan dhe e futën në mes. Njëri prej tyre i hodhi krahun në qafë dhe në shpatulla të burgosurit të ri dhe e tërhoqi drejt vetes, duke e parë ngultazi në fytyrë. I burgosuri i ri u shtrembërua në fytyrë dhe u përpoq të largohej. Grupi qeshi. Pas disa minutash, i burgosuri i ri u dha atyre diçka. Më pas, ai u tërhoq, me kokën poshtë, duke ecur me vështirësi.”

Pyeteni klasën si ndihet i burgosuri i ri, çfarë marrëdhënieje duket se ka ai me këtë grup dhe sa energjik ndihet ai. Pse (arsyet) nxorën këto përfundime? (Me arsyet nënkuptojmë sjelljen dhe veprimet e demonstruara.)

Shkruani në dërrasën e zezë ose në tabelë për secilën:

Ndjenjën: _____

Arsyen: _____

Të përcaktosh nëse ka problem/apo jo. Ky vendim duhet të bazohet te vëzhgimet dhe njohuritë që keni mbi jetën në burg. Me njohuritë që keni mbi jetën në burg në përgjithësi, duhet të jeni i aftë të përftoni disa parime të cilat do të jenë të dobishme në marrjen e këtij vendimi. Një person tepër depresiv, zakonisht tërhiqet nga aktivitetet dhe personat e tjerë; kur 10 për qind deri në 15 për qind e grupit të burgosurve janë depresivë apo të tensionuar ose armiqësor, kjo gjë mund të ndikojë tek i gjithë grupi. Ndryshimet e papritura dhe/apo të mëdha në sjellje dhe/ose ndryshimet madhore në paraqitje nënkuptojnë problem; një person i cili ka përdorur një thikë më parë në burg, ka më shumë gjasa të godasë dikë tjetër. *Të vëzhgosh, do të thotë të vendosësh nëse një situatë është “problematike” ose “jo problematike”.*

2.4. Të Dëgjosh

Të dëgjuarit është aftësia për të dëgjuar me vëmendje dhe për të kuptuar atë që po thonë të burgosurit. Të dëgjuarit ndihmon për të kapur sinjalet e rrezikut që lëshohen nga të burgosurit, ndërsa gjërat janë ende në fazën verbale në mënyrë që të mund të ndërmerreni veprimin e duhur për të menaxhuar gjendjen përpara se të dalë jashtë duarve.

Katër hapat e të dëgjuarit janë:

1. Pezullimi i gjykimit
2. Nxjerrja e fjalëve kyçe
3. Identifikimi i intensitetit
4. Reflektim mbi natyrën e qëndrimit

Shenjat verbale dhe sinjalet: Shpesh të burgosurit kalojnë përmes fazës verbale përpara se të fillojnë të veprojnë. Nëse arrini të dëgjoni sinjale rreziku, atëherë mund ta ndaloni problemin përpara se të shpërthejë. Të dëgjuarit ka të bëjë me aftësinë që ka polici për të dëgjuar dhe për të riprodhuar me saktësi të gjitha shenjat e rëndësishme verbale të përdorura nga të burgosurit.

Sigurisht, ankesat nga të burgosurit janë të zakonshme, por ato janë edhe të rëndësishme. Një polic efektiv u vë veshin ankesave. Polici mban vesh veçanërisht për ndryshimet: për heshtjen atëherë kur duhet të ketë zhurmë (në mensë), ose për zhurmë atëherë kur zakonisht është heshtje (3 e mëngjesit te qelitë). Edhe një herë, polici pyet veten: “A ka problem këtu?”

Një tjetër gjë paraprake: nuk mund t’i dëgjoni me efektivitet të burgosurit nëse keni gjëra të tjera në mend. Nëse jeni duke menduar për shtëpinë apo përgjegjësitë e tjera të punës suaj, atëherë ndoshta nuk do të kapni shumë nga ato që po thuhet dhe se çfarë po thuhet me të vërtetë. Duhet të fokusoheni tek i burgosuri të cilin po dëgjoni – dhe kjo kërkon goxha përqendrim. Mund të punoni për ta zhvilluar këtë lloj përqendrimi duke përsëritur atë që do të bëni dhe kë do të takoni përpara se të merrni turnin.

Pezulloni gjykimin. Kjo është e vështirë për t’u bërë në lidhje me cilindo të burgosur, pasi vetë shoqëria e ka gjykuar atë. E megjithatë shumica e policëve bien dakord se është me rëndësi të gjykohet një person në bazë të asaj që bën në burg e jo në bazë të asaj që kanë bërë jashtë. Përsëri mbetet e vështirë ndonjëherë të dëgjosh, pa gjykuar menjëherë, pasi shumica e të burgosurve ose ankohen për të burgosurit e tjerë, për burgun ose ju, ose kërkojnë që t’u jepet diçka. Pavarësisht kësaj, përsëri do të ndikonte ndjeshëm te përpjekjet tuaja për të menaxhuar nëse nuk pezulloni gjykimin, pasi nuk keni për t’i dëgjuar kurrë shenjat që dërgohen përmes fjalëve të cilat duhet t’i dëgjoni për të parandaluar rrezikun apo për të ndihmuar dikë. *Të dëgjosh do të thotë të pezullosh gjykimin tënd përkohësisht në mënyrë që të mund të kuptosh me të vërtetë ç’po thuhet.*

Dalloni fjalët kyçe. Sigurisht, gjithçka që dëgjoni dhe shihni, duhet shqyrtuar në kontekstin e cilit është i burgosuri ose kush e bëri diçka e cili ishte konteksti. *Të dëgjosh do të thotë të dallosh fjalët dhe frazat kyçe, si: “marr” ose “thikë”, ose “fsheh”.*

Identifikimi i intensitetit. Deklaratat variojnë për nga intensiteti (i lartë, i moderuar dhe i ulët). Sa më emotive e me zë të lartë të thuhet, aq më pasionante janë. Por zëri i lartë dhe emocioni nuk janë e njëjta gjë. Një zë i drithëruar, për shembull, sinjalizon shumë emocione, ndonëse mund të mos jetë i lartë. Një fjali që thuhet ose me zë të lartë ose me emocion, por jo me të dyja të ndërthurura, ka intensitet të moderuar. Një fjali e thënë me zë të ulët dhe pa emocion, është e intensitetit të ulët. Fjalitë me intensitet të lartë janë shenja të vërteta rreziku. *Të dëgjosh do të thotë të përcaktosh nëse intensiteti i të folurit të burgosurit është i ulët, i moderuar apo i lartë.*

Të reflektosh për natyrën e qëndrimit (pozitiv, negativ, neutral dhe normal apo anormal) dhe përse. Me “natyrën e qëndrimit” këtu duam të themi thjesht atë që ndiejnë të burgosurit. Një pyetje që përdoret për të përcaktuar natyrën e qëndrimit është: “Çfarë ndjenjash po shprehesh apo nënkuptohen (pozitive, negative, neutrale)?” Një tjetër pyetje është: “A është ky qëndrim normal apo anormal për këtë kohë dhe vend?” *Të dëgjosh do të thotë të përcaktosh nëse natyra e qëndrimit të burgosurit është pozitive, negative apo neutrale dhe nëse është normale apo jonormale.*

Shënime për trajnerët

Bëjini klasës tre pyetjet e mëposhtme dhe shënojini përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë ose në tabelë:

Si përfundim, të jesh punonjës me uniformë nuk është asnjëherë e lehtë. Por është pothuajse e pamundur nëse do t'ju duhet të veproni në mënyrë impulsive ose sipas zakonit. Tani keni filluar t'i shtoni punës suaj profesionalizëm të vërtetë. Vlerësimi i situatës ju lejon të përdorni aftësitë pozicionuese, të qëndrimit të trupit, të vrojtimit dhe të dëgjuarit për të kuptuar se kur po ecin mirë gjërat dhe kur jo. Dhe kjo do të thotë që jeni të aftë të minimizoni rrezikun dhe të jepni maksimumin e efektivitetit tuaj në punë.

Ushtrim

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse mendoni se vlerësimi i situatës është i rëndësishëm?

(Përgjigje e mundshme: vlerësimi i situatës ju lejon të përdorni pozicionimin, qëndrimin e trupit, vëzhgimin dhe dëgjimin për të kuptuar kur gjërat po shkojnë mirë dhe kur jo. Dhe kjo do të thotë që ju jeni në gjendje të jepni më të mirën nga efektiviteti juaj në punë.)

2. Nëse do të shkonit në sektorin që ju mbulon para se të merrni në dorëzim punën, çfarë do të përpiqeshit të shihni?

(Përgjigje e mundshme: informacion në lidhje me sigurinë fizike/ndjesinë e sigurisë në atë zonë dhe për informacione të tjera relevante)

3. Cila nga aftësitë themelore mendoni se do të ishte më e dobishme për ju për ta marrë atë informacion?

(Përgjigje e mundshme: Në përgjithësi, një oficer i aftë i vlerëson sistematikisht gjërat gjatë ndërrimit të turnit, përmes vëzhgimit të burgosurve ose gjatë kryerjes së detyrës. Këto janë disa nga mënyrat se si ata mund të vlerësojnë situatën para ndërrimit të turnit:

- Kontrollon bashkë situatën me zyrtarin e monitorimit (kolegu që përfundon turnin) dhe i hedh një sy regjistrave për të parë se çfarë ka ndodhur gjatë ndërrimit të fundit.
- Lexon regjistrin e shërbimit të oficerit që po zëvendëson dhe kërkon raportim për situatën në sektorin e tij.
- Përcakton nëse ka çështje që kërkojnë prioritet (të tilla si kontrolli i një ambienti, një konflikt i pazgjidhur, një ankesë, etj.) dhe i mban shënim për t'i adresuar ato.

Bën një vizitë në sektorin që mbulon për të kontrolluar se çfarë po ndodh atje, ku janë të gjithë, çfarë po bëjnë, dhe për të shqyrtuar situatën e përgjithshme në atë sektor.

Moduli 3: Mbikëqyrja e të burgosurve (2,5 orë)

Objektivat: Në fund të modulit, pjesëmarrësit do të:

- shpjegojnë nocionet e mbikëqyrjes direkte dhe indirekte e të burgosurve
 - rendisin arsyet e mbikëqyrjes së të burgosurve
 - listojnë parimet dhe tiparet e rëndësishme të mbikëqyrjes efektive (direkte)
 - diskutojnë për teknikat e mbikëqyrjes direkte
 - ushtrohen nëpërmjet ushtrimeve praktike për mbikëqyrjen
 - njihen me raste të veçanta të mbikëqyrjes
-

Hyrje (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Qëllimi i këtij moduli është t'ju prezantojë me konceptin e mbikëqyrjes direkte dhe indirekte të burgosurve. Do t'i kushtojmë pak kohë diskutimit mbi qëllimet dhe parimet e mbikëqyrjes dhe aftësitë e një mbikëqyrësi të mirë të burgosurve.

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet pjesëmarrësit:

Nëse një burg është i sigurt për stafin, për të burgosurit dhe vizitorët, çfarë do të thotë kjo për burgun?

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit³⁹

Nëse një burg është i sigurt për stafin, për të burgosurit dhe për vizitorët, kjo tregon se ka një popullsi të burgosurish të mbikëqyrur mirë. Është një tregues se aty përdoren praktikatat më të mira të *mbikëqyrjes dhe të menaxhimit të sjelljes së të burgosurve* duke realizuar qëllimin e institucioneve të burgimit për sigurimin e një mjedisi të sigurt fizikisht.

Në përgjithësi, burgjet dhe qendrat e paraburgimit përdorin metoda të mbikëqyrjes **direkte** ose **indirekte**. Mbikëqyrja indirekte përkufizohet si metoda e mbikëqyrjes së të burgosurve ku stafi i burgjeve monitoron sektorët e banimit të burgosurve nga salla operative. *Mbikëqyrja direkte* e stacionon stafin e burgjeve brenda sektorëve të banimit të burgosurve, ku atyre u kërkohet të kenë ndërveprim të vazhdueshëm, personal e të drejtpërdrejtë me të burgosurit.

Struktura më e zakonshme e burgjeve me **mbikëqyrje indirekte** është ajo me një sallë qendrore kontrolli të mbyllur, nga e cila oficerët mbikëqyrin aktivitetin ditor të një sektori të përbërë nga qeli teke (plani modular ose “kontrollit”) ose nga qeli ku vendosen disa të burgosur bashkë.

39 Burgjet e mbikëqyrjes direkte podulare. (1993) Departamenti Amerikan i Drejtësisë. NIC. Mbikëqyrja direkte kundrejt asaj indirekte në institucionet korrektuese. Forumi mbi Kërkimin Shkencor mbi Korrektimin Shërbimi Korrektues i Kanadasë. 2015. <https://www.csc-scc.gc.ca/research/forum/e032/e032d-eng.shtml>.

Në përgjithësi, roli kryesor i oficerit në sallat e mbikëqyrjes indirekte është të operojë sistemet e kontrollit dhe të monitorojë sjelljen e të burgosurve. Konfliktet e vogla trajtohen përmes ndërhyrjes së shpejtë nga ana e oficerit; në rast të një konflikti të madh, thirret stafi mbështetës.

Qasja e metodës të **mbikëqyrjes direkte** mund të jetë disi e ngjashme me atë të mbikëqyrjes indirekte të burgjeve, por shpesh përdoren forma dhe mënyra të tjera. Gjithashtu, stafi në vend të stacionohet në ambiente të veçanta nga të burgosurit, vendoset pikërisht brenda sektorëve të banimit të burgosurve.

Një nga detyrat kryesore të punonjësve të burgjeve në institucionet e mbikëqyrjes direkte është mbajtja e kontakteve personale me të burgosurit. Në fakt, siguria varet nga aftësia e stafit të trajnuar për të zbuluar dhe për të parandaluar problemet e mundshme.

Institucionet e mbikëqyrjes direkte kanë tendencën t'u ofrojnë të burgosurve më shumë aktivitete fizike, të tilla si lojëra tavoline, pajisje stërvitore dhe akses për të fikur dhe për të ndezur dritën në qelitë e tyre. Këtu zakonisht ka edhe salla më të shumta për aktivitete ditore. Numri i lartë i sallave të aktiviteteve ndihmon në normalizimin e mjedisit dhe rrit gjasat që të burgosurit të ndahen në grupe më të vogla, më të përshtatshme për njëri-tjetrin.

Disa institucione përdorin metodat **hibride** të mbikëqyrjes direkte dhe indirekte. Për shembull, disa institucione kanë salla operative kontrolli, si dhe punonjës të stacionuar direkt në sektorët e banimit të burgosurve. Karakteristikë dalluese e mbikëqyrjes direkte është prania e vazhdueshme dhe ndërvepruese e punonjësit të burgut në sektorin e banimit të burgosurve.

Në burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Shqipëri praktika, detyrat dhe përgjegjësitë përfshijnë metodën direkte të mbikëqyrjes. Të jesh vëzhgues i mirë është shumë e rëndësishme për të garantuar një mjedis të sigurt dhe pa rreziqe në burgje dhe paraburgime. Aftësitë e mira të vëzhgimit mësohen dhe për to kërkohet një mendje e kthjellët. Mësimi për vëzhgimin e të burgosurve ka si synim të ndihmojë punonjësit e shërbimit të burgjeve për të mprehur aftësitë e tyre vëzhguese. Si mbikëqyrës i të burgosurve, mund të jeni çdo ditë efikas në komunikimin e drejtpërdrejtë me të dënuarve në rast se do të dëgjoni në mënyrë më efektive. Duhet të jetë e rëndësishme për ju si mbikëqyrës që të kuptoheni dhe, edhe më shumë e rëndësishme, që të shmangen keqkuptimet. Në mënyrë që të jeni një mbikëqyrës efektiv, çdo situatë duhet ta trajtoni duke shprehur me mendje atë që dëshironi të arrini në atë situatë dhe deri ku mund të mbërrini me atë informacion që do të merrni.

1. Mbikëqyrja efektive (direkte) e të burgosurve: arsyet dhe parimet e rëndësishme⁴⁰ (30 minuta)

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet pjesëmarrësit:

Cilat janë arsyet e rëndësishme për mbikëqyrjen (direkte) të burgosurve?

⁴⁰ Burgjet e Mbikëqyrjes Direkte. (2010) Departamenti Amerikan i Drejtësisë Instituti Kombëtar i Korrektiveve.

Shënime për trajnerët

Trajneri kërkon nga pjesëmarrësit që të diskutojnë mbi arsyet përkatëse për një praktikë mbikëqyrjeje në burgje dhe në qendra paraburgimi. Ky ushtrim do të bëhet në grupe dyshe.

Ushtrim

Pyetje: Cilat janë arsyet themelore për mbikëqyrjen e të burgosurve?

- 1.....
- 2.....
- 3.....

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë:

Të burgosurit i vëzhgojmë për këto arsye:

- Për të garantuar sigurinë dhe rendin
- Për të siguruar në kohë shkeljet e disiplinës që duhet të shqyrtohen në institucionin e kryerjes së dënimit
- Për të siguruar llogaridhënien e të dënuarve
- Për të monitoruar nga afër ndryshime e vëna re në sjelljen dhe mjedisin e të dënuarve

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet pjesëmarrësit:

Cilat janë parimet e rëndësishme ose rregullat bazë që udhëheqin mbikëqyrjen direkte të burgosurve?

Shënime për trajnerët

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të diskutojnë mbi parimet e rëndësishme ose rregullat bazë të praktikës së mbikëqyrjes direkte. Ky ushtrim duhet të bëhet në grupe dyshe.

Ushtrim

Pyetje: Cilat janë parimet e rëndësishme ose rregullat bazë që udhëheqin mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të të burgosurve?

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Pasi merr përgjigjet, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

- Një pikë fillestare e rëndësishme ose rregull bazë është se në burgje ose në institucionet e paraburgimit kontrolli nuk duhet të kryhet kurrë bashkë me të burgosurit. **Të kesh në çdo kohë institucionin në kontroll total** është vendimtare. Mbikëqyrja efektive varet nga roli drejtues i stafit të burgut dhe kontrolli në sektor;
- Popullsia e burgjeve duhet të ndahet në **grupe që janë lehtësisht të vëzhgueshme** dhe të kontrollueshme. Një *raport i përshtatshëm personel/i burgosur* është i rëndësishëm;
- Oficeri mbikëqyrës duhet të jetë gjithmonë në **gjendje të vëzhgojë me lehtësi sektorin që ai/ajo kontrollon**. Kjo duhet të lehtësohet nga dizajni i burgut dhe koncepti arkitektonik i “hapësirës së mbrojtshme”;
- **Mbikëqyrja efektive përfshin më shumë sesa mbikëqyrjen vizuale**; përfshin përdorimin e të gjitha shqisave njerëzore, si dhe ndërveprim të gjerë personal midis stafit dhe të burgosurve;
- **Vendosni pritshmëri të qarta me të burgosurit**. Tregojuni të burgosurve se çfarë prisni prej tyre;
- **Përdorni teknika pozitive të përforcimit**. Të gjithëve u pëlqen të dëgjojnë kur bëjnë diçka të drejtë. Menaxhimi i sjelljes përmes përforcimit pozitiv është më efektiv sesa përdorimi i kritikave dhe kërcënimeve. Shumica e të burgosurve rrallë dëgjojnë diçka pozitive për veten e tyre. Kur ata dëgjojnë lavdërime, zakonisht punojnë edhe më shumë për të marrë më shumë vlerësime të tilla. Gjejeni kohën për t’i «kapur duke bërë diçka të drejtë» dhe për t’ua përforcuar menjëherë ndjesinë se po bëjnë diçka të drejtë. Gjeni një sërë mënyrash për ta përforcuar sjelljen e mirë;
- **Kërkojuni llogari të burgosurve për sjelljen e tyre**. Një element kritik i menaxhimit të sjelljes është të kërkuarit llogari të burgosurve për veprimet e tyre;
- **Trajtojini të burgosurit me respekt dhe konsideratë. Jini të drejtë**; Trajtojini të burgosurit ashtu siç do të dëshironit ju vetë t’ju trajtojë stafi nëse do ishit në burg. Tregojuni respekt dhe konsideratë. Nga ana tjetër, ata do t’ju trajtojnë me respekt, dhe ju do të keni më pak probleme të sjelljes në sektor. Vendosni standardet. **DHE:** Mos i gënjeni të burgosurit. Mos premtoni asgjë që nuk mund ta realizoni;
- **Identifikoni dhe adresoni shqetësimet e të burgosurve**. Merrni kohë për të adresuar shqetësimet dhe nevojat e të burgosurve. Jepni arsyetime të menduara dhe ndihmoni të burgosurit të adresojnë shqetësimet e tyre drejtpërdrejt ose duke iu referuar një burimi të përshtatshëm. Mos harroni t’u qëndroni atyre që thoni;
- **Mbështetuni te teknikat e nevojshme mbikëqyrëse më pak kufizuese**. Nuk mund ta menaxhoni një sektor duke përdorur gjithmonë komanda, urdhra dhe disiplinë. Po të filloni në këtë nivel, nuk keni ku të shkoni, përveçse më lart. Detyrojeni veten gjithmonë që të filloni me teknika mbikëqyrëse të nivelit të ulët, mos konfrontues. Nëse filloni gjithmonë në këtë nivel, keni të gjitha opsionet e mundshme në dispozicion. Mos harroni, shumica e të burgosurve në shumicën e rrethanave do t’u përgjigjen mirë kërkesave të thjeshta. Do të habiteni se sa mirë funksionojnë. Çelësi është **që të filloni në nivelin më pak kufizues** - kjo do ta bëjë punën tuaj shumë më të lehtë me kalimin e kohës.

2. Teknika për mbikëqyrjen (direkte) të burgosurve (40 minuta)

Vëzhgimi i të burgosurve është aftësia e punonjësve të shërbimit të burgjeve për të mbikëqyruar të burgosurit 24 orë në ditë, 7 ditë të javës dhe 365 ditë të vitit. Sistemi i turneve e lehtëson vëzhgimin e të burgosurve gjatë gjithë kohës, pa ndërprerje. Në mbikëqyrjen e të burgosurve (ose të njerëzve në përgjithësi) ka tri gjëra që duhet të keni parasysh:

- situatën
- të burgosurin që po mbikëqyrni
- veten tuaj

A. Situata

Gjatë mbikëqyrjes së të burgosurit duhet të mbani mend se në çfarë situatë gjendeni dhe në çfarë situatë po kryhet një detyrë. Kjo është e rëndësishme pasi ju duhet të dini se çfarë duhet të bëjë i dënuari.

B. I dënuari.

Si mbikëqyrës duhet gjithnjë të merrni parasysh:

- Aftësinë e të burgosurit për të kryer punën
- Aftësinë për të mësuar si ta kryejë punën
- Vullnetin për të kryer punën

Njohja me të burgosurin është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i *sigurisë dinamike* (shihni modulën përkatëse mbi këtë temë) rrit efektivitetin tuaj si mbikëqyrës dhe si drejtues. Meqë gjithsecili është i ndryshëm, detyra për t'u dhënë të dënuarve punë që përshtaten me mundësitë dhe aftësitë e tyre bëhet më e lehtë nëse investoni kohë për t'i njohur ata.

Ka disa pyetje të përgjithshme që mund t'i bëni vetes për të testuar njohuritë, aftësitë, talentet dhe mundësitë.

- Sa i aftë është personi?
- Çfarë talentesh ka?
- A ka nevojë për trajnim?
- Cilat janë pikat e tij/saj të forta?
- A është ai/ajo i vëmendshëm ndaj nevojave të sigurisë?

C. Ju vetë

Mendoni se çfarë ju motivon për të bërë punën tuaj ose se çfarë ju ka motivuar për t'u bërë mbikëqyrës. Duhet të ketë tre forca madhore të cilat formojnë motivimin tuaj:

- perceptimet
- qëndrimi
- sjellja

Si mbikëqyrës, sjellja juaj mund të kontrollojë reagimet e shumë prej të dënuarve ndaj punës, marrëdhënieve të punës dhe arritjet.

Mendoni si një mbikëqyrës i mirë. Që ditën e parë që vë këmbën në një sektor

banimi të mbikëqyrjes direkte, je mbikëqyrës. Të burgosurit kërkojnë nga ju drejtim, vendimmarrje, zgjidhje problemesh dhe përforcimin pozitiv. Nëse mendoni dhe veproni si një mbikëqyrës i mirë, do të jeni më të suksesshëm në arritjen e qëllimeve tuaja në sektor.

Forma të vëzhgimit: mbikëqyrja

Vëzhgimi përfshin dy lloje të mbikëqyrjes të burgosurve që lëvizin nëpër institucion:

Lëvizje e përgjithshme e vijës – kjo është një lëvizje e mbikëqyrur, me shoqërim, e një grupi të dënuarish drejt vendeve specifike. P.sh., lëvizja e të burgosurve nga vendi ku jetojnë për në mensë, në kishë, në vendin e veprimtarive të kohës së lirë, në infermieri etj. dhe në kthim:

- Qëndroni pas grupit, në të majtë ose në të djathtë
- Qëndroni në një pozicion ku mund të vëzhgoni
- Shikoni me kujdes drejt duarve për të parë nëse shkëmbehen sende të ndaluara

Vëzhgimi nga pika në pikë – mund të mos përfshijë mbikëqyrje të drejtpërdrejtë me shoqërim. Me këtë formë vëzhgimi, të burgosurit vëzhgohen në mënyrë të tërthortë nga postet specifike.

Çfarë të vëzhgoni?

Kur vëzhgojnë të burgosurit, punonjësit e shërbimit duhet të shohin:

- Çfarë ka ndryshuar në sjelljen e të burgosurve?
- Çfarë ka ndodhur në pamjen fizike të burgosurve-it/ve?
- Çfarë ka ndryshuar në mjedisin e të burgosurve-it/ve?
- Përshkrimet fizike – gjatësia, trupi, qëndrimi fizik, çehra e fytyrës, shenja nga plagët, tatuazhe, shenja të lindura, invaliditet etj.

Mos shpërfillni ndryshimet e vëna re te të burgosurit dhe mjedisi i tyre. Ndryshimet në sjelljen, pamjen dhe në mjedis mund të nënkuptojnë:

- vetëvrasje
- arratisje
- sulm
- trazira të ardhshme

Punonjësit e shërbimit të burgut kanë detyrimin:

- Të raportojnë pranë eprorit të tyre dhe te kolegët relevantë të sektorëve të tjerë (sektori i shëndetësisë, edukimit dhe sigurisë) ndryshimet e vëna re.
- Të informojnë për ndryshimin kolegët që i zëvendësojnë në ndërrimin e turneve .
- Të jenë përgjegjës gjatë gjithë kohës për të burgosurit-in/it nën mbikëqyrjen e tyre.

Mbikëqyrje maksimale gjatë orëve fillestare të paraburgimit

Kërkohet vëmendja e veçantë gjatë periudhës së observimit sepse 24 deri në 48 orët e para të burgimit janë një fazë kritike e procesit të dënimit me burg. Shkalla më e lartë e vetëvrasjeve ndodh gjatë kësaj kohe, duke përbërë gati gjysmën e numrit të vetëvrasjeve në burgje. Mbikëqyrja intensive në këtë fazë të paraburgimit dhe

identifikimi i shpejtë i të burgosurve me prirje vetë shkatërruese kontribuon në një përqindje më të ulët të vetëvrasjeve.

Një nga mënyrat më të sigurt për të garantuar një mjedis të sigurt është që, si punonjësit, ashtu edhe të burgosurit, t'u nënshtrohen rregullave dhe normave të institucionit. Punonjësit inkurajohen që të sillen në mënyrë profesionale në lidhje me të burgosurit. Si punonjës i shërbimit të burgjeve ju duhet:

- Të mos familjarizoheni shumë me të burgosurit
- Të shmangni kontaktet fizike joprofesionale me të burgosurit dhe familjarët e tyre
- Të shmangni kontaktet seksuale me ta. Marrëdhëniet seksuale me një të burgosur nuk miratohen në asnjë rast
- Të mos luani me të burgosurit
- Të mos diskriminoni
- Të mos bëheni korrier/lajmëtar ndërmjet të burgosurve dhe /ose familjeve të tyre
- Të mos merrni apo jepni hua dhe të mos pranoni ose shkëmbeni dhurata me të burgosurit
- Të mos diskutoni me ta çështjet personale
- Të mos diskutoni me ta për kolegët e tjerë

3. Ushtrimi për mbikëqyrjen (30 minuta)

Shënime për trajnerët

Trajneri i kërkon grupit që të diskutojë në grupe dyshe për përgjigjen më të përshtatshme në tre rastet e mëposhtme (Materiali 1)

MATERIALI 1

Rasti 1: Ditën e parë, një i burgosur në sektorin tuaj, nuk arrin të rregullojë shtratin e vet, gjë që është në kundërshtim me rregullat e institucionit. Çfarë do të bënit?

1. Meqenëse ishte dita e parë e të burgosurit në sektor, unë do t'i shpjegoja rregullat të burgosurit, do t'i jepja një paralajmërim verbal, do të dokumentoja shkeljen dhe do të sigurohesha që ai të veprojë në përputhje me këtë rregull në të ardhmen.
2. Do ta urdhëroja të burgosurin të rregullojë shtratin (nuk i shpjegoj të burgosurit rregullin ose shkeljen). Do t'i thosha të burgosurit se do ta falja këtë herë - në fund të fundit, ai është i ri në sektor.
3. Do ta injoroja shkeljen e rregullit - në fund të fundit, ai është i ri në burg. Do ta ndëshkoja (do t'i jepja një formë ndëshkimi, siç është izolimi).

Cila është përgjigja më e mirë?

Rasti 2: Të burgosurit në sektorin që ju mbikëqyrni po bëjnë shumë shkelje të vogla të rregullave. Për shembull, nuk po e mbajnë sektorin të pastër; mezi çohen në mëngjes, etj. Si do t'i korrigjonit këto shkelje të vogla?

1. Do të mbaja një takim me të gjithë të burgosurit në sektor dhe do t'u komunikoj pritshmëritë e mia. Do t'i informoja për pasojat e problemeve të vazhdueshme.
2. Do të komunikoj pakënaqësinë time vetëm me disa të burgosur - ata do t'ua përcjellin fjalën të burgosurve të tjerë.
3. Do t'i disiplinoj të gjithë të burgosurit në sektor për këto shkelje të rregullave.

Cila është përgjigja më e mirë?

Rasti 3: Ju keni një të burgosur të ri në sektor, i cili nuk duket se përshtatet me të burgosurit e tjerë. Ai/ajo është i qetë, i veçuar dhe nuk përzihet me të burgosurit e tjerë. Ai/ajo e bën punën që i kërkohet, por ju mendoni se mund të dalin probleme.

Çfarë do të bënit?

Grupi im do të:

4. Rastet e Veçanta të Mbikëqyrjes (30 minuta)

Në burg kemi një sërë grupesh ndaj të cilave kemi mbikëqyrje të veçantë. Shumica e tyre janë banda (ose grupazhe) të burgosurish.

Sfida e ballafaqimit me bandat e burgjeve

Shënime për trajnerët

Trajneri pyet grupin: çfarë dini për bandat e burgjeve? Pas diskutimit, trajneri përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit⁴¹

Një bandë burgu përbëhet nga një grup i zgjedhur i të burgosurve që kanë një hierarki të organizuar dhe që funksionojnë sipas një kodi të përcaktuar sjelljeje. Bandat e burgjeve ndryshojnë si në organizim ashtu edhe në përbërje, nga banda shumë të strukturuar në banda me një strukturë më pak të formalizuar.

Natyra e bandave të burgjeve përfshin veçori të tilla si:

- Struktura dhe funksionimi i tyre i përgjithshëm, duke përfshirë kërkesat fillestare, karakteristikat e lidershit, marrëdhëniet e anëtarëve të bandës me të burgosurit që nuk janë pjesë e bandës dhe aktivitetet e bandave brenda burgjeve.
- Problemet e identifikuar të bandave burgjeve janë: trafikimi i drogës, kanosja e të burgosurve që nuk janë pjesë e bandës, zhvatja me forcë, konflikte mes bandave dhe vrasjet e kontraktuara të burgosurve.

Në luftën kundër bandave të burgjeve, burgu ka nevojë për një politikë të identifikimit, gjurmimit dhe ruajtjes së informacionit të vazhdueshëm mbi bandat e burgjeve.

Strategjitë për të luftuar bandat e burgjeve dhe aktivitetet e tyre përfshijnë:

- zhvillimin e politikave ndaj bandave të burgjeve;
- zhvillimin e procedurave për zbulimin e shenjave të hershme të veprimtarisë së bandës;
- ndërtimin e burgjeve më të vogla;
- krijimin e task forcave për bandat e burgjeve, dhe
- marrja sistematike në pyetje e ish -anëtarët bandave për të marrë informacion të dobishëm.

Rekomandohet gjithashtu që sistemet e burgjeve të ndajnë me njëri -tjetrin modele të kontrollit të bandave që kanë qenë të suksesshme dhe jo të suksesshme në juridiksionet e tyre.

Teknikat e posaçme të mbikëqyrjes

Është e rëndësishme që punonjësit e burgut të kenë njohuri të mira për grupazhet në burgje dhe ndikimin mbi të burgosurit. Kjo mund të identifikohet përmes:

- telefonatave të burgosurve⁴²

41 Kampi. Kampi CG (1984). Bandat e Burgjeve - Shtrirja, Natyra dhe Ndikimi i tyre në Burgje. Raporto. Numri NCJ 99458. Instituti Kombëtar i Drejtësisë. SHBA

42 Rregulli 24.1 Evropian i Burgjeve thotë se: Të burgosurit duhet të lejohen të komunikojnë sa më shpesh me letra, telefon ose forma të tjera komunikimi me familjet e tyre, me persona të tjerë dhe me përfaqësues të organizatave të jashtme dhe të marrin vizita nga këta persona. Rregulli 24.2 thotë se: Komunikimi dhe vizitat mund t'i nënshtrohen kufizimeve dhe monitorimit të nevojshëm për kërkesat e vazhdimet të hetimit penal, ruajtjen e rendit dhe sigurisë, parandalimin e veprave penale dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, por këto kufizime, duke përfshirë edhe ato që vendosen me urdhër të një autoriteti gjyqësor duhet gjithsesi të lejojnë një nivel minimal kontakti.

- postës së të burgosurve
- parave të burgosurve
- listës së personave që vizitojnë të burgosurit
- me kë ecin dhe/ose flasin të burgosurit
- sjelljes në terren
- informacionit
- sistemet e survejimit me video⁴³

Mbikëqyrja me video mund të garantojë siguri efektive në burgje dhe në institucionet e paraburgimit. Teknologjia e mbikëqyrjes me video u mundëson institucioneve të azhurnojnë sistemet e tyre në mënyrë që të sigurojnë një monitorim më gjithëpërfshirës dhe një nivel të rritur të sigurisë për të burgosurit dhe për punonjësit.

Plani strategjik

Plani strategjik konsiston në:

- trajnimin për njohjen e bandave (grupazheve)
- planin monitorues (monitorimi i veprimtarive të bandave)
- shënjimin e veprimtarisë që përbën rrezik
- identifikimin e anëtarëve

Tani keni më shumë njohuri për bandat, si dhe një plan strategjik për t'i trajtuar ato; gjithashtu dini përgjegjësitë tuaja si dhe njihni mënyrën si i identifikoni bandat.

Jam i sigurt se jeni të interesuar të dini se cilat janë ato që duhet dhe që nuk duhet të bëni kur punoni me bandat (grupazhet).

Çfarë të bëni dhe çfarë të mos bëni:

- Të mos i shihni si fuqi e organizuar
- Të mos e pranoni autoritetin e bandave
- Të flisni me anëtarët dhe drejtuesit e bandave
- Të bëni pyetje
- Të mos shpërndani sende me simbolizëm bandash (shembuj: tatuazhe, mbishkrime)
- Të mbështetni ata që largohen nga bandat (shembull: nëse duan t'i japin fund veprimtarive të bandave, ndihmojini ata)

Si përfundim, është shumë e rëndësishme që ju të mësoni si të identifikoni të burgosurit që u përkasin bandave të ndryshme të burgut, sikurse edhe grupe të tjera të burgosurish që përbëjnë rrezik.

⁴³ Përdorimi i kamerave dhe të dhënave të survejimit në burgje duhet të bazohet në një politikë të qartë dhe në të gjitha standardet relevante ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Diskutime

- Shpjegoni se çfarë nënkupton mbikëqyrja direkte dhe indirekte e të burgosurve
- Listoni arsyet pse është e rëndësishme të mbikëqyrni të burgosurit
- Listoni parimet e rëndësishme ose rregullat bazë të mbikëqyrjes efektive të drejtpërdrejtë
- Listoni dy llojet e vëzhgimit
- Përshkruani teknikat e mbikëqyrjes speciale

MATERIALI 1

Rasti 1: Ditën e parë, një i burgosur në sektorin tuaj, nuk arrin të rregullojë shtratin e vet, gjë që është në kundërshtim me rregullat e institucionit. Çfarë do të bënit?

1. Meqenëse ishte dita e parë e të burgosurit në sektor, unë do t'i shpjegoja rregullin të burgosurit, do t'i jepja një paralajmërim verbal, do të dokumentoja shkeljen dhe do të sigurohesha që ai të veprojë në përputhje me këtë rregull në të ardhmen.
2. Do ta urdhëroja të burgosurin të rregullojë shtratin (nuk i shpjegoj të burgosurit rregullin ose shkeljen). Do t'i thosha të burgosurit se do ta falja këtë herë - në fund të fundit, ai është i ri në sektor.
3. Do ta injoroja shkeljen e rregullit - në fund të fundit, ai është i ri në burg. Do ta ndëshkoja (do t'i jepja një formë ndëshkimi, siç është izolimi).

Cila është përgjigja më e mirë?

Rasti 2: Të burgosurit në sektorin që ju mbikëqyrni po bëjnë shumë shkelje të vogla të rregullave. Për shembull, nuk po e mbajnë sektorin të pastër; mezi çohen në mëngjes, etj. Si do t'i korrigjonit këto shkelje të vogla?

1. Do të mbaja një takim me të gjithë të burgosurit në sektor dhe do t'u komunikoja pritshmëritë e mia.
2. Do t'i informoja për pasojat e problemeve të vazhdueshme.
3. Do të komunikoja pakënaqësinë time vetëm me disa të burgosur - ata do t'ua përcjellin fjalën të burgosurve të tjerë.
4. Do t'i disiplinoj të gjithë të burgosurit në sektor për këto shkelje të rregullave.

Cila është përgjigja më e mirë?

Rasti 3: Ju keni një të burgosur të ri në sektor, i cili nuk duket se përshtatet me të burgosurit e tjerë. Ai/ajo është i qetë, i veçuar dhe nuk përzihet me të burgosurit e tjerë. Ai/ajo e bën punën që i kërkohet, por ju mendoni se mund të dalin probleme.

Çfarë do të bënit?

Grupi im do të:

Moduli 4: Transportimi dhe shoqërimi i të burgosurve

(5 orë)

Të burgosurit janë kryesisht vulnerabël kur transportohen jashtë burgut. Për këtë arsye, në Nenin 32 të Rregullave Evropiane të Burgjeve parashikohen masa mbrojtëse. Rregulli 32.3 është konceptuar në mënyrë specifike për të garantuar që të burgosurit të mos shfrytëzohen financiarisht për shpenzimet e transportimit. Gjithashtu, autoritetet publike ngarkohen me përgjegjësi të plotë për sigurinë e të burgosurve gjatë kohës së transportimit të tyre⁴⁴.

Kushtet e papërshtatshme gjatë transportit mund të jenë çnjerëzore dhe degraduese dhe për këtë arsye në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së⁴⁵.

Objektivat: Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të:

- kuptojnë qartë kuadrin ligjor në vend dhe standardet ndërkombëtare në fuqi në lidhje me transportimin dhe shoqërimin e të burgosurve;
- planifikojnë dhe përgatisin siç duhet udhëtimin e të burgosurve jashtë ambienteve të burgut dhe kthimin në objekt;
- jenë të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me transportimin dhe të gjitha çështjet që lidhen me të;
- jenë të vetëdijshëm për të gjitha llojet e shoqërimeve të lejuara sipas rregulloreve përkatëse;
- kuptojnë si duhet teknikat dhe modalitetet e komunikimit në procesin e transportimit;
- jenë të vetëdijshëm për të gjitha rregullat dhe teknikat e menaxhimit gjatë gjithë procesit të transportit, duke garantuar sigurinë e personave të transportuar.

Hyrje (15 minuta)

Kontributi i trajnerit

Rregullat Evropiane të Burgjeve⁴⁶

- 1.1 *Kur të burgosurit transferohen nga një burg në tjetrin ose lëvizin nga burgu në vende të tjera, si në gjykatë ose në spital, ata ekspozohen ndaj publikut sa më pak të jetë e mundur dhe merren masat e nevojshme për të ruajtur anonimin e tyre.*
- 1.2 *Ndalohet transportimi i të burgosurve me mjete pa ajrim të mjaftueshëm ose me dritë të përshtatshme ose që u shkaktojnë atyre vështirësi të panevojshme fizike ose cenim të dinjitetit.*
- 1.3 *Transportimi i të burgosurve realizohet me shpenzimet dhe nën drejtimin e autoriteteve publike.*

44 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581

45 *Khudoyorov kundër Rusisë*, Nr. 6847/02, paragrafët 112-120, gjykimi i 08/11/2005.

46 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581

Përpara se të lërë muret dhe sigurinë e institucionit, eskorta duhet të kuptojë se përgatitja dhe planifikimi janë të rëndësishme për suksesin e përgjithshëm të udhëtimit. Ju duhet t'i njihni të burgosurit që po transportoni; jeta juaj, jeta dhe mirëqenia e kolegëve tuaj apo e të burgosurve mund të varet nga këto çështje.

Burgjet u lejojnë të burgosurve udhëtime të miratuara në komunitet nën shoqërimin e eskortave. Këto udhëtime mund të bëhen për një trajtim mjekësor që nuk mund të jepet diku tjetër, për të vizituar një familjar të sëmurë, si dhe për të marrë pjesë në funksione pune të programuara apo ceremoni mortore ose dasma.

Neni 57 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" përcakton disa kriterë për shoqërimin e të burgosurve:

57.1 Lëvizjet e burgosurit jashtë institucionit bëhen për atë që është e mundur brenda një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast nën shoqërimin e personelit të Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

57.2 Shoqërimi i grave dhe i të miturave të burgosura kryhet nga personeli i së njëjtës gjini, ndërsa shoqërimi i të burgosurve të sëmurë kryhet me praninë e stafit mjekësor.

57.3 Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar të burgosurin sa më pak që të jetë e mundur para publikut, duke marrë masat e duhura mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e identitetit tij dhe të kushteve, që nuk cenojnë dinjitetin apo përkeqësojnë gjendjen e tij fizike.

Nëse po planifikoni transferimin e një të burgosuri jashtë institucionit, atëherë duhet të merrni në konsideratë:

- veprimet e nevojshme për përgatitjen e transferimit
- listën e formularëve dhe dokumenteve të nevojshme për transferimin
- përgatitjen e mjeteve të transportit
- hapat që duhen marrë gjatë kthimit.

Në çastin e duhur gjatë mësimin të mëpasshëm, përdorni formularët e përgatitur dhe përdorur nga administrata e burgjeve për identifikimin e të burgosurit dhe procedurat e transportit.

1. Përgatitja dhe planifikimi i udhëtimit (20 minuta)

Kur të jeni duke planifikuar udhëtimin, duhet të identifikoni procedurat që ndiqen para transportimit për t'u garantuar se keni informacion të mjaftueshëm për të burgosurin përpara se të niseni. Planifikimi i udhëtimit është hapi i parë madhor që duhet kryer. Ja si duhet të vijojë:

1. Urdhrrat

Së pari, do të merrni urdhrin që ju kërkon të transportoni një të burgosur jashtë institucionit. Këta urdhra kanë:

- autorizimin e udhëtimit
- grafikun apo një udhëtim të paplanifikuar
- udhëtim lokal apo në vend.

2. Mjetet e kufizimit, personeli shtesë, armët dhe mjetet (15 minuta)

Anëtarët e stafit të burgut që janë përgjegjës për transportimin dhe shoqërimin e të burgosurve jashtë institucionit duhet të marrin në konsideratë se përdorimi i çdo mjeti kufizues gjatë lëvizjes së të burgosurve duhet të bazohet në rezultatin e vlerësimit individual të riskut të kryer përpara transportimit. Edhe përdorimi i prangave duhet të jetë në proporcion me nivelin e riskut që paraqet i burgosuri që po transportohet.

Në nenit 57 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, më konkretisht në pikën 4 të tij parashikohet:

57.4 Në lëvizjet në grup është i detyrueshëm përdorimi i prangave ose i mjeteve të tjera shtrënguese. Mjetet shtrënguese që përdoren gjatë lëvizjes së të burgosurit duhet të jenë në proporcion me nivelin e rrezikut dhe qëllimin për të cilin përdoren.

Stafi i burgjeve duhet gjithashtu të zbatojë kërkesat që parashikon rregullorja për mjetet e kufizimit, personel shtesë, armë dhe mjete.

Në bazë të vlerësimit të riskut, stafi i burgut duhet të përcaktojë kriteret për llojin e mjeteve kufizuese që do të përdoren:

- prangat
- këllëf prangash
- prangat e këmbëve (prangat e kyçit të këmbës ose prangat e gjurit)/

3. Përgatitja e automjetit (15 minuta)

Privimi i lirisë së një personi ngarkon me përgjegjësi për të marrë masat e duhura për të garantuar sigurinë e tij. Automjetet e përdorura duhet të projektohen në mënyrë të përshtatshme për qëllimin e tyre, duke marrë parasysh të gjitha kërkesat që lidhen me sigurinë për të mbrojtur të burgosurit, si dhe personelin, sa më shumë që të jetë e mundur në rast emergjence ose aksidenti (p.sh. sistemet e mbylljes duhet të vlerësohen, duhet të vihen në dispozicion pajisjet kundra zjarrit)⁴⁷.

Automjetet e pajisura me ndarje të sigurt, kabina individuale me përmasa më të vogla se 0.6 m² nuk duhet të përdoren për transportin e një personi, pavarësisht sa e shkurtër është distanca. Kabinat individuale me madhësi rreth 0.6 m² mund të konsiderohen të pranueshme për udhëtime/distanca të shkurtra; megjithatë, kabinat e përdorura për udhëtime/distanca më të gjata duhet të jenë shumë më të mëdha⁴⁸.

Ndarjet ose kabinat e destinuara për të transportuar më shumë se një të burgosur për udhëtime/distanca të shkurtra duhet të ofrojnë jo më pak se 0.4 m² hapësirë për person, dhe mundësisht më shumë. Sa u përket udhëtimeve/distancave më të gjata, ndarjet duhet të ofrojnë të paktën 0.6 m² hapësirë personale.⁴⁹

Ndarjet ose kabinat e përdorura për transportin e të burgosurve duhet të jenë të një lartësie të arsyeshme. Të gjitha automjetet e transportit duhet të jenë të pastra, të

47 The CPT 2000 visit report to the Government of Lithuania, paragraph 117.

48 Broshura me fakte dhe të dhëna e KPT-së për transportin e të paraburgosurve, qershor 2018, <https://rm.coe.int/16808b631d>.

49 Po aty

ndriçuara dhe të ajrosura sa duhet dhe të ngrohen në mënyrë të përshtatshme⁵⁰.

Automjetet e transportit duhet të pajisen me mjete të përshtatshme çlodhjeje (të tilla si stola ose ulëse të përshtatshme).⁵¹

Numri i të burgosurve të transportuar nuk duhet të kalojë kapacitetin e automjeteve të përdorura për atë qëllim. Të burgosurit nuk duhet të qëndrojnë në këmbë gjatë një udhëtimi për shkak të mungesës së hapësirës për t'u ulur⁵².

Automjetet që përdoren për transportin e të burgosurve duhet të jenë të pajisura me mjete të përshtatshme sigurie (të tilla si rripat e sigurisë)⁵³.

Të burgosurit që do të transferohen duhet të jenë gjithmonë të shoqëruar nga grupi i shoqërimit, pavarësisht llojit të mjetit të transportit ose kohëzgjatjes së udhëtimit. Automjetet e transportit duhet të jenë të pajisura me mjete për t'u mundësuar të burgosurve të komunikojnë me grupin e shoqërimit⁵⁴.

Përpara se të niseni me të burgosurit, nuk duhet të merrni vetëm masat e zakonshme që merrni kur dilni vetëm, por duhet të merrni edhe masa që i përkasin vetëm mjedisit të burgjeve dhe të gjitha detajet që duhet të kontrollohen kur përdoren mjetet për transferimin e të burgosurve jashtë institucionit.

Le t'i hedhim një sy përgatitjes së mjetit:

- Firmosni për nxjerrjen e mjetit.
- Kontrolloni gjendjen e përgjithshme të operimit dhe shërbimet që i janë bërë.
- Kryeni kontrollin e mjetit sipas teknikave të përcaktuara.
- Kontrolloni instalimin dhe funksionimin e pajisjeve të komunikimit të mjetit.
- Kontrolloni pajisjet e sigurisë të instaluara aty (siguresat, rrjetat, mjetet e kufizimit, sirenat etj.).

4. Dokumentet e transportit (15 minuta)

Përpara se të transportohet jashtë institucionit duhen plotësuar të gjitha raportet dhe dokumentet e duhura për personelin dhe të burgosurin. Si punonjës i shoqërimit, duhet të firmosni formularin e udhëzimeve të shoqërimit. Ky formular shpjegon detyrat dhe përgjegjësitë tuaja si polic shoqërimi.

5. Përgatitni të burgosurin për udhëtim (15 minuta)

Pasi të jenë diskutuar të gjitha përgatitjet e mësipërme, tani jeni gati ta përgatitni të burgosurin për udhëtim.

- Verifikoni identitetin e të burgosurit duke kontrolluar fotografinë apo kartën e identitetit të tij.
- Merrni dhe inspektoni veshjen që do të mbajë i burgosuri gjatë udhëtimit.
- Kontrolloni të burgosurin vizualisht duke përdorur një detektor metalik apo

50 Po aty

51 Ibid.

52 Po aty

53 Po aty

54 Ibid.

duke bërë një kontroll me prekje të shpejta për të zbuluar nëse mban sende të ndaluara.

- Autorizoni veshje të pastra për të burgosurin dhe garantohuni që i burgosuri nuk merr sende të ndaluara pasi të vishet.
- Në bazë të rezultateve vlerësimit të riskut, përcaktoni nevojat dhe llojin e mjeteve kufizuese që do të përdoren gjatë transportimit
- Punonjësi apo përgjegjësi për udhëtimin ka për detyrë të kontrollojë mjetet e kufizimit përpara se të përdoren, sa të shtrënguara janë, gjendjen e kyçeve të mjetit të kufizimit dhe identitetin e të burgosurit që po transportohet.

2. Gjatë rrugës

A. Tani le të diskutojmë hapat që duhen ndjekur gjatë transportimit të një të burgosuri. Së pari, duhet të flisni vetë me qendrën e kontrollit. Mos u largoni duke i bërë punët me radio.

Ju duhet të identifikoni:

1. Identifikoni veten
2. Identifikoni të burgosurin
3. Deklaroni qëllimin e udhëtimit

Tani duhet të kryeni një instruktim përpara nisjes.

Njoftoni të burgosurin rreth sjelljes që pritet të ketë gjatë udhëtimit. Mos i tregoni të burgosurit hollësitë e udhëtimit.

Kur transportohet, i burgosuri duhet të jetë gjithmonë i shoqëruar nga grupi i shoqërimit, pavarësisht llojit të mjetit të transportit ose kohëzgjatjes së udhëtimit⁵⁵.

Të burgosurit që transportohen duhet t'i sigurohen mjete që të komunikojnë me personelin e shoqërimit në rast emergjence⁵⁶.

Duhet të sigurohen ndalesa të rregullta pushimi. Për më tepër, të gjitha automjetet e transportit duhet të ndriçohen mjaftueshëm dhe të ajrosen dhe të ngrohen në mënyrë të përshtatshme⁵⁷.

Gjatë udhëtimit duhet të ruani mbikëqyrjen dhe të respektoni procedurat e sigurisë duke e mbajtur të burgosurin:

1. nën mbikëqyrje vizive
2. të siguruar gjatë gjithë kohës me të paktën nivelin minimal të kufizimit.

B. Nëse do t'ju duhet të ndryshoni mjetin, merrni masat e duhura të sigurisë:

1. Vendosni një perimetër të sigurt përreth mjetit.
2. Merrni masat e duhura të sigurisë dhe të identifikimit të të burgosurit
3. Siguroni automjetet gjatë transferimit të të burgosurve.
4. Nëse është e mundur, ndryshoni rrugë, por njoftoni institucionin për rrugën tuaj.

55 Raporti i vizitës i KPT 1996 në qeverinë e Zvicrës, paragrafi 117.

56 Raporti i vizitës i KPT 2012 në Qeverinë e MB, paragrafi 88.

57 The CPT 2006 visit report to the Government of Greece, paragraph 134.

5. Mos e lejoni kurrë të burgosurin të shkojë për vizitë diku gjatë udhëtimit.
 6. Sigurohuni që anëtarët e personelit të mos jenë asnjëherë në kontakt me të burgosurin gjatë gjithë udhëtimit.
 7. Nëse i burgosuri arratiset, njoftoni menjëherë agjencinë më të afërt të zbatimit të ligjit dhe institucionin tuaj.
- C. Ruani llogaridhënien. Sikundër e thamë edhe më herët, duhet të jeni të sigurt për vendndodhjen e të burgosurit në çdo kohë. E përsëri këtë mund ta bëni:
1. Duke transferuar përgjegjësinë për të burgosurin te mbikëqyrësit pritës.
 2. Duke i mbajtur të burgosurit nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë derisa të mbarojë udhëtimi.
- D. Mendoni përpara se të ndodhin gjërat—mbijetesa juaj varet nga kjo! E teksa numri i incidenteve madhore është i ulët, përsëri ato mund të ndodhin. Bëhuni gati.

3. Raportoni sapo të ktheheni

Sapo të përfundoni udhëtimin dhe të ktheheni në institucionin tuaj, duhet të ndiqni këto procedura specifike:

1. Regjistroni kthimin te qendra e kontrollit (burgu ose sektori përkatës në DPB).
2. Identifikoni të burgosurin duke përdorur kartën e identifikimit të burgosurit.
3. Raportoni kthimin e të burgosurit në burg.

6. Punonjësi drejtues i eskortës (30 minuta)

Përpara se të niseni, duhet të identifikohet punonjësi drejtues i eskortës. Është thelbësore që ky punonjës të jetë trajnuar si duhet për të gjitha aspektet e procedurës së shoqërimit. Shoqëruesit duhet të kenë përfunduar periudhën e provës. Nëse kërkesat operacionale e bëjnë të pamundur që të veprohet në përputhje me këtë, atëherë drejtorët kanë si detyrë të garantojnë që cilido polic që vendoset në krye të eskortës të kuptojë përgjegjësitë e veta dhe të jetë plotësisht i aftë t'i përmbushë ato. Masat dhe udhëzimet do t'i përcillen qartë policit në ngarkim të eskortës. Është përgjegjësia e policit në ngarkim të eskortës që kjo të kryhet në përputhje me instruktimin dhe çdo udhëzim tjetër të dhënë nga eprorët dhe që ai ose ajo të kërkojë të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pajisjet që mund të duhen. E teksa polici në ngarkim të eskortës mban përgjegjësi të posaçme, të gjithë anëtarët e personelit shoqërues kanë si përgjegjësi të garantojnë mos arratisjen e të burgosurve.

Identitetet e eprorit të linjës që kryen instruktimin dhe të personelit që instruktohet, p.sh., policëve/shoferëve, duhen regjistruar së bashku me një shënim të udhëzimeve të dhëna, në një regjistër të mbajtur për këtë qëllim. Regjistri duhet t'u vihet në dispozicion eprorëve të linjës dhe ekipeve të revizionimit në shkallë lokale dhe kombëtare.

Instruktimi duhet të përfshijë:

- komunikimin gjatë shoqërimit;
- përdorimin e forcës;

- përzierjen e policëve/policeve, d.m.th. i burgosuri nuk duhet të ketë një eskortë vetëm me femra dhe e burgosura nuk duhet të ketë një eskortë vetëm me meshkuj;
- personeli i eskortës duhet të ketë gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me të burgosurin që ka në ngarkim, d.m.th. karakterin, sjelljen aktuale, inteligjencën etj.

Numri dhe niveli i personelit shoqërues duhet të përcaktohet duke kryer një vlerësim të rrezikut, që merr parasysh:

- numrin e të burgosurve që do të shoqërohen,
- nivelin e mbikëqyrjes së të burgosurve,
- natyrën e shoqërimit,
- vendndodhjen e destinacionit të eskortës,
- skemën e destinacionit të eskortës,
- kohëzgjatjen e parashikuar të eskortës,
- vlerësimin e gjasave që i burgosuri të tentojë arratisjen,
- vlerësimin e kërcënimit të mundshëm të jashtëm.

Përpara se të niset, punonjësi me uniformë në ngarkim të eskortës do të ketë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për sa u përket të burgosurve nën përgjegjësinë e tij, përfshirë edhe fotografi të azhurnuara, forma përshkruese (përfshirë një listë të veshjeve që mbajnë në trup të burgosurit), formularë të rrezikshmërisë së veçantë apo manualin në rast se i burgosuri arratiset, sipas nevojës.

Punonjësi i rolit bazë në ngarkim të eskortës, në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut, do të tërheqë aq pranga sa i duhen, dryna “D”, (që vijnë në tri lloje), çelësa, zinxhirë shoqërimi⁵⁸, dhe një celular. Polici duhet të garantohet që ato janë në gjendje pune dhe se i gjithë personeli shoqërues është i aftë t’i përdorë. Gjithashtu, nëse eskorta parashikon një udhëtim të gjatë apo drejt një vendi të pasigurt, atëherë duhet menduar edhe për mbajtjen e një telefoni celular, përfshirë edhe numrat e shërbimeve urgjente bashkë me udhëzimet e përdorimit.

Oficeri në ngarkim të eskortës duhet të garantojë se:

- personeli shoqërues kontrollon identitetin e të burgosurit që do të shoqërohet;
- statusi ligjor i të burgosurit është i njohur për eskortën.
- automjeti i eskortës kontrollon përpara se të futen të burgosurit;
- stafi shoqërues të kontrollojë nëse janë vendosur rripat e sigurimit dhe a janë funksionale;
- automjeti i eskortës është furnizuar si duhet me karburant për udhëtimin përpara nisjes. Përveç rasteve të pashmangshme, d.m.th. rrugëve të gjata, automjetet nuk duhet të ndalojnë për t’u rimbushur gjatë transportimit të burgosurve;
- personeli i shoqërimit kontrollon të burgosurin që do të shoqërohet, përpara nisjes. Këtu përfshihet edhe përdorimi i detektorit të metalit;

58 Për t’u përdorur vetëm në bazë të vlerësiit të riskut dhe kur mjetet e tjera më pak interferuese rezultojnë të pasuksesshme.

- të burgosurit kanë akses te tualetet përpara nisjes;
- prangat janë vendosur në mënyrë të sigurt mbi kockën e kyçit;
- Vendndodhja e personelit në automjet është e përshtatshme me skemën e uljes dhe konfigurimin e dymëve;
- Punonjësi me uniformë i prangosur me të burgosurin duhet të pozicionojë fillimisht të burgosurin në automjet e pastaj të sigurohet që i burgosuri është i fundit që mund të dalë.

Gjatë shoqërimit, punonjësi me uniformë në ngarkim të eskortës duhet të garantojë që:

- prangat të ekzaminohen herë pas here gjatë shoqërimit për t'u siguruar se janë vendosur në mënyrë të sigurt dhe mos të dëmtojnë të burgosurin.
- personeli i shoqërimit të minimizojë ekspozimin e të burgosurit ndaj syve të publikut dhe se asnjë person i paaautorizuar nuk ka akses tek i burgosuri;
- gjatë eskortës me autobus, personeli duhet ta pozicionojë veten përkrah të gjitha hyrjeve dhe në pozicione të tilla që u lejojnë mbikëqyrje të përshtatshme të burgosurve;
- masat për vaktet, ujin e pijshëm dhe ndalesat për nevoja personale do të merren në bashkëpunim me institucionet e tjera penale apo forcat policore (teksta transportojnë të burgosur automjetet e shoqërimit nuk duhet të ndalojnë pa qenë nevoja).

Kujdes: Ndalesat për të marrë diçka për të ngrënë NUK lejohen.

Udhëzimet e dhëna personelit shoqërues do të ndryshojnë në varësi të natyrës dhe destinacionit të eskortës. Destinacionet e zakonshme janë:

- gjykata;
- spitali, si pacient i jashtëm ose vizitë te të afërmit;
- spitali, si pacient i brendshëm;
- kisha / varrezat / krematori;
- zyra e gjendjes civile;
- paneli dëgjimor për fëmijët;
- shtëpi apo banesa të tjera;
- institucione të tjera.

Drejtuesit e njësive operacionale duhet të garantohen që vendndodhjet e përdorura zakonisht nga eskortat të vlerësohen për nivelin e rrezikshmërisë dhe që rregullat e institucionit për shoqërimin të formulohen sipas këtij mendimi. Gjithashtu, duhet vendosur lidhje me ata të cilët janë në ngarkim të këtyre vendeve për të garantuar se do të merren masat e duhura të sigurisë për të trajtuar të burgosurit. Kur është e mundur, planet e këtyre vendeve për të pritur të burgosurin duhen marrë për t'u përdorur gjatë instruktimit të personelit përpara eskortës. Drejtuesit e operacionit duhet të ndajnë me burgjet e tjera që ka të ngjarë të përdorin si vendpushim informacionin për vlerësimin e rrezikshmërisë.

7. Trajtimi i disa klasave të burgosurve (45 minuta)

Asnjë i burgosur nuk duhet të prangoset pas një objekti.

Standardet e KPT-së:

Kur transportohet, i burgosuri duhet të jetë gjithmonë i shoqëruar nga grupi i shoqërimit, pavarësisht llojit të mjetit të transportit apo kohëzgjatjes së udhëtimit⁵⁹.

Prangosja gjatë transportit, duhet të përdoret vetëm kur vlerësimi individual i riskut e përcakton qartësisht këtë dhe të bëhet në një mënyrë që minimizon çdo rrezik për lëndimin e personit të burgosur⁶⁰.

KPT rekomandon që autoritetet marrin masat që përdorimi i prangave dhe rripave të sigurimit gjatë transportit të burgosurve jashtë institucioneve dhe brenda burgjeve të bëhet vetëm kur vlerësimi individual i riskut e përcakton qartë këtë; dhe përdorimi i çdo mjeti kufizimi nuk duhet të përbëjë rrezik shtesë për lëndimin e të burgosurve gjatë transferimit të tyre. Në veçanti, gjatë transportit duhet të shmangët prangosja e të burgosurve me duart pas shpine, duke pasur parasysh mundësinë e shqetësimit për të burgosurin dhe rrezikun e lëndimit në rast aksidenti; të burgosurit duhet të transportohen me automjete të sigurta, duke shmangur kështu nevojën që ata të prangosen gjatë udhëtimit⁶¹.

1. Masat për eskortat e sigurisë së lartë

Pikat e mëposhtme u referohen procedurave të shoqërimit për të burgosur që kërkojnë masat të larta sigurie:

- Përveçse në rastet e urgjencës, të burgosurit që kanë nevojë për masa të larta sigurie, nuk duhet të nxirren jashtë pa autorizimin paraprak të drejtorit të përgjithshëm.
- Nuk duhet të shoqërohen me të burgosur të një kategorie tjetër sigurie.
- Përveçse rasteve urgjente, apo nëse drejtori i përgjithshëm bie dakord, këta të burgosur duhet të transportohen gjithmonë me një automjet të posaçëm shoqërimi, të shoqëruar nga dy policë të armatosur.
- Duhet të prangoset gjatë gjithë kohës me një punonjës shoqërimi;
- Nuk duhet të prangoset pas pikave të sigurimit të automjetit në qoftë se kjo nuk është e nevojshme për shkak të sjelljes apo në raste urgjente. Drejtuesi i vijës së parë në ngarkim të eskortës duhet t'i raportojë këto rrethana me shkrim pranë drejtorit të institucionit pritës dhe pranë drejtorit të vet në kthim.
- Forcat e policisë lokale, aty ku të jetë e mundur, duhet të njoftohen të paktën 48 orë para për shoqërimin. Policia duhet të përcaktojë rrugën që do të merret dhe asnjë lëvizje nuk do të bëhet derisa të vijë eskorta policore. Është e nevojshme të ketë një memorandum bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për rastet e transportimit të burgosurve me siguri të lartë.
- Gjatë shoqërimit, normalisht, këta të burgosur nuk duhet të paralajmërohen se kur do të bëhet nisja.
- Gjatë shoqërimit ata do të konsiderohen si “të arratisur” potencialë.

59 The CPT 1997 visit to Switzerland, paragraph 117.

60 The CPT 2008 visit to Denmark, paragraph 11.

61 Ibid, paragraph 27.

Eskortat e sigurisë së lartë (ndiqen për të gjithë të burgosurit që kanë nevojë për mbikëqyrje të lartë dhe të nivelit të mesëm dhe për ata të burgosur të nivelit të ulët të mbikëqyrjes që pas vlerësimit të rrezikshmërisë përcaktohen si të burgosur që kanë nevojë për eskortë sigurie të plotë.

Organet përkatëse të policisë së shtetit duhet të informohet rreth lëvizjeve të çdo të burgosuri të nivelit të lartë apo të mesëm të sigurisë (duhet mbajtur një regjistër i kontakteve të tilla). Mbikëqyrja, prangosja dhe zinxhirët e shoqërimit janë të detyruar, përveç rasteve kur nuk është e nevojshme për shkak të trajtimit mjekësor apo teksa janë pacientë të shtruar në spital dhe pasi të jetë kryer një vlerësim rrezikshmërie.

2. Masat parandaluese ndaj arratisjes

Kërkesat e sigurisë gjatë shoqërimit, nëse nuk vlerësohen si ekstreme, janë të njëjta, si për të burgosurit e nivelit të lartë, ashtu edhe të mesëm, por me ndryshimin që merret me vete dhe ruhet manuali i arratisjes. Personeli i eskortës duhet ta vlerësojë plotësisht të kaluarën e të burgosurit.

- Organet përkatëse të policisë së shtetit shoqërues duhet të mbajë me vete manualin e arratisjes, që i përket të burgosurit. Ky libër duhet të ketë udhëzime të shkruara për mënyrën e parandalimit të arratisjeve që duhen përdorur për atë të burgosur.
- Policia duhet të informohet rreth shoqërimit të çdo të burgosuri për të cilin duhen marrë masa kundër arratisjes.
- Të burgosurit për të cilët duhen marrë masa kundër arratisjes, që udhëtojnë me të burgosur të tjerë, do të ndahen qartazi nga të gjithë anëtarët e personelit shoqërues.
- Të burgosurit që janë paracaktuar si të arratisur potencialë, duhet të prangosen me një anëtar të personelit.

3. Masat e shoqërimit e të burgosurve

Një eskortë që shoqëron një të burgosur me mbikëqyrje të ulët, sikundër përkufizohet më sipër, duhet të kryejë një vlerësim të rrezikut për arratisje përpara se kjo të ndodhë. Vlerësimi duhet të marrë parasysh:

- të kaluarën e të burgosurit;
- stabilitetin e dukshëm në burg;
- nëse ka emër të keq;
- nëse ka ndonjë problem familjar apo të brendshëm;
- nëse ka dalë pozitiv në një test droge, ka kryer agresion apo është raportuar për sjellje të keqe.

Vlerësuesi duhet të bëjë një vlerësim të gjasave që ka për arratisje dhe të ndikimit që do të kishte kjo arratisje në media apo në shqetësimin e publikut. Aty ku duket se nuk ka faktorë që mundësojnë një tentativë arratisjeje dhe në rastet kur një tentativë mund të jetë e suksesshme, por do të kishte pak ndikim, eskorta do të klasifikohet si e sigurisë së ulët. **Nëse** nuk vlerësohet si e sigurisë së ulët, duhet të merren masa të sigurisë së lartë (sikundër për të burgosurit e mbikëqyrjes së lartë dhe të mesme). I njëjti vlerësim rrezikshmërie duhet bërë përpara se i burgosurit të shkojë të punojë jashtë burgut apo nëse lejohet të kryejë ndonjë aktivitet tjetër jashtë perimetrit të sigurisë.

Përveç rasteve kur vlerësimi i rrezikshmërisë nxjerr si përfundim se fuqia e një eskortë duhet të jetë më e lartë, atëherë propozohet që ajo të zbatohet për ata të burgosur të mbikëqyrjes së ulët të cilët mbahen në burgje të sigurisë së ulët. Ndryshimi i vetëm ndaj këtyre masave është përbërja e eskortës nga një punonjës me uniformë dhe një shofer civil dhe përdorimi i detyruar i prangave.

Prangat nuk duhet të përdoren si mjet, por duhet të mbahen nga punonjësi në ngarkim të eskortës dhe të burgosurit duhet të paralajmërohen se personeli i eskortës ka të drejtën t'i përdorë ato përpara se të niset eskorta. Fuqia e eskortës mund të jetë vetëm një punonjës, por shoferi duhet të jetë i aftë të qëndrojë me të burgosurin gjatë gjithë kohës. Gjatë shoqërimeve të sigurisë së ulët, punonjësi mund të jetë edhe vetë shofer nëse mund të qëndrojë gjatë gjithë kohës me të burgosurin. Punonjësi mund t'i vendosë prangat në çdo kohë, nëse e sheh të arsyeshme, dhe të kontaktojë menjëherë policinë vendore për të kërkuar ndihmë dhe ata duhet të dërgojnë mbështetje për policin pa vonesë.

Për shoqërimin e të burgosurve që mbahen në burgje të hapura apo ata që ndodhen në vende të mbikëqyrura, nuk ka ndonjë kërkesë të detyrueshme për shoqërim sigurie. Drejtorët duhet të përdorin gjykimin e tyre në ato rrethana kur shoqërimi të duket i arsyeshëm.

4. Të paraburgosurit në pritje të gjykimit

Për sa kohë që të jetë praktike, të paraburgosurit në pritje të gjykimit nuk do të pranohen me të burgosurit e dënuar.

5. Të dënuarat

- Ato duhet t'u nënshtrohen të njëjtave masa të sigurisë, të përshtatshme me statusin e tyre të mbikëqyrjes, sikundër në rastin e meshkujve.
- Të dënuarat shtatzëna, të cilat janë duke lindur dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes së lartë apo të mesme, duhet të kenë një shoqëruese femër, por, për to, NUK duhet të përdoren prangat apo zinxhirët e shoqërimit. Aty ku vlerësimi i rrezikshmërisë tregon një rrezik të lartë arratisjeje, duhet të rritet fuqia e shoqëruesve.

6. Të burgosurit që shfaqin sjellje të dhunshme

Kur duhen shoqëruar një apo më shumë të burgosur që kanë të kaluar apo, aktualisht, shfaqin sjellje të dhunshme, atëherë për masat dhe fuqinë e eskortës duhet marrë parasysh që duhet të informohet policia dhe mund t'i kërkohet të shoqërojë automjetin e burgut.

7. Të burgosurit e profilit të lartë

Për shoqërimin e disa të burgosurve të cilët mund të kenë profil të lartë mediatik apo për grupet e presionit, duhen marrë masa të veçanta. Mund të jetë e nevojshme të reduktohet në minimumin maksimal ekspozimi i tyre në publik dhe mohimi i aksesit të personelit të paautorizuar.

8. Përdorimi i tualetit

Me përjashtim të eskortave të sigurisë minimale, të burgosurit e shoqëruar do të lejohen të përdorin tualetet vetëm nëse janë të kufizuar përmes një zinxhiri të eskortës.

Tualeti duhet të kontrollohet nëse ka kontrabandë dhe dalje të lehtë përpara se ta përdorë i burgosuri.

Të vetmet përjashtime ndaj këtyre procedurave janë:

- gratë që janë duke lindur;
- një i burgosur që i është nënshtruar një trajtimi në spital apo si pacient i jashtëm, gjë që e bën jopraktike përdorimin e zinxhirit të shoqërimit e, për rrjedhojë, heqja lejohet vetëm gjatë periudhës së trajtimit.
- Një i dënuar që ka dëmtime në duar dhe për të cilin është shprehur mjeku, nuk i vihen pranga gjatë shoqërimit.

8. Llojet e eskortave speciale (45 minuta)

1. Udhëtimet e gjata

KPT-ja rekomandon se duhet të sigurohen ndalesa të rregullta pushimi. Për më tepër, të gjitha automjetet e transportit duhet të ndriçohen mjaftueshëm dhe të ajrosen dhe të ngrohen në mënyrë të përshtatshme⁶².

Në rastin e eskortave që do të shoqërojnë udhëtime të gjata, duhen marrë masa të veçanta:

- Me rrugë tokësore: Duhet të ketë personel të mjaftueshëm për t'u siguruar se lodhja nuk do të prekë shkallën e mbikëqyrjes. Udhëtimi duhet të ndahet në faza gjë që të lejojnë periudha çlodhjeje. Aty ku të jetë e mundur, duhet kontaktuar me institucionet e tjera penale apo me forcat policore për të marrë masa për pushimet gjatë rrugës në kushte sigurie. Polici në ngarkim të eskortës duhet të kontaktojë rregullisht me institucionin mëmë rreth ecurisë së udhëtimit përgjatë gjithë eskortës.
- Me rrugë ajrore: Linja ajrore duhet të këshillohet për eskortën dhe t'i kërkohet të merren masa të veçanta, si për shembull në lidhje me uljen. Si në aeroportet e nisjes, ashtu edhe në ato të mbërritjes, policia duhet të informohet dhe të marrë masa për akomodimin, nëse kjo shihet e nevojshme. Kapitenët e avionit mund të këmbëngulin që të hiqen prangat, por kjo nuk duhet bërë derisa dyert e avionit të mbyllen dhe i burgosuri të ulet në një ndenjësë nga dritarja. Prangat duhet të rivendosen pas uljes dhe përpara hapjes së dyerve. Kur është e mundur, eskorta duhet të pritët në aeroport nga personeli i autorizuar i burgut apo i policisë.
- Me rrugë hekurudhore: Autoriteti hekurudhor duhet të njoftohet paraprakisht në mënyrë që të merren masat për vendin e uljes. Si në nisje, ashtu edhe në mbërritje, policia duhet të informohet dhe të merren masa për akomodim, nëse kjo shihet e nevojshme.

2. Eskortat në spital

Të burgosurit që shkojnë në spital/klinika etj. për t'u ekzaminuar/trajtuar normalisht duhet të kenë një zinxhir shoqërimi gjatë ekzaminimit/trajtimit. Kjo i lejon eskortës të ruajë kontroll maksimal, por në distancë, gjë që lejon një mbikëqyrje të sjellshme.

62 The CPT 2005 visit to Greece, paragraph 134.

Kur ka gjasa që, për arsye mjekësore, të nevojitet heqja e prangave (përfshirë edhe pranimin e të burgosurve si pacientë për t'u shtruar), atëherë duhet kryer një vlerësim i rrezikut përpara shoqërimit. Drejtori apo drejtuesi i turnit duhet të miratojë rrethanat ekzakte në të cilat do të mund të hiqen prangat dhe kjo duhet të mbulohet plotësisht gjatë instruktimit përpara shoqërimit.

- Siguria e dhomës – dritaret, daljet, vendet.
- Numri i personelit të shoqërimit.
- Natyra e trajtimit dhe kushtet e të burgosurit.
- Mbështetja policore e disponuar.
- Mjetet e kufizimit (prangat) përdoren nga oficeri i burgut ndaj një të burgosuri të shoqëruar në spitalin civil (jo të sigurt) bazuar në vlerësimin individual të riskut dhe prangat hiqen kur rreziku nuk është më i pranishëm;
- Kufizimet nuk duhet të përdoren për të lidhur një të burgosur në mobilje, pajisje ose objekt të Spitalit;
- Kur përdoren mjete kufizuese për të burgosurit paraplegjikë, tetraplegjikë ose të burgosur me sëmundje të pashërueshme duhet të ketë arsyetim me shkrim nga burgu për arsyen e përdorimit. Kjo duhet të regjistrohet në vlerësimin individual të riskut të burgosurit;
- Nëse i burgosuri shfaq shenja nervozizmi në spital dhe ekziston rreziku i vetë-dëmtimit ose dëmtimit të tjerëve, mjetet e kufizimit mund të përdoren, por gjithmonë me miratimin e një mjeku dhe duke respektuar të gjitha rregullat në fuqi.
- I burgosuri nuk duhet të lihet pa mbikëqyrje në asnjë moment. Nëse trajtimi përfshin një ekzaminim intim, të burgosurit duhet t'i sigurohet sa më shumë privatësi të jetë e mundur.
- Oficerët shoqërues duhet të qëndrojnë me të burgosurin në fjalë në të njëjtën dhomë nëse vendi nuk është i sigurt.
- Në rast se shoqërohet një e burgosur grua, të paktën një anëtar i personelit shoqërues duhet të jetë femër dhe i autorizuar të qëndrojë në dhomën e pacientit.
- Dhoma që është përcaktuar për akomodim, duhet të jetë teke dhe të ketë tualet. Kjo i siguron shoqëruesit një shkallë më të lartë sigurie dhe eliminon shqetësimin për çdo pacient tjetër.
- Kur një grua e burgosur shtatzënë shkon në spital për çfarëdo arsye, përfshirë kontrollet para lindjes dhe gjatë lindjes, personeli i shoqërimit nuk duhet të jetë i pranishëm në dhomën e lindjes, ose në dhomën ku po bëhet një ekzaminim intim, përveçse nëse e burgosura e kërkon atë. Sidoqoftë, personeli shoqërues duhet të jetë vigjilent dhe të vëzhgojë hollësisht çdo lëvizje nga dhoma.
- Kur një e burgosur e shtruar në spital për të lindur vlerësohet se paraqet rrezik të lartë arratisjeje, duhet të ndërmerren hapa shtesë për sigurinë, p.sh. duke rritur numrin e personelit shoqërues.

Në rastin e trajtimit urgjent apo ndryshimit të trajtimit aty ku personeli mjekësor vë në dukje se ekziston një arsye urgjente mjekësore që kërkon heqjen e prangave, atëherë kjo duhet bërë. Polici në ngarkim të eskortës kryen një vlerësim të rrezikut (mundësisht përpara heqjes së prangave) e pastaj ia komuniko këtë institucionit.

Polici i shoqërimit dhe i institucionit do të regjistrojë termat ekzaktë të këtij komunikimi dhe institucioni duhet të vlerësojë nëse është e nevojshme të dërgojë mbështetje. Personeli shoqërues duhet të bëjë ç'është e mundur për ta minimizuar rrezikun.

3. Shoqërimi i pacientëve të shtruar në spital

Procedurat e mëposhtme shtesë duhen ndjekur kur të burgosurit trajtohen si pacientë të shtruar në spital:

- Policia lokale duhet të jetë gjithmonë e njoftuar për shtrimin e një të burgosuri në spital.
- Sikundër u tha edhe më parë, prangat nuk duhen përdorur te gratë që janë duke lindur, as gjatë udhëtimit në spital dhe as gjatë kohës kur janë në spital për të lindur, por do të mbahen me vete nga shoqëruesit dhe do të përdoren gjatë largimit nga spitali.

9. Komunikimi gjatë shoqërimit (15 minuta)

Metoda e komunikimit me eskortat e burgut/policiisë duhet të përcaktohet gjatë instruktimit përpara nisjes. Këtu duhet të preket përdorimi i radios dhe/ose celularëve me të gjitha sinjalet përkatëse të telefonatave dhe numrat e kontaktit që duhen siguruar. Kur mjetet e burgut shoqërohen nga policia, shoferi i burgut apo personi përgjegjës për eskortën duhet të lidhet me radio me automjetet shoqëruese.

Sapo kthehet në institucionin mëmë, polici në ngarkim të eskortës duhet të paraqesë një raport mbi përfundimin e shoqërimit. Ky raport duhet të përfshijë:

- çfarëdo incidenti gjatë eskortës;
- çfarëdo ngjarje të pazakontë;
- çdo kontakt mes të burgosurve dhe personave të paautorizuar;
- çdo vështirësi të përgjithshme të përjetuar.

10. Dërgimi i të burgosurve jashtë perimetrit të sigurisë (30 minuta)

Gjatë dërgimit të burgosurve jashtë perimetrit të institucionit të paraburgimit/burgut, përveç institucioneve të burgjeve të hapura, duhen pasur parasysh.

1. Për të gjitha eskortat e sigurisë së lartë/të mesme

- A është paralajmëruar i burgosuri paraprakisht për eskortën?
- A ka informacion policor që tregon se i burgosuri ka gjasa të tentojë të arratiset?
- A ka tipare të pazakonta të burgosurit (historiku i tij, sëmundje mendore, probleme disiplinore etj.)?
- A ka informacion policor për rreziqe të mundshme nga jashtë?
- A ka problem apo tipare të pazakonta për sa i përket rrugës së shoqërimit?
- A ka problem apo tipare të pazakonta lidhur me destinacionin e eskortës?

2. Për të burgosurit nën mbikëqyrje të ulët që kualifikohen për eskorta të sigurisë së ulët:

- Historia e kaluar e të burgosurit: a njihet për dhunë apo veprime të papritura?
- Stabiliteti në burg: ndonjë vështirësi e njohur?
- Historia e të dënuarit: a ka pasur arratisje nga ky i burgosur, a ka të ngjarë të zgjojë interes të veçantë të publiku?
- Ndonjë problem i brendshëm apo familjar i kohëve të fundit?
- Ndonjë ndodhi e kohëve të fundit, p.sh., ka dalë pozitiv në testin e drogës, ka sulmuar apo ka një raport për sjellje të keqe?

3. Planet e shoqërimit

Të gjitha shoqërimet duhen planifikuar mbi bazën e numrit dhe nivelit të mbikëqyrjes së të burgosurve, vlerësimit të rrezikut, llojit të transportit që do të përdoret dhe numrit të personelit.

4. Komunikimet

Punonjësi në ngarkim të eskortës duhet të pajiset me metoda të besueshme komunikimi me radio apo celular, pavarësisht nga lloji i eskortës. Sistemi duhet të jetë i aftë të funksionojë përgjatë gjithë eskortës dhe i sigurt, d.m.th. të jetë radio UHF ose celular digjital.

5. Kompetenca e personelit

Drejtorët kanë si përgjegjësi të garantojnë që personeli që shoqëron të burgosurit jashtë institucionit, të jetë trajnuar plotësisht dhe të jetë vlerësuar për sa i përket kompetencës për të kryer këto detyra.

6. Instruktimi

Përpara nisjes, punonjësi në ngarkim të eskortës duhet identifikuar nga eprori i linjës, duhet të japë udhëzime të qarta dhe të njoftojë masat e marra. Identiteti i palëve të përfshira në instruktim duhet të regjistrohet.

7. Minimizimi i eskortave

Frekuenca e eskortave të jashtme duhet të minimizohet duke sjellë specialistët mjekë etj., në institucion aty ku të jetë e mundur.

8. Manualët e brendshme

Manualët e brendshme të sigurisë duhet të përmbajnë udhëzime të plota për të gjitha aspektet e sigurisë, përfshirë edhe menaxhimin e shoqërimit. Manuali duhet të pasqyrojë shqetësimet e brendshme, por duhet të ketë edhe standardet minimale të parashtruara në këtë dokument.

9. Përrjashtimet

Këto standarde minimale vlejné për të gjitha eskortat. Përrjashtimet e vetme do të jenë urgjencat mjekësore, eskortat në spital aty ku janë kryer vlerësimet e rrezikut ose në rastet kur nëndrejtori operacional ka dhënë miratim me shkrim.

11. Ushtrime praktike (30 min)

- Listoni katër gjëra që duhen mbajtur parasysh gjatë përgatitjes së eskortës për udhëtim.
- Listoni dokumentacionin baze që nevojitet për eskortën.
- Përshkruani detyrat e përgjegjësit të eskortës.
- Diskutoni rreth një situatë, si prishja e mjetit gjatë udhëtimit. Çfarë masash do të merren.
- Klasifikoni ose bëni vlerësimin e rrezikshmërisë për një të burgosur të profilin të lartë.

Mbyllja

Moduli 5: Teknikat e kontrollit dhe sendet e ndaluara

(5.5 orë)

Objektivat: Në fund të këtij moduli pjesëmarrësit do të:

- shpjegojnë parimet themelore, legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me aplikimin e kontrolleve në situata dhe kushte të ndryshme;
- shpjegojnë teorinë dhe praktikën e kontrolleve në kontekstin e burgut;
- ndërgjegjësohen për të gjitha llojet e kontrolleve dhe për të gjitha modalitetet që lidhen me zbatimin e tyre në praktikë duke përfshirë masat mbrojtëse për të shmangur poshtërimin e personave të burgosur;
- marrin njohuri për të gjitha sendet dhe substancat e ndaluara sikurse përcaktohet në rregulloret e brendshme të burgjeve;
- jenë në gjendje të plotësojnë të gjitha protokollet përkatëse;
- demonstrojnë zbatimin e teknikave të kontrollit në praktikë.

Hyrje (15 minuta)

Kontributi i trajnerit

Çdo burg duhet të ketë disa procedura të njohura mirë, të cilat përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të kryhen kontrollet, metodat që duhen përdorur dhe frekuencën e tyre. Procedurat duhet të hartohen për të parandaluar arratisjet, për të garantuar sigurinë e të burgosurve dhe të personelit të burgut, si dhe për të mbrojtur dinjitetin e të burgosurve dhe të vizitorëve. Duhet të parashikohen procedura për kontrollin sistematik të ambienteve të banimit si qelitë dhe dhomat për t'u siguruar se nuk janë cenuar masat e sigurisë, duke përfshirë dyert dhe kyçet, dritaret dhe grilat⁶³.

Neni 54 i Rregullave Evropiane të Burgjeve, adreson⁶⁴:

Në raste kontrolli, ka procedura të veçanta që ndiqen nga personeli. Kontrollohen:

- a. të gjitha vendet ku jetojnë, punojnë dhe rrinë së bashku të burgosurit;
- b. të burgosurit;
- c. vizitorët dhe sendet e tyre; dhe
- d. personeli.

Situatat kur janë të nevojshme këto kontrolle dhe natyra e tyre parashikohen në legjislacionin vendas.

- Personeli trajnohet për të qenë i aftë të realizojë këto kontrolle në mënyrë që të zbulojë dhe të parandalojë përpjekjet për të shpëtuar nga kontrabanda ose për t'u fshehur asaj, ndërkohë që respektohet dinjiteti i personave mbi të cilët kryhet kontrolli dhe sendet personale të tyre.
- Gjatë procesit të kontrollit, personat që janë subjekt i tij, nuk duhet të trajtohen

63 Rregullat Evropiane të Burgjeve të rishikuara: udhëzime të reja për shërbimet e burgjeve mbi trajtimin njerëzor të të burgosurve - Promovimi i sanksioneve penale më humane dhe me efektivitet shoqëror (coe.int)

64 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581 .

pa dinjitet.

- Kontrolli ushtrohet vetëm nga personeli i së njëjtës gjini.
- Personeli i burgut nuk bën kontrolle të brendshme fizike në trupin e të burgosurve.
- Kontroll intim lidhur me kërkimin bëhet vetëm nga mjeku i burgut.
- Të burgosurit janë të pranishëm kur kërkohet në sendet e tyre personale, me përjashtim të rasteve kur prania e tyre nuk lejohet nga teknikat e investigimit ose kërcënimet e mundshme të stafit
- Detyrimi për të ruajtur sigurinë dhe te qenit i sigurt balancohet me privatësinë e vizitorëve.
- Procedurat për kontrollin e vizitorëve profesionistë, si p.sh., përfaqësuesit ligjorë, punonjësit socialë, mjekët e burgut etj., janë subjekt i konsultimeve me organet përkatëse profesionale për të siguruar një balancë ndërmjet sigurisë dhe së drejtës së aksesit profesional konfidencial.

Parimi i Ligjshmërisë dhe Proporcionalitetit

Sendet personale të burgosurve i nënshtrohen kontrollit në varësi të kategorisë së sigurisë të burgosurve. Personeli që kryen kontrolle duhet të trajnohet posaçërisht për të garantuar respektimin e parimeve të proporcionalitetit dhe ligjshmërisë. Këto parime sugjestionojnë një ekuilibër midis masave për zbulimin dhe parandalimin e çdo akti për arratisje apo për futjen e sendeve të ndaluara, dhe respektimin e dinjitetit të burgosurve dhe personalitetin e tyre.

Gjatë kontrollit të qelisë ose sendeve personale, i burgosuri duhet të jetë i pranishëm.

Rregulli 51 i Rregullave të Nelson Mandelës parashtron se, për qëllime llogaridhënieje, administrata e burgut duhet të mbajë shënime të plota për të gjitha kontrollet, arsyen e kontrolleve, punonjësit që i kanë kryer dhe rezultatet e kontrolleve⁶⁵.

1. Korniza Ligjore (30 minuta)

Korniza ligjore që rregullon kontrollet dhe procedurat përkatëse paraqitet më poshtë. Në Shqipëri, aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë udhëzime të rëndësishme për personelin përgjegjës të burgjeve.

Ligj nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, në nenin 54 parashikon dispozitat e mëposhtme për kontrollin personal të burgosurve:

- 1. I burgosuri i nënshtrohet kontrollit personal në çdo rast të hyrjes ose të daljes nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale dhe në rastet kur ka dyshime të arsyeshme që mban sende të ndaluara.*
- 2. Kontrolli personal i të burgosurit duhet të jetë në proporcion me nevojën që dikton kryerjen e tij dhe bëhet duke respektuar dinjitetin, besimin dhe veçori të tjera të tij.*
- 3. Kontrolli mund të bëhet vetëm nga persona me të njëjtin gjini me të burgosurin, në praninë e jo më pak se dy punonjësve, në mënyrë që të shmangë mundësinë e kontaktit vizual nga personeli i gjinisë tjetër.*

65 Po aty

4. Kontrolli i të burgosurave gra dhe vajza kryhet vetëm nga stafi me të njëjtën gjini, i trajnuar me metoda të përshtatshme kontrolli, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullohen e përgjithshme të burgjeve.
5. Kontrolli i të miturit të burgosur kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit.
6. Në çdo rast, ndalohet kontrolli intim ndaj të burgosurit nga punonjësi i Policisë së Burgjeve. Kontrolli intim bëhet vetëm nga mjeku i institucionit, me autorizim të drejtorit të institucionit vetëm kur ka dyshim të arsyeshëm se personi që kontrollohet mund të ketë fshehur sende të ndalura. Kontrolli intim bëhet në përputhje me rregullat dhe sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Ndërsa në nenin 55 të ligjit të sipërcituar parashikohen dispozitat për kontrollin në mjediset e dhomave. “Kontrolli në mjediset dhe dhomat ku qëndrojnë të burgosurit kryhet nga personeli i specializuar në prani të burgosurit, me përjashtim të rasteve kur prania e tij përbën rrezik për sigurinë fizike të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.”

Ligji Nr. 80/2020 “Për policinë e burgjeve”, në nenin 16 të tij parashikon këto dispozita për ushtrimin e kontrollit:

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron kontroll në mjedise, si dhe ndaj:
 - b. të burgosurve;
 - c. personave që hyjnë brenda perimetrit të sigurisë dhe kanë statusin e vizitorit;
 - d. personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Kontrolli personal kryhet nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, në praninë e jo më pak se dy punonjësve dhe në mënyrë që shmang mundësinë e shikimit nga punonjësi i gjinisë tjetër. Kontrolli personal i të burgosurit duhet të jetë në proporcion me nevojën, si dhe mban parasysh respektimin e dinjitetit të personit që kontrollohet, të besimit dhe veçori të tjera të tij.
3. Në çdo rast ndalohet kontrolli intim ndaj personave që i nënshtrohen kontrollit nga ana e punonjësit të Policisë së Burgjeve. Kontrolli intim bëhet vetëm nga mjeku i burgut, kur ka dyshim të arsyeshëm se personi që kontrollohet mund të ketë fshehur sende të ndalura. Kontrolli intim bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.
4. Kontrolli i të miturve të dënuar ose të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
4. I nënshtrohen kontrollit edhe sendet personale, që kanë personat që kontrollohen në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Personi që kontrollohet duhet të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të sendeve personale të tij, me përjashtim të rasteve kur përdoren mjetet teknike të kontrollit ose prania e personit përbën rrezik për personelin që ushtron kontrollin. Kontrolli personal dhe i sendeve personale të personit mund të bëhet edhe me mjete teknike të kontrollit.
5. Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontrolleve në mjedise, punonjësi i Policisë së Burgjeve harton një raport, ku jepen arsyet e hyrjes, të kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.
6. Rregullat e hollësishme për rastet, llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kontrolleve parashikohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

2. Çfarë futet në sende të ndaluara për mjedisin e burgut? (15 minuta)

Që një institucion të mbahet nën kontroll është e nevojshme të mos prodhohen, mbahen, transportohen apo të përdoren sende të ndaluara. Kjo mund të arrihet vetëm përmes kontrolleve të kryera nga personeli i trajnuar e profesional në të gjithë institucionin ndaj të burgosurve në këtë institucion, ndaj vizitorëve, ndaj punonjësve me kohë të pjesshme apo edhe ndaj shitësve.

Sende të ndaluara konsiderohen të gjithë ato mallra të cilat, si pasojë e përdorimit të tyre nga ana e të dënuarve nëpër burgje, përbëjnë rrezik për jetën e punonjësve të policisë, personave të tjerë të administratës si dhe vetë të dënuarve. Sendet kontrabandë brenda institucionit të burgut mund të kenë efekte shkatërrimtare ndaj sigurisë dhe rendit në institucion. Për këtë arsye, është përgjegjësia jonë si punonjës të shërbimit të burgjeve, që gjatë gjithë kohës të jemi të vëmendshëm ndaj sendeve të ndaluara. Duhet të jemi të vetëdijshëm se për çfarë jemi duke kërkuar, ku të kërkojmë dhe si, në mënyrë që kontrollet tona të jenë efektive. Ky material duhet t'ju ndihmojë të mprehni aftësitë tuaja për t'u siguruar se do të eliminohen të gjitha sendet e ndaluara dhe institucioni ku punoni dhe të dënuarit të cilët i keni në mbikëqyrje do të jenë të sigurt.

1. Sendet e ndaluara

Sendet të ndaluara mund të përkufizohen si sende që zotërohen nga ndonjë i burgosur, punonjës apo vizitor të cilat janë të ndaluara nga rregullorja e atij institucioni. Ato duhet të përcaktohen qartë si të tilla dhe një gjë e tillë t'u bëhet e ditur të gjithëve. Sendet e ndaluara, në shumicën e rasteve, përfshijnë:

- Armë, duke përfshirë pistoletë, thika, sende me formë etj.
- Çdo send që nuk është dhënë nga ose nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një punonjësi ose që nuk janë të lejuara që të mbahen nga të burgosurit.
- Sende që mund të përdoren për të ndihmuar apo për të realizuar arratisjen.
- Vegla të paautorizuara.
- Droga intoksikuese.
- Para.
- Alkool.
- Sende të tjera që mund të përshkruhen si sende të ndaluara në institucion.
- Celularë.

2. Pikat e hyrjes

Sendet e ndaluara, në një mënyrë apo në një tjetër, arrijnë të hyjnë në burg. Pikat e hyrjes janë aspekti më i rëndësishëm për të cilin duhet të keni njohuri në mënyrë që të ndaloni hyrjen e tyre .

Këto mund të përfshijnë:

- Portën, nga hyjnë: automjete të shpërndarjes, vizitorë, zyrtarë, të afërm dhe miq të burgosurve, punonjës etj.
- Sendet që vijnë përmes zyrës së informacionit, takimeve me familjarët,

mjediseve të avokatit, bashkë me ushqimet apo pajisjet që futen në mjediset e të dënuarve.

- Sendet e hedhura përtej murit ose gardhit, apo që hidhen ose merren nga dritaret.
- Vizitat normale për të burgosurit nga miq e të afërm.
- Postën.
- Mbi/nën/ose përmes rrethimit ose muret e burgut.
- Punonjësit.
- Kontrollin që nuk kryhet ashtu si duhet.
- Punishtet ku punojnë të burgosurit nga mund të vjedhin sende intoksikuese, si p.sh., ngjitësi.

3. Qëllimi, rëndësia dhe parimet e kontrollit (60 minuta)

1. Rëndësia e kontrollit

Sendet e ndaluara brenda një burgu mund të kenë efekt shkatërrimtar në sigurinë dhe rendin në institucion. Për këtë arsye, është përgjegjësia jonë si punonjës të burgjeve që të jemi të vëmendshëm gjatë gjithë kohës në lidhje me sendet kontrabandë. Duhet të jemi të vetëdijshëm se për çfarë po kërkojmë, ku të kërkojmë dhe si të kërkojmë. Arsyet kryesore për të kryer kontrolle përfshijnë:

1. Për të identifikuar dhe për të parandaluar hyrjen në burg të sendeve të ndaluara ose të rrezikshme:
 - Vizitorët që vijnë për të takuar të burgosurit, duhet të kontrollohen për të shmangur hyrjen në burg të sendeve të ndaluara.
 - Punonjësit duhet të kontrollohen nëse dyshohen se janë të përfshirë në trafik me të burgosurit.
2. Për të identifikuar dhe për të parandaluar marrjen e paautorizuar të veglave të rrezikshme nga punishtet e burgut, dyqani, kuzhina, spitali etj. Të burgosurit që punojnë në punishte dhe në kuzhinën e burgut, duhet të kontrollohen kur largohen nga vendi i punës për të parë nëse kanë thika, vegla gdhendëse etj. Gjatë kthimit nga spitalet, nga gjykatat, duhet të kontrollohen, gjithashtu, pasi që andej mund të sjellin sende kontrabandë.
3. Për të siguruar se asnjë i burgosur nuk ka, nuk mban në qeli apo në vendin e punës sende të rrezikshme. Kontrollat e qelisë dhe të dhomave duhet të identifikojnë sende e ndaluara që mund të jenë futur. Kontrolli duhet të identifikojë veglat e sjella që mund të përdoren për t'u arratisur nga burgu.
4. Për të identifikuar dhe për të parandaluar vjedhjen e pronës së institucionit. Të burgosurit që punojnë në pjesë të ndryshme të burgut, mund të vjedhin sende që më pas i përdorin për arsye të dyshimta. Ndonjëherë edhe punonjësit mund të vjedhin sende të caktuara nga burgu nëse kontrollet nuk kryhen ashtu siç duhet. Automjetet që hyjnë dhe largohen nga burgu, mund të shfrytëzohen për të marrë sende që i përkasin institucionit, nëse kontrollet nuk kryhen ashtu siç duhet.
5. Për të identifikuar personat që mund të arratisen duke u fshehur në automjete.

Kontrollet ndaj të gjitha automjeteve që hyjnë në burg dhe që largohen nga burgu parandalojnë arratisjen e të burgosurve që mund të tentojnë t'i përdorin këto automjete. Kontrolli duhet të ushtrohet brenda automjetit, nën automjet si dhe në kontejnerët që mund të ketë.

6. Për të identifikuar përpjekjet për t'u arratisur nga burgu. Vegla të futura kontrabandë në qeli apo në dhomat e fjetjes, nëse nuk identifikohen, mund të përdoren për të hapur muret në një përpjekje për t'u arratisur. Kontrollet duhet të realizohen për të parë nëse ka përpjekje për t'u arratisur.
7. Për të parandaluar personelin dhe vizitorët në mënyrë që të mos sjellin sende kontrabandë në burg. Kontrollet duhet të kryhen si ndaj punonjësve, ashtu edhe ndaj vizitorëve që vijnë në burg, kurdo që të ketë arsye të besojë se ata mund të kenë sende kontrabandë.

Kontrollet janë të nevojshme :

- Për të ruajtur sigurinë dhe për të ruajtur rendin dhe disiplinën.
- Për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë personat që qëndrojnë brenda perimetrit të institucionit, duke përfshirë të burgosurit dhe stafin.
- Për të parandaluar qarkullimin e sendeve të ndaluara, duke përfshirë edhe drogën në burg, për t'u marrë sendet e ndaluara të burgosurve, vizitorëve dhe punonjësve.

2. Etika e kontrolleve

- Kontrollet nuk kanë si qëllim të poshtërojnë personin që kontrollohet.
- Kontrollet duhet të realizohen duke ruajtur mirësjelljen dhe në një mënyrë që është në përputhje me qëllim për të marrë sende të fshehura.
- Kontrollet duhet të kryhen nga një punonjës i së njëjtës gjini me të burgosurin/ vizitorin.
- Të burgosurve nuk duhet t'u kërkohet që të zhvishen në prani të stafit të seksit së kundërt.
- Kontrollet intime duhet të kryhen në mjedise të veçuara, larg shikimit të burgosurve të tjerë.
- Kur realizoni kontrollin intim sigurohuni që subjekti të mos jetë asnjëherë plotësisht i zhveshur.

3. Parimet e kontrollit

Për të siguruar që kontrolli kryhet në mënyrën e duhur dhe për të mbajtur institucionin të sigurt dhe pa rreziqe, duhet të zbatohen këto parime:

Qasja Sistematike: Të gjitha kontrollet duhet të zhvillohen në mënyrë sistematike.

- Vendosni një sistem që ta zbatoni sa herë kryeni kontrolle.
- Filloni të kontrolloni nga lart-poshtë.
- Nga e majta në të djathtë.
- Nëse bëhet kontroll qelie, punonjësit duhet të vendosin se çfarë do të kontrollojë secili.
- Kryejini kontrollet në të njëjtën mënyrë çdo herë.
- Mos u hutoni.

Tërësore: Kontrollët duhet të jenë të plotë dhe tërësore çdo herë:

- Nuk duhet të hamendësoni.
- Shihni në zonat më të dukshme dhe më pak të dukshme.
- Gjithnjë të jeni kureshtarë, asnjëherë mos i merrni gjërat për të mirëqena.
- Kontrolloni dhe rikontrolloni.
- Nëse diçka ju bën të dyshoni, kontrolloni dhe mos i shpërfillni instinktët tuaja.

Objektive: Kontrollët nuk duhet të bëhen asnjëherë duke pasur si synim që t'u bihet në qafë të burgosurve që kontrollohen.

- Kontrollët duhet të kryhen për të marrë sendet e ndaluara të futura kontrabandë.
- Duhet të ndiqen gjithnjë procedurat normale.
- Vetëm punonjës të së njëjtës gjini me të burgosurit lejohen të realizojnë kontrolle me prekje apo kontrolle intime.
- Çdo kontroll duhet të ketë si synim që të gjenden dhe të merren sendet e ndaluara dhe jo thjesht për të kryer kontrollin e radhës.

4. Llojet e kontrollit

- Kontrolli me prekje të lehta e të shpejta.
- Kontrolli intim.
- Kontrolli i posaçëm.
- Kontrolli rutinë.

Siguria e të burgosurve dhe e personelit varen në shkallë të madhe nga fakti sa të plotë dhe tërësore janë kontrollët që kryhen në burg. Mbajtja nën kontroll realizohet nëpërmjet kontrolleve që kryhen ndaj të burgosurve, anëtarëve të personelit, vizitorëve, automjeteve që hyjnë në burg ose largohen nga burgu, qeli, dhoma kolektive dhe në të gjithë burgun.

4. Format e kontrollit (60 min)

1. Kontrollët me prekje të lehta nga lart - poshtë:

Çdo i burgosur, dhe në mënyrë të veçantë ata të cilët mbahen në siguri të zakonshme dhe të lartë duhet të kontrollohen sistematikisht për t'u siguruar se nuk kanë sende të ndaluara në përdorim, të cilat mund t'i shfrytëzojnë për t'u arratisur, për të plagosur njerëz të tjerë ose për të lënduar veten, apo lëndë që nuk lejohen, siç janë drogat e paligjshme. Intensiteti i kontrolleve ndryshon sipas rrethanave. Për shembull, kur një numër i madh të burgosurish kthehen nga vendi i tyre i punës drejt e në ambientet e jetesës, është normale që t'i nënshtrohen kontrolleve «trupore». Për shkak të natyrës intime të kontrolleve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet respektimit të dinjitetit të personit gjatë kryerjes së tyre. Kontrollët trupore nuk duhet të kryhen nëse nuk janë të nevojshme dhe nuk duhet të përdoren kurrë si formë ndëshkimi⁶⁶.

Kontrolli me prekje të lehta nga lart – poshtë ka të bëjë me prekjen e pjesëve të veshura të personit. Kontrolli kryhet gjatë:

- Pranimi në burg.

⁶⁶ Ibid.

- Kurdo që i burgosuri shkon për në punë.
- Kur hyn në mjediset e banimit.
- Kur kthehet nga gjykata, takimet, spitalet etj.

Kur kryhet ky lloj kontrolli punonjësit duhet:

- Të informojnë të burgosurin se do t'i nënshtrohet kontrollit.
- T'i kërkojnë të burgosurit të heqë të gjitha sendet që mund të ketë me vete dhe t'i vendosë ato në një vend.
- T'u kushtojnë vëmendje të veçantë astarëve të xhepave, jakave, shiritave të dorës, këpucëve dhe takave.
- Të udhëzojnë të burgosurin të kalojë duart nëpër flokë.
- Të udhëzojnë të burgosurin të hapë duart, të hapë gishtat, të hapë gojën dhe të lëvizë kokën nga njëra anë në anën tjetër.
- Të udhëzojnë të burgosurin të kthehet me fytyrë nga muri dhe të mbështetet te muri duke mbajtur këmbët hapur.
- Të filloni nga jaka, poshtë krahëve, para, prapa, te mesi dhe këmbët.
- Të kontrolloni shputat e këmbëve një e nga një.
- Të kontrolloni sendet që mund të ketë i burgosuri me vete kur kthehet, nëse nuk gjenden sende të ndaluara.
- Të regjistroni rezultatet e kontrollit në regjistrin e kontrollit.

2. Kontrolli personal dhe kontrolli i imtësishëm⁶⁷

Nëse ka arsye për të besuar se një i burgosur po fsheh diçka në trup ose kur është klasifikuar si i burgosur me rrezikshmëri të lartë, duhet të kryhet ai që njihet si “kontroll i imtësishëm trupor”. Në këtë rast, i kërkohet të burgosurit që të heqë rrobat për të treguar se nuk ka asgjë të fshehur në trup. Gjatë zbatimit të këtij kontrolli, duhet të mbahen në konsideratë procedurat për kontrollin personal të burgosurve. GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kërkesën që i ishte bërë një të burgosuri që të zhvishej lakuriq në prani të grave⁶⁸ ose gjatë kryerjes së kontrolleve të caktuara trupore, për shkak të shpeshtësisë dhe metodës së përdorur.⁶⁹ Të burgosurve nuk duhet t'u kërkohet kurrë që të zhvishen plotësisht për qëllime kontrolli⁷⁰.

Personeli i burgut, për asnjë lloj arsye, nuk duhet të kryejë kurrë kontrolle të brendshme trupore të burgosurve, për shembull, duke futur një gisht ose ndonjë instrument në zgavrat e trupit të burgosurit. Nëse ka arsye për të dyshuar se të burgosurit mund të kenë fshehur në trup drogë ose ndonjë send tjetër të ndaluar, duhet të merren masa që ata të mbahen nën mbikëqyrje deri në momentin kur nxjerrin nga trupi çdo send që mund të kenë fshehur brenda në trup. Nëse kontrollet e brendshme trupore kryhen nga një mjek, duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe Deklaratës së Shoqatës Botërore të Mjekësisë mbi Kontrollin Trupor të Burgosurve (Tetor 1993). Rregulli

67 **Kontrolli i zhveshur** përfshin një akt të heqjes së rrobave të dikujt për të parë nëse ai person fsheh sende të ndaluara, droga të paligjshme, armë, etj. **Një kontroll intim** përfshin ekzaminimin fizik të ndonjë prej vrimave të trupit të të dyshuarit, përveç gojës.

68 *Valasinas kundër Lituanisë*, Nr. 44558/98, gjykimi i 24/07/2001.

69 *Van der Ven kundër Holandës*, Nr. 50901/99, gjykimi i 04/02/2003.

70 Rregullat e rishikuara Evropiane të Burgjeve, f.36. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809c9086.

54.6 nuk përjashton mundësinë e përdorimit të teknologjisë moderne për të skanuar trupat e të burgosurve⁷¹.

Standardet e KPT-së:

KPT rekomandon që autoritetet [...] të marrin masa për kryerjen e kontrolleve trupore të cilat duhet të bazohen në vlerësimin individual të riskut dhe t'i nënshtrohet kritereve dhe mbikëqyrjes rigoroze, dhe të kryhet në një mënyrë që respekton dinjitetin njerëzor. Për më tepër, të burgosurve nuk duhet t'u kërkohej të zhvishen në prani të personelit të seksit të kundërt⁷².

Kontrolli i imtësishëm trupor (dhe aq më tepër një inspektim vizual i zonës perineale), është një procedurë tejet invazive dhe potencialisht degraduese. Sipas këndvështrimit të KPT-së, zbatimi i tij në çdo rast është i tepërt dhe i panevojshëm. Sigurisht, personat e burgosur duhet të kontrollohen vazhdimisht për të garantuar sigurinë e tyre dhe të personelit [të policisë/burgut]. Sidoqoftë, kontrolli i imtësishëm trupor duhet të bëhet vetëm kur ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se një i burgosur mund të ketë fshehur në trup sende që mund të përdoren për të dëmtuar veten ose të tjerët ose që mund të jenë dëshmi të një krimi dhe një kontroll i tillë është i nevojshëm për t'i zbuluar këto, duke qenë se kontrolli i zakonshëm nuk ka gjasa të rezultojë në gjetjen e tyre. Kryerja e një kontrolli të tillë kërkon autoritetin e një oficeri të lartë dhe duhet të jetë objekt i një politike të shkruar, duke përcaktuar në mënyrë të qartë rrethanat në të cilat lejohet të përdoret⁷³.

Duhet bërë çdo përpjekje e arsyeshme për të minimizuar poshtërimin; të burgosurve që kontrollohen nuk duhet t'u kërkohej që t'i heqin të gjitha rrobat në të njëjtën kohë, p.sh. personit duhet t'i lejohet të heqë rrobat nga mesi e lart dhe t'i veshë përsëri para se të heqë rrobat e tjera. Përveç kësaj, si rregull, duhet të ketë më shumë se një oficer të pranishëm gjatë çdo kontrolli të imtësishëm trupor si një lloj mbrojtjeje si për të burgosurit, ashtu edhe për stafin⁷⁴.

Kontrollet intime duhet të kryhen vetëm kur ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se një i burgosur mund të ketë fshehur në trup sende që mund të përdoren për të dëmtuar veten ose të tjerët ose në rast se mund të ketë dëshmi të një krimi, mund të nevojitet dhe një kërkim e një kontroll i tillë, pasi një kontroll i zakonshëm mund të rezultojë i pasuksesshëm. Nëse një kontroll i imtësishëm është absolutisht i nevojshëm, ai kurrë nuk duhet të kryhet nga mjeku që e ndjek të burgosurin si pacient, në mënyrë që të ruhet marrëdhënia pacient-mjek⁷⁵.

Ekzaminimet [e kaviteteve trupore] duhet të kryhen përjashtimisht mbi bazën e një vlerësimi të rrezikut, jo sistematikisht.. Përveç kësaj, ekzaminimet e imtësishme të brendshme duhet të bëhen vetëm nga një mjek, por kuptohet që ky mjek nuk duhet të jetë mjeku që e trajton të burgosurin si pacient në lidhje me shëndetin⁷⁶.

Zbatimi i kontrollit intim:

Çdo i burgosur, kur vjen në institucion, duhet t'i nënshtrohet një kontrolli intim. Ky

71 Po aty

72 Vizita e KPT 2008 në Portugali, paragrafi 45.

73 Vizita e KPT 2010 në Kosovë, paragrafi 29.

74 Po aty

75 Vizita e KPT 2011 në Zvicër, paragrafi 105.

76 Vizita e KPT -së 2005 në Greqi, paragrafi 81.

kontroll ka të bëjë me një kontroll të plotë të gjitha rrobave dhe të gjitha pjesëve të jashtme të trupit.

Ekzaminimi i kaviteve të brendshme trupore duhet të kryhet vetëm nga personeli mjekësor. Këto kontrolle kryhen për arsye sigurie dhe jo për arsye mjekësore. Megjithatë, kontrolle të tilla nuk duhen kryer nga askush tjetër përveçse një person kompetent që ka marrë trajnim mjekësor. Ky veprim jomjekësor mund të kryhet nga një mjek për të mbrojtur të burgosurit nga hapja e plagëve që mund të shkaktohen gjatë një kontrolli të kryer nga një ekzaminues i cili nuk ka ndjekur trajnime mjekësore. Mjeku duhet t'ia shpjegojë këtë gjë të burgosurit dhe më pas duhet t'i shpjegojë se për këtë procedure të imponuar nuk zbatohen kushtet normale të konfidencialitetit mjekësor dhe se rezultatet e këtij kontrolli do t'u bëhen të ditura autoriteteve. Nëse një mjek mandatohet sipas mënyrës së rregullt nga autoriteti për të kryer një kontroll intim dhe nëse bie dakord të bëjë një kontroll të kaviteve të trupit të një të burgosuri, atëherë autoriteti duhet njoftuar plotësisht se është e nevojshme që kjo procedurë të kryhet në mënyrë humane. Nëse kontrolli i imtësishëm është absolutisht i nevojshëm, ai nuk duhet të kryhet kurrë nga mjeku që e trajton të burgosurin me qëllim ruajtjen e marrëdhënies pacient-mjek.

Nëse kryhet ky lloj kontrolli, duhet të keni parasysh;

- Kontrolli duhet të kryhet nga të paktën dy punonjës.
- Asnjë i burgosur nuk duhet të zhvishet para të burgosurve të tjerë.
- I burgosuri duhet të heqë të gjitha rrobat.
- Filloni duke kontrolluar së pari rrobat se mos janë fshehur aty sende të ndaluara.
- Kontrolli gojën, këmbët, flokët, pas veshëve, nën sqetullat e të burgosurit etj.
- Kontrolloni me kujdes këmbët dhe krahët, sidomos nëse i burgosuri ka gjymtyrë artificiale (proteza).
- Të burgosurit me fasha dhe me allçi duhet të kontrollohen me kujdes në mënyrë që të sigurohemi se nuk ka sende të ndaluara të fshehura në to.
- Pas kontrollit, i burgosuri duhet të lejohet që të vishet.
- Regjistroni përfundimet e kontrollit.

Kontrolli intim duhet të kryhet kur ekziston një shkak i mundshëm si p.sh.:

Shembuj të shkakut të mundshëm :

1. Një punonjës i shërbimit të burgut kalon pranë një dhome dhe shikon se i burgosuri ulet me nxitim. A ka shkak të mundshëm të kryhet një kontroll intim i të burgosurit? Jo.
2. Një punonjës shërbimi vë re një të burgosur i cili flet sikur ka diçka në gojë, mban krahun të ngjeshur pas trupit ose ecën në mënyrë të pazakontë që të bën të mendosh se ka diçka të fshehur në një nga kavitetet e trupit. A ka shkak të mundshëm? Po.

3. Kontrolli i sigorisë

Kontrollet e sigorisë garantojnë ruajtjen e sigurisë së institucionit në një nivel të lartë. Gjithashtu, ato përcaktojnë nëse të gjitha pajisjet dhe mjetet e sigurisë janë në rregull. Kontrollet e sigurisë kanë të bëjnë me:

Kyçet dhe dyert: kur kontrollohen kyçet dhe dyert duhet:

- a. Të tërhiqni dorezën e derës për t'u siguruar se është e mbyllur.
- b. Të kërkonti për pengesa të mundshme në kyçet dhe sigurohuni që ato funksionojnë.

Hekurat dhe skarat: gjithnjë kontrollojini:

- a. Duke i tërhequr dhe duke bërë një kontroll vizual për të parë nëse janë të sigurt.
- b. Duke tërhequr portat dhe dyert për të parë nëse janë të kyçura dhe të sigurta.
- c. Duke tërhequr dhe shtyrë dyert e kyçura të qelive për të parë nëse janë të siguruara.
- d. Duke përdorur një shufër metalike për ta kaluar në skarat që ndodhen shumë lart për të parë nëse janë të sigurta.

Dritaret dhe rrjetat: gjithnjë kontrolloni: xhamat, rrjetat, kornizat, muret rrethuese dhe dyshtimet për të parë nëse janë dëmtuar apo ngacmuar.

Prizat dhe instalimet elektrike: Kontrolloni për të parë nëse kapakët janë hequr për të fshehur në to sende të ndaluara. Ngacmimi i instalimeve elektrike mund të shkaktojë rrezik zjarri.

Banjat: Kontrolloni të gjitha banjat e punonjësve dhe të burgosurve duke përfshirë lavamanët, dollapët etj. Tualetet, dushet, dyshtimet dhe tavanet për të parë nëse janë dëmtuar apo ngacmuar.

Furnizimet, magazinimin dhe dhomat e pastrimit, kontrollojini për: fshesa të thyera, shtupa, litarë, çarçafë apo batanije të grisura. Të gjithë kontejnerët. Plehrat, kanoçet, kutitë etj.

Fusha dhe pajisje të ndryshme. Kontrolloni: pajisjet kundër zjarrit, tryeza, karrige; shkallët, çdo gjë që mund të përdoret për të hipur sipër, nuk duhet të lihet pa mbikëqyrur.

4. Kontrolle rutinë

Kontrollet në ambientet e punishteve duhet të kryhen çdo ditë. Gjatë kërkimeve, të burgosurit duhet të largohen nga ambientet e punishteve. Pala që kryen kontrollin, duhet të kërkojë për sende të ndaluara që mund të jenë fshehur, pajisje të dëmtuara në ambientet e punishteve.

5. Kontrollet e befasishme

Edhe këto njihen si kontrole të posaçme. Kur një punonjës ka arsye të besojë se një i burgosur ka fshehur në trupin e tij apo në dhomën e tij sende të ndaluara, ai mund të kryejë menjëherë një kontroll të befasishëm. Nëse kontrolli po kryhet në zonën e banimit, të gjithë të burgosurit duhet të largohen dhe pastaj të kryhet kontrolli. Pas kësaj, në bazë të vlerësimit të riskut mund të kryhet një kontroll intim ose një kontroll me prekje të lehta e të shpejta i të burgosurve. Kur kontrolli kryhet në dhomat e fjetjes, gjithnjë sigurohuni që të burgosurit të mos jenë aty dhe të mos e shohin se në cilat vende ju do të kontrolloni apo metodat e kontrollit që përdoren. Së fundmi, mos u hutoni gjatë kontrollit.

5. Çfarë duhet pasur parasysh gjatë kontrollit? (15 minuta)

Në varësi të llojit të kontrollit që do të kryhet, duhet të përcaktohet një grup për të kryer kontrollet dhe nëse disponohen, të zgjidhen pajisje të përshtatshme kontrolli. Për të kryer kontrollin duhet të kini parasysh:

- *Të jeni të qëndrueshëm dhe të kontrolloni në bazë të një plani.* Kjo do të thotë se grupi që bën kontrollin duhet të nisë punën në një pikë të dhomave të fjetjes dhe të vazhdojë punën për të mbërritur në drejtimin e kundërt. Nëse është kontroll me të prekur lehtë, duhet të kryhet në drejtimin nga lart-poshtë duke filluar nga koka.
- *Mos u hutoni.* Të burgosurit do të shfrytëzojnë çdo mundësi për të hutuar punonjësën në mënyrë që ta pengojnë atë të kryejë një kontroll të plotë. Për këtë arsye duhet të mbahen jashtë zonës që po kontrollohet.
- *Kontrolloni të gjithë hekurat, kyçet, skarat dhe dritaret.* Të gjitha aparatet dhe sendet e tjera. Kërkoni për shenja të keqpërdorimit ose të ngacmimit.
- *Kontrollet duhet të zhvillohen në intervale të rregullta.* Të burgosurit nuk duhet të jenë në gjendje të parashikojnë se kur mund të zhvillohet kontrolli.
- *Tregoni kujdes të veçantë ndaj vendeve që mund të përdoren për të fshehur sende.* Lavamanë, WC, dushe, radio, TV, dyshekë etj., kur kryeni një kontroll me prekje nga lart-poshtë, kini kujdes dhe shihni pas veshëve, brenda në gojë, dhe gjymtyrët artificiale apo protezat në rast se i burgosuri përdor të tilla.
- *Regjistroni kontrollin.* Të gjitha kontrollet e kryera në institucion duhet të regjistrohen. Një regjistër për kontrollet duhet të mbahet për të reflektuar se çfarë kontrolli është bërë dhe çfarë rezultati ka pasur.
- *Eliminimi i sendeve të ndaluara.* Çdo gjë e gjetur gjatë kontrollit duhet të mbahet në vend të sigurt për t'u përdorur si provë nëse ndaj të burgosurit apo punonjësit do të merren masa disiplinore. Pas kësaj, sendet e gjetura duhet të eliminohen në mënyrën e duhur.

6. Pajisjet e kontrollit (15 minuta)

Përdorimi i pajisjeve të kontrollit është me rëndësi për realizimin e kontrolleve, pasi ndihmon që kontrollet të jenë më tërësore. Kohët e fundit në procedurat e kontrollit po përdoren produkte të ndryshme të teknologjisë së hapësirës. Më të zakonshmet mund të përfshijnë:

1. **Dorezat:** Ato gjenden lehtësisht dhe duhet të përdoren sa herë të jetë e nevojshme. Ato garantojnë sigurinë, si të burgosurve, ashtu edhe të punonjësve.
2. **Pasqyrat:** Nevojiten për të kontrolluar automjetet nga poshtë, vende të fshehura, WC etj.
3. **Detektorët e metaleve:** Dy detektorët e metaleve që përdoren me shpesh, janë:
 - 3.1 **Urat nën të cilat ecet.** Këto janë të ngjashme me ato që përdoren për kontrollet e sigurisë nëpër aeroporte ku njerëzit ecin përmes një fushe magnetike e cila mund të identifikojë objektet metalike.
 - 3.2 **Portabël.** Njësi që mund të mbahet në dorë dhe kryen të njëjtin funksion, por ndryshimi qëndron se është më i vogël dhe lëvizet fizikisht rreth e rrotull individit.

Monitorët TV:

Monitorët TV bëjnë që të burgosurit dhe punonjësit të mund të vëzhgohen nga afër dhe, nëse është e nevojshme, edhe të bëhen regjistrime filmike. Ata përdoren shpesh për të vëzhguar veprimtaritë dhe lëvizjet në korridore ose qeli dhe për të mbajtur nën vëzhgim punonjës të paarmatosur që punojnë së bashku me të burgosurit ose për të vëzhguar të burgosur në izolim. Një punonjës mund të mbajë nën vëzhgim një krah të tërë ose të gjithë bllokun edhe krejt i vetëm.

Duke pasur parasysh natyrën ndërhyrëse të një monitorimi të tillë të vazhdueshëm, është e nevojshme të hartohet një rregullore gjithëpërfshirëse që parashikon, ndër të tjera, bazat mbi të cilat mund të autorizohet mbikëqyrja me video brenda qelisë, procedurën që duhet ndjekur dhe kriteret që do të përdoren; përveç kësaj, autorizimi duhet të lëshohet për raste individuale dhe duhet të jetë objekt rishikimi i vazhdueshëm. Për më tepër, mbikëqyrja me video nuk duhet të ndërhyjë ose të zëvendësojë frekuencën ose cilësinë e kohës gjatë së cilës personeli ndërvepron me të burgosurit. Gjithashtu, është thelbësore që monitorimi i video-kamerave të bëhet nga një sallë e veçantë dhe jo në një vend “publik”, të caktohet staf i trajnuar dhe ngjarjet të regjistrohen në një ditar në intervale të rregullta⁷⁷.

7. Procedurat për të kryer kontrolle (1.5 hrs)

1. Kontrolli i vizitorëve

Duhet të ketë procedura të përcaktuara qartë për t'u siguruar që vizitorët e të burgosurve të mos shkelin rregullat e sigurisë, për shembull, duke sjellë në burg artikuj që nuk lejohen. Procedurat mund të përfshijnë të drejtën e kontrollit trupor të vizitorëve, por duke marrë parasysh që vizitorët nuk janë të burgosur, detyrimi për të ruajtur sigurinë e burgut duhet të jetë i balancuar me të drejtën e vizitorëve për privatësinë e tyre personale.

Procedurat për kontrollin e grave dhe të fëmijëve duhet të adresojnë nevojat e tyre, për shembull, duke u siguruar që një pjesë e mjaftueshme e stafit që kryen kontrollet të jenë femra. Kontrollet trupore nuk duhet të kryhen në publik. Kontrollet intime të vizitorëve mund të çojnë në shkelje të nenit 3 dhe nenit 8 të KEDNJ-së⁷⁸. Paragrafi 23 i Rekomandimit CM/Rec (2018) 5 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për fëmijët me prindër të burgosur parashikon se: “Kontrollet e sigurisë duhet të kryhen në një mënyrë të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke respektuar dinjitetin dhe privatësinë e fëmijëve, si edhe të drejtën e tyre për integritet, siguri fizike dhe psikologjike. Ndalohet çdo kontroll intim i fëmijëve, duke përfshirë kontrollet e kaviteteve trupore”.⁷⁹

Mund të jetë e nevojshme të kontrollohen vizitorët profesionistë, të tillë si përfaqësuesit ligjorë, punonjësit socialë dhe mjekët, duke u kujdesur që të mos cenohet e drejta e aksesit konfidencial profesional, pra miratimi i një protokollit për kontrollin me pajisjet e duhura profesionale⁸⁰.

77 Raporti i vizitës i KPT 2006 në Maqedoninë e Veriut, paragrafi 109.

78 *Waineright kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 12350/04, gjykimi i 26/09/2006.

79 Koment për Rregullat e rishikuara Evropiane të Burgjeve: <https://rm.coe.int/pc-cp-2018-15-e-rev-3-epr-2006-with-changes-and-commentary-08-10-18/16808e4ac1>

80 Po aty

- Nëse ka arsye të besoni se një vizitor mund të ketë sende të ndaluara, mund t'u kërkonti atyre të dalin mënjane në mënyrë që t'i nënshtrohen kontrollit. Nëse janë në automjet, atëherë u kërkonti të hapin automjetin i cili do t'i nënshtrohet kontrollit, gjithashtu.
- Vizitorët mund t'i nënshtrohen kontrollit me prekje të lehta nga lart-poshtë ose kontrollit intim, nëse ka arsye të besohet se vizitori mund të ketë fshehur sende të rrezikshme poshtë rrobave.
- Asnjëherë nuk duhet të kryhet kontroll ndaj personave me gjini të kundërt. Kjo do të përbente incident dhe shkelje të rregullave dhe standardeve minimale.
- Kontrollat nuk duhet të kryhen me forcë. Thjesht i thoni atij si janë rregullat dhe se për këtë arsye ai nuk mund të hyjë në burg.
- Në rast se një vizitor nuk pranon t'i nënshtrohet kontrollit, ai ose ajo nuk do të lejohen të hyjnë në institucion.
- E drejta e takimeve/vizitave mund të pezullohet për vizitorin.
- Vizitorëve mund t'u kërkohej të lënë jashtë disa sende të caktuara kur hyjnë në takim me të burgosurit, p.sh.: celular, para, armë të ndryshme etj.
- Duke pasur parasysh ndikimin që vizitorët mund të kenë në mbajtjen e marrëdhënieve të burgosurve me familjen dhe miqtë e tyre, autoritetet mund të rishikojnë qasjen e tyre ndaj kontroll të imtësishëm të vizitorëve të burgosurve. Në vend që të detyrohen të largohen pa takuar të burgosurin, nëse ata refuzojnë t'i nënshtrohen një kontrolli të tillë, vizitorëve për të cilët ka shqetësime serioze sigurie bazuar në informacione specifike mund t'u sigurohet një vizitë e tipit të mbyllur dhe/ose një vizitë e mbikëqyrur⁸¹.

2. Kontrolli i punonjësve

Nëse një punonjës dyshohet se sjell sende të ndaluara, ai/ajo mund t'i nënshtrohet një kontrolli me prekje nga lart-poshtë ose një kontrolli intim. Për disa punonjës mund të dihet se bashkëpunojnë me të burgosurit; ata duhet të kontrollohen kurdo që dyshohet se kanë me vete sende të ndaluara.

- Nuk duhet të kontrollohen persona të gjinisë së kundërt, edhe pse mund të jenë punonjës.
- Nuk duhet të kryhen kontrole me forcë. Askush nga personeli nuk duhet t'i nënshtrohet kontrollit me forcë. Nëse nuk pranon të kontrollohet, duhet të merren masa të tjera për të zgjidhur situatën.
- Mospranimi për t'u kontrolluar duhet të rezultojë në masa disiplinore ose moslejimin për të hyrë në burg.

3. Eliminimi i sendeve të ndaluara

Çdo gjë e gjetur gjatë kontrollit duhet të trajtohet sipas rregullave dhe normave të institucionit. Praktika e përgjithshme është si më poshtë:

1. Një i burgosur të cilit i kapen sende kontrabandë/ të ndaluara, duhet t'u nënshtrohet masave disiplinore.
2. Kur sende kontrabandë i gjenden një vizitori, ato duhet të konfiskohen dhe në varësi të llojit të sendeve të ndaluara: armë zjarri, drogë etj., mund të merren këto masa:

81 The CPT 2013 visit report to Poland, paragraph 106.

- Vizitori mund të ndalohet dhe çështja t'i bëhet e ditur policisë.
- Vizitorit mund të mos i lejohet të takojë të burgosurin.
- Të burgosurit mund t'i mohohet e drejta për të pasur takime⁸².

Punonjësit të cilëve u gjenden sende kontrabandë/të ndaluara duhet t'i nënshtrohen masave disiplinore sipas rregullave dhe normave të përcaktuara. Ata mund edhe të mos lejohen të hyjnë në burg.

Të gjitha sendet e ndaluara që gjenden, duhet të eliminohen sipas udhëzimeve të drejtuesit. Në varësi të llojit të tyre kjo mund të bëhet duke i:

- Djegur,
- Groposur,
- Dorëzuar tek autoritetet përkatëse,
- Hedhur në WC,
- Flakur tutje etj.

Gjithnjë regjistroni masat e marra për eliminimin e sendeve kontrabandë.

Kur kontrollet kryhen duke ndjekur procedurat e duhura, ka mundësi që siguria e institucionit të mos cenohet dhe kështu si të burgosurit dhe punonjësit do të jenë të sigurt.

4. Kontrollet me prekje të lehta

Kontrolli fizik me prekje të lehta është lloji më i zakonshëm që përdoret normalisht për këdo nga këto grupe:

- personelin,
- vizitorët që hyjnë në burg,
- të burgosurit gjatë kontrolleve rutinë

Kontrollet me prekje të lehta kryhen për secilin nga grupet e lartpërmendura. Qëllimi i kontrolleve është të diktohet futja e kontrabandës në burg si dhe kapja e kontrabandës që tanimë e ka çarë rrugën brenda burgut. Kontrolli fizik i të burgosurve është pjesë e rutinës ditore në burg.

1. Kontrolli fizik me prekje të lehta të të burgosurit kryhet:

- sa herë dalin apo hyjnë brenda burgut, kur ata punojnë jashtë burgut;
- sa herë kthehen në burg nga gjykata, spitalet etj.;
- sa here që ka arsye për të besuar se po fusin kontrabandë.

2. Kontrolli fizik me prekje të lehta të vizitorët kryhet kur ata:

- futen në burg për të takuar një të burgosur,
- janë kontraktorë që sjellin artikuj për konsum në burg,
- vijjnë për të takuar një anëtar të personelit.

82 The CPT recommends that steps be taken to ensure that disciplinary punishment of prisoners does not include a total prohibition of family contacts and that any restrictions on family contacts as a form of punishment should be used only where the offence relates to such contacts. The CPT 2009 visit to Hungary, para. 113.

3. Kontrolli fizik me prekje të lehta te punonjësit mund të kryhet kur:

- marrin turnin,
- largohen nga burgu në përfundim të turnit,
- kthejnë të burgosurit në burg pas largimit të përkohshëm.

Gjatë kryerjes së kontrollit me prekje të lehta, punonjësit duhet të respektojnë sa më poshtë:

- Të informojnë të burgosurit, anëtarët e personelit apo vizitorët se do të kontrollohen pas pak. Nëse ka arsye për të besuar se një i burgosur i caktuar, anëtar personeli apo vizitor mban me vete artikuj të ndaluar, atëherë ata duhen njoftuar për qëllimin e kontrollit që do të kryhet.
- Kontrolli duhet të kryhet nga anëtarë personeli të së njëjtës gjini me atë të personit që po kontrollohet.
- As vizitorët, as personeli nuk do të kontrollohen me forcë. Nëse ata refuzojnë t'i nënshtrohen kontrollit, atëherë duhen marrë masat e duhura, p.sh., moslejimi i hyrjes në mjediset e burgut, njoftimi i policisë, nëse është e nevojshme.
- T'u kërkojnë të burgosurve, anëtarëve të personelit apo vizitorëve të nxjerrin të gjithë artikujt që mund të kenë me vete dhe t'i grumbullojnë në një vend. Oficeri kontrollon me kujdes të gjithë artikujt. Kjo duhet bërë në mënyrë të rregullt, sidomos në rastin e anëtarëve të personelit dhe vizitorëve.
- T'i kërkojë personit t'i kalojë duart nëpër flokë.
- Të kontrollojë personin me kujdes dhe me prekje të lehta nga lart-poshtë, duke filluar nga shpatullat, poshtë kraharorit, në të dyja anët e trupit, duke zbritur te këmbët, e gjitha kjo e kryer në mënyrë korrekte, pa i mbajtur duart gjatë në një pjesë trupi, pa qenë nevoja.
- T'u kërkojnë të burgosurve të kthehen me fytyrë nga muri dhe të mbështeten pas tij me këmbët e hapura dhe, më pas, përsëritin procesin.
- T'u kushtojnë vëmendje të veçantë veshjeve me xhepa, pjesës nën jaka, rripave në kyçe, kapakëve të mëngëve, këpucëve dhe takave, vende këto ku fshihen zakonisht artikuj të ndryshëm.
- Të kontrollojnë shojet e këmbëve një e nga një.
- Të kontrollojnë artikujt që personat mund të kenë me vete dhe t'ua kthejnë ato nëse nuk gjendet kontrabandë.
- Të regjistrojnë kontrollin e kryer dhe atë çfarë kanë gjetur në regjistrin e kontrollit.
- Të shkatërrojnë kontrabandën sipas rekomandimeve apo udhëzimeve të dhëna nga kryeinspektori përgjegjës.

Kontrollet e me prekje të lehta mund të kryhen për të kapur kontrabandën apo sendet e humbura, por asnjëherë si një mënyrë ndëshkimi apo ngacmimi. Këto kontrolle duhen kryer në mënyrë profesionale nga anëtarë personeli të së njëjtës gjini me personin që po i nënshtrohet kontrollit dhe në praninë e të paktën dy oficerëve.

5. Kontrolli i dhomës

Kryerja e kontrollit në mjediset e banimit të burgosurve është tepër jetësore për ruajtjen e sigurisë. Ato duhen kryer duke pasur në mend tri parimet e kontrollit.

Dhomat mund të përdoren për të fshehur kontrabandë dhe, nëse kontrolli nuk kryhet me imtësi, atëherë mund të ndodhin arratisje nga burgu.

Të burgosurit mund të vendosen ose në dhomë teke ose në kabanon, që do të thotë se në këtë vend ata shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës jashtë orarit të punës, argëtimit apo jashtë burgut. Prandaj kjo nënkupton që në këto mjedise shpenzohet koha e lirë. Nga ana tjetër, vetë të burgosurit janë të prirur të merren me aktivitete që shkojnë kundër rregullave dhe rregulloreve të institucionit. Kjo kohë e pazënë është moment i përshtatshëm për ta për të studiuar me kujdes dhomën dhe për të kërkuar vende apo pika të dobëta që mund të përdoren për të krijuar një mundësi arratie. Dhoma, po kështu, mbetet një vend i përshtatshëm për të fshehur kontrabandën. Gjithë artikujt kontrabandë që nuk diktohen në portat e hyrjes së burgut përfundojnë nëpër dhomat e banimit. Duke mbajtur këtë në mendje, kontrolli i dhomave duhet të bëhet tepër imtësisht.

Punonjësit e burgut mund ta kontrollojë dhomën e banimit pa paralajmërim, në mënyrë të rastësishme dhe pa ndonjë orar të përcaktuar. Çdo burg ka procedurat e veta për kryerjen e kontroleve, të cilat duhet të parashikojnë edhe numrin minimal të kontrollit të qelive në muaj.

Qëllimi kryesor i kontrollimit të një qelie është:

- Të zbulohet kontrabandë e rrezikshme ose jo.
- Të parandalohen arratisjet duke mbyllur çfarëdo të çarë që mund të kenë krijuar të burgosurit.
- Të ruhen standardet e higjienës duke u siguruar se qelitë nuk janë kthyer në kosha mbeturinash dhe artikujsh të papastër.
- Të eliminohen rreziqet ndaj sigurisë. Gjatë kontrollit të qelive duhen konstatuar problemet me lidhjet elektrike që mund të jenë të rrezikshme. Për riparimin e tyre duhen marrë masa të menjëhershme.

Gjatë kryerjes së kontrollit në një dhomë duhen ndjekur plotësisht tre parimet e kontrollit. Çfarëdo gjëje që mund të shkasë gjatë kontrollimit të një qelie krijon një të çarë në murin e sigurisë dhe mund të sjellë pasoja të skajshme. Prandaj, ngaherë duhet:

- **Të siguroheni që kontrolli i dhomës të mos bëhet në praninë e të burgosurit.** Të burgosurve duhet t'u kërkohej të largohen nga dhoma përpara kryerjes së kontrollit. Mos harroni se ata nuk duhet ta marrin vesh mënyrën dhe metodologjinë e përdorur për të kryer kontrollin.
- **Vendosni se nga do ta filloni kontrollin për të vazhduar në drejtim të daljes.** Ekipi i kontrollit duhet të organizohet në mënyrë të tillë që kontrolli të fillohet nga pika të ndryshme dhe të mbarojë në një pikë të përbashkët.
- **Kontrolloni dyert dhe bravat për t'u siguruar se nuk janë dëmtuar.**
- Tërhiqni menteshat e dymëve për të parë nëse janë dëmtuar.
- Kontrolloni bravat për të parë nëse janë forcuar.
- **Kontrolloni shufrat e hekurave dhe rrjetat** dhe, nëse ndodhen shumë lart, përdorni një shufër metali për të goditur mbi to për t'u siguruar se nuk janë dëmtuar. Dihet që shumë të burgosur i kanë prerë rrjetat pak e nga pak duke pritur me durim ditën e arratisë.
- **Kontrolloni plasaritjet në mur, pasi ato krijojnë xhepa për të fshehur**

sende. Të burgosurit zgjerojnë ose hapin vrima në mur me qëllim që të fshehin kontrabandë në vrimat ekzistuese.

- Me kalimin e kohës, të thellojnë plasaritjet për të dobësuar murin.
- **Gjithmonë shikojeni me sy përpara se ta prekni me dorë,** pasi dihet që të burgosurit fshehin tehe, gjilpëra dhe objekte të tjera brenda dyshekëve, rrugicave, apo në buzët e çarçafëve të batanijeve. Kontrollonini me kujdes shtretërit.
- Të burgosurit kontrollonini me prekje të lehta nga lart-poshtë dhe kontrolloni me imtësi edhe sendet e tyre. Sendet e të burgosurit kontrollonini gjithmonë në praninë e tij/e saj.
- **Regjistrojeni kontrollin dhe shënoni gjithë gjetjet e kontrollit.** Nëse gjatë kontrollit gjeni kontrabandë, dokumentojeni dhe mbajeni kontrabandën në një vend të sigurt për ta përdorur më vonë si provë.

Kur kontrolli i një qelie bëhet me imtësi, objektivizëm dhe sistematikisht, atëherë çfarëdolloj artikulli i paautorizuar që mund të jetë futur në burg, do të zbulohet. Ndryshimi i qëllimshëm i mureve të qelisë, i shufrave të hekurit etj. do të vërehen në kohë për të parandaluar ndonjë arratisje të planifikuar.

6. Kontrolli i mjediseve dhe i mjeteve

Kontrolli i mjediseve dhe i mjeteve është i detyruar në një institucion të vuajtjes së dënimit me qëllim që të ruhet siguria. Kjo është një nga mënyrat për të garantuar se në institucion nuk hyjnë persona apo sende të paautorizuara dhe as dalin. Gjithashtu, ky kontroll garanton sigurinë e territorit.

1. Kontrolli i mjediseve:

Siguria në një institucion të vuajtjes së dënimit varet së tepërmi nga rigoroziteti me të cilin kontrollohet mjedisi përreth. Kontrollohet përqark gardhit rrethues, brenda e përreth zyrave, punishteve, mjediseve të vizitorëve, kuzhinës, fushës së lojërave dhe çfarëdo mjedisi tjetër në institucion.

Qëllimi i kontrollit të mjediseve:

- a. Zbulimi i ndonjë kontrabande që mund të jetë fshehur në afërsi. Të burgosurit e fshehin kontrabandën brenda dhe përreth godinës së burgut. Nëse kontrolli bëhet me imtësi atëherë do të mund të zbulohen sendet e fshehura në shkurre, brenda apo nën kova apo në kuzhina.
- b. Zbulimi i dëmeve që mund t'i jenë shkaktuar masave të sigurisë. Të burgosurit, teksa kërkojnë për një rrugë arratie, zakonisht prishin muret, tavanet, dritaret, rrjetat etj., në mënyrë që të mund të dalin jashtë godinës. Kontrolli duhet të kontrollojë sigurinë e këtyre gjërave.
- c. Zbulimi i ndonjë të çare që mund të përdoret nga të burgosurit për t'u arratisur. Nëse ka të çara që nuk janë vënë re më parë, atëherë ato duhet të identifikohen gjatë kontrolleve.
- d. Zbulimi i dëmeve shkaktuar godinës. Gjatë kontrollit të mjediseve duhet të konstatohen dëmet që mund t'i jenë bërë pronës së institucionit.

Gjatë kryerjes së kontrollit, punonjësit duhet të garantohen gjithmonë se:

- Asnjë nga të burgosurit nuk mbahet brenda mjedisit që po kontrollohet dhe që të burgosurit nuk bëhen dëshmitarë të mënyrave si kryhet kontrolli.

- Në ekip ka personel të mjaftueshëm për të kryer kontrollin; ka mbledhur një grup njerëzish që janë të aftë të kryejnë një kontroll me imtësi dhe sipas standardeve të vendosura.
- Është ndarë mjedisi për ta kontrolluar në parcela dhe se vendi po kontrollohet me breza duke mbuluar gjithë zonën. Është vendosur pika ku do të fillojnë dhe se gjithsecili do ta mbulojë zonën e vet duke u drejtuar për te pika ku u ra dakord.
- Nuk duhet të shpërqendroheni. Të burgosurit e dinë mirë rëndësinë e kontroleve dhe do të përdorin çfarëdolloj mundësie që u krijohet për t'ju shpërqendruar në mënyrë që kontrolli të mos bëhet me aq imtësi.
- Nëse në vendin ku do të bëhet kontrolli ka shkurre ose bar, atëherë duhet të bëhet një raport në mënyrë që ato të priten; shkurret janë një vend ideal për të fshehur artikuj, kështu që pritini dhe më e mira është të mos i lini më të rriten.
- Brenda mjediseve të burgut shkallët të mos lihen jashtë kujdesit të personit që i ka në ngarkim; ato janë mjeti më i shpejtë për të dalë jashtë burgut duke kapërcyer murin. Kurrë mos i lini jashtë kujdesit brenda territorit të burgut.
- Do të kontrollohen të gjitha dhomat e dusheve, lavamanët, banjat, çatitë etj. Këto janë vende ideale për të fshehur kontrabandë. Kontrollojini ato me imtësi.
- Do të kontrollohen koshat e plehrave, të gjithë kontejnerët. Shpesh të burgosurit e fusin kontrabandën brenda koshave të plehrave ose nxjerrin jashtë pronën e institucionit në të njëjtën mënyrë.
- Nëse është e mundur mbani veshur doreza; gjatë kontrollit do të ekspozoheni ndaj papastërtive, kështu që, nëse dispononi, vishni dorashka mbrojtëse.
- Mos i kontrolloni me gishta sipërfaqet mbi apo nën tavolina, krevate etj.; atje mund të jenë fshehur objekte të mprehta. Bëni kujdes.
- Do të regjistroni kontrollin e kryer. Çdo kontroll i kryer duhet të shënohet dhe gjetjet të dokumentohen për referim të mëvonshëm.
- Do të kontrollohen mjediset e pritjes së vizitorëve, si para, ashtu edhe pas vizitave.

2. Kontrolli i automjeteve

Në çdo institucion të vuajtjes së dënimit, është normale që automjetet të hyjnë e të dalin jashtë territorit përditë. Këto mund të jenë automjete që sjellin të burgosurit nga gjykatat, spitalet, puna etj. apo mund të jenë makina që përdoren nga personeli për të ardhur në punë, nga vizitorët, kontraktorët etj. Si masë sigurie, të gjitha këto automjete duhet të kontrollohen teksa hyjnë dhe dalin nga territori i burgut. Nëse këto automjete nuk do të kontrollohen, atëherë mund të pësojmë një ulje të sigurisë. Një anëtar i personelit, sipas mënyrës së parashikuar, mund të kryejë pa paralajmërim një kontroll rutinë të automjeteve brenda territorit të burgut, pa qenë nevoja të dyshojë ndaj një individi të caktuar.

Automjetet mund të përdoren:

1. për të futur kontrabandë nga jashtë brenda burgut;
2. si mjet arratisjeje nga të burgosurit që fshihen brenda tyre;
3. si mjet për të nxjerrë jashtë burgut pronë të vjedhur në institucion, që mund të fshihet në automjet dhe të nxirret me lehtësi nëse nuk pikaset në portat e daljes të burgut.

Gjatë kontrollit të një automjeti mos harroni asnjëherë:

- Ta ndaloni automjetin dhe t'i kërkonti shoferit të dalë jashtë. Të gjitha automjetet që hyjnë brenda burgut, duhet të kontrollohen pasi shoferi të identifikohet dhe të shpjegojë arsyen e vizitës.
- T'i kërkonti shoferit të hapë automjetin. Pas identifikimit, shoferi duhet ta hapë automjetin për ta lejuar oficerin e hyrjes që ta inspektojë atë.
- Ta kontrolloni automjetin brenda me imtësi, si portbagazhin, ashtu poshtë automjetit. Sigurohuni që i keni kontrolluar të gjitha vendet e mundshme që përdoren për të fshehur kontrabandën.
- Të shihni brenda tyre, nëse makina transporton sende të mëdha, për të parandaluar daljen e fshehtë të burgosurve. Ka pasur raste kur të burgosurit janë fshehur brenda gjithfarëlloj objektsh që mund t'i nxitnin duke udhëtuar kështu me katër rrota drejt lirisë.
- Të kontrolloni sendet që futen brenda në burg për t'u siguruar se nuk po futet kontrabandë.
- Të kryeni edhe një kontroll me prekje të lehta nga lart-poshtë, nëse dyshoni se pasagjerët e një automjeti mbajnë artikuj të paautorizuar. Nëse ata refuzojnë të kontrollohen, atëherë u duhet refuzuar hyrja në burg.
- Të regjistroni kontrollin e bërë si dhe gjetjet, nëse ka të tilla.

Kontrolli i mjedisve dhe automjeteve kur kryhet si duhet, është një mënyrë e shkëlqyer për të verifikuar sigurinë në institucion. Mos harroni të zbatoni tri parimet e kontrollit sa herë që kryeni një të tillë.

7. Kontrolli intim

Ekzaminimi/inspektimi i trupit të zhveshur të një të burgosuri, kontrolli për kontrabandë dhe kontrollimi i plotë i veshjeve që individi ka hequr nga trupi, tanimë njihet si kontroll intim.

Gjatë kontrollit intim, punonjësit e burgut duhet të kërkojnë, si për kontrabandë, ashtu edhe për shenja sëmundjeje apo plagosjeje. Kontrollat intime duhen kryer në vendet më të sigurta dhe private që disponohen. Punonjësit duhet të bëjnë përpjekje për t'i veçuar nga të tjerët të burgosurit që po kontrollohen, në mënyrë që të minimizohen situatat e sikletshme. Kur është e mundur, gjatë kontrollit intim duhet të jenë të pranishëm dy apo më shumë anëtarë personeli. Kontrolli intim mund të kryhet kur del si i domosdoshëm, në këto raste:

1. **Para dhe pas çdo vizite:** institucioni duhet të ketë standardin e kontrollimit të vendit të pritjes para dhe pas çdo vizite.
2. **Gjatë pranimi në burg:** kur i burgosuri sapa pranohet në burg, atëherë duhet t'i nënshtrohet një kontrolli intim për t'u siguruar se nuk ka sjellë me vete artikuj të palejuar. Gjithashtu, qëllimi i këtij kontrolli është që të shihet për shenja apo plagë që i burgosuri mund të ketë në momentin e pranimi. Në këtë mënyrë, i burgosuri mund të dërgohet për mjekim dhe personeli i burgut nuk mund të fajësohet për neglizhencë apo torturim të burgosurit.
3. **Kur një i burgosur kthehet nga puna jashtë burgut, nga spitali, gjykata etj.,** pasi koha jashtë burgut është një mënyrë ideale për të burgosurit të sjellin artikuj të palejuar. Të burgosurit duhen kontrolluar ngaherë te porta e hyrjes përpara se të lejohen brenda.

4. Kur ka arsye për të besuar se i burgosuri ka me vete artikuj të ndaluar: sa herë që dyshoni se një i burgosur mund të ketë me vete kontrabandë, siguroni konfiskimin ose konfirmoni se i burgosuri nuk po fsheh gjë.

Mbyllja

MATERIALE

MODEL- REGJISTRI I KONTROLLEVE

Data	Ora	Pozicioni punonjësit	Emri	Lloji i kontrollit	Sendet e gjetura	Veprim i kryer	Firma
1.2.09	0745	Spec.sig	John	Me prekje nga lart - poshtë	Teh brisku Para	U morën	jkh

Sa herë që të kryeni një kontroll intim, kjo detyrë duhet bërë në mënyrë profesionale duke mbajtur qëndrimin e duhur. Ja se çfarë duhet të respektoni gjatë këtij lloji kontrolli:

- **Kontrolli duhet të kryhet nga të paktën dy oficerë.** Në këtë mënyrë nuk do të mund t'ju akuzojnë dot për veprime të pahijshme apo se keni viktimizuar të burgosurin gjatë kësaj procedure.
- **Asnjë të burgosuri nuk duhet t'i kërkohet të zhvishet përpara një tjetri.** Mos harroni asnjëherë se gjatë këtyre kontrolleve duhet ruajtur dinjiteti i të burgosurit. Mos e vendosni të burgosurin në pozita të vështira duke i kërkuar të zhvishet përpara të tjerëve.
- **Kontrollet duhet të kryhen gjithmonë nga personel i së njëjtës gjini me personin që po i nënshtrohet kontrollit.** Ky është një kriter ndërkombëtar dhe, nga ana tjetër, rrit humanizmin dhe mirësjelljen.
- **Të burgosurit duhet t'i kërkohet t'i heqë të gjitha veshjet.** Kurrë mos e zhvishni të burgosurin, lëreni ta bëjë vetë këtë gjë.
- **Filloni duke inspektuar veshjet e tij për të parë nëse në to është fshehur kontrabandë.** Kontrolloni me kujdes nëpër rrobat e tij dhe sendet personale që mund të ketë.
- **Kontrolloni gojën, këmbët, flokët, pas veshëve, nën sqetulla etj.** Kërkojini të burgosurit të hapë gojën, të shtrijë gishtërinjtë e dorës, të kalojë dorën nëpër flokë, kontrollojini veshët, nën sqetulla, shputat e këmbëve etj.
- **Ekzaminoni me kujdes këmbët dhe krahët, veçanërisht nëse i burgosuri mban proteza te gjymtyrët.** Nëse këto të fundit nuk inspektohen si duhet, atëherë mund të kthehen në transportues të kontrabandës. Gjithsesi, kjo gjë duhet bërë me kujdes për të mos e dëmtuar më shumë të burgosurin.
- **Të burgosurit që kanë pjesë trupi të lidhura me fashë apo në allçi duhet të kontrollohen me kujdes për t'u siguruar se nuk fshehin gjë nën to.**
- **Kontrolli i kaviteteve të brendshme të trupit duhet kryer vetëm nga personeli mjekësor.** Kurrë mos u përpiqni ta kryeni vetë kontrollin e brendshëm intim të një i burgosur.
- **Pasi ta keni përfunduar kontrollin, kërkojini të burgosurit të vishet.**
- Regjistroni kryerjen e kontrollit dhe gjetjet.
- Mos harroni asnjëherë të lani duart pas çdo kontrolli.

Nëse kryhet në mënyrën e duhur, sikundër u shpjegua më lart, kontrolli intim mund të realizohet plotësisht. Mos harroni asnjëherë se kontrollimi i kontrabandës që futet në burg, ka rëndësi tepër të madhe për sigurinë tuaj dhe atë të burgosurve.

Protokollet që mbahen gjatë kontrollit

Kontrolli i shpejtë i trupit – listë kontrolli

Hapi	Kontrolli	Vëzhguesi	Kryer ose jo	Komente
1	Kontrollimi i mjedisit ku kryhet kontrolli fizik			
2	Shkelësi i ligjit heq të gjitha veshjet e stinës, d.m.th.: shallin, kapelën, gëzofin apo kapuçin etj.			
3	Shkelësi i ligjit heq bizhuteritë, syzet dhe aparatet ndihmëse për dëgjimin			
4	Shkelësi i ligjit boshatis xhepat			
5	Sendet e tij kontrollohen nga kontrollori			
6	Shkelësi i ligjit tregon pjesën prapa veshit			
7	Shkelësi i ligjit shtrin gishtat dhe hap duart			
8	Shkelësi i ligjit vendoset në pozicionin e kontrollit – këmbët e hapura në gjerësinë e shpatullave, të dy krahët sipër kokës dhe të shtrira plotësisht lart apo trupi në një kënd 30 për qind dhe duart mbi mur, oficeri kontrollon trupin para e prapa duke e prekur shkurt të burgosurin dhe jo duke i rrëshqitur duart nëpër trup			
9	Jakat			
10	Krahët nga jashtë e brenda (përfshirë sqetullat)			
11	Kontrollim i kraharorit dhe barkut			
12	Kontrollim i kurrizit			
13	Kontrollim i këmbëve nga poshtë-lart, para e prapa			
14	Kontrollim i zonës gjenitale			
15	Kontrollim i pjesës së rripit të pantallonave apo mesit			
16	Kontrollim i zinxhirit të pantallonave			
17	Kontrollim i të ndenjurrave			
18	Kontrollim i shputave të këmbëve			
19	Për një shkelëse të ligjit (femër) kontrollohet edhe pjesa e gjoksit dhe e reçipetave			

Kontrolli intim - listë kontrolli

Çdo grup duhet të ketë tre vetë, njëri në rolin e shkelësit të ligjit, tjetri në rolin e anëtarit të personelit të burgut dhe i fundit në rolin e vëzhguesit. Vëzhguesi do të monitorojë ushtrimin praktik dhe do të komentojë nëse dy personat e tjerë i ndoqën apo jo të gjithë hapat e përfshirë në këtë listë kontrolli.

Hapi	Kontrolli	Vëzhguesi	Kryer ose jo	Komente
1	Të pranishëm vetëm ekipi i emergjencës prej 2 anëtarësh personeli /			
2	Shkelësi i ligjit heq të gjitha rrobat			
3	Shkelësi i ligjit heq bizhuteritë, syzet dhe aparatet ndihmëse të dëgjimit			
4	Kontrollohen të gjitha rrobat			
5	Kontrollohen sendet			
6	Shihet në gojën dhe hundën e shkelësit të ligjit			
7	Shkelësi i ligjit lëviz gishtat, gojën dhe flokët			
8	Shkelësi i ligjit tregon pjesën pas veshit			
9	Shkelësi i ligjit shtrin gishtërinjtë dhe hap duart			
10	Shkelësi i ligjit vendoset në pozicionin e kontrollit – këmbët e hapura në gjerësinë e shpatullave, të dy krahët sipër kokës dhe të shtrira plotësisht lart apo trupi në një kënd 30 për qind dhe duart mbi mur.			
11	Jakat			
12	Krahët nga jashtë e brenda (përfshirë sqetullat)			
13	Kontrollim i krahërorit dhe barkut			
14	Kontrollim i kurrizit			
15	Kontrollim i këmbëve nga poshtë lart, para e prapa			
16	Kontrollim i zonës gjenitale			
17	Kontrollim i pjesës së rripit të pantallonave apo mesit			
18	Kontrollim i zinxhirit të pantallonave			
19	Kontrollim i të ndenjurrave			
20	Kontrollim i shputave të këmbëve (pasi të jenë hequr këpucët)			
21	Për një shkelëse të ligjit (femër) kontrollohet edhe pjesa e gjoksit dhe e reçipetave			

Kontrolli i mjedisit - listë kontrolli

Çdo grup duhet të ketë tre vetë, njëri në rolin e shkelësit të ligjit, tjetri në rolin e anëtarit të personelit të burgut dhe i fundit në rolin e vëzhguesit. Vëzhguesi do të monitorojë ushtrimin praktik dhe do të komentojë nëse dy personat e tjerë i ndoqën apo jo të gjitha hapat e përfshirë në këtë listë kontrolli.

Hapi	Kontrolli	Vëzhguesi	Kryer ose jo	Komente
1	Nëse është e mundur, gjatë kontrollit duhet të jenë të pranishëm dy anëtarë personeli			
2	Informohuni nëse duhet të kërkonti për ndonjë gjë specifike			
3	Plani është bërë paraprakisht së bashku me një anëtar tjetër të personelit			
4	Kontrolloni zonën në mënyrë sistematike; nga e majta në të djathtë apo nga e djathta në të majtë, nga lart-poshtë apo nga poshtë-lart.			
5	Përdorni mjetet e duhura për kryerjen e kontrollit			
6	Në fund të kontrollit vendi duhet të jetë po aq i rregullt dhe i pastër sa më parë			
7	Kontrabanda e gjetur konfiskohet dhe etiketohet si duhet (me etiketën e kontrabandës)			
8	Në fund përpilohen raportet përkatëse			

Kontrolli i shpejtë i trupit - listë kontrolli

Çdo grup duhet të ketë tre vetë, njëri në rolin e shkelësit të ligjit, tjetri në rolin e anëtarit të personelit të burgut dhe i fundit në rolin e vëzhguesit. Vëzhguesi do të monitorojë ushtrimin praktik dhe do të komentojë nëse dy personat e tjerë i ndoqën apo jo të gjithë hapat e përfshirë në këtë listë kontrolli.

Hapi	Kontrollori	Vëzhguesi	Kryer ose jo	Komente
1	Nëse është e mundur, gjatë kontrollit duhet të jenë të pranishëm dy anëtarë personeli			
2	Informohuni nëse duhet të kërkonti për ndonjë gjë specifike			
3	Plani është bërë paraprakisht së bashku me një anëtar tjetër të personelit			
4	Kontrolloni zonën në mënyrë sistematike; nga e majta në të djathtë apo nga e djathta në të majtë, nga lart-poshtë apo nga poshtë-lart.			
5	Përdorni mjetet e duhura për kryerjen e kontrollit			
6	Në fund të kontrollit vendi duhet të jetë po aq i rregullt dhe i pastër sa më parë			
7	Kontrabanda e gjetur konfiskohet dhe etiketohet si duhet (me etiketën e kontrabandës)			

Model për vlerësimin procedural të aftësive në kontrollet fizike

Vlerësimi i procedurës – kontrollet fizike

Emri i punonjësit (jeni të lutur ta shkruani me shkronja shtypi):

Hyrje

Lexoni të gjitha aftësitë e sigurimit që vijojnë. Vendosni shenjën (✓) nën rubrikat **Po ose Jo** te kolonat që tregojnë nëse oficeri e ka kryer këtë detyrë, ata duhet ta demonstrojnë këtë aftësi dy herë (në ditë të ndryshme) dhe të vlerësohen për të dyja herët.

Kontrollet fizike	Praktika e parë		Praktika e dytë	
	Po	Jo	Po	Jo
1. Njohuri për politikat institucionale dhe/apo urdhrat e vendit të punës				
• Është i aftë t'i referohet dhe të citojë numrat e politikave dhe/apo urdhra të vendit të punës				
• Duket qartë se e kupton kur mund të kryhet një kontroll fizik				
• Duket qartë se e kupton që të gjitha kontrollohet duhen kryer nga një person i së njëjtës gjini				
2. Përgatitet				
• I njeh arsyet për kontrollin				
• Merr pajisjet e duhura, si për shembull një çantë (për kontrabandën)				
• Ka të pranishëm një tjetër oficer si mbështetje				
3. Procedurat	Po	Jo	Po	Jo
• Informon të burgosurin se do t'i nënshtrohet kontrollit				
• E vrojton të burgosurin për të parë nëse shfaq shenja agresiviteti pasi informohet se do të kontrollohet				
• I kërkon të burgosurit të heqë rrobat e tepërta, këpucët, xhaketën, etj.				
• I kërkon të burgosurit të zbrazë të gjithë xhepat e t'i kthejë mbrapsht				
• I thotë të burgosurit të qëndrojnë rreth një metër larg nga muri me fytyrë nga oficeri				
• I kërkon të burgosurit të hapë këmbët dhe të shtrijë krahët anash				
• I kërkon të burgosurit të lëvizë gishtërinjtë dhe i kontrollojnë gojën nëse ka kontrabandë të fshehur aty				
• I kërkon të burgosurit të kthehet prapa dhe t'i vendosë duart mbi mur, me këmbët hapur rreth 1 metër dhe po kaq larg murit				

• E vendos dorën në mesin e kurrizit të burgosurit (për të dalluar çfarëdo lëvizje të menjëhershme)				
4. Kryerja e kontrollit (e plotë dhe sistematike)				
• Kontrollon pjesën e kokës dhe qafës (veshët, flokët dhe gojën nëse nuk e ka bërë më parë)				
• Kontrollon pjesën e sipërme të trupit– kurrizin– shpatullat– krahët– kafazin e kraharorit– para dhe prapa				
• Kontrollon pjesën e poshtme – mesin – të ndenjurat– bashkimin e këmbëve – këmbët – shputat				
• Kontrollon veshjet e tjera dhe sendet vetjake				
• Kontrollon këpucët/ ose sandalet				
• I kthen sendet të burgosurit				
5. Administrimi	Po	Jo	Po	Jo
E dokumenton kontrollin duke e shënuar në regjistrin përkatës dhe shkruan emrat e të gjithë personelit që ka marrë pjesë				
E vendos kontrabandën në një zarf dhe informon menjëherë mbikëqyrësin				
Paraqet tek eprori raporte me shkrim mbi çfarëdo gjëje të pazakontë të gjetur				
Vlerësimi i përgjithshëm	Kalon	Ngel	Kalon	Ngel

Komentet e udhëheqësit dhe nevojat për trajnim të konstatuara gjatë ushtrimit

Firma e udhëheqësit: _____ **Data:** ____/____/____

Komentet e oficerit (fakultative): _____

Firma e oficerit: _____ **Data:** ____/____/____

Me këtë oficeri nuk deklaron se është dakord, por thjesht që gjithë sa më sipër është rishikuar me udhëheqësin e tij)

8. Diskutime

- Përse kryhen kontrollet në institucionet e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit?
- Cilat janë parimet bazë për realizimin e kontrolleve?
- Përse janë të rëndësishme kontrollet në institucione?
- Si futen sendet e ndaluara në institucione?
- Cilat janë llojet e kontrolleve të kryera në institucionet e vuajtjes së dënimit?
- Çfarë bën pjesë në sendet e ndaluara në burg?
- Cilat janë pajisjet për kontroll?

Moduli 6: Përgatitja për situatat e emergjencës (4 orë)

Objektivat: Në fund të modulit, pjesëmarrësit:

- do të jenë në gjendje të shpjegojnë katër fazat e ciklit të incidentit;
- do të kuptojnë shkaqet e trazirave dhe rebelimeve në burg;
- do të jenë në gjendje të dallojnë shenjat e tensionit dhe trazirave në burg;
- do të dinë si të parandalojnë dhe si të përgatiten e t'i përgjigjen emergjencave/incidenteve;
- do të jenë në gjendje të shpjegojnë masat e reagimit në situatat e pengmarrjes;
- do të dinë t'u përgjigjen situatave të zjarrit, katastrofave natyrore, arratisjeve.

1. Hyrje (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Urgjencat janë situata që krijohen dhe që kërkojnë veprim të menjëhershëm. Këto mund të jenë situata që lidhen me të burgosurit, si për shembull: arratisjet, revoltat dhe prishjet e rendit apo dukuritë natyrore, si: tërmetet, përmytjet apo stuhitë shkatërruese.

Institucioni duhet të ketë një plan reagimi ndaj çdonjëres prej situatave emergjente të përmendura më sipër dhe duhet të dijë se çfarë pjese do të luajë për të ndihmuar në përballimin e tyre. Ju duhet të jeni të përgatitur të përballoni situata emergjente edhe sikur të gjendeni në kushtet më të vështira.

Përgatitja për situatat e emergjencës nga stafi i burgut është gjithmonë pjesë e një strategjie më të madhe për **menaxhimin e emergjencave dhe incidenteve në institucion**.

Shënim për trajnerin

Trajneri pyet grupin “Cilët janë komponentët themelorë të menaxhimit të integruar të incidenteve përveç përgatitjes për raste emergjence?”

Shkruan përgjigjet në tabelë. Pasi secili të japë idetë e tij, trajneri përmbledh sa më poshtë vijon:

Kontributi i trajnerit ⁸³

Emergjencat dhe incidentet nuk ndodhin sa hap e mbyll sytë. Ato lidhen me aftësinë tonë për t'u përgjigjur atyre. Menaxhimi i mirë i emergjencave kërkon një **qasje holistike** dhe jo thjesht një “përpjekje të mirë” në momentin kur ndodh emergjenca. Në mbështetje të kësaj, planet e miratuara në nivel kombëtar dhe lokal për menaxhimin e emergjencave përbëjnë **CIKLIN E INCIDENTIT**.

⁸³ Përshtatur nga: **Fuqizimi i menaxhimit të Sistemit Penitenciar Palestinez dhe Rehabilitimit i të Burgosurve në Qendrat e Reformimit dhe Rehabilitimit të administruara nga shteti i Palestinës MODULI I SPECIALIZUAR 3 PËR SIGURINË DHE MANUALI PËR MENAXHIMIN E INCIDENTEVE PËR TRAJNERËT**, Shtator 2013 Zyra Vendore e UNODC, Palestinë.

Cikli i incidentit në menaxhimin e emergjencave dhe incidenteve përfshin katër faza:

- Parandalimi i ndodhjes së incidenteve
- Përgatitja për incidentet e mundshme që mund të ndodhin
- Reagimi ndaj incidenteve kur ndodhin
- Rikuperimi nga incidentet pas rimarrjes së kontrollit

Cikli i incidentit dhe katër komponentët e tij, d.m.th. Parandalimi, Përgatitja, Reagimi dhe Rikuperimi marrin shkurtimin PPRR.

Në shumicën e rasteve ose në shumë prej rasteve, ekzistojnë indikatorë që tregojnë se diçka nuk po shkon mirë dhe që të japin mundësinë përpara se incidenti “të ndodhë”, për të eliminuar potencialin për ndodhjen e tij, si dhe për të reduktuar apo minimizuar nivelin e incidentit.

“Cikli i incidentit” është mënyrë të menduari dhe të vepruari mbi incidentet, që synon reduktimin e gjasave të dëmtimit të njerëzve (stafit dhe të burgosurve), si dhe të llojeve të tjera të dëmtimit dhe humbjeve.

Vlera më e madhe e mënyrës sonë aktuale e të menduarit rreth incidenteve në burgje është pranimi se vetëm përgjigja ndaj incidenteve kur ato ndodhin nuk është qasje e mjaftueshme.

2. Revoltat dhe prishjet e rendit (45 minutes)

Kontributi i trajnerit

Trazirat dhe prishjet e rendit janë emergjenca që ndodhin rregullisht në burgjet e të gjitha vendeve.

Pasojat e trazirave dhe prishjeve të rendit mund të jenë katastrofike sa i përket humbjes së jetëve dhe aseteve. Në rastet kur revoltat marrin përshkallëzim të madh dhe përfshijnë një numër të madh të burgosurish, mund të përdorim termin ndërkombëtar “kryengritje”. Kryengritje konsiderohet kur një numër i konsiderueshëm të burgosurish arrijnë të marrin në kontroll një pjesë të institucionit për një periudhë të konsiderueshme kohe. Prishja e rendit quhet kur ka pak të burgosur të përfshirë dhe ata kanë pak ose aspak kontroll mbi institucionin.

Studimet mbi kryengritjet dhe trazirat kanë nxjerrë në pah një sërë shkaqesh. Shpeshherë, brenda një institucioni ekzistojnë disa prej tyre njëkohësisht.

Shënim për trajnerin

Diskutim i lirë në grup rreth shkaqeve të mundshme të trazirave dhe rebelimeve në burg.

Trajneri kërkon sa më shumë ide që të jetë e mundur nga klasa, shkruan përgjigjet në tabelë dhe më pas përmbledh si më poshtë:

Kontributi i trajnerit

Shkaqet më të zakonshme janë:

- Mostrajtimi i nivelit të lartë të incidenteve mes të burgosurve apo mes të burgosurve dhe personelit. (Siguri e pamjaftueshme e institucionit).
- Moskontrollimi dhe lejimi i sendeve të ndaluara që rrezikojnë jetën, apo që përbëjnë rrezik për arratisje. (Siguri e pamjaftueshme e institucionit).
- Moszbatimi i njëjtë i rregullave dhe i kërkesave. Përdorimi i disa standardeve.
- Komunikim i dobët dhe marrëdhënie jo të mira mes personelit dhe të burgosurve.
- Ndryshime të shpeshta të rregulloret dhe procedurat e punës.
- Programe të pakuptimta dhe shtrëngime të panevojshme.
- Prishja e ekuilibrit midis ruajtjes dhe sigurisë, nga njëra anë, dhe trajtimit dhe respektimit të të drejtave, nga ana tjetër.
- Mosreagim apo reagim i pamjaftueshëm ndaj ankesave, shqetësimeve dhe kërkesave (problematikë me sistemin gjyqësor).
- Kushtet e këqija të jetesës.
- Efektet e mbipopullimit.
- Aktiviteti i bandave.
- Konflikti racor dhe kulturor.
- Korrupsion pasiv apo aktiv nga personeli.
- Diferencime dhe lejim supremacie ndaj disa të burgosurve.
- Kujdes i pamjaftueshëm dhe veprime në kundërshtim me Kodin e Sjelljes nga personeli me familjarët e të dënuarve ose me ata vetë.

Shënim për trajnerin

Kërkojini grupit të japin disa ide rreth shkaqeve të lartpërmendura dhe të përshkruajnë shembujt nga përvoja e tyre vetjake

Kërkojuni atyre të paraqesin praktikat, masat dhe veprimet “e mira”, që sipas tyre, janë të rëndësishme për parandalimin dhe reduktimin e trazirave në burg, duke i shkruar përgjigjet në tabelë.

Më pas, trajneri përmbledh si më poshtë:

Normalisht ka dy situata të zakonshme që janë gjithmonë prezente në incidentet në burgje në mbarë botën:

Mostrajtimi i të burgosurve në mënyrë të drejtë – Trazira e mirënjohur në Burgun HM Strangeways është shembull i një incidenti madhor të shkaktuar nga të burgosurit e trajtuar padrejtësisht.

Abuzimi me të burgosurit – fizik dhe verbal – ndodh si rrjedhojë e mbikqyrjes jo të mirë. Shembulli për këtë mund të gjendet në raportin e burgut Abu Ghraib në Irak. Një shembull nga Australia kur trazirat në burgjet Bathurst dhe Goulburn u konstatuan se ndodhën për shkak të keqtrajtimit sistematik të të burgosurve.

3. Parandalimi, përgatitja dhe reagimi ndaj incidenteve (60 minuta)

Kontributi i trajnerit

Parandalimi i incidenteve

Asnjë burg në botë nuk përjashtohet nga problemet e përmendura – kjo mund të ndodhë në çdo vend.

Parandalimi nënkupton *mostolerimin* e praktikave jo të mira dhe përfshin:

- Konfigurimin e politikës, procedurave dhe praktikave institucionale, konkretisht: 1) politikat dhe procedurat e mira për zbatim nga stafi; 2) trajnimi i punonjësve në përputhje me ato rregulla dhe ndërveprimi me të burgosurit; 3) një sistem mbikqyrjeje për të garantuar respektimin e politikave dhe mosshkeljen e të drejtave të njeriut;
- ofrimi i akomodimit dhe shërbimeve të përshtatshme;
- sigurimi i veprimtarive të rëndësishme, si punësimi, arsimimi, rekreacioni;
- trajtimi i të burgosurve në mënyrë të drejtë;
- informimi i të burgosurve kur ndodhin ndryshime;
- trajtimi i incidenteve të vogla në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme;
- mbledhja dhe shpërndarja e informacionit;
- parashikimi i incidenteve madhore (sistem për paralajmërimin paraprak);
- trajnimi i stafit për dallimin e sinjaleve të paralajmërimit.

Parandalimi i kryengritjeve dhe trazirave përfshin trajtimin e të gjithë të burgosurve në mënyrë të barabartë dhe të paanshme dhe mbajtja hapur e kanaleve të komunikimit me të burgosurit.

Dallimi i sinjaleve të paralajmërimit:

Shenjat e tensionit mes të burgosurve zakonisht paraprijnë trazirat në grup. Si rezultat i kontaktit të ngushtë me të burgosurit, shpesh mund t'i dalloni këto shenja dhe t'i raportoni në mënyrë që të mund të zgjidhen – përpara se të shpërthejë dhuna.

Shenja të zakonshme të tensionit, mes të cilave:

- Rritje apo mungesë e pazakontë e armiqësisë apo debateve mes të burgosurve, apo mes tyre dhe personelit.
- Sherret serioze për nga natyra apo sherret që çojnë në plagosje të rëndë.
- Rritje e ankesave dhe e acarimeve.
- Rritje e incidenteve të pazakonta që janë shprehje e agresionit dhe e dhunës.
- Rritje apo ulje e niveleve të zakonta të zhurmës në një zonë të caktuar.
- Grumbullim i furnizimeve apo ushqimit nga të burgosurit.
- Shmangie e kontaktit me policët e burgut nga të burgosurit.
- Rritje e numrit të kërcënimeve nga të burgosurit kundër policëve të burgut.
- Rritje e numrit të sendeve të ndaluara me rrezikshmëri jete, si armë të ftohta apo të tjera për rezistencë.
- Rritje e numrit të të burgosurve të cilët shënojnë emrin për t'u vizituar nga mjeku.

- Rritje e numrit të të burgosurve që kërkojnë mbikqyrje mbrojtëse.
- Ulje e papritur e pjesëmarrjes në programe, ngjarje dhe aktivitete.
- Konstatimi i rasteve të vendosjes së supremacisë së një apo disa të burgosurve mbi të tjerët.
- Shtimi i ankimeve në rrugë postare apo në rrugë të tjera në instanca më të larta.
- Interesi i komunikimit me të dënuar të burgjeve të tjera ose të seksioneve të të njëjtit burg, ku mund të ketë probleme për mbështetje apo solidaritet.
- Një rast i publikuar në media dhe shtyp dhe reagimi i të burgosurve mund të shërbejnë si sinjal.

Ju duhet t'i raportoni menjëherë ndryshimet në sjelljen e të burgosurve, mosmarrëveshjet mes tyre apo shenjat e tjera të tensionit. Ndryshimi në sjellje shpeshherë nënkupton se mund të ketë probleme.

Shënim për trajnerin

Diskutoni treguesit dhe sigurohuni që grupi të kuptojë arsyet se pse këto pika mund të shërbejnë si tregues të një problemi potencial.

Kontributi i trajnerit

Nëse jeni në dijeni të sjelljeve përkatëse sinjalizuese të cilat duhet të shikoni, atëherë krijohet mundësia e të pasurit të një “sistemi paralajmërues paraprak” të potencialit të problemeve, si dhe të përgatiteni për atë problem, ose mundësisht, të ndërmerni veprimet e duhura për të garantuar që problemet mos të ndodhin.

Shënim për trajnerin

Ushtrim

Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla duke garantuar përzierjen e ekipeve sa më shumë që të jetë e mundur.

Jepini secilit ekip disa kopje të raporteve në shqip të trazirave të burgjeve Camp Hill dhe në Indonezi (MATERIALI 1,2, 3) dhe kërkojuni atyre të rendisin:

- faktorët që kanë kontribuar në incidente?

- veprimet që mund të ishin ndërmarrë për të parandaluar ndodhjen e incidentit.

Kërkojuni drejtuesve të grupeve të paraqesin rezultatet e ekipit të tyre për të gjithë pjesën tjetër të pjesëmarrësve.

Përgatitja për incidentet e mundshme që mund të ndodhin

Koncepti i gatishmërisë përfshin një sërë masash të hartuara për të siguruar që, nëse ndodh një incident, burimet dhe shërbimet e burgut janë të gatshme të përgjigjen.

- Minimizoni pikat e zakonshme të tensionit - ushqimin, etj.
- Dialog i hapur me të burgosurit e duhur - identifikoni çështjet shqetësuese.
- Identifikoni dhe ndani udhëheqësit e sektorëve.
- Kontrolloni armaturën dhe pajisjet e urgjencës.
- Reduktoni mungesat e stafit kur është e mundur.
- Mbani moralin e stafit.

- Njoftoni agjencitë e tjera.
- Pastroni burgun - zvogëloni ngarkesat e zjarrit dhe pajisjet e zjarrit.
- Trajnim për Reagimin ndaj Emergjencës.
- Kontrolli i pajisjeve.
- Kontrolli institucional dhe kontrolli i kontrabandës.
- Kontrolle sigurie - d.m.th. kontrolle të sektorëve dhe qelive.

Reagimi ndaj incidenteve kur ndodhin

Detyrat e policisë së burgjeve gjatë kryengritjeve, revoltave dhe prishjeve të rendit janë të përshkruara në planet e çdo institucioni për reagimin ndaj emergjencave. Praktikisht ato janë:

- Mospërhapja – parandalimi i përhapjes së kryengritjes apo trazirave; punoni për të qetësuar dhe për të mbajtur të burgosurit në zonën tuaj specifike të punës. Zgjidhja – ndihmoni për t'i dhënë fund kryengritjes apo prishjes së rendit. Kryeni detyrat që ju janë caktuar në ndihmë të atyre që do të reagojnë, sipas asaj që zgjedh përgjegjësi i sigurisë apo drejtori i institucionit (te reagimet renditen: negociatat; demonstrimi i forcës; përdorimi i ujit, tymit apo agjentëve kimikë; përdorimi i forcës; përdorimi i armëve të zjarrit).
- Rivendosja e rendit– ndihmoni ta riktheni institucionin në gjendjen ekzistuese para kryengritjes apo trazirave.
- Identifikimi – ndihmoni në identifikimin e të burgosurve dhe të veprimeve që ata ndërmorën gjatë kryengritjes apo trazirave.

4. Situatat e pengmarrjes (20 minuta)

Reagimit ndaj marrjes peng do t'i kushtojmë një mësim të tërë. Këtu do të diskutojmë vetëm disa nga arsyet përse të burgosurit marrin pengje:

- Për mbrojtje – i përdorin pengjet si “mburoja njerëzore” nga autoritetet të cilat dëshirojnë të rimarrin në kontroll institucionin.
- Si mall për pazar – për t'i këmbyer pengjet me diçka që duan, pra si kusht për të realizuar diçka.
- Rastësisht – ndonjëherë të burgosurit nuk nisen për të marrë pengje, por, aksidentalisht, kthehen në pengmarrës/robërues.
- Për t'i vrarë apo për t'u bërë keq – disa të burgosur që vuajnë nga gjendje të paqëndrueshme shpirtërore apo mendore, mund të marrin pengje për t'u bërë keq; të tjerë ndoshta për t'u bërë keq më vonë në shenjë hakmarrjeje apo shpagimi ose për të shprehur diçka.

Ndonjëherë “elementi i rastësisë” përcakton nëse ka për të pasur një incident pengmarrjeje apo jo. Rastësia, gjithashtu, ka rolin e vet në atë se cili punonjës apo polic burgu do të jetë pengju. Ju mund të ndërmerrni disa masa, gjithsesi, këto vetëm sa do të ndihmojnë në parandalimin e situatave të pengmarrjes në të ardhmen.

Procedura efektive sigurie, të shoqëruara me kontrolle të shpeshta për armë

dhe kontrabandë, mund të ulin shanset e marrjes së pengjeve nga të burgosurit. Gjithashtu, një mbikqyrje e kujdesshme e të burgosurve dhe patrullimi i shpeshtë i seksioneve, i dhomave të banimit dhe i zonave të punës së të burgosurve ul mundësitë e pengmarrjeve.

Masat që mund të përdoren nga një polic që është marrë peng:

- të përpiqet të mos rezistojë fizikisht;
- të përmbushë dëshirat e pengmarrësit;
- të bëjë çfarë i thuhet;
- të duket i qetë;
- të ruajë kontakt me shikim, por të mos duket kërcënues;
- ta dëgjojë pengmarrësin;
- ta lërë pengmarrësin të mendojë;
- të jetë i sjellshëm, të flasë për gjëra pozitive;
- të ndryshojë temën e bisedës, nëse e irriton pengmarrësin;
- të flasë me ngadalë (mund ta qetësojë situatën);
- nëse është e mundur, të flasë me pengjet;
- nëse është e mundur, të mos lejojë mbylljen e syve (në këtë rast do të ishte e vështirë të njohë pengmarrësit);
- të përpiqet të qëndrojë në të njëjtën dhomë ku është edhe pengmarrësi;
- të krijojë një imazh pozitiv;
- të mos tërheqë vëmendjen;
- të mos bëhet figura qendrore e krizës, të lërë pengmarrësin të tregojë veten.

Shënim për trajnerin

Grupi bën diskutim të lirë rreth kërkesave që mund të bëhen objekt negocimi dhe kërkesave që nuk mund të bëhen objekt negocimi. Trajneri përmbledh si më poshtë:

Të mëposhtmet mund të jenë objekt negocimi:

- kontrollet mjekësore;
- takime konkrete;
- ushqimi;
- pijet joalkoolike.

Çështje që nuk mund të diskutohen:

- më shumë pengje;
- lirimi i të burgosurve të tjerë;
- këmbimi i një pengu me një tjetër;
- amnistia.

5. Zjarret, natyra, katastrofat, arratisjet (60 minuta)

Zjarret në një institucion janë tepër të rrezikshme dhe siguria e personelit dhe e të burgosurve ka rëndësi madhore. Temës së zjarreve do t'i kushtojmë një mësim të tërë. Katastrofat natyrore krijojnë probleme, por, normalisht, paraprakisht merret një lloj paralajmërimi. Roli juaj specifik do të jetë shpjeguar në **planin e përballjes së katastrofave si dhe urdhrat e shërbimit**. Edhe sikur i gjithë institucioni të duhet të evakuhet apo të burgosurit të lëvizin në zona të veçanta sigurie, puna juaj mbetet sigurimi i të gjithë atyre që gjenden në këtë situatë duke ruajtur njëkohësisht edhe sigurinë. Sikundër në të gjitha rastet e urgjencave, roli juaj gjatë një arratisjeje apo tentative për t'u arratisur do të trajtohet në urdhrat e shërbimit.

Përmbledhje udhëzimesh si të veproni në situata emergjente:

Zgjidhja e emergjencave synon:

- Izolimin dhe lokalizimin e emergjencës sa më shpejt që të jetë e mundur
- Rivendosjen e rendit sa më shpejt që të jetë e mundur
- Garantimin e sigurisë personale
- Zgjidhjen e incidentit duke përdorur sa më pak forcë
- Parandalimin e arratisjeve
- Përpjekjen për të minimizuar dëmet materiale

Situatat emergjente mund të zgjidhen sipas një metode me **pesë hapa**. Cila është kjo metodë me pesë hapa?

- a. Izolim dhe konfirmim i një situatë urgjente
- b. Lokalizim, izolim dhe menaxhim
- c. Evakuim
- d. Zgjidhje e urgjencave
- e. Veprimet pas përfundimit të urgjencës

Detyrat e policëve të burgut, nëse kuptojnë se mund të zhvillohet një situatë emergjente, janë:

- Të informojnë që situata po përkeqësohet
- Të shpëtojnë jetë dhe të parandalojnë plagosjet
- Të izolojnë vendin e aksidentit
- Të gjejnë dëshmitarët dhe/apo fajtorët
- Të shkruajnë dhe të ruajnë provat
- Të përgatitin përshkrimin e ngjarjes

Situata emergjente janë:

- Pengmarrja
- Arratisja e të burgosurve
- Kryengritjet
- Zjarri
- Katastrofat natyrore

Katastrofat natyrore – janë një lloj urgjence, por jo të gjitha katastrofat natyrore janë të asaj shkalle që mund të quhen situatë emergjence.

Tipari më i rëndësishëm dhe i rrezikshëm i një situatë urgjente është paaftësia e personelit të reagojë njësoj sikundër bënte para incidentit.

Përkufizime

Stresi i situatave urgjente – është një gjendje psikologjike çuditërisht e gjatë, gjendje kjo që mund ta paralizojë policin dhe ta bëjë të ndihet i paaftë të reagojë si duhet në rast incidenti.

Situata të cilat mund të shkaktojnë stres:

- Plagosja e rëndë apo vdekja e një kolegu
- Skena të plagosjes së rëndë apo vdekjes së dikujt tjetër
- Incidente të rrezikshme me kërcënim jete (marrja peng apo dhunë e përdorur kundër tij)
- Kontakt me lëndë toksike apo lëndë kimike të panjohura që mund të çojnë në pasoja afatgjatë fizike apo psikologjike
- Aksidentet
- Vetëvrasja e një kolegu apo të burgosuri
- Një operacion tejet i gjatë në shpëtim të pengjeve
- Vëmendje tejet e madhe mediatike
- Dhunim, pengmarrje apo përdhunim i një kolegu
- Plagosje e rëndë apo humbje e jetës si rezultat i një shkrepte aksidentale të armës

Gjatë marrjes në pyetje të një polici që ka qenë nën stres, duhen ndjekur këto parime:

1. Biseda duhet të jetë absolutisht **konfidenciale**.
2. Në një bisedë të tillë duhet të marrin pjesë të gjithë policët të cilët kanë vuajtur gjatë një situatë urgjente.
3. Askush nuk mund të kritikohet për ndjenjat e përjetuara gjatë një situatë urgjente; policët mund të kenë rastin të shprehin ndjenjat e tyre dhe të gjejnë mbështetje.
4. Biseda as nuk mbahet shënim dhe as regjistrohet.
5. Biseda të tilla nuk mund të përfundojnë derisa të gjithë të kenë thënë atë që dëshirojnë.
6. Bisedat rreth situatës urgjente nuk janë kritika ndaj veprimeve të institucionit. Policët mund të flasin vetëm për ndjenjat dhe reagimet e tyre. Në këtë mënyrë ulin ndikimin e stresit. Të gjitha bisedat janë absolutisht **konfidenciale**.
7. Media nuk mund të informohet rreth përmbajtjes së bisedës. Specialisti i shtypit komunikon me median në bazë të informacionit që merr nga bashkërenduesi i bisedës mbi stresin gjatë situatës urgjente.

Punonjësit profesionistë të cilët kanë përvojë të madhe me situatat e rrezikshme apo delikate, do të mund t'ju thonë se në momentin që shfaqet një krizë, trajnimi që kanë kryer drejton veprimet e tyre. Pothuajse të gjitha mësimet që do të merrni në këtë kurs të trajnimit bazë, së bashku me trajnimet gjatë shërbimit dhe kurset e avancuara, do t'ju përgatitin për t'u përballur me këto urgjenca.

Është me rëndësi që t'i kuptoni drejt, të praktikoheni dhe të përditësoni mësimet mbi komunikimin me të burgosurit, procedurat e sigurisë dhe ato të përgjithshme. Nëse përfshihen në një urgjencë, atëherë ka shumë të ngjarë që të reagoni vetvetiu në mënyrë të menjëhershme. Sa më i trajnuar e sa më shumë praktikë të keni bërë, aq më shumë gjasa ka që të reagoni si duhet e madje të shpëtoni jetë.

6. Diskutim

7. Cilat janë situatat emergjente?
8. Si do të vepronit në se do të jeni marrë peng?
9. Çfarë mund të bëni objekt negociatash me pengmarrësit dhe çfarë nuk duhet të bëni objekt negocimi?
10. Listoni disa detyra të punonjësit të sigurisë në situata emergjente?

Mbyllje

Shtojcë

MATERIALI 1

JORDAN MISJA

Gjatë vitit 1997 dhe 1998 disa herë burgjet e Shqipërisë janë përfshirë në revolta dhe peng marrje. Më poshtë po japim një rast i cili ka ndodhur në Institucionin e Paraburgimit Rr. "Jordan Misja". *Në orët e vona të mesnatës së 1 korrikut 1997 u sulmua personeli i shërbimit të Burgut 313. U morën peng për pesë orë pesë policë. Drejtori i burgut kërkoi bisedime me të dënuarit pengmarrës, por këta të fundit nuk pranuan. Pas kësaj, ndërhyrë forcat e BRISK-ut dhe për 10 minuta, arritën të lirojnë pengjet e të normalizojnë situatën.* Revoltat kanë përfshirë edhe shtete të BE-së, si Greqinë, gjatë vitit 2008, apo shtete të kontinentit Amerikan, si Brazili, sidomos revolta e fuqishme në burgun e San-Paulos ku ishin marrë peng mbi 100 punonjës.

MATERIALI 2

Arratisja në masë pas trazirave në burgun indonezian

Korrik 12, 2013 - 12:06 drekë⁸⁴

Oficerët e policisë që qëndrojnë roje jashtë burgut Tanjung Gusta, të cilit iu vu flaka nga të burgosurit pas shpërthimit të një trazire, në Medan në Sumatrën e Veriut. *Fotografia: Reuters*



Xhakarta: Pesë njerëz u vranë dhe më shumë se 70 të burgosur u arratisën pas një trazire në burg në provincën Sumatra të Veriut në Indonezi.

Të burgosurit thyen qelitë e tyre dhe i vunë zjarrin një dhomë administrative në burgun Tanjung Gusta në kryeqytetin e provincës Medan, ditën e enjte vonë pas një ndërprerje të energjisë elektrike që prishi furnizimin me ujë, tha të premten Zëvendës Ministri i Drejtësisë Denny Indrayana.

“Trazira u ndez nga mungesa u energjisë elektrike dhe e ujit,” tha ai.

Tridhjetë e tetë nga më shumë se 100 të burgosur, të cilët u arratisën u rikapën”: - tha shefi i policisë së Medan-it Nico Afinta për kanalin e lajmeve TVOne. Pesë njerëz, duke përfshirë dy gardianë burgu, u gjetën të vdekur me të djegura të rënda: - tha Afinta.

Më shumë se një duzinë të burgosurish ishin të dënuar për terrorizëm, tha media lokale.

Indrayana tha se burgu ishte i projektuar të mbante 1054 të burgosur, por 2600 njerëz u transferuan atje në kohën e trazirës.

84 <https://www.smh.com.au/world/mass-escape-after-indonesian-prison-riot-20130712-2pudm.html>.

MATERIALI 3

Rikthim tek trazirat e burgut Camp Hill 1989, Pjesa 1⁸⁵

SULMI I NJË OFICERI BURGUT NISI TRAZIRAT E TETORIT, SOT PARA 20 VITESH.

Shih <https://www.pennlive.com/life-and-culture/erry-2018/10/11a5f30a832610/camp-hill-prison-riots-in-1989.html> për linkun e fotografisë

Oficerët e burgut dhe autoritetet lokale u thirrën në qytezën e Allen-it të Poshtëm 20 vjet më parë për një emergjencë në burg. Kurrë mos thuaj kurrë.

Këtë mund ta bëni më mirë.

Mund të rrisni sigurinë e bllokut të qelive.

Mund t'i ndani terrenet e burgut me rrethime dhe porta elektronike, me qëllim që të burgosurve t'u vonohet aksesin në zonat e tjera.

Mund të rrisni sigurinë e perimetrit me teknologji më të avancuar si sensorët e lëvizjes. Dhe mësoni.

Sot, oficerët e burgut thonë se është e vështirë të gjesh një incident tjetër të këtyre përmasave, siç ishin trazirat historike të 25 tetorit të vitit 1989, në Institucionin Shtetëror të Korrektimit në Camp Hill, incident i cili përfundoi me 16 nga 32 ndërtesa të institucionit plotësisht të shkatërruara ose të dëmtuara rëndë nga zjarri.

“Të burgosurit e dinë se gjërat kanë ndryshuar,” tha Inspektori John Palakovich.

Para se atë ditë të shkonte ora 3 e pasdites, Palakovich e më pas asistenti i inspektorit, e përshkruan atë si pasditja e përkryer e tetorit.

“Ishte diell, në vitet ‘70 dhe gjendja përreth burgut ishte mjaft e qetë”: - tha ai.

Megjithatë, brenda orës, dita e përkryer u prish nga trazirat e të burgosurve. Qetësia u zëvendësua nga një valë sirenash policie — që nga Cumberland dhe përreth rajonit — pasi, sipas vlerësimeve, 1200 të burgosur morën kontrollin e burgut shtetëror pasi një i burgosur u sulmua nga oficeri i burgut.

Në atë moment, Palakovich ishte në bodrumin e një blloku qelish me Zëvendësprokurorin e Përgjithshëm të Shtetit, duke punuar mbi një çështje civile për heqjen e azbestit.

“Ata po ktheheshin nga zona e stërvitjes. Ishte një sulm spontan”:- u shpreh ai për fillimin e trazirës që ndodhi në anën veriperëndimore të institucionit përgjatë rrugës së palestrës pranë asaj që atëherë ishte Porta E (tani quhet T9).

Oficerët përmendën një rregull të ri, që u ndalonte familjarëve të të burgosurve t'u sillnin atyre ushqim të gatuar në shtëpi, si një nga faktorët kontribuues të shpërthimit.

Mbipopullimi në sistemin e burgut ishte një tjetër faktor, tha Palakovich, pasi legjislacioni i ri në atë kohë vendosi dënime minimale më të detyrueshme për shkelësit e drogës.

Sipas mbikqyrësit, pati një rritje të numrit të të burgosurve në të gjithë sistemin dhe SCI Camp Hill nuk përbënte përjashtim nga kjo me rreth 2600 të burgosur në një burg të ndërtuar për 1400 të tillë, duke përfshirë shumë të dënuar për afate të gjata.

85 https://cumberlandlink.com/news/local/looking-back-at-the-1989-camp-hill-prison-riots/article_c0e7d68e-93fe-54b6-a2ad-48eb2c26c7fe.html.

Përgjigja e policisë

Kur trazira shpërtheu, Palakovich ishte në anën lindore të institucionit e cila u bllokua, ndërkohë që të burgosurit morën kontrollin e gjysmës tjetër. Departamenti i Korrektimeve njoftoi menjëherë policinë e shtetit për incidentin. Edhe autoritetet e tjera u vendosën në gatishmëri të sigurisë së perimetrit rreth burgut në Rugën Lisburn.

Palakovich tha se kishte ngecur brenda për rreth dy orë gjatë konfuzionit pasi të burgosurit morën çelësat e bllokut të qelive dhe filluan të vënë zjarre në burg.

Më pas, bravat mekanike të blloqeve të qelive u hapën të gjitha me një çelës. Tani çdo gjë kontrollohet elektronikisht në çdo bllok qelie.

Së bashku me qelitë, mes mjediseve të tjera, të burgosurit kishin çelësat e ndërtesës së mirëmbajtjes dhe kuzhinës.

“Stafi ishte bllokuar në zonat e trajnimit dhe të blloqet e qelive dhe u morën peng,” tha Palakovich.

Jashtë portës, më shumë se 350 trupa të policisë së shtetit rrethuan perimetrin, së bashku me departamentet e panumërta të policisë dhe me Zëvendësit e Sherifit nga Qarku Cumberland.

Disa përfaqësues të qarkut u thirrën, duke përfshirë Mick Barrick dhe Ronny Anderson. Kryesoja ishte kthimi i të burgosurve brenda në qeli dhe mbyllja e tyre aty”: - tha Anderson. “Objektivi ishte kthimi i tyre në blloqet e qelive.”

Barrick, i cili hyri në burg atë natë me pajisjet e tij për të ndihmuar shpërndarjen e të burgosurve tha se ishte “vërtetë i frikësuar” rreth asaj se çfarë mund të ndodhte. “Nëse ato të arrinin të na kapnin, e dija se nuk kishte shans të shpëtoja gjallë,” tha ai. Kryesoja ishte kthimi i të burgosurve brenda në qeli dhe mbyllja e tyre aty”: - tha Anderson. “Objektivi ishte kthimi i tyre në blloqet e qelive.”

Ai ishte një nga 200 policët dhe anëtarët e Ekipit të Korrektimit për Reagimin ndaj Emergjencave që u fut brenda.

Ai tha se kishte një armë (shotgun) me rreth 50 predha dhe pistoletën e tij 357 me 15 plumba, por kurrë nuk iu është dashur të përdorte asnjërën.

Shtimi i personave të armatosura të emergjencës shpërndau të burgosurit, tha Barrick. “Shkuam nëpër çdo seksion dhe i rregulluam,” tha ai.

Sipas oficerëve të burgut, të burgosurit liruan pengjet e marra nga stafi dhe pranuan të ktheheshin në qelitë e tyre gjatë orëve të vona të natës. Institucioni u siguria dhe Departamenti i Korrektimeve u mor sërish nën kontroll rreth orës 10 ose 11 të darkës, sipas raporteve dhe personave të ekipit të reaguesve të emergjencave. Duke parë shkallën e gravitetit të situatës ku pati disa të lënduar, shpejt u përhapën thashethemet për njerëz të vdekur. Pati një shqetësim të konfirmuar se të burgosurit do të kapërcenin rrethimet e jashtme të burgut dhe do të përpiqeshin të arratiseshin, tha Kline. Ai ishte jashtë gjithë kohës me policinë lokale të qarqeve Dauphin dhe York, mes departamenteve të tjera përreth zonës, të cilët erdhën gjatë pasdites dhe mbrëmjes.

Asnjë njeri nuk u vra dhe të burgosurit nuk i kapërcyen rrethimet. 44 njerëz në total, nëntë të burgosur dhe 35 oficerë korrektimi u raportuan si të lënduar atë natë. Njëmbëdhjetë u shtruan në spital.

Nata e dytë

Ditën e enjte, më 26 tetor, Inspektori u takua me drejtuesit e të burgosurve për të diskutuar trazirën dhe kërkesat çfarë ata donin.

“Inspektori nuk u dha asgjë atyre,” u shpreh Palakovich rreth kërkesave të të burgosurve.

Shkurtimi i ditëve të familjeve të të burgosurve ishte një nga faktorët që ai e përcaktoi si shkakun për fillimin e trazirës. Duke u kthyer pas, ai beson edhe se nuk kishte mjaftueshëm programe apo punë të disponueshme për t'i mbajtur të burgosurit të zënë.

Që pas trazirave, ajo gjë ka ndryshuar tashmë. Sot, ka punësim të plotë dhe një mori programesh speciale, shpjegoi ai, si dhe njësi për nevojat specifike për personat me probleme të shëndetit mendor dhe me probleme disiplinore.

Moduli 7: Çelësat dhe Kontrolli i Mjeteve të Punës

(1,5 -2 orë)

Objektivat: Në fund të modulit, pjesëmarrësit do të:

- njihen me elementët bazë të klasifikimit të çelësave dhe kontrollin e tyre;
- familjarizohen me praktikën për sigurimin e çelësave dhe kyçeve;
- njihen me elementet bazë të kontrollit të mjeteve të punës, klasifikimin e mjeteve dhe teknikat e kontrollit të mjeteve;
- rishikojnë disa artikuj të një rëndësie të veçantë dhe do të diskutojnë aspektet procedurale të një incidenti kur mungon një mjet;

Hyrje (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Kontrollimi efektiv i çelësave është ndër elementet më thelbësore të sigurisë në çdo sistem burgu, pavarësisht nivelit të sigurisë. Për të ruajtur një nivel efektiv sigurie, personeli duhet të kontrollojë dyert, portat dhe mjetet e tjera të kyçjes që përbëjnë sigurinë fizike, si brenda, ashtu edhe jashtë perimetrit. Për të bërë këtë gjë, personeli duhet të ketë komandë të plotë mbi çelësat dhe mjetet kyçëse.

Kontrolli përmes mjeteve është i rëndësishëm për të gjithë ne, pasi një kontroll i ulët mund të na vërë të gjithëve në një situatë të rrezikshme. Vëmendja juaj ndaj hollësive mund të ndikojë shumë kontrollin e mjeteve. Mund të jeni të sigurt se, nëse neglizhoni me mjetet e kontrollit, atëherë të dënuarit kanë për ta shfrytëzuar rastin. Ndjekja e rreptë e politikave dhe e procedurave është e nevojshme për të ruajtur drejtpeshimin mes përdorimit të mjeteve gjatë punës dhe nevojës së institucionit për të parandaluar përdorimin e mjeteve kundër arratisë apo prishjes së sigurisë.

1. Kontrolli i çelësave (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Kontrolli i mirë i të kyçurit nuk është vetëm një program apo sistem, por është një aftësi që duhet të mësohet dhe të praktikohet nga çdo anëtar i personelit. Parimet bazë të kësaj gjëje duhet të gjejnë vendin e tyre në operacionet e çdo institucioni dhe të ndërthuren në zakonet e punës së çdo anëtari të personelit.

Kjo temë përcakton saktë kategoritë e ndryshme të çelësave të përdorur në institucion dhe kërkesat e përgjegjshmërisë për çdonjërin. Në institucionet tona nuk kemi një klasifikim të tillë, por do të ishte mirë që ai të përshtatej nga menaxherët e burgjeve, me qëllim rritjen e sigurisë. Në praktikën e përditshme ndodh që një punonjësi i duhet një kohë e konsiderueshme për gjetjen e një çelësi për hapjen e një dore, si portë kryesore apo si portë sigurie. Kjo ndodh se ata nuk janë trajnuar dhe të gjithë çelësat i mbajnë bashkë.

Këto kategori zakonisht përfshijnë:

- * Çelësat e emergjencës: mbahen në unazat e çelësave, veças të gjithë çelësave të zakonshëm. Këta çelësa sigurojnë akses të menjëhershëm në të gjitha pjesët e institucionit gjatë zjarreve, kryengritjeve apo situatave të tjera urgjente.
- * Çelësat *inaktivë*: nuk përdoren më, por mbahen si kopje rezerve për mjetet e papërdorura të kyçjes.
- * Çelësat *master*: të prerë në mënyrë të atillë që një çelës të mund të hapë më shumë se një brave në një seri bravash të prodhuara nga e njëjta fabrikë.
- * Çelësat kallëp: sipas të cilëve priten të gjithë çelësat e tjerë për një brave të caktuar apo një sërë bravash.
- * Çelësat me përdorim të kufizuar: lejojnë akses në zonat delikate të institucionit. Përpara se t'i jepen ndokujt që nuk është punonjësi i autorizuar për tërheqjen e tyre të rregull, duhet të merret autorizim i veçantë.
- * Çelësat e sigurisë: nëse humbasin apo publikohen nga të burgosurit, atëherë këta çelësa do të lehtësonin arratisjen apo do të rrezikonin sigurinë e institucionit, pronës institucionale, punonjësve, vizitorëve apo të dënuarve. Nëse një çelës sigurie humbet, komprometohet apo mungon, atëherë duhet ndërmarrë veprim i menjëhershëm.
- * Çelësat e automjeteve dhe çelësa të tjerë: zakonisht ndezin automjetet e përdorura nga personeli i institucionit për qëllime zyrtare, makineritë e tjera të specializuara dhe dhomën/dollapin/kutinë e veglave që gjenden brenda apo jashtë perimetrit të sigurisë së burgut.

Shënime për trajnerët

*Trajneri i kërkon grupit të lexojë **Materialin 1** rreth një incidenti me çelësat në një burg gjerman. Trajneri i kërkon grupit të shkruajë secili më vete disa praktika të mira për sigurimin e çelësave dhe kyçeve. Pastaj u kërkon anëtarëve të grupit të ndajnë idetë e tyre dhe t'i shkruajnë të gjitha sugjerimet në një fletë.*

Ushtrim

Pyetje: cila është mënyra më e përshtatshme sigurimin e çelësave dhe kyçeve/bravave?

Praktika për ruajtjen e sigurinë e çelësave dhe kyçeve/bravave⁸⁶

Kontributi i trajnerit

Të përgjithshme - Për të gjithë stafin

- Çelësat nuk duhet të ekspozohen gjatë filmimeve apo fotografimeve nga afër.
- Asnjë i burgosur nuk duhet të lejohet të marrë apo të ekzaminojë çelësat ose kyçet.
- Në momentin që hiqen nga dera, çelësat duhet të mbahen të siguruar.
- Në momentin që hiqen nga dera, çelësat duhet të mbahen në një unazë hekuri të lidhur pas vetes gjatë gjithë kohës. Në Strategjinë Vendore të Sigurisë duhet të përcaktohet qartë çdo masë për administrimin dhe sigurimin e çelësave dhe arsyet që personeli mund të heqë çelësat apo unazën e çelësave (si për shembull për qëllime kontrolli, kufizimi apo për përdorimin e palestrës).

⁸⁶ https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/903113/psi-2011-55-security-keys-locks.pdf

- Unazat e çelësave duhet të vulojnë me vula të dukshme që nuk lejojnë manipulime, në mënyrë që në unazat e çelësave të mos mund të hiqet dhe as të shtohet asnjë çelës. Personat që mbajnë çelësat nuk duhet të bëjnë asnjë ndryshim në tufën e çelësave që kanë marrë në dorëzim pa autorizimin e strukturave drejtuese.
- Nuk duhet të përdoret forcë për të hapur asnjë bravë. Çdo vështirësi në hapjen e çdo kyçi apo brave duhet të raportohet menjëherë për të parë nëse ka ndodhur ndonjë komprometim i kyçit/bravës. Të gjitha komprometimet e kyçeve/bravave janë incidente që duhen raportuar.

2. Kontrolli i mjeteve të punës (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Fokusi i kësaj pjese do të jetë:

- Klasifikimi i mjeteve
- Kontrolli i mjeteve
- Rishikimi i programit

Është jetike që të gjithë t'u përmbahen politikave që lidhen me kontrollin e mjeteve. Besojmë se kjo do të jetë e qartë në fund të kësaj seance. Pavarësisht nga seksioni apo shërbimi ku jeni caktuar brenda institucionit, jeni përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së institucionit.

Klasifikimi i mjeteve

Klasifikimi i mjeteve është tepër i rëndësishëm. I gjithë personeli, pavarësisht nga pozicioni ku është caktuar, duhet të jetë i familjarizuar me klasifikimin e mjeteve që ekzistojnë në institucion.

Të gjitha mjetet mund të klasifikohen nën tre tituj:

- Të rrezikshme Klasa AA;
- Rrezik potencial Klasa A;
- Të parrezikshme Klasa B.

Klasa AA – të rrezikshme

Te grupi AA futen ato mjete që konsiderohen tepër të rrezikshme për sigurinë e institucionit për t'u përdorur nga i burgosuri pa mbikëqyrje të vazhdueshme nga personeli apo pa qenë në fushëpamjen e personelit ose pa qenë i siguruar, duke mos u lejuar kështu të burgosurve as mundësinë më të vogël për të pasur akses te kjo pajisje. Këto pajisje mund t'u jepen vetëm punonjësve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mjetet e klasës AA duhen hequr nga institucioni në fund të çdo dite pune ose të magazinohen në kasaforta me çelës në dhomat e mjeteve të klasës A, në magazinën e armëve apo të çohen mbrapsht në qendrën e kontrollit. Le të renditim disa nga mjetet e rrezikshme që i quajtmë klasa AA:

- tehet metalprerëse,
- dhomat e përzierjes,
- pinca të mëdha,
- mjete me diamante,
- turjelat.

Klasa A – rrezik potencial

Grupi i klasës A përfshin ato mjete që ka më shumë të ngjarë të përdoren gjatë arratisjeve apo tentativave për t'u arratisur si dhe për të prodhuar mjete që shërbejnë si armë që mund të shkaktojnë plagë të rënda në trup ose të paraqesin rrezik të lartë ndaj sigurisë së institucionit apo personelit. Edhe këto mjete mund t'u jepen për përdorim vetëm punonjësve.

Klasa B – të parrezikshme

Grupi i klasës B përfshin mjete të një natyre të parrezikshme. Këto mjete mund të përdoren nga të burgosurit, por përgjegjësi i personelit apo drejtuesi i punishtes duhet t'i numërojë pas çdo dite pune.

3. Teknikat e kontrollit të mjeteve (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

I gjithë personeli i institucionit është përgjegjës për kontrollimin e mjeteve. Kontrolli mbi mjetet ruhet përmes një etiketimi, magazinimi, inventarizimi dhe aksesit të saktë. Te gjitha pajisjet e reja duhen etiketuar sipas klasës së të caktuar, sikundër përkufizohet në manualin e shërbimeve të burgjeve

3.1 Identifikimi i mjeteve dhe etiketimi

Të gjitha mjetet etiketohen në çdo vend pune me një simbol identifikimi që tregon seksionin apo personelin. Oficeri i kontrollit të mjeteve ka si përgjegjësi që të sigurojë etiketime të sakta. Mjetet që nuk mund të etiketohen, inventarizohen dhe mbahen të mbyllura. Gjithashtu, mjetet e klasës AA etiketohen sipas vendndodhjes së magazinimit.

3.2 Magazinimi i mjeteve

Sa prej jush në këtë dhomë kanë parë një tabelë me vrima? Tabela me vrima konsiderohet si metoda më e mirë e magazinimit të mjeteve të cilat mund të varen në mur. Në çdo tabelë muri me vrima duhet vendosur vetëm një mjet dhe tabela duhet të jetë identike me madhësinë dhe formën e mjetit. Këto tabela zakonisht janë të bëra me kompensatë, të lyera me të bardhë dhe kanë nga një çengel për çdo mjet. Tabelat me ngjyra kanë nga një ngjyrë për çdo klasë mjeti. Të gjitha institucionet përdorin një sistem standard të ngjyrave për këto tabela, në varësi të klasës së mjetit.

- e verdha = klasa AA
- e kuqja = klasa A
- e zeza = klasa B

Të gjitha varëset e murit që mund të jenë të aksesueshme nga të burgosurit duhet të mbulohen me një rrjetë metalike me bravë.

3.3 Inventari i mjeteve

Të gjitha mjetet e marra nga institucioni duhet të etiketohen dhe të futen në inventarin e duhur përpara se të jepen për përdorim. Punonjësit përgjegjës për mjetet duhet të ndihmojnë në mbajtjen e inventarit dhe të certifikojnë saktësinë e tij. Ndoshta fakti më i rëndësishëm që duhet mbajtur mend nga grupi juaj është përgjegjësia që keni për inventarin e mjeteve të magazinuara në vendin e punës suaj.

3.4 Lista e pajisjeve

Nëse nuk mbani mend asgjë tjetër nga ky seksion, atëherë mos harroni se, kur humbasin mjete, kjo duhet raportuar brenda ditës. Njoftoni menjëherë eprorin e drejtpërdrejtë. Zyra e specialistit të policisë ruan një dosje për çdo raport mbi mjete të humbura, monitoron me kujdes dhe saktësi shpeshtësinë e humbjeve nga zona apo punishte të caktuara, bën përpjekje për të gjetur mjetet e humbura, etj.

Shënime për trajnerët

*Trajneri i kërkon grupit të lexojë **Materialin 2** ku paraqitet një qarkore përgjithësuese rreth një incidenti kritik në një burg australian⁸⁷. Qarkorja trajton përshkallëzimin e një sërë incidentesh serioze në një burg australian dhe analizon shkaqet kryesore, duke përfshirë mangësitë në kontrollin e mjeteve. Trajneri i kërkon grupit të sjellë disa shembuj situatash (ose vendesh/aktivitetesh) në burgje, ku mjetet mund të përbëjnë rrezik serioz për sigurinë.*

Ushtrim

Pyetje: rendisni sa më shumë shembuj situatash në burgje, ku mjetet mund të përbëjnë rrezik serioz për sigurinë.

Pas marrjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si më poshtë.

Kontributi i trajnerit

Analiza kritike e incidenteve në burgun australian tregon se në kohën që po ndodhnin incidentet, të burgosurit ishin në çatinë e ndërtesës së burgut duke pasur akses në një zonë ajrimi rrethor mbi zyrën e Njësisë 2 direkt mbi Oficinën e Mirëmbajtjes.

Të burgosurit arritën të hynin në oficinë dhe morën prej andej *dy shkallë dhe një makinë mprehëse me bateri*. Shkallët u zhvendosën duke u prerë me *një makinë mprehëse me bateri* që ishte lënë pa u siguruar në Oficinën e Mirëmbajtjes.

Makina mprehëse u përdor për të prerë një zinxhir që siguronte shkallët. Në oficinë, shkallët mbaheshin të lidhura me zinxhir pas murit dhe të kyçura, por aty kishte mjete të tjera të palidhura/pasiguruara, duke përfshirë edhe makinën mprehëse. Shumica e mjeteve mbaheshin të kyçura në dollapë dhe në karrocë e punës.

Mangësia kritike në këtë rast: Disa mjete të tjera, duke përfshirë makinën mprehëse, ishin lënë sipër karrocës në oficinë.

4. Artikuj të një rëndësie të veçantë (20 minuta)

Le të shpenzojmë pak kohë tani duke folur rreth artikujve që nuk gjejnë vend të përkufizimet normale të mjeteve ose që nuk mund të trajtohen sipas procedurave që diskutuam.

- Depozitat acetileni - përdorimi i këtyre depozitave duhet të kufizohet ndjeshëm, duke lejuar të hyjnë në institucion vetëm atë sa nevojitet për të përfunduar detyrat e përditshme. Në fund të ditës, depozitat e përdorura ose të papërdorura duhet të magazinohen jashtë perimetrit.
- Armët ramset (ramseti është një armë që shkrepi gozhdë duke i ngulur në beton

⁸⁷ [https://www.parliament.wa.gov.au/publications/tailedpapers.nsf/displaypaper/4012084aee99505c47e2437f482583530037a7a1/\\$file/2084.pdf](https://www.parliament.wa.gov.au/publications/tailedpapers.nsf/displaypaper/4012084aee99505c47e2437f482583530037a7a1/$file/2084.pdf)

dhe që po përdoret përherë e më gjerësisht në projektet e ndërtimit) dhe municioni duhet të magazinohen në magazinën e armatimeve të institucionit. Personeli që kërkon të përdorë armën ramset duhet ta marrë atë si dhe municionin nga oficeri i sigurisë dhe duhet t'ia kthejë të njëjtit oficer sigurie, përfshirë këtu edhe kompletet e harxhuara.

- Materialet e djegshme, të rrezikshme, helmuese dhe kimikatet duhet të mbahen në inventar sipas vendimit të menaxherit të sigurisë.

Këta artikuj mund të merren vetëm nga punonjësit.

Si përfundim, tanimë duhet të keni kuptuar se kontrolli i çelësave dhe i mjeteve është jetik për sigurinë e institucionit. Nëse humbasim kontrollin e një çelësi apo mjeti, komprometohet siguria juaj, ajo e anëtarëve të tjerë të personelit dhe komunitetit si dhe e të burgosurit. Sikundër u tha më sipër, jemi të gjithë përgjegjës për kontrollin e çelësave dhe të mjeteve.

Kjo temë është pak abstrakte për ne, pasi ende nuk kemi një punësim masiv dhe punishte në burgje. Por kujtojmë se punësimi është një perspektivë e afërt në burgjet tona, ndaj kjo temë do të na duhet që të kemi trajnimin e nevojshëm për: identifikimin e mjeteve të punës të rrezikshme dhe potencialisht të rrezikshme, magazinimin e tyre, nxjerrjen nga regjimi dhe zbatimin e protokolleve të sakta për kontrollin e veglave të punës. Shumë arratisje ose tentativa për arratisje janë mundësuar falë moskontrollit të mirë të çelësave dhe lejimit të mjeteve të rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme në regjimin e burgut.

Diskutoni për problematikat e mëposhtme

A e di ndokush se çfarë veprimi ndërmerret në vendin e punës kur zbulohet se mungon një mjet?

Përgjigje

- Njoftohet menjëherë eprori.
- Kryhet një kontroll i hollësishëm i zonës.
- Të gjithë të dënuarit që mund të kenë pasur akses ndaj mjetit, mbahen në vendin e punës derisa të përfundojë kontrolli.
- Plotësohet formulari i quajtur Raporti për mjetet e humbura apo që mungojnë po të njëjtën ditë që ndodh humbja.
- I dërgohen kopje specialistit të sigurisë.

Mbyllja

MATERIALI 1

Ushtrimi: Praktika për sigurimin e çelësave dhe kyçeve/bravave

Burimi: LADbible

<https://www.ladbible.com/news/news-prison-has-to-change-600-locks-after-intern-shared-pics-of-keys-20210303>

Burgu duhet të ndryshojë 600 brava pasi punonjësi ndau fotografi të çelësave në WhatsApp

Publikuar në orën 19:00, 03 Mars 2021 GMT
Përditësuar së fundmi në orën 14:42, 14 Prill 2021 BST



Foto Erika Wittlieb përmes Pixabay Free Pictures

Ne të gjithë duam të bëjmë përshtypje të mirë kur fillojmë një punë të re, apo jo?

Fatkeqësisht një i sapo punësuar në një burg në Gjermani, bëri fiks të kundërtën kur u dërgoi fotografi të çelësave të institucionit miqve të tij në WhatsApp.

Edhe pse synimet e tij ishin në dukje të pafajshme, kjo gjë rrezikonte seriozisht sigurinë e burgut.



Foto Jan Vasek përmes Pixabay Free Pictures

Si rezultat, të 600 bravat e objektit duhej të ndryshoheshin - kurse djaloshit të

shkretë mund t'i jetë dashur të shpenzojë dhjetëra mijëra euro për gafën. Mos!

I sapo punësuar, i cili punonte në burgun JVA Heidering në rajonin metropolitan Berlin-Brandenburg të Gjermanisë, thuhet se bëri një foto-selfie brenda burgut dhe ua dërgoi shokëve.

Në foto, thoshte se mbante në duar çelësin më të rëndësishëm nga të gjithë - atë që mbyllte të gjitha dyert e qelive dhe korridoreve.

Sipas mediave lokale, punonjësi, i cili nuk kishte dalë me emër, donte të mburrej se sa e rëndësishme ishte puna e tij e re.

Kuptohet që nuk e kuptonte se ku çonin veprimet e tij - d.m.th. çelësi mund të riprodhohej lehtësisht nga specialistët.

Nëse kjo do të ndodhte dhe brenda në burg do të arrinin të futeshin çelësa kontrabande, kjo mund të kishte çuar në një shpërthim masiv të burgut, ku ndodheshin aktualisht 657 të burgosur.

Edhe pse nuk dihet se kush e lajmëroi burgun për fotografinë, ata konstatuan se duhet të ndryshohej i gjithë sistemi i çelësave të burgut - kjo përfshinte instalimin e 600 bravave dhe çelësave të rinj.

Incidenti u raportua tek autoritetet gjyqësore të enjten dhe zëdhënësi Sebastian Brux konfirmoi: "Për këtë arsye, janë ndryshuar dyert e të gjitha qelive dhe korridoreve."

Këto përpjekje nuk kushtuan pak. Jo vetëm që duhet të blinin brava dhe çelësa të rinj, por u deshën edhe 20 vetë nga stafi i burgut për të instaluar sistemin e ri të sigurisë, për të mos përmendur koston e asgjësimit të çelësave të vjetër.

Edhe pse nuk ka pasur asnjë përditësim zyrtar mbi shpenzimet, ekspertët llogarisin se burgut do t'i ketë kushtuar 50,000 € (mbi 43,000 paund) zëvendësimi i sistemit.

Kredit: Uwe Baumann përmes Pixabay Free Pictures

Ndërkohë, zëdhënësi Brux tha se kostot mund t'i faturoheshin punonjësit të pakujdesshëm, duke shtuar: "Atij iu ndalua menjëherë hyrja në institucion dhe iu ndërpre kontrata."

Pra, jo vetëm që mund të humbiste punën, por ky gabim mund t'i kushtonte *shumë më tepër* - gjithçka vetëm për një mesazh në WhatsApp.

MATERIALI 2 Kontrolli i mjeteve

Çfarë ndodhi në 24-25 korrik 2018?

HYRJE

- E martë, 24 korrik 2018, dita filloi si një ditë normale në burgun Greenough - me mungesa në staf, modifikime në rutinën e përditshme dhe lëvizja e vazhdueshme e të burgosurve në sektorë. Atë ditë, në burgun e Greenough ndodheshin 284 të burgosur; 228 burra dhe 56 gra.
- Ajo që ndodhi pak pas orës 16:00 - dhe vazhdoi për më shumë se dymbëdhjetë orë - ishte jashtëzakonisht serioze në çdo kontekst. Pati një humbje të kontrollit të seksionit kryesor të sigurisë së burgut. *Një nga shkaqet që çoi në humbjen e kontrollit ishte siguria jo e mirë fizike dhe procedurale, duke përfshirë edhe mangësitë në kontrollin efektiv të mjeteve.*

Moduli 8: Shkrimi i raporteve (3 orë)

Objektivat: Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë arsyet se pse janë të rëndësishme aftësitë e shkrimit të raporteve;
- të përshkruajnë qëllimet e shkrimit të raporteve dhe dokumentimit;
- të përmbledhin kuptimin e instrumenteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të shpjegojnë procedurat e raportimit të incidenteve;
- të identifikojnë pjesët e një raporti të organizuar dhe të mirëstrukturuar;
- të rendisin llojet e detajeve që duhet të merren parasysh në këto raporte në lidhje me kush, çfarë, ku, kur, pse dhe veprimet e ndërmarra;
- të shpjegojnë strategjitë që mund të përdoren për të shkruar fjali të qarta dhe koncize;
- të shpjegojnë 5 C-të e përdorura për vlerësimin e raportit.

Në fund të kursit, pjesëmarrësit praktikojnë aftësitë e të shkruarit të një raporti incidenti.

1. Hyrje (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Politika dhe qëllimi

Për një oficer burgjesh apo institucionesh korrektuese, *shkrimi i raporteve* është një prej detyrave më të rëndësishme që i kërkohet të kryejë çdo ditë. Raportet që shkruani pasqyrojnë nivelin tuaj sa u përket aftësive dhe profesionalizimit, si punonjës burgjesh.

Raportet dëshmojnë jo vetëm profesionalizimin tuaj, por luajnë gjithashtu rol të rëndësishëm në funksionimin e përditshëm të agjencisë së drejtësisë penale apo institucionit përkatës.

Shënim për trajnerin

Trajneri i kërkon grupit që të reflektojë mbi qëllimin e regjistrimit të fakteve dhe veprimeve në raportet e punonjësve të zbatimit të ligjit, si dhe të shkruajnë secili më vete disa mendime, në mënyrë që më pas të shkëmbejnë me njëri-tjetrin idetë në grupe të vogla.

Ushtrim

Pse janë të rëndësishme raportet?

Udhëzime: Imagjinoni sikur një mik ju ka folur për karrierën që mund të ketë në sistemin e drejtësisë penale. Ai/ajo po pret me shumë kënaqësi të provojë të punojë në një institucion burgu ose në polici. Shokut apo shoqes suaj nuk i ka pëlqyer shumë gjuha shqipe në shkollë të mesme dhe shpreson që t'i duhet të shkruajë sa më pak raporte. Shkruani një letër të shkurtër, ku shpjegoni se pse shkrimi i raporteve është i rëndësishëm dhe sugjeroni disa ide për përmirësimin e këtyre aftësive.

Pas këtij ushtrimi, trajneri përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Së pari, raportet tuaja dëshmojnë profesionalizimin tuaj. Përveç kësaj, faktet dhe veprimet e përshkruara në raporte mund të përdoren për qëllime të ndryshme, si p.sh.:

- mund të lexohen nga eprorët, media, liderët e komunitetit, prokurorët dhe aktorë të tjerë që krijojnë një opinion në lidhje me sistemin e zbatimit të ligjit në bazë të asaj çka është shkruar dhe si është shkruar;
- ato ndihmojnë eprorët/hetuesit për të zbuluar faktet dhe rrethanat e një incidenti;
- raportet e sakta vërtetojnë se i keni ndjekur procedurat si duhet;
- raportet efikase japin informacione për raportet statistikore, mund të ndihmojnë për t'ju përgatitur për të dhënë dëshmi në gjykatë ose mund t'ju çlirojnë nga detyrimi për të dëshmuar, nëse gjithçka në raport është e qartë;
- një raport efikas duhet ta ndihmojë prokurorin që ta ndjekë një krim të kryer brenda institucionit ose në rast arratisjeje, stafi i burgjeve duhet të bashkëpunojë me autoritetet e zbatimit të ligjit për hetimin e incidentit;
- Raportet i ndihmojnë hetuesit të kuptojnë skemat e ndryshme të sjelljeve kriminale.

Përveç kësaj, stafi i burgjeve është përgjegjës për shkrimin e raporteve dhe për dokumentimin e të gjitha detajeve relevante për sjelljen e të burgosurve, si dhe për gjithçka tjetër që ka ndodhur gjatë kohës që ata kanë qenë në detyrë. Shkrimi i raporteve shërben si një qëllim i rëndësishëm i promovimit të mënyrave transparente të të vepruarit në burg, dokumentimit të incidenteve, sjelljeve dhe qëndrimeve si të burgosurve, ashtu edhe stafit që veprojnë në kundërshtim me normat dhe rregullat.

2. Referencat ligjore në instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare (10 minuta)

Në Rregullat Evropiane të Burgjeve, rëndësia e raportimit të incidenteve theksohet në dy rekomandime:

Rregulli 58 Çdo akuzë për thyerje të rregullave disiplinore nga një i burgosur do t'i raportohet menjëherë organit përkatës, i cili bën hetimet pa vonesë.

Rregulli 65 Ka procedura të detajuara për përdorimin e forcës, duke përfshirë dispozita rreth raporteve që duhet të plotësohen pas përdorimit të forcës.

Baza ligjore kombëtare:

- Ligji nr. 81 datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve, i ndryshuar”.
- Ligji nr. 80 datë 25.06.2020, “Për Policinë e Burgjeve”.
- Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve, miratuar me VKM Nr. 437 datë 20.05.2015, neni 41, 42, 43, 116.
- Rregullore “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve”, neni 49; 50; 51
- Rregullore e hollësishme e sjelljes së punonjësve të policisë së burgjeve, miratuar me Urdhër Nr. 5251/1, datë 30.07.2010, të Ministrit të Drejtësisë.

Lidhur me procedurat e tjera

Procedura për shkrimin dhe administrimin e raporteve mbi incidentet, lidhet me procedura të tjera, si:

- Procedurat e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit
- Procedurat e vëzhgimit dhe ndjekjes së veprimeve
- Procedurat e kontrollit (fizik, të automjeteve, për sendet e ndaluara, elementët e sigurisë etj).
- Procedurat e përdorimit të forcës dhe të mjeteve të kufizimit fizik.
- Procedurat e shoqërimit dhe transportit.
- Procedurat e vlerësimit të riskut.
- Të drejtat e të dënuarve dhe paraburgosurve, etj.

3. Përkufizimet dhe procedurat për raportimin e një incidenti (40 minuta)

- 1. Raportim incidenti:** Format i plotësuar që dokumenton një veprim, apo mosveprim, sjellje apo qëndrim në kundërshtim me normat e sjelljes të një ose më shumë personave të burgosur, punonjës, vizitorë dhe jo vetëm.
- 2. Incident** - një veprim, apo mosveprim, sjellje apo qëndrim në kundërshtim me normat e sjelljes të një ose më shumë personave të burgosur, punonjës, vizitorë dhe jo vetëm.

Procedurat

1. Raporti i incidentit plotësohet vetëm në formatin tip që i bashkëlidhet kësaj procedure, i cili është me numër serie në bllok dhe depozitohet tek zyra e specialistit të informacionit të IEVP.
2. Raporti i plotësuar i dorëzohet specialistit të informacionit në detyrë, i cili e dokumenton atë në librin e aktivitetit ditor dhe e dorëzon atë menjëherë në protokoll të institucionit.
3. Raporti plotësohet nga çdo punonjës policie, por jo vetëm, që konstaton ose njihet me një shkelje disiplinore të kryer nga;
 - të dënuarit
 - vizitorët
 - punonjësit
4. Kur në një incident janë të pranishëm disa punonjës policie, raportin e plotëson punonjësi i planifikuar në atë shërbim, ose punonjësi drejtues i grupit që është prezent.
5. Shefi i Policisë së burgut ose një punonjës i ngarkuar prej tij informon të burgosurin për mbajtjen e raportit në ngarkim të tij.
6. Pas përfundimit të raportit, punonjësi raportues do ta konsultojë dhe rishikojë atë me ndihmën e eprorit të tij të drejtpërdrejtë.
7. Drejtori i Institucionit, pasi merr dijeni për hartimin e raportit lidhur me një

incident, kërkon të mblidhen të gjitha provat, si CD të pamjeve filmike të regjistruara, sende dhe mjete si provë materiale, etj.

8. Brenda 48 orëve nga ndodhja e incidentit, Drejtori i Institucionit mbledh Komisionin Disiplinor për të dëgjuar dhe vlerësuar provat mbi shkaqet dhe pasojat e incidentit.

9. Në rastet kur është përdorur forca, punonjësit e policisë do të plotësojnë edhe formularin e përdorimit të forcës, të cilin ia vënë në dispozicion drejtorit të IEVP.

Shënim për trajnerin - Ushtrim

Trajneri i kërkon grupit që të lexojë një raport⁸⁸

Raporti për Institucionin Penal

Në orën 10:35 paradite, më 9 korrik 2010, unë, punonjësi i policisë së rolit bazë Elton, shkova në Godinën B që të flisja me përfaqësuesin fetar për planet e programit muzikor të muajit tjetër.

Kur hapa derën e zyrës së përfaqësuesit fetar, dëgjova ca hapa mbrapa meje. U ktheva dhe pashë të burgosurin Danilo DC 091724 që po dilte nga një dollap.

Kur më pa, ai i vuri duart pas kurrizit. I thashë të ndalonte dhe të më tregonte se çfarë kishte në duar. Ai tha “Mos më trego mua se ç’duhet të bëj.”

Unë e urdhërova përsëri të burgosurin Danilo që të më tregonte se çfarë kishte në duar. Ai u kthye dhe unë pashë tre stilografë në secilën dorë. Ia kontrollova xhepat dhe gjeta edhe dy rulona me nxitës transparent.

Ia konfiskova stilografët dhe ngjitësin dhe e shoqërova të burgosurin Danilo në dhomën e veçimit. U ktheva në Godinën B dhe i kujtova përfaqësuesit fetar rregulloren e burgut, sipas së cilës dollapët duhet të qëndronin gjatë gjithë kohës të kyçur.

Ju lutemi, kërkojini grupit që të shkruajë përgjigjet për këto pyetje:

- **Çfarë është struktura e raportit?**
- **Çfarë informacionesh duhet të japin punonjësit?**
- **Si përdoren fjalitë?**
- **Si mbyllet raporti?**

Kur grupi të ketë mbaruar së shkruajturi përgjigjet e veta individuale, trajneri e përmbledh ushtrimin si vijon:

Kontributi i trajnerit

Ja disa karakteristika të rëndësishme të raportimit:

- Raportet kanë fillimin, mesin dhe fundin.
- Është shpjeguar qartë se pse të dy personat kanë qenë të pranishëm në ngjarjen që ka ndodhur.
- Data, ora dhe vendi i shënjestër regjistruar si duhet, bashkë me emrat e personave me të cilët ata folën.
- Është regjistruar se çfarë kanë parë, çfarë kanë thënë dhe çfarë tha i burgosuri.
- Raportet mbylleen me një përmbledhje, ku shpjegohet rezultati i situatës.

⁸⁸ Marrë nga Reynolds, J. (2011) Udhëzues për shkrimin e raporteve të Drejtësisë Penale, The Maple leaf Press, faqja 19 -20.

Punonjësi ka përdorur përemrat “unë” dhe “mua” kur i referohet vetes. Ai ka shkruar me fjali të qarta dhe të thjeshta dhe i ka qëndruar fakteve, duke shmangur opinionet apo hamendësimet për atë çka ka ndodhur.

4. Kërkesat për raportet e incidenteve (100 minuta)

Hapat e shkrimit të raportit

Si çdo detyrë, shkrimi i një raporti ka tre faza:

- 1) përgatitjen
- 2) hartimin
- 3) rishikimin

Përgatitja përfshin rindërtimin e fakteve dhe veprimeve relevante.

Kur shkruajmë raporte shërbimi, ne duam të ndërtojmë një figurë. Mendojeni atë si një figurë, përshkrimin e së cilës doni që t’ia tregoni një personi që nuk është i pranishëm. Ky mund të jetë shefi juaj ose kolegë të tjerë. Disa prej këtyre individëve nuk punojnë në një institucion burgu dhe, për këtë arsye, u duhen detaje të mjaftueshme që ta kuptojnë këtë figurë. Është e rëndësishme që figura të ndërtohet si duhet dhe me informacione të mjaftueshme për incidentin që ka ndodhur. Ka shumë komponentë që duhet të jenë të pranishëm në këtë raport, konkretisht: një dokumentim i personave të përfshirë, natyra e incidentit, detaje në lidhje me atë që ka ndodhur, pohime të rëndësishme, dëmtimet, si dhe rezultati. Mënyra më e lehtë për t’i shtuar këta komponentë është që të fillohet nga fillimi dhe thjesht të tregohet historia siç ka ndodhur.

Hartimi përfshin regjistrimin e informacioneve në letër ose në një kompjuter/laptop. Juve mund t’ju jepet një formular në letër me hapësira për emrat, datat, vendndodhjen, shkeljen dhe informacione të tjera. Nëse përdorni një kompjuter/laptop, duhet ta shtypni këtë informacion në hapësirat në ekran.

Rishikimi përfshin korrigjimin e gabimeve, verifikimin e informacioneve, si dhe kontrollin nëse është përdorur gjuha e duhur, nëse shkrimi është i qartë, i plotë dhe me stil profesional.

Shkrimi i raporteve të incidenteve është një pjesë e rëndësishme e shumicës së punëve të punonjësve të policisë. Punonjësit duhet të komunikojnë mirë me shkrimin. Kjo do të thotë që duhet të përdorni drejtshkrimin dhe gramatikën e duhur. Duhet të merret parasysh se raporti mund të lexohet nga mbrojtësi ligjor, komisioni i ankimit, ose autoritete të pavarura.

- Vetëm Faktet

Raportet e incidenteve nuk duhet të përfshijnë kurrë opinione, por vetëm fakte.

- Gjuhë e thjeshtë

Kur dikush është duke lexuar raportin tuaj të incidentit, ai duhet të jetë në gjendje të kuptojë gjuhën, pavarësisht nga përvoja e tyre. Përdorni gjuhë të thjeshtë që çdokush duhet të jetë në gjendje ta kuptojë. Mundohuni të shmangni përdorimin e zhargonit kur është e mundur. Nëse është e pashmangshme, shkruani kuptimin e zhargonit në kllapa.

- **Formatimi**

Mos e ktheni raportin tuaj të incidentit në një paragraf të gjatë, i cili do të jetë i vështirë për tu kuptuar. Sigurohuni që të përdorni paragrafë në mënyrë që lexuesi të dijë kur prezantoni fakte për diçka të re. Ju madje mund të përdorni “bullets” ose listat me numra nëse ato duken të përshtatshme. Ata mund ta bëjnë më të lehtë leximin dhe do të tërheqin vëmendjen e lexuesit drejt pikave të rëndësishme.

- **6 pyetjet Kush, Çfarë, Kur, Ku, Pse dhe Si**

Të gjitha këto pyetje duhet të kenë përgjigje dhe të jenë pjesë e raportit tuaj të incidentit. Nëse ju mungon një nga këto, atëherë raporti juaj nuk është i plotë. Përfshini të gjithë ata që ishin të pranishëm në incident, përfshirë policinë.

Kush (përdor emrin e plotë për të dyshuarit, dëshmitarët, të dëmtuarit, ose viktimat)

Çfarë (tipi i incidentit, apo krimit)

Kur (koha, data dhe ora)

Ku (ambjenti, vendi i ngjarjes)

Përse (motivi, arsyeja e ngjarjes)

Si (mënyra ose mjetet e përdorura)

Veprimet që keni bërë ju

- **Kronologji**

Renditni ngjarjet në mënyrë kronologjike në kohë

- **Jini shterues.**

Shkruani gjithçka që arrini të mbani mend - sa më shumë detaje të ofroni, aq më mirë. Mos u jepni njerëzve që lexojnë raportin tuaj mundësi për të interpretuar diçka në mënyrë të gabuar. Mos u shqetësoni nëse raporti është shumë i gjatë ose shumë i stërgjatur. Gjëja e rëndësishme është të paraqisni një pamje të plotë të asaj që ka ndodhur.

- **Ji i qartë**

Mos përdorni gjuhë të zbukuruar dhe konfuze për të përshkruar atë që ndodhi. E shkruara duhet të jetë e qartë dhe koncize. Përdorni fjali të shkurtra, të bazuara në fakte, të detajuara, të bazuara në të dhëna të cilat nuk lënë vend për interpretim.

- **Ji i sinqertë**

Edhe nëse nuk ndiheni mirë për mënyrën si e keni menaxhuar situatën, është e domosdoshme që të shkruani një histori të vërtetë e të ndershme. Nëse shkruani diçka false, ajo mund të zbulohet më vonë nëpërmjet kamerave apo nga dëshmitë e kolegëve të tjerë duke e vënë punën tuaj në rrezik dhe duke shkaktuar probleme për njerëzit e përfshirë në aksident.

Pesë “C-të”

Duke qenë se jeni në procesin e mbledhjes së informacioneve për raportin, duke u kujdesur në të njëjtën kohë që t’u jepni përgjigje dhe të adresoni shtatë elementët kyçë të shkrimit të raporteve renditur më sipër, duhet gjithashtu të keni parasysh

“**Pesë C-të**” e të shkruarit si duhet të një raporti.

1. Plotësia (Completeness)
2. Saktësia (Conciseness)
3. Qartësia (Clearness)
4. Korrektësia (Correctness)
5. Kortezia (Courteousness)

Përdorimi i Pesë C-ve mund të përmbliidhet si besnikëri ndaj fakteve, përdorimi i fjalive të plota, shmangia e zhargonit të burgut, qëndrimi brenda temës dhe të qenit i drejtpërdrejtë, shmangia e fjalëve të panevojshme, përpjekja për saktësi, të shkruarit pa gabime gramatikore apo drejtshkrimore, si dhe të qenit i ndershëm dhe objektiv në shkrimin e raportit.

Shënim për trajnerin

Opsionale: Trajneri i kërkon grupit që të plotësojë testet paraprake I dhe II për “Raportet efikase” dhe për “Zgjedhjen efikase të fjalëve” (Shih SHTOJCËN, MATERIALIN 1)⁸⁹.

5. Ushtrim për shkrimin e një raporti incidenti

Shënim për trajnerin: Trajneri u kërkon pjesëmarrësve të lexojnë MATERIALIN 2 për rastin e të burgosurit George “Tre goditje dhe del jashtë”. Shkruani një raport për këtë incident dhe:

- Përdorni formularin e raportimit të incidenteve (MATERIALI 3) për ta shkruar këtë raport, duke përdorur Kush, Çfarë, Ku, Kur, Pse dhe Si, si dhe duke aplikuar rregullin e 5 C-ve.
- Në këtë raport duhet të përshkruhet sjellja e policëve të burgut në kundërshtim me rregullat: të gjitha shkeljet e rregullave, **shkeljet si nga i burgosuri, ashtu edhe nga stafi** i përfshirë në këtë incident, të cilat duhet të përfshihen në raportin e incidentit.

Mbyllje

89 Marrë nga Reynolds, J. (2011) Udhëzues për shkrimin e raporteve të Drejtësisë Penale, The Maple leaf Press.

Shtojcë

MATERIALI 1

TEST PARAPRAK PJESA I dhe II

Udhëzime: Plotësoni secilin aktivitet më poshtë.

TEST PARAPRAK pjesa I Raportet efikase

Udhëzimet: Vendosni një shenjë ✓ nëse fjalja i përmbush kriteret e një raporti efikas. Vendosni ✗ nëse fjalja nuk i përmbush këto kriteret.

- ___ 1. Ndjeva erë alkooli në frymën e të burgosurit Klajdi.
- ___ 2. I burgosuri Rasim ishte agresiv kur hyra në qelinë e tij.
- ___ 3. Unë pashë nga dera e hapur të burgosurin Luka që ia kishte vënë të dyja duart të burgosurit Fatlind në qafë.
- ___ 4. I burgosuri Leon po shikonte televizor, ndërkohë që unë pyesja të burgosurin Getoard.
- ___ 5. Pashë të burgosurin Fatjon, i cili i ra tre herë lartë e poshtë oborrit.
- ___ 6. Ishte e qartë se e ecura e të burgosurit Klajdi ishte e paqëndrueshme, ndoshta për shkak të alkoolit.
- ___ 7. I burgosuri Fatjon nuk pranoi të bashkëpunonte.
- ___ 8. I burgosuri Fatjon “u orientua”, “u udhëzua” dhe u urdhërua “të shtrihej përmbys” në dysHEME.

TEST PARAPRAK Pjesa II Zgjedhja efikase e fjalëve

Udhëzimet: Vendosni një shenjë ✓ nëse formulimi i fjalive i përmbush kriteret e një raporti modern. Vendosni ✗ nëse jo.

- ___ 1. I burgosuri Albert më tha se kishte dalë nga qelia për punë në orën 7:45 atë mëngjes.
- ___ 2. Kur qelia e të burgosurit Rasim u kontrollua nga ky polic, u gjet një qese e vogël plastike me pluhur të bardhë.
- ___ 3. Konstatove se i burgosuri David kishte marrë orën e të burgosurit Lukas gjatë përleshjes.
- ___ 4. E pyeta të burgosurin Albert nëse kishte nevojë për ndihmë mjekësore dhe ai tundi kokën lartë e poshtë.
- ___ 5. I burgosuri Agon shau dhe mallkoi kur pa prangat.
- ___ 6. Kontrollova zonën, kurse polici Bujar mori në pyetje të burgosurin Sotir.
- ___ 7. Dritarja mbi lavaman ishte thyer dhe copat e xhamit kishin rënë në banakun e kuzhinës.
- ___ 8. Kur kontaktova policin Sokol, ai tha se nuk kishte parë dhe nuk kishte dëgjuar asgjë të pazakontë.

Më pas trajneri diskuton përgjigjet e duhura duke përdorur një **ÇELËS TË PËRGJIGJEVE TË TESTIT PARAPRAK**.

Pjesa I Raportet efikase

- ✗ 1. Ndjeva erë alkooli në frymën e të burgosurit Klajdi. [Alkooli nuk ka erë. Ju duhet të thoni se ndjetë erën e një pijeje alkoolike ose një lëngu]
- ✗ 2. I burgosuri Rasim ishte agresiv kur hyra në qelinë e tij. [E paqartë. Duhet thënë saktësisht se çfarë bëri konkretisht.]
- ✓ 3. Unë pashë nga dera e hapur të burgosurin Lukas që ia kishte vënë të dyja duart të burgosurit Fatlind në qafë.
- ✓ 4. I burgosuri Leon po shikonte televizor, ndërkohë që unë pyesja të burgosurin Getoard
- ✓ 5. Pashë të burgosurin Fatjon, i cili i ra tre herë lartë e poshtë oborrit.
- ✗ 6. Ishte e qartë se e ecura e të burgosurit Klajdi ishte e paqëndrueshme, ndoshta për shkak të alkoolit. [E paqartë: Duhet thënë se çfarë bëtë ju dhe çfarë po bënte Klajdi, hiqini opinionet.]
- ✗ 7. I burgosuri Fatjon nuk pranoi të bashkëpunonte. [E paqartë. Duhet thënë saktësisht se çfarë tha ose bëri Fatjoni.]
- ✗ 8. I burgosuri Fatjon “u orientua”, “u udhëzua” dhe “u urdhërua” të shtrihej përmbys në dysHEME. [E paqartë, nuk jep detaje për atë çka bënë policët që i përshkruajnë kështu, me këto fjalë]

ÇELËSI I PËRGJIGJEVE TË TESTIT PARAPRAK

Pjesa II Zgjedhja efikase e fjalëve

- ✗ 1. I burgosuri Albert më tha se kishte dalë nga qelia për punë në orën 7:45 atë mëngjes. [Albert *të tha* se kishte dalë për punë. Ruajeni fjalën “këshilloj” kur vërtet jepni këshilla]
- ✗ 2. Kur qelia e të burgosurit Rasim u kontrollua nga ky polic, u gjet një qese e vogël plastike me pluhur të bardhë. [Shmangeni formën pësore. Një fjali më e mirë do të ishte: “Unë gjeta një qese të vogël plastike me pluhur të bardhë kur kontrollova qelinë e të burgosurit Rasim.” (Është më mirë të përdorësh “unë” sesa “prej meje” në vend të shprehjes së vjetëruar “ky polic”)]
- ✗ 3. Konstatova se i burgosuri David kishte marrë orën e të burgosurit Lukas gjatë përleshjes. [“Konstatova” është zhargon i policisë që duhet shmangur. Një tjetër problem: Kjo fjali nuk shpjegon se nga e di ti se çfarë ka bërë i burgosuri David.]
- ✓ 4. E pyeta të burgosurin Albert nëse kishte nevojë për ndihmë mjekësore dhe ai tundi kokën lartë e poshtë.
- ✗ 5. I burgosuri Agon shau dhe mallkoi kur ka prangat. [“Të mallkosh” do të thotë t’u thërrasësh shpirtrave të këqij,; “të shash” do të thotë të bësh një betim. Ju duhet të shkruani saktësisht se çfarë ka thënë Agoni, fjalë për fjalë, dhe jo të përgjithësoni.]
- ✗ 6. Kontrollova zonën, kurse polici Bujar mori në pyetje të burgosurin Sotir. [“Kontrollova” është e paqartë: Për çfarë kërkuat dhe çfarë gjetët?]
- ✓ 7. Dritarja mbi lavaman ishte thyer dhe copat e xhamit kishin rënë në banakun e kuzhinës.
- ✗ 8. Kur kontaktova policin Sokol, ai tha se nuk kishte parë dhe nuk kishte dëgjuar asgjë të pazakontë. [“Kontaktova” është e paqartë: E more në telefon, e vizitove apo i dërgove një email Sokolit?]

MATERIALI 2

Rasti i të burgosurit George: Tre goditje dhe del jashtë⁹⁰

Ishte ora rreth 5:30 pasdite më 10 gusht 2011 dhe stafi i burgut ishte vonë me shpërndarjen e medikamenteve në Qendrën Korrektuese të Veriut. I burgosuri George ishte në pritje të medikamenteve të tij psikiatrike dhe po bëhej i padurueshëm. Ai shante dhe i bërtiste stafit që të bënin punën. Si përgjigje, e kishin hequr nga njësia e tij dhe më pas tre oficerë e kishin shoqëruar në dhomën e peshimit poshtë korridorit për “këshillim.”

Në dhomën e peshimit, George ecte lart e poshtë, sikur e godiste njeri me grushte dhe shtrihej në dysheme. Rreth orës 6:30 pasdite, kishte dalë nga dhoma për të marrë mjekimet, ishte kthyer dhe ishte shtrirë në një qoshe. Më pas, tre oficerë hynë në dhomë. Disa minuta më vonë, ra alarmi i emergjencave për një të burgosur që “nuk respektonte rregullat”. George bashkëpunoi për sa kohë ishte në pranga, pastaj njëri prej oficerëve e kapi nga krahu i majtë dhe që të gjithë dolën nga dhoma.

Sipas stafit të burgut, ndërkohë që ata po i afroheshin një dere rrëshqitëse rrugës për në zonën e izolimit, George u shkëput nga oficeri që e mbante. George-in e shtrinë në tokë dhe i vendosën hekura në këmbë. Më pas, stafi i njësisë mjekësore e vizitoi dhe e vuri nën vëzhgim. U regjistrua se ai kishte pasur shenja të kuqe në kyçet e dorës dhe të këmbës, dy gërvishtje në kurriz, si dhe një prerje në pjesën e brendshme të kyçit të djathtë të dorës.

Stafi e akuzoi George për shkelje të rregullave të institucionit. Më 16 gusht 2011, kur një asistent i zëvendës eprorit e shqyrtoi këtë akuzë, George u ankua se stafi kishte ushtruar forcë të tepruar ndaj tij gjatë incidentit.

Ndonëse George e pranoi se nuk e kishte respektuar stafin, ai mohoi të ishte sjellë në mënyrë agresive. Ai tha se rojet e kishin shtyrë drejt murit pa i provokuar, e kishin shtrirë në tokë dhe i kishin qëlluar në mënyrë të përsëritur me grushte.

George u ankua në zyrën tonë dhe ashtu sikurse ndodh zakonisht në këto raste, ne komunikuam me institucionin gjatë hetimit të brendshëm të rastit, i cili më vonë u referua në Njësinë e Sigurisë dhe Hetimit të Institucioneve Korrektuese.

Kjo Njësi konstatoi se oficerët e burgut e kishin nxjerrë George nga njësia e tij, e kishin lënë në dhomën e peshave për rreth 50 minuta dhe më pas e kishin zhvendosur në njësinë e izolimit, duke i bërë të gjitha këto pa autorizimin e drejtuesit. Njësia zbuloi gjithashtu se edhe pse nuk kishte pasur në fakt një situatë emergjence, ishte ngritur alarmi dhe incidenti nuk ishte regjistruar si duhet në regjistrin përkatës të institucionit.

Ajo çka është më e rëndësishme është që videoja e sigurisë nuk korrespondonte me raportet e depozituara nga stafi i burgut. Ajo tregon se George po vepronte siç po urdhërohej gjatë kohës që po shoqërohej jashtë dhomës së peshave dhe më pas një oficer i burgut e kishte shtyrë drejt murit pa arsye. Më pas, stafi e kishte rrëzuar George në dysheme në atë çka Njësia e përkroi “në një mënyrë të rrezikshme, të panevojshme dhe të tepruar, duke pasur parasysh se tashmë ishte vendosur

90 Rast i marrë nga Raporti i Avokatit të Popullit për Hetimin e reagimeve të Ministrisë së Shërbimeve dhe Komunitet dhe Shërbimeve Korrektuese për akuzat për përdorim të tepruar të forcës ndaj të burgosurve, Ontario, 2013, fq.40-43.

kontrolli”. Kur George ishte në dysheme, me pranga dhe i kufizuar, po ai oficer shihet se e ka goditur tre herë në fytyrë me grusht të mbyllur. Njësia vendosi se këto goditje ishin të pajustificuara dhe të tepruara. Ky oficer nuk e kishte raportuar këtë përdorim të forcës, por kishte folur për të vetëm kur ishte intervistuar nga Njësia.

Video tregoi gjithashtu se pas kontaktit fillestar, ndërkohë që George po shoqërohej në njësinë e izolimit, një tjetër oficer i burgut ia kishte shtyrë kokën në një ashensor pa arsye. Përveç kësaj, gjatë shoqërimit të tij në njësinë e izolimit, nën mbikqyrjen e një menaxheri operacional, stafi e kishte detyruar George të ecte mbrapa, të përkulej përpara në mes me kokën poshtë. Kjo metodë ishte përsëritur kur George ishte nxjerrë nga njësia e segregimit për në njësinë mjekësore për vizitë.

Njësia u konsultua me Koordinatorin e Sigurisë dhe Reagimeve ndaj Emergjencave, si dhe me trajnerë të tjerë, të cilët konfirmuan se kjo teknikë shoqërimi, ndonëse mesa duket përdoret shpesh në institucionin ku ndodhet George, ishte e paautorizuar dhe mund të shkaktonte ngritje të presionit të gjakut tek të burgosurit dhe vështirësi në frymëmarrje.

Përveç kësaj:

- Ishin bërë fotografi të dëmtimeve të George, por imazhet e mëvonshme nuk ishin marrë brenda 48 orësh, në kundërshtim me politikën e Ministrisë.
- Katër prej oficerëve të përfshirë nuk kishin raportuar deri të nesërmen e incidentit. Një pjesë e madhe e stafit që kishte qenë dëshmitar i përdorimit të forcës ndaj George nuk kishin dorëzuar asnjë raport siç kërkohet nga politika e Ministrisë.
- Raportet e depozituara përmbanin terma të paqartë për forcën e përdorur – për shembull, aty thuhej se George ishte “udhëzuar”, “orientuar” dhe “ndihmuar” për në dysheme. Sjellja e George karakterizohej si “agresive” dhe “jo në përputhje me rregullat”, por askush nuk kishte përshkruar me detaje se çfarë nënkuptonin këto etiketime.
- Veçanërisht, një prej anëtarëve të stafit kishte raportuar se George ishte goditur në fytyrë tre herë. Tre oficerë pranuan se e kishin parë këtë, por u desh që Njësia të bënte hetimin që ata ta pranonin.
- Asistenti i zëvendës eprorit nuk kishte raportuar ankesën e George menjëherë tek krye eprori.
- Ministria e kishte hequr nga puna oficerin që kishte goditur George. Policia e provincës përkatëse e kishte akuzuar gjithashtu atë për goditje në datën 29 shtator, 2011. Prej atëherë, ai është dënuar me 12 muaj shërbim prove dhe 60 orë shërbim në komunitet.

MATERIALI 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Institucioni Ekzekutimit Vendimeve.....

Nr. _____ Prot _____ më _____.

RAPPORT INCIDENTI

Për të dënuarin/paraburgosurin, Emri Mbiemri

(.....)

Referuar Ligjit Nr. 81 datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, dhe të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, neni 116, miratuar me VKM Nr.437, datë 20.05.2015, mbaj këtë raport për incidentin e poshtëshënuar;

Data dhe ora e incidentit Ora

Tipi i incidentit.....

Vendi i incidentit (Godina Kati Sektori Dhoma)

Raportuar prej: punonjësi i policisë (.....)

Vëzhgova;

[illegible]

I burgosuri është njoftuar për mbajtjen e raportit në datën.....

I burgosuri është në pritje,deri në marrjen e vendimit nga Komisioni Disiplinor në:

a) në dhomën e tij _____ b) në dhomën e veçimit _____ c) në infermieri, _____

d) në spitalin e burgjeve_____

Raportuesi: funksioni, emër, mbiemër, firma

Moduli 9: Përdorimi i forcës (5 orë, duke përfshirë edhe detyrat)

“Me njerëzillëk arrin më shumë sesa me forcë”

“Forca është e dobët, sepse i beson vetëm forcës”

Objektivat: Deri në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit:

- do të ndërgjegjësohen se **parandalimi** i përdorimit të forcës **është gjithmonë më i mirë se kurimi**;
- do të njohin dhe do të kuptojnë bazën ligjore (ndërkombëtare), si dhe aktet nënligjore për përdorimin e forcës;
- do të mësojnë parimet e nevojës, proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë për përdorimin e forcës;
- do të analizojnë kontekstin e një rasti të përdorimit të paligjshëm dhe të tepruar të forcës;
- do të kuptojnë rëndësinë e masave lidhur me shëndetin, si dhe raportimin e dokumentimin e tyre;
- do të mësojnë kategorizimin e situatave dhe vazhdimësinë e përdorimit të forcës;
- do të njohin çpërshkallëzimin dhe aftësi të tjera të rëndësishme ndërpersonale/komunikuese, përmes një detyre.

1. Hyrje (20 minuta)

Kontributi i trajnerit

Është e pamundur që në burgje të shmanget tensioni. Pavarësisht se sa i përkushtuar është stafi, nuk mund të mohohet se shumica e të burgosurve janë atje kundër vullnetit të tyre. Rrjedhimisht, burgjet janë vende me nivele të shtuara stresi, emocione negative sa i përket zemërimit, frustrimit, pamundësisë për të bërë diçka dhe kundërshtimit të burgosurve. Të burgosurit e zemëruar që hasin vështirësi “gjatë kryerjes së dënimit” mund të shfryhen duke kundërshtuar stafin dhe rregullat.

Literatura e mbështet nocionin se sa më shtrëngues të jetë mjedisi i burgut, aq më shumë hapësirë krijohet për dhunë. Kjo ndodh sidomos në ato raste kur të burgosurit kanë perceptimin se menaxhimi i burgut dhe trajtimi i të burgosurve është i padrejtë ose në kundërshtim me ligjin, gjë e cila forcon solidaritetin e të burgosurve për kundërshtimin e autoriteteve. Si rrjedhojë, kërcënon legjitimitetin e regjimit dhe redukton respektimin e rregullave nga ana e të burgosurve. Nga ana tjetër, raportohet se burgjet që ofrojnë më shumë mundësi për marrëdhënie konstruktive dhe pozitive mes stafit dhe të burgosurve, pjesëmarrjen e të burgosurve në programe edukimi dhe programe të aftësimit profesional, si dhe nxisin autoefiçencën, kanë më pak dhunë dhe shkelje rregullash.⁹¹

91 Reforma Penale Ndërkombëtare dhe Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT), 2013. Autor Andrea Huber; Reforma e burgjeve, tabela, instrumentet e kufizimit, faqja 2.

Përveç kësaj, mesazhi i parë që duhet të mësojnë punonjësit për përdorimin e forcës është që **parandalimi është gjithnjë më i mirë se kurimi**. Praktika e përditshme e të jetuarit dhe të punuarit në burg tregon se ndodh jashtëzakonisht rrallë që incidentet madhore të ndodhin pa asnjë lloj sinjalizimi paraprak. Në pothuajse të gjitha rastet, ka gjithmonë tregues paraprak të rritjes së tensionit në nivel individ ose grupi. Parandalimi i përshkallëzimit të këtyre situatave tensionuese nëpërmjet shkeljeve të rregullave dhe rregulloreve, nëpërmjet dhunës dhe përdorimit të forcës kërkon pajisjen me aftësi dhe teknika nga ana e stafit të burgjeve në fushën e çpërshkallëzimit, zgjidhjes paqësore të konflikteve, aftësi në metodat e bindjes, negocimit dhe ndërmjetësimit. Pikërisht këtu dalin në pah përfitimet e **sigurisë dinamike**.

Shënim i trajnerit

Trajneri pyet: çfarë është siguria dinamike?

Trajnerët marrin shënim përgjigjet në tabelë dhe më pas përmbledhin si vijon:

Siguria dinamike është një kombinim i marrëdhënieve pozitive midis stafit dhe të burgosurve me trajtimin pa dallim të burgosurve dhe aktivitetet kuptimplota (një burg i zënë me punë është burg i sigurt), si dhe i teknikave të ndërmjetësimit dhe çpërshkallëzimit. Përdorimi i sigurisë dinamike ka rezultuar më efikas në garantimin e rendit në burgje, pasi ndihmon në parashikimin e problemeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë.⁹²

Për teknikat e zgjidhjes së konflikteve dhe çpërshkallëzimit, trajneri i referohet MATERIALIT 4 dhe detyrave.

2. Aktet ligjore dhe nënligjore për përdorimin e forcës (30 minuta)

Shënim për trajnerin

Trajneri përmbledh informacionet për aktet ligjore dhe nënligjore për përdorimin e forcës.

Rregullat Evropiane të Burgjeve

Rregullat Evropiane të Burgjeve parashikojnë si vijon në lidhje me përdorimin e forcës:

64.1 Stafi i burgjeve nuk përdor forcë kundër të burgosurve me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje, ose në rast të tentativave për arratisje rezistencës aktive apo pasive ndaj një urdhri të ligjshëm dhe gjithmonë si mjet i fundit.

64.2 Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

65. Ka procedura të detajuara për përdorimin e forcës, duke përfshirë dispozita rreth:

- a. llojeve të ndryshme të forcës që mund të përdoret;
- b. rrethanat në të cilat përdoret secila lloj force;

92 IBID Tabela Reforma Penale Ndërkombëtare faqja 8.

- c. anëtarët e stafit që kanë të drejtë të përdorimin lloje të ndryshme force;
- d. niveli i pozitës që kërkohet para përdorimit të çdo lloj force; dhe
- e. raportet që duhet të plotësohen pas përdorimit të forcës.

66. Stafi që merret drejtpërdrejtë me të burgosurit trajnohet për teknikat që mundësojnë përdorimin minimal të forcës për të kthyer vetëkontrollin tek të burgosurit agresivë.

67.1 Stafi i agjencive të tjera të zbatimit të ligjit përfshihet në trajtimin e të burgosurve brenda burgjeve në raste të veçanta.

67.2 Duhet të ketë një marrëveshje zyrtare ndërmjet autoriteteve të burgut dhe ndonjë agjencie për zbatimin e ligjit, në përjashtim të rasteve kur marrëdhënia rregullohet nga legjislacioni vendas.

67.3 Një marrëveshje e tillë parashikon:

- a. kushtet në të cilat anëtarë të tjerë të agjencive të zbatimit të ligjit mund të hyjnë në burg për të trajtuar konflikte;
- b. masën e të drejtave që kanë agjencitë e zbatimit të ligjit gjatë kohës që ndodhen në burg dhe marrëdhënia e tyre me drejtorin e burgut;
- c. llojet e ndryshme të forcës që përdorin anëtarët e agjencive të tilla;
- d. rrethanat në të cilat përdoret secila lloj force;
- e. nivelin e nevojshëm të kompetencave përpara se të përdoret forca; dhe
- f. raportet që duhet të përgatiten pas përdorimit të forcës.

EPR - Komentar mbi versionin e rishikuar të Rregullave Evropiane të Burgjeve (2020)⁹³, ku theksohet se:

“Rregulli 64 përforcon parimin se stafi mund të përdorë forcë vetëm brenda kufijve të përcaktuar qartë dhe si reagim kundrejt kërcënimeve specifike ndaj sigurisë apo rendit.

Si rregull, parandalimi i incidenteve të dhunshme është gjithnjë më mirë sesa përballimi i tyre. Njoftimi i stafit që i njeh të burgosurit dhe është në gjendje të identifikojë elementët problematikë mund të parandalojë aktet e dhunshme.

Marrëdhëniet e mira profesionale mes stafit dhe të burgosurve përbëjnë një element thelbësor të sigurisë dinamike që përmendet në Rregullin 51.2 sa i përket çpërshkallëzimit të incidenteve potenciale ose rikuperimit të rendit përmes procesit të dialogut dhe negociimit. Vetëm në rast se këto metoda nuk funksionojnë ose kur konsiderohen të papërshtatshme, mund të mendohet përdorimi i metodave fizike ose rivendosja e rendit. Kur stafi i nevojitet të përdorë forcë ndaj të burgosurve, ajo duhet të jetë e kontrolluar dhe të jetë në minimumin e mundshëm për rivendosjen e rendit.

GjEDNj-ja ka pranuar se përdorimi i forcës mund të jetë i nevojshëm në disa raste për të garantuar sigurinë e burgjeve, si dhe për të ruajtur rendin apo për të parandaluar krimet në burgje. Megjithatë, kjo forcë mund të përdoret vetëm nëse është e domosdoshme dhe në asnjë rast nuk duhet të jetë e tepruar. Çdo mjet i forcës fizike i përdorur ndaj personave të privuar nga liria dhe që nuk ka qenë i domosdoshëm për shkak të sjelljes së tyre, cenon dinjitetin human dhe përbën shkelje të nenit 3 të KEDNj-së.

93 Faqja e internetit: www.coe.int/cm.

Përveç kësaj, çdo ankesë e diskutueshme për përdorimin e forcës duhet të hetohet me efikasitet (shih komentarin e mëtejshëm për Rregullin 55).

Ky rregull rendit çështjet kryesore që duhet të trajtohen sipas procedurave përkatëse për përdorimin e forcës (kur mund të përdoret, kush ka të drejtë ta përdorë, kush ka të drejtë të autorizojë përdorimin e forcës dhe mekanizmat raportues që duhet të respektohen pas përdorimit të çdo lloji force). Rregulli 82 i Rregullave të Nelson Mandelës thekson se stafi i burgjeve që përdor forcën duhet ta raportojë atë menjëherë tek drejtori i burgut.

Ky rregull e bën të qartë se stafi nuk duhet të mbështetet vetëm në demonstrimin e supeoritetit të forcës fizike për të kontrolluar të burgosurit problematikë. Ka një sërë teknikash kontrolli dhe kufizimi për të cilat stafi mund të trajnohet dhe t'i ndihmojë që të mbajnë nën kontroll të burgosurit pa shkaktuar dëme personale apo te të burgosurit. Strukturat drejtuese duhet të jenë të informuara rreth tyre dhe të marrin masa që të gjithë punonjësit të përfitojnë aftësitë bazë dhe një numër i mjaftueshëm punonjësish të trajnohen për teknika më të përparura.

Ky rregull ka të bëjë me ndërhyrjen e agjencive të zbatimit të ligjit në burgje. Në rrethana të veçanta, mund të ndodhë që niveli i dhunës së të burgosurve të jetë kaq i madh, sa që stafi të mos jetë në gjendje ta frenojë atë dhe mund të duhet të thërrasë një agjenci tjetër të zbatimit të ligjit, siç është policia. Një kurs i tillë veprimi duhet të trajtohet me shumë kujdes. Në trajtimin e dhunës, stafi i burgut duhet të jetë gjithnjë i vetëdijshëm se do i duhet të merret me të burgosurit pas zgjidhjes së incidentit dhe se duhet të rikthehen në normalitet. Kjo do të thotë se ata zakonisht duhet të përpiqen të shmangin përdorimin e forcës dhe se duhet të hezitojnë para se të përdorin forcë të tepruar apo pa dallim.

Kjo mund të mos jetë e vlefshme për zyrtarë të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit që nuk punojnë në burg dhe që mund të ndërhyjnë vetëm për zgjidhjen e incidenteve të dhunshme. Në mënyrë që të parandalohet përdorimi i tepruar i forcës, në këto rrethana, rekomandohet që autoritetet e burgjeve të bihen dakord për një protokoll të përhershëm me strukturat e larta drejtuese të çdo agjencie tjetër që mund të thirret për të ndihmuar në zgjidhjen e një incidenti të dhunshëm. I gjithë stafi që ka të ngjarë të përfshihet duhet të informohet për përmbajtjen e këtij protokollit para se të hyjë në burg.

Në ligjin nr. 81 datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, në nenin 70 thuhet:

“Përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurit nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin, ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm.....

Në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, punonjësi i institucionit, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të burgosurit, duhet menjëherë të vërë në dijeni me shkrim

drejtorin e institucionit nëpërmjet një raporti, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, në ç’masë dhe me cilat mjete është ushtruar forca, si dhe nëse ka shkaktuar ose jo lëndime fizike tek i burgosuri ose tek personeli i burgjeve...”

Neni 71: “Rregullat e hollësishme për llojet, mënyrat, natyrën, teknikat e përdorimit të forcës dhe të mjeteve të shtrëngimit, si dhe rregullat dhe masa e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të burgosurit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve”.

Në ligjin nr. 80, datë 25.06.2020, “Për policinë e burgjeve”, në nenin 13, përdorimi i forcës është parashikuar në këtë mënyrë:

Përdorimi i forcës:

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të përdorë forcë ndaj personave të dënuar dhe të paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, ose në rast të rezistencës aktive apo pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Në këto raste forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo degradues.

3. Përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera kufizuese gjatë ushtrimit të forcës kryhet në mënyrë të përshkallëzuar dhe në proporcion me situatën dhe nivelin e riskut me të cilin punonjësi i Policisë së Burgjeve përballet.

4. Personeli që merret drejtpërdrejt me të burgosurit trajnohet paraprakisht, para se të marrë detyrën, për teknikat që bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës, për të kthyer vetëkontrollin tek të burgosurit agresivë.

5. Përdorimi i forcës ndaj të miturve të dënuar dhe të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Zbatuesve të ligjit u është dhënë autorizim i ligjshëm për të përdorur forcën në mbrojtje të publikut dhe ligjeve të vendit. Megjithatë, ky autorizim kundërpeshohet nga detyrimi për mosshkeljen e të drejtave të njeriut. Politikat apo rregullat janë të thjeshta:

1. Punonjësi i burgut duhet të përdorë aq forcë sa është e nevojshme dhe e arsyeshme për të vënë me efikasitet gjendjen nën kontroll gjatë një incidenti.
2. Punonjësi i burgut duhet t'i përgjigjet dhunës me të njëjtën shkallë dhe aspak më tepër nga ç'është e nevojshme për të mbrojtur jetën e kolegëve apo të një të dënuari tjetër.

3. Përdorimi i forcës dhe mbështetja në parimin e nevojës, proporcionalitetit/ nivelin minimal të forcës, ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë (90 minuta)

Në instrumentet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, udhëzimet për përdorimin e forcës dhe për parandalimin e keqtrajtimit të të burgosurve bazohen në parimet e nevojës, proporcionalitetit/ nivelit minimal të forcës, ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë. Koncepti i përgjithshëm është mbrojtja dhe ruajtja e jetës së njeriut, pronës, lirisë dhe dinjitetit.

Shënim për trajnerin

Ushtrim - diskutim në klasë

*Trajneri e ndan klasën në **katër grupe**.*

- Grupet diskutojnë për kuptimin e parimeve të: domosdoshmërisë, proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë për përdorimin e forcës.

10 minuta

Trajneri mbledh përgjigjet e pjesëmarrësve, i shkruan në tabelë dhe pastaj shpjegon si vijon:

Kontributi i trajnerit

Përdorimi i forcës nga punonjësit e burgjeve është i justifikueshëm⁹⁴ dhe rrjedhimisht i ligjshëm vetëm:

- Nëse është i arsyeshëm në kushtet aktuale
- Nëse është i nevojshëm
- Nëse nuk përdoret më shumë forcë sesa është e nevojshme
- Nëse është proporcionale me seriozitetin e rrethanave
- Nëse trajtohet brenda legjislacionit kombëtar

A. E arsyeshme në kushtet aktuale

Interpretimi i “nivelit të arsyeshëm” është çështje e rëndësishme për përdorimin e forcës.

Çështja e arsyeshmërisë është një çështje që duhet vendosur sipas çdo rasti.

Kushtet janë unike dhe prandaj ato duhet të gjykohen sipas rëndësisë së tyre.

Faktorët që duhet të merren në konsideratë kur vendoset se çfarë është “e arsyeshme” në përdorimin e forcës janë: përmasat, mosha dhe gjinia e të burgosurit dhe anëtarit të stafit, si dhe nëse ka armë të pranishme.

B. Parimi i domosdoshmërisë

Veprimet e ndërmarra duhet të kenë qenë të nevojshme.

Përpara përdorimit të forcës, një anëtar i stafit duhet gjithnjë të përcaktojë nëse qëllimi i dëshiruar mund të arrihet edhe me mënyra të tjera. Nëse jo, merret masa e përdorimit të forcës.

⁹⁴ Ky informacion bazohet në miratimin e Urdhrit të Shërbimit të Burgjeve për Përdorimin e Forcës të Mbretërisë së Bashkuar, fq. 5 dhe 6

Dallimi i parë që duhet evidentuar është midis forcës së përdorur për “vetëmbrojtje” (mund të jetë më e lehtë për t’u demonstruar si “e nevojshme”) dhe forcës së përdorur si rezultat i mosbindjes ndaj një urdhri të ligjshëm. *Për përdorimin e nevojshëm të forcës nuk është e mjaftueshme vetëm që një të burgosuri t’i jepet një urdhër “i ligjshëm” për të bërë diçka dhe ai të mos pranojë ta bëjë atë.*

Është e rëndësishme të merret parasysh lloji i dëmit që anëtari i stafit po përpiket të parandalojë – kjo do të ndihmojë në përcaktimin nëse forca është e nevojshme në rrethanat e veçanta me të cilat stafi përballet. “Dëmi” mund të mbulojë të gjitha rreziqet e mëposhtme:

- Rrezikun për jetën
- Rreziku i gjymtimit
- Rrezikun ndaj pronës
- Rrezikun ndaj rendit të sistemit

Është qartësisht më e lehtë ta justifikosh forcën si “të nevojshme” në qoftë se ka një rrezik ndaj jetës apo gjymtimit.

Orientime për të vendosur nëse përdorimi i forcës është i nevojshëm

Vendimi nëse përdorimi i forcës është “i nevojshëm” me qëllim ruajtjen e rendit mund të jetë i ndërlikuar – anëtari i personelit duhet të marrë parasysh pasojat e mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme nga të burgosurit.

Shënim për trajnerin

Ushtrim me tre situata dhe pasoja

Trajneri pyet grupin se çfarë do të vendosnin ata në tre situatat në vijim në lidhje me përdorimin e forcës

Shembulli 1 - dhënie e një urdhri të ligjshëm një të burgosuri për të ndaluar kur shihet se po vrapon drejt vijës së perimetrit.

Shembulli 2 - dhënia e urdhrit të ligjshëm një të burgosuri që të ndalojë së ofenduari mësuesin.

Shembulli 3 - një i burgosur ka një send të mprehtë dhe kërcënon se do dëmtojë veten (p.sh. të presë damarët).

Më poshtë jepen tre shembuj. Pas diskutimit, trajneri përmbledh si vijon:

Shembulli 1 - dhënie e një urdhri të ligjshëm një të burgosuri për të ndaluar kur shihet se po vrapon drejt vijës së perimetrit. Nëse i burgosuri nuk respekton urdhrin, do të ishte e arsyeshme dhe e nevojshme të përdorej forca në këto rrethana me qëllim që i burgosuri të mos arratisë.

Shembulli 2 - dhënia e urdhrit të ligjshëm një të burgosuri që të ndalojë së ofenduari mësuesin. Udhëzimi parashikon një urdhër “të ligjshëm”, por nuk do të ishte e arsyeshme apo e nevojshme që pas këtij urdhri, të përdorej forca, nëse i burgosuri nuk reagon menjëherë për zbatimin e urdhrit. Megjithatë, refuzimi për të dalë nga klasa ose për të mos ofenduar mësuesin, mund të çojë në ndërhyrje të planifikuara për Kontroll & Kufizim (nëse të gjitha alternativat e tjera si bindja apo çpërkallëzimi janë provuar dhe kanë dështuar).

Shembulli 3 - një i burgosur ka një send të mprehtë dhe kërcënon se do dëmtojë veten (p.sh. të presë damarët). Situata të tilla duhet të zgjidhen rast pas rasti - personeli duhet të marrë parasysh historinë e individit dhe rrethanat aktuale. I burgosuri duhet të qetësohet dhe të bindet të dorëzojë sendin e rrezikshëm tek një anëtar i stafit kurdo që kjo është e mundur. Megjithatë, në qoftë se gjendja do të përkeqësohej (p.sh. deri në pikën ku i burgosuri do të përpiquej të dëmtonte veten) atëherë anëtari i personelit mund të gjykojë se ndërhyrja është e nevojshme (kjo mund të kërkojë ndihmën e një ekipi Kontrolli & Kufizimi për marrjen e sendit).

Jo më shumë forcë sesa është e nevojshme

Nuk duhet të përdoret më shumë forcë sesa është e nevojshme. Çdo forcë më e madhe se sa është e nevojshme mund të konsiderohet e paligjshme.

C. Parimi i proporcionalitetit / përdorimi minimal i forcës

Ky parim përcakton se sa herë që “përdorimi i forcës” është i nevojshëm, zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të përdorin aq forcë sa është e nevojshme për të ndaluar sjelljet e shfaqura. Proporcionale me rrethanat nënkupton që:

- Personeli duhet të demonstrojë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit. Veprimi i ndërmarrë nuk ka gjasa të konsiderohet proporcional kur ekzistojnë alternativa më pak të dëmshme dhe po aq efektive.

Aty ku është i nevojshëm përdorimi i forcës, duhet të përdoren vetëm teknikat e miratuara të kontrollit dhe kufizimit.

D. Parimi i ligjshmërisë

Përcakton se zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk duhet të veprojnë kurrë jashtë legjislacionit që rregullon punën e tyre. Prandaj, autoritetet kombëtare duhet të parashikojnë brenda legjislacionit kombëtar “përdorimin e forcës” për punonjësit e burgjeve. Personeli kombëtar i burgjeve nuk duhet të përdorë kurrë forcë jashtë kuadrit ligjor kombëtar dhe i gjithë përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me normat dhe standardet e të drejtave të njeriut. Përdorimi i tepruar i forcës është i paligjshëm, i neveritshëm dhe i pafalshëm. Nuk ka asnjë vend, në të cilën sulmet e paprovokuara fizike ndaj të burgosurve, përdorimi i panevojshëm i forcës si shuplaka, goditje apo grushte duhet toleruar.

E. Parimi i përgjegjshmërisë

Ky parim nënkupton se zyrtarët e zbatimit të ligjit në çdo kohë duhet të përmbushin detyrat e caktuara me ligj, duke i shërbyer komunitetit dhe duke mbrojtur të gjithë personat kundër akteve të paligjshme, në përputhje me shkallën e lartë të përgjegjësisë që kërkohet nga profesioni i tyre. Për të parandaluar përdorimin pa dallim dhe të panevojshëm të forcës, personelit i kërkohet t'i raportojnë eprorëve të tyre dhe drejtorit menjëherë pas çdo incidenti ku përfshihet përdorimi i forcës. Nëse përdoret forcë, incidenti duhet raportuar tek eprori dhe çdo përdorim abuziv “i forcës” duhet të jetë i dënueshëm sipas ligjit. Në të gjitha rrethanat ku është përdorur forcë, personat e përfshirë duhet të mbajnë përgjegjësi për vendimet dhe veprimet e tyre.

Shënim për trajnerin

Një raport që justifikon përdorimin e çdo lloj force duhet të plotësohet në të gjitha rastet dhe trajneri tregon NJË SHEMBULL TË NJË RAPORTI TË PËRDORIMIT TË FORCËS (SHIH SHTOJCËN 3)

Shënim për trajnerin

Ushtrim

Rasti i të burgosurit Daniel dhe përdorimi i forcës së tepruar (Nga raporti i Avokatit të Popullit të Ontarios, Kanada, 2013)

*Trajneri i kërkon grupit të lexojë **MATERIALIN 1** nga një raport i Avokatit të Popullit lidhur me rastin e një të burgosuri me emrin Daniel dhe të diskutojë:*

- *Nevojën dhe masën e forcës së përdorur në këtë rast*

4. Masat shëndetësore, raportimi dhe dokumenti i tyre (20 minuta)

Shënim për trajnerin

Diskutim

Trajneri pyet grupin: Pse masat për garantimin e raportimit dhe të ndihmës shëndetësore për të burgosurit pas përdorimit të forcës nga personeli i burgjeve janë pjesë e bazës ligjore?

Pas diskutimit dhe mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh në vijim:

Kontributi i trajnerit

Stafi i burgjeve do të duhet të përdorë ndonjëherë forcën për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe mund të duhet të përdorë veçanërisht mjetet e shtrëngimit fizik. Është e dukshme se këto situata janë të rrezikut të lartë, për sa kohë bëhet fjalë për keqtrajtime të mundshme të të burgosurve dhe si të tilla kërkojnë mbrojtje të posaçme ligjore:

- Sa herë që është përdorur forcë kundër një të burgosuri apo një i burgosur pretendon se është goditur nga stafi, ai apo ajo duhet të ekzaminohet nga personeli i kujdesit shëndetësor pavarësisht nëse ka apo jo shenja të dukshme të dëmtimit.
- I burgosuri ndaj të cilit është përdorur çfarëdolloj force, ka të drejtë të ekzaminohet menjëherë dhe nëse është e nevojshme, të trajtohet nga një mjek.
- Rezultatet e ekzaminimit (duke përfshirë çdo deklaratë të rëndësishme nga i burgosuri dhe përfundimet e mjekut) duhet të regjistrohen zyrtarisht dhe të vihen në dispozicion të të burgosurit.
- Personeli i kujdesit shëndetësor duhet të dokumentojë ekzaminimin rreth çdo dëmtimi në **kartelën e kujdesit shëndetësor të të burgosurve** dhe të plotësojë pjesën e duhur të raportit të **aksidentit dhe dëmtimit**, i cili duhet të iniciohet nga personeli i burgjeve. Gjithashtu, të burgosurit i kërkohet të plotësojë në këtë formular një deklaratë rreth lëndimeve që ka pësuar.
- Në qoftë se ka pretendime se një anëtar i stafit ka goditur një të burgosur, atij duhet t'i kërkohet të plotësojë **njoftimin e të drejtës për të proceduar/për të**

hequr dorë nga ngritja e **akuzave penale**. I burgosuri duhet të përcaktojë në këtë formular nëse ai apo ajo zgjedh që ankesa e tij apo e saj të trajtohet nëpërmjet një hetimi të brendshëm nga institucioni apo të ngrejë një akuzë penale nëpërmjet policisë.

- Drejtori i burgut ka gjithashtu përgjegjësinë të marrë masat që të burgosurit të fotografohen pas çdo përdorimi force, pavarësisht nëse kanë apo jo lëndime. Për të siguruar marrjen e fotografive, në rregullat e shërbimit të burgjeve përcaktohen kërkesat lidhur me kohën dhe llojin e fotografive që duhet të merren.
- Rastet e përdorimit të forcës shënohen edhe në regjistrat e shërbimit që mbahen në zona të ndryshme të institucionit.

5. Kategorizimi i situatave dhe modeli i vazhdimësisë së përdorimit të forcës (90 minuta)

Kontributi i trajnerit

Në fillim të këtij seksioni diskutuam se si rregulloret janë të thjeshta për t'u cituar. Megjithatë, praktika, pa pasur trajnim dhe njohuri, bëhet shumë e vështirë. I dënuari duhet t'u bindet komandave specifike të dhëna nga një punonjës i burgut. Në disa raste, i dënuari nuk u bindet komandave verbale, prandaj, në një formë apo në një tjetër, bëhet i nevojshëm ushtrimi i forcës fizike. Nëse forca e përdorur ishte e arsyeshme apo e tepruar, kjo gjykohet pas përfundimit të incidentit shpeshherë nga epërori, gjykatat apo mekanizmat për parandalimin e torturës.

Përdorimi i forcës mund të justifikohet si “i arsyeshëm” kur të analizohet pasi të ketë marrë fund dhe larg emocioneve të gjendjes aktuale. “Arsyeja”, kur përdoret si provë për të kuptuar nëse forca ishte e justifikuar apo jo, matet nga:

1. “Balancimi” i interesave të shtetit dhe efekteve fizike tek i dyshuari;
2. Izolimi dhe analizimi i veprimeve specifike të të dyshuarit dhe reagimet e punonjësve;
3. Njohja me të gjitha rrethanat, sa i përkasin përdorimit të forcës;
4. Njohja me seriozitetin e veprës në fjalë dhe të dhënat e mëparshme lidhur me të dënuarin;
5. Njohja me nivelin e drejtpërdrejtë të kërcënimit që paraqiste i dënuari;
6. Njohja me nivelin e rezistencës;
7. Urdhërimi i pasojave të mundshme për veprimet e të dyshuarit;
8. Shqyrtimi i alternativave që kishte në dispozicion punonjësi, ndaj përdorimit të forcës, bashkë me pasojat e mundshme të çdo alternative.

Të gjithë këta faktorë që shqyrtohen pas faktit, mund të paraqesin një kuadër plotësisht tjetër nga ai që ka menduar punonjësi në kohën kur ndodhi. Është pothuajse e pamundur të bëhet një analizë e tillë në vend, në një moment kur je i frikësuar, nën ankth dhe i detyruar të reagoosh me shpejtësi dhe pa i ditur të gjitha faktet.

Kjo është arsyeja pse kemi hartuar, si më poshtë, një kategori situatash që e ndihmojnë stafin për t'i analizuar situatat shpejt dhe lehtë. Ky kategorizim përfshin modelin e **vazhdimësisë së përdorimit të forcës** që është një model që i ndihmon zyrtarët e zbatimit të ligjit të mendojnë opsione të arsyeshme të forcës dhe shkallën e forcës që do të konsiderohet si reagim ndaj sjelljes aktuale të burgosurve. Çdo nivel i vazhdimësisë është relativ ndaj një niveli korrespondues të sjelljes apo rezistencës në burg. Personeli i burgut mund të konstatojë se një i burgosur rezistent i përgjigjet siç duhet opsionit të një force më të vogël dhe se gjendja mund të zgjidhet me më pak forcë se ç'pritej fillimisht. Ndonëse progresioni specifik i forcës ndryshon në mënyrë të konsiderueshme bazuar në sjelljen e të burgosurve dhe në burimet në dispozicion, normalisht progresioni i përdorimit të forcës është siç vijon:

1. *Prania e personelit*
2. *Verbalizimi*
3. *Kontrolli pa pajisje (pa përdorur pajisje force, masa kontrolli pa armë).* Policët e burgut kontrollojnë të burgosurin fizikisht. Ata mund të përdorin shirita, mbajtëse dhe kyçe për ta ndaluar ose për ta kontrolluar një të burgosur.
4. *Forcë vdekjeprurëse* - Policët e burgut përdorin mjete jo vdekjeprurëse (masa kontrolli me armë) për të ndaluar sjelljen e të burgosurve dhe për të marrë kontrollin e të burgosurve.
5. *Forca vdekjeprurëse* – Shërbimet e burgjeve që janë të armatosura dhe zyrtarët e burgut që janë trajnuar për përdorimin e armëve të zjarrit mund të marrin në konsideratë përdorimin e forcës vdekjeprurëse (armët e zjarrit) për të ndaluar sjelljen e të burgosurit, në mënyrë që të mbrojnë jetën. (shikoni **Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe të Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit në Shtojcë.**)⁹⁵

1. I dënuari bashkëpunon (shoqërohet me video)

a. Duket se është i gatshëm të ndjekë udhëzimet e punonjësve.

i. Prania e punonjësit me uniformë– si simbol i autoritetit ligjor përmes sjelljes, gjendjes së dukshme fizike dhe trajnimit (gjithashtu, prania e disa punonjësve rrit efektin parandalues). Nuk përdoret asnjë forcë specifike. Kjo konsiderohet demonstrim force. Është mënyra e dëshiruar për të zgjidhur një situatë. Prania e policëve të burgut ose e pengon, ose e lehtëson situatën. Qëndrimet e personelit duhet të jenë profesionale dhe jo kërcënuese

b. Bashkëpunues, por i duhen dhënë drejtime sipas udhëzimeve.

i. Prania e punonjësit me uniformë.

ii. **Udhëzime verbale ose verbalizimi** – nga shprehja miqësore “ju lutem” te “Ndal ose do të qëlltoj!”. Forca nuk është fizike. Oficerët e burgut lëshojnë komanda të qeta, jo kërcënuese, të tilla si “Ku po shkon?” ose “Çfarë po ndodh këtu?”. Oficerët e burgjeve mund të përdorin komanda të shkurtra (“Ndal” ose “Mos lëviz”) për të pasur mundësinë e paralajmërimit, kurse

⁹⁵ Disa teknika të menaxhimit të të burgosurve apo teknika të frenimit të tyre janë të rrezikshme dhe nuk lejohen, si aplikimi i kufizimeve rreth kokës apo qafës së të burgosurit, (lidhja e duarve dhe nyjeve të këmbës së bashku, ose aplikimi i “mbytyjes”. Oficerët e burgut kanë nevojë gjithashtu për udhëzime rreth disa qëndrimeve që janë të rrezikshme, të tilla si mbajtja e një të burgosuri në një pozicion të detyruar dhe ushtrimi i presionit në supe, shpinë apo në pjesën e poshtme të kurrizit. Shih kornizën ligjore ndërkombëtare ose kombëtare dhe standardet e KPT-së, si dhe rastin e fundit në SHBA të George Floyd)

përmes urdhrave të drejtpërdrejtë mund të bëjnë që të burgosurit t'u binden ("bëj diçka ose do të përdoren opsionet e forcës").

Shpesh, një punonjës i trajnuar për mënyrën si duhet të flasë, edhe pasi i është dashur të përdorë forcën fizike, mund ta bëjë një të burgosur t'i japë fund rezistencës duke e thirrur personin në emër ose duke dhënë udhëzime, teksa përdor armët apo manipulimet fizike.

- (1) bindje
- (2) këshillim
- (3) paralajmërim

2. I dënuari reziston

a. I dënuari nuk kontrollohet me udhëzime verbale. Ai reziston duke mos lëvizur.

i. Prania e punonjësit

ii. Udhëzimet verbale

- (1) bindje
- (2) këshillim
- (3) paralajmërim

iii. Masa kontrolli pa armë (pa përdorur pajisje force)

- (1) Oficerët e burgut kontrollojnë fizikisht të burgosurin. Ata mund të përdorin kapëse, mbajtëse dhe kyçe për ta ndaluar ose për ta kontrolluar një të burgosur.
- (2) Dhimbja bind /pikat e shtypjes -- shtypje te receptorët e dhimbjes (si për shembull, te kyçet e duarve apo zonat e tjera të ndjeshme të trupit – ky trajnim do të bëhet në seancat e tjera). Kjo lloj shtypjeje bën që i dënuari të ndjekë udhëzimet në këmbim të uljes së shtypjes që lejon punonjësi me uniformë.

iv. Masa kontrolli me armë

1. Instrumentet e kontrollit janë mjete të konceptuara për të ushtruar presion, pa ndikuar te ndjesorët e dhembjes. Këto instrumente janë konceptuar për të maksimalizuar dhembjen, por, kur përdoren në mënyrë të rreptë si instrumente kontrolli, ato shkaktojnë pak dëmtim indesh. Përdorimi i instrumenteve të kontrollit thjesht për të mbledhur informacion nuk konsiderohet etike, por si një formë torture. Përdorimi i tyre për të shmangur përdorimin e një forme më shkatërrimtare të kontrollit, si për shembull goditjet, është etike. Dhimbja duhet të ndalojë në çastin që i dyshuari pushon së rezistuari.

2. Mjetet me goditje elektrike. Këto nuk janë as shumë të besueshme dhe as efektive, por mund të shkaktojnë dhembje apo djegie të vogla.

3. I dënuari reziston aktivisht në mbrojtje

i. Prania e punonjësit me uniformë

ii. Udhëzimet verbale

- (1) bindje
- (2) këshillim
- (3) paralajmërim

iii. Masa kontrolli pa armë

- (1) Dhembja bind/pikat e shtypjes
- (2) Trullosja –Disa nga format e trullosjes janë pengim në frymëmarrje, në kapacitetin muskolor apo në aftësinë për t'u përqendruar. Shembuj të goditjeve trullosëse janë: goditja në thembër në kokë, në brinjën e fundit të kafazit të krahavorit, apo në pleksusin solar. Përdorimi i trullosjes i jep mundësi punonjësit të kryejë teknikat e neutralizimit, vendosjen e prangave apo mjeteve të tjera kufizuese. Presioni në pika të impaktit kufizohet qëllimisht gjatë teknikave trullosëse, në mënyrë që forca të përhapet në një sipërfaqe më të gjerë të trupit të të dënuarit. Ulja e presionit e një force të dhënë ndryshon cilësinë e efektit nga efekt shpues dhe thyes në shok të absorbuar të lehtë.

iv. Masa kontrolli me armë

- (1) instrumentet e kontrollit
- (2) mjetet me goditje elektrike
- (3) agjentët kimikë – Agjentët kimikë, siç janë gazi lotsjellës apo gazi me piper, zakonisht nuk janë vdekjeprurës. Atyre u duhet kohë për të dhënë efekt. Prandaj, zakonisht janë më me vlerë kur përdoren mbi subjekte që rezistojnë, por që në të vërtetë nuk janë duke sulmuar nga afër në çastin kur përdoret agjenti kimik.

4. I dënuari është agresor

a. I dënuari kundërsulmon me agresivitet, por nuk ka armë

i. Prania e punonjësit me uniformë

ii. Udhëzimet verbale

- (1) bindje
- (2) këshillim
- (3) paralajmërim

iii. Masa kontrolli pa armë (pa përdorur pajisje force)

- (1) dhimbja bind/pikat e presioni
- (2) goditje trullosëse
- (3) teknikat e drejtpërdrejta mekanike - Këto merren drejtpërdrejtë me strukturën mbështetëse skeletore apo mekanike dhe përdorimin e presionit mekanik të impaktit apo mbështetjen e drejtpërdrejtë tek ai. Për këtë qëllim përdoret ose presioni i impaktit, ose presionet e kundërta frenuese. Çdonjëri nga këto presione mund të shkaktojë fraktura në kocka apo dëme tek indet lidhëse, muskujt apo organet. Përgjithësisht, teknikat mekanike krijojnë më shumë mundësi për të kontrolluar fizikisht subjektin, por, nga ana tjetër, ato përbëjnë edhe rrezik të lartë për dëmtimin e tij/e saj.

Në teknikat e kësaj kategorie hyjnë:

- a. Presioni i përqendruar me impakt, siç janë goditjet dhe shkelmimet penetruese të karatesë.
- b. Bllokimi frenues i kyçeve dhe teknikat e thyerjes, siç janë bllokimet e kyçeve dhe të krahëve.
- c. Kapja nga fyti dhe mjete kufizuese për qafën, siç janë kontrolli vaskular apo shtrëngim fyti.

iv. Masa kontrolli me armë

(1) instrumentet e kontrollit

(2) mjete me goditje elektrike

(3) agjentë kimikë

(4) armët e impaktit. – Shembuj të armëve me impakt janë shkop gome i drejtë dhe shkop gome me dorezë anësore, që mund të përdoren me intensitet të ndryshëm.

6. Forca vdekjeprurëse (armët e zjarrit)

Konkluzion

Rrethanat në të cilat mund të përdoret çdo lloj force duhen specifikuar qartë. Përveç kësaj, sa herë që përdorimi i forcës mund të shkaktojë dhembje të konsiderueshme apo të rezultojë në dëmtime serioze, duhet të jepen dhe të regjistrohen paralajmërime paraprake. Është gjithashtu thelbësore që detyrimet për raportim të mos çojnë thjesht në një formalitet, por në mbikqyrjen nga afër të përdorimit të “mjeteve të posaçme” nga autoritetet kompetente. Më dhënien e lejes për përdorimin e forcës, vendimi për të qëlluar merret nga zyrtari individual i zbatimit të ligjit dhe duhet të justifikohet në secilin rast. ***Disa teknika të menaxhimit të të burgosurve apo teknika të frenimit të tyre janë të rrezikshme dhe nuk lejohen, si aplikimi i kufizimeve rreth kokës apo qafës së të burgosurit, (lidhja e duarve dhe nyjeve të këmbës së bashku, ose aplikimi i “mbytjes”.*** Duhet të ndalohen shtrëngimet e qafës dhe teknikat që mund të pengojnë rrugët e frymëmarrjes së individëve ose të shkaktojnë dhimbje.

Në rastet ku ndeshet rezistencë, personeli shoqërues zakonisht e bllokun të burgosurin në tokë, me fytyrë poshtë, me qëllim që t'i vendosë prangat. Mbajtja e një të burgosuri në një pozicion të tillë, sidomos nëse stafi i peshon në pjesë të ndryshme të trupit (presion mbi kafazin e krahavorit, në gjunjë, në shpinë, çmobilizimi i qafës) kur personi në fjalë përpiket të kundërshtojë, përbën rrezik asfiksioni pozicional.

Prandaj: Punonjësit e burgut kanë nevojë edhe për udhëzime rreth disa qëndrimeve që janë të rrezikshme, të tilla si mbajtja e një të burgosuri në një pozicion të detyruar dhe ushtrimi i presionit në supe, shpinë apo në pjesën e poshtme të kurrizit.

Nëse nuk ka mënyra të tjera përveç përdorimit të shkopinjve të gomës apo armëve të tjera më me pak ndikim për të adresuar kërcënimet e drejtpërdrejta ndaj jetës apo ndaj gjymtyrëve, **duhet të shmangen goditjet në kokë, qafë, fytyrë, veshka, klavikul, organet gjenitale dhe në zona të tjera të ndjeshme.** Në momentin që personi vihet

nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për t'i qëlluar. Çdo i dënuar, ndaj të cilit është përdorur shkopi i gomës apo ndonjë “mjet tjetër i posaçëm” (si p.sh. armë me plumba gome) duhet të kontrollohet menjëherë nga një profesionist i kujdesit shëndetësor dhe nëse është e nevojshme, të dërgohet në spital.

KPT-ja e ka bërë të qartë se përdorimi i forcës dhe / ose mjeteve të shtrëngimit që shkaktojnë asfiksi pozicionale duhet të shmangen kur është e mundur dhe se çdo përdorim i tillë në rrethana të jashtëzakonshme duhet të jetë subjekt i udhëzimeve të hartuara për të ulur në minimum rreziqet ndaj shëndetit të personit në fjalë.

Përveç shmangies së rreziqeve të asfiksive pozicionale të përmendura më lart, KPT-ja ka rekomanduar sistematikisht ndalimin absolut të përdorimit të mjeteve që mund të pengojnë pjesërisht ose tërësisht rrugët e frymëmarrjes (hundë dhe / ose gojë).

Si përfundim, zbatuesit e ligjit, teksa shqyrtojnë nëse do të përdoret forcë, duhet të mbajnë parasysh se qëllimi parësor i zbatimit të ligjit është mbrojtja e jetës dhe e pronës. Jetën dhe pronën e të gjithëve, qytetarëve dhe personave të privuar nga liria, njësoj. Teksa pranojnë punën e zbatuesit të ligjit, punonjësit betohen se do të përmbushin pikërisht këtë detyrë. Me fjalë të tjera, të gjitha detyrat e tjera janë dytësore. Përdorimi i forcës, përveçse në rastet e vetëmbrojtjes apo të mbrojtjes së një qytetari nga plagosja, është shkelje e betimit ose përkushtimit ndaj detyrës që ka ndërmarrë punonjësi me uniformë. Në momentin që personi i privuar nga liria është vënë në kontroll, përdorimi i forcës duhet të ndalojë. Përdorimi i forcës përdoret si mjeti i fundit dhe në proporcion me situatën e krijuar.

Shënim për trajnerin

Kuiz

Trajneri pyet:

- 1. Çfarë dini për sigurinë dinamike?*
- 2. Cilat janë katër parimet që orientojnë përdorimin e forcës?*
- 3. Përshkruani pesë teknikat e përgjithshme që mund të përdoren për të kontrolluar një të burgosur apo një të dyshuar dhe renditini ato sipas preferencës (domethënë, që nga i burgosuri/i dyshuari jo aq i rrezikshëm deri tek ai më i rrezikshmi)*

Dhënia e detyrave të shtëpisë

Trajneri prezanton:

- **MATERIALI 2** RREGULLAT DHE PARIMET
- **MATERIALI 3** FORMULARI PËR PËRDORIMIN E FORCËS (RAPORTIMI)
- **MATERIALI 4** STRATEGJITË EFIKASE TË KOMUNIKIMIT: AFTËSITË E ÇPËRSHKALLËZIMIT DHE KOMUNIKIMIT NDËRPERSONAL dhe
- **MATERIALI 5** (KUSHTET MJEKËSORE DHE PASOJAT NEGATIVE TË PËRDORIMIT TË MJETEVE KUFIZUESE/SHTRËNGUESE

Shënim për trajnerin

Trajneri u kërkon pjesëmarrësve t'i lexojnë këto materiale dhe t'u përgjigjen këtyre pyetjeve:

1. Në bazë të politikave/rregulloreve për zbatimin e ligjit, në cilat raste mund të përdoret forca që kërcënon jetën?
2. Cila është politika/rregulli që rekomandohet të ndiqet nga zyrtarët e zbatimit të ligjit për gjuajtjen me armë në ajër si formë paralajmërimi?
3. Çfarë rekomandohet nga Rregullat Evropiane të Burgjeve për përdorimin e armëve nga stafi që ka kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit?
4. Gjatë përballjes me të burgosur agresivë, çfarë aspektesh duhet të marrë në konsideratë stafi për të vlerësuar rrezikun e dhunës?
5. Cilat janë strategjitë e shpërndarjes dhe teknikat e çpërshkallëzimit?
6. Cilat janë pasojat e mundshme negative në lidhje me përdorimin e mjeteve/mënyrave izoluese/bllokuese?

PËRGJIGJET E KUIZIT dhe pyetjet e detyrës së shtëpisë:

1. **Qasja e sigurisë dinamike** Siguria dinamike është një kombinim i marrëdhënieve pozitive midis stafit dhe të burgosurve me trajtimin pa dallim të burgosurve dhe aktivitetet kuptimplota (një burg i zënë me punë është burg i sigurt), si dhe i teknikave të ndërmjetësimit dhe çpërshkallëzimit. Përdorimi i sigurisë dinamike ka rezultuar më efikas në garantimin e rendit në burgje, pasi ndihmon në parashikimin e problemeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë⁹⁶.
2. **Parimet:** domosdoshmëria, proporcionaliteti, ligjshmëria dhe përgjegjshmëria në përdorimin e forcës.
3. **Teknikat e kontrollit sipas preferencës janë:**
 - a. Prania e oficerit
 - b. Komandat verbale
 - c. Masat e kontrollit pa armë
 - d. Masat e kontrollit me armë
 - e. Forca vdekjeprurëse

PËRGJIGJET PËR DETYRËN E SHTEPISË:

Lista e forcës kërcënuese mund të përdoret VETËM:

- a. Si një zgjidhje e fundit në çdo situatë ku forca është e justifikuar
- b. Për parandalimin e arratisjes vetëm nëse i burgosuri që arratiset përbën rrezik të konsiderueshëm
- c. Për shkatërrimin e një kafshe që përbën kërcënim apo si një akt humanitar

2. Gjuajtjet paralajmëruese NUK lejohen

3. Punonjësit nuk duhet të jenë të armatosur

Mbyllje

96 IBID Tabela fq. 8.

Shtojcë

MATERIALI 1

I BURGOSURI DANIEL

I burgosuri me emrin Daniel ka pasur vështirësi me stafin e burgut më 23 tetor 2010. Ai ishte një prej të burgosurve që ishte zhvendosur si pjesë e një transferimi masiv atë ditë. Stafi i burgut përgjegjës për transferimin e Danielit ka thënë se ai nuk i kishte ndjekur udhëzimet pasi ishte vendosur në një qeli izolimi dhe ishte urdhëruar të shtrihej me fytyrën përmbys derisa rojet të dilnin nga qelia. Ata thanë se Danieli kishte tentuar të çohet ndërkohë që oficerët ishin ende në qeli dhe se ata e kishin detyruar që t'i bindej urdhrit dhe kishin dalë të sigurt. Danieli u akuzua për shkelje të rregullave të institucionit përmes mosbindjes me dëshirë ndaj një urdhri të ligjshëm të një oficeri në lidhje me sjelljen e tij atë ditë. Ai më pas u dënua me 20 ditë izolim dhe humbje të të gjitha privilegjeve.

Danieli e tregon krejtësisht ndryshe atë çka ndodhi. Shumë shpejt pas incidentit, ai u ankua te një drejtues se gjatë kohës që i kishin vënë prangat dhe e kishin shtrirë me fytyrë përmbys në dyshe, e kishin qëlluar me shqelma në kokë dhe me grushta disa herë. Ai thotë se nuk është e vërtetë që nuk u është përmbajtur udhëzimeve. Si reagim ndaj kësaj ankese, Danielit i kanë bërë disa fotografi, është vlerësuar nga një infermiere dhe është kontaktuar policia. Infermierja ka shënuar në regjistër se Danieli ka pasur një lëndim pas veshit të djathtë. Për më shumë se një vit nuk u ndërmor asnjë veprim. Ky rast iu referua njësisë së sigurisë dhe hetimit të institucionit si pjesë e analizës së ministrisë në lidhje me hetimin nga Avokati i Popullit. Pas këtij hetimi, kjo njësi theksoi se drejtuesi operacional i përfshirë në këtë rast dhe dy oficerët korrektues nuk kishin dhënë asnjë hollësi për dëmtimet e Danielit në raportet e shërbimit dhe as nuk kishin dhënë ndonjë informacion gjatë intervistave që mund të lidheshin me këto dëmtime. Ata të gjithë e kishin mohuar që ta kishin qëlluar Danielin.

Njësia vuri re se ndonëse përshkrimi i stafit për atë se çfarë kishte ndodhur në fillim të transferimit ishte mjaft i hollësishëm, “kur erdhi puna te shoqërimi për në qelinë e izolimit, ky përshkrim përfundoi në gjëra të përgjithshme”. Duke qenë se stafi nuk kishte arritur të përshkruante se pse kishte qenë i nevojshëm përdorimi i forcës, të përshkruante teknikat që kishin përdorur apo të jepte detaje për dëmtimet e Danielit, njësia doli në përfundimin se përdorimi i forcës kishte qenë i tepruar.

“Ka një kuptim të caktuar fakti që koha së cilës i referohej [Danieli] në pretendimet e tij ...është identike me fragmentet e kohës që edhe tre anëtarët e stafit nuk i kishin përshkruar me hollësi sa u përket teknikave që kishin përdorur apo sa u përket dëmtimeve të marra prej tij. Stafi nuk arriti të japë asnjë shpjegim bindës për dëmtimet që kishte pësuar [Danieli] në kokë, pas veshëve”.

Njësia shprehu gjithashtu shqetësimin për raportimet e vonuara dhe të pasakta, si dhe për mosadresimin nga ana e qendrës së ankesës së Danielit dhe për penalitetin e rëndë që mori Danieli për mosbindje të qëllimshme ndaj urdhrave.

Që të gjithë anëtarëve të stafit të burgut të përfshirë në këtë incident iu dërguan vërejtje disiplinore nga Këshilli.

MATERIALI 2

Rregullat dhe parimet përkatëse

Shtojcë për disa dokumente ndërkombëtarë për përdorimin e forcës

Përvec Rregullave Evropiane të Burgjeve, paraqitet një listë citimesh të standardeve ndërkombëtare.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, viti 1948.

Neni 5 Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor, poshtërues apo ndëshkimit.

Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike”

Neni 7 Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor, poshtërues apo ndëshkimit. E, sidomos, askush nuk duhet t'u nënshtrohet eksperimenteve mjekësore apo shkencore, pa miratimin e tij të shprehur.

Rregullat minimale standarde për trajtimin e të burgosurve

54. (1) Oficerët e institucioneve, gjatë marrëdhënies me të burgosurit nuk duhet ta përdorin forcën përveçse për vetëmbrojtje ose në rastet e tentativave për arratisje apo rezistencës fizike, aktive apo pasive, ndaj një urdhri, në bazë të ligjit apo rregulloreve. Oficerët të cilët mund t'i kthehen forcës, nuk duhet të përdorin më shumë nga ç'është tejet e nevojshme dhe këtë incident duhet ta raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit.

(2) Oficerët e burgjeve duhet të ndjekin trajnime të veçanta fizike në mënyrë që të mund të kufizojnë të burgosurit agresivë.

(3) Përveç rasteve të veçanta, personeli që kryen detyra, të cilat i çojnë në kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit, nuk duhet të jetë i armatosur. Për më tepër, personeli nuk duhet të pajiset me armë nën asnjë rrethanë, përveç atyre që janë trajnuar në përdorimin e tyre.

Kodi i sjelljes për zbatuesit e ligjit

Neni 3 Zbatuesit e ligjit mund ta përdorin forcën vetëm atëherë kur është tejet e nevojshme dhe në shkallën e kërkuar për përmbushjen e detyrës së tyre.

Neni 5 Asnjë zbatues ligji nuk mund të shkaktojë, të nxitë apo të tolerojë ndonjë akt torture apo trajtim mizor, çnjerëzor, poshtërues apo ndëshkim dhe asnjë zbatues tjetër ligji nuk mund të nxjerrë /citojë apo t'u referohet urdhrave të lëshuar nga instancat e larta apo rrethana të veçanta, si gjendje lufte apo kërcënimi i luftës, kërcënim ndaj sigurisë kombëtare, destabilitet i brendshëm politik apo ndonjë emergjencë tjetër publike, si justifikim të torturës apo trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore, poshtëruese apo ndëshkimit.

Tërësia e parimeve në mbrojtje të gjithë personave që ndodhen nën ndonjë formë arresti apo burgimi:

Parimi 6

Asnjë person që gjendet nën ndonjë formë arresti apo burgimi nuk duhet t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues. Asnjë rrethanë nuk mund të përdoret si justifikim për torturën apo trajtimin a ndëshkimin mizor, çnjerëzor apo poshtërues.

Parimi 21

1. Ndalohet shfrytëzimi i paligjshëm i gjendjes së një të paraburgosuri apo të burgosuri me qëllim që të detyrohet të rrëfejë apo të inkriminojë veten ose të dëshmojë kundër dikujt tjetër.

2. Gjatë marrjes në pyetje, asnjë i paraburgosur nuk duhet t'i nënshtrohet dhunës, kërcënimeve apo metodave të marrjes në pyetje që dëmtojnë kapacitetin e tij për të vendosur apo për të gjykuar.

Parimi 33

1. Të paraburgosurit apo të burgosurit, ose avokatit të tij duhet t'i jepet e drejta të paraqesë një kërkesë apo të ankimohet në lidhje me trajtimin e tij, veçanërisht në rast torture apo ndonjë trajtimi mizor, çnjerëzor apo poshtërues, pranë autoriteteve përgjegjëse për administrimin e vendit të paraburgimit dhe pranë autoriteteve më të larta dhe, kur është e nevojshme, pranë autoriteteve kompetente që kanë pushtetin për të shqyrtuar apo për të rivendosur të drejtat e shkelura apo të mohuara.

Parimet bazë për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit nga zbatuesit e ligjit

Dispozita të përgjithshme

1. Qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të miratojnë dhe të zbatojnë rregullat dhe rregulloret për përdorimin e forcës dhe armët e zjarrit nga zbatuesit e ligjit kundër të tjerëve. Në hartimin e këtyre rregullave dhe rregulloreve, qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të shqyrtojnë vazhdimisht çështjet etike që lidhen me përdorimin e forcës dhe armët e zjarrit.

2. Qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të krijojnë një gamë sa më të gjerë mjetesh dhe t'i pajisin zbatuesit e ligjit me sa më shumë armë e municione të ndryshme, gjë që do të lejonte një përdorim të diferencuar të forcës dhe të armëve të zjarrit. Këtu duhet të përfshihet krijimi i armëve jovědekjeprurëse paaftësuese për t'u përdorur në situatë të përshtatshme. Kjo duhet bërë duke pasur si qëllim kufizimin përherë e më të madh të mjeteve që mund të shkaktojnë vdekje apo plagosjen e personit. Për të njëjtin qëllim, zbatuesit e ligjit duhet të kenë mundësinë të pajisen me mjete vetëmbrojtëse, siç janë mburojat, helmetat, jelekët antiplumb dhe mjetet e blinduara të transportit, për të ulur kështu nevojën e përdorimit të çfarëdolloj arme.

3. Ndërtimi dhe përdorimi i armëve jovědekjeprurëse paaftësuese duhet të vlerësohet me kujdes për të minimizuar rrezikun për personat e jashtëm dhe për të kontrolluar me kujdes përdorimin e armëve të tilla.

4. Në përmbushjen e detyrës së tyre, zbatuesit e ligjit, përpara se t'i kthehen përdorimit të forcës dhe armëve të zjarrit, duhet të përdorin deri sa të jetë e mundur mjete të padhunshme. Ata mund të përdorin forcën dhe armët e zjarrit vetëm në rast se mjetet e tjera mbeten joefektive ose nëse nuk ka shpresa se ato do të sjellin arritjen e rezultateve të kërkuara.

5. Sa herë që përdorimi i ligjshëm i forcës dhe i armëve të zjarrit është i pashmangshëm, atëherë zbatuesit e ligjit duhet:

(a) të ushtrojnë vetëpërmbajtje në përdorimin e tyre dhe të veprojnë në raport me seriozitetin e veprës penale dhe realizimin e objektivit të ligjshëm;

- (b) të minimizojnë dëmet dhe plagosjen dhe të respektojnë e të ruajnë jetën e njeriut;
- (c) të sigurojnë që të gjithë personat e prekur apo të plagosur të marrin ndihmë mjekësore sa më shpejt që të jetë e mundur;
- (d) të sigurojnë që të afërmit apo miqtë e ngushtë të personave të plagosur apo të prekur të njoftohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

6. Në rastet kur përdorimi i forcës apo armëve të zjarrit nga zbatuesit e ligjit ka shkaktuar plagosje apo vdekje, ata duhet ta raportojnë këtë incident menjëherë tek eprorët e tyre, sipas parimit 22.

Dispozita të posaçme

9. Zbatuesit e ligjit nuk duhet të përdorin armë zjarri kundër askujt, përveçse në rast vetëmbrojtjeje apo në mbrojtje të tjerëve kundër një kërcënimi të pashmangshëm me vdekje apo plagosje të rëndë, për parandalimin e një krimi tepër të rëndë që nënkupton kërcënim serioz të jetës, për arrestimin e dikujt që përbën një kërcënim të tillë dhe që i reziston autoritetit të tyre si zbatues të ligjit, apo për parandalimin e arratisjes së tij/së saj dhe vetëm kur mjetet më pak të skajshme nuk mjaftojnë për të realizuar këta objektiva. Në çdo rast, përdorimi i armëve të zjarrit me qëllim vdekjen mund të bëhet vetëm kur është plotësisht i pashmangshëm, me qëllim mbrojtjen e jetës.

10. Në rrethanat e parashikuara sipas parimit 9, zbatuesit e ligjit duhet ta identifikojnë veten si të tillë dhe të japin një paralajmërim të qartë se kanë ndër mend të përdorin armët e zjarrit, duke lënë kohë mjaftueshëm që të ndiqet paralajmërimi. Mosbërja e kësaj gjëje do t'i vendoste zbatuesit e ligjit në rrezik të panevojshëm apo nëse rrezikonte të shkaktonte vdekjen apo plagosjen e rëndë të personave të tjerë, apo nëse do të ishte e qartë se një gjë e tillë do të ishte e papërshtatshme apo e pakuptimte për rrethanat e incidentit.

Stafi i policisë në burgje, paraburgime dhe rajonet e policisë

15. Zbatuesit e ligjit, në marrëdhëniet e tyre me personat nën arrest apo paraburgim, nuk duhet të përdorin forcën, përveçse atëherë kur është tejet e domosdoshme për ruajtjen e sigurisë dhe rendit brenda institucionit ose kur kërcënohet siguria personale.

16. Zbatuesit e ligjit, në marrëdhëniet e tyre me personat nën arrest apo paraburgim, nuk duhet të përdorin armët e zjarrit, përveçse për vetëmbrojtje dhe në mbrojtje të personave të tjerë të cilët gjenden nën kërcënimin e drejtpërdrejtë të vdekjes apo plagosjes së rëndë, ose kur është tejet e nevojshme për të parandaluar arratisjen e një personi në arrest apo paraburgim që përbën rrezikun e parashikuar në parimin 9.

Procedurat e raportimit dhe të rishikimit

24. Qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të sigurohen që oficerët eprorë quhen përgjegjës nëse kanë dijeni apo duhet të kenë dijeni mbi faktin se zbatuesit e ligjit nën komandën e tyre po përdorin apo kanë përdorur forcën dhe armët e zjarrit në mënyrë të paligjshme dhe se nuk kanë marrë të gjitha masat që mund të merrnin brenda mundësive të tyre për të parandaluar, për të ndrydhur apo për të raportuar një përdorim të tillë.

25. Qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të sigurojnë se zbatuesit e ligjit të

cilët, në përputhje me Kodin e sjelljes së zbatuesve të ligjit dhe këtyre parimeve bazë, refuzojnë të ndjekin një urdhër për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit apo që e raportojnë një përdorim të tillë nga oficerët e tjerë, nuk do t'i nënshtrohen asnjë sanksioni penal apo disiplinor.

26. Bindja ndaj urdhrave të eprorit nuk duhet të shërbejë si mbrojtje për një zbatues ligji i cili e ka ditur se ndjekja e një urdhri për të përdorur forcën me armën e zjarrit me rezultat vdekjen dhe plagosjen e rëndë të një personi ishte qartësisht e paligjshme dhe që ka pasur një mundësi të arsyeshme për ta refuzuar e për të mos e ndjekur atë. Në çdo rast, përgjegjësia mbetet edhe me eprorët të cilët kanë lëshuar urdhra të paligjshëm.

Rekomandimi nr. R (87) 3 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane për Burgjet

63. 1. Personeli i institucioneve nuk duhet të përdorë forcë kundër të burgosurve, përveçse për vetëmbrojtje ose në rastet e tentativave për arratisje apo të rezistencës aktive apo pasive fizike ndaj një urdhri të mbështetur në ligj dhe në rregullore. Personeli që përdor forcën, duhet ta përdorë deri në atë shkallë që është tejet e nevojshme dhe për këtë incident duhet të raportojë menjëherë te drejtori i institucionit.

2. Personeli duhet të trajnohet, sipas nevojës, në teknika të posaçme për t'u aftësuar si të kufizojnë të burgosurit agresivë.

3. Përveçse në rrethana tepër të veçanta, personeli që kryen detyra që kërkojnë kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit, nuk duhet të jetë i armatosur. Për më tepër, personeli nuk duhet të pajiset me armë zjarri nën asnjë rrethanë, përveçse nëse është trajnuar si duhet në përdorimin e tyre.

MATERIALI 3

Formulari për përdorimin e forcës (raportimi)

FORMAT MBI PËRDORIMIN E FORCËS

Të plotësohet nga punonjësi i policisë së burgjeve i nivelit të mesëm në detyrë, prezent në incidentin e ndodhur.

Institucioni:

Seksioni:

Detaje të incidentit	
Data:	Ora:

Detaje të të burgosurit			
Emri:		Mbiemri:	
Seksi:	Përdorimi i forcës ishte:	Grup mosha:	
Mashkull ☐	I planifikuar ☐	I rritur ☐	
Femër ☐	Spontan ☐	I ri/ e re ☐	
		I mitur ☐	

Punonjësit e përfshirë në përdorimin e forcës			
Grada:	Emri:	Mbiemri	Sektori ku shërben:

Vendi ku ka ndodhur incidenti			
Në dhomë ☐	Në klasë ☐		
Në sektor (koridor, kollonë) ☐	Në sallën e gjyqit ☐		
Në ambientin eajrosjes ☐	Në dhomën e vizitës mjekësore ☐		
Në dhomën e dentistit ☐	Vend tjetër ☐		
Në ambientin e punës ☐			

Ngjarje që lidhen me këtë incident	Rrethanat përse është përdorur forca
Organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive që çenojnë masat e sigurisë në IEV; ☐	Vetëmbrojtje ☐
Kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEV; ☐	Parandalimi i vetë-dëmtimit ☐
Ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë; ☐	Parandalimi i lëndimit të një pale të tretë ☐
Përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga IEVP ose gjatë shoqërimit të tij; ☐	Parandalimin e dëmtimit të pronës ☐
Përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së IEVP ose të burgosurve të tjerë; ☐	Parandalimi i një arratisje ☐
Dhuna verbale dhe sjellja agresive ndaj të burgosurve të tjerë; ☐	Tjetër (ju lutem, jepeni hollësi)
Mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur përbëjnë vepër penale. ☐	
Prodhimi dhe përdorimi i lëndëve narkotike dhe alkoolit; ☐	
Përdorimi i fjalëve të pahijshme e fyese ndaj personave të tjerë; ☐	
Moszbatimi i detyrimeve dhe urdhrave ose vonimi i pajustificuar i zbatimit të tyre. ☐	
Mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur nuk përbëjnë vepër penale ☐	
Specifiko ngjarje tjetër:	
.....	
.....	
.....	
.....	
Tipi i forcës që është përdorur	
A është përdorur komunikim i arsyeshëm për të ulur shkallëzimin e situatës, para përdorimit të forcës dhe gjatë saj.	
Po ☐	Jo ☐

A është aplikuar kontrolli dhe kufizimi i të burgosurit me forcë

Po ☐ Jo ☐

Nëqoftë se po :

Në çfarë pozicioni është kufizuar?

Duke qëndruar në këmbë ☐

I shtrirë në kurris ☐

I shtrirë barkas ☐

Në pozicion ulur ☐

A janë përdorur prangat?

Po ☐ Jo ☐

A është përdorur shkopi i gomës?

Po ☐ Jo ☐

A janë përdorur teknika të sigurisë personale (vetëmbrojtje)?

Po ☐ Jo ☐

A ka lëndime:

Po ☐ Jo ☐

A është bërë mjekim gjatë kufizimit

Po ☐ Jo ☐

I burgosuri është lëvizur në:

Dhomë të veçimit ☐ I burgosuri ka shfaq rezistencë: Po ☐ Jo ☐

Në dhomë të tij ☐

Në infermieri ☐

Në spital rajonal ☐

Në spital të burgjeve ☐

Përdorimi i forcës është urdhëruar nga specialist i policisë:

Emri Mbiemri.....

Grada.....

Arsyeja:

.....

.....

.....

.....

VËRTETIM

Unë konfirmoj se të gjitha detajet e përshkruara në formularin e përdorimit të forcës janë korrekte.

Firma.....

Emri Mbiemri.....

Data.....

MATERIALI 4⁹⁷

STRATEGJITË EFEKTIVE TË KOMUNIKIMIT: ÇPËRSHKALLËZIMI DHE AFTËSITË NDËRPERSONALE/TË KOMUNIKIMIT

Ky seksion përfshin:

- Menaxhimi i agresionit
- Komunikimi
- Komunikimi joverbal
- Strategjitë e shpërndarjes
- Teknikat e çpërshkallëzimit

Menaxhimi i agresionit

Përkufizimi i dhunës për burgjet:

“Çfarëdo loj incidenti, si pasojë e të cilit, abuzohet, kërcënohet ose sulmohet një person. Këtu përfshihet cenimi direkt ose i nënkuptuar i sigurisë, mirëqenies ose shëndetit të tyre. Dëmi i shkaktuar mund të jetë fizik, emocional ose psikologjik.”

Menaxhimi efektiv i të burgosurve agresivë është një nga aspektet më sfiduese të punës në institucion. Kjo është një fushë ku kërkohen aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi.

Shumica e situatave, ku ka potencial për dhunë, mund të menaxhohen përmes komunikimit.

Agresioni mund të përcaktohet si çfarëdo loj sjellje që perceptohet nga viktimat si e dëmshme me qëllim dhe dëmtuese, si psikologjikisht ashtu edhe fizikisht.

Politika jonë është që stafi të parandalojë përshkallëzimin e agresionit në dhunë reale fizike.

Shenjat e agresionit:

- Qëndrimi autoritar në këmbë
- Skuqja e fytyrës
- Ngritja e zërit
- Frymëmarrja e shpejtë
- Kontakti i zgjatur me sy
- Gjestet e ekzagjeruara

Të burgosurit mund të bëhen agresivë për arsye të ndryshme, duke përfshirë:

- Acarimin
- Padrejtësinë
- Poshtërimin
- Papjekurinë
- Zemërimin
- Sjellje të mësuar (merr rezultate)

97 Kjo është një kopje e Urdhrit të Shërbimit të Burgjeve të Mbretërisë së Bashkuar për përdorimin e forcës.

- Reputacioni
- Mjetet për të arritur qëllimin
- E përdor dhunën si karrem

Shenjat e mëposhtme mund të tregojnë agresion:

- Çfarëdolloj ndryshimi i konsiderueshëm i sjelljes që ndryshon nga sjellja normale e të burgosurit
- Fytyra e zbehtë ose e skuqur
- Ngritja e zërit
- Përqendrimi/ngushtimi i shikimit
- Tensionimi i muskujve
- Rritja e zemërimit dhe e shqetësimit në sjellje (p.sh. endja me hapa)

Personeli që përballët me të burgosurit agresivë duhet të vlerësojë rrezikun e dhunës duke marrë parasysh sa më poshtë:

- A po përballët i burgosuri me një nivel të lartë stresi? (p.sh. humbja e dikujt kohën e fundit, pritja e datës së gjykimit)
- A duket se i burgosuri është i dehur apo i droguar?
- A ka i burgosuri histori dhune?
- A ka i burgosuri historik sëmundjeje psikiatrike?
- A ka pasur abuzime verbale nga ana e të burgosurit kundrejt stafit në të kaluarën?
- A ka pasur kërcënime me dhunë nga ana e të burgosurit në të kaluarën?

Komunikimi

Komunikimi është një proces me dy drejtime që lidhet me ndërveprimin me fjalë (të dëgjuar si shqisë, të folur dhe dëgjimin me vetëdije), ndërveprimin joverbal (interpretimin dhe aftësitë vëzhguese, shikimin dhe perceptimin).

Për të minimizuar problemet e komunikimit, stafi duhet të përdorë gjuhën e duhur ndaj të burgosurit (dhe nëse është e mundur në gjuhën e tij/saj dhe përmes përkthyesve), të marrë kohë për të komunikuar, të verifikojnë që është kuptuar, të nxisë dhe të japë mendimin e tij dhe të sigurohet që zhvillimi i bisedës të bëhet në kohën dhe vendin e duhur (kur është e mundur).

Disa nga pengesat e përbashkëta të komunikimit efektiv janë:

- Zhurma
- Gjuha
- Perceptimi dhe paragjykim
- Ndërhyrje në hapësirën personale

Ne nuk mund t'i shmangim apo kapërcejmë domosdoshmërisht të gjitha këto pengesa, por duhet të gjejmë mënyra për t'i minimizuar ato.

Zhurma:

Zhurma është hutim i madh kur po komunikohet. Është e vështirë që diskutimi të zhvillohet kur në sfond ka zhurmë.

Gjuha:

Oficerët duhet ta shprehin veten në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë e të qartë që të jetë e mundur dhe të shmangin gjuhën emocionale (për shembull - shmangia e fjalëve të “pushtetit”)

Perceptimi dhe paragjykimi:

Çdokush ka një formim dhe historik unik me ndikime dhe përvoja që përbëjnë mënyrën tonë të të parit të botës. Është e rëndësishme të njohim paragjykimet tona dhe të punojmë rreth paragjyimeve të të tjerëve. Ne duhet të mbajmë një qëndrim profesional duke mos lejuar që perceptimet tona të pengojnë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të tjerëve, veçanërisht në promovimin e mundësive të barabarta ose në lënien e paragjyimeve tona që të ndikojnë mënyrën tonë të komunikimit.

Ndërhyrje në hapësirën personale:

Mos qëndroni shumë afër personit.

Komunikimi joverbal

Stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për mesazhet joverbale që tregojnë se si ndihet një i burgosur apo si mund të reagojë ai dhe duhet të përdorë teknikat e komunikimit joverbal që mësojnë në trajnim për të shuar situatat që mund të shndërrohen në situata të dhunshme.

Strategjitë e shpërndarjes

Para se të ndodhë diçka tjetër, stafi duhet të përpiqet ta shuajë/qetësojë situatën. A Një i burgosur që e ka humbur kontrollin mund të jetë nën efektet e ndonjë koktejlit adrenaline. Stafi duhet të synojë të mos bëjë asgjë që përshkallëzon gjendjen e tyre mendore, ndërsa është i përgatitur të mbrojë veten, nëse kjo është e nevojshme.

Stafi duhet të kërkojë:

- Të duket i sigurt
- Të shfaqë qetësi
- Të krijojë pak hapësirë
- Të flasë ngadalë, butë dhe qartë
- Të ulë zërin e tij
- Të shmangë kureshtjen
- Të shmangë grindjet dhe konfrontimet
- Të tregojë që po dëgjon
- Të qetësojë të burgosurin para se të mundohet të zgjidhë problemin

Stafi duhet të mbajë qëndrim trupor jokërcënues:

- Të mbajë qëndrim të qetë, të hapur (të jetë i ulur ose në këmbë)
- Të reduktojë kontaktin e drejtpërdrejtë me sy (pasi mund të merret si konfrontim)
- T'i krijojë të burgosurit hapësirën e nevojshme personale
- T'i mbajë të dyja duart të dukshme
- Të shmangë lëvizjet e papritura që mund të trembin ose të perceptohen si sulm

- Të shmang audienca - pasi audienca mund të përshkallëzojë situatën

MOS KËRCËNONI KURRË: Pasi të keni bërë një kërcënim apo të keni dhënë ultimatum, i keni ndërprerë të gjitha negociatat dhe e keni vënë veten në situatë të mundshme humbjeje.

Teknikat e çpërshkallëzimit

Shpjegoni qëllimin apo synimin tuaj

- Jepni udhëzime të qarta, të shkurtra, të sigurt, negocioni opsione dhe shmangni kërcënimet.
- Shkoni drejt një “vendi më të sigurt”, pra mos ngecni në një qoshe.

Nxitni arsyetimin (për sjelljen e tyre)

- Nxitni arsyetimin duke bërë pyetje të hapura dhe pyesni në lidhje me arsyen e agresionit.
- Pyetjet mbi “faktet” dhe jo mbi ndjenjat mund të ndihmojnë përshkallëzimin (p.sh çfarë ju ka bërë të ndiheni i zemëruar?)
- Tregoni shqetësimin tuaj nëpërmjet përgjigjeve jo-verbale dhe verbale.
- Dëgjoni me kujdes dhe tregoni ndjeshmëri, pranoni çdo ankesë, shqetësim apo acarim. Mos i nënçmoni shqetësimet e tyre.

Sigurohuni që komunikimi juaj jo verbal të mos jetë kërcënues

- Shqyrtoni teknikat e çpërshkallëzimit që janë të përshtatshme për situatën.
- Kushtojini vëmendje indicieve jo-verbale (pra kontaktit me sy). Krijojini hapësirë trupi më të madhe se normalisht.
- Jini të vetëdijshëm për sjelljen tuaj joverbale, si qëndrimi i trupit dhe kontakti me sy.
- Shfaquni të qetë, të vetëkontrolluar dhe konfident, pa qenë mospërfillës apo autoritarë.
- Kontrolloni situatën.

MATERIALI 5

Kushtet mjekësore dhe pasojat potenciale negative të përdorimit të instrumenteve të shtrëngimit⁹⁸

Duke qenë se një prej temave të Modulit 8 trajton të burgosurit me probleme të shëndetit mendor, duhet të përdoren standardet e KPT-së për mjetet e kufizimit në institucione psikiatrike: <https://www.coe.int/en/web/cpt/means-of-restraint-psychiatry>; mes çështjeve të tjera thuhet si vijon: mjetet e kufizimit duhet të përdoren gjithmonë me kujdes për të minimizuar rrezikun e dëmeve apo të shkaktimit të dhimbjeve ndaj pacientit, si dhe për të ruajtur sa më shumë që të jetë e mundur dinjitetin e tij/të saj. Stafi duhet të trajnohet si duhet para se të marrë pjesë në aplikimin praktik të mjeteve të kufizimit. Në rastet kur mjetet e përdorura konsistojnë në një lloj shtrëngimi fizik (manual), stafi duhet të trajnohet posaçërisht për përdorimin e këtyre teknikave për të minimizuar rrezikun e dëmtimeve. Duhet të ndalohen shtrëngimet e qafës dhe teknikat që mund të pengojnë rrugët e frymëmarrjes së pacientëve ose të shkaktojnë dhimbje.

Në rastet ku ndeshet rezistencë, personeli shoqëruar zakonisht e bllokun të burgosurin në tokë, me fytyrë poshtë, me qëllim që t'i vendosë prangat. Mbajtja e një të burgosuri në një pozicion të tillë, sidomos nëse stafi i peshon në pjesë të ndryshme të trupit (presion mbi kafazin e krahavorit, gjunjtë në shpinë, çmobilizimi i qafës) kur personi në fjalë përpiqet të kundërshtojë, përbën rrezik asfiksioni për shkak të pozicionit.

Asfiksia për shkak të pozicionit

Përdorimi i mjeteve shtrënguese ka një sërë pasojash që mund të jenë negative. Këtu përfshihen: vështirësitë në frymëmarrje, të vjellat, ënjtje e fytyrës dhe e qafës, si dhe shkaktim i *petechiae* (njolla të vogla gjaku shoqëruar me asfiksion) në kokë, në qafë dhe në krahavor.

Shtrëngimi i një personi në një pozicion që pengon rrugët frymëmarrjes apo që zgjeron mushkëritë (si për shembull në pozicionin përmbys) mund të dëmtojë seriozisht frymëmarrjen e tij dhe mund të çojë në asfiksion. Këtu përfshihet presioni i ushtruar në pjesën e qafës, shtrëngimi i kafazit të krahavorit dhe dëmtimet e diafragmës. Kur koka detyrohet të ulët në nivelin e zemrës, truri nuk furnizohet sa duhet me gjak. Enjtja dhe njollat e gjakut në kokë dhe në qafë janë shenja të rritjes së presionit në kokë dhe në qafë, që shihen shpesh tek asfiksioni.

Presioni nuk duhet të ushtrohet në qafë, sidomos në këndin e nofullës dhe në laring. Presioni i ushtruar në qafë, sidomos në pjesën e nofullave (sinusi karotid) mund të dëmtojë kontrollin nervor të zemrës dhe mund të çojë në një ngadalësi të menjëhershëm të saj apo edhe në mosfunksionim të zemrës. Kjo pasojë mund të ndodhë veçanërisht më shumë te personat:

- me anginë
- personat që kanë kaluar më parë një infarkt
- personat me tension të lartë
- me diabet
- të moshuarit, sidomos ata me probleme të arterieve

98 Kjo është një kopje e Urdhrit të Shërbimit të Burgjeve të Mbretërisë së Bashkuar

Asfiksia pozicionale mund të shkaktohet deri diku nga pozicionet e detyruara të qafës, kafazit të krahavorit ose diafragmës, sidomos në rastet kur koka detyrohet të qëndrojë poshtë gjunjëve. Kufizimet ku subjekti qëndron i ulur ka nevojë për kujdes, duke qenë se këndi mes kafazit të krahavorit dhe gjymtyrëve të brendshme është më i ulur në atë pozicion. Shtërngimi i bustit drejt kofshëve të njeriut e kufizon diafragmën dhe cenon edhe më shumë mushkëritë. Kjo vlen dhe për pozicionet përmbys, ku pesha e trupit i mëshon kafazit të krahavorit dhe barkut duke kufizuar lëvizjet e diafragmës.

Faktorët që e bëjnë njeriun subjekt të asfiksisë pozicionale dhe vdekjes së papritur në kushtet e shtërngimit përfshijnë:

- Intoksikimin nga droga/alkooli (për shkak se medikamentet qetësuese dhe alkooli veprojnë duke ulur frymëmarrjen, duke reduktuar kështu sasinë e oksigjenit që merr trupi
- Lodhja fizike (ose çdo faktor që rrit kërkesën e trupit për oksigjen, si për shembull rastet e përplasjeve fizike apo ankthit)
- Obeziteti

Shenjat paralajmëruese të asfiksisë pozicionale:

- Individit ka vështirësi në frymëmarrje
- Ankohet se nuk merr dot frymë
- Prova ose raportime se individ ndihet keq ose po vjell
- Ënjtje, skuqje ose njolla të kuqe gjaku në fytyrë ose qafë
- Zgjerim i dallueshëm i venave në qafë
- Individit mpihet ose nuk reagon
- Ndryshime në sjellje (si përshkallëzuese, ashtu edhe në të kundërt)
- Humbje ose reduktim i vetëdijes
- Arrest kardiak ose respirator

MASA: Lirojeni ose zbuteni menjëherë shtërngimin sa të mundeni për të zbutur shtërngimin e trupit dhe për të kërkuar vëmendje mjekësore.

Asnjë i burgosur nuk duhet të detyrohet të qëndrojë përmbys (dhe në rastin e një të burgosure shtatëzanë, në pozicionin në brinjë) më gjatë sesa është e domosdoshme për të marrë kontrollin. Duhet të vëzhgohet në mënyrë të vazhdueshme i burgosuri pas detyrimit për të qëndruar përmbys deri në momentin që i burgosuri të ndryshoj qëndrim.

Shënim. Njerëzit zakonisht mendojnë gabimisht se nëse një person mund të flas, atëherë ai mund të marrë frymë, por NUK është kështu. Një person që është duke vdekur nga asfiksia pozicionale mund edhe të flasë apo të bërtasë para se të vdesë.

Deliri i entuziazmimit

Deliri i entuziazmimit është si gjendje mendore, ashtu edhe një lloj entuziazmimi fiziologjik.

Deliri i entuziazmimit mund të shkaktohet nga intoksikimi i drogës (duke përfshirë dhe alkoolin) ose nga sëmundje psikiatrike ose nga të dyja bashkë. Kokaina është një nga shkaqet e njohura të delirit të shkaktuar nga droga.

Është e vështirë të bëhet dallimi midis një personi në momente deliri dhe një tjetri që është thjesht i dhunshëm. Personat që vuajnë nga deliri i entuziazmimit:

- mund të kenë një lloj force dhe rezistence të papritur dhe në dukje pa asnjë lodhje
- mund të demonstrojnë një tolerancë të pazakontë ndaj dhimbjes
- mund të jenë të nxehtë
- mund të jenë të axhituar
- mund të djersitin shumë
- mund të jenë armiqësor
- mund të shfaqin sjellje dhe të folur të çuditshme

I vetmi moment ku mund të bëhet e qartë se i burgosuri vuan në fakt nga deliri i entuziazmimit mund të jetë kur ai papritur bie: kini kujdes nga momente të papritura qetësie pas një aktiviteti kaq dinamik që mund të shkaktohet nga lodhja e jashtëzakonshme, asfiksia apo nga problemet kardiopulmonare që lidhen me drogën (problemët me zemrën dhe mushkëritë).

Sëmundja e qelizave drapër

Sëmundja e qelizave drapër është e përhapur në popullatat me ngjyrë të Afrikës, në Mesdhe dhe në Lindjen e Mesme dhe në disa pjesë të Indisë. Ajo është sëmundje e trashëgueshme dhe çon ose në sëmundje të qelizave drapër ose në simptoma të qelizave drapër, dhe varet nëse personi e ka trashëguar këtë gen nga njëri apo nga të dy prindërit.

Duhet pasur GJITHMONË parasysh mundësia e shfaqjes së sëmundjes së qelizave drapër te personat që vijnë nga këto rajone ose në grupet etnike të pasardhësve të tyre. Kjo sëmundje ka një natyrë të tillë që kur personi vendoset në një situatë ku ulet sasia e oksigjenit në trup, enët e tij të gjakut mund të bllokohen. Megjithatë, është një problem që nuk e vuajnë vetëm personat që kanë sëmundjen e qelizave drapër dhe se mund të ketë edhe persona të tjerë që mund të vuajnë njësoj në të njëjtat kushte, pra nëse përjetojnë një ulje të oksigjenit në gjak.

Psikoza

Psikoza është një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar gjendjen mendore ku personi humb kontaktin me realitetin dhe pëson gjithashtu një humbje të madhe të të kuptuarit të gjërave dhe ku, për këtë arsye, mund të jetë jashtëzakonisht dyshues. Frikërat e tyre duken kaq të vërteta, sa që mund të besojnë se u kërcënohet siguria personale, domethënë që u duket sikur persona të tjerë kanë ndërmend t'u shkaktojnë dëme. Ndonjëherë, ata fillojnë të besojnë se jeta e tyre është drejtpërdrejtë e kërcënuar. Fillojnë të kenë jashtëzakonisht frikë, axhitohen dhe mund të bëhen edhe fizikisht agresivë dhe të dhunshëm. Personat që vuajnë nga psikoza duhet të konsiderohen seriozisht të sëmurë dhe kanë nevojë urgjente për vëmendje mjekësore.

Mund të jetë e rrezikshme që pacientët me psikozë të kontrollohen përmes teknikave të kontrollit & kufizimit, pa pasur mbështetje mjekësore, sepse reagimet e të burgosurve ndaj dhimbjes mund të jenë jonormale, duke çuar në përballjen e tyre të dhunshme me tentativat për t'i vënë nën kontroll përmes shtrëngimit. Këto përballje mund t'i lodhin kaq shumë, sa që kur më në fund të vendosen nën kontroll, sistemi i trupit të tyre të bjerë papritur në një gjendje kolapsi të plotë virtual. Në këto kushte, personi mund të mos ketë më fuqi të mjaftueshme për të mbështetur lëvizjet respiratorë të krahërorit që janë të domosdoshme për jetën, dhe në këto kushte mundet që papritur të vdesë.

Moduli 10: Përdorimi i mjeteve kufizuese (4 orë)

“Punonjësve të burgjeve u duhet të përdorin ndonjëherë forcën për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe në rrethana të veçanta, mund të duhet të përdorin edhe mjete të kufizimit fizik. Kuptohet që këto janë situata me rrezik të lartë, sa i takon keqtrajtimin të mundshëm të të burgosurve dhe kërkojnë garanci specifike.”
(Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës)⁹⁹

Objektivat: në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të shpjegojnë teorinë dhe parimet e përdorura për përdorimin e forcës në rast konfliktesh;
- të shpjegojnë parimet dhe legjislacionin bazë në lidhje me përdorimin e mjeteve kufizuese në situata të ndryshme (ngjarje, shoqërime, të burgosur me probleme të shëndetit mendor);
- të njohin mjetet e kufizimit në Shqipëri;
- të përfitojnë njohuri për masat e posaçme për përdorimin e masave kufizuese gjatë transportimit/shoqërimit dhe për përdorimin e mjeteve të kufizimit në rastin e të burgosurve vulnerabël me probleme të shëndetit mendor;
- të demonstrojnë përdorimin e mjeteve kufizuese, duke përfshirë edhe prangat.

1. Hyrje (5 minuta)

Kontributi i trajnerit

Gjatë karrierës suaj si policë burgjesh do të vendosni shumë herë mjete kufizimi të të burgosurit. Ekzistojnë shumë arsye përse mjetet e kufizimit përdoren për të kontrolluar të burgosurit. Në të gjitha rastet duhet të dini me saktësi se çfarë mjeti të kufizimit mekanik jeni duke përdorur dhe si ta vendosni saktë. Për të kuptuar aftësitë që do të mësoni, duhet të praktikoheni në mënyrë që të zhdërvjelltësoheni. Kjo seancë ka për qëllim t'ju zhdërvjelltësojë në vendosjen e mjeteve të kufizimit që disponon shërbimi i burgjeve. Ajo do t'i kushtohet teorisë dhe arsyeve për vendosjen e mjeteve të kufizimit, si dhe do t'ju udhëzojë gjatë praktikës së vendosjes së mjeteve të kufizimit të të burgosurit, duke respektuar njëkohësisht edhe dinjitetin e të dënuarit.

2. Respektimi i parimeve të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Parimi i ligjshmërisë kërkon që përdorimi i mjeteve kufizuese të parashikohet në ligj. Në ligj duhet të specifikohet se cilat mjete mund të përdoren dhe në çfarë rrethanash. Gjithashtu, duhet të parashikohen edhe kushtet e përdorimit të mjeteve,

⁹⁹ Reforma Penale Ndërkombëtare dhe Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT), 2013. Autor Andrea Huber; Reforma e burgjeve, tabela, instrumentet e kufizimit, faqja 2.

duke përfshirë periudhën kohore të përdorimit të tyre. Përdorimi i mjeteve që janë “degraduese ose të dhimbshme” nuk lejohet në asnjë rrethanë. Ko duhet të lexohet nga këndvështrimi i nenit 5 të Kodit të OKB-së për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, ku thuhet se termat “*ndëshkim ose trajtim mizor, çnjerëzor apo degradues*” duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të zgjerojnë mbrojtjen më të gjerë të mundshme kundër abuzimeve fizike ose mendore.

Parimi i domosdoshmërisë synon të garantojë që mjetet e kufizimit të **mos përdoren për qëllime të tjera përveçse si një masë e fundit** kur të gjitha mjetet e tjera për ruajtjen e rendit dhe sigurisë të kenë rezultuar joefektive. Kohëzgjatja e përdorimit të këtyre mjeteve duhet të mbështetet në këtë parim. Prandaj, çdo përdorim i mjeteve të kufizimit duhet rivlerësuar sistematikisht dhe të ndalojë sapo arsyet që çuan në përdorimin e tij të pushojnë së ekzistuari.

Parimi i proporcionalitetit zbatohet për të garantuar që metodat e përdorura të kufizimit të jenë të përshtatshme për nivelin e vlerësuar të rrezikut dhe që të zgjidhet metoda më pak e dëmshme.

Parimi i proporcionalitetit synon të garantojë që kohëzgjatja e përdorimit të metodave të kufizimit të korrespondojë me rreziqet e identifikuar. Në terma konkretë, stafi mjekësor i institucionit duhet të kontrollojë në intervale sistematike që këto mjete të mos kenë asnjë pasojë negative ndaj shëndetit fizik ose psikologjik të personave në fjalë.

3. Shkaqet ligjore për përdorimin e mjeteve të kufizimit (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Rregullat e Nelson Mandelës

Mjetet e kufizimit

Rregulla 47 1. Ndalohet përdorimi i zinxhirëve, hekurave dhe mjeteve të tjera shtrënguese, që për nga natyra janë degraduese ose të dhimbshme.

2. Mjetet e tjera shtrënguese përdoren vetëm kur parashikohen në legjislacion dhe në këto rrethana: (a) si masë paraprake ndaj arratisjes gjatë një transferimi, me kusht që të hiqen kur i burgosuri të dalë para një autoriteti gjyqësor ose administrativ; (b) me urdhër të drejtorit të burgut, nëse dështojnë metodat e tjera të kontrollit, me qëllim që të mos lejojnë që i burgosuri të dëmtojë veten apo pronën; në këto raste, drejtori duhet të njoftojë menjëherë mjekun ose ndonjë profesionist tjetër të kujdesit shëndetësor dhe të raportojë tek autoritetet më të larta administrative.

Rregulli 48 1. Kur vendosja e mjeteve të kufizimit autorizohet në përputhje me pikën 2 të rregullit 47, duhet të zbatohen këto parime: (a) mjetet e kufizimit duhet të vendosen vetëm nëse për adresimin e rreziqeve që përbën lëvizja e pakufizuar, të gjitha format e tjera më të vogla të kontrollit kanë rezultuar joefektive; (b) metoda e kufizimit duhet të jetë më pak e dëmshme që nevojitet dhe që është e arsyeshme për të kontrolluar lëvizjet e të burgosurit, në bazë të nivelit dhe natyrës së rreziqeve që përbën ajo; (c) mjetet e kufizimit duhet të vendosen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe duhet të hiqen menjëherë sapo rreziqet që përbën lëvizja e pakufizuar nuk ekzistojnë më.

2. Mjetet e kufizimit nuk duhet të përdoren asnjëherë tek gratë që janë me dhimbjet e lindjes, gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes së fëmijës.

Rregulli 49 Administrata e burgjeve duhet të ketë akses në trajnime për përdorimin e teknikave të kontrollit që çojnë në nevojën e vendosjes së mjeteve të kufizimit apo në reduktimin e dëmeve të tyre.

Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁰⁰

68.1 Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe i hekurave.

68.2 Prangat e duarve, xhaketat e dënimit dhe gjëra të tilla të rënda trupore kufizuese nuk përdoren me përjashtim të rasteve kur:

a. ato janë të nevojshme për të parandaluar arratisjen gjatë një transferimi, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrativ, në përjashtim të rasteve kur organet vendosin ndryshe ose kur

b. jep urdhër drejtori, në rastet kur metodat e tjera të kontrollit dështojnë, në mënyrë që të mbrohet i burgosuri nga vetëdëmtimi, dëmtime të tjerëve ose për të parandaluar dëmtime serioze ndaj pronës. Në këto raste drejtori informon menjëherë mjekun e burgut dhe i raporton një organi më të lartë.

68.3 Instrumentet e kufizimit dhe të sigurisë nuk përdoren më gjatë sesa është jashtëzakonisht e nevojshme.

68.4 Mënyra e përdorimit të instrumenteve të tilla specifikohet në legjislacionin kombëtar.

Ligji nr. 81 datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 70, parashikon:

“.....Mjetet e shtrëngimit fizik mund të përdoren për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personelit të institucionit, të burgosurve të tjerë, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të burgosurit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik si mjet ndëshkimi. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik kryhet në mënyrë të përshkallëzuar, në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut dhe duhet të jetë i kufizuar në kohë. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik, për një periudhë më të gjatë se 48 orë, bëhet me miratimin e prokurorit. Gjatë shtrëngimit fizik, i burgosuri duhet të jenë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.”

Përdorimi i instrumenteve shtrënguese në Evropë: përshtypje¹⁰¹

Siç theksohet në raportet e Observatorit Evropian të Burgjeve, mjetet më të zakonshme të kufizimit të përdorura në burg janë prangat. Prangat përdoren veçanërisht gjatë transferimeve, por në disa raste mund të përdoren për çdo zhvendosje jashtë qelisë së të burgosurve që konsiderohen “të rrezikshëm” (Francë).

- Në Greqi, Kodi i Burgjeve parashikon që përdorimi i prangave duhet të shmanget kur i burgosuri është i mitur, i sëmurë, i moshuar ose e burgosura shtatzënë.

100 Rekomandimi Rec(2006)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane të Burgjeve (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 dhe i rishikuar dhe i ndryshuar nga Komiteti i Ministrave më 1 korrik 2020 në takimin e 1380^{-të} të Zëvendësministrave).

101 Burgjet në Evropë: Përmbledhje dhe tendenca, 2013.

- Në Poloni, instrumentet më të rënda të kufizimit janë xhaketat e ngushta dhe rripi frenues; zbatohen për të imobilizuar të burgosurin dhe përdoren vetëm në një dhomë të veçantë e të zhurmshme. Mund të përdoren vetëm nëse asnjë masë tjetër kufizuese nuk do të jetë efektive.
- Një sërë veprimesh lejohen sipas rregullave të burgut në Mbretërinë e Bashkuar: fizike (duke përdorur forcë fizike pa pajisje), mekanike (duke përdorur pajisje të tilla si pranga ose mbajtëse këmbësh, shufra dhe shkopinj), kimike (duke përdorur ilaçe), mjedisore (për shembull, izolim), teknologjike (për shembull, survejim elektronik, bllokues ose alarme), psikologjike (për shembull, duke i thënë dikujt në mënyrë të përsëritur se nuk lejohen ose është e rrezikshme të bësh diçka, ose privimi i një të burgosuri nga diçka që është e nevojshme për të, për shembull, një mjet ndihmës për të ecur.

Siç theksohet në raportet kombëtare pothuajse në çdo vend është e ndaluar të mbash brenda burgut armë vdekjeprurëse.

4. Përkufizimi i mjeteve të kufizimit (10 minuta)

Kontributi i trajnerit

Mjet kufizimi (sigurimi) quhet çdo mjet i miratuar që përdoret për të siguruar një të burgosur në mënyrë që të garantohet siguria e tij dhe mbajtja nën arrest apo burgim.

Mjetet e shtrëngimit të miratuara në legjislacionin e burgjeve të Shqipërisë në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve janë:

- pranga (të duarve dhe të këmbëve)
- xhaketat kufizuese

Personeli duhet ta kuptojë se këto janë mjete të kufizimit të përkohshëm. Mos i përdorni ato te një i burgosur dhe të vetëkënaqeni. Duhet të vazhdoni të ruani vigjilencën edhe pasi t'ia keni vendosur të burgosurit, pasi disa prej tyre mund të çlirohen prej mbërthimit të tyre. Vëzhgimi i vazhdueshëm i të burgosurit të kufizuar garanton që ai do të mbetet kështu.

Në këtë nen janë përcaktuar edhe mjetet e forcës, që janë:

- shkopinjtë e gomës
- pistoleta neuroparalizuese
- gazi lotsjellës

Këto do të trajtohen në një temë tjetër.

5. Përdorimi i mjeteve kufizuese në rast incidentesh dhe në rast shoqërimi (45 minuta)

Kontributi i trajnerit

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që mjetet kufizuese të përdoren në mënyrë të kufizuar, vetëm në raste të veçanta ose në rast **incidentesh**, kur të jenë shteruar dhe të mos kenë rezultuar efikase metodat e tjera.

Mjetet e forcës dhe kufizimit duhet të përdoren vetëm për periudha sa më të shkurtra kohore dhe nuk duhet të aplikohen kurrë si ndëshkim. Roli i mjekëve udhëhiqet – dhe përkufizohet - nga standardet e zhvilluara për etikën mjekësore.

Mjetet e shtrëngimit përdoren:

- Gjatë transportimit/shoqërimit të një të burgosuri në burg, spital apo në një institucion tjetër të vuajtjes së dënimit.
- Gjatë urgjencave për të parandaluar arratisjet.
- Për të siguruar një të burgosur, gjendja mjekësore e të cilit mund ta çojë në vetëgjymtim apo plagosje të tjerëve.
- Përpara apo pasi një përplasje të jetë kthyer në fizike. Është me rëndësi që punonjësit e burgjeve ta dinë se mjetet e sigurimit nuk përdoren si ndëshkim, për të shkaktuar dhembje apo për të poshtëruar të burgosurin.

Ato duhet të përdoren vetëm kur:

1. *prishet rregulli dhe siguria në burg;*
2. *ka përpjekje për t'u larguar nga burgu apo gjatë transferimit;*
3. *ka dhunë dhe kërcënim ndaj personave të tjerë;*
4. *ka dëmtime të shëndetit të vet ose të personave të tjerë;*
5. *ndodh dëmtimi i rëndë i sendeve;*
6. *ka kundërshtim aktiv ose pasiv në zbatim të rregullave dhe të urdhrave ose në ekzekutimin e një dënimi disiplinor.*

Transferimi/shoqërimi dhe përdorimi i instrumenteve shtrënguese

Kontributi i trajnerit

Oficerët e policisë dhe të institucioneve penale bëjnë transferimin e të burgosurve disa herë në ditë për një sërë arsyesh. Në përgjithësi, shumica e këtyre transferimeve zhvillohen pa incidente, por për shkak të natyrës së paparashikueshme të transferimit, mund të ndodhë gjithçka, kështu që oficerët dhe eprorët duhet të jenë të përgatitur për reduktimin e rreziqeve kur kryejnë detyrën. Reduktimi i rreziqeve të incidenteve gjatë transferimit kërkon kryerjen e **vlerësimit të rrezikut** para çdo lëvizjeje të të burgosurit duke përfshirë planifikimin e llojit të mjetit kufizues që mund të përdoret. Kryerja e një mini-vlerësimi të menaxhimit të riskut për masat e nevojshme gjatë transferimit të një të burgosuri mund të nxjerrë një sërë çështjesh të përgjithshme dhe mund të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve që lidhen me kryerjen e detyrës.

Shënim për trajnerin

Ky ushtrim bëhet dyshe-dyshe

- *Çdo dyshe merr rreth dhjetë minuta për të reflektuar mbi temat ose rreziqet potenciale që mund të dalin nga kryerja e transferimit të burgosurve.*

Pas mbledhjes së përgjigjeve, trajneri përmbledh si vijon:

Në çdo transferim të burgosurish dallohen këta komponentë kryesorë: përzgjedhja dhe përgatitja e automjetit; aksidente që mund t'i ndodhin mjetit; sigurimi dhe vendosja

e të burgosurve në mjet; marrja e informacioneve për të burgosurit; transferimi i të burgosurve me nevoja të veçanta; gjinia e të burgosurit; mjetet kufizuese të përdorura; kontrolli i të burgosurit; numri i të burgosurve që transferohen; natyra e transferimit; distanca dhe itinerari i transferimit; qëllimet mjekësore të transferimit; përdorimi i një mjeti fluturues komercial; armët e policëve; numri i policëve që nevojiten për transferimin; si dhe komunikimet e nevojshme për transferimin.

Bashkë me komponentët e tjerë, këta elementë duhet të përdoren për të hartuar udhëzimet, për trajnime dhe për shqyrtimin e rasteve.

Ja një shembull i politikës së Shërbimit të Burgjeve të Mbretërisë së Bashkuar për përdorimin e mjeteve shtrënguese për lëvizjet e shoqëruara të të burgosurve.

Politika

- Ekziston një prezumim kundër përdorimit të mjeteve kufizuese gjatë vizitave në institucione jashtë burgut apo gjatë shoqërimeve. Çdo përdorim i pajisjeve të tilla duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi individual rreziku që duhet të ndërmerret për çdo lëvizje të shoqëruar individuale, edhe nëse bëhet fjalë për takime sistematike dhe në të duhet të përfshihen informacionet më të fundit që mund të ekzistojnë. Kjo vlen për të përcaktuar nëse duhet të përdoren mjete kufizuese dhe për të identifikuar mjetet që duhet të përdoren për çdo lëvizje.
- Mund të nevojitet që një i burgosur të kufizohet në lëvizje për t'i paraprirë rrezikut të arratisjes apo fshehjes, për të parandaluar dëmet që mund t'i kanosen publikut, të burgosurve të tjerë apo stafit, si dhe për të parandaluar dëmet në pronë. Përveç kësaj, një i burgosur mund të duhet të kufizohet me mjete shtrënguese për të mos dëmtuar veten apo për të mos penguar zhvendosjen.
- Përdorimi i çfarëdolloj mjeti kufizimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të **ruhet dinjiteti** i të burgosurit, duke u përdorur në mënyrë sa më diskrete për aq sa është e mundur, pa cenuar sigurinë e të burgosurve, të stafit dhe të të tjerëve.
- Në qoftë se risku nuk vlerësohet si duhet dhe nëse përdorimi i mjeteve shtrënguese nuk është plotësisht i justifikuar, sidomos për të moshuarit, të burgosurit vulnerabël apo të sëmurë terminalë, përdorimi i mjeteve kufizuese mund të çojë në trajtim çnjerëzor dhe degradues sipas neneve 2 dhe/ose 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Përdorimi i çfarëdolloj mjeti kufizues duhet të jetë **i arsyeshëm, i nevojshëm dhe proporcional** dhe të marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse: mjetet kufizuese duhet të përdoren vetëm për periudha minimale kohore.

6. Masa të posaçme për rastet e kufizimit të personave me probleme të shëndetit mendor (30 minuta)

Kontributi i trajnerit

Të burgosurit kanë një shkallë më të lartë problemesh të shëndetit mendor krahasuar me popullatën e përgjithshme, duke përfshirë histori të rënda të traumave.

Studimet¹⁰² tregojnë se përdorimi i forcës fizike nuk e rrit sigurinë; në fakt, mund të ndikojë negativisht tek siguria. Nga ana tjetër, reduktimi i metodave ndëshkuese dhe të dhunshme ndaj shkeljeve dhe mirëkuptimi i nevojave të shëndetit mendor të të burgosurve kontribuojnë në uljen e dhunës. Kërkimet e departamentit të policisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbi udhëzimet e përdorimit të forcës, zbuluan se atje ku ekzistonin politika *më kufizuese* të përdorimit të forcës, punonjësit kishin më pak të ngjarë të vriteshin dhe të sulmoheshin gjatë kryerjes së detyrës.

Në fushën e shëndetit mendor, duke përfshirë edhe psikiatrinë ligjore, bëhen shumë përpjekje për të ulur përdorimin e masave kufizuese dhe shtrënguese (si kufizimi dhe izolimi) ndaj pacientëve. Studimet në atë fushë tregojnë se “masat shtrënguese mendohet se kanë efekte paradoksale në provokimin e sjelljeve edhe më të dhunshme dhe më agresive, kundrejt sjelljeve që ato tentojnë të përmbajnë, të menaxhojnë dhe të kontrollojnë.”

Studimet tregojnë se ka shumë raste të burgosurish me probleme të shëndetit mendor që nuk iu binden udhëzimeve të punonjësve të burgjeve, ndaj të cilëve përdoret forcë edhe kur sjellja e tyre nuk përbën asnjë rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e dikujt. Këtu hyjnë të burgosurit që nuk pranojnë të dalin nga qelia, që nuk pranojnë t'i kyçësh brenda dhe situata të tjera të ngjashme. Këto gjetje tregojnë se reagimet (duke përfshirë edhe forcën) duhet të bazohen në një vlerësim të hollësishëm të rrezikut të paraqitur në atë moment. Punonjësit duhet ta përdorin forcën vetëm kur nevojitet për të mos e lënë dikë që të dëmtojë dikë tjetër. Përdorimi i forcës në rrethana të tjera e përshkallëzon në mënyrë të panevojshme konfliktin. Ndonëse për momentin mund të arrijë rezultatin e dëshiruar, në planin afatgjatë, mund të krijojë një marrëdhënie armiqësore mes të burgosurve dhe oficerëve të burgjeve, e cila në fund ndikon negativisht te siguria.

Për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor, duhet të përdoren si duhet në institucionet psikiatrike mjetet e kufizimit sipas standardeve të KPT-së: <https://www.coe.int/en/web/cpt/means-of-restraint-psychiatry>; ku mes të tjerave thuhet se: mjetet e kufizimit duhet të përdoren gjithnjë me kujdes dhe profesionalizëm për të minimizuar rrezikun e shkakimit të dëmeve tek pacienti dhe për të ruajtur dinjitetin e tij/të saj sa më shumë që të jetë e mundur. Stafi duhet të trajnohet si duhet para se të marrë pjesë në aplikimin në praktikë të mjeteve të kufizimit. Në rastin e kufizimeve fizike (manuale), stafi duhet të trajnohet si duhet për përdorimin e teknikave që minimizojnë rrezikun e dëmtimeve. Duhet të ndalohen shtrëngimet e qafës dhe teknikat që mund të pengojnë rrugët e frymëmarrjes së pacientëve ose të shkaktojnë dhembje.

Në rastet ku ndeshet rezistencë, personeli shoqërues zakonisht e bllokun të burgosurin në tokë, me fytyrë poshtë, me qëllim që t'i vendosë prangat. Mbajtja e një të burgosuri në një pozicion të tillë, sidomos nëse stafi i peshon në pjesë të ndryshme të trupit (presion mbi kafazin e kraharorit, gjunjët në shpinë, qafë) kur personi në fjalë përpiket të kundërshtojë, përbën rrezik asfiksioni për shkak të pozicionit.

102 Dëmet/Kontrolli: Përdorimi i forcës dhe ciklit të dhunës dhe traumës në burgjet federale dhe rajonale të BC. Raport, (2019) Shoqëria për Drejtësi e Burgjeve të West Coast/Shërbimet Ligjore për të Burgosurit me financim nga Fondacioni Ligjor i British Columbia.

Shënim për trajnerin

Kur një i burgosur me probleme të shëndetit mendor nuk i bindet urdhrave të punonjësit të burgut në një mënyrë që nuk përbën ndonjë rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë, punonjësit kanë një sërë opsionesh.

Trajneri pyet: çfarë janë këto opsione?

Shkruajini përgjigjet e pjesëmarrësve në tabelë dhe zhvilloni një diskutim të shkurtër për atë çfarë thanë dhe pastaj trajneri përmbledh si vijon:

Kontributi i trajnerit

Për t'iu përgjigjur sjelljeve që nuk përfshijnë asnjë lloj dhune, ata mund të bëjnë si vijon:

- të përpiqen të identifikojnë arsyet kryesore që e bëjnë të burgosurin të mos bjerë dakord t'u bindet.
- të negociojnë me të burgosurin.
- t'i japin të burgosurit kohë që të qetësohet ose të ndryshojë mendje.
- t'i japin të burgosurit një masë disiplinore.
- të thërrasin dikë, me të cilin i burgosuri ka një raport të mirë.

Përdorimi i forcës në këto rrethana bën shpesh që incidentet të përshkallëzohen dhe ndonëse për momentin mund të arrihet qëllimi, në planin afatgjatë kjo e cenon marrëdhënien dhe krijon një ambient frike dhe armiqësie.

7. Demonstrimi se si vendosen instrumentet e kufizimit (60 minuta)

Trajneri përdor: Teknikën me katër faza për shpjegimin e aftësive

Faza 1: Ekspertiza demonstruese: Demonstrimi i aftësisë, me shpejtësinë reale, shoqëruar ose jo me fjalë nga instruktori;

Faza 2: Komponentët përforcues të ekspertizës: Përsëritja e demonstrimit (në mënyrë të ngadalësuar) me dialog, duke dhënë shpjegimet për veprimet e kryera nga instruktori;

Faza 3: Kalimi i pjesshëm i përgjegjësisë për aftësinë nga instruktori te kandidati/personi që trajnohet: Përsëritja e demonstrimit e drejtuar nga një nga personat që trajnohen, i cili i shpjegon instruktorit veprimet, ndërkohë që vetë instruktori i kryen ato;

Faza 4: Praktika e pavarur e kandidatit/personit që trajnohet: Përsëritja e demonstrimit nga personi që trajnohet dhe praktikimi i aftësisë nga të gjithë kursantët.

Kontributi i trajnerit

Arsyet përse të burgosurit mund të çlirohen nga mjetet e kufizimit janë si më poshtë:

Të burgosurit arrijnë të çlirohen nga mjetet e kufizimit, pasi:

- ato nuk janë vendosur si duhet;
- mekanizmi kyçës prishet nga i burgosuri duke përdorur kapëse letrash, tela apo fletë të holla metalike, etj;
- i burgosuri i prish mjetet e kufizimit;
- oficeri vetëkënaqet dhe nuk e mban të burgosurin nën vëzhgim duke e lejuar që të prishë mjetet.

Udhëzime për përdorimin e prangave si mjet shtrëngimi¹⁰³

“Punonjësve të burgjeve u duhet të përdorin ndonjëherë forcën për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe në rrethana të veçanta, mund të duhet të përdorin edhe mjete të kufizimit fizik. Kuptohet që këto janë situata me rrezik të lartë, që lidhen me keqtrajtimin e mundshëm të të burgosurve dhe kërkojnë garanci specifike.” (Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës)¹⁰⁴

Nga Tabela e Reformës Penale Ndërkombëtare që merret me faktorët e rrezikut për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, mund të nxjerrim këto garanci për përdorimin e prangave:¹⁰⁵

- Askujt nuk duhet t'i vihen prangat në burg, përveçse për ndonjë arsye të vlefshme që lidhet me sigurinë.
- Përdorimi i prangave është legjitim vetëm nëse është i nevojshëm, i ligjshëm dhe proporcional.
- Prangat përdoren vetëm në rrethana përjashtuese, kur nuk ka asnjë opsion tjetër, me qëllim që i burgosuri të mos dëmtojë të tjerët ose veten ose të mos arratiset gjatë një transferimi.
- Prangat mund të vendosen vetëm kur për adresimin e rreziqeve që përbëjnë lëvizjet e pakufizuara të të burgosurit nuk ka asnjë metodë tjetër efektive dhe metoda kufizuese duhet të jetë sa më pak e dëmshme që të jetë e mundur.
- Në rastet kur përdoren prangat, ato duhet të vendosen vetëm për aq kohë sa të jetë e nevojshme dhe duhet të hiqen sapo rreziku që paraqiste lëvizja e pakufizuar nuk është më i pranishëm.
- Kufizimi si përdorimi i prangave duhet të përdoret vetëm si masë afatshkurtër për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rrezikut na ndihmon të përcaktojmë se për sa kohë duhet të vendoset kjo masë’.
- Aty ku përdorimi i prangave është parimisht legjitim, mënyra se si aplikohen ato nuk duhet të jetë degraduese apo e dhimbshme. Ato duhet të përdoren në mënyrë të tillë që të minimizojnë dhembjen sa të jetë e mundur dhe duhet të hiqen në mundësinë me të parë.
- Ndalohet prangosja e një personi në mënyrë më të shtrënguar sesa është e nevojshme ose vendosja e prangave pa qenë e nevojshme në situata poshtëruese (p.sh. në sy të familjarëve në dhomën e vizitës).

¹⁰³

¹⁰⁴ European Committee for the Prevention of Torture (CPT), 2nd General Report on the CPT's activities 1 January – 31 December 1991, [CPT/Inf (92) 3], 13 April 1992, para. 53.

¹⁰⁵ *Instruments of restraint. Addressing risk factors to prevent torture and ill-treatment.* Detention Monitoring Tool. Factsheet. Penal Reform International. https://www.apr.ch/sites/default/files/publications/factsheet-5_use-of-restraints-en.pdf

- Ndalohet përdorimi i instrumenteve kufizuese, si prangave, si sanksion për shkelje disiplinore.
- Është gjithashtu e rëndësishme që:
- Mjetet kufizuese duhet të hiqen para se të burgosurit të dalin para një autoriteti gjyqësor apo administrativ për të shmangur poshtërimin dhe për të reduktuar rrezikun që të burgosurit të prezumohen fajtorë apo të rrezikshëm, ngaqë janë të lidhur me pranga.
- Në momentin që të burgosurve u janë vënë mjete kufizuese, mbi ta nuk duhet të përdoret asnjë lloj tjetër force, në qoftë se ata nuk përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë apo kërcënim serioz që nuk mund të përmbahet me mjete më pak ekstreme.
- Të burgosurit që mbahen në çfarëdolloj forme kufizimi, duke përfshirë edhe prangosjen, duhet të mbahen vazhdimisht nën mbikqyrje, siç rekomandohet nga KPT-ja.
- Duhet treguar kujdes i veçantë kur përdoren mjete kufizuese tek të burgosurit e sëmurë apo të lënduar, të burgosurit e moshuar dhe tek ata në gjendje fizike specifike apo me probleme të shëndetit mendor.

Nga garancitë e mësipërme del se “prangosja e dyfishtë” është e panevojshme dhe e ndaluar: i burgosuri nuk duhet të lidhet pas një personi tjetër apo një objekti.

Shih gjithashtu: Manualin e Trajnimit të OKB-së për teknikat e vendosjes së prangave, 2015

Vendosja e prangave:

- I. Për të hapur mjetet e kufizimit, shtypni nifullën e mjetit kufizues. Kjo pjesë rrotulluese e njësisë do të kalojë përmes nifullës së palëvizshme dhe tani mjeti kufizues është i hapur për t’u përdorur.
- II. Pasi të jetë vendosur mjeti i kufizimit, në shumicën e rasteve do t’ju duhet ta kyçni dy herë atë. Për t’i kyçur prangat dy herë shtypni gjilpërën e kyçjes së dyfishtë duke përdorur aktivizuesin e mbylljes së dyfishtë që ndodhet në trupin e prangave. Pasi të jetë çliruar gjilpëra, kontrolloni për t’u siguruar se mekanizmi i kyçjes së dyfishtë është aktivizuar duke shtypur njëherë nifullën lëvizëse. Nëse njësia është e kyçur dy herë, atëherë nifulla do të rrijë e fiksuar.

Procedurat e vendosjes së prangave:

Procedurat e mëposhtme do të përdoren gjatë vendosjes së prangave te të burgosurit:

- I. Punonjësi do të qëndrojë në anë të të burgosurit, nëse duart prangosen përpara trupit dhe pas të burgosurit, nëse prangosja do të bëhet me duart pas kurrit.
- II. Ai/ajo do të mbajë prangat në dorën e fortë, duke i mbajtur ato të mbyllura me nifullën e palëvizshme lart dhe me vendin e çelësit që sheh pëllëmbën e policit.
- III. Punonjësi do të mbajë kyçin e të burgosurit me dorën e tij ose të saj dhe do ta vendosë nifullën e prangës te kyçi i të burgosurit. Metoda e parapëlqyer e prangosjes së një të burgosuri është duke i mbajtur pëllëmbët e të burgosurve për lart dhe duart e tij të bashkuara me kurrit.
- IV. Punonjësi shtyp poshtë mjetin kufizues duke bërë që nifulla e prangave të futet brenda nifullës së palëvizshme. Prangat shtrëngohen aq sa nifullat e saj zor se

mund të kalojnë mbi zonën e kyçit. Kufizimet nuk duhet të jenë aq të shtrënguara sa të ndalojnë qarkullimin e gjakut.

- V. Teksa ruhet kontrolli i prangave, polici vendos edhe unazën tjetër të prangave në po të njëjtën mënyrë të kyçi tjetër.
- VI. Pasi të siguroheni që të dyja unazat janë mbyllur si duhet, bëni mbylljen e dyfishtë të prangave.
- VII. Për të hequr prangat, qëndroni në anë dhe hiqni unazën që ndodhet më pranë jush dhe, teksa mbaheni nga prangat, tërhiqeni unazën tjetër më pranë jush dhe hiqeni.

Si përfundim, me mbarimin e temës ju duhet të jeni të aftë:

- Të shpjegoni se çfarë janë pajisjet, mjetet e sigurimit apo të kufizimit.
- Të shprehni arsyet për përdorimin e mjeteve të sigurimit.
- Të identifikoni mjetet e miratuara të sigurimit që përdoren në burgjet e Shqipërisë.
- Të demonstroi përdorimin e duhur të mjeteve të sigurimit.
- Të shpjegoni përse të burgosurit çlirohen nga mjetet e kufizimit.

Pyetje dhe diskutime

- 8. Cilat janë katër arsye për përdorimin e mjeteve kufizuese?
- 9. Përse mund të hapen prangat nga dora e të burgosurit?
- 10. Demonstroni në klasë procesin e prangosjes, nën praninë e instruktorit.

Mbyllje

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën, diversitetin, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës